RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
MBI AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË NË
"MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE"

TIRANË, 2026

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 3
I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit. 3
1.2. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit. 6
II. HYRJA 8
1. Objektivat dhe qëllimi. 8
2. Identifikimi i çështjes: 10
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim: 10
4. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH: 10
5. Kriteret e vlerësimit: 11
6. Standardet e Auditimit 12
7. Medodat e auditimit 12
8. Dokumentimi i auditimit 13
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT 13
1. Informacion i Përgjithshëm 13
2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit. 14
2.1 Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit. 14
2.2 Mbi zbatimin e dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare. 57
2.3 Mbi prokurimet e fondeve publike. 84
2.4 Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm. 252
2.5 Të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit. 270
IV. GJETJE DHE REKOMANDIME 276
A. MASA ORGANIZATIVE 276
B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI 290
C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE. 293
D. PËR AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK 294
E. MASA DISIPLINORE 295
F. MASA ADMINISTRATIVE 296

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

a. Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 110/1 prot., datë 24.01.2025, i ndryshuar, Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), për periudhën 01.01.2023 deri me datën 31.12.2024.

Funksioni i Ministrisë së Shëndetësisë është të hartojë, zhvillojë dhe zbatojë politikat kombëtare në fushën e shëndetësisë, me qëllim përmirësimin e shëndetit publik dhe garantimin e aksesit të barabartë në kujdesin shëndetësor për të gjithë qytetarët. MSHMS, në përputhje me drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim dhe me programin e Këshillit të Ministrave e ushtron veprimtarinë e saj në fusha të përgjegjësisë shtetërore të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr.609, datë 20.10.2021 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale". Gjithashtu funksionet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përcaktohen në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit, të miratuar me Urdhër nr.457, datë 26.08.2024 sipas legjislacionit në fuqi. Financimi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (këtu e më poshtë MSHMS) realiziohet si në vijim:

Shpenzimet për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, mallra dhe shërbime (llogaritë ekonomike 600, 601, 602, 606 dhe 230–231) mbulohen nga fondet e brendshme buxhetore.

Shpenzimet për investime (llogaritë 230 dhe 231) financohen nga fonde buxhetore, po ashtu edhe nga financimi i huaj.

b. Rëndësia e auditimit.

Rëndësia e auditimit të përputhshmërisë të MSHMS për periudhën e aktivitetit 2023-2024, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore, qëndron në pasqyrimin në mënyrë sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese, në të gjitha fushat që ajo administron.

c. Qëllimi i auditimit.

Qëllimi i këtij auditimi është përputhshmëria e veprimtarisë së subjektit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimit dhe shpenzimet vjetore të institucionit.

Nëpërmjet auditimit të përputshmërisë do të jepet një vlerësim objektiv, profesional e i pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- *Veprimtaria e institucionit të MSHMS,*
- *Hartimi dhe zbatimi i buxhetit;*
- *Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare;*
- *Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik.*

- Zbatimi i dispozitave ligjore në funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes së të dhënave.

Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efiçencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku.

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve. Zgjedhja i transaksioneve të kryera përgjatë vitit 2023 dhe vitit 2024, është bërë bazuar në ISA 530 (i rishikuar) "Kampioni i auditimit" dhe ISSAI 1530 "Shënime praktike mbi ISA 530".

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 1,524 milion lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve të aparatit. Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimi si: *Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.*

e. Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se MSHMS për periudhën në auditim, paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 31 gjetje dhe ka dhënë 49 rekomandime nga të cilat 24 masa organizative, 7 masa shpërblim dëmi, 2 masa për eliminimin e efekteve financiare negative, 1 masë për Agjencinë e Prokurimit Publik, si dhe 8 masa disiplinore dhe 7 masa administrative.

f. Gjetjet kryesore sipas drejtimeve.

Lidhur me hartimin dhe zbatimin e buxhetit, u konstatuan tejkalime të afatit për dërgimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) në fazën strategjike (faza I-rë), si dhe paraqitje të kërkesave buxhetore shtesë në fund të fazës teknike të PBA-së. Nga verifikimet rezultoi se disa projekte janë çelur pa kaluar procedurat e ciklit të miratimit të PBA-së, ndërsa në raste të tjera projektet janë realizuar në vlera më të larta se ato të planifikuara. Po ashtu, u evidentuan detajime të projekteve të investimit publik që nuk kanë qenë pjesë e PBA-së përkatëse dhe as të listës së investimeve publike të paraqitur me Projektbuxhetin e vitit.

MSHMS nuk ka ngritur një grup monitorimi për zbatimin e Projektit "Marrëveshja e Bashkëpunimit me Donatorë në disa raste. Për këto raste në pasqyrat financiare të vitit 2024, nuk janë pasqyruar detyrimet e prapambetura për rimbursimin e TVSH-së.

- MSHMS ka ekzekutuar pjesërisht vendime gjyqësore të formës së prerë për largime nga puna në vlera përkatësisht **9,739,882 lekë** për vitin 2023 dhe **33,205,362 lekë** për vitin 2024**, me pasojë efekt financiar negativ**. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm vendimesh të formës së prerë vijojnë të mbeten të paekzekutuara për periudha të gjata, deri në 13 vite, duke përfshirë raste që datojnë nga viti 2011.
- Aktualisht janë në proces shqyrtimi gjyqësor 10 çështje kundër MSHMS dhe institucioneve të varësisë, me objekt "Shpërblim dëmi jashtëkontraktor" si pasojë e mjekimit të pakujdesshëm.

Sipas të dhënave, 7 padi janë ende në proces, 2 janë rrëzuar, dhe 1 është pranuar pjesërisht nga gjykata e shkallës së parë. Këto çështje përbëjnë risk të drejtpërdrejtë financiar për institucionin, për shkak të mundësisë së shpërblimit të dëmit. Këto raste nuk janë reflektuar në pasqyrat financiare përkatëse.

Mbi procedurat e prokurimeve dhe zbatimit të kontratave

Nga auditimi u konstatua se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ushtron mbikëqyrjeje të mjaftueshme mbi zbatimin dhe monitorimin e kontratave të furnizimit me barna, duke ia lënë këtë përgjegjësi institucioneve spitalore të varësisë. Njësia e prokurimit nuk ka përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit dhe në marrëveshjet kuadër që, në fazën e zbatimit të kontratave, pavarësisht çmimit të ofertuar dhe të pranuar gjatë procedurës së prokurimit, barnat të mos tregtohen me shumicë mbi çmimin maksimal të lejuar. Në procedurat e prokurimit me objekt blerje pajisje mjekësore nuk është parashikuar detyrimi që operatori ekonomik i shpallur fitues, në momentin e lëvrimit të pajisjeve, t'i shoqërojë ato me certifikatën e regjistrimit të pajisjes mjekësore. U evidentua gjithashtu se MSHMS nuk ka kryer kontrollin paraprak për verifikimin e orendive dhe pajisjeve të mobilimit përpara marrjes së tyre në dorëzim nga komisionet përkatëse. Nga auditimi u konstatuan edhe mangësi në hartimin e kritereve të kualifikimit, të cilat lidhen me aplikimin e gabuar të vlerës për paraqitjen e punëve të ngjashme, mungesën e argumentimit për numrin e punonjësve dhe makinerive të kërkuara, si dhe vendosjen e kritereve të njëjta dhe të përsëritura për disponimin e stafit mbështetës përgjegjës kantieri, ndërkohë që njëkohësisht është kërkuar deklarimi i drejtuesve teknikë të punësuar me profile përkatëse inxhinierike.

Në tre raste nga skualifikimi në mënyrë të pa mbështetur në ligj është shkaktuar efekt negativ në menaxhimin e fondeve publike **në vlerën 6,620,452 lekë pa TVSH.**

- Në 7 raste, janë konstatuar likujdime për volume pune të pa kryera në vlerën totale prej **4,292,280 lekë** pa TVSH, me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.
- Nga verifikimi në terren në 8 qendra shëndetësore të rikonstruktuara, në kuadër të zbatimit të kontratave të lidhura me objekt furnizim me mobilje, rezulton se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka aplikuar e nuk ka ushtruar aktivitete të nevojshme të kontrollit në dy faza kritike të procedurës së prokurimit, si *planifikimi* dhe *verifikimi i marrjes në dorëzim të artikujve*. Për pasojë janë evidentuar raste ku sasia e artikujve të kërkuar dhe furnizuar nuk përputhet me nevojat reale të QSH-ve, duke tejkaluar ndjeshëm kapacitetin funksional dhe fizik të këtyre njësive. Si rezultat, një pjesë e artikujve të furnizuar ka rezultuar e panevojshme, duke çuar në shpërndarje të pajustifikuar të mobiljeve në qendra të tjera që nuk ishin përfshirë në planifikimin fillestar apo në magazinim të pajisjeve të papërdorura.

g. Rekomandimet kryesore:

Titullari i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të marrë masa për të siguruar respektimin e afateve dhe procedurave të përcaktuara në Udhëzimin plotësues vjetor dhe në Udhëzimin "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*"

Titullari i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të marrë masa për përfshirjen e plotë të projekteve në planifikimin buxhetor, duke shmangur realizimin e projekteve pa plan buxhetor me qëlim të rritjes së transparencës, monitorimit, efektivitetit dhe për të mundësuar një analizë reale të realizimit të shpenzimeve buxhetore.

Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të merren masa për të garantuar angazhimet buxhetore afatshkurtra me fonde buxhetore, me qëllim shmangien e detyrimeve të prapambetura

MSHMS duhet të vendosë procedura të qarta për kontrollin paraprak të furnizimeve, duke siguruar dërgimin e të gjitha specifikimeve teknike (shtojca 5) tek Drejtoritë Rajonale të OSHKSH-së, verifikim nga Komisioni i marrjes në dorëzim të përputhshmërisë së mallrave me kontratën dhe

specifikimet teknike, si dhe monitorimin e afateve të shpërndarjes së artikujve drejt qendrave shëndetësore, për të garantuar përputhshmërinë me kontratën dhe shmangien e vonesave.
MSHMS duhet të vendosë një mekanizëm të qartë për zbatimin e menjëhershëm të të gjitha vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duke prioritizuar rastet që nuk janë ekzekutuar për periudha të gjata, si dhe të sigurojë zbatimin e menjëhershëm të vendimeve gjyqësore për kthimin në detyrë të nëpunësve civilë
Titullari i MSHMS-së të marrë masat për ngritjen e një sistemi të brendshëm komunikimi ndërmjet Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Spitalor në MSHMS dhe institucioneve spitalore të varësisë, për grumbullimin, administrimin dhe analizimin e të dhënave mbi konsumin mesatar të barnave, sëmundshmërinë e mbuluar dhe diagnozat më frekuente, numrin e shtrimeve, si dhe nivelin e zbatueshmërisë së kontratave të lidhura për furnizim me barna, për të garantuar planifikimin e furnizimit me barna të mbështetur në të dhëna reale e të verifikuara nga MSHMS-ja.
Titullari i MSHMS-së të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një procedure të shkruar, që të shërbejë si udhëzim për institucionet spitalore të varësisë, lidhur me ndjekjen e zbatimit të kontratave nëpërmjet planit të zbatimit të kontratave
Autoriteti Kontraktor, në vijimësi, duhet të argumentojë specifikimet teknike, në mënyrë të tillë që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mosdiskriminim dhe konkurrencë, njëherazi duke garantuar përdorimin e fondeve publike me ekonomicitet dhe eficiencë.
MSHMS të marrë masa për referimin dhe ndjekjen e këtij rasti dhe rasteve të tjera potencialisht të ngjashme, ku çmimi i ofertuar/ pranuar për një/ disa barna gjatë fazës së procedurës së prokurimit është më i lartë se çmimi maksimal i lejuar për tregtimin me shumicë, pranë institucionit të varësisë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në çdo rast gjatë vlerësimit të ofertave nga operatorëve ekonomik, në rastet e ofertave anomalish të ulëta të pasqyrojë në sistemin e prokurimit elektronik si dhe të administrojë në dokumentacionin e dosjes kërkesën nga Autoriteti Konraktor ndaj Operatorëve Ekonomikë për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, si dhe dokumentacionin e Operatorit Ekonomik për shpjegime dhe argumentim për ofertën anomalisht të ulët.
MSHMS të marrë masa për ndjekien e të gjitha rrugëve ligjore për arkëtimin e vlerës totale prej 4,292,280 lekë për punime të pa kryera, likujduar në 7 raste.

1.2. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit.

Opinion për auditimin e përputhshmërisë (Kualifikuar[1]).
Mbështetur në, ISSAI 4000 "*Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë*", Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

[1] **Opinion i modifikuar/ kualifikuar:** Referuar Manualit të Përputhshmërisë të KLSH-së (vendim nr. 24, datë 29.12.2022 fq.104) *Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku,* ***janë materiale por jo të përhapura***".

"Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e MSHMS*, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një* ***opinioni të kualifikuar të përputhshmërisë****".*

Baza për opinionin e përputhshmërisë.

Në kemi audituar veprimtarinë e subjektit Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42. Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s); me parimet INTOSAI-PI, "Deklarata e Limës"; INTOSAI P-10, "Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t", si dhe INTOSAI P-12, INTOSAI P-20 dhe INTOSA P-50, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë". Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 56, datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga MSHMS dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa.

Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për përgatitjen e ***opinionit të kualifikuar.***

Raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara janë si më poshtë:

Lidhur me hartimin dhe zbatimin e buxhetit, u konstatuan tejkalime të afatit për dërgimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) në fazën strategjike (faza I-rë), si dhe paraqitje të kërkesave buxhetore shtesë në fund të fazës teknike të PBA-së. Nga verifikimet rezultoi se disa projekte janë çelur pa kaluar procedurat e ciklit të miratimit të PBA-së, ndërsa në raste të tjera projektet janë realizuar në vlera më të larta se ato të planifikuara. Po ashtu, u evidentuan detajime të projekteve të investimit publik që nuk kanë qenë pjesë e PBA-së përkatëse dhe as të listës së investimeve publike të paraqitur me Projektbuxhetin e vitit.

MSHMS nuk ka ngritur një grup monitorimi për zbatimin e Projektit "Marrëveshja e Bashkëpunimit me Donatorë në disa raste. Për këto raste në pasqyrat financiare të vitit 2024, nuk janë pasqyruar detyrimet e prapambetura për rimbursimin e TVSH-së.

- MSHMS ka ekzekutuar pjesërisht vendime gjyqësore të formës së prerë për largime nga puna në vlera përkatësisht **9,739,882 lekë** për vitin 2023 dhe **33,205,362 lekë** për vitin 2024**, me pasojë efekt financiar negativ**. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm vendimesh të formës së prerë vijojnë të mbeten të paekzekutuara për periudha të gjata, deri në 13 vite, duke përfshirë raste që datojnë nga viti 2011.
- Aktualisht janë në proces shqyrtimi gjyqësor 10 çështje kundër MSHMS dhe institucioneve të varësisë, me objekt "Shpërblim dëmi jashtëkontraktor" si pasojë e mjekimit të pakujdesshëm. Sipas të dhënave, 7 padi janë ende në proces, 2 janë rrëzuar, dhe 1 është pranuar pjesërisht nga gjykata e shkallës së parë. Këto çështje përbëjnë risk të drejtpërdrejtë financiar për institucionin, për shkak të mundësisë së shpërblimit të dëmit. Këto raste nuk janë reflektuar në pasqyrat financiare përkatëse.

Mbi procedurat e prokurimeve dhe zbatimit të kontratave

- Nga auditimi u konstatua se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ushtron mbikëqyrjeje të mjaftueshme mbi zbatimin dhe monitorimin e kontratave të furnizimit me barna,

duke ia lënë këtë përgjegjësi institucioneve spitalore të varësisë. Njësia e prokurimit nuk ka përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit dhe në marrëveshjet kuadër që, në fazën e zbatimit të kontratave, pavarësisht çmimit të ofertuar dhe të pranuar gjatë procedurës së prokurimit, barnat të mos tregtohen me shumicë mbi çmimin maksimal të lejuar. Në procedurat e prokurimit me objekt blerje pajisje mjekësore nuk është parashikuar detyrimi që operatori ekonomik i shpallur fitues, në momentin e lëvrimit të pajisjeve, t'i shoqërojë ato me certifikatën e regjistrimit të pajisjes mjekësore. U evidentua gjithashtu se MSHMS nuk ka kryer kontrollin paraprak për verifikimin e orendive dhe pajisjeve të mobilimit përpara marrjes së tyre në dorëzim nga komisionet përkatëse.
- Nga auditimi u konstatuan edhe mangësi në hartimin e kritereve të kualifikimit, të cilat lidhen me aplikimin e gabuar të vlerës për paraqitjen e punëve të ngjashme, mungesën e argumentimit për numrin e punonjësve dhe makinerive të kërkuara, si dhe vendosjen e kritereve të njëjta dhe të përsëritura për disponimin e stafit mbështetës përgjegjës kantieri, ndërkohë që njëkohësisht është kërkuar deklarimi i drejtuesve teknikë të punësuar me profile përkatëse inxhinierike.
- Në tre raste nga skualifikimi në mënyrë të pa mbështetur në ligj është shkaktuar efekt negativ në menaxhimin e fondeve publike **në vlerën 6,620,452 lekë pa TVSH.**
- Në 7 raste, janë konstatuar likujdime për volume pune të pa kryera në vlerën totale prej **4,292,280 lekë** pa TVSH, me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.
- Nga verifikimi në terren në 8 qendra shëndetësore të rikonstruktuara, në kuadër të zbatimit të kontratave të lidhura me objekt furnizim me mobilje, rezulton se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka aplikuar e nuk ka ushtruar aktivitete të nevojshme të kontrollit në dy faza kritike të procedurës së prokurimit, si *planifikimi* dhe *verifikimi i marrjes në dorëzim të artikujve*. Për pasojë janë evidentuar raste ku sasia e artikujve të kërkuar dhe furnizuar nuk përputhet me nevojat reale të QSH-ve, duke tejkaluar ndjeshëm kapacitetin funksional dhe fizik të këtyre njësive. Si rezultat, një pjesë e artikujve të furnizuar (p.sh. deri në 55% të vlerës totale të artikujve për QSH nr. 2 Vlorë, 31% të vlerës për QSH Bicaj, etj.) ka rezultuar e panevojshme, duke çuar në shpërndarje të pajustifikuar të mobiljeve në qendra të tjera që nuk ishin përfshirë në planifikimin fillestar apo në magazinim të pajisjeve të papërdorura.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH*", në zbatim të Programit të Auditimit me nr. 110/1 prot., datë 24.01.2025, i ndryshuar, në MSHMS, nga data 27.01.2025 deri më datën 31.07.2025, për periudhën e auditimit 01.01.2023 deri më 31.12.2024, u krye auditim i Përputhshmërisë, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. R. K., (*përgjegjës grupi*),
2. D. P., anëtar
3. A. M., anëtar
4. E. K., anëtar
5. K. N., anëtar
6. A. H., anëtar
7. A. R., anëtar

1. Objektivat dhe qëllimi.

Objektivi specifik i auditimit është përputhshmëria e veprimtarisë së subjektit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimit dhe shpenzimet vjetore të institucionit.

Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" në nenin 3 të tij ka përcaktuar se, "Auditim i përputhshmërisë nënkupton dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord". Neni 12 "Auditimi i përputhshmërisë" i po këtij ligji është shprehur se: "Në auditimet e përputhshmërisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të përcaktojë: nëse të ardhurat dhe shpenzimet kanë qenë në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik". Në pikën 2 të po këtij neni ka përcaktuar se "Auditim financiar" nënkupton një vlerësim të pavarur, që rezulton në një opinion me siguri të arsyeshme, nëse gjendja e raportuar financiare e një subjekti të audituar, rezultatet dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar.

ISSAI 4000, paragrafi 23: Objektivi kryesor i auditimit të përputhshmërisë është t'i sigurojë përdoruesit të synuar informacione nëse entitetet publike të audituara ndjekin vendimet parlamentare, ligjet, aktet legjislative, politikat, kode të përcaktuara dhe terma të dakordësuar.

ISSAI 1700, paragrafi 4: Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

a. Dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.

b. njëherësh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kritereve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik).

c. promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve:

-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

-nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

- verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare.

- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

Qëllimi i auditimit është vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin financiar, mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në

mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, me synim të mirë përdorimit të fondeve të financuara nga Buxheti i Shtetit.

2. Identifikimi i çështjes:

Raporti Përfundimtar synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësive të institucionit të Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat nënligjore në fuqi. Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së "Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale", për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2023 deri në 31.12.2024, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni. Përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e drejtorive përkatëse të MSHMS, të cilat realizojnë koordinimin dhe zbatimin e strategjive që orientojnë në hartimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme të institucionit.

Në funksion të këtij angazhimi, janë vlerësuar aktivitetet që kanë të bëjnë me respektimin e kritereve mbi administrimin e shpenzimeve, buxhetimin dhe menaxhimin financiar, prokurimet publike, respektimin e organigramës dhe të strukturës organike, etj.

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit nr.110/1, datë 24.01.2025.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Niveli menaxherial i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi menaxherial është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

4. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Audituesit e KLSH-së kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e paracaktuara, e shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinioni.

Audituesit e KLSH-së kanë përgjegjësi që nëpërmjet auditimit të realizuar, të krijojnë bindjet për të shprehur një opinionin mbi çështjet që janë nën auditim.

Audituesit e KLSH-së kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet etj;

- njëherësh aspektet e përputhshmërisë (respektimi i kritereve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik);

- promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-së) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

a) nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;

c) nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji Organik i Buxhetit apo Ligji i Prokurimit Publik, etj.

b) nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;

c) Interesin publik ose pritshmëritë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, etj.)

d) Fusha specifike që janë objekt i fokusit ligjvënës, etj;

Në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t, përkatësisht ISSAI 100 "Parimet themelore të auditimit në Sektorin Publik" (rishikimi i vitit 2019), paragrafi 41 "Materialiteti" dhe ISSAI 400 "Parimet e auditimit të përputhshmërisë", (rishikimi i vitit 2019), paragrafi 47 , ku nënvizohet se:

"Audituesit duhet të marrin në konsideratë materialitetin gjatë gjithë procesit të auditimit. Përcaktimi i materialitetit është çështje gjykimi profesional dhe varet në interpretimin e auditorit të nevojave të përdoruesve. Një çështje mund të gjykohet material nëse njohuritë për të do të kishin të ngjarë të ndikonin në vendimet e përdoruesit e synuar. Ky gjykim mund të ketë të bëjë me një çështje individual ose me një grup të çështjeve të marra së bashku. Materialiteti shpesh konsiderohet në kuptim të vlerës, por gjithashtu ka aspekte të tjera sasiore si dhe cilësore. Karakteristikat e qenësishme një çështjeje ose grupi të çështjeve mund të jenë materiale nga vetë natyra e saj. Një çështje mund të jetë gjithashtu materiale për shkak të kontekstit në të cilin ndodh".

Sa më sipër, audituesit aplikojnë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

5. Kriteret e vlerësimit:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Ligji 10296, datë 08.07.2010 "Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26,06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar;
- Ligji nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"
- Ligji nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutike";
- Ligji nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore", i ndryshuar;
- VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik";

- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar;
- Urdhër i MFE nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK” i ndryshuar,
- Udhëzimi MFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”;
- Udhëzimet standard të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 7, datë 17.01.2024 të Kryetarit të KLSH-së, e ndryshuar.

6. Standardet e Auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuara të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Raporti Përfundimtar i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- INTOSAI – P - 1 “Deklarata e Limës”;
- INTOSAI – P – 10 - 99 “Parimet themelore të INTOSAI”;
- INTOSAI – P - 10 “Deklarata e Meksikës mbi pavarësinë e SAI”;
- INTOSAI – P - 12 “Vlerat dhe përfitimet e SAI – sjellja e ndryshimit në jetën e qytetarëve”;
- INTOSAI – P - 20 “Parimet e Transparencës dhe Llogaridhënies”;
- INTOSAI – P - 50 “Parimet e juridiksionit të SAI”;
- ISSAI 100 - 129 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”;
- ISSAI 2000 - 2899 “Standardet e Auditimit Financiar”;
- ISSAI 400 “Parimet e Auditimit të Përputhshmërisë”;
- ISSAI 4000 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”;
- ISSAI 2705 “Modifikimet e opinionit në Raportin e Audituesit të Pavarur”;
- Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 64, datë 22.06.2020;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 66, datë 23.06.2020.

7. Medodat e auditimit

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analiza të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve ne regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike si dhe në kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

Auditimi ynë ka përfshirë përputhshmërinë e aktivitetit të MSHMS,, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi lidhur me zbatimin e kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet

vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, zbatimin e kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar, parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore, planifikimin mbi identifikimin vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e informacioneve dokumenteve , procedurat për qarkullim e dokumentacionit, prokurimet duke filluar nga buxhetimi i fondit, hartuesi i specifikimeve, komisionet e vlerësimit, kontraktuesi, zbatuesi i kontratës, procedurat për pagesat, etj.

8. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit Përputhshmërisë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 66, datë 23.06.2020, , si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 "Dokumentimi i Auditimit".

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Teknikat e kontrollit të përdorura gjatë auditimit janë; kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, rezultateve të akt konstatimeve, dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar u përgatit ky Raport Përfundimtar Auditimi.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i Përgjithshëm

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është institucioni shtetëror përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave kombëtare në fushën e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale në Shqipëri. Ajo luan një rol kyç në garantimin e shërbimeve bazë për qytetarët, duke ndikuar direkt në cilësinë e jetës dhe mirëqenien e popullsisë. MSHMS ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor, e cila është përgjegjëse për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe për bashkërendimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve, brenda dhe jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor, të cilët kontribuojnë dhe synojnë të garantojnë të drejtën kushtetuese, të përcaktuar në nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu ka si mision garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje e përfshirje sociale dhe përkujdesje sociale e shanse të barabarta.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

2.1 Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.

Viti 2023

a. Zbatimi i kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

Financimi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (këtu e më poshtë MSHMS) realizohet si në vijim:

Shpenzimet për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, mallra dhe shërbime (llogaritë ekonomike 600, 601, 602, 606 dhe 230–231) mbulohen nga fondet e brendshme buxhetore.

Shpenzimet për investime (llogaritë 230 dhe 231) financohen nga fonde buxhetore si dhe nga financimi i huaj.

Në fazën e planifikimit buxhetor afatmesëm 2023-2025, buxheti i miratuar për MSHMS paraqitet i ndarë sipas shtatë programeve të miratuara si më poshtë vijon:

1.Planifikim Menaxhim Administrimi (01110);
2.Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor (07220);
3.Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor (07330);
4.Shërbime të Shëndetit Publik (07450);
5.Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore (07460)
6.Përkujdesja Sociale (10430);
7.Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë (01190).

Viti 2023

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2023 në nivel llogarish ekonomike

Grupi i auditimit shqyrtoi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) për vitin buxhetor 2023, sipas klasifikimit ekonomik të shpenzimeve, me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë ndërmjet planifikimit buxhetor (fillestar dhe të rishikuar) dhe realizimit faktik të shpenzimeve, si dhe evidentimin e devijimeve kryesore sipas zërave të shpenzimeve.

Analiza u krye në nivel të llogarive ekonomike dhe rezultatet paraqiten në tabelën në vijim.

Tabela nr. 1: "Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të vitit 2023 sipas llogarive ekonomike"

Emërtimi	Viti paraardhës 2022	Periudha raportuese	Periudha raportuese	Periudha raportuese	Ndryshimi Vjetor (Plan - Fakt)
	Shpenzime Faktike	Plani Fillestar Vjetor Viti 2023	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2023	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive	
	(1)	(2)	(3)	(4)	10 (3-4)
Paga 600	13,204,439,930	3,911,091,000	15,034,192,944	15,001,896,804	32,296,141
Sigurime Shoqërore 601	2,137,046,731	649,211,000	2,470,433,000	2,451,862,249	18,570,752
Mallra dhe Shërbime të Tjera 602	13,386,892,578	2,567,156,000	13,347,023,600	12,943,271,519	403,752,081
Subvencione 603	0	0	0	0	0
Transferta Korente të Brendshme 604	13,784,597,000	37,459,000,000	13,157,280,000	13,132,071,300	25,208,700
Transferta Korente të Huaja 605	1,882,322,050	697,570,000	461,731,400	452,803,524	8,927,876
Trans per Buxh. Fam. & Individ 606	29,782,443,159	29,150,000,000	30,599,310,056	30,114,430,322	484,879,734
Nen-Totali Shpenzime Korrente	**74,177,741,448**	**74,434,028,000**	**75,069,971,000**	**74,096,335,717**	**973,635,283**
Kapitale të Patrupëzuara 230	5,066,032	42,500,000	9,248,847	9,231,602	17,245
Kapitale të Trupëzuara 231	1,004,642,754	1,859,200,000	1,533,751,153	1,470,494,486	63,256,667
Nen-Totali Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	**1,009,708,786**	**1,901,700,000**	**1,543,000,000**	**1,479,726,088**	**63,273,912**
Kapitale të Patrupëzuara 230	284,760,552	0	600,000	176,454,790	-175,854,790
Kapitale të Trupëzuara 231	1,752,284,640	1,710,000,000	738,800,000	464,678,340	274,121,660
Nen-Totali Shpenzime Kapitale me financim te huaj	**2,037,045,192**	**1,710,000,000**	**739,400,000**	**641,133,130**	**98,266,870**
Totali Shpenzime Kapitale	**3,046,753,978**	**3,611,700,000**	**2,282,400,000**	**2,120,859,218**	**161,540,782**

Totali i Shpenz. Buxhetore t	**77,224,495,426**	**78,045,728,000**	**77,352,371,000**	**76,217,194,935**	**1,135,176,065**
Shpenzime nga te Ardhurat Jashtë limitit	**427,234,417**			**387,726,930**	
Totali (Korrente + Kapitale + Shpenz.nga të ardh.jashtë limti	**77,651,729,843**			**76,604,921,866**	

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

Shpenzimet korrente zënë peshën më të madhe të buxhetit të MSHMS për vitin 2023, duke zënë rreth 97% të totalit në planifikim dhe rreth 97% në realizim. Brenda tyre, pjesën kryesore e zënë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore, si dhe transfertat për familjet dhe individët. Shpenzimet kapitale përbëjnë pjesën më të vogël të buxhetit dhe kanë nivel realizimi më të ulët, veçanërisht ato me financim të huaj. Kjo problematikë është evidentuar gjithashtu në analizën e shpenzimeve për investime me financim të huaj në këtë Projekt Raport Auditimi.

Programimi i PBA-së 2023-2025 dhe i buxhetit i shpenzimeve të vitit 2023

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent i Sistemit të Planifikimit të Integruar. Ky dokument përdoret për të informuar Kuvendin e Shqipërisë dhe publikun e gjerë lidhur me planet e shpenzimeve të qeverisë për tre vitet e ardhshme, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të qeverisë. Ai përcakton kontekstin afatmesëm të buxhetit vjetor. Kërkesat buxhetore të institucionit hartohen në bazë të programit buxhetor afatmesëm, në mënyrë që shpërndarjet e fondeve buxhetore të reflektojnë qëllimet e politikës dhe iniciativat e përcaktuara në programin e qeverisë gjatë një periudhe 3-vjeçare, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit të MFE nr.7 datë 28.02.2018, "*Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm*" dhe Udhëzimit plotësues nr. 9, datë 28.02.2022 dhe nr. 22, datë 08.07.2022 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025".

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për "*Fondin e pagave & sigurimeve shoqërore*" (llog 600 dhe 601), është bazuar në nivelin aktual të punonjësve dhe strukturës së miratuar për secilin program buxhetor të pagave sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Llogaritja për shpenzime të tjera korrente (llog 602-606) është bazuar në kërkesat e institucioneve të varësisë së këtij institucioni, tavaneve të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë2, limiteve të shpenzimeve të periudhave paraardhëse dhe realizimit të pritshëm të vitit.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së I-rë të PBA 2023-2025

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" dhe Udhëzimit të MFE nr. 9 datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e PBA 2023-2025", MSHMS ka hartuar dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, Faza I-rë, i cili është dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 1350/1 prot., datë 03.05.2022, protokolluar në MFE me nr. 5771/60, datë 26.05.2022, në tejkalim të afatit të përcaktuar në pikën 9/a të Udhëzimit plotësues nr. 9 datë.28.02.2022, ku përcaktohet se afati për dorëzimin e kërkesave buxhetore të PBA 2023-2025 për fazën strategjike, është deri ne datë 2 Maj 2022.

2 Ministria e Financave, prej muajit Janar të vitit 2024.

Me VKM nr. 130 datë 02.03.2022 *"Për miratimin e tavaneve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025*", janë miratuar tavanet përgatitore për ministritë dhe institucionet buxhetore.
Me Urdhrin Ministrit të MSHMS nr. 187 datë 25.03.2022, protokolluar me nr. 1408, datë 25.03.2022 "*Për ngritjen e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve në Sistemin e MSHMS, për hartimin e PBA 2023-2025*", është krijuar EMS për secilin program buxhetor dhe me Urdhrin e Ministrit nr. 190 datë 25.03.2022 *"Për krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik*", u ngrit GMS në MSHMS, veprime këto në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm"*.
Për verifikimin e kërkesave buxhetore të paraqitura nga MSHMS në fund të fazës strategjike të PBA 2023-2025, grupi i auditimit verifikoi Formatet 2 dhe 3 të plotësuara nga kjo e fundit si dhe kërkesat shtesë të paraqitura në faqen e Ministrisë së Financave, konkretisht aneksi nr. 4 "*Kërkesat shtesë në fund të fazës së parë të PBA 2023-2025*". Fondet e planifikuara, sipas programeve të MSHMS paraqiten në mënyrë të detajuar si në vijim:

Tabela nr. 1/1 "Kërkesat Buxhetore të MSHMS sipas programeve buxhetore krahasuar me tavanet përgatitore të PBA 2023-2025, miratuar me VKM nr. 130/2022"

Në mijë lekë

Prog.	Emërtimi i Programi	Tav. Përgatitor 2023	Kërkesat në fund të fazës së I-rë		Tavan VKM nr. 130/2022	
			2023	Shtesë	2024	2025
1110	Plani. Menaxhimi & Admini	348,000	368,000	20,000	378,000	458,000
7220	Shërbimi i Kujdesit Parësor	8,750,000	9,654,909	904,909	8,900,000	8,420,900
7330	Shërbimi i kujdesit dytësor	32,992,020	34,681,317	1,689,297	33,663,020	34,169,020
17450	Shërbimet e Shëndetit Publik	5,228,108	5,305,028	76,920	3,678,108	3,678,108
7460	Shërbimi Kombëtar i Urgjencës	484,600	464,600	-20,000	525,000	525,000
10430	Përkujdesi Social	27,280,000	27,365,347	85,347	7,680,000	28,180,000
1190	Reha. i të Përndjek. politik	1,035,000	1035000	-	1,050,000	1,050,000
TOTALI		76,117,728	78,874,201	2,756,473	75,874,128	76,481,028

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

Nga tabela më sipër rezulton se në fund të fazës së parë të planifikimit buxhetor afatmesëm, për vitin 2023, janë paraqitur kërkesa shtesë (kërkesat shtesë në tabelën më sipër janë plotësuar sipas Aneksit nr. 4 të PBA 2023-2025, faza I-rë), për shpenzime korrente dhe kapitale në shumën 2,756,473 3mijë lekë e cila përbëhet nga:

- Shpenzime kapitale në shumën 270,806 mijë lekë;
- Shpenzime korrente në shumën 2,485,667 mijë lekë.

Grupi i auditimit testoi saktësinë e paraqitjes së kërkesave për fonde të paraqitura për fazën e parë, nëpërmjet formateve standard 2 dhe 3, për vitin 2023 nga ku rezultoi se:
- rezultojnë Formate nr. 3 (F3) të plotësuara për 4 programe buxhetore ndërsa sipas aneksit nr. 4 në faqen e MF "*Kërkesat shtesë në fund të fazës së I-rë*", rezulton se ka një shtim fondi në shumën 20,000 mijë lekë në programin "*Planifikimi, Menaxhim dhe Administrim (01110)*" dhe pakësim në të njëjtën shumën në programin "*Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë (01190)*", gjë e cila nuk reflektohet me Formatet nr. 3 të paraqitura nga MSHMS;
Kërkesat buxhetore për politikat ekzistuese, të paraqitura në formatin standard nr. 2, sipas programeve kanë respektuar tavanet përgatitore, të përcaktuara me anë të VKM nr. 130, datë 02.03.2022;

3 Shumë e konfirmuar dhe me kërkesat shtesë të PBA 2023-2025, aneksi 4.

Në lidhje me formatet nr. 3, grupi i auditimit mori kërkesat për çdo produkt dhe i verifikoi nëse janë pjesë e Formatit nr. 2 (për të verifikuar nëse janë shtesë për politikën ekzistuese), pasi sipas nënpikës 7 të pikës 3 të Udhëzimit Plotësues nr. 9, datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025", përcaktohet se: "Në rastin kur kostoja për financimin e politikave ekzistuese tejkalon tavanin indikativ të alokuar për programin buxhetor të njësisë së qeverisjes qendrore me 4%, pjesa e kostos detajuar në nivel programi/objektivi/produkti do të paraqitet si pjesë e propozimeve të reja".
Dhe në rastet kur produkti paraqitej si politikë ekzistuese është hequr shuma përkatëse në F2 për të evidentuar vetëm shtesat, të cilat janë krahasuar me Kërkesat shtesë sipas aneksit nr.4 të PBA 2023-2025, Faza I-rë, nga ky kryqëzim i të dhënave dhe përllogaritjet përkatëse ka rezultuar situata si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 2: "Verifikimi i saktësisë së paraqitjes së kërkesave buxhetore, sipas programeve të MSHMS gjatë fazës së parë të PBA 2023-2025"

Në mijë lekë

Format nr. 2	**Format nr.3**	**Kërkesa shtesë**	**Aneksi 4**	**Përputhje**
01110				
	n/a	n/a	20,000,000	Nuk rakordojnë
01190				
	n/a	n/a	- 20,000,000	Nuk rakordojnë
				07220
11,648,843,000	11,648,843,000	-		
11,905,067,000	12,616,090,000	711,023,000		
	112,600,000	112,600,000		
	600,000	600,000		
	10,000,000	10,000,000		
	14,686,000	14,686,000		
	20,000,000	20,000,000		
	6,000,000	6,000,000		
	10,000,000	10,000,000		
	20,000,000	20,000,000		
Totali 07220	24,458,819,000	904,909,000	904,909,000	Rakordojnë
				07330
23,512,812,000	25,202,109,000	1,689,297,000		
24,000,000	24,000,000	-		
Totali 07330		1,689,297,000	1,689,297,000	Rakordojnë
				10430
274,050,000	359,397,000	85,347,000		
totali 10430		85,347,000	85,347,000	Rakordojnë
				07450
13,480,000	45,980,000	32,500,000		
200,000	620,000	420,000		
	34,000,000	34,000,000		
	10,000,000	10,000,000		
Totali 07450		76,920,000	76,920,000	Rakordojnë
Totali		2,756,473,000	2,756,473,000	Rakordojnë

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

Nga tabela më sipër rezulton se nuk rakordojnë të dhënat në lidhje më kërkesat shtesë mes Aneksit nr. 4 dhe Formateve nr. 3 për programet 01110 dhe 01190.
Në lidhje me kërkesat buxhetore shtesë rezultoi se ato janë të shoqëruara me relacion shoqërues, në zbatim të pikës 8/g , të kapitullit 1, të Udhëzimit nr. 7/2018 "*Për procedurat Standarde të përgatitjes së PBA".*
Gjatë kësaj faze nuk disponohet dokumentacion në lidhje me takimet e zhvilluara me shoqërinë civile, kjo në kundërshtim me përcaktimet e pikës 8/c të Udhëzimit plotësues nr. 9/2022 "*Për përgatitjen e PBA 2023-2025".*

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se kërkesat buxhetore të Fazës së Parë për shpenzime korrente dhe kapitale janë përgatitur nga MSHMS dhe nuk janë paraqitur kërkesa buxhetore nga institucionet e varësisë.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së II-të të PBA 2023-2025

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 janë miratuar me VKM nr. 536 datë 29.07.2022 "Për miratimin e tavaneve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025".

Me shkresën nr. 3192/1 prot., datë 31.08.2022 të Ministrit të MSHMS-së, janë përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në MFE, kërkesat buxhetore, pasqyrat plotësuese dhe relacioni shoqërues për fazën e II-të të PBA 2023-2025 (në përputhje me pikën 8.6, kapitulli 1 i udhëzimit standard për përgatitjen e PBA-së) për institucionet e varësisë dhe aparatin e MSHMS-së në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, pra brenda afatit dhe sipas formatit të përcaktuar në pikën 10/d të Udhëzimit plotësues nr. 22, datë 08.07.2022 "Për përgatitjen e PBA 2023-2025".

Edhe në këtë fazë, MSHMS ka ri paraqitur Formate 3 "Për financimin e Politikave të reja", në kundërshtim me paragrafin III të kapitullit 3 të Udhëzimit "Standard për përgatitjen e PBA" ku përcaktohet: "Duke marrë parasysh që vendimet strategjike për buxhetin afatmesëm merren gjatë fazës së parë të përgatitjes së buxhetit, objektivi i fazës së dytë është përpunimi i detajeve teknike të buxhetit brenda "tavaneve të qëndrueshme të shpenzimeve" të vendosura gjatë fazës "strategjike". Objektivi kryesor i kësaj faze është të sigurojë që vendimet e marra gjatë fazës strategjike të zbatohen dhe që ligji vjetor i buxhetit të përgatitet në mënyrë efektive" si dhe në kundërshtim me pikën 3 të Udhëzimit plotësues nr. 22, datë 08.07.2022 ku përcaktohet se: "Objektivi i fazës teknike të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 është përpunimi i detajeve teknike të buxhetit brenda tavaneve përfundimtare të miratuara. Në këtë kuptim, Njësitë e Qeverisjes Qendrore nuk mund të ri-sjellin kërkesa për financimin e politikave të reja dhe kërkesa për mangësitë në financim të politikave ekzistuese".

Nga të dhënat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit, konstatohet se MSHM ka paraqitur Formate nr. 3 për programet: "*Shërbimi i Kujdesit Parësor*" (07220), "*Shërbimi i kujdesit dytësor*" (07330) dhe "*Përkujdesi Social*" (10430).

Sipas PBA të përgatitur nga MSHMS buxheti i planifikuar sipas fushave paraqitet si në tabelën më poshtë:

nga MSHMS buxheti i planifikuar sipas fushave paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 3 "Buxheti i planifikuar në PBA 2023-2025 sipas fushave

Në mijë lekë

Nr.	Fusha	Buxheti 2022	Plan 2023	Plan 2024	Plan 2025
1	Shëndetësia	60,368,370	60,001,028	61,087,428	62,274,328
2	Mbrojtja Sociale	26,698,130	27,000,000	27,400,000	27,900,000
3	Rehabilitimi i te përndjekurve politikë	1,035,991	1,035,000	1,035,000	1,035,000
4	Investimet	2,752,944	3,011,700	3,211,700	3,211,700

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

Shëndetësia
Për vitin 2023: buxheti total është parashikuar në total në shumën 60,001,028 mijë lekë, krahasuar me vitin 2022 ka pësuar një rënie prej 1%;
Për vitin 2024: buxheti total është parashikuar në total në shumën 61,087,428 mijë lekë, krahasuar me vitin 2023 është parashikuar në rritje me 1.81%;
Për vitin 2025: buxheti total është parashikuar në total në shumën 62,274,328 mijë lekë krahasuar me vitin 2024 është parashikuar në rritje me 1.94%.
Shënim: Në buxhetin për shëndetësinë janë të përfshira dhe kontributet shëndetësore.
Mbrojtja Sociale
Në vitin 2022 buxheti i kësaj fushe ka qenë në shumën 26,698,130 mijë lekë. Në PBA 2023-2025, MSHMS ka parashikuar:
Për vitin 2023: buxheti total është parashikuar në shumën 27,000,000 mijë lekë, i cili krahasuar me vitin 2022 është parashikuar në rritje me 2.7%;
Për vitin 2024: buxheti total është parashikuar në shumën 27,400,000 mijë lekë, krahasuar me vitin 2023 është parashikuar në rritje me1.5%;
Për vitin 2025: buxheti total është parashikuar në shumën 27,900,000 mijë lekë, krahasuar me vitin 2024 është parashikuar në rritje me 1.8%.
Rehabilitimi i të përndjekurve politikë
Në vitin 2022 buxheti i kësaj fushe ka qenë në shumën 1,035,991 mijë lekë. Në PBA 2023-2025, MSHMS ka parashikuar:
Për vitin 2023: buxheti total është parashikuar në shumën 27,000,000 mijë lekë, krahasuar me vitin 2022, ka pësuar një rënie prej 2.7%;
Për vitin 2024: buxheti total është parashikuar në shumën 27,400,000 mijë lekë, krahasuar me vitin 2023 është parashikuar në rritje me 1.5%;
Për vitin 2025: buxheti total është parashikuar në shumën 27,900,000 mijë lekë në total, krahasuar me vitin 2024 është parashikuar në rritje me 1.8%.
Investimet
Buxheti për investimet në vitin 2022 ka qenë 2,752,944 mijë lekë, prej të cilave 1,342,944 mijë lekë me financim të brendshëm dhe 1,410,000 mijë lekë me financim të huaj. Në PBA 2023-2025, MSHMS ka parashikuar:
Për vitin 2023: Buxheti total është parashikuar në shumën 3,011,700 mijë, prej të cilave 11,901,700 mijë lekë me financim të brendshëm dhe 1,100,000 mijë lekë me financim të huaj.
Për vitin 2024 buxhet total është parashikuar në shumën 3,593,000 mijë lekë, prej të cilave 2,483,000 mijë lekë me financim të brendshëm dhe 1,110,000 mijë lekë me financim të huaj;
Për vitin 2025: buxheti total është parashikuar në shumën 3,211,700 mijë lekë, prej të cilave 2,101,700 mijë lekë me financim të brendshëm dhe 1,110,000 mijë lekë me financim të huaj.

Kërkesat buxhetore të paraqitura në fund të fazës së dytë, nga programet e MSHMS janë paraqitur në afat.
Grupi i auditimit verifikoi pasqyrat bashkëlidhur Projekt Buxhetit Afatmesëm 2023-2025, të MSHMS-së, dërguar në MFE me shkresën nr. 3192/1, datë 31.08.2022 nga ku rezultuan pasaktësi në plotësimin e pasqyrës nr. 2, të cilat paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 4: "Testimi i paraqitjes së Pasqyrës nr. 2 të PBA 23-25, faza II-të bazuar në Formularët F2"

Në mijë lekë

Prog.	Sipas Pasqyrës nr. 2		Sipas Format 2		Test 230	Test 231
	230	231	230	231		
01110		3,000		18,000	Rakordojnë	Nuk Rakordojnë

07220		305,052		250,000	Rakordojnë	Nuk Rakordojnë
07330		1,619,968	63,000	2,262,020	Nuk Rakordojnë	Nuk Rakordojnë
07450		13,680		13,680	Rakordojnë	Rakordojnë
07460			5,000	120,000	Nuk Rakordojnë	Nuk Rakordojnë
10430		120,000		280,000	Rakordojnë	Nuk Rakordojnë

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

Nga tabela më sipër rezulton se:
- *Për programin 01110* – në pasqyrën nr. 2, llogaria 231 është paraqitur në shumën 3,000 mijë lekë, ndërsa sipas formatit F2 kjo llogari është paraqitur në shumën 18,000 mijë lekë, konkretisht 3,000 mijë lekë financim i huaj dhe 15,000 mijë lekë financim nga buxheti;
- *Për programin 07220*- nuk rakordon paraqitja e llogarisë 231, konkretisht në pasqyrën nr. 2 kjo llogari paraqitet në shumën 305,052 mijë lekë ndërsa sipas formatit nr. 2 në shumën 250,000 mijë lekë;
- *Për programin 07330*- nuk rakordon paraqitja e llogarisë 230, e cila nuk është plotësuar në pasqyrën nr. 2, ndërsa në Formatin nr. 2 paraqitet në shumën 63,000 lekë;
- *Për programin 07460* – nuk rakordon llogaria 203 dhe llogaria 231.
- *Për programin 10430*- gjithashtu nuk rakordojnë llogaria 230 dhe 231.

Me shkresën nr. 3736, datë 17.09.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS zj. J. D., i është kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, shtesë, në shumën 2,156,000 mijë lekë në tavanin e vitit 2023 për programin e "Përkujdesen Social, konkretisht:
- 1,200,000 mijë lekë për pagesën e aftësisë së kufizuar dhe
- 956,000 mijë lekë për pagesën e ndihmës ekonomike.

Me anë të shkresës nr. 4353/1, datë 16.11.2022 Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS i ka dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, shkresën "*Kërkesë për ndryshim të tavaneve mes programeve buxhetore të MSHMS*", ku është kërkuar ndryshimi si më poshtë:

Tabela nr. 5: "Ndryshimet e kërkuara nga MSHMS në shkresën nr. 4353/1, datë 16.11.2022"

Në mijë lekë

Programi	**Shuma**
7330	-150,000
Pakësim	-150,000
Shtesa	150,000
1110	80,000
7220	5,000
7450	35,000
10430	30,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

Pra për totalin e llogarisë 602 të programit 07330 është kërkuar pakësimi i fondeve dhe shtimi i llogarisë 602 për 4 programe të tjera, pa ndryshuar tavanin buxhetor të shpenzimeve korrente të MSHMS.
Me email e datës 27.12.2022, MSHMS ka dërguar në mënyrë elektronike Formatet nr. 2 të gjashtë programeve të saj, të cilët janë të rakorduara me tavanet buxhetore të ligjit nr. 84/2022, konkretisht tabelës nr. 1 të tij.

Çelja e fondeve buxhetore të vitit 2023

Detajimi i planit të buxhetit për shpenzimet korrente për programet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është bërë me shkresën nr. 23774/38, datë 20.01.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm të MFE, zj. M. Dh. *"Mbi detajimin e buxhetit për vitin 2023*", ndërsa për shpenzimet kapitale e shkresën e MFE nr. 23774/62, datë 23.01.2023, në mënyrë të detajuar shpenzimet buxhetore, të çelura në nivel programi paraqiten si në vijim:

Tabela nr. 6:"Plani fillestar sipas shpenzimeve dhe programeve"

Në mijë lekë

Prog.	Ligji 84/2022			II.Çelja shp korrente	II.Çelja sp. Kapitale	TOTALI
	Shp. Korrente	Shp. Kapitale	I. Totali			
01110	358,500	18,000	376,500	358,500	18,000	376,500
07220	7,855,933	509,318	8,365,251	7,855,933	509,318	8,365,251
07330	31,933,667	2,556,204	34,489,871	31,933,667	2,556,204	34,489,871
07450	4,037,428	150,400	4,187,828	4,037,428	150,400	4,187,828
10430	29,212,000	377,778	29,589,778	29,212,000	377,778	29,589,778
01190	1,036,500		1,036,500	1,036,500		1,036,500
Totali	**74,434,028**	**3,611,700**	**78,045,728**	**74,434,028**	**3,611,700**	**78,045,728**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

Nga tabela më sipër rezulton se fondet e çelura për shpenzimet korrente dhe kapitale rakordojnë me shpenzimet e paraqitura në ne ligjin nr. 84/2022 *"Për Buxhetin e vitit 2023*".

Shpenzimet e Investimeve

Investimet viti 2023

Për verifikimin e planifikimit të shpenzimeve për investime, grupi i auditimit, krahasoi projektet e investimeve me financim të brendshëm sipas planit të investimeve të miratuar në projekt buxhetin e vitit 2023 me projektet e çelura në vijim të miratimit të ligjit vjetor të buxhetit, nga ku rezultoi si më poshtë:

Tabela nr. 7: "Ndryshimet mes fondit të çelur me ligjin e buxhetit për vitin 2023 dhe planit sipas projekt buxhetit për projektet me financim të brendshëm".

Në mijë lekë

Prog.	Emërtimi i produkteve	Lista investim. PB	LB	Diferenca
		I.Σ e parashikuar	II.Σ e Çelur	II-I
7450	Ndërtim I godinës se re te laboratorëve te ISHP	200,000	96,000	-104,000
7450	Rikonstruksion i godinës qendrore te ISHP Tirane	72,800	-	-72,800
7450	Pajisje për laboratorët e ISHP	50,000	-	-50,000
7330	Rikonstruksion i godinës se QKTGjakut Tirane	99,416	49,416	-50,000
7330	RikoN. I qendrës se gruas, amb. pritëse dhe urgjencës se Maternitetit nr.2	47,500	-	-47,500
7220	TVSh & detyrim doganor për projektet me financim te huaj	26,000	-	-26,000
7330	F.V. pajisje tekno., elektrike për godi. ekzistuese te pediatrisë, me kredi te BB	136,235	116,235	-20,000
7220	Projekt-preventiva për rikonstruksionin e godinave te kujdesit shëndetit parësor dhe qsh-ve	20,000	-	-20,000
7220	F.V pajisje mjekësore dhe mobilimi per QSH te rikonstruktuara	10,000	-	-10,000
7450	Superv dhe kolaudim për ndërtimin e godinës se re te laboratorëve te ISHP	4,000	1,200	-2,800
7330	Rikonstruksion i poliklinikës se sp.Elbasan	60,300	58,352	-1,948
7220	Rikonstruksion i qendrave shendetesore	84,073	82,703	-1,370
7220	Ndërtim i godinës se re për akomodimin e qsh1, dhe njvksh Durrës	88,045	86,996	-1,049
7450	Superviz & kolaudim për rikonstruk. e godinës qendrore te ISHP Tirane	1,000	-	-1,000
7330	Superv+kolaudim për rikonstruksionin e godinës se QKTGjakut Tirane	1,803	900	-903
7330	Superv+kolaudim për rikonstruksion I godinës qendrore te sp.Diber	900	-	-900
7330	Rikonstruksion ne Maternitetin nr.1 Tirane faza II	26,500	26,000	-500
7330	Rikonstruksioni I Poliklinikes sp.Durres	50,500	50,000	-500
7330	Rikonstruksion i poliklinikës se sp.Shkoder	50,240	50,000	-240
7330	Supervi për rikon. e shtëpizave te mbështetura sp.Psikiatrik Vlore	290	541	251
7330	Rikon. & ndërtim e 1 godine te re SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë"	300,016	301,133	1,117

7220	Rikonstruksion i qendrave shëndetësore v.2023-2024	113,200	128,614	15,414
7450	Takse infrastrukture për godinën e re te ISHP	-	19,200	19,200
7450	TVSH sipas marrëveshjes për BE (EU4HEALTH)- "	-	34,000	34,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

Nga tabela më sipër rezulton se:

- 2 projekte [4], konkretisht "*Taksë infrastrukturë për godinën e re te ISHP*" dhe "*TVSH sipas marrëveshjes për BE (EU4HEALTH)*", janë çelur në shumën 53,200 mijë lekë, por nuk kanë qenë pjesë e Listës së Investimeve të miratuar me projektligj janë miratuar me ligj, pra nuk kanë kaluar procedurat e përgatitjes së kërkesave buxhetore;
- 19 projekte [5]janë çelur më pak se shuma e planifikuar, konkretisht në shumën 411,510 lekë;
- 5 projekte [6]janë çelur me shumë se shuma e planifikuar në listën e investimeve, konkretisht në shumën 35,982 lekë

Gjithashtu grupi i auditimit krahasoi projektet e realizuara për vitin 2023 me ato të planifikuara në PBA 2023-2025, konkretisht në Fazën e III-të të saj, nga ku situata paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 8: "Investimet të realizuara për vitin 2023 me ato të planifikuara për 2023 sipas PBA 2023-2025"

Në lekë

Kod i projekt	Emri i projektit	Shuma e realizuar	Paraqitja në PBA F3	Diferenca (I-II)
18BA613	Rikonstruksion i qendrave shëndetësore v.2023-2024	27,332,022	128,614,074	-101,282,052
22AC619	Rikonstruksion I godinës qendrore te sp.Diber	-	65,600,000	-65,600,000
18BB045	Rikonst i godinës së vjetër te Neonatologjisë dhe Obstetrikës dhe ndertim e dy godinave te reja ne SUOGJ ¿M Geraldinë¿	261,133,183	301,133,191	-40,000,008
22AC625	Rikonstruksioni i shtepizave te mbeshtetura ne sp.Psikiatrik Vlore	26,121,669	56,121,669	-30,000,000
22AC623	Rikonstruksioni i Poliklinikes sp.Durres	24,034,553	50,000,000	-25,965,447
20AB705	Rikonstruksion i qendrave shendetesore	59,447,612	82,703,000	-23,255,388
22AC613	Rikonstruksion i poliklinikes se sp.Shkoder	40,034,433	50,000,000	-9,965,567
18BB209	Godina A1, dy katet + Kati 0 QSUT FAZA 2	91,836,890	100,000,000	-8,163,110
18BA702	"F.V pajisje mjekesore dhe mobilimi per qendra shendetesore "	2,788,000	10,000,000	-7,212,000
18BA301	pajisje kompiuterike (13-01110)	9,119,640	15,000,000	-5,880,360
18BB153	TVSH per Grantin Japonez	10,056,492	15,000,000	-4,943,508
21AA801	Ngritja e modulit shtesë për kontrollin e menaxhte rastit ne kuadër të projektit te PAK nga BB	55,248,354	60,178,000	-4,929,646
18BB076	Punime per pjesen teknologjike te fazes II te	49,581,159	53,782,000	-4,200,841
18BC206	TVSH mbështetje për të përmirësuar organizimin dhe qeverisjen e institutit	-	3,650,000	-3,650,000
22AC628	Projekt preventiv per ndertimin e godines se re te back up per QKUM	2,230,892	5,000,000	-2,769,108
22AC609	Rikonstruksion i disa sherbimeve te Maternitetit nr.2	64,042,975	66,000,000	-1,957,025
18BC205	TVSH e asistences teknike per projektin "Perfshirja sociale" IPA II	2,063,938	3,650,000	-1,586,062
20AB703	Supervizion dhe kolaudim per rikonstruksion te qendrave shendetesore	90,000	1,370,000	-1,280,000
20AB702	uperv+kolaudim per ndertimin e godines se re per akomodimin e qsh1, njvksh dhe kl.stomatologjike Durres	-	1,049,000	-1,049,000
18BB511	Takse insfrastrukture per godinen e re te ISHP	18,228,735	19,200,000	-971,265
22AC620	Supervizion dhe kolaudim per rikonstruksionin e godines qendrore te sp.Diber	-	900,000	-900,000
18BB512	TVSH sipas marreveshjes per BE (EU4HEALTH)- "Kontributi në disp. dhe aksesin në vaksinat kundër COVID 19"	33,316,274	34,000,000	-683,726
18BA614	Superv+kolaudim per rikonstruksion i qendrave shendetesore v.2023-2024		600,000	-600,000
22AC610	Superv+kolaudim per rikonstruksion disa sherbimeve	980,940	1,500,000	-519,060
18BC007	Projekt-preventiv	1,987,814	2,500,000	-512,186
22AC624	Supervizion dhe kolaudim per rikonstruksioni I Poliklinikes sp.Durres	90,802	500,000	-409,198
18BB151	Furnizim vendosje mobilim spitalor sp.Kukes	19,664,760	19,764,760	-100,000
18BB025	uperv+kolaudim per rikonstruksionin e godines se QKTGjakut Tirane	823,350	900,000	-76,650
18BA612	Projekt preventiva zbatimi per rikonstruksionin e qsh-ve dhe amb-ve per v.2023-2024	3,966,350	3,985,926	-19,576
18BB120	F.V pajisje per QKTGJaku Tirane	39,991,140	40,000,000	-8,860
18Ç006	TVSH per rikonstruksion te Qendres Sociale ne Linze	7,799,878	7,800,000	-122
M130335	TVSH, Detyrime Doganore (Spitalori)	15,713,588	15,000,000	713,588
M133696	Kosto Lokale per PIU-n (njesia e zbatimit te projekteve te huaja)	3,962,497	3,000,000	962,497
19AB001	Pajisje te ndryshme per qendrat e SHSSH	1,136,100	-	1,136,100
18BB046	Supervizion per rikonst e godinës së vj te Neonato dhe Obstetrikës dhe ndertimit te dy godinave te reja ne SUOGJ Mbretëresha G.	4,341,485	2,318,000	2,023,485

[4] Paraqitur në dy rreshtat e fundit të tabelës nr. 7

[5] Rreshtat kur diferenca shfaqet negative.

[6] Rreshtat kur diferenca shfaqet pozitive.

18BB156	F.V pajisje per polikliniken e sp.Elbasan	9,954,960	-	9,954,960
20AB607	Nuk gjendet	18,652,896	-	18,652,896
M133831	TVSH & detyrim doganor per projektin e Cooperacionit Zviceran- Grant	60,878,827	20,000,000	40,878,827
22AC615	Rikonstruksion i poliklinikes se sp.Elbasan	147,367,452	58,352,000	89,015,452
18BA303	F.V Pajisje kondicionimi per aparatin e MSHMSF.V Pajisje kondicionimi per aparatin e MSHMS	455,280	Nuk paraqitet	N/A në PBA
18BA605	"Superv+kola per rikonste te QSH-ve ne qytete/njesi administ (PER OBJEKTET 2019-2020)"	123,223	Nuk paraqitet	N/A në PBA
18BA611	Superv+kolaudime per rikonstruksione te QSH-ve ne qytete/njesi administrative 20-21	1,796,095	Nuk paraqitet	N/A në PBA
18BA602	Rikonstruksion i qendrave shendetesore 2019-2021	1,280,825	Nuk paraqitet	N/A në PBA
20AB606	F.V pajisje per matjen e densitometrise kockore per strukturat shendetesore	15,899,340	Nuk paraqitet	N/A në PBA
M132168	TVSH shkolla per shendetin	34,992,197	Nuk paraqitet	N/A në PBA
20AB617	F.v pajisje per njvksh Gramsh	818,600	Nuk paraqitet	N/A në PBA
M131944	TVSH& Det . Dog. Per ndertimin e QSh & amb.	763,378	Nuk paraqitet	N/A në PBA
20AB618	F.v pajisje per kabinetet dentare te njvksh Kruje	834,000	Nuk paraqitet	N/A në PBA
20AB628	F.V pajisje per laboratorin e higjenes NJVKSH Tirane	679,704	Nuk paraqitet	N/A në PBA
20AB629	F.V pajisje zyre per DROSHKSH Tirane	-	Nuk paraqitet	N/A në PBA
20AB619	F.v pajisje per njvksh Korce	821,160	Nuk paraqitet	N/A në PBA
20AB620	F.v pajisje per njvksh Gjirokaster	1,114,800	Nuk paraqitet	N/A në PBA
20AB630	F.v pajisje per njvksh Berat	1,027,200	Nuk paraqitet	N/A në PBA
20AB625	F.v pajisje per njvksh Diber	1,006,512	Nuk paraqitet	N/A në PBA
20AB621	F.v pajisje per njvksh Tepelene	778,820	Nuk paraqitet	N/A në PBA
20AB622	F.v pajisje per njvksh Vlore	1,119,600	Nuk paraqitet	N/A në PBA
20AB623	F.v pajisje per njvksh Lushnje	1,161,600	Nuk paraqitet	N/A në PBA
20AB624	F.v pajisje per njvksh Has	1,104,000	Nuk paraqitet	N/A në PBA
20AB626	F.v pajisje per njvksh Lac	708,000	Nuk paraqitet	N/A në PBA
20AB627	Blerje pajisje elektronike per DROSHKSH Vlore	951,600	Nuk paraqitet	N/A në PBA
22AC606	TVSH per 5 Poliklinikat (Gjirokastra+ Peshkopi)- kredi e qev italiane	4,271,330	Nuk paraqitet	N/A në PBA
M133892	Projekt preventiva per nderhyrje ne spitale	-	Nuk paraqitet	N/A në PBA
18BB168	Upgrade i sistemit te MRI me 3 pajisje te reja per sp.Elbasan		Nuk paraqitet	N/A në PBA
18BB164	F.V pajisje biomjekesore dhe mobilimi per urgjencen e sp.rajonal Vlore	20,866,890	Nuk paraqitet	N/A në PBA
18BB165	TVSH per projektin e cooperazionit italian per nderhyrjet ne urgjencen e sp.rajonal Vlore	6,926,203	Nuk paraqitet	N/A në PBA
20AE206	F.V pajisje 3D Scaner extraoral per KSU	6,948,000	Nuk paraqitet	N/A në PBA
22AC630	Projekt preventiv zbatimi per rikonstruksionin e ambienteve te KSU	1,046,546	Nuk paraqitet	N/A në PBA
M134067	Rikons. i sistemit te ngrohje/ftohje/aspirim per godinen qendrore te SU Shefqet ndroqi-detyrim kontrate nga v.2019	8,871,069	Nuk paraqitet	N/A në PBA
M134068	Superv+kolaudim per rikons. e sist. te ngrohje/ftohje/aspirim per god. te SU Sh. ndroqi detyrim kontrate nga v.2019	120,279	Nuk paraqitet	N/A në PBA
22AC631	Tax e ndik infras per lejen e ndertimit me objekt" rikons I spitalit dhe polikl se spitalit Lezhe	13,163,406	Nuk paraqitet	N/A në PBA
18BB166	F.V pajisje teknologjike per sp.Bulqize	1,136,400	Nuk paraqitet	N/A në PBA
18BB167	Pajisje per spitalin Has	1,194,000	Nuk paraqitet	N/A në PBA
M133595	Blerje autoambulanca, motore urgjence dhe pajisje per sistemin shendetesor	12,444,000	Nuk paraqitet	N/A në PBA
22AC632	TVSH per projektin e financuar nga Center of Exellence of BE	4,884,690	Nuk paraqitet	N/A në PBA
20AE207	F.V pajisje mobilimi per sherbimin kombetar te urgjences Tirane		Nuk paraqitet	N/A në PBA
22AC633	Tvsh per Promovimi i e-shendetit ne zonen CB Ekono.lokale", per Sherb Komb te Urgjen	1,803,905	Nuk paraqitet	N/A në PBA
22AC637	Kosto lokale per projektin "Promovimi i e-shendetit ne zonen CB stimuluar Ekono.lokale"	17,613,654	Nuk paraqitet	N/A në PBA
22AC634	Kost lokale per projek "Promovimi i e-shendetit ne zonen CB dstimuluar Ekonomine lokale"	14,129,840	Nuk paraqitet	N/A në PBA
22AC635	TVSH per projektin "Promovimi i e-shendetit ne zonen CB duke stimuluar Ekonomlokale"		Nuk paraqitet	N/A në PBA
18BB169	F.V pajisje mjekesore per sp.psikiatrik Vlore		Nuk paraqitet	N/A në PBA
18BB170	F.V pajisje kompiuterike per sp.psikiatrik Vlore		Nuk paraqitet	N/A në PBA
18BB171	Blerje Sistemi dixhitalizues per sherbimin e Imazherise te spitalit Durres		Nuk paraqitet	N/A në PBA
18BB208	Kosto lokale per ndert. e spitalit te semundjeve te brendshme ne QSUT -shtese kontrate	40,576,722	Nuk paraqitet	N/A në PBA
18BB209	Kosto Lokale Godina A1, dy katet + Kati 0 QSUT FAZA 2	27,012,075	Nuk paraqitet	N/A në PBA
M133471	TVSH Ndertimi I Spitalit te Semundjeve Interne Q.S.U.T.	19,538,554	Nuk paraqitet	N/A në PBA
18BC203	Rikonstruksioni i zyrave te SHSSH rajonal Elbasan dhe Durres	124,687	Nuk paraqitet	N/A në PBA

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

Nga tabela më sipër rezulton se 47 projekte të paplanifikuara në PBA 2023–2025 (të paraqitura në tabelë me shënimin *"Nuk Paraqitet"*) janë realizuar pa kaluar procedurat e ciklit të miratimit të Planit Buxhetor Afatmesëm, në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, konkretisht me VKM nr. 185, datë 29.03.2018 *"Për menaxhimin e investimeve publike",* Aneksi 1 dhe me pikat 22/a dhe 25/b të Udhëzimit plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 *"Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023"*. Realizimi i këtyre projekteve në tabelën e realizimeve paraqitet në një vlerë totale prej 270,108,184 lekësh, ndërsa në mënyrë të detajuar këto projekte paraqiten si në vijim:

Tabela nr. 9: "Projekte të realizuara pa qenë pjesë e PBA-së"

Në lekë

Prog	Kod I projekt	Emërtimi i projektit	Shuma e realizuar
01110	18BA303	FV Pajisje kondicionimi per aparatin e MSHMS	455,280
07220	18BA605	Superv+kolaudime per rikonstruksione te QSH-ve ne qytete/njesi administrative (PER OBJEKTET 2019-2020)"	123,223
07220	18BA611	Superv+kolaudime per rikonstruksione te QSH-ve ne qytete/njesi administrative 2020-2021	1,796,095
07220	18BA602	Rikonstruksion i qendrave shendetesore 2019-2021	1,280,825
07220	20AB606	FV pajisje per matjen e densitometrise kockore per strukturat shendetesore	15,899,340
07220	M132168	Tvsh per projektin "Shkollat per shendetin"	34,992,197
07220	20AB617	FV pajisje per njvksh Gramsh	818,600
07220	M131944	TVSH& Det . Dog. Per ndertimin e QSh & amb. (Miresia)	763,378
07220	20AB618	FV pajisje per kabinetet dentare te njvksh Kruje	834,000
07220	20AB628	FV pajisje per laboratorin e higjenes NJVKSH Tirane	679,704
07220	20AB629	FV pajisje zyre per DROSHKSH Tirane	-
07220	20AB619	FV pajisje per njvksh Korce	821,160
07220	20AB620	FV pajisje per njvksh Gjirokaster	1,114,800
07220	20AB630	FV pajisje per njvksh Berat	1,027,200
07220	20AB625	FV pajisje per njvksh Diber	1,006,512
07220	20AB621	FV pajisje per njvksh Tepelene	778,820
07220	20AB622	FV pajisje per njvksh Vlore	1,119,600
07220	20AB623	FV pajisje per njvksh Lushnje	1,161,600
07220	20AB624	FV pajisje per njvksh Has	1,104,000
07220	20AB626	FV pajisje per njvksh Lac	708,000
07220	20AB627	Blerje pajisje elektronike per DROSHKSH Vlore	951,600
07330	22AC606	TVSH per 5 Poliklinikat (Gjirokastra+ Peshkopi)- kredi e qev italiane	4,271,330
07330	M133892	Projekt preventiva zbatimi per rikonstruksione te godinave te spitaleve rajonale dhe bashkiake, si dhe rishikimi I projekteve egzistuese per disa nga spitalet	-
07330	18BB168	Upgrade i sistemit te MRI me 3 pajisje te reja per sp.Elbasan	
07330	18BB164	FV pajisje biomjekesore dhe mobilimi per urgjencen e sp.rajonal Vlore	20,866,890
07330	18BB165	TVSH per projektin e cooperazionit italian per nderhyrjet ne urgjencen e sp.rajonal Vlore	6,926,203
07330	20AE206	FV pajisje 3D Scaner extraoral per KSU	6,948,000
07330	22AC630	Projekt preventiv zbatimi per rikonstruksionin e ambienteve te KSU	1,046,546
07330	M134067	Rikonstruksioni i sistemit te ngrohje/ftohje/aspirim per godinen qendrore te SU Shefqet ndroqi- detyrim kontrate nga v.2019	8,871,069
07330	M134068	Superv+kolaudim per rikonstruksionin e sistemit te ngrohje/ftohje/aspirim per godinen qendrore te SU Shefqet ndroqi detyrim kontrate nga v.2019	120,279
07330	22AC631	Takse e ndikimit ne infrastrustrukture per lejen e ndertimit me objekt" rikonstruksion I spitalit dhe polikliniknes se spitalit Lezhe	13,163,406
07330	18BB166	FV pajisje teknologjike per sp.Bulqize	1,136,400
07330	18BB167	Pajisje për spitalin Has	1,194,000
07330	M133595	Blerje autoambulanca, motore urgjence dhe pajisje për sistemin shëndetësor	12,444,000
07330	22AC632	TVSH për projektin e financuar nga Center of Exellence of BE	4,884,690
07330	20AE207	FV pajisje mobilimi per sherbimin kombetar te urgjences Tirane	
07330	22AC633	Tvsh per projektin Promovimi i e-shendetit ne zonen CB duke stimuluar Ekonomine lokale", per Sherbimin Kombetar te Urgjences	1,803,905
07330	22AC637	Kosto Lokale per projektin Promovimi i e-shendetit ne zonen CB duke stimuluar Ekonomine lokale", per Sherbimin Kombetar te Urgjences	17,613,654
07330	22AC634	Konsto lokale per projektin "Promovimi i e-shendetit ne zonen CB duke stimuluar Ekonomine lokale"	14,129,840
07330	22AC635	TVSH per projektin "Promovimi i e-shendetit ne zonen CB duke stimuluar Ekonomine lokale"	
07330	18BB169	FV pajisje mjekesore per sp.psikiatrik Vlore	
07330	18BB170	FV pajisje kompiuterike per sp.psikiatrik Vlore	
07330	18BB171	Blerje Sistemi dixhitalizues per sherbimin e Imazherise te spitalit Durres	
07330	18BB208	Kosto lokale per ndertimin e spitalit te semundjeve te brendshme (8 katshi A2) ne QSUT -shtese kontrate	40,576,722
07330	18BB209	Kosto Lokale Godina A1, dy katet + Kati 0 QSUT FAZA 2	27,012,075
07330	M133471	TVSH Ndertimi I Spitalit te Semundjeve Interne Q.S.U.T.	19,538,554
10430	18BC203	Rikonstruksioni i zyrave te SHSSH rajonal Elbasan dhe Durres	124,687
Totali			**270,108,184**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

- 8 projekte janë realizuar më shumë se planifikimi në PBA e shuma e realizuar më tepër është 163,337,805 lekë;

- 31 projekte janë realizuar më pak se shuma e planifikuar në PBA 2023-2025 dhe diferenca më pak është 348,489,766 lekë.

Tek realizimet projekti me kod 18BB209 është paraqitur dy herë tek realizimet për këtë arsye ka dalë në dy rreshta më vete me emërtimet "Kosto Lokale Godina A1, dy katet + Kati 0 QSUT faza 2" dhe "TVSH Godina A1, dy katet + Kati 0 QSUT FAZA 2", në planifikim është vetëm njëherë sa shuma e shënuar në një nga rreshtat, pra nuk është planifikuar TVSH-ja.

Për verifikimin e investimeve dhe realizimit te tyre, nga grupi i auditimit u bë verifikimi i investimeve të planifikuara e atyre të realizuara, për investimet kapitale me financim të brendshëm, ku për vitin 2023 situata paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 10: "Investime të planifikuara dhe të pa realizuara për vitin 2023"

Në lekë

Programi	Kodi Projektit	Emërtimi I projektit	Planifikuar	Realizuar
7220	20AB702	Superv+kolaudim per ndertimin e godines se re per akomodimin e qsh1, dhe njvksh Durres	210,000	-
	18BA614	Superv+kolaudim per rikonstruksion i qendrave shendetesore v.2023-2024	1,287,423	-
	20AB629	F.V pajisje zyre per DROSHKSH Tirane	1,200,000	-
7330	M133892	F.V pajisje zyre per DROSHKSH Tirane	5,059	-
	22AC619	Projekt preventiva zbatimi per rikonstruksione te godinave te spitaleve rajonale dhe bashkiake, si dhe rishikimi I projekteve egzistuese per disa nga spitalet	490,989	-
	22AC620	Rikonstruksion i godines qendrore te sp.Diber	900,000	-
	18BB168	Superv+kolaudim per rikonstruksionin e godines qendrore te sp.Diber	3,940,000	-
	20AE207	Upgrade i sistemit te MRI me 3 pajisje te reja per sp.Elbasan	1,200,000	-
	22AC635	F.V pajisje mobilimi per sherbimin kombetar te urgjences Tirane	427,800	-
	18BB169	TVSH per projektin "Promovimi i e-shendetit ne zonen CB duke stimuluar Ekonomine lokale"	1,200,000	-
	18BB170	F.V pajisje mjekesore per sp.psikiatrik Vlore	1,200,000	-
	18BB171	F.V pajisje kompiuterike per sp.psikiatrik Vlore	1,200,000	-
7450		Blerje Sistemi dixhitalizues per sherbimin e Imazherise te spitalit Durres	175,313	-
Totali			13,436,584	0

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

Nga tabela më sipër rezulton se për vitin 2023 në tri programe, janë planifikuar fonde buxhetore për projektet përkatëse, por nuk janë realizuar (realizimi 0 lekë).

Për shpenzimet kapitale me financim të huaj

Për shpenzimet kapitale me financim të huaj

Për verifikimin e investimeve dhe realizimit te tyre, nga grupi i auditimit u bë verifikimi i investimeve të planifikuara e atyre të realizuara, për investimet kapitale me financim të huaj (kap 02), ku për vitin 2023 situata paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 11: "Investime, me financim të huaj të planifikuara dhe të realizuara për vitin 2023"

Në lekë

Programi	Llog.Ek.	Kodi i projektit	Plani 31.12.23	Realizimi 31.12.23	Diferenca
7330	231	KM13021	177,000,000	262,271,240	-85,271,240
7220	231	GM13021	109,000,000	147,980,270	-38,980,270
7330	231	KM13017	105,700,000	141,196,590	-35,496,590
10430	231	18BC201	-	6,990,670	-6,990,670
7220	231	KM13001	22,000,000	28,971,160	-6,971,160
7330	231	91304AP	-	4,915,470	-4,915,470
7330	231	GM13020	5,100,000	5,368,550	-268,550
7330	230	18BB403	-	2,750	-2,750
7330	230	G037018	-	2,750	-2,750
7330	230	91301AA	-	250	-250
7330	230	18BB309	600,000	523,090	76,910
10430	231	18BC207	6,000,000	-	6,000,000
10430			15,000,000	6,990,670	8,009,330
10430	231	KM13027	9,000,000	-	9,000,000
7330	231	18BB403	15,000,000	-	15,000,000

7330	231	GM13009	135,000,000	42,910,310	92,089,690
7330	231	KM13020	155,000,000	-	155,000,000
Totali			**754,400,000**	**648,123,770**	

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

Nga tabela më sipër rezulton se nga investimet me financim të huaj (kapitulli 2) 10 projektet e para janë realizuar më shumë se shuma e planifikuar, ku diferenca fakt-plan, për këto 10 projekte është në shumën 178,899,700 lekë dhe 7 projekte janë realizuar më pak se vlera e planifikuar.

Realizimi i projekteve të investimeve me financim të huaj pa pasur plan buxheti apo në tejkalim të planit buxhetor të miratuar, si dhe mos marrja e masave për sistemimin e tyre nëpërmjet rialokimeve gjatë vitit apo gjatë procesit të rishikimit të buxhetit është në kundërshtim me pikën 27 të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 2, datë 19.01.2023 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023" ku citohet se: "*Plani i miratuar në ligjin e buxhetit për financimet e huaja, është kufiri i cili duhet të respektohet gjatë procesit të kryerjes së shpenzimeve, si për projektet me skemë të plotë thesari ashtu edhe për projektet me skemë të pjesshme thesari (jashtë TSA-së, në bankat e nivelit të dytë). Në rast të tejkalimit të planit të shpenzimeve njësitë e qeverisjes qendrore do të marrin masa për sistemimin e tyre nëpërmjet rialokimeve gjatë vitit dhe gjatë procesit të rishikimit të buxhetit"*

Detajimi i planit të buxhetit për shpenzimet kapitale

Me shkresën nr. 23774/62, datë 23.01.2023 të MFE është Dërguar detajimi i buxhetit 2023-2025 për shpenzimet kapitale.

Nga grupi i auditimi u bë verifikimi i tyre në detajimin 2023-2025, planin përfundimtar dhe faktin në dhjetor 2023, ku për shpenzimet kapitale situata paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 12 "Detajimi i shpenzimeve kapitale Vs plan Përfundimtar vs Realizim për vitin 2023"

Program	Kod proj.	Emri projekt	Plani Fillestar	Plani Përfundimtar	Realizim	Komente gr. auditimit
01110	18BA301	Pajisje kompjuterike	15,000,000	12,500,000	9,119,640	Rishikuar në ulje
01110	18BA303	F.V Pajisje kondicionimi per aparatin e MSHMS	#N/A	500,000	455,280	Jo pjesë e Plan Fillestar
01110	M133696	Kosto Lokale per PIU-n (njesia e zbatimit te projekteve te huaja)	3,000,000	4,200,000	3,962,497	Rishikuar në rritje
07220	18BA612	Projekt preventiva zbatimi per rikonstruksionin e qsh-ve dhe amb-ve per v.2023-2024	3,985,926	3,966,350	3,966,350	Rishikuar në ulje
07220	20AB702	Superv+kolaudim per ndertimin e godines se re per akomodimin e qsh1, dhe njvksh Durres	1,049,000	210,000	-	Rishikuar në ulje
07220	18BA613	Rikonstruksion i qendrave shendetesore v.2023-2024	#N/A	56,374,796	27,332,022	Jo pjesë e Plan Fillestar
07220	18BA614	Superv+kolaudim per rikonstruksion i qendrave shendetesore v.2023-2024	#N/A	1,287,423		Jo pjesë e Plan Fillestar
07220	18BA605	"Superv+kolaudime per rikonstruksione te QSH-ve ne qytete/njesi administrative (PER OBJEKTET 2019-2020)"	#N/A	123,223	123,223	Jo pjesë e Plan Fillestar
07220	18BA611	Superv+kolaudime per rikonstruksione te QSH-ve ne qytete/njesi administrative 2020-2021	#N/A	1,796,160	1,796,095	Jo pjesë e Plan Fillestar
07220	18BA602	Rikonstruksion i qendrave shendetesore 2019-2021	#N/A	1,280,825	1,280,825	Jo pjesë e Plan Fillestar
07220	18BA702	"F.V pajisje mjekesore dhe mobilimi per qendra shendetesore "	#N/A	2,788,000	2,788,000	Jo pjesë e Plan Fillestar
07220	20AB606	F.V pajisje per matjen e densitometrise kockore per strukturat shendetesore	#N/A	15,899,340	15,899,340	Jo pjesë e Plan Fillestar
07220	20AB703	Supervizim dhe kolaudim per rikonstruksionin e qendrave shendetesore	1,370,000	1,370,000	90,000	Pa ndryshim
07220	20AB705	Rikonstruksion i qendrave shendetesore	82,703,000	59,449,482	59,447,612	Rishikuar në ulje
07220	M132168	Tvsh per projektin "Shkollat per shendetin"	6,000,000	34,995,506	34,992,197	Rishikuar në rritje
07220	M133831	Tvsh & detyrim doganor per projektin e Cooperacionit Zviceran-Grant	20,000,000	61,000,000	60,878,827	Rishikuar në rritje
07220	20AB607	F.V unite dentare per kujdesin dentar te femijet	-	18,652,896	18,652,896	Rishikuar në ulje
07220	20AB617	F.v pajisje per njvksh Gramsh	#N/A	900,000	818,600	Jo pjesë e Plan Fillestar
07220	M131944	TVSH& Det . Dog. Per ndertimin e QSh & amb. (Miresia)	#N/A	764,000	763,378	Jo pjesë e Plan Fillestar
07220	20AB618	F.v pajisje per kabinetet dentare te njvksh Kruje	#N/A	840,000	834,000	Jo pjesë e Plan Fillestar
07220	20AB628	F.V pajisje per laboratorin e higjenes NJVKSH Tirane	#N/A	720,000	679,704	Jo pjesë e Plan Fillestar
07220	20AB629	F.V pajisje zyre per DROSHKSH Tirane	#N/A	1,200,000	-	Jo pjesë e Plan Fillestar
07220	20AB619	F.v pajisje per njvksh Korce	#N/A	1,200,000	821,160	Jo pjesë e Plan Fillestar
07220	20AB620	F.v pajisje per njvksh Gjirokaster	#N/A	1,200,000	1,114,800	Jo pjesë e Plan Fillestar
07220	20AB630	F.v pajisje per njvksh Berat	#N/A	1,200,000	1,027,200	Jo pjesë e Plan Fillestar
07220	20AB625	F.v pajisje per njvksh Diber	#N/A	1,200,000	1,006,512	Jo pjesë e Plan Fillestar

07220	20AB621	F.v pajisje per njvksh Tepelene	#N/A	800,000	778,820	Jo pjesë e Plan Fillestar
07220	20AB622	F.v pajisje per njvksh Vlore	#N/A	1,200,000	1,119,600	Jo pjesë e Plan Fillestar
07220	20AB623	F.v pajisje per njvksh Lushnje	#N/A	1,200,000	1,161,600	Jo pjesë e Plan Fillestar
07220	20AB624	F.v pajisje per njvksh Has	#N/A	1,200,000	1,104,000	Jo pjesë e Plan Fillestar
07220	20AB626	F.v pajisje per njvksh Lac	#N/A	800,000	708,000	Jo pjesë e Plan Fillestar
07220	20AB627	Blerje pajisje elektronike per DROSHKSH Vlore	#N/A	1,200,000	951,600	Jo pjesë e Plan Fillestar
07330	18BB153	TVSH per Grantin Japonez	15,000,000	10,056,492	10,056,492	Rishikuar në ulje
07330	22AC606	TVSH per 5 Poliklinikat (Gjirokastra+ Peshkopi)- kredi e qev italiane	#N/A	4,271,330	4,271,330	Jo pjesë e Plan Fillestar
07330	M133892	Projekt preventiva zbatimi per rikonstruksione te godinave te spitaleve rajonale dhe bashkiake, si dhe rishikimi I projekteve egzistuese per disa nga spitalet	40,000,000	5,059	-	Rishikuar në ulje
07330	22AC619	Rikonstruksion i godines qendrore te sp.Diber	#N/A	490,989	-	Jo pjesë e Plan Fillestar
07330	22AC620	Superv+kolaudim per rikonstruksionin e godines qendrore te sp.Diber	900,000	900,000	-	Pa ndryshim
07330	22AC615	Rikonstruksion i poliklinikes se sp.Elbasan	58,352,000	148,352,000	147,367,452	Rishikuar në rritje
07330	22AC616	Supervizion+ kolaudim per rikonstruksion I poliklinikes se sp.Elbasan	300,000	300,000	300,000	Pa ndryshim
07330	18BB156	F.V pajisje per polikliniken e sp.Elbasan	-	10,000,000	9,954,960	Rishikuar në rritje
07330	18BB168	Upgrade i sistemit te MRI me 3 pajisje te reja per sp.Elbasan	#N/A	3,940,000		Jo pjesë e Plan Fillestar
07330	18BB076	Punime per pjesen teknologjike te fazes II te rikonstruksionit te sp.Kukes qe po implementohet nga Banka Boterore	53,782,000	53,782,000	49,581,159	Pa ndryshim
07330	18BB151	Furnizimi vendosje mobilim spitalor sp.Kukes	19,764,760	19,764,760	19,664,760	Pa ndryshim
07330	22AC613	Rikonstruksion i poliklinikes se sp.Shkoder	50,000,000	40,034,554	40,034,433	Rishikuar në ulje
07330	22AC614	Supervizion+ kolaudim per rikonstruksion i poliklinikes se sp.Shkoder	#N/A	240,000	240,000	Jo pjesë e Plan Fillestar
07330	18BB164	F.V pajisje biomjekesore dhe mobilimi per urgjencen e sp.rajonal Vlore	#N/A	20,914,915	20,866,890	Jo pjesë e Plan Fillestar
07330	22AC605	Rikonstruksion i Urgjences se sp.Vlore	29,100,000	29,100,000	29,100,000	Pa ndryshim
07330	18BB165	TVSH per projektin e cooperazionit italian per nderhyrjet ne urgjencen e sp.rajonal Vlore	#N/A	7,700,000	6,926,203	Jo pjesë e Plan Fillestar
07330	18BB045	Rikonstruksion dhe ndertim e nje godine te re ne SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë"	301,133,191	261,133,191	261,133,183	Rishikuar në ulje
07330	18BB046	Supervizion per rikonstruksionin dhe ndertimin e nje godine te re ne SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë"	2,318,000	5,118,000	4,341,485	Rishikuar në rritje
07330	18BB008	Rikonstruksion i godines se QKTGjakut Tirane	49,416,131	49,416,131	49,416,131	Pa ndryshim
07330	18BB025	Superv+kolaudim per rikonstruksionin e godines se QKTGjakut Tirane	900,000	960,000	823,350	Rishikuar në rritje
07330	18BB120	F.V pajisje per QKT GJAKU	40,000,000	40,000,000	39,991,140	Pa ndryshim
07330	22AC625	Rikonstruksioni i shtepizave te mbeshtetura ne sp.Psikiatrik Vlore	56,121,669	26,121,669	26,121,669	Rishikuar në ulje
07330	22AC626	Supervizion per rikonstruksionin e shtepizave te mbeshtetura ne sp.Psikiatrik Vlore	541,000	541,000	541,000	Pa ndryshim
07330	22AC623	Rikonstruksioni i Poliklinikes sp.Durres	50,000,000	24,034,554	24,034,553	Rishikuar në ulje
07330	22AC624	Supervizion dhe kolaudim per rikonstruksioni I Poliklinikes sp.Durres	500,000	500,000	90,802	Pa ndryshim
07330	18BB158	F.V pajisje per sherbime te reja ne Maternitetin nr.2 Tirane	16,000,000	16,000,000	16,000,000	Pa ndryshim
07330	22AC609	Rikonstruksion i disa sherbimeve te Maternitetit nr.2	66,000,000	64,042,975	64,042,975	Rishikuar në ulje
07330	22AC610	Superv+kolaudim per rikonstruksion disa sherbimeve te Maternitetit nr.2	1,500,000	1,500,000	980,940	Pa ndryshim
07330	20AE206	F.V pajisje 3D Scaner extraoral per KSU	#N/A	7,000,000	6,948,000	Jo pjesë e Plan Fillestar
07330	22AC630	Projekt preventiv zbatimi per rikonstruksionin e ambienteve te KSU	#N/A	1,046,546	1,046,546	Jo pjesë e Plan Fillestar
07330	M134067	Rikonstruksioni i sistemit te ngrohje/ftohje/aspirim per godinen qendrore te SU Shefqet ndroqi- detyrim kontrate nga v.2019	#N/A	8,871,069	8,871,069	Jo pjesë e Plan Fillestar
07330	M134068	Superv+kolaudim per rikonstruksionin e sistemit te ngrohje/ftohje/aspirim per godinen qendrore te SU Shefqet ndroqi detyrim kontrate nga v.2019	#N/A	120,280	120,279	Jo pjesë e Plan Fillestar
07330	22AC631	Takse e ndikimit ne infrastrustrukture per lejen e ndertimit me objekt" rikonstruksion I spitalit dhe polikliniknes se spitalit Lezhe	#N/A	13,164,000	13,163,406	Jo pjesë e Plan Fillestar
07330	18BB166	F.V pajisje teknologjike per sp.Bulqize	#N/A	1,200,000	1,136,400	Jo pjesë e Plan Fillestar
07330	18BB167	Pajisje per spitalin Has	#N/A	1,200,000	1,194,000	Jo pjesë e Plan Fillestar
07330	22AC628	Projekt preventiv per ndertimin e godines se re te back up per QKUM	5,000,000	2,230,892	2,230,892	Rishikuar në ulje
07330	M133595	Blerje autoambulanca per sistemin shendetesor	87,000,000	12,444,000	12,444,000	Rishikuar në ulje
07330	22AC632	TVSH per projektin e financuar nga Center of Exellence of BE	#N/A	5,000,000	4,884,690	Jo pjesë e Plan Fillestar
07330	20AE207	F.V pajisje mobilimi per sherbimin kombetar te urgjences Tirane	#N/A	1,200,000		Jo pjesë e Plan Fillestar
07330	22AC633	Tvsh per projektin Promovimi i e-shendetit ne zonen CB duke stimuluar Ekonomine lokale", per Sherbimin Kombetar te Urgjences	#N/A	1,803,905	1,803,905	Jo pjesë e Plan Fillestar
07330	22AC637	Kosto Lokale per projektin Promovimi i e-shendetit ne zonen CB duke stimuluar Ekonomine lokale", per Sherbimin Kombetar te Urgjences	#N/A	18,000,000	17,613,654	Jo pjesë e Plan Fillestar
07330	22AC634	Konsto lokale per projektin "Promovimi i e-shendetit ne zonen CB duke stimuluar Ekonomine lokale"	#N/A	14,129,840	14,129,840	Jo pjesë e Plan Fillestar
07330	22AC635	TVSH per projektin "Promovimi i e-shendetit ne zonen CB duke stimuluar Ekonomine lokale"	#N/A	427,800		Jo pjesë e Plan Fillestar
07330	18BB169	F.V pajisje mjekesore per sp.psikiatrik Vlore	#N/A	1,200,000		Jo pjesë e Plan Fillestar
07330	18BB170	F.V pajisje kompiuterike per sp.psikiatrik Vlore	#N/A	1,200,000		Jo pjesë e Plan Fillestar
07330	18BB171	Blerje Sistemi dixhitalizues per sherbimin e Imazherise te spitalit Durres	#N/A	1,200,000		Jo pjesë e Plan Fillestar
07330	18BB208	Kosto lokale per ndertimin e spitalit te semundjeve te brendshme (8 katshi A2) ne QSUT -shtese kontrate	#N/A	40,576,722	40,576,722	Jo pjesë e Plan Fillestar
07330	18BB209	Godina A1, dy katet + Kati 0 QSUT FAZA 2	100,000,000	91,836,890	91,836,890	Rishikuar në ulje
07330	18BB209	Godina A1, dy katet + Kati 0 QSUT FAZA 2	100,000,000	27,012,075	27,012,075	Rishikuar në ulje

07330	M133471	TVSH Ndertimi I Spitalit te Semundjeve Interne Q.S.U.T.	#N/A	19,538,554	19,538,554	Jo pjesë e Plan Fillestar
07330	M130335	TVSH per Projektin e GLOBAL FUND	15,000,000	15,881,807	15,713,588	Rishikuar në rritje
07450	18BB512	TVSH sipas marreveshjes per BE (EU4HEALTH)- "Kontributi në disponueshmërinë dhe aksesin në vaksinat kundër COVID 19"	34,000,000	33,400,000	33,316,274	Rishikuar në ulje
07450	18BB511	Takse infrastrukture per godinen e re te ISHP	19,200,000	18,300,000	18,228,735	Rishikuar në ulje
10430	21AA801	Ngritja e modulit shtesë për kontrollin e menaxhimit te rastit ne kuadër të projektit te PAK nga BB	60,178,000	60,178,000	55,248,354	Pa ndryshim
10430	18BC205	TVSH e asistences teknike per projektin "Perfshirja sociale" IPA II	3,650,000	2,300,000	2,063,938	Rishikuar në ulje
10430	18BC206	TVSH mbështetje për të përmirësuar organizimin dhe qeverisjen e institutit	#N/A	175,313	-	Jo pjesë e Plan Fillestar
10430	18Ç006	Nuk gjendet	7,800,000	7,800,000	7,799,878	Pa ndryshim
10430	18BC007	Projekt-preventiv zbatimit per rikonstruksion te shtepise se femijes "Zyber Hallulli" Tirane	#N/A	2,000,000	1,987,814	Jo pjesë e Plan Fillestar
10430	18BC203	Rikonstruksioni i zyrave te SHSSH rajonal Elbasan dhe Durres	#N/A	124,687	124,687	Jo pjesë e Plan Fillestar
10430	19AB001	Pajisje per inst e perkujdesit social te blera	-	1,200,000	1,136,100	Rishikuar në rritje
Totali				1,543,000,000	1,479,724,975	

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

Nga tabela më sipër rezulton se se gjatë vitit 2023 janë realizuar 50 projekte që nuk kanë qenë të planifikuar në planin fillestar të shpenzimeve të MSHMS-së. Këto projekte janë financuar nëpërmjet rialokimeve të fondeve brenda vitit, pa u reflektuar paraprakisht në planifikimin buxhetor siç përcaktohet në VKM nr. 185, datë 29.03.2018 "*Për menaxhimin e investimeve publike*" aneksi 1, si dhe në kundërshtim me pikën 22/a/b të Udhëzimit nr. 1, datë 10.01.2022 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023*" ku përcaktohet se: "*Njësitë e qeverisjes qendrore, në detajimin e planeve të miratuara të investimeve, do të mbajnë parasysh...a. Projektet e investimeve të propozuara për financim duhet të jenë pjesë e projekteve të propozuara dhe të shqyrtuara nga Këshilli i Ministrave dhe të paraqitura në Kuvend, për vitin 2023".* Konkretisht, evidentohen 50 kode projektesh investimi, të cilat nuk kanë qenë pjesë e planit fillestar dhe janë bërë pjese e planit përfundimtar në shumën totale 272,409,717 lekë, prej të cilave vetëm 40 janë realizuar në shumën totale 228,007,748 lekë, konkretisht janë projektet e paraqitura, në tabelë me shënimin "*Jo pjesë e planit fillestar".*

Nga tabela më sipër rezulton se 26 projekte janë çelur në fillim të vitit me Ligjin e Buxhetit, por nuk janë realizuar, shuma e projekteve të çelura në fillim të vitit, për këto projekte është 967,099,858 lekë.

Për të parë ecurinë dhe qëndrueshmërinë e planifikimit, grupi i auditimit krahasoi të dhënat për projektet e investimeve të planifikuara, për vitin 2024 në fazën teknike të përgatitjes së PBA 2023-2025 me projektet e planifikuara po në këtë fazë, po për vitin 2024, në PBA 2024-2026, dhe verifikoi realizimin e këtyre projekteve. Situata nga kjo analizë paraqitet si të tabelën më poshtë:

Tabela nr. 31: "Krahasimi i të dhënave për Shpenzimet kapitale të vitit 2024, në PBA 2023-2025 dhe 2024-2026 vs Realizimin e produkteve"

Prog.	Kodi Output	Buxheti 2023	Buxheti 2024 (PBA 23-25)	2024 sipas PBA 24-26	Realizimi 2024
1110	18BA301	15,000,000	15,000,000	13,800,000	7,627,500
7220	20AB701	7,927,000		50,000,000	#N/A
7220	20AB702	-		727,870	#N/A
7220	20AB705	82,703,000		-	#N/A
7220	20AB703	1,370,000		-	#N/A
7220	20AB607	-	7,200,000	-	#N/A
7220	18BA613		147,400,000	134,092,996	#N/A
7220	18BA614		2,400,000	2,179,134	#N/A
7220	Rikonstruksioni i godinave te kujdesit shendetit paresor dhe qsh-ve			#N/A	#N/A
7220	Supervizim kolaudim per rikonstruksione te godinave te njvksh-ve			#N/A	#N/A
7330	18BB057	-		#N/A	#N/A
7330	18BB058	-		#N/A	#N/A
7330	22AC615	60,000,000	100,000,000	98,667,969	9,671,547
7330	22AC616	300,000	1,200,000	1,200,000	1,200,000
7330	18BB156		30,000,000	20,000,000	17,952,480
7330	18BB015		48,000,000	48,000,000	#N/A
7330	18BB031		715,452	715,452	#N/A
7330	18BB105	-		-	#N/A
7330	M133892	40,000,000		20,000,000	11,807,963
7330	22AC613	50,000,000	70,000,000	50,353,665	50,353,386
7330	22AC614	240,000	960,000	960,000	#N/A
7330	18BB157		30,000,000	20,000,000	29,063,700
7330	18BB045	399,617,149	134,520,000	#REF!	190,068,709
7330	18BB046	670,000	1,000,000	7,220,224	3,204,862
7330	18BB048	-	286,000	286,000	-
7330	18BB060	18,000,000	72,000,000	80,000,000	28,610,844
7330	22AC621	26,000,000	104,000,000	#REF!	#N/A
7330	Supervizion+koaudim per rikonstruksion ne Maternitetin nr.1 Tirane faza II	500,000	2,000,000	#N/A	#N/A
7330	18BB061			#N/A	#N/A
7330	18BB062			#N/A	#N/A
7330	Rikonstruksion I qendres se gruas, ambienteve pritese dhe urgjencës se Maternitetit nr.2	46,000,000		#N/A	#N/A
7330	Superv+kolaudim per rikonstruksion I qendres se gruas dhe urgjences se Maternitetit nr.3	1,500,000		#N/A	#N/A
7330	18BB158	16,000,000		-	#N/A

7330	22AC623	50,000,000	70,000,000	90,965,446	50,255,346
7330	22AC624	500,000	2,000,000	500,000	646,787
7330	20AE205		30,000,000	30,000,000	25,494,708
7330	22AC611		20,000,000	-	#N/A
7330	22AC612		500,000	-	#N/A
7330	18BB159			-	#N/A
7330	18BB007	-		#N/A	#N/A
7330	18BB024	-		#N/A	#N/A
7330	18BB008	99,416,131		-	#N/A
7330	18BB025	1,803,000		-	#N/A
7330	18BB120	40,000,000		-	#N/A
7330	18BB103	-		#N/A	#N/A
7330	18BB310	103,276,599	32,958,650	74,988,860	132,534,780
7330	18BB160	-	70,000,000	37,000,000	-
7330	18BB103			#N/A	#N/A
7330	18BB079			#N/A	#N/A
7330	18BB080			#N/A	#N/A
7330	Rikonstruksion Pediatria Infektive ne QSUT (perforcim)	-	20,000,000	#N/A	#N/A
7330	Superv+kolaudim per rikonstruksion Pediatria Infektive ne QSUT	-	200,000	#N/A	#N/A
7330	F.V pajisje biomjekesore per QSUT (sipas marreveshjes me amb USA dhe IAEA)		82,000,000	#N/A	#N/A
7330	19AD307			#N/A	#N/A
7330	19AD308			#N/A	#N/A
7330	19AD309			#N/A	#N/A
7330	18BB076	53,782,000		-	#N/A
7330	18BB077	-		#N/A	#N/A
7330	Rikonstruksion i godines qendrore sp.Lushnje		72,000,000	#N/A	#N/A
7330	Superv +kolaudim per rikonstruksionin e god.qendrore sp.Lushnje		532,599	#N/A	#N/A
7330	M133894	-		-	#N/A
7330	18BB043		149,080,000	94,618,200	24,240,048
7330	18BB044		2,047,000	987,000	-
7330	M133894	-		-	#N/A
7330	18BB081		79,639,401	-	#N/A
7330	18BB082		630,000	-	#N/A
7330	M133894	-		-	#N/A
7330	18BB083	-	90,000,000	48,744,671	#N/A
7330	18BB084	-	1,500,000	800,000	#N/A
7330	18BB161			-	#N/A
7330	22AC619	65,600,000	142,002,567	125,082,380	#N/A
7330	Superv+kolaudim per rikonstruksion I godines qendrore te sp.Diber	900,000	1,600,000	#N/A	#N/A
7330	18BB162			-	#N/A
7330	22AC625	56,121,669	63,878,331	52,785,431	117,153,576
7330	22AC626	290,000	1,160,000	1,500,000	1,499,999
7330	22AC627		50,000	-	#N/A
7330	20AE204		30,000,000	-	#N/A
7330	21AA101	-		#N/A	#N/A
7330	18BB116	87,908,452	16,560,000	#N/A	#N/A
7330	18BB311			#N/A	#N/A
7450	18BB507			52,800,000	#N/A
7450	18BB508			1,000,000	#N/A
7450	18BB509	13,480,000	13,480,000	208,800,000	#N/A
7450	18BB510	200,000	200,000	4,000,000	2,050,856
7450	Pajisje per laboratoret e higjenes ne rrethe			#N/A	#N/A
7460	M133595	105,000,000	54,300,000	-	#N/A
7460	22AC628	5,000,000		-	#N/A
7460	20AE102	-	70,000,000	26,400,000	#N/A
7460	20AE103	-	700,000	280,000	-
7460	20AB903			#N/A	#N/A
7460	Takse infrastrukture per godinen e re te back up QKUM			#N/A	#N/A
7460	F.V pajisje biomjekesore per sherbimin e urgjences QKUM	15,000,000		#N/A	#N/A
10430	21AA801	80,000,000		-	#N/A

10430	18BC007	2,500,000		-	#N/A
10430	18BC006	29,700,000	114,350,000	#N/A	#N/A
10430	Superv+kolaudim per rik. i godines se SHSSH dhe godinave ne rrethe	500,000	2,000,000	#N/A	#N/A
10430	19AB001	60,000,000	60,000,000	-	#N/A

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

Grupi i audimit për projektet e reja të vitit 2024, të cilat në PBA 2023-2025, kishin vetëm emërtimin e produktit dhe jo kodin përkatës, bëri lidhjen me PBA 2024-2026, me emërtim produkti për të gjeneruar kodin në kolonën e dytë të tabelës, në rastet kur rreshtat e kësaj tabele nuk kanë një kod produkti, por përshkrimin nuk janë gjendur në PBA 2024-2026, nga verifikimi rezultoi si në vijim:

- 46 produkte, për vitin 2024, në fazën teknike të PBA 2023-2025 janë planifikuar me zero (0) lekë, nga verifikimi i tyre në PBA 2024-2026 (viti 2024) rezultoi se:
  - 17 prej tyre janë me 0 lekë të parashikuara dhe në PBA 2024-2026, viti 2024;
  - 24 produkte nuk gjenden në PBA 2024-2026, viti 2024 dhe
  - 5 produkte janë parashikuar me vlerë pozitive.

Sa më sipër rezulton se 29 produkte kanë ndryshuar vlerat e parashikuara të vitit 2024, nga PBA 2023-2025 në PBA 2024-2026.

- 51 produkte për vitin 2024, parashikohen me vlera pozitive në PBA 2023-2025, të cilat krahasuan me vitin 2024 sipas PBA 2024-2026, nga ku:
  - 10 produkte nuk u gjenden në PBA 2024-2026 dhe
  - 9 ishin planifikuar në shumën 0 lekë dhe

32 produkte ishin parashikuara me vlerë pozitive, për vitin 2024, në PBA 2024-2026. Për këto produkte të cilat janë parashikuar me vlera pozitive në të dy PBA dhe janë realizuar në fund të vitit 2024-të u bë diferenca mes parashikimit të dy PBA-të për çdo produkt dhe krahasimi me realizimin në fund të vitit 2024, ku situata paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 32: Produkte të planifikuara me vlerë pozitive për vitin **2024**, në PBA 23-25 dhe 24-26

Në lekë

Programi	Kodi Output	Buxheti 2023	I.Buxheti 2024	II.2024 sipas PBA 24-26	Realizimi 2024	Diferenca II-I	Dife Realizim-II
7330	18BB310	103,276,599	32,958,650	74,988,860	132,534,780	42,030,210	57,545,920
7330	18BB045	399,617,149	134,520,000	234,577,347	190,068,709	100,057,347	-44,508,638
7330	18BB046	670,000	1,000,000	7,220,224	3,204,862	6,220,224	-4,015,362
7330	18BB060	18,000,000	72,000,000	80,000,000	28,610,844	8,000,000	-51,389,156
7330	22AC623	50,000,000	70,000,000	90,965,446	50,255,346	20,965,446	-40,710,100
7330	22AC626	290,000	1,160,000	1,500,000	1,499,999	340,000	-1
7450	18BB510	200,000	200,000	4,000,000	2,050,856	3,800,000	-1,949,144
7330	18BB157		30,000,000	20,000,000	29,063,700	- 0,000,000	9,063,700
7330	22AC624	500,000	2,000,000	500,000	646,787	- ,500,000	146,787
7330	22AC625	56,121,669	63,878,331	52,785,431	117,153,576	-11,092,900	64,368,145
1110	18BA301	15,000,000	15,000,000	13,800,000	7,627,500	-1,200,000	6,172,500
7330	22AC615	60,000,000	100,000,000	98,667,969	9,671,547	-1,332,031	-88,996,422
7330	22AC616	300,000	1,200,000	1,200,000	1,200,000	-	-
7330	18BB156		30,000,000	20,000,000	17,952,480	-10,000,000	-2,047,520
7330	22AC613	50,000,000	70,000,000	50,353,665	50,353,386	-19,646,335	-279
7330	20AE205		30,000,000	30,000,000	25,494,708	-	-4,505,292
7330	18BB043		149,080,000	94,618,200	24,240,048	-54,461,800	-70,378,152

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

- 17 produkte janë parashikuar në të dy PBA, për vitin 2024 me vlera pozitive dhe janë realizuar, për vitin 2024, prej këtyre 7 janë rishikuar në rritje dhe kur janë realizuar 1 është realizuar më

shumë së planifikimi për vitin 2024, sipas PBA 2024-2026, 5 janë realizuar më pak se planifikimi 2024, sipas PBA 2024-2026 dhe një sa planifikimi. (diferenca 1).

Produkti me kod M133892 "Projekt preventiva zbatimi për rikonstruksione te godinave te spitaleve rajonale dhe bashkiake, si dhe rishikimi i projekteve ekzistuese për disa nga spitalet", nuk është parashikuar për vitin 2024 në PBA 2023-2025, por është parashikuar në PBA 2024-2026 dhe është realizuar në shumën 11,807,963 lekë.
Nga sa më sipër rezulton se nga ana e MSHMS-së nuk janë marrë në konsideratë tavanet buxhetore, nuk është respektuar disiplina buxhetore dhe fishat e financimit gjatë hartimit të programeve buxhetore afatmesme, veprime në kundërshtim me *pikën 63 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2008, për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit,* ku përcaktohet se: *"Plani i investimeve i detajuar nga njësitë e qeverisjes qëndrore në nivel projekti, mban parasysh këtë rradhë prioritare: i) Projektet e investimeve në proces nga viti i kaluar; ii) Projektet e investimeve sipas prioriteteve sektoriale në programin buxhetor afatmesëm dhe të paraqitura në Kuvend, gjatë shqyrtimit të projekt – buxhetit; iii) Bashkëfinancimet e buxhetit të shtetit në projektet me financime të huaja."* Po ashtu, veprimet janë në kundërshtim me *pikën 23/b të Udhëzimit plotësues nr.1, datë 24.01.2024, për zbatimin e buxhetit të vitit 2024,* ku përcaktohet se: *"Projektet në vazhdim nga viti 2021-2023, ose më parë, do të financohen me përparësi dhe duhet të jenë pjesë e prioriteteve të propozuara për financim gjatë vitit 2024."* Mosqëndrueshmëria e parashikimit buxhetor të vitit 2024 nga PBA 2023-2025 në PBA 2024-2026, tregon për një planifikim jo të saktë, zbeh parimet e disiplinës buxhetore dhe cënon prioritetizimin e shpenzimeve.

Për shpenzimet kapitale me financim të huaj

Për verifikimin e investimeve dhe realizimit të tyre, grupi i auditimit krahasoi investimet kapitale me financim të huaj (kap 02) të planifikuara me ato të realizuara, ku për vitin 2024 situata paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 33 "Investime, me financim të huaj të planifikuara dhe të realizuara për vitin 2023"

Llog.Ek.	Kodi i projektit	Plani 31.12.24	Realizimi 31.12.24	Diferenca
231	KM13021	627,000,000	746,314,210	119,314,210
230	18BB403	-	892,620	892,620
230	G037018	-	3,300	3,300
231	KM13001	9,000,000	8,957,770	- 42,230
231	KM13017	69,000,000	68,633,890	- 366,110
231	GM13009	276,000,000	272,902,980	- 3,097,020
231	GM13021	109,000,000	95,832,510	- 13,167,490
Totali		1,090,000,000	1,193,537,280	103,537,280

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

Nga tabela më sipër rezulton se nga investimet me financim të huaj (kapitulli 2) diferenca fakt-plan, për këto projekte është në shumën 103,537 mijë lekë.
Realizimi i projekteve të investimeve me financim të huaj pa pasur plan buxheti apo në tejkalim të planit buxhetor të miratuar, si dhe mos marrja e masave për sistemimin e tyre nëpërmjet rialokimeve gjatë vitit apo gjatë procesit të rishikimit të buxhetit është në kundërshtim me pikën 28 të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave *dhe Ekonomisë nr. 1, datë 24.01.2024 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024" ku citohet se: "Plani i miratuar në ligjin e buxhetit për financimet e huaja, është kufiri i cili duhet të respektohet gjatë procesit të kryerjes së shpenzimeve, si për projektet me skemë të plotë thesari ashtu edhe për projektet me skemë të pjesshme thesari (jashtë TSA-së, në bankat e nivelit të dytë). Në rast të tejkalimit të planit të shpenzimeve njësitë e qeverisjes*

qendrore do të marrin masa për sistemimin e tyre nëpërmjet rialokimeve gjatë vitit dhe gjatë procesit të rishikimit të buxhetit"

Tabela nr. 34: "Produkte me financim të huaj të cilat nuk janë planifikuar, por janë realizuar."

Kodi i projektit	Emërtimi I projektit	Plan buxhet 31.12.2024 në lekë	Realizimi
18BB403	Projekt ne kuadër te IPA-Interreg "Promoting health in cbc area by stimulating local economies"	-	892,620
G037018	Projekti Pharem	-	3,300

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

Verifikime mbi Shpenzimet kapitale të MSHMS për periudhën 2023-2024

Nga verifikimi i shpenzimeve kapitale të paraqitura në fazën e tretë të PBA 2023-2025 dhe 2024-2026, detajimit përkatës 2023 dhe 2024 me ndryshimet mujore, realizimit vjetor dhe detajeve të lidhjes së kontratës përkatëse sipas të dhënave në Open Procurment rezultoi si në vijim:

- *Projekti 22AC623 "Rikonstruksioni i Poliklinikës së Spitalit Rajonal Durrës"*

Projekti është çelur në muajin Janar 2023 për vlerën 50,000 mijë lekë, është rishikuar me ulje në muajin Maj për vlerën 9,656 mijë lekë dhe në muajin Gusht për vlerën 16,000 mijë, duke reflektuar vlerën përfundimtare 24,035 mijë lekë. Projekti ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitur me Projekt Buxhetin e vitit 2023, si dhe është planifikuar në PBA 2023-2025, Faza III, si në vijim:

22AC623	Rikonstruksion i Poliklinikës së spitalit Durrës			
Viti	2022	2023	2024	2025
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Kosto totale (në lekë)	-	50,000,000	70,000,000	-

Nga auditimi rezulton se për këtë projekt, procedurat e prokurimit kanë filluar më datë 28.02.2023, me fond limit 97,099 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 14.09.2023, me afat përfundimi 5 muaj, me vlerë 73,395 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues "N. S.". Rezulton se vlera totale e kontratës është 23,395 mijë lekë më shumë se fondi i parashikuar në PBA për vitin 2023.

Rezulton se gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit janë ulur fondet buxhetore, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 51,360 mijë lekë.

- *Projekti 22AC613 "Rikonstruksion i poliklinikës së specialiteteve Shkodër"*

Projekti është çelur në muajin Janar për vlerën 50,000 mijë lekë, është rishikuar me ulje në muajin Maj për vlerën 9,965 mijë lekë, është rritur në muajin Tetor për vlerën 20,000 mijë lekë dhe në muajin Dhjetor është ulur përsëri për vlerën 20,000 mijë lekë, duke reflektuar vlerën përfundimtare 40,034 mijë lekë. Projekti ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitur me Projekt Buxhetin e vitit 2023, si dhe është planifikuar në PBA 2023-2025, Faza III, si në vijim:

22AC613	"Rikonstruksion i poliklinikës së specialiteteve Shkodër"			
	2022	2023	2024	2025
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Kosto totale (në lekë)	-	50,000,000	70,000,000	-

Nga auditimi rezulton se për këtë projekt, procedurat e prokurimit kanë filluar më datë 13.02.2023, me fond limit 103,068 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 28.04.2023, me afat përfundimi 6 muaj, me vlerë 90,388 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues "A. T.". Rezulton se vlera totale e kontratës është 40,388 mijë lekë më shumë se fondi i parashikuar në PBA për vitin 2023.

Rezulton se gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 50,000 mijë lekë fonde, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore projekt në vlerën 40,388 mijë lekë.

- Projekti 22AC625 "Rikonstruksioni i shtëpizave të mbështetura në Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë

Projekti është çelur në muajin Janar 2023 për vlerën 56,122 mijë lekë dhe është rishikuar me ulje në muajin Dhjetor për vlerën 30,000 mijë lekë, duke reflektuar vlerën përfundimtare 26,122 mijë lekë. Projekti ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitur me Projekt Buxhetin e vitit 2023, si dhe është planifikuar në PBA 2023-2025, Faza III, si në vijim:

22AC625	Rikonstruksioni i shtëpizave të mbështetura në spitalin Psikiatrik Vlorë			
	2022	2023	2024	2025
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Kosto totale (në lekë)	-	56,121,669	123,878,331	-

Nga auditimi rezulton se për këtë projekt, procedurat e prokurimit kanë filluar më datë 14.02.2023, me fond limit 149,469 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 16.05.2023, me afat përfundimi 10 muaj, me vlerë 175,306 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues "N.". Rezulton se vlera totale e kontratës është 117,184 mijë lekë më shumë se fondi i parashikuar në PBA, për vitin 2023.

Rezulton se gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 56,122 mijë lekë fonde, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore projekt në vlerën 119,184 mijë lekë.

- Projekti 18BA613 "Rikonstruksion i qendrave shëndetësore v.2023-2024"

Projekti është çelur në muajin Janar 2023 për vlerën 128,615 mijë lekë, është rishikuar me rritje në muajin Mars për vlerën 31,103 mijë lekë ndërsa më pas është rishikuar me ulje, në muajin Gusht për vlerën 34,246 mijë lekë, në muajin Tetor për vlerën 14,346 mijë lekë, në muajin Nëntor për vlerën 50,503 mijë lekë dhe në muajin Dhjetor për vlerën 4,241 mijë lekë, duke reflektuar vlerën përfundimtare 56,375 mijë lekë. Projekti ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitur me Projekt Buxhetin e vitit 2023, si dhe është planifikuar në PBA 2023-2025, Faza III, si në vijim:

18BA613	Rikonstruksion i Qendrave Shëndetësore			
	2022	2023	2024	2025
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Kosto totale (në lekë)	-	128,614,074	151,385,926	-

Nga auditimi rezulton se për këtë projekt, procedurat e prokurimit kanë filluar më datë 14.02.2023, me fond limit 149,469 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 16.05.2023, me afat përfundimi 10 muaj, me vlerë 175,306 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues "N.". Rezulton se vlera totale e kontratës është 117,184 mijë lekë më shumë se fondi i parashikuar në PBA, për vitin 2023.

Rezulton se gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 56,122 mijë lekë fonde, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore projekt në vlerën 119,184 mijë lekë.

- Projekti 18BA613 "Rikonstruksion i qendrave shëndetësore v.2023-2024"

Projekti është çelur në muajin Janar 2023 për vlerën 128,615 mijë lekë, është rishikuar me rritje në muajin Mars për vlerën 31,103 mijë lekë ndërsa më pas është rishikuar me ulje, në muajin Gusht

për vlerën 34,246 mijë lekë, në muajin Tetor për vlerën 14,346 mijë lekë, në muajin Nëntor për vlerën 50,503 mijë lekë dhe në muajin Dhjetor për vlerën 4,241 mijë lekë, duke reflektuar vlerën përfundimtare 56,375 mijë lekë. Projekti ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitur me Projekt Buxhetin e vitit 2023, si dhe është planifikuar në PBA 2023-2025, Faza III, si në vijim:

18BA613	Rikonstruksion i Qendrave Shëndetësore			
	2022	2023	2024	2025
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Kosto totale (në lekë)	-	128,614,074	151,385,926	-

Nga auditimi rezulton se në këtë kod projekti janë regjistruar 4 procedura prokurimi, konkretisht:

- Procedura e prokurimit me objekt "Lot.1 - Rikonstruksion i disa QSH-ve në qarqet Tiranë dhe Durrës", ka filluar më datë 14.04.2023, me fond limit 51,147 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 11.07.2023, me afat përfundimi 6.5 muaj, me vlerë 48,534 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues " 2. K.".
- Procedura e prokurimit me objekt "Lot.2 - Rikonstruksion i disa QSH-ve në qarqet Berat, Korçë dhe Elbasan", ka filluar më datë 14.04.2023, me fond limit 63,257 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 11.07.2023, me afat përfundimi 6.5 muaj, me vlerë 56,819 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues "C.".
- Procedura e prokurimit me objekt "Lot.3 - Rikonstruksion i disa QSH-ve në qarqet Shkodër, Kukës, Lezhë, Dibër", ka filluar më datë 14.04.2023, me fond limit 93,021 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 11.07.2023, me afat përfundimi 6.5 muaj, me vlerë 85,062 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues "C. R. ".
- Procedura e prokurimit me objekt "Lot.4 - "Rikonstruksion i disa QSH-ve në qarqet Gjirokastër, Vlorë dhe Fier", ka filluar më datë 14.04.2023, me fond limit 75,168 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 11.07.2023, me afat përfundimi 6.5 muaj, me vlerë 69,150 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues "I.".

Rezulton se gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt për të 4 procedurat e prokurimit ka pasur 159,717 mijë lekë fonde, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore në vlerën 99,847 mijë lekë.

Viti 2024

- Projekti 22AC640 "Ndërhyrje në godinën e A2 në QSUT për kthimin në gjendje pune të shërbimeve shëndetësore"

Projekti është çelur në muajin Mars 2024 në vlerën 28,000 mijë lekë, vlerë e cila nuk ka pësuar rishikime gjatë vitit. Projekti nuk ka qenë pjesë e PBA-së. Nga auditimi konstatohet se për këtë projekt kanë filluar procedurat e prokurimit më datë 05.04.2024, me fond limit 27,773 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 12.04.2024, me afat përfundimi 28 ditë, me vlerë 30,716 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues "A. K." SHPK.

Rezulton se gjatë vitit 2024 nuk janë kryer pagesa për këtë kod projekti.

- Projekti 18BB043 "Rikonstruksion i godinës qendrore të spitalit Gjirokastër"

Projekti është çelur në muajin Janar 2024 në vlerën 94,618 mijë lekë, në muajin Maj është rishikuar në rritje për vlerën 28,302 mijë lekë, në Nëntor është rishikuar me ulje për vlerën 14,638 mijë lekë dhe në muajin Dhjetor është rishikuar përsëri me ulje për vlerën 60,000 mijë lekë, duke reflektuar vlerën përfundimtare 48,282 mijë lekë. Projekti është planifikuar në PBA 2024-2026 si në tabelën në vijim:

18BB403	"Rikonstruksion i godinës qendrore të spitalit Gjirokastër"			
	2024	2025	Pas vitit 2025	2025
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Kosto totale (në lekë)	149,080,000	276,472,767	47,538,232	126,200,000

Nga auditimi konstatohet se për këtë projekt kanë filluar procedurat e prokurimit më datë 06.08.2024, me fond limit 512,166 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 04.11.2024, me afat përfundimi 24 muaj, me vlerë 419,477 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues "E. C." SHPK & "B. N." SHPK.

Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe në kohën e nënshkrimit të kontratës ky projekt ka pasur në dispozicion 20% të fondeve të nevojshme për lidhjen e kontratës duke qenë angazhim shumë vjeçar. Nga auditimi rezulton se ky alokim fondesh është bërë për qëllim të lidhjes së kontratës duke qenë se pas lidhjes së kontratës, pra për periudhën Nëntor-Dhjetor i janë hequr fonde në vlerën 70,638 mijë lekë.

Tabela nr. 33 "Investime, me financim të huaj të planifikuara dhe të realizuara për vitin 2023"

Llog.Ek.	Kodi i projektit	Plani 31.12.24	Realizimi 31.12.24	Diferenca
231	KM13021	627,000,000	746,314,210	119,314,210
230	18BB403	-	892,620	892,620
230	G037018	-	3,300	3,300
231	KM13001	9,000,000	8,957,770	- 42,230
231	KM13017	69,000,000	68,633,890	- 366,110
231	GM13009	276,000,000	272,902,980	- 3,097,020
231	GM13021	109,000,000	95,832,510	- 13,167,490
Totali		1,090,000,000	1,193,537,280	103,537,280

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

Nga tabela më sipër rezulton se nga investimet me financim të huaj (kapitulli 2) diferenca fakt-plan, për këto projekte është në shumën 103,537 mijë lekë.

Realizimi i projekteve të investimeve me financim të huaj pa pasur plan buxheti apo në tejkalim të planit buxhetor të miratuar, si dhe mos marrja e masave për sistemimin e tyre nëpërmjet rialokimeve gjatë vitit apo gjatë procesit të rishikimit të buxhetit është në kundërshtim me pikën 28 të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave *dhe Ekonomisë nr. 1, datë 24.01.2024 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024" ku citohet se: "Plani i miratuar në ligjin e buxhetit për financimet e huaja, është kufiri i cili duhet të respektohet gjatë procesit të kryerjes së shpenzimeve, si për projektet me skemë të plotë thesari ashtu edhe për projektet me skemë të pjesshme thesari (jashtë TSA-së, në bankat e nivelit të dytë). Në rast të tejkalimit të planit të shpenzimeve njësitë e qeverisjes qendrore do të marrin masa për sistemimin e tyre nëpërmjet rialokimeve gjatë vitit dhe gjatë procesit të rishikimit të buxhetit*"

Tabela nr. 34: "Produkte me financim të huaj të cilat nuk janë planifikuar, por janë realizuar."

Kodi i projektit	Emërtimi I projektit	Plan buxhet 31.12.2024 në lekë	Realizimi
18BB403	Projekt ne kuadër te IPA-Interreg "Promoting health in cbc area by stimulating local economies"	-	892,620
G037018	Projekti Pharem	-	3,300

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

Verifikime mbi Shpenzimet kapitale të MSHMS për periudhën 2023-2024

Nga verifikimi i shpenzimeve kapitale të paraqitura në fazën e tretë të PBA 2023-2025 dhe 2024-2026, detajimit përkatës 2023 dhe 2024 me ndryshimet mujore, realizimit vjetor dhe detajeve të lidhjes së kontratës përkatëse sipas të dhënave në Open Procurment rezultoi si në vijim:

- Projekti 22AC623 "Rikonstruksioni i Poliklinikës së Spitalit Rajonal Durrës"
Projekti është çelur në muajin Janar 2023 për vlerën 50,000 mijë lekë, është rishikuar me ulje në muajin Maj për vlerën 9,656 mijë lekë dhe në muajin Gusht për vlerën 16,000 mijë, duke reflektuar vlerën përfundimtare 24,035 mijë lekë. Projekti ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitur me Projekt Buxhetin e vitit 2023, si dhe është planifikuar në PBA 2023-2025, Faza III, si në vijim:

22AC623	**Rikonstruksion i Poliklinikës së spitalit Durrës**			
Viti	2022	2023	2024	2025
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Kosto totale (në lekë)	-	50,000,000	70,000,000	-

Nga auditimi rezulton se për këtë projekt, procedurat e prokurimit kanë filluar më datë 28.02.2023, me fond limit 97,099 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 14.09.2023, me afat përfundimi 5 muaj, me vlerë 73,395 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues "N. S.". Rezulton se vlera totale e kontratës është 23,395 mijë lekë më shumë se fondi i parashikuar në PBA për vitin 2023.
Rezulton se gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit janë ulur fondet buxhetore, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 51,360 mijë lekë.

- Projekti 22AC613 "Rikonstruksion i poliklinikës së specialiteteve Shkodër"
Projekti është çelur në muajin Janar për vlerën 50,000 mijë lekë, është rishikuar me ulje në muajin Maj për vlerën 9,965 mijë lekë, është rritur në muajin Tetor për vlerën 20,000 mijë lekë dhe në muajin Dhjetor është ulur përsëri për vlerën 20,000 mijë lekë, duke reflektuar vlerën përfundimtare 40,034 mijë lekë. Projekti ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitur me Projekt Buxhetin e vitit 2023, si dhe është planifikuar në PBA 2023-2025, Faza III, si në vijim:

22AC613	**"Rikonstruksion i poliklinikës së specialiteteve Shkodër"**			
	2022	**2023**	**2024**	**2025**
	Buxheti	**Parashikimi**	**Parashikimi**	**Parashikimi**
Kosto totale (në lekë)	-	50,000,000	70,000,000	-

Nga auditimi rezulton se për këtë projekt, procedurat e prokurimit kanë filluar më datë 13.02.2023, me fond limit 103,068 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 28.04.2023, me afat përfundimi 6 muaj, me vlerë 90,388 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues "A. T.". Rezulton se vlera totale e kontratës është 40,388 mijë lekë më shumë se fondi i parashikuar në PBA për vitin 2023.
Rezulton se gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 50,000 mijë lekë fonde, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore projekt në vlerën 40,388 mijë lekë.

- Projekti 22AC625 "Rikonstruksioni i shtëpizave të mbështetura në Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë
Projekti është çelur në muajin Janar 2023 për vlerën 56,122 mijë lekë dhe është rishikuar me ulje në muajin Dhjetor për vlerën 30,000 mijë lekë, duke reflektuar vlerën përfundimtare 26,122 mijë lekë. Projekti ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitur me Projekt Buxhetin e vitit 2023, si dhe është planifikuar në PBA 2023-2025, Faza III, si në vijim:

22AC625	**Rikonstruksioni i shtëpizave të mbështetura në spitalin Psikiatrik Vlorë**			
	2022	**2023**	**2024**	**2025**
	Buxheti	**Parashikimi**	**Parashikimi**	**Parashikimi**
Kosto totale (në lekë)	-	56,121,669	123,878,331	-

Nga auditimi rezulton se për këtë projekt, procedurat e prokurimit kanë filluar më datë 14.02.2023, me fond limit 149,469 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 16.05.2023, me afat përfundimi 10 muaj, me vlerë 175,306 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues "N.". Rezulton se vlera totale e kontratës është 117,184 mijë lekë më shumë se fondi i parashikuar në PBA, për vitin 2023.
Rezulton se gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 56,122 mijë lekë fonde, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore projekt në vlerën 119,184 mijë lekë.

- *Projekti 18BA613 "Rikonstruksion i qendrave shëndetësore v.2023-2024"*

Projekti është çelur në muajin Janar 2023 për vlerën 128,615 mijë lekë, është rishikuar me rritje në muajin Mars për vlerën 31,103 mijë lekë ndërsa më pas është rishikuar me ulje, në muajin Gusht për vlerën 34,246 mijë lekë, në muajin Tetor për vlerën 14,346 mijë lekë, në muajin Nëntor për vlerën 50,503 mijë lekë dhe në muajin Dhjetor për vlerën 4,241 mijë lekë, duke reflektuar vlerën përfundimtare 56,375 mijë lekë. Projekti ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitur me Projekt Buxhetin e vitit 2023, si dhe është planifikuar në PBA 2023-2025, Faza III, si në vijim:

18BA613	Rikonstruksion i Qendrave Shëndetësore			
	2022	2023	2024	2025
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Kosto totale (në lekë)	-	128,614,074	151,385,926	-

Nga auditimi rezulton se në këtë kod projekti janë regjistruar 4 procedura prokurimi, konkretisht:
- Procedura e prokurimit me objekt "Lot.1 - Rikonstruksion i disa QSH-ve në qarqet Tiranë dhe Durrës", ka filluar më datë 14.04.2023, me f1vond limit 51,147 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 11.07.2023, me afat përfundimi 6.5 muaj, me vlerë 48,534 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues " 2. K.".
- Procedura e prokurimit me objekt "Lot.2 - Rikonstruksion i disa QSH-ve në qarqet Berat, Korçë dhe Elbasan", ka filluar më datë 14.04.2023, me fond limit 63,257 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 11.07.2023, me afat përfundimi 6.5 muaj, me vlerë 56,819 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues "C.".
- Procedura e prokurimit me objekt "Lot.3 - Rikonstruksion i disa QSH-ve në qarqet Shkodër, Kukës, Lezhë, Dibër", ka filluar më datë 14.04.2023, me fond limit 93,021 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 11.07.2023, me afat përfundimi 6.5 muaj, me vlerë 85,062 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues "C. R.".
- Procedura e prokurimit me objekt "Lot.4 - "Rikonstruksion i disa QSH-ve në qarqet Gjirokastër, Vlorë dhe Fier", ka filluar më datë 14.04.2023, me fond limit 75,168 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 11.07.2023, me afat përfundimi 6.5 muaj, me vlerë 69,150 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues "I.".

Rezulton se gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt për të 4 procedurat e prokurimit ka pasur 159,717 mijë lekë fonde, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore në vlerën 99,847 mijë lekë.
Viti 2024
- *Projekti 22AC640 "Ndërhyrje në godinën e A2 në QSUT për kthimin në gjendje pune të shërbimeve shëndetësore"*

Projekti është çelur në muajin Mars 2024 në vlerën 28,000 mijë lekë, vlerë e cila nuk ka pësuar rishikime gjatë vitit. Projekti nuk ka qenë pjesë e PBA-së. Nga auditimi konstatohet se për këtë projekt kanë filluar procedurat e prokurimit më datë 05.04.2024, me fond limit 27,773 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 12.04.2024, me afat përfundimi 28 ditë, me vlerë 30,716 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues "A.K." SHPK.
Rezulton se gjatë vitit 2024 nuk janë kryer pagesa për këtë kod projekti.

- Projekti 18BB043 "Rikonstruksion i godinës qendrore të spitalit Gjirokastër"

Projekti është çelur në muajin Janar 2024 në vlerën 94,618 mijë lekë, në muajin Maj është rishikuar në rritje për vlerën 28,302 mijë lekë, në Nëntor është rishikuar me ulje për vlerën 14,638 mijë lekë dhe në muajin Dhjetor është rishikuar përsëri me ulje për vlerën 60,000 mijë lekë, duke reflektuar vlerën përfundimtare 48,282 mijë lekë. Projekti është planifikuar në PBA 2024-2026 si në tabelën në vijim:

18BB403	**"Rikonstruksion i godinës qendrore të spitalit Gjirokastër"**			
	2024	**2025**	**Pas vitit 2025**	**2025**
	Buxheti	**Parashikimi**	**Parashikimi**	**Parashikimi**
Kosto totale (në lekë)	149,080,000	276,472,767	47,538,232	126,200,000

Nga auditimi konstatohet se për këtë projekt kanë filluar procedurat e prokurimit më datë 06.08.2024, me fond limit 512,166 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 04.11.2024, me afat përfundimi 24 muaj, me vlerë 419,477 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues "E. C." SHPK & "B. N." SHPK.
Gjatë zhvillimit të icion 20% të fondeve të nevojshme për lidhjen e kontratës duke qenë angazhim shumë vjeçar. Nga auditimi rezulton sprocedurës së prokurimit dhe në kohën e nënshkrimit të kontratës ky projekt ka pasur në dispoze ky alokim fondesh është bërë për qëllim të lidhjes së kontratës duke qenë se pas lidhjes së kontratës, pra për periudhën Nëntor-Dhjetor i janë hequr fonde në vlerën 70,638 mijë lekë.

Lidhur me sa trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga z. A. K., zj.G. I., zj. A. Gj.dhe zj, D. K.. përfaqësues të MSHMS-së është paraqitur observacioni nr. 85/5 prot., datë 05.02.2026, administruar në KLSH me nr. 110/29 prot., datë 09.02.2026, ku janë shprehur objeksionet, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *"....Treguesve të monitorimit financiar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2024, u përcollën vetëm anekset përkatëse të saktësuara me të dhënat e sistemit SIFQ, për programin 10430.*
Nga komunikimet edhe të mëvonshme me MF, në momentin që do të mbyllen sistemimet e të dhënave do të gjenerohen dhe anekset e këtij programi.
Megjithatë, sqarojmë se pavarësisht mosprezencës së anekseve përkatëse për programin 07330 "Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor", në relacionin që shoqëron këto anekse, paraqiten të gjitha të dhënat faktike (si sasiore, ashtu edhe në vlerë faktike), për secilin produkt, si për shpenzimet korrente ashtu edhe për shpenzimet kapitale.".
Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në lidhje me objeksionet e paraqitura nga përfaqësuesit e MSHMS-së, pas shqyrtimit të detajuar të argumenteve të paraqitura, konstatojmë se gjendja faktike paraqitet e njëjtë me atë të evidentuar gjatë auditimit në terren dhe të reflektuar në akt-konstatimet përkatëse.

Komunikimet e zhvilluara në vijimësi evidentojnë se subjekti ka ndërmarrë hapa për adresimin e problematikave të konstatuara, çka tregon fillimin e procesit të marrjes së masave korrigjuese.
Megjithatë, pavarësisht pretendimeve të paraqitura, **grupi i auditimit i qëndron konstatimeve të bëra lidhur me paplotësinë e raportit të monitorimit, për sa kohë që dokumentacioni i administruar nuk provon në mënyrë të mjaftueshme përmbushjen e kërkesave përkatëse.**

Lidhur me sa trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga zj. M. Sh., z. A. K. dhe zj. D. K., përfaqësues të MSHMS-së është paraqitur observacioni nr. 85/4 prot., datë 05.02.2026, administruar në KLSH me nr. 110/28 prot., datë 09.02.2026, ku janë shprehur objeksionet, si më poshtë:

***Pretendimi i subjektit**: Lidhur me Projekt Raportin e Auditimit të KLSH-së, Nr. Prot. 110/25, datë 07.01.2026, protokolluar në MSHMS me Nr. 85 Prot., datë 08.01.2026 (mbajtur nga Kontrolli i Lartë i Shtetit "Mbi auditimin e ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale" dhe në bazë të Programit të Auditimit nr. 110/1 Prot., datë 24.01.2025, i ndryshuar), për të cilin kemi marrë dijeni nëpërmjet email-it zyrtar me datë 12.01.2026 nga drejtoresha e drejtorisë së prokurimeve në MSHMS, paraqesim observacionin sa më poshtë vijon:*
SHPENZIMET E INVESTIMEVE
Nga ana e grupit të auditimit në projekt-raport është bërë një përshkrim i të gjithë procesit, që nga përgatitja e projektbuxhetit (faza I, faza II dhe faza III), me miratimin e ligjit të buxhetit në Parlament e për të vijuar me çeljet e investimeve sipas viteve 2023 dhe 2024, e për të vijuar më pas me monitorimin dhe mbylljen e vitit buxhetor.

Çdo vit buxhetor, MSHMS harton dokumentacionin e PBA për vitet respektive dhe, për periudhën e audituar, bëhet fjalë për PBA 2023–2025 dhe PBA 2024–2026.
Bazuar në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pika b e nenit 44 "Rishpërndarja e fondeve buxhetore" citohet: "Rishpërndarjet e fondeve të projekteve të investimeve brenda të njëjtit program të njësisë së qeverisjes qendrore miratohen nga Ministri i Financave". Referuar legjislacionit të sipërcituar, neni 44 i këtij ligji e lejon rishpërndarjen e fondeve buxhetore për investime me miratim të Ministrit të Financave.
Kjo e bën të qartë se pse tabela nr. 14 e paraqitur nga ana juaj në projekt-raport ka ndryshime nga plani fillestar në atë përfundimtar. Procedurat e zbatimit të buxhetit janë të mirëpërcaktuara në udhëzimet që çdo vit Ministria e Financave nxjerr për zbatimin e buxhetit.
Pika 12 e paragrafit "Përgjegjësia e Ministrit përgjegjës për Financat gjatë zbatimit të buxhetit" në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, citon: "Miraton rishpërndarjet e fondeve të projekteve të investimeve brenda të njëjtit program të njësisë së qeverisjes qendrore".
Gjithashtu, referuar kapitullit II "Procedurat standarde të shpërndarjes dhe rishpërndarjes të fondeve të buxhetit vjetor", në paragrafin II.1 "Buxheti vjetor, rishpërndarja e fondeve buxhetore" citohet:"Pika 69. Rishpërndarja e fondeve buxhetore është pjesë e procesit të azhornimit të politikave të programuara në fillim të vitit dhe të detajuara sipas strukturës përkatëse buxhetore.
Pika 73. Mbështetur në kërkesën për rishpërndarje fondesh dhe analizën e paraqitur tek Nëpunësi i Parë Autorizues:

b) Rishpërndarjet e fondeve të projekteve të investimeve brenda të njëjtit program të njësisë së qeverisjes qendrore miratohen nga Ministri përgjegjës për Financat, pa cenuar burimet e financimit (buxheti, financimi i huaj, të ardhurat dytësore).
Kërkesat për rishpërndarje sipas germave "a", "b" dhe "c" të paraqitura zyrtarisht dhe elektronikisht miratohen në nivel vjetor dhe regjistrohen nga struktura përgjegjëse për buxhetin në SIFQ. Nëpunësi i Parë Autorizues, nëpërmjet strukturës përgjegjëse për buxhetin në Ministrinë përgjegjëse për Financat, njofton zyrtarisht njësinë qendrore për miratimin e kërkesës si dhe strukturën përgjegjëse të thesarit në degë.
Pika 74. Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes qendrore njofton zyrtarisht drejtuesit e programeve buxhetore dhe nëpunësit autorizues të nivelit të dytë/të gjithë drejtuesit funksionalë për rishpërndarjet ose shtesat e fondeve të miratuara sipas përcaktimeve të paragrafëve 72, 73 të këtij udhëzimi.
Pika 76. E drejta e njësisë së qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve të miratuara për vitin buxhetor ushtrohet deri në datën 15 nëntor të çdo viti, e cila konsiderohet data e fundit e paraqitjes së kërkesës tek Nëpunësi i Parë Autorizues."
Të gjitha sa cituam më lart janë ndjekur me përpikmëri nga ana e MSHMS dhe dokumentacioni ka qenë pjesë e dosjeve të dorëzuara te grupi i auditimit në fillim të kontrollit.
Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është përgjegjëse për menaxhimin e fondeve buxhetore. Kërkesat për fonde investimesh janë shumë më tepër se tavanet e miratuara nga MF; për këtë arsye, nisur nga fakti që disa prej investimeve nuk paraqesin ecuri të mirë, nuk kanë mundur të realizojnë procedura prokurimi për arsye nga më të ndryshmet, MSHMS bën rialokime gjatë vitit, duke kaluar të gjithë procedurën e përcaktuar nga legjislacioni.

Në projekt-raport është bërë një krahasim i disa projekteve nga njëra PBA në tjetrën, një krahasim statistikor, por pa i hyrë në brendësi arsyeve të këtyre ndryshimeve, të cilat janë:
1. Tavanet e ulëta buxhetore të miratuara nga MF.
2. Mosrealizimi i fondeve të parashikuara në buxhetin paraardhës, për të gjitha llojet e kontratave dhe sidomos për kontratat shumëvjeçare. Kjo bën që, duke qenë i detyrueshëm parashikimi në buxhet i detyrimeve kontraktuale, të planifikohen këto detyrime dhe për rrjedhojë objektet e tjera të investimeve të spostohen në vitet e tjera buxhetore.
3. Prioritetet e reja që rezultojnë nga politika të reja të MSHMS.Po paraqesim dhe sqarimet për lëvizjet e fondeve për disa objekte që ju i keni përmendur, për t'jua bërë më të qarta arsyet e këtyre lëvizjeve.
Specifikisht:
1. 22AC623 Rikonstruksioni i Poliklinikës sp. Durrës
Fillim PBA 2023–2025:
v.2023 – 50,000,000
v.2024 – 70,000,000
Ky objekt është çelur në PBA 2023–2025 me çelje fillestare sipas tabelës më sipër. Prokurimi është kryer nga vetë spitali Durrës dhe vlera e kontratës është 74,289,899 lekë me TVSH.
Plani i fundvitit për këtë objekt është:
v.2023 – 24,034,553
v.2024 – 50,255,346
Në asnjë moment nuk kanë munguar fondet buxhetore, pasi ato janë trevjeçare dhe jo vetëm për vitin buxhetor 2023, kjo për kontrata shumëvjeçare. Në rast të mungesës së fondeve, nuk do të mund të regjistrohej urdhri i prokurimit në SIFQ dhe, për rrjedhojë, nuk do të mund të financohej

vlera për vitin 2023. Vlera që ju citoni prej 51,360 mijë lekë është në vitin 2024, sepse në atë vit përfundon objekti.
2. 22AC613 Rikonstruksion i Poliklinikës së sp. Shkodër
Fillim viti 2023:
v.2023 – 50,000,000
v.2024 – 70,000,000
Fund viti 2023:
v.2023 – 50,353,665
v.2024 – 40,034,554
Për sqarim, kontratat e ndërtimit nuk janë kontrata që sapo nënshkruhen fillojnë punimet; ka disa procedura të tjera që duhen respektuar. Punimet nisin kur merret leja e ndërtimit dhe kur lirohet sheshi i ndërtimit. Vetëm në këtë moment fillon numërimi i ditëve sipas afatit të kontratës dhe për këtë arsye kontrata shkon përtej vitit 2023 dhe në këtë rast nuk mund të flasim për marrje të angazhimeve pa fonde buxhetore.
3. 22AC625 Rikonstruksioni i shtëpizave të mbështetura në sp. Psikiatrik Vlorë
Fillim viti 2023:
v.2023 – 56,121,669
v.2024 – 123,878,331
Fund viti 2023:
v.2023 – 26,121,669
v.2024 – 52,785,431
v.2025 – 96,398,966
Për këtë objekt investimi kanë nisur punimet në nëntor 2023 me grafik 10 muaj. Lidhja e kontratës është bërë në 10.05.2023, por punimet kanë nisur vetëm kur është zbardhur leja e ndërtimit dhe për këtë arsye, për objektet që shfaqin realizim të ulët financiar, MF me anë të Aktit Normativ të fundvitit 2023 ka kërkuar pakësim të fondeve të investimeve.
I njëjti arsyetim vlen edhe për objektet e rikonstruksionit të spitalit Gjirokastër dhe rikonstruksionin e qendrave shëndetësore, për të cilat keni konstatuar "marrje e angazhimeve pa fonde buxhetore".
Konkluzion:
Ashtu siç cituam në observacionin e akt-konstatimit nr. 3 dhe në këtë observacion, theksojmë se në asnjë moment nuk kemi marrë angazhime pa fonde buxhetore, për asnjë investim. Fondet janë të regjistruara në sistemin e thesarit. Ju si grup audituesish jeni përqendruar vetëm në buxhetin e një viti dhe jo të tre viteve, për të parë sesi shpërndaheshin fondet buxhetore.
Gjithashtu ritheksojmë se arsyet që dhamë më sipër mund t'jua kishim bërë me dije gjatë periudhës së kontrollit, që këto konstatime të mos ishin shkruar nga ana juaj dhe të mos vijonin në projekt-raport, por asnjëherë nuk jemi thirrur për t'u ballafaquar. Ju keni audituar buxhetin e investimeve vetëm nga pjesa e fondeve dhe vetëm për një vit buxhetor, ndërkohë që zbatimi i kontratave (dhe i buxhetit gjithashtu) është i lidhur edhe me legjislacione të tjera, si ai i fushës së ndërtimit, të cilat, nëse nuk respektohen, përbëjnë shkelje të rënda të ligjit dhe, për rrjedhojë, edhe dëm ekonomik, duke ndërtuar në mënyrë të paligjshme.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në lidhje me shpërndarjet dhe rishpërndarjet e fondeve buxhetore, grupi i auditimit nuk është shprehur mbi realizimin e tyre pa konfirmimet përkatëse. Megjithatë, vetë ekzistenca e rishpërndarjeve përbën element tregues të një "planifikimi jo të mirë" të fondeve buxhetore.

- Sa i përket krahasimit statistikor të dy PBA-ve të njëpasnjëshme, mbetet fakt se situata paraqitet ashtu siç është reflektuar në materialin e grupit të auditimit, pavarësisht arsyetimeve të paraqitura nga ana juaj. Për këtë çështje nuk është ngarkuar me përgjegjësi individuale asnjë person konkret. Mosrealizimi i fondeve dhe ndryshimi i prioriteteve të evidentuara në arsyetimin tuaj lidhen me "planifikim jo të mirë", siç është theksuar edhe në PRA, duke zbehur rëndësinë e procesit të planifikimit buxhetor.
- Në lidhje me projektet me kode specifike të evidentuara nga ana juaj, rezulton se pothuajse të gjitha kontratat përkatëse kanë qenë me afat më pak se një vit. Në momentin e lidhjes së tyre, fondet buxhetore kanë rezultuar të pamjaftueshme, duke krijuar risk të shtuar për marrjen e angazhimeve pa mbulim të plotë buxhetor. Theksojmë se nuk është konstatuar materializimi i këtij risku, por situata e krijuar rrit mundësinë e ndodhjes së tij.
- Në lidhje me konsultimin gjatë auditimit në terren, theksojmë se ky është realizuar në ditën e fundit të misionit të auditimit, moment në të cilin jeni njohur me situatën e evidentuar dhe me gjetjet paraprake të grupit të auditimit. Në atë fazë, grupi ka paraqitur qëndrimin e tij profesional mbi çështjet e konstatuara.

Gjithashtu, sqarojmë se subjekti i audituar ka pasur mundësinë të paraqesë argumentet dhe qëndrimin e tij, të cilat janë administruar dhe po trajtohen nëpërmjet observacioneve përkatëse, në përputhje me procedurën standarde të shqyrtimit të kundërshtimeve.

Për sa më sipër, grupi i auditimit vijon t'i qëndrojë konstatimeve dhe qëndrimit të shprehur në PRA

Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi S. K., M. Sh., G. I., Anj. Gj., D. K. dhe A. K.

2.2 Mbi zbatimin e dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

Në zbatim të pikës nr. 2 të programit të auditimit nr. 110/1 prot, datë 24.01.2025, i ndryshuar, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrje, fletëdalje, faturë, mandat-arkëtim, mandat-pagesë, urdhër-shpenzim.
- Transaksionet e llogarive bankare;
- Pagesa për shërbime e blerje të vogla, të ndara në disa kontrata me disa grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme.

Nga auditimi me zgjedhje i transaksioneve të kryera përgjatë viteve 2023-2024 mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër shpenzim, etj.) të realizuara në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rezultoi se, veprimet janë kryer konform kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar;, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018*"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar,* ***rezultoi se:***

- ✓ Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara **në ditarin e bankës** për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 janë në vlerën totale 1,745,403,298 lekë;
- ✓ Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara **në ditarin e bankës** për periudhën 01.01.2024-31.12.2024 janë në vlerën totale 1,717,183,192 lekë.
- ✓ Regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit, mbështeten në dokumente origjinale si dokumente autorizues, dokumente vërtetues, dokumente të kontabilitetit, etj.

- ✓ Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konform rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Urdhër-shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues (si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve) konform pikës 35, të Udhëzimit të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë nr.30, date 27.12.2011 *"Për Menaxhimin e Aktiveve ne Njësite e Sektorit Publik"* dhe në çdo rast kanë nënshkrimin e personit të autorizuar në Degën e Thesarit.

Nga auditimi i kryer mbi ditarin e arkës, rezultoi se ditarët janë mbajtur në mënyrë të përditësuar dhe në përputhje me dokumentacionin mbështetës përkatës. Dokumentacioni përfshin autorizime për tërheqje valute të firmosura nga Drejtori i Përgjithshëm; mandat arkëtimi dhe mandat pagesa; urdhra shërbimi dhe autorizime për shërbime jashtë vendit, të lëshuara nga Sekretari i Përgjithshëm, në të cilat përcaktohet autoriteti pagues për shpenzimet e udhëtimit (si bileta udhëtimi, boarding pass, shërbim taksie, akomodim në hotel, etj.). Urdhrat e shërbimit janë firmosur në çdo rast nga punonjësi udhëtues, nëpunësi urdhërues dhe nëpunësi zbatues.

Gjatë periudhës 01.01.2024 deri më 31.12.2024, **në ditarin e arkës** janë kontabilizuar me mandat arkëtime 14,000 USD dhe 30,000 Euro dhe për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023 janë kontabilizuar 4,716 USD dhe 46,000 Euro.

a. Auditimi me zgjedhje i urdhër shpenzimeve

Urdhër-shpenzimet e përzgjedhura u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*".

Nga auditimi me zgjedhje i urdhër-shpenzimeve, duke i analizuar dhe me regjistrimin në sistemin SIFQ (*rastet e evidentuara ne Aneksin nr. 2.1 dhe Aneksin 2.2 bashkëlidhur*) nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua:

- Për vitin 2023, janë kryer likuidime në tejkalim të afatit ligjor 30 ditor **56 transaksione në vlerë 38,960,913 lekë.**
- Për vitin 2024, janë kryer likuidime në tejkalim të afatit ligjor 30 ditor **54 transaksione në vlerë 83,626,788 lekë.**

Nga auditimi me përzgjedhje i urdhër-shpenzimeve, duke i analizuar dhe me regjistrimin në sistemin SIFQ, për vitet 2023 dhe 2024, u konstatua:

- **Me USH nr. 663/2024, datë 18.11.2024**, janë kryer pagesat per "Supervizim të rikonstruksionit të QSH" për faturën tatimore të shitjes: nr.67/2024, dt 25.09.2024 ne shumën ne total 986,405 lekë, bazuar ne urdhër prokurimi nr. 509, date 28.08.2023; Kontrata nr. 3108/32, dt 15.12.2023; njoftim fituesi nr. 3108/24, dt 16.11.2023, kërkesë nr. 137, dt 25.09.2024, formular sigurim kontrate dt 11.12.2023 nga Al. sha, ne tejkalim ta afatit ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në pikën 184 Udhëzimit MFE nr. 09, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".
- **Me USH nr. 718/2024, datë 10.12.2024** "**Blerje çeku i bebeve**", përfitues Banka C. me NIPT K.....O, njësia shpenzuese ka kryer pagesën për vlerën çekut për përfitimin e Bonus–it për nënat me foshnja të porsalindur, për blerjen e 45,000 fije (çek) në vlerë 2,250,000 lekë, për periudhën 07.07.2023 deri 26.08.2024 paguar me fatura tatimore e shitjes nr. 17230/2024, dt 12.09.2024, shoqëruar me FH e magazinës, tejkalim ta afatit ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në pikën 184 Udhëzimit MFE nr. 09, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*".
- **Me USH nr. 711/2024, datë 10.12.2024** janë kryer pagesat per "Shpenzime Uji" ne total 58,789 lekë për faturat tatimore të shitjes nr. 161868/2024, dt 08.08.2024; nr. 136788/2024, dt 03.09.2024; nr. 205886/2024 dt 04.10.2024, nr. 232838/2024 dt 08.11.2024 dhe nr.259921/2024

dt 04.12.2024 (brenda afatit), ne tejkalim ta afatit ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në pikën 184 Udhëzimit MFE nr. 09, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*"

- **Me USH nr. 712/2024, datë 10.12.2024**, janë kryer pagesat per "Shërbim Postar" ne total **945,535 lekë** për faturat tatimore të shitjes: nr.92905/2023, dt 06.10.2023 ne shumën 43,210 lekë; nr. 929695/2023, dt 06.11.2023 ne shumen 64,350 lekë; nr. 930547/2023 dt 07.12.2023 në shumën 54,425 lekë; nr. 105/2024 dt 05.01.2024 në shumën 70,525 lekë; nr. 1008/2024 dt 05.02.2024 në shumën 75,155 lekë; nr. 1549/2024 dt 05.03.2024 në shumën 118,155 lekë; nr. 2097/2024 dt 04.04.2024 në shumën 50,535 lekë; nr. 2627/2024 dt 07.05.2024 në shumën 55,985 lekë; nr. 3558/2024 dt 07.06.2024 në shumën 50,715 lekë; nr. 4148/2024 dt 08.07.2024 në shumën 51,230 lekë; nr. 4660/2024 dt 07.08.2024 në shumën 88,610 lekë; nr. 4784/2024 dt 04.09.2024 në shumën 89,130 lekë; nr. 5271/2024 dt 03.10..2024 në shumën 57,170 lekë; nr. 5816/2024 dt 05.11.2024 në shumën 76,340 lekë, ne tejkalim ta afatit ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në pikën 184 Udhëzimit MFE nr. 09, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*".
- **Me USH nr. 708/2024**, datë 10.12.2024, janë kryer pagesat per "Rikonstruksionin e godinave të QSH" për faturën tatimore të shitjes: nr.11/2024, dt 23.07.2024 ne shumën ne total 9,624,024 lekë (zbritur penaliteti 60.018 lekë per tejkalim afat punimesh në QSH Maliq), bazuar ne urdhër prokurimi nr. 197, date 11.04.2023; Kontrata nr. 1592/20, dt 11.07.2023; proces verbal kolaudimi dt 01.11.2023-29.04.2024, situacionet përfundimtare për qarqet Berat, Korçë, Elbasan, certifikatën e marrjes ne dorëzim dt 03.07.2024, ne tejkalim ta afatit ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në pikën 184 Udhëzimit MFE nr. 09, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*".
- **Me USH nr. 721/2024, datë 10.12.2024**, janë kryer pagesat për "Shërbim riparimi dhe mirëmbajtje automjetesh në MSHMS" për faturën/at tatimore të shitjes: nr.700/2024, dt 27.04.2024 ne shumën ne total 313.920 lekë; nr. 729/2024, dt 30.04.2024 në shumën 357,240 lekë; nr. 730/2024, dt 30.04.2024 në shumën 312.730 lekë; nr. 821/2024, dt 16.05.2024 në shumën 154,920 lekë; **ne total 1,138,800 lekë (me tvsh**) në tejkalim ta afatit ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në pikën 184 Udhëzimit MFE nr. 09, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".
- **Me USH nr. 736/2024, datë 18.12.2024**, janë kryer pagesat për "Supervizim për rikonstruksionin e QSH-re/ Ambulanca në qarqet Gjirokastër dhe Vlore" me operatorin Ekonomik H. ENG. K. shpk me NIPT M.....F, për faturën/at tatimore të shitjes: nr.31/2024, dt 20.09.2024 ne shumën ne total 937,122 lekë (me tvsh), bashkëngjitur Urdhëri Prokurimit. Formulari njoftimit te fituesit, kontrate mbikëqyrje punimesh, ne tejkalim ta afatit ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në pikën 184 Udhëzimit MFE nr. 09, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".
- **Me USH nr. 740/2024, datë 18.12.2024**, janë kryer pagesat per **"**Blerje Orendi dhe pajisje mobilimi për QSH-re/ Ambulanca të rikonstruktuara **Rajoni Tiranë**" për Operatorin Ekonomik R.-A. me NIPT J……M për faturën/at tatimore të shitjes: nr.49/2024, dt 09.08.2024 ne vlerë 1,741,109 lekë (me tvsh); nr.50/2024, dt 13.08..2024 ne vlerë 167,715 lekë (me tvsh); nr.51/2024, dt 13.08.2024 ne vlerë 692.969 lekë (me tvsh); nr.52/2024, dt 14.08.2024 ne vlerë 2,337,906 lekë (me tvsh); nr.58/2024, dt 26.08.2024 ne vlerë 1,551,754 lekë (me tvsh); nr.59/2024, dt 28.08.2024 ne vlerë 1.060.683 lekë (me tvsh); **ne total 7.552.158 lekë (me tvsh**).
- Bashkëngjitur USH nr. 740/2024 gjenden: Urdhëri prokurimi nr. 75, datë 31.08.2023; Mini **Kontrate Furnizimi (Marrëveshje Kuadër) nr. 2019/11, datë 07.08.2024**; Amendim kontrate (pakësim) nr.3642 prot, date 28.08.2024 (mos përfshirjen e mobilimit për QSH Thumanë) ne vlerë 968,018 lekë (me tvsh); përmbledhëse faturave (6 fatura) ne total 7,552,158 lekë ; **proces verbal**

nr.1716/1 prot, **datë 09.08.2024** "Për marrjen ne dorëzim të mobileve dhe pajisjeve mjekësore , për QSH / Ambulanca e ri konstruktuara gjatë vitit 2023-2024, të rajonit Tirane" i mbajtur nga grupi i marrjes ne dorëzim (5 pjesëtarë) punonjës të QSHKSH- Drejtoria Rajonale Tirane; Flete – Hyrje nr. 1, date 09.08.2024 QSHKSH- Drejtoria Rajonale Tirane per 13 artikuj ne vlerë 7,552,158 lekë;

Nga auditimi rezultoi se:

Nëpërmjet shkresës administruar në MSHMS me nr. 2747 prot., datë 14.06.2024, Drejtori i Drejtorisë Rajonale të OSHKSH-së Tiranë ka dërguar listën përfundimtare me kërkesat për mobilim të qendrave shëndetësore të rikonstruktuara. Nëpërmjet shkresës nr. 2019/6 prot., datë 02.07.2024, Drejtori i Përgjithshëm Ekonomik dhe i Shërbimeve Mbështetëse M. Sh. ka kërkuar lidhjen e minikontratës për Rajonin e Tiranës, bazuar në nevojat e paraqitura prej tyre. Titullari i AK S. H. ka dërguar ftesën për ofertë nr. 2019/7 prot., datë 03.07.2024, drejtuar përfaqësuesit të OE "R.-A.". OE ka përcjellë ofertën ekonomike, administruar në MSHMS me nr. 2019/9 prot., datë 12.07.2024, në vlerën totale prej 7,100,146 lekë pa TVSh dhe 8,520,175 lekë me TVSH.

Ndërmjet AK dhe OE është lidhur kontrata e furnizimit nr. 2019/11 prot., datë 07.08.2024, në vlerën prej 7,100,146 lekë pa TVSh dhe 8,520,175 lekë me TVSh, me afat 25 ditë nga lidhja e kontratës, *duke specifikuar se vendi i dorëzimit të objektit të kontratës është në qendrat shëndetësore të rikonstruktuara*. Në nenin 4 të kontratës janë paraqitur artikujt që do të furnizohen, sasitë dhe vlerat përkatëse, *por jo kolona "Specifikimet teknike", sipas kërkesës së MSHMS dhe Shtojcës 5 "Specifikimet teknike"*. Nëpërmjet shkresës së APP-së nr. 750/15 prot., datë 25.07.2024 "*Të dhëna mbi Vendimin nr. 73, datë 25.07.2024*", APP ka vendosur të përjashtojë OE "R.-A." nga e drejta për të fituar kontrata publike për 12 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, pra, në momentin e lidhjes së kontratës datë 07.08.2024, OE ka qenë i përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike.

Në nenin 4 të kontratës janë paraqitur artikujt që do të furnizohen, sasitë dhe vlerat përkatëse, *por jo kolona "Specifikimet teknike", sipas kërkesës së MSHMS dhe Shtojcës 5 "Specifikimet teknike"*.

Në nenin 5 të kontratës përcaktohet se "*Operatori Rajonal Tiranë dhe Qendrat shëndetësore kanë për detyrë të marrin në dorëzim mallrat objekt i kësaj kontrate*". Nëpërmjet Urdhrit nr. 91, datë 12.06.2024, Drejtori i Drejtorisë Rajonale të OSHKSH-së Tiranë ka **ngritur grupin e punës** për marrjen në dorëzim të mobiljeve dhe pajisjeve mjekësore për QSH/ ambulancat e rikonstruktuara të Rajonit Shkodër, të përbërë nga N. B., M. L., V. S., S. A., L. S.. Komisioni i ngritur pranë Drejtorisë Rajonale të OSHKSH-së Tiranë ka hartuar procesverbalin mbi dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të mallrave me nr. 1716/1 prot., datë 09.08.2024, duke bashkëlidhur Fletë-hyrjen nr. 1, datë 09.08.2024, për të gjithë artikujt që *duhej të furnizoheshin QSH/ Amb*., sipas kërkesave.

Nga auditimi nuk rezulton *që Shtojca 5 "Specifikimet teknike" të jetë vënë në dispozicion të DR OSHKSH Tiranë,* ***duke bërë objektivisht të pamundur kryerjen e veprimeve të nevojshme nga ana e anëtarëve të Komisionit të marrjes në dorëzim****, për të garantuar se mallrat e furnizuar janë në përputhje me specifikimet teknike.*

Në nenin 5 të kontratës gjithashtu specifikohet se "*MSHMS do të kryejë një* ***kontroll paraprak*** *në lidhje me furnizimin e orendive dhe pajisjeve të mobilimit të marra në dorëzim*". **Nga auditimi ka rezultuar se marrja në dorëzim është kryer vetëm nga komisioni i marrjes në dorëzim i ngritur në DR OSHKSH Tiranë, dhe *nuk ka patur kontroll paraprak nga ana e MSHMS*.**

Nëpërmjet shkresës nr. 2019/17 prot., datë 06.08.2024, Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS i drejtohet OE "R.-A." duke bërë me dije se QSH Thumanë do të mobilohet nga FSHZH dhe për këtë arsye të mos vijohet me mobilimin e kësaj QSH. **Ndërmjet AK dhe OE është nënshkruar Amendimi i kontratës nr. 3642 prot., datë 28.08.2024, për zbritjen e vlerës së mobilimit të**

QSH Thumanë në vlerën prej 806,681 lekë pa TVSh dhe 968,017 lekë me TVSh. Vlera e ndryshuar e kontratës parashikohet të jetë 6,293,465 lekë pa TVSh dhe 7,552,158 lekë me TVSh. Drejtori i Drejtorisë Rajonale të OSHKSH-së Tiranë ka hartuar Plan-shpërndarjen e mobiljeve dhe pajisjeve mjekësore nr. 1716/2 prot., datë 09.08.2024, duke bashkëlidhur tabelën ku janë përcaktuar artikujt sipas sasive përkatëse me destinacionet finale QSH/ Amb. Dorëzimi i artikujve në QSH/ Amb. përkatëse është dokumentuar nëpërmjet Fletë-daljeve nga magazina e DR OSHKSH Tiranë, si më poshtë:

Nr.	Fletë-dalja		Destinacioni	Vlera
	Nr.	Datë		
1	1	09.08.2024	QSH 8, Spitallë	1,159,040
2	2	12.08.2024	QSH Gose, Amb. Vilë – Bashtovë	335,468
3	3	12.08.2024	Luz i Vogël	120,215
4	4	12.08.2024	Amb. Vorrozen	81,822
5	5	13.08.2024	QSH Synej, Amb. Bago	280,716
6	6	13.08.2024	Amb. Shtodher	242,464
7	7	14.08.2024	QSH Nikël, Amb. Qerek	162,889
8	8	14.08.2024	QSH Nikël, Amb. Kurcaj	162,436
9	9	14.08.2024	QSH Bubq	686,046
10	10	14.08.2024	QSH Bubq, Amb. Budall	234,697
11	11	14.08.2024	QSH Bubq, Amb. Bilaj	305,687
12	12	20.08.2024	QSH Paskuqan	850,319
13	13	20.08.2024	Amb. Frutikulturë	367,255
14	14	28.08.2024	Amb. Farkë e Madhe	325,715
15	15	22.08.2024	QSH Bathore Lagjja 6	943,471
16	16	23.08.2024	Amb. Prush	280,398
17	17	26.08.2024	Amb. Adriatik	36,316
18	18	26.08.2024	QSH Ishëm, Amb. Gjuricaj e Sipërme	131,419
19	19	28.08.2024	QSH Rrushkull, Amb. Romanat	477,211
20	20	29.08.2024	Amb. Arapaj	104,358
21	21	27.12.2024	QSH nr. 8, pika 2	263,718

Nga ana e përfaqësuesve të DR OSHKSH Tiranë N. B., L. S. dhe nga përfaqësuesi i OE është nënshkruar procesverbali nr. 1716/3 prot., datë 29.08.2024, ku është dokumentuar realizimi i shpërndarjes së artikujve nëpër QSH/ Amb., duke cituar se shpërndarja e mobiljeve dhe pajisjeve mjekësore për pikën 1 të QSH 8 do të kryhet pas përfundimit të rikonstruksionit.
Faturat tatimore të shitjes nr.49/2024, dt 09.08.2024 ne vlerë 1.741.109 lekë (me tvsh); nr.50/2024, dt 13.08.2024 ne vlerë 167,715 lekë (me tvsh);nr.51/2024, dt 13.08.2024 ne vlerë 692,969 lekë (me tvsh); nr.52/2024, dt 14.08.2024 ne vlerë 2,337,906 lekë (me tvsh); nr.58/2024, dt 26.08.2024 ne vlerë 1,551,754 lekë (me tvsh); nr.59/2024, dt 28.08.2024 ne vlerë 1,060,683 lekë (me tvsh) **ne total 7,552,158 lekë (**me tvsh**), janë likuiduar ne tejkalim ta afatit ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në pikën 184 Udhëzimit MFE nr. 09, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".**

- **Me USH nr. 741/2024, datë 18.12.2024**, janë kryer pagesat per "Blerje Orendi dhe pajisje mobilimi për QSH-re/ Ambulanca të rikonstruktuara, Rajoni Shkodër" për Operatorin Ekonomik R.-A. me Nipt J.....M për faturën/at tatimore të shitjes: nr.74/2024, dt 29.10.2024 ne vlerë 7,191,191 lekë (me tvsh); bashkëngjitur Urdhëri prokurimi nr. 75, datë 31.08.2023; Mini Kontratë nr. 2019/23, datë 08.10.2024; proces verbal marrje në dorëzim nr.1303/1 prot, datë 29.10.204 i mbajtur nga grupi i marrjes ne dorëzim (5 pjesëtarë) punonjës të QSHKSH- **Drejtoria Rajonale Shkodër**; Flete –Hyrje nr. 10, date 29.10.2024 QSHKSH- Drejtoria Rajonale Shkodër per 14 artikuj ne vlerë 7,191,191 lekë;

Nga auditimi rezultoi se:
Nëpërmjet shkresës administruar në MSHMS me nr. 2019/10 prot., datë 15.07.2024, Drejtori i Drejtorisë Rajonale të OSHKSH-së Shkodër ka dërguar listën përfundimtare me kërkesat për

mobilim të qendrave shëndetësore të rikonstruktuara. Nëpërmjet shkresës nr. 2019/20 prot., datë 25.09.2024, Drejtori i Përgjithshëm Ekonomik dhe i Shërbimeve Mbështetëse A. K. ka kërkuar lidhjen e minikontratës për Rajonin e Shkodrës, bazuar në nevojat e paraqitura prej tyre. Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS L. S. ka dërguar ftesën për ofertë nr. 2019/21 prot., datë 26.09.2024, drejtuar përfaqësuesit të OE "R.-A.". OE ka përcjellë ofertën ekonomike, administruar në MSHMS me nr. 2019/22 prot., datë 02.10.2024, në vlerën totale prej 5,992,659 lekë pa TVSH dhe 7,191,191lekë me TVSH.

Grupi i punës[13], i përbërë nga N. K., R. M., E. K., ka paraqitur ndryshimet e sasive bazuar në kërkesat e operatorit rajonal Shkodër, duke cituar, se "*Objektet shëndetësore të dërguara për prokurim janë 17 QSH/* ambulanca*, kurse Operatori Rajonal Shkodër ka dërguar kërkesa për 15 QSH/ ambulanca (pasi Amb. Lagjia M. Alimani dhe QSH Rubik janë të mobiluara)*".

Ndërmjet AK dhe OE është lidhur kontrata e furnizimit nr. 2019/23 prot., datë 08.10.2024, në vlerën prej 5,992,659 lekë pa TVSH dhe **7,191,190 lekë me TVSH**, me afat 25 ditë nga lidhja e kontratës, *duke specifikuar se vendi i dorëzimit të objektit të kontratës është në qendrat shëndetësore të rikonstruktuara*. Në nenin 4 të kontratës janë paraqitur artikujt që do të furnizohen, sasitë dhe vlerat përkatëse, *por jo kolona "Specifikimet teknike", sipas kërkesës së MSHMS dhe Shtojcës 5 "Specifikimet teknike"*.

Në nenin 5 të kontratës përcaktohet se "*Operatori Rajonal Tiranë dhe Qendrat shëndetësore kanë për detyrë të marrin në dorëzim mallrat objekt i kësaj kontrate*". Nëpërmjet Urdhrit nr. 222, datë 10.10.2024, Drejtori i Drejtorisë Rajonale të OSHKSH-së Shkodër ka ngritur grupin e punës për marrjen në dorëzim të mobiljeve dhe pajisjeve mjekësore për QSH/ ambulancat e rikonstruktuara të Rajonit Shkodër, të përbërë nga E. T., F. Z., A. V., E.R., G.Sh.. Komisioni i ngritur pranë Drejtorisë Rajonale të OSHKSH-së Shkodër ka hartuar procesverbalin mbi dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të mallrave me nr. 1303/1 prot., datë 29.10.2024, duke bashkëlidhur Fletë-hyrjen nr. 10, datë 29.10.2024, për të gjithë artikujt që *duhej të furnizoheshin QSH/ Amb.*, sipas kërkesave.

Nga auditimi nuk rezulton që Shtojca 5 "Specifikimet teknike" të jetë vënë në dispozicion të DR OSHKSH Shkodër, duke bërë objektivisht të pamundur kryerjen e veprimeve të nevojshme nga ana e anëtarëve të Komisionit të marrjes në dorëzim, për të garantuar se mallrat e furnizuar janë në përputhje me specifikimet teknike.

Në nenin 5 të kontratës specifikohet se "*Afati i lëvrimit: Brenda 25 ditëve nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të AK, në bazë të MK. **Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës është në QSH të rikonstruktuara**. Blerësi është i detyruar të krijojë kushtet për marrjen në dorëzim të mallit me mbërritjen e tij në destinacionet e përcaktuara më sipër*".

PV i hartuar nga komisioni i marrjes në dorëzim pranë DR OSHKSH Shkodër mban datën 29.10.2024, brenda afatit të lëvrimit 25-ditësh të përcaktuar në kontratë, por është objektivisht e pamundur që këto artikuj të jenë magazinuar për 2-4 javë (referuar fletë-daljeve të listuara më poshtë) në ambientet e DR OSHKSH Shkodër, kur bëhet fjalë për 13 recepsione (me përmasa 140*70*75), 56 rafte (me përmasa 40*80*84), 49 dollap mjeku, 81 rafte për dokumentacion, 32 karrige pune për mjekun, 186 karrige për pacientin, 74 tavolina pune për mjekun, 62 shtrate vizitash, 60 shkallë ndihmëse për shtratin e vizitës, 48 stativa serumi, 41 karrige për pritje holli, për më tepër, destinacioni i përcaktuar në kontratë nuk është DR OSHKSH Shkodër, por QSH të rikonstruktuara.

Në nenin 5 të kontratës gjithashtu specifikohet se "*MSHMS **do të kryejë një kontroll paraprak** në*

[13] I ngritur me Urdhrin nr. 08, datë 09.01.2024 me objekt "*Për krijimin e komisionit të vlerësimit për dhënien e kontratave në bazë të marrëveshjeve kuadër për procedurat e prokurimit publik të zhvilluara nga ASHPP dhe AKSHI, në cilësinë e Organit Qendror Blerës*", i ndryshuar.

lidhje me furnizimin e orendive dhe pajisjeve të mobilimit të marra në dorëzim". Nga auditimi ka rezultuar se marrja në dorëzim është kryer vetëm nga komisioni i marrjes në dorëzim i ngritur në DR OSHKSH Shkodër, **dhe *nuk ka patur asnjë kontroll paraprak nga ana e MSHMS***.
Dorëzimi i artikujve në QSH/ Amb. përkatëse është dokumentuar nëpërmjet Fletë-daljeve nga magazina e DR OSHKSH Shkodër, si më poshtë:

Nr.	Fletë-dalja		Destinacioni	Vlera
	Nr.	Datë		
1	133	14.11.2024	QSH Golaj, Amb. Vllahen, Has	197,002
2	135	15.11.2024	QSH F/ Tropojë, Amb. Aste	813,751
3	136	18.11.2024	QSH F/ Ana e Malit	283,350
4	137	19.11.2024	QSH Dajç, Shkodër	194,321
5	138	19.11.2024	QSH Reç	1,678,062
6	139	19.11.2024	QSH Shkrel, Shkodër	616,812
7	140	20.11.2024	QSH Kallmet, Lezhë	227,213
8	142	21.11.2024	QSH Velipojë, Shkodër	584,083
9	143	21.11.2024	QSH Pukë, Gjegjan	581,314
10	144	21.11.2024	QSH Bicaj, Kukës	470,735
11	146	25.11.2024	QSH Lekbibaj, Tropojë	295,818
12	147	25.11.2024	QSH Fushë-Kuqe, Laç	254,278
13	148	25.11.2024	QSH Kolsh, Amb. Manati, Lezhë	219,661
14	149	25.11.2024	QSH Orosh, Amb. Reps	774,791

Nga auditimi rezultoi se:
Dorëzimi i pajisjeve *në vendin e përcaktuar të dorëzimit* është **kryer nga 37 ditë në 48 ditë nga nënshkrimi i kontratës, pra nga 12 ditë deri në 23 ditë në tejkalim të afatit të përcaktuar prej 25 ditësh**. Për sa kohë nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk rezulton që blerësi (në këtë rast MSHMS) të mos ketë krijuar kushtet për marrjen në dorëzim të mallit me mbërritjen e tij në destinacion, sipas përcaktimeve në kontratë, nga ana e MSHMS duhej të ishin përllogaritur kamatëvonesat, sipas përcaktimit në nenin 13 të kontratës.

Faturat tatimore të shitjes nr.74/2024, dt 29.10.2024 ne vlerë 7,191,191 lekë (me tvsh); janë likuiduar ne tejkalim ta afatit ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në pikën 184 Udhëzimit MFE nr. 09, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"
Ne dokumentacionin bashkëlidhur **mungon** relacion **mbi kryerjen e kontrollit paraprak** që duhet te kryejnë përfaqësuesit e MSHMS lidhur me furnizimin me orendi dhe pajisjet mjekësore mobilimi të marra ne dorëzim, ne kundërshtim me nenin 5 të **Kontrate Furnizimi (Marrëveshje Kuadër) nr. 2019/23, datë 08.10.2024**;sipas të cilës citojmë : "*MSHMS do te kryeje një kontroll paraprak në lidhje me furnizimin e orendive dhe orendive dhe pajisje mobilimi të marra në dorëzim*".

- **Me USH nr. 742/2024, datë 18.12.2024**, janë kryer pagesat per "Blerje Orendi dhe pajisje mobilimi për QSH-re/ Ambulanca të rikonstruktuara, **Rajoni Elbasan**" për Operatorin Ekonomik R.-A. me Nipt J.....M për faturën/at tatimore të shitjes: nr.62/2024, dt 16.09.2024 ne vlerë 1,582,708 lekë (me tvsh);nr.63/2024, dt 20.09.2024 ne vlerë 1,254,897 lekë (me tvsh); nr.65/2024, dt 21.09.2024 ne vlerë 1,582,708 lekë (**Me USH nr. 742/2024, datë 18.12.2024**me tvsh); nr.68/2024, dt 24.09.2024 ne vlerë 2,125,806 lekë (me tvsh);në total 6,609,606 lekë (me tvsh).

Nga auditimi rezultoi se:
Nëpërmjet memo-s së datës 01.08.2024, Komisioni për zbatimin e kontratës ka përgatitur informacionin lidhur me procedurën e prokurimit për rajonin Elbasan, duke pasqyruar kërkesat e ardhura nga DROSHKSH Elbasan për mobilimin e QSH-ve/ Ambulancave. Në dosje administrohet korrespondenca elektronike me përfaqësues të DROSHKSH Elbasan lidhur me konfirmimin e sasive. Nëpërmjet shkresës nr. 2019/24 prot., datë 08.11.2024, Drejtori i Përgjithshëm Ekonomik dhe i Shërbimeve Mbështetëse M. Sh. ka dërguar kërkesën për lidhje minikontratë drejtuar Komisionit. Nëpërmjet shkresës administruar në MSHMS me nr. 4643 prot.,

datë 11.11.2024, Drejtori i Drejtorisë Rajonale të OSHKSH-së Vlorë ka dërguar kërkesat nga NJVKSH-të në varësi, lidhur me nevojat për mobilim të qendrave shëndetësore. Titullari i AK S. H. ka dërguar ftesën për ofertë nr. 2019/14 prot., datë 22.08.2024, drejtuar përfaqësuesit të OE "R.-A.". OE ka përcjellë ofertën ekonomike, administruar në MSHMS me nr. 2019/15 prot., datë 26.08.2024, në vlerën totale prej 5,508,005 lekë pa TVSH **dhe 6,609,606 lekë me TVSH.**
Ndërmjet AK dhe OE është lidhur kontrata e furnizimit nr. 2019/18 prot., datë 02.09.2024, në vlerën prej 5,508,005 lekë pa TVSH dhe 6,609,606 lekë me TVSH, me afat 25 ditë nga lidhja e kontratës, *duke specifikuar se vendi i dorëzimit të objektit të kontratës është në qendrat shëndetësore të rikonstruktuara*. Në nenin 4 të kontratës janë paraqitur artikujt që do të furnizohen, sasitë dhe vlerat përkatëse, *por jo kolona "Specifikimet teknike", sipas kërkesës së MSHMS dhe Shtojcës 5 "Specifikimet teknike"*.
Në nenin 5 të kontratës përcaktohet se "*Operatori Rajonal Vlorë dhe Qendrat shëndetësore kanë për detyrë të marrin në dorëzim mallrat objekt i kësaj kontrate*". Nëpërmjet Urdhrit nr. 149, datë 22.08.2024, Drejtori i DROSHKSH Elbasan ka ngritur grupin e punës për marrjen në dorëzim të mobiljeve dhe pajisjeve, të përbërë nga A. L., J. D., L. Z., D. F., M. K.. Komisioni ka hartuar PV nr. 1396 prot., datë 16.09.2024 për marrjen në dorëzim të pajisjeve, duke bashkëlidhur Fletë-hyrjen nr. 1, datë 16.09.2024, për të gjithë artikujt që duhej të furnizoheshin në QSH/ Amb., sipas kërkesave.
Nga auditimi nuk rezulton që Shtojca 5 "Specifikimet teknike" të jetë vënë në dispozicion të DR OSHKSH Elbasan, duke bërë objektivisht të pamundur kryerjen e veprimeve të nevojshme nga ana e anëtarëve të Komisionit të marrjes në dorëzim, për të garantuar se mallrat e furnizuar janë në përputhje me specifikimet teknike.
Dorëzimi i artikujve në QSH/ Amb. përkatëse është dokumentuar nëpërmjet Fletë-daljeve nga magazina e DR OSHKSH Elbasan, si më poshtë:

Nr.	Fletë-dalja		Destinacioni	Vlera
	Nr.	Datë		
1	1	16.09.2024	QSH Roshnik, Berat	376,381
2	2	16.09.2024	Amb. Lagjia Llukan Prifti,Kuçovë	713,110
3	3	16.09.2024	Amb. Xibrakë, Elbasan	349,084
4	4	16.09.2024	Amb. Dyli Haxhire, Elbasan QSH. Nr. 2	144,133
5	5	17.09.2024	Amb. Rashtan, Librazhd	121,474
6	6	19.09.2024	QSH. Perparim , Peqin	568,978
7	7	20.09.2024	QSH. Kukur, Gramsh	310,168
8	8	20.09.2024	Amb. Mashan, Gramsh	254,278
9	9	23.09.2024	Amb. Kamenice, Korçe	215,507
10	10	23.09.2024	QSH. Maliq, Korçe	1,584,829
11	11	24.09.2024	Amb. Pilur, Devoll	335,470
12	12	25.09.2024	QSH. Proptisht, Pogradec	865,702
13	13	25.09.2024	QSH. Udenisht, Pogradec	392,223
14	14	27.09.2024	QSH. Bramash, Kolonje	199,520
15	15	27.09.2024	Amb. Qinam, Kolonje	178,750

Në konkluzion:

- Nga ana e MSHMS **nuk është kryer kontroll *paraprak*** në lidhje me furnizimin e orendive dhe pajisjeve të mobilimit të marra në dorëzim në QSH/ Amb. të përfshira në asnjë prej rajoneve, në mospërputhje me nenin 5 të kontratës.
- MSHMS **nuk ka dërguar Shtojcën 5 "Specifikimet teknike"** drejt Drejtorive Rajonale të OSHKSH-së, duke pamundësuar objektivisht kryerjen e veprimeve të nevojshme nga ana e anëtarëve të Komisionit të marrjes në dorëzim, të ngritur pranë DR OSHKSH Elbasan, për të garantuar se mallrat e furnizuar janë në përputhje me specifikimet teknike, në mospërputhje me nenin 124, pika 1 të LPP-së, si dhe me kreun III, pika 4, gërma b, të Rekomandimit të APP-

së nr. 5529/4 prot., datë 18.07.2023, ku citohet se Komisioni i marrjes në dorëzim bën verifikimin e sasisë, llojit, plotësisë, *përputhshmërisë së aktiveve të furnizuara me kërkesat e AK, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, në ofertën fituese dhe në kontratë.*

- Artikujt janë furnizuar në Drejtorinë Rajonale të OSHKSH Elbasan brenda afatit të lëvrimit 25-ditësh (sipas PV dhe fletë hyrjes në magazinë), por jo në qendrat shëndetësore, si destinacioni i përcaktuar në kontratë. Pavaresisht respektimit të afatit kontraktor të lëvrimit 25 ditë, shpërndarja e paisjeve dhe orendive në vendin e përdorimit të tyre, QSH/Amulancë, rezultoi nga 37 ditë deri në 48 ditë nga data e nënshkrimtitëi kontratës, në mospërputhje me nenin 5 të kontratës.

-Me USH nr. 755/2024, datë 18.12.2024, janë kryer pagesat per "Blerje Kompjuter" për operatorin ekonomik I. S. shpk me NIPT L.....Q, për faturën/at tatimore të shitjes: nr.1162/2024, dt 04.09.2024 ne shumën ne total **3,482,400 lekë.**

Bashkëngjitur USH nr. 755/2024 gjenden: Urdhëri prokurimi nr. 2104/1, datë 03.07.2024; Njoftim fituesi nr. 3242, dt 05.07.2024; **Mini Kontrate Furnizimi nr. 3165/4, datë 19.08.2024**; proces verbal marrje në dorëzim nr._ prot, datë 18.09.2024 i mbajtur nga grupi i marrjes ne dorëzim (3 pjesëtarë) ngritur me Urdhër nr. 490, dt 04.08.2023 "Për marrjen në dorëzim të pajisjeve TIK për (Loti 1; Loti 2, Loti 4, Loti 5, Loti 6)"; akt –dorëzimi fizikisht datë 04.09.2024, fature tatimore nr. 1162/2024, dt 04.09.2024, flete hyrje nr. 21 date 18.09.2024.

Fatura tatimore nr. 1162/2024, dt 04.09.2024 është likuiduar në tejkalim ta afatit ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në pikën 184 Udhëzimit MFE nr. 09, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

Bashkëngjitur Urdhëri prokurimi nr. 75, datë 31.08.2023; Kontrate Furnizimi (Marrëveshje Kuadër) nr. 2019/18, datë 02.09.2024; proces verbal marrje në dorëzim nr.1396 prot, datë 16.09.2024 i mbajtur nga grupi i marrjes ne dorëzim (5 pjesëtarë) punonjës të QSHKSH- Drejtoria Rajonale Elbasan; Flete –Hyrje nr. 1, date 16.09.2024. QSHKSH- Drejtoria Rajonale Elbasan per 13 artikuj ne vlerë 6,609,606 lekë;

Fatura/at tatimore të shitjes janë likuiduar ne tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në pikën 184 Udhëzimit MFE nr. 09, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

- **Me USH nr. 763/2024, datë 18.12.2024**, është likuiduar pjesa e mbetur pa paguar 1,011,032 lekë për Operatorin Ekonomik I. shpk me NIPT J.....Ë, duke zbritur garancinë 53,212 lekë, të faturës tatimore të shitjes nr.38/2024, dt 15.07.2024 ne vlerë **13,659,462 lekë**, paguar pjesërisht me USH 426, dt 05.06.2024 ne shumen 11,965,458 lekë duke mbajtur garancinë 629,761 lekë, per punimet e kryera për "Rikonstruksion QSH", Procedura është kaluar per likuidim me fature shoqërohet me Urdhër prokurim nr. 197, dt 11.04.2023, Kontratë nr. 1592/22, dt 11.07.2023, njoftim fituesi nr. 1592/18, dt 26.06.2023

Fature tatimore nr. 38, dt 15.07.2024, është likuiduar ne tejkalim ta afatit ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në pikën 184 Udhëzimit MFE nr. 09, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

- **Me USH nr. 764/2024, datë 18.12.2024**, është likuiduar pjesa e mbetur 529,055 lekë duke mbajtur pjesën e garancisë 27,845 lekë, për Operatorin E. R. shpk me NIPT K.....V për faturën tatimore të shitjes nr.264/2024, dt 12.07.2024 ne vlerë 36,259,788 lekë, paguar pjesërisht me USH 387, dt 13.08.2024 ne shumen 33,917,744 lekë duke zbritur garancinë 1,785,144 lekë, për punimet e kryera për "Rikonstruksion QSH". me Urdhër prokurim nr. 197, dt 11.04.2023 shoqërohet me fature tatimore nr. 265/2024, dt 12.07.2024, situacioni punimesh nr.2, dt.04.07.2027, Kontratë nr.

1592/21, dt 11.07.2023, njoftim fituesi nr. 1592/16, dt 26.06.2023.
Fature tatimore nr. 264, dt 12.07.2024 është likuiduar në tejkalim ta afatit ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në pikën 184 Udhëzimit MFE nr. 09, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

- **Me USH nr. 846/2024, datë 23.01.2025**, janë kryer pagesat per "Blerje Orendi dhe pajisje mobilimi për QSH-re/ Ambulanca të rikonstruktua, **Rajoni Vlore**" për Operatorin Ekonomik R.-A. me NIPT J.....M për faturën/at tatimore të shitjes: nr.97/2024, dt 16.12.2024 ne vlerë 6,605,225 lekë (me tvsh); bashkëngjitur Urdhëri prokurimi nr. 75, datë 31.08.2023; Marrëveshje Kuadër nr. 75/11, dt 24.04.2024; njoftim fituesi nr. 78/12, dt 24.04.2024, **Mini Kontratë nr.2019/28, datë 21.11.2024**; Flete –Hyrje nr. 13, date 25.11.2024 QSHKSH- Drejtoria Rajonale Shkodër per 14 artikuj ne vlerë 7,191,191 lekë; proces verbal marrje në dorëzim nr.2553/2 prot, datë 25.11.2024 i mbajtur nga Komisioni i Marrjes ne dorëzim (5 pjesëtarë) punonjës të QSHKSH- Drejtoria Rajonale Vlorë. Ne përmbajtjen e proces verbalit Komisioni ka konstatuar se malli i marrë në dorëzim është konform Fletë –Daljes nr. 18, datë 25.11.2024, dhe si i tillë bëhet hyrje në magazinën e QSHKSH- Drejtoria Rajonale Vlorë, i gatshëm për shpërndarje pranë QSH/Ambulancave të ri konstruktuara për vitin 2023-2024.

Nga auditimi rezulton se:
Nëpërmjet shkresës nr. 2019/24 prot., datë 08.11.2024, Drejtori i Përgjithshëm Ekonomik dhe i Shërbimeve Mbështetëse A. K. ka dërguar kërkesën për lidhje minikontrate drejtuar Komisionit të dhënies së kontratave. Nëpërmjet shkresës administruar në MSHMS me nr. 4643 prot., datë 11.11.2024, Drejtori i Drejtorisë Rajonale të OSHKSH-së Vlorë ka dërguar kërkesat nga NJVKSH-të në varësi, lidhur me nevojat për mobilim të qendrave shëndetësore. Titullari i AK L. S. ka dërguar ftesën për ofertë nr. 2019/25 prot., datë 13.11.2024, drejtuar përfaqësuesit të OE "R.-A.". OE ka përcjellë ofertën ekonomike, administruar në MSHMS me nr. 2019/27 prot., datë 20.11.2024, në vlerën totale prej 5,504,354lekë pa TVSH dhe 6,605,225 lekë me TVSH.
Ndërmjet AK dhe OE **është lidhur kontrata e furnizimit nr. 2019/28 prot**., datë 21.11.2024, në vlerën prej 5,504,354 lekë pa TVSH dhe 6,605,225 lekë me TVSH, me afat 25 ditë nga lidhja e kontratës, *duke specifikuar se vendi i dorëzimit të objektit të kontratës është në qendrat shëndetësore të rikonstruktuara*. Në nenin 4 të kontratës janë paraqitur artikujt që do të furnizohen, sasitë dhe vlerat përkatëse, *por jo kolona "Specifikimet teknike", sipas kërkesës së MSHMS dhe Shtojcës 5 "Specifikimet teknike"*.
Në nenin 5 të kontratës përcaktohet se "*Operatori Rajonal Vlorë dhe Qendrat shëndetësore kanë për detyrë të marrin në dorëzim mallrat objekt i kësaj kontrate*". Nëpërmjet Urdhrit nr. 204, datë 12.11.2024, Drejtori i DROSHKSH Vlorë ka ngritur grupin e punës për marrjen në dorëzim të mobiljeve dhe pajisjeve, të përbërë nga A. K., A. K., B. Sh., B. B., J. H.. Komisioni ka hartuar PV nr. 2553/2 prot., datë 25.11.2024 për marrjen në dorëzim të pajisjeve, duke bashkëlidhur Fletë-hyrjen nr. 13, datë 25.11.2024, për të gjithë artikujt që duhej të furnizoheshin në QSH/ Amb., sipas kërkesave.
Nga auditimi nuk rezulton që Shtojca 5 "Specifikimet teknike" të jetë vënë në dispozicion të DR OSHKSH Vlorë, duke bërë objektivisht të pamundur kryerjen e veprimeve të nevojshme nga ana e anëtarëve të Komisionit të marrjes në dorëzim, për të garantuar se mallrat e furnizuar janë në përputhje me specifikimet teknike.
Dorëzimi i artikujve në QSH/ Amb. përkatëse është dokumentuar nëpërmjet Fletë-daljeve nga magazina e DR OSHKSH Vlorë, si më poshtë:

Nr.	Fletë-dalja		Destinacioni	Vlera
	Nr.	Datë		
1	271	25.11.2024	QSH Orikum	1,102,054
2	272	27.11.2024	Amb. 28 Nëntori/ QSH nr. 2	2,545,923

3	274	02.12.2024	QSH Armeni	589,244
4	275	02.12.2024	Amb. Hoshtim/ QSH Nartë	405,409
5	278	05.12.2024	QSH Novosel/ Amb. Bishan	383,934
6	279	05.12.2024	QSH Xarrë	602,965
7	280	05.12.2024	Amb. Vrinë/ QSH Xarrë	18,882
8	283	10.12.2024	Amb. Cërvil/ QSH Fshat Memaliaj	270,327
9	284	10.12.2024	Amb. Vasjan/ QSH Fshat Memaliaj	270,327
10	289	12.12.2024	Amb. Kutal/ QSH Piskovë Frashër	248,739
11	290	12.12.2024	Amb. Pacomit/ QSH Piskovë Frashër	167,420

Ne nenin 5 të **Mini Kontratë nr. 2019/28, datë 21.11.2024** përcaktohet se : : ...**"***Kontraktuesi do të furnizojë orendi dhe pajisje mobilimi konform sasive të përcaktuara në ofertë, dukë ja dorëzuar ato QSH–re përkatëse.* ***Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform Standardeve Teknike të Parashikuara në specifikimet teknike****. Operatori Rajonal Tiranë dhe QSH-re kanë për detyrë të marrin në dorëzim mallrat.* ***MSHMS do të kryejë një kontroll paraprak në lidhje me furnizim e orendive dhe e pajisjeve të mobilimi****t*."

Proces verbal marrje i marrjes në dorëzim nr.2553/2 prot, datë 25.11.2024 i mbajtur nga Komisioni i Marrjes ne dorëzim (5 pjesëtarë) punonjës të QSHKSH- Drejtoria Rajonale Vlorë, ngritur me Urdhër nr. 204, dt 12.11.2024 të QSHKSH- Drejtoria Rajonale Vlorë., për Mallrat e pranuara nuk është shprehur mbi verifikimin e plotësimit Standardeve Teknike të Parashikuara në specifikimet teknike, në kundërshtim me nenin 5 të **Mini Kontratë** nr. 2019/28, datë 21.11.2024.

Nga MSHMS nuk është kryer një kontroll paraprak në lidhje me furnizim e orendive dhe e pajisjeve të mobilimit, para marrjes në dorëzim nga Komisioni i Marrjes ne dorëzim (5 pjesëtarë) punonjës të QSHKSH- Drejtoria Rajonale Vlorë, ngritur me Urdhër nr. 204, dt 12.11.2024 të QSHKSH- Drejtoria Rajonale Vlorë, në kundërshtim me nenin 5 të Mini Kontratë nr. 2019/28, datë 21.11.2024

Konkluzion:

Nga auditimi i kryer rezultoi se, në **nenin 5 të Mini-Kontratave të lidhura me operatorin ekonomik R.-A.**: Mini Kontrata e Furnizimit nr. 3165/4, datë 19.08.2024; Mini Kontrata e Furnizimit nr. 2019/11 prot., datë 07.08.2024; Mini Kontrata nr. 2019/23, datë 08.10.2024; Mini Kontrata nr. 2019/28, datë 21.11.2024 është përcaktuar se: "*Kontraktuesi do të furnizojë orendi dhe pajisje mobilimi në përputhje me sasitë e përcaktuara në ofertë, duke i dorëzuar ato pranë QSH-ve përkatëse.* ***Mallrat e furnizuara duhet të jenë në përputhje me standardet teknike të përcaktuara në specifikimet teknike****. Operatori Rajonal dhe QSH-të përkatëse kanë për detyrë të marrin në dorëzim mallrat,* ***ndërsa MSHMS do të kryejë një kontroll paraprak*** *lidhur me pajtueshmërinë e orendive dhe pajisjeve të mobilimit.* "

Nga verifikimi i dokumentacionit për marrjen në dorëzim të mallrave rezulton se:

- **MSHMS nuk ka kryer kontrollin paraprak** për verifikimin e orendive dhe pajisjeve të mobilimit përpara marrjes së tyre në dorëzim nga komisionet përkatëse, gjë që bie ndesh me detyrimin e përcaktuar po në nenin 5 të mini-kontratave përkatëse.
- **Procesverbalet e marrjes në dorëzim**, të mbajtura nga komisionet përkatëse pranë QSH-ve dhe Drejtorive Rajonale, **nuk përmbajnë vlerësim mbi përputhshmërinë e mallrave me standardet teknike** të përcaktuara në kontratë, në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara në nenin 5 të mini kontratave të mësipërme.

Nga auditimi i faturave të likuiduara nga ana e MSHMS, me datën e faturës tatimore, nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua se për vitin 2023 dhe 2024, janë kryer likuidime në tejkalim të afatit ligjor 30 ditor. Konkretisht, nga kryerja e testimeve mbi urdhër shpenzimet, u konstatua se janë kryer likuidime në tejkalim të afatit ligjor 30 ditor 56 transaksione në vlerë 38,960,913 lekë (aneksi bashkëlidhur) për vitin 2023, 54 transaksione në vlerë 83,626,788 lekë (aneksi

bashkëlidhur) për vitin 2024..Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin për **"**Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH", i ndryshuar, neni 52 ku citohet... : **"***specifikohet se Nëpunësi zbatues i njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, Brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së,* si dhe Ligjin nr.48/2014 **"***Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*" neni 7.

MONITORIMI DHE RAPORTIMI I DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA.

Ky auditim është ndërmarrë në kuadër të vlerësimit të përputhshmërisë së veprimeve të Ministrisë me kuadrin ligjor dhe rregullator që rregullon menaxhimin e financave publike dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Objekt i këtij drejtimi janë detyrimet e papaguara ndaj palëve të treta, të cilat përfshijnë furnitorët, detyrimet tatimore, kontributet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe çdo detyrim tjetër financiar i mbartur nga vitet e mëparshme, duke synuar analizimin shkaqeve që kanë çuar në akumulimin e detyrimeve të prapambetura, të vlerësojë ndikimin e tyre në pasqyrat financiare dhe stabilitetin buxhetor të Ministrisë.

Ky proces realizohet në përputhje me dispozitat e:

- Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë",
- Ligjit nr. 48/2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare",
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 19.12.2019, "Për miratimin e strategjisë sektoriale për menaxhimin e financave publike 2019–2022",
- Si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Në këtë kuadër, auditimi do të përfshijë shqyrtimin e dokumentacionit financiar, regjistrave kontabël dhe Kontratave dhe Mini Kontratave, si dhe intervistimin e strukturave përgjegjëse për financat dhe prokurimet, me qëllim sigurimin e një vlerësimi të plotë dhe objektiv mbi nivelin e pajtueshmërisë dhe efektivitetin e masave të ndërmarra për menaxhimin e detyrimeve të prapambetura.

Situata e Detyrimeve të Prapambetura

Analiza e të dhënave të pasqyruara në **Pasqyrat Financiare të vitit 2024** tregon mangësi në evidentimin dhe trajtimin e detyrimeve të prapambetura nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

1**. Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm".** Sipas të dhënave të përfshira në pasqyrat financiare të vitit 2024, llogaria 468 rezulton me një vlerë prej 26,256,378 lekë, e cila përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj subjekteve kontraktore që kanë kryer punime në funksion të MSHMS.Kjo vlerë përbën një angazhim financiar të mbartur nga vitet e mëparshme, i cili është trajtuar edhe nga auditimet e mëparshme të KLSH-së. Megjithatë, në dokumentacionin shoqërues të pasqyrave financiare 2024 nuk është reflektuar asnjë informacion lidhur me masat konkrete të ndërmarra për arkëtimin apo zgjidhjen e këtij detyrimi, duke treguar një mungesë transparence dhe ndjekjeje efektive të çështjes.

Mospasqyrimi i Detyrimeve të Njohura nga Marrëveshje dhe Projekte Bashkëpunimi

Nga shqyrtimi i dokumentacionit financiar dhe regjistrimeve kontabël rezulton se detyrimet që burojnë nga marrëveshje dhe projekte bashkëpunimi ndërkombëtar nuk janë pasqyruar si detyrime për t'u paguar në pasqyrat financiare të vitit 2024. Ato evidentohen dhe regjistrohen vetëm në

momentin e ekzekutimit të pagesës, duke mos u raportuar paraprakisht si angazhime të njohura financiarisht.
Kjo praktikë bie ndesh me parimet e kontabilitetit të angazhimeve, siç përcaktohet në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, i cili kërkon që çdo detyrim i njohur, i bazuar në një marrëveshje, kontratë ose dokument tjetër zyrtar, të **pasqyrohet në regjistrat kontabël që në momentin e lindjes së tij**, pavarësisht nëse është kryer apo jo pagesa.

Konkretisht, MSHMS ka detyrime të papaguara që rrjedhin nga marrëveshjet e mëposhtme:
1. Marrëveshja e Bashkëpunimit nr. 5241, datë 25.11.2013 me donatorin "**Gj. K.**" e Emirateve të Bashkuara Arabe;
2. Projekti "Shëndeti për të gjithë" (HAP), financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), zbatuar nga **Qendra H.**, me NIPT L.....E, dhe
3. Qendra "**S. Ch.**", me NIPT J.....D.

1. Marrëveshja e Bashkëpunimit nr.5241, dt 25.11.2013 me Donatorin "Gj. K." e EBA;
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka kryer likuidimin e rimbursimit të TVSH-së për ndërtimet e reja dhe pajisjen e tyre me pajisje mjekësore, në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 5241, datë 25.11.2013, të lidhur ndërmjet Donatorit "Gj K" e Emirateve të Bashkuara Arabe (në vijim: Donatori) dhe Ministrisë.
Marrëveshja përcakton se Përfituesi i Donacionit (Ministria) do të kryejë rimbursimin e TVSH-së për fondet monetare të dhëna nga Donatori, të destinuara për ndërtimin e qendrave shëndetësore/ambulancave si dhe për furnizimin e tyre me pajisje dhe aparatura të nevojshme për funksionimin e tyre normal, në përputhje me detyrimet dhe të drejtat e përcaktuara në marrëveshje.
Në zbatim të kësaj marrëveshjeje dhe në bazë të dokumentacionit dhe faturave tatimore të paraqitura nga Donatori për rimbursim të TVSH-së, **Ministria ka realizuar likuidimet përkatëse si më poshtë:**
Për vitin 2024.
Me Urdhër Shpenzimi **nr. 765/2024, datë 19.12.2024**, janë kryer pagesat për rimbursimin e TVSH-së lidhur me ndërtimin e qendrave shëndetësore/ambulancave dhe furnizimin e tyre me pajisje mjekësore.
Ministria ka likuiduar:
- **Dy fatura** për punimet e ndërtimit të realizuara nga sipërmarrësi **I. shpk**, me rimbursim të TVSH-së në shumën **507,479 lekë**, dhe
- **Pesë fatura** për furnizimin me pajisje mjekësore të kryer nga **E. shpk**, me rimbursim të TVSH-së në shumën **520,000 lekë**.

Në total, është rimbursuar **TVSH në vlerën 1,027,480 lekë**, sipas faturave tatimore të paraqitura si më poshtë vijon:

Paguar TVSH per Donator "Gj. K."

Faturë tatimore		TVSH			Ambulanca Tip A2	Dokumentet e dorezuar ne MSHMS nga Donatori
Nr.	Date	Situacioni Punimesh	Pajisje Mjekësore			
3	19.12.2023	286,112		I. shpk	Fshati Vanaj-Fie	Nr. 516 dt 29.01.2024
1	13.06.2023	221,367		I. shpk	Fshati Peshtan-Fier	Nr.3499, dt 28.09.2024
3509	19.04.2023		104,000	E. M. shpk	Fshati Perparimaj-Devoll	Nr. 516/5 dt 07.02.2024
6403	11.07.2023		104,000	E. M. shpk	Fshati Borsh-Devoll	Nr.516/4 dt 07.02.2024
9498	29.09.2023		104,000	E. M. shpk	Fshati Vishoci-Devoll	Nr.516/6dt 07.02.2024
10304	26.10.2023		104,000	E. M. shpk	Fshati Zicisht-Devoll	Nr. 516/7 dt 07.02.2024
10305	26.10.2023		104,000	E. M shpk	Fshati Sul-Devoll	Nr.516/7 dt 07.02.2024
		507,479	**520,000**			
	Total		**1,027,479**			

Bashkëlidhur Urdhër Shpenzimit nr. 765, datë 19.12.2024, ndodhen dokumentet përkatëse mbështetëse, përfshirë: Marrëveshjen nr. 5241, datë 25.11.2013; **7 fatura tatimore të lëshuara** nga Donatori; memon shoqëruese "Për ndërhyrje në qendrat shëndetësore nga Donatori"; përmbledhjen e rimbursimit të TVSH-së për vitin 2023; përmbledhjen e faturave tatimore; si dhe kërkesat zyrtare të Donatorit së bashku me dokumentacionin shoqërues për rimbursimin e TVSH-së.

Nga auditimi rezultoi se:

MSHMS nuk ka raportuar detyrime të prapambetura në vlerën **1,169,454 lekë si detyrime ndaj donatorit për rimbursim TVSH-së** për ndërtimin dhe pajisjen e Qendrave Shëndetësore (QSH), të kryera nga Shoqata sipas **Marrëveshjes së Bashkëpunimit** nr.5241, dt 25.11.2013 me Donatorin "**Gj. K."** e EBA, përkatëshit **441,454 lekë ndaj shoqërisë ndërtuese I. shpk** për rimbursimin e TVSH-së dhe **728,000 lekë ndaj shoqërisë furnizuese E. shpk** për furnizimin me pajisje mjekësore. Në total, detyrimi për rimbursim TVSH arrin vlerën **1,169,454 lekë**.

Bashkëlidhur Urdhër Shpenzimit nr. 765/2025, dokumentin **Memo, datë 14.10.2024**, hartuar nga Sektori i Investimeve në MSHMS ka evidentuar faktin se në planin e investimeve për vitin 2024 (me transferim), është **alokuar fondi prej 1,065,454 lekë** për rimbursimin e TVSH-së për ndërtimin e QSH-ve dhe ambulancave, bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr. 5241, datë 25.11.2013. Kjo marrëveshje ngarkon Ministrinë e Shëndetësisë me **detyrimin për të rimbursuar TVSH-në** në mënyrë të rregullt dhe të plotë, brenda vitit pasardhës të përfundimit të objekteve, duke përfshirë edhe pajisjet dhe aparaturat mjekësore.

- Ministria në PBA 2023-2025 nuk ka parashikuar fonde per rimbursimin TVSH-së per rikonstruksionin e ambulancave sipas planit te investimeve për zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr.5241, dt 25.11.2013, **arsye per te cilën në prill 2024 ka parashtruar kërkesë për çelje fondesh në programin 07220**, sipas kërkesave të Donatorit per rimbursim fondesh.

Nga auditimi rezultoi se:

- Në **pasqyrat financiare të vitit 2024** nuk janë pasqyruar detyrimet për rimbursimin e TVSH-së në shumën **totale prej 1,169,454 lekësh** ndaj shoqërive ndërtuese dhe furnizuese për ndërtimin dhe pajisjen e Qendrave Shëndetësore, të kryera në kuadër të marrëveshjeve të donacionit.. Kjo për faktin se nga MSHMS raportimi dhe njohja e këtyre detyrimeve bëhet vetëm në momentin e likuidimit të pagesave, duke mos respektuar parimet e njohjes së detyrimeve sipas Standardit Kombëtar të Kontabilitetit për Sektorin Publik nr. 19 "Kontigjencat dhe Ngjarjet pas Datës së Pasqyrimit" (SKKSP 19), si dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, veçanërisht Udhëzimin nr. 6, datë 12.02.2020 "Për përgatitjen e pasqyrave financiare në sektorin publik". Kjo praktikë është në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili kërkon një menaxhim të kujdesshëm, të përgjegjshëm dhe transparent të fondeve dhe detyrimeve publike.

- **MSHMS deri 31.12.2024 nuk ka rimbursuar TVSH-në** ndaj donatorit lidhur me ndërtimin dhe pajisjen e Qendrave Shëndetësore Ambulanca Tip A2, të realizuara, përkatësisht **104,000 lekë** ndaj shoqërisë furnizuese **E.shpk** për rimbursimin e TVSH-së për faturën nr. 516/1, datë 07.02.2024, për pajisje mjekësore të furnizuara në fshatin Vanaj, Fier; dhe ***104,000 lekë*** ndaj shoqërisë furnizuese **E.shpk** për rimbursimin e TVSH-së për faturën nr. 516/3, datë 07.02.2024, për pajisje mjekësore të furnizuara në fshatin Peşhtan, Fier. Në total, **detyrimi për rimbursim TVSH është 208,000 lekë, sipas tabelës:**

Faturë tatimore		TVSH			Ambulanca Tip A2	Dokumentet e dorezuar ne MSHMS nga Donatori
Nr.	Date	Situacioni Punimesh	Pajisje Mjekësore			
12173	18.12.2023		104,000	E.shpk	Fshati Vanaj-Fier	Nr. 516/1 dt 07.02.2024
5172	05.06.2023		104,000	E.shpk	Fshati Peshtan-Fier	Nr. 516/3 dt 07.02.2024
	Total		**208,000**			

✓ **Objekti "Qendër Shëndetësore" në Fshatin Vanaj- Fier**

- Me shkresën hyrëse nr. 516 prot., datë 29.01.2024, Donatori ka paraqitur kërkesën për rimbursimin e TVSH-së të faturës tatimore nr. 3, datë 19.12.2023, për ndërtimin e objektit "Qendra Shëndetësore" në fshatin Vanaj, Fier, realizuar nga **firma ndërtuese I. shpk**. Praktika e bashkëlidhur përmban dokumentet mbështetëse: Fatura tatimore nr. 3/2023; Marrëveshja nr. 5241/2013; Kontrata e sipërmarrjes e datës 13.11.2023 ndërmjet Donatorit (porositës) dhe I. shpk (sipërmarrës); Preventivi i objektit "Fshati Vanaj – Fier"; Projekti i zbatimit dhe situacioni i punimeve; **Akti i kolaudimit i datës** 12.12.2023; **Akti i dhurimit nr. 11491 prot., datë 21.12.2023** (i protokolluar në Bashkinë Fier).

Sipas kontratës së sipërmarrjes të datës 13.11.2023, janë përcaktuar këto kushte financiare: Vlera e kontraktuar e punimeve me I. shpk është **1,716,677 lekë** (me TVSH), sipas preventivit bashkëlidhur. Vlera e miratuar nga Ministria është **1,320,521 lekë** (me TVSH), e ndarë si më poshtë: Donatori mbulon vlerën pa TVSH: 1,100,434 lekë; Ministria mbulon TVSH-në 20%: 220,087 lekë; **Bashkia Fie**r, bazuar në Marrëveshjen nr. 4009, datë 30.08.2023, për shkak të rritjes së çmimeve, **do të disbursojë në llogarinë** e donatorit 30% të vlerës me TVSH (1,320,521 lekë), pra shumën 396,156 lekë.

Rimbursimi i TVSH-së do të realizohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në përputhje me Marrëveshjen nr. 5241, datë 25.11.2013, konkretisht: Pika 1.4: përfshin rimbursimin e TVSH-së; Pika 1.5: mbështetur në dokumentacion si situacioni i punimeve, akti i supervizionit dhe akti i kolaudimit; Pika 1.6: si garanci për punimet, mbahet 5% e vlerës së preventivit pa TVSH Pagesa e TVSH-së do të kryhet një vit pas nënshkrimit të procesverbalit të dorëzimit të objektit, **periudhë që konsiderohet si afat garancie për cilësinë e punimeve të realizuara**.

- Me shkresën nr. 516/1 prot., datë 07.02.2024, Donatori ka paraqitur kërkesën për rimbursim të TVSH-së për furnizimin me pajisje mjekësore të Qendrës Shëndetësore në fshatin Vanaj, Fier, bazuar në faturën tatimore nr. 12173/2023, datë 18.12.2023, të lëshuar nga shoqëria **"E." shpk**.

Praktika e dorëzuar përfshin dokumentacionin përkatës: Fatura tatimore nr. 12173/2023;Kontrata e furnizimit, datë 12.12.2023 dhe Aneksi 1 me listën e pajisjeve mjekësore; Fletë-hyrjet nr. 12 dhe 12/1, datë 19.12.2023 për pajisjet e dorëzuara në QSH Vanaj-Fier, në vlerë totale prej 624,000 lekë (me TVSH), respektivisht 405,750 lekë dhe 218,250 lekë; Marrëveshja për bashkëpunim dhe procesverbali i dorëzimit të pajisjeve, datë 19.12.2023, ndërmjet furnizuesit dhe Donatorit.

Sipas kontratës së furnizimit të datës 12.12.2023, vlera e kontratës është 520,000 lekë (pa TVSH), e pandryshueshme, ndërsa çmimet e pajisjeve janë të përcaktuara në Aneksin 1 pa përfshirë TVSH-në.

Nga auditimi rezultoi se:

Nga auditimi i procesit të rimbursimit të TVSH-së për ndërtimin dhe pajisjen e Qendrës Shëndetësore në fshatin Vanaj, Fier, **u konstatuan mangësi dhe shkelje në zbatimin e marrëveshjeve dhe kuadrit ligjor si më poshtë**:

- Mungesë monitorimi nga përfituesi i donacionit (MSHMS) e cila nuk ka kryer kontroll dhe monitorim për cilësinë, afatet e përfundimit të punimeve dhe pajisjen e objektit me aparatura, në

kundërshtim me pikën III.b të Marrëveshjes nr. 5241, datë 25.11.2013.

- Mungesë dokumentacioni justifikues për rimbursimin e TVSH-së për pajisjet mjekësore: Në dosjen e rimbursimit mungonte fatura tatimore nr. 12173/2023 **e E. shpk** – dokument ky i domosdoshëm për vërtetimin e furnizimit dhe aplikimit të TVSH-së sipas ligjit nr. 92/2014 "Për TVSH-në".
- **Akti i dhurimit nr. 11491, datë 21.12.2023,** nuk është nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë si përfitues i donacionit, në kundërshtim me pikën III.c të Marrëveshjes, duke penguar përfundimin e procedurës ligjore për kalimin formal të pronësisë nga donatori te përfituesi. **Mungesë dokumentacioni për kalimin e pronësisë së objektit:** Dokumentet e domosdoshme për kalimin e pronësisë së ambulancës (leja e ndërtimit, planvendosja, lista e pajisjeve) nuk ishin protokolluar në Ministri, në kundërshtim me nenet 5 dhe 6 të Aktit të Dhurimit nr. 11491/2023.
- Ministria nuk ka mbajtur 5% të shumës së preventivit pa TVSH (vlera 55,021 lekë) si garanci për cilësinë e punimeve, në kundërshtim me pikën 1.6 të kontratës së sipërmarrjes të datës 13.11.2023 dhe kriterit kontraktual se pagesa e TVSH-së do të kryhet një vit pas nënshkrimit të procesverbalit të dorëzimit të objektit periudhë që konsiderohet si afat garancie për cilësinë e punimeve të realizuara.
- Në praktikën bashkëlidhur Urdhër Shpenzimit mungon Akt Marrëveshja e nënshkruar me Bashkinë Fier për pagesën nga ana e tyre 30% te vlerës së kontratës ë ndërtimit të QSH-ve Tip A2.

✓ **Objekti "Qendër Shëndetësore" në Fshatin Peshtan- Fier**

Donatori, me shkresë hyrëse nr. 3499 prot., datë 28.09.2023, **ka paraqitur kërkesë** për rimbursimin e TVSH-së, në lidhje me faturën tatimore nr. 1, datë 13.06.2023, për ndërtimin e objektit të Qendrës Shëndetësore (Ambulancë Tip A2) në fshatin **Peshtan, Fier**, të realizuar **nga shoqëria ndërtuese I. shpk.** Bashkëlidhur praktikës janë dokumentet përkatëse: marrëveshja e bashkëpunimit, fatura tatimore nr. 1/2023, preventivi dhe situacioni i punimeve, kontrata e sipërmarrjes e lidhur më 30.03.2023 ndërmjet Donatorit (porositësit) dhe shoqërisë I. shpk (zbatuesi i punimeve), projekti i zbatimit, si dhe akt-kolaudimi i datës 12.12.2023.

Kërkesa për rimbursimin e TVSH-së bazohet në dokumentacionin vërtetues si: fatura tatimore e shitjes nr. 1/2023; situacioni i punimeve, i nënshkruar nga donatori, sipërmarrësi dhe supervizori; akt-kolaudimi i datës 27.05.2023, i nënshkruar nga të tre palët, kontrata e sipërmarrjes, në të cilën vlera e punimeve është përcaktuar në shumën 1,113,575 lekë (pa TVSH); **Sipas Marrëveshjes, Donatori mbulon vlerën prej 1,113,575 lekë (pa TVSH), ndërsa nga Ministria duhet të rimbursohet TVSH-në prej 220,087 lekë (20%).**

Donatori, me shkresë nr. 516/3 prot., datë 07.02.2024, **ka paraqitur kërkesë** për rimbursimin e TVSH-së në lidhje me furnizimin me **pajisje mjekësore** për Qendrën Shëndetësore në fshatin Peshtan, Fier, bazuar në faturën tatimore nr. 1/2023, datë 13.06.2023, të lëshuar nga shoqëria furnizuese **E. shpk.** Praktikës i **janë bashkëlidhur dokumentet përkatëse**: fatura tatimore nr. 1/2023; Marrëveshja e bashkëpunimit dhe kontrata e furnizimit, datë 12.12.2023, së bashku me Aneksin 1 "Lista e pajisjeve mjekësore"; procesverbali i datës 05.06.2023 për dorëzimin e pajisjeve në ambientet e ambulancës, i nënshkruar nga furnizuesi dhe Donatori; Fletë Hyrjet nr. 5 dhe nr. 12/1, datë 05.06.2023 që dokumentojnë marrjen në dorëzim të 23 artikujve të pajisjeve mjekësore në QSH **Peshtan–Fier**, **me vlerë totale 624,000 lekë** (me TVSH); si dhe **Akt Dhurimi**, **datë 08.03.2023** nënshkruar nga Dhuruesi (Donatori), Bashkia Fier (palë e interesuar); Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik të Qarkut Fier (Pranuesi i Dhurimit).

- ✓ **Furnizimi me pajisje mjekësore për ambulanca Tipa A-2**

Nga shqyrtimi i Urdhrit të Shpenzimit nr. 765/2024, datë 19.12.2024, rezulton se është përfshirë pagesa, për rimbursimin e TVSh-së, në funksion të furnizimit me pajisje mjekësore:

1) për ambulancën në fshatin **Përparim – Devoll**. Kjo pagesë është kryer në zbatim të kërkesës së Donatorit, të parashtruar me shkresë hyrëse nr. 516/5, datë 07.02.2024 për faturën tatimore nr. 3509, datë 19.04.2023, në vlerën 104,000 lekë; Sipas praktikës bashkëngjitur faturës përshkruajmë dokumentet mbështetëse: Marrëveshja e bashkëpunimit, Kontrata e furnizimit me pajisje, Aneksi nr. 1, Procesverbali i dorëzimit të pajisjeve mjekësore, datë 19.04.2023, si dhe Fleta e Hyrjes së pajisjeve. Gjithashtu, është dorëzuar edhe **Akti i Dhurimit, datë 15.11.2023**,

2) për ambulancën në fshatin **Borsh – Devoll**. Kjo pagesë është kryer në zbatim të kërkesës së Donatorit, të parashtruar me shkresë hyrëse nr. 516/4, datë 07.02.2024 për faturën tatimore 6403, datë 11.07.2023, në vlerën 104,000 lekë. Sipas praktikës bashkëngjitur faturës përshkruajmë dokumentet mbështetëse: Marrëveshja e bashkëpunimit, Kontrata e furnizimit me pajisje, Aneksi nr. 1, Procesverbali i dorëzimit të pajisjeve mjekësore, datë 07.11.2023, si dhe Fleta e Hyrjes nr. 07, dt 07.11.2023 per 8 artikuj në vlerë 220.650 lekë. Gjithashtu, është dorëzuar edhe Akti i Dhurimit, datë 15.11.2023 (i përbashkët)

3) për ambulancën në fshatin **Vishocicë – Devoll**. Kjo pagesë është kryer në zbatim të kërkesës së Donatorit, të parashtruar me shkresë hyrëse nr. 516/6, datë 07.02.2024 për faturën tatimore 9498, date 29.09.2023, në vlerën 104,000 lekë. Sipas praktikës bashkëngjitur faturës përshkruajmë dokumentet mbështetëse: Marrëveshja e bashkëpunimit, Kontrata e furnizimit me pajisje dt 15.09.2023, Aneksi nr. 1, Procesverbali i dorëzimit të pajisjeve mjekësore, datë 07.11.2023, si dhe Fleta e Hyrjes nr. 08, dt 07.11.2023 së pajisjeve në total 624.000 per 23 artikuj. Gjithashtu, është dorëzuar edhe Akti i Dhurimit, datë 15.11.2023 (i përbashkët)

4) për ambulancën në fshatin **Ziçisht – Devoll**. Kjo pagesë është kryer në zbatim të kërkesës së Donatorit, të parashtruar me shkresë hyrëse nr. 516/7, datë 07.02.2024 për faturën tatimore 10304, datë 26.10.2023, në vlerën 104,000 lekë. Sipas praktikës bashkëngjitur faturës përshkruajmë dokumentet mbështetëse: Marrëveshja e bashkëpunimit, Kontrata e furnizimit me pajisje dt 15.09.2023, Aneksi nr. 1, Procesverbali i dorëzimit të pajisjeve mjekësore, datë 27.10..2023, si dhe Fleta e Hyrjes nr. 09, dt 07.11.2023 së pajisjeve në total 1.248.000 per 23 artikuj (per ambulance fshati Ziçisht dhe Sul). Gjithashtu, është dorëzuar edhe Akti i Dhurimit, datë 15.11.2023 (i përbashkët)

5) për ambulancën në fshatin **Sul– Devoll**. Kjo pagesë është kryer në zbatim të kërkesës së Donatorit, të parashtruar me shkresë hyrëse nr. 516/7, datë 07.02.2024 për faturën tatimore 10305, datë 26.10.2023, në vlerën 104,000 lekë. Sipas praktikës bashkëngjitur faturës përshkruajmë dokumentet mbështetëse: Marrëveshja e bashkëpunimit, Kontrata e furnizimit me pajisje dt 15.09.2023, Aneksi nr. 1, Procesverbali i dorëzimit të pajisjeve mjekësore, datë 07.11.2023, si dhe Fleta e Hyrjes nr. 09, dt 07.11.2023 së pajisjeve në total 1.248.000 per 23 artikuj (e përbashkët fshati Ziçisht dhe Sul). Gjithashtu, është dorëzuar edhe Akti i Dhurimit, datë 15.11.2023 (i përbashkët)

Aktit të Dhurimit datë 15.11.2023 përcakton transferimi i pronësisë për 6 (gjashtë) objekte të ndërtuara në fshatrat Përparimaj, Vishovicë, Çipan, Borsh, Sul dhe Ziçisht, të gjitha në territorin e Bashkisë Devoll, përfshirë dhe pajisjen e tyre me aparatura dhe pajisje mjekësore, ndërmjet Donatorit, Bashkisë Devoll (në cilësinë e pranuesit/përfituesit) dhe NJVKSH Devoll (në cilësinë e përfituesit dhe menaxhuesit të ambulancave të dhuruara).

Nga auditimi rezultoi se:

- **Marrëveshja e Bashkëpunimit nr.5241, dt 25.11.2013** me Donatorin **"Gj. K.**" e EBA **në pikën II.f** përcakton se : "*Përfituesi i doancionit .... rimburson TVSH-në me korrektësi në vitin pasardhës të përfundimit të QSH-re ose Ambulancave duke përfshirë edhe TVSH-në për pajisjet dhe aparaturat e tyre.*". **në pikën III.c** përcakton se: "*Dhruimin dhe pranimine akt dhurmit nga Përfituesi i donacionit dhe dokumntacionin përkatës sipas dispozitave ligjore në fuqi, **duke nënshkruar kontratën e dhurimit** për kalimin e pronësisë së objketit nga Donatori (Dhuruesi) tek përfituesi i Donacionit (Përfituesi i dhurimit)*".
- **Kontrata e dhurimit**, **datë 08.03.2023** ka për objekt : "*Krijimi dhe rregullimi i marrëdhënieve juridike për kalimin e pronësisë të një objekti të ndërtuar në fshatin **Peshtan – Fier**, me emërtimin Ambulancë tip A2 (me pajisje mjekësore), nga Dhuruesi tek Përfituesi i Dhurimit, sipas përcaktimeve, të drejtave, detyrimeve e përgjegjësive të kësaj kontrate*". **Ne nenin 4** të Kontratës së dhurimit përcaktohet dokumentacioni bashkëlidhur saj përkatësisht: leje për sheshin e ndërtimit të objektit, Projekti, plan vendosja, kontrata e sipërmarrjes, preventivi, situacioni për ndërtimin e objektit, akt kolaudimi i objektit, lista e pajisjeve dhe aparaturave mjekësore të objektit. Sipas **nenit 5** citojmë : "*Kjo kontratë hartohet dhe nënshkruhet me vullnetin e plotë dhe të lirë të palëve nënshkruese në 5 (pesë) ekzemplarë të njëjtë të barasvlershëm në gjuhën shqipe, nga një për secilën palë nënshkruese **dhe dy depozitohen në Ministrinë e Shëndetësisë***."
- Nga analiza krahasuese e përmbajtjes së Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe Kontratës së Dhurimit, rezulton një **mospërputhje sa i përket përcaktimit të përfituesit të donacionit**: **Në Marrëveshjen e Bashkëpunimit**, Përfituesi i donacionit identifikohet si **Ministria e Shëndetësisë**, e cila angazhohet edhe për rimbursimin e TVSH-së, n**dërsa në Kontratën e Dhurimit të vitit 2023**, përfituesi rezulton të jetë **Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Fier**, përkatësisht struktura që administron dhe pranoi objektin e ambulancës. Ky ndryshim përbën një **mospërputhje në kuptimin juridik dhe financiar**, që krijon paqartësi në identifikimin e subjektit që mban përgjegjësinë për pranimin ligjor të dhurimit; rimbursimin e TVSH-së; regjistrimin dhe menaxhimin e pasurisë së dhuruar.

Gjithashtu, nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se **nuk janë depozituar dy ekzemplarë** të **Kontratës së Dhurimit pranë Ministrisë së Shëndetësisë**, siç parashikohet në nenin 5 të kontratës së dhurimit të datës 08.03.2023. Kjo përbën shkelje të qartë të kushteve kontraktore dhe paraqet mangësi në administrimin dhe transparencën e pasurisë publike të përfituar nga donacioni. **Mosdepozitimi i kontratës** në autoritetin përkatës (MSHMS) cenon procesin e regjistrimit, kontabilizimit dhe raportimit të pasurisë së dhuruar në evidencat financiare dhe juridike të institucionit publik. Veprimet e mësipërme bien ndesh me **Nenin 5 i kontratës së dhurimit, datë 08.03.2023**, përcakton: "*Kjo kontratë hartohet dhe nënshkruhet me vullnetin e plotë dhe të lirë të palëve nënshkruese në 5 (pesë) ekzemplarë të njëjtë të barasvlershëm në gjuhën shqipe, nga një për secilën palë nënshkruese dhe **dy depozitohen në Ministrinë e Shëndetësisë***."; me **Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"**, neni 4, pika 1 dhe neni 6, pika 2 dispozita që përcaktojnë detyrimin për administrim të efektshëm dhe të ligjshëm të pasurisë publike dhe për përfshirjen e të gjitha burimeve në evidencat financiare të institucioneve buxhetore; **Udhëzimi nr. 26, datë 04.11.2015 i Ministrit të Financave**, "Për kontabilizimin e pasurive në institucionet publike" që parashikon se çdo pasuri e përfituar si donacion duhet të evidentohet dhe të mbështetet me dokumentacion të plotë, përfshirë aktet e dhurimit dhe dokumentet përcjellëse, të cilat depozitohen pranë autoriteteve përgjegjëse për miratim dhe regjistrim dhe **Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë (ligji nr. 7850, datë 29.07.1994)**, nenet 787–793 që përcakton që dhurimi i pasurive të paluajtshme kërkon formë të

shkruar dhe respektim të procedurave të regjistrimit dhe kalimit të pronësisë sipas legjislacionit në fuqi.

- Dokumentacioni bashkëlidhur praktikës së rimbursimit per furnizim me pajisë mjekësore **nuk është i plotë**, siç përshkruhet në shkresën e Donatorit nr. 516/5, datë 07.02.2024. Konkretisht, **mungojn**ë fletë-hyrjet e pajisjeve mjekësore, të cilat shërbejnë si dokumentacion mbështetës për vërtetimin e zbatimit të Procesverbalit të dorëzimit, datë 19.04.2023.

Lista e pajisjeve mjekësore në ambulancën e fshatit Borsh-Devoll nuk përputhet ne artikuj (8 /23 artikuj) dhe vlerë (220.650/624.000) me proces verbal dorëzimi date 07.11.2023 me Flete Hyrjen nr. 07, dt 07.11.2022.

- Aktit të Dhurimit datë 15.11.2023 përcakton transferimi i pronësisë për 6 (gjashtë) objekte të ndërtuara në fshatrat Përparimaj, Vishovicë, Çipan, Borsh, Sul dhe Ziçisht, të gjitha në territorin e Bashkisë Devoll, përfshirë dhe pajisjen e tyre me aparatura dhe pajisje mjekësore, ndërmjet Donatorit, Bashkisë Devoll (në cilësinë e pranuesit/përfituesit) dhe NJVKSH Devoll (në cilësinë e përfituesit dhe menaxherit të ambulancave të dhuruara).**nuk përmban aktet e ndërtimit të këtyre objekteve**, listën e pajisjeve mjekësore (Aneksi nr. 1), dhe fletë-hyrjet për secilën ambulancë, të cilat janë të domosdoshme për të vërtetuar përmbushjen e objektit të dhurimit, per te cilat MSHMS ka detyrimin per rimbursimin e Tvsh-së në investimit te objektit dhe pajisjeve mjekësore të furnizuara në këto qendra shëndetësore.

Konkluzion:

MSHMS nuk ka një grup monitorimi per zbatimin e projektit Marrëveshja e Bashkëpunimit nr.5241, dt 25.11.2013 me Donatorin **"Gj. K.**" e EBA**.** Nga dokumentacioni bashkëlidhur urdhër shpenzimit **nuk rezultuan raporte gjashte-mujore dhe vjetore të progresit Këshillit Drejtues të Projektit,** per verifikimin e shpenzimeve faktike dhe aprovimin e TVSH-së së rimbursuar.

Ne pasqyrat financiare të vitit 2024, nuk janë pasqyruar detyrimet e prapambetura për rimbursimin e TVSH-së në shumën 1,027,479 lekë,

Veprimet dhe mosveprimet e konstatuara **tregojnë për mangësi në menaxhimin** e pasurive të përfituara nga donacionet, mungesë koordinimi ndërmjet institucioneve përgjegjëse dhe cenim të dispozitave ligjore që rregullojnë dhurimet, regjistrimin dhe administrimin e pasurisë publike, në kundërshtim Marrëveshjen e bashkëpunimit nr. 5241, datë 05.11.2013 nënshkruar ndërmjet **MSHMS** dhe shoqatës humanitare "**Gj. K.**" e EBA me piken III.b te sipas te cilës përcaktohet kontroll dhe monitorim nga përfituesi i Donacionit (MSHMS) për cilesinë dhe afatin e përfundimit të objekteve dhe paujën e tyre me orenditë dhe aparaturat përkatëse dhe pikën III.c sipas të cilës "... pranimin e akt dhurimit nga Përfituesi i Donacionit dhe dokumentacionin përkatës sipas dispozitave ligjore në fuqi, **duke nënshkruar** kontratën e dhurimit për kalimin e pronësisë së objektit nga Donatori (Dhuruesi) tek përfituesi i Donacionit (Përfituesi i dhurimit)".

Paguar TVSH per Donator "Gj.K."

Faturë tatimore		TVSH			Ambulanca Tip A2	Dokumentet e dorezuar ne MSHMS nga Donatori
Nr.	Date	Situacioni Punimesh	Pajisje Mjekësore			
3	19.12.2023	286,112		I. shpk	Fshati Vanaj-Fie	Nr. 516 dt 29.01.2024
1	13.06.2023	221,367		I. shpk	Fshati Peshtan-Fier	Nr.3499, dt 28.09.2024
3509	19.04.2023		104,000	E.shpk	Fshati Perparimaj-Devoll	Nr. 516/5 dt 07.02.2024
6403	11.07.2023		104,000	E.shpk	Fshati Borsh-Devoll	Nr.516/4 dt 07.02.2024
9498	29.09.2023		104,000	E.shpk	Fshati Vishoci-Devoll	Nr.516/6dt 07.02.2024
10304	26.10.2023		104,000	E.shpk	Fshati Zicisht-Devoll	Nr. 516/7 dt 07.02.2024
10305	26.10.2023		104,000	E.shpk	Fshati Sul-Devoll	Nr.516/7 dt 07.02.2024
		507,479	**520,000**			
	Total		**1,027,479**			

2. Projekti "Shendeti per te gjithë" (HAP), finacuar nga Agjencia Ziceriane, i cili zbatohet në Shqiperi nga Qendra H. me NIPT L.....E.

Qendra H. me NIPT L.....E, me **shkrese hyrese nr. 3760, datë 15.10.2024**, ka depozituar kerkese për imbursimin e TVSH-së në kuadër të projketit "Shnëdeti per të gjithë", më të dhëna të TVSH-së së akumuluar deri 31.08.2024 (pas rakordimeve të bëra me sektorin e finacës) e detajuar:H.-1 (Faza e Pare 2015-2019) në shumën **5,466,649** lekë; HAP-2 (Faza e Dyte 2019-2024); në shumën **7,113,647** lekë; HAP-3 (Faza e Tretë 2024-2019) në shumën **9,670,233** lekë. në **total vlerën 22,250,53 lekë.**.

Ne **Memo date 05.11.2024** projekti "Shëndeti për të gjithë-HAP", informohet se projekti financohet nga Agjencia Zviceriane për bashkëpunim dhe Zhvillim (SDC) sipas kontratave: Nr. 81030395 për fazën e parë (HAP-1); Nr. 81059430 për fazën e dyte (HAP-2); Nr. 81077006 për fazën e Konsolidimit (Faza-3). Në këtë dokument sqarohet se Qendra H. pretendon rimbursimin e TVSH-se **12,580,297 lekë** shumë së i përket TVSH-së për: Hap-1, Faza e Parë, 2015-31 Mars 2019 në shumën **5,466,649** lekë; Hap-2, Faza e Dytë , 1 prill 2019-2023 në shumën **7.113.648 lekë**, e cila sipas MSHMS nuk vërtetohet sipas dokumenteve të depozituara, pasi nuk rezulton si detyrim në pasqyrat financiare të MSHMS, arsye për të cilën ajo **nuk konfirmon likuidimin e detyrimit** të pretenduar të rimbursimit të TVSH-së, **pasi duhet të verifikohet gjithë dokumentacioni që nga fillimi i projektit. MSHMS nga 2015 deri 2023 ka likuiduar TVSH-në e projektit "Shëndet për të gjithë**".

Sipas MSHMS aprovohet për tu rimbursuar TVSH-se për Fazën e trete për periudhën për 275 fature tatimore të periudhës 01.01.2023 deri 31.12.2023 në vlerë tvsh-je per tu rimbursuar në total **5.102.086 lekë dhe** 252 fature tatimore të periudhës 01.01.2024 deri 31.08.2024, në vlerë tvsh-je per tu rimbursuar në total **4.568.147 lekë, në total** sipas në total shumën **9,670.233 lekë.**

Me shkresë nr. 5247, datë 31.12.2024 **konfirmohet** se projekti ka përfunduar Fazën e Konsolidimit (Faza3), duke lejuar vazhdimin e procedurave sipas kërkesës së të interesuarit, referuar në ligjin nr. 9801, dt 13.09.2007 "Për ratifikim e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Këshillit Federal Zvicerian", për bashkëpunim teknik, financiar dhe humanitar në kuadër të projektit për të gjithë HAP për fazën e parë, të dytë dhe të konsolidimit faza e tretë.

Bashkëlidhur dokumentacionit Raport Auditi financiar për zbatimin e projektit nr. 81077006 për periudhën 01.04.2023 deri 31.03.2024

Me USH nr. 21/2025, datë 24.01.2025, është likuiduar shuma **9,670,233 lekë** pagesa e rimbursimi të TVSH-se sipas kërkesës nr. 2131 prot, datë 15.10.2024 "Kërkesë per rimbursimin e TVSH-se", ne kuadër të projektit "*Shëndeti për të gjithë -HAP*",

Nga auditimi rezultoi se:

-MSHMS **nuk ka një grup monitorimi** per zbatimin e projektit. Nga dokumentacioni bashkëlidhur urdhër shpenzimit nuk rezultuan raporte gjashte-mujore dhe vjetore të progresit Këshillit Drejtues të Projektit,

-Nga të dhënat dokumentare bashkëlidhur Urdhër Shpenzimit 21/2025, nuk rezulton njoftimi i OJF per refuzimin dhe mos rimbursimin e TVSH-se 12,580,297 lekë shumë së i përket TVSH-së për: Hap-1, Faza e Parë, 2015-31 Mars 2019 në shumën 5,466,649 lekë; Hap-2, Faza e Dytë , 1 prill 2019-2023 në shumën 7.113.648 lekë .

-MSHMS ka rimbursuar TVSH-në kerkuar me shkrese hyrese nr. 3760, datë 15.10.2024 për Fazën e trete në total sipas në total shumën 9,670.233 lekë që i përkasin për periudhën periudhës 01.01.2023 deri 31.12.2023 (për 275 fature tatimore) per tu rimbursuar në total 5.102.086 lekë dhe periudhës 01.01.2024 deri 31.08.2024 (252 fature tatimore), në vlerë tvsh-je per tu rimbursuar në

total 4.568.147 lekë, në tejkalim ta afatit ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në pikën 184 Udhëzimit MFE nr. 09, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", paragrafin pika 63 pika 2 të Udhëzimit Nr. 6, datë 30.1.2015 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë,"

-Ne pasqyrat financiare të vitit 2024, nuk janë pasqyruar detyrimet e prapambetura për rimbursimin e TVSH-së nr. 3760, datë 15.10.2024 për detyrimin për rimbursimin e TVSH-së në shumën 12,580,297 lekë, lidhur me shpenzimet e projektit për TVSH-së për: Hap-1, Faza e Parë, 2015-31 Mars 2019 në shumën 5,466,649 lekë; Hap-2, Faza e Dytë , 1 prill 2019-2023 në shumën 7.113.648 lekë,, mbështetur në Marrëveshjen e Këshillit të Ministrave me Konfederatën Zviceriane.

Konkluzion

Nga auditimi i kërkesës për rimbursimin e TVSH-së **nga Qendra H.** për projektin "Shëndeti për të gjithë", rezulton se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka miratuar dhe likuiduar pjesërisht shumën e kërkuar, konkretisht për Fazën e Tretë të projektit, **në vlerën 9,670,233** lekë. Kjo pagesë është kryer me tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh, duke mos respektuar afatet e përcaktuara **në pikën 184** Udhëzimit MFE nr. 09, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", paragrafin pika 63 pika 2 të Udhëzimit Nr. 6, datë 30.1.2015 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë,"

Ndërkohë, nuk është marrë asnjë vendimmarrje për pjesën tjetër të kërkuar **prej 12,580,297 lekë** që lidhet me fazat HAP-1 dhe HAP-2 të projektit, dhe nuk është bërë njoftimi zyrtar i subjektit për mosrimbursimin e kësaj shume. Gjithashtu, kjo shumë nuk është pasqyruar si detyrim në pasqyrat financiare të vitit 2024, ndonëse është një pretendim i paraqitur dhe i dokumentuar nga OJF-ja, mbështetur në marrëveshjen ndërkombëtare të miratuar me ligj.

Po ashtu, u konstatua mungesa e një strukture monitoruese të projektit brenda MSHMS, si dhe mungesa e dokumentacionit të brendshëm mbështetës, si raporte progresi ose vendimmarrje nga Këshilli Drejtues i Projektit, situate që ngre shqetësime për ndjekjen dhe kontrollin efektiv të procesit të rimbursimit të TVSH-së dhe përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare që rrjedhin nga marrëveshja e ratifikuar

3.Projekti "Shëndeti për të gjithë" (HAP), finacuar nga Agjencia Ziceriane, i cili zbatohet në Shqiperi nga Qendra "S.Ch." me NIPT J.....D.

Qendra "S.Ch.", me NIPT **J.....D**, në zbatim të projektit të SDC "Shkolla për Shëndetin", në kuadër të **kontratës nr. 81068419**, mbështetur në **Marrëveshjen e Këshillit të Ministrave me Konfederatën Zviceriane**, sipas **VKM nr. 869, datë 29.12.2021**, "Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Konfederatës Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës, e cila vepron përmes Ambasadës Zvicerane në Shqipëri, për Projektin 'Shkollat për Shëndetësi'", dhe në zbatim të **Marrëveshjes për bashkëpunim dhe zhvillim ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Konfederatës Zviceriane** (Faza e Parë **Mars 2021 – Shkurt 2025**), ka paraqitur kërkesat për rimbursimin e TVSH-së si më poshtë:

- Shkresa nr. 413, datë 23.01.2024: Rimbursimi i TVSH-së për periudhën 01 nëntor 2023 – 31 dhjetor 2023 në vlerën 1,512,703 lekë si dhe shuma 1,414,177 lekë, pjesë e mbetur pa likuiduar nga TVSH-ja e rimbursuar për periudhën 01 mars 2021 – 31 dhjetor 2021.
- Shkresa nr. 413/1, datë 13.03.2024: Rimbursimi i TVSH-së për periudhën 01 shkurt 2024 – 29 shkurt 2024 në vlerën 818,124 lekë.
- Shkresa nr. 413/2, datë 02.05.2024: Rimbursimi i TVSH-së për periudhën 01 mars 2024 – 30

prill 2024 në vlerën 48,413 lekë.

- Shkresa nr. 413/3, datë 15.07.2024: Rimbursimi i TVSH-së për periudhën 01 maj 2024 – 30 qershor 2024 në vlerën 734,284 lekë.
- Shkresa nr. 413/4, datë 08.10.2024: Kërkesë për rimbursimin e TVSH-së në shumën 1,371,231 lekë, për shpenzimet e projektit gjatë periudhës 01 korrik 2024 – 30 shtator 2024.

Sektori i Financës me Memo datë 13.01.2025 ka kërkuar likuidimin e rimbursimit të TVSH-se **4,997,962 lekë, sipas kërkesës për rimbursim.** bazuar në **Vendimit nr. 869, datë 29.12.2021** kërkuar me shkresat 413; 413/1; 413/2;413/3 dhe pjesërisht 413/4 per 470,261 lekë , bashkëlidhur përmbledhëse Faturash.

MSHMS me shkrese nr. 411 Prot., date 23.01.2025, ne zbatim te Vendimit nr. 869, datë 29.12.2021 dhe në zbatim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Konfederatës Zviceriane ka urdhëruar të vijohet me kryerjen e pagesës së TVSH-se për projektin "Shkolla për shëndetin" sipas Aneksit III-A.

Urdhër Pagese nr. 822, dt 24.01.2025 MSHMS ka likuiduar rimbursimin e TVSH-së me ne shumën 4.997.962 lekë.

Nga auditimi rezultoi se:

- MSHMS **nuk ka ngritur një grup monitorimi** per zbatimin e projektit.
- MSHMS **ka rimbursuar TVSH-në në shumën 4,997,962 lekë**, sipas kërkesës për rimbursim. bazuar në Vendimit nr. 869, datë 29.12.2021 kërkuar me shkresat 413; 413/1; 413/2;413/3 dhe pjesërisht 413/4 p, (bashkëlidhur përmbledhëse faturash), në tejkalim ta afatit ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në pikën 184 Udhëzimit MFE nr. 09, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", paragrafin pika 63 pika 2 të Udhëzimit Nr. 6, datë 30.1.2015 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë,"
- Nga dokumentacioni bashkëlidhur urdhër shpenzimit **nuk rezultuan raporte gjashte-mujore dhe vjetore të progresit Këshillit Drejtues të Projektit,** në kundërshtim me detyrat e KD përcaktuar ne **nenin 6.6 gërma "b**" Marrëveshjes të Miratuar me VKM nr. 868, datë 29.12.2021, per projektin "Shkolla Për Shëndetin" sipas të cilit citojmë : "*Këshilli Drejtues do të kryejë detyrat e mëposhtme: .... 6.b. Do të rishikojë dhe aprovojë raportet gjashtë mujore dhe vjetore të progresit, përfshire statusin e shpenzimeve kundrejt buxhetit* ".
- Ne pasqyrat financiare të vitit 2024, nuk janë pasqyruar detyrimet e prapambetura për rimbursimin e TVSH-së 5,898,932 lekë, lidhur me shpenzimet e projektit në kuadër të kontratës nr. 81068419, mbështetur në Marrëveshjen e Këshillit të Ministrave me Konfederatën Zviceriane sipas VKM nr. 869, datë 29.12.2021

Konkluzion

Nga auditimi i procesit të rimbursimit të TVSH-së për projektin "Shkolla për Shëndetin", mbështetur në marrëveshjen e miratuar me VKM nr. 869, datë 29.12.2021, rezulton se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale **ka kryer rimbursimin në shumën 4,997,962 lekë**, por në tejkalim të afatit ligjor 30-ditor të përcaktuar në legjislacionin në fuqi, duke shkelur dispozitat e Udhëzimit të MFE nr. 09/2018 dhe Udhëzimit nr. 6/2015 për TVSH-në.

Gjithashtu, nuk është ngritur një grup i posaçëm monitorimi për ndjekjen e zbatimit të projektit dhe nuk rezultojnë të jenë hartuar apo miratuar raportet gjashtëmujore dhe vjetore të progresit, në kundërshtim me nenin 6.6, germa "b" të Marrëveshjes. Kjo përbën mangësi në zbatimin e mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes së projektit.

Për më tepër, **në pasqyrat financiare të vitit 2024 nuk janë pasqyruar detyrimet e prapambetura për rimbursimin e TVSH-së në vlerën 5,898,932 lekë**, ndonëse ato burojnë nga

kontrata zyrtare nr. 81068419 dhe janë të mbështetura në marrëveshjen ndërkombëtare me Konfederatën Zvicerane. Kjo cenon transparencën dhe saktësinë e pasqyrimit të detyrimeve buxhetore të ministrisë dhe rrezikon mosrespektimin e angazhimeve ndërkombëtare të shtetit shqiptar.

VENDIMET GJYQËSORE:

Në **pasqyrat financiare të vitit 2024** nuk janë pasqyruar detyrimet për pagesat e gjyqfituesve, me të drejtë rikthimi në detyrë dhe me kod pune..

Kjo për faktin se nga MSHMS raportimi dhe njohja e këtyre detyrimeve b**ëhet vetëm në momentin e likuidimit të pagesave,** duke mos respektuar parimet e njohjes së detyrimeve sipas Standardit Kombëtar të Kontabilitetit për Sektorin Publik nr. 19 "Kontigjencat dhe Ngjarjet pas Datës së Pasqyrimit" (SKKSP 19), si dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, veçanërisht Udhëzimin nr. 6, datë 12.02.2020 "Për përgatitjen e pasqyrave financiare në sektorin publik".

Kjo praktikë është në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili kërkon një menaxhim të kujdesshëm, të përgjegjshëm dhe transparent të fondeve dhe detyrimeve publike; Udhëzimin nr. 1, datë 04.05.2014 të Kryeministrit "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit"; Urdhërin e Ministrit të Shteti për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 5151, datë 28.10.2015 "Për zbatimin e vendimeve gjyqësorë të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil"; si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 24, datë 29.08.2019 "Për përdorimin e arkivës elektronike në procesin e ekzekutimin e buxhetit të shtetit nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme"

VENDIME GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË

Per vitin 2024

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2024 ka kryer likuidimin financiar që rrjedhin nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë **të gjyq fituesve nëpunës civilë, më të drejtë rikthimi në punë, bazuar ne Urdhërin e SP nr. 360/dt 21.06.2024; nr. 649, dt 18.12.2024** si **ne Aneskin 2.3** , pjesë e këtij raporti.

Për vitin 2023.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2024 ka kryer likuidimin financiar që rrjedhin nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë **të gjyq fituesve nëpunës civilë, më të drejtë rikthimi në punë, bazuar** ne Urdhërin e SP nr. 413, prot nr. 621/1, dt 11.07.2023 si më poshtë vijon, si **ne Aneskin 2.4** , pjesë e këtij raporti.

Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore dhe njohjen e tyre ne kontabilitet rezultoi se :

- MSHMS gjatë vitit 2024 janë ekzekutuar vendime gjyqësore të formës së prerë (pjesërisht) për **25 urdhra shpenzimesh**, me një shumë të likuiduar prej **33,205,362 lekësh**. Gjatë vitit 2023 janë ekzekutuar pjesërisht vendime gjyqësore të formës së prerë për **11 urdhra shpenzimesh**, me një shumë të likuiduar prej **9,739,882 lekësh**, **pasqyruar në Aneksin 2.3 dhe Aneksin 2.4,** pjesë e këtij projekt raporti. Pagesat e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, paguhen në total pa dalluar shumën e shpenzimeve përmbarimore.

- Vendimet gjyqësore të pa ekzekutuara plotësisht variojnë nga 2 (dy) deri në 13 (trembëdhjetë) vite. Konkretisht, janë evidentuar ne proces ekzekutimi nder vite: 1 (një) rast për vitin 2011; 1 (një) rast për vitin 2012; 2 (dy) raste në vitin 2014; 3 (tre) raste për vitin 2015; 1 (një) rast për vitin 2016; 1 (një) rast për vitin 2017; 1 (një) rast për vitin 2018; 1 (një) rast për vitin 2022.

Sipas **nenit 66/1** të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", vendimet gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë zbatohen menjëherë nga njësia përgjegjëse. Nëpunësi civil ka të drejtë të kthehet në të njëjtin pozicion pune, sipas vendimit gjyqësor. Vetëm nëse kjo nuk është objektivisht e mundur, institucioni mund të ofrojë një pozicion të përshtatshëm dhe të barasvlershëm (në nivel, pagë, përgjegjësi). Nëpunësi, duhet të rikthehet në të njëjtin pozicion pune që ka mbajtur, nëse ai është ende i lirë. Nëse pozicioni nuk është më i lirë institucioni duhet të zhvendosë nëpunësin aktual në një pozicion tjetër të përshtatshëm, ose të krijojë një vend pune të përkohshëm për të zbatuar vendimin.

Nga dokumentacioni dhe informacioni i kërkuar për vendimmarrjen mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore titull ekzekutiv, rezultoi se Sektori i Burimeve Njerëzore për Ministrinë, me marrjen dijeni për vendimin gjyqësor të formës së prerë si dhe me kërkesë/lajmërim nga gjyqfituesi apo përmbaruesi gjyqësor, në zbatim të pikës 4, të kreut 3, të Urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike "*Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit të shërbimit civil*", ka vënë në dijeni nëpunësin më të lartë civil të institucionit (Sekretarin e Përgjithshëm) dhe ka kërkuar mbledhjen e komisionit.

MSHMS ka ngritur **Komisionin e Posaçëm** më Urdhër nr. 351 , datë 02.06.2022, i ndryshuar me Urdhër nr. 161, datë 16.03.2023; Urdhër nr. 746, datë 18.12.2023, i ndryshuar me Urdhër nr. 203, datë 09.04.2024 për shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes se vendimit gjyqësore të formës së prerë të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" si dhe urdhërit të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr.5151, datë 28.10.2015**.**

Komisioni i Posaçëm ka trajtuar rastet e të gjithë gjyq fituesve në liste pritje duke shqyrtuar mundësinë e rikthimit të tyre në pozicionet e mëparshme të punës, pozicione ekuivalente me të dhe njëkohësisht të përshtatshme me kriteret profesionale të tyre. Komisioni ka shqyrtuar të gjitha rastet në mbledhjet e datave; 12.04.2024, 30.04.2025, 04.07.2025 dhe në mbledhjen e datës 23.05.2025 (per vitin 2023 nuk ka informacion per vendimmarrje).

Nga shqyrtimi i secilit prej rasteve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë në favor të gjyq fituesve prej Komisionit të Posaçëm, kanë rezultuar 3 (tre) Gjyq fitues të larguar nga listë pritja përgjatë vitit 2024 dhe 9 (nëntë) gjyq fitues të cilët vazhdojnë të mbeten në listë pritje, pasi ende nuk është krijuar një pozicion vakant në Ministri, i përshtatshëm për sistemimin e tij në një pozicion të rregullt në shërbim civil, bazuar në arsimin dhe përvojën e tij profesionale.

Në zbatim të detyrave të lëna nga Komisioni, me shkresën nr. 2191 Prot., datë 09.05.2024, Ministria i është drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me kërkesë për ndihmë administrative për shkak të mungesës së pozicioneve që kanë kriter disa fusha specifike profesionale. Gjithashtu me shkresën nr. 1795/18, datë 10.07.2024, si dhe MEKI-t me shkresën nr. 1795/29, datë 21.08.2024.

Nga sa më sipër, moszbatimi nga ana e institucionit i vendimit gjyqësor të formës së prerë, i cili urdhëron kthimin në punë të nëpunësit civil, përbën shkelje të detyrimeve ligjore që burojnë nga **neni 66/1, ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil**", i ndryshuar, sipas të cilit institucioni

është i detyruar të zbatojë menjëherë vendimin dhe të kthejë nëpunësin në vendin e punës që ai ka pasur. Më tej, ky veprim përbën mosrespektim edhe të nenit 117 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", i cili përcakton detyrimin e organeve publike për të zbatuar vendimet gjyqësore.

KONKLUZION:
Nga auditimi i kryer mbi trajtimin e vendimeve gjyqësore dhe njohjen e tyre në kontabilitet në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), rezultoi se:
Ekzekutim pjesor dhe i vonuar i vendimeve gjyqësore – MSHMS gjatë vitit 2024 janë ekzekutuar vendime gjyqësore të formës së prerë (pjesërisht) për **25 urdhra shpenzimesh**, me një shumë të likuiduar prej **33,205,362 lekësh**. Gjatë vitit 2023 janë ekzekutuar pjesërisht vendime gjyqësore të formës së prerë për **11 urdhra shpenzimesh**, me një shumë të likuiduar prej **9,739,882 lekësh**, **pasqyruar në Aneksin 2.3 dhe Aneksin 2.4,** pjesë e këtij projekt raporti. Pagesat e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, paguhen në total pa dalluar shumën e shpenzimeve përmbarimore.
Vendimet gjyqësore të pa ekzekutuara plotësisht variojnë nga 2 (dy) deri në 13 (trembëdhjetë) vite. Konkretisht, janë evidentuar ne proces ekzekutimi nder vite: 1 (një) rast për vitin 2011; 1 (një) rast për vitin 2012; 2 (dy) raste në vitin 2014; 3 (tre) raste për vitin 2015; 1 (një) rast për vitin 2016; 1 (një) rast për vitin 2017; 1 (një) rast për vitin 2018; 1 (një) rast për vitin 2022.
Shkelje e dispozitave për zbatimin e menjëhershëm të vendimeve për kthimin në detyrë – Moszbatimi i vendimeve gjyqësore për kthimin në punë të nëpunësve civilë përbën shkelje të rëndë të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", si dhe nenit 117 të Kodit të Procedurave Administrative (ligji nr. 44/2015), që përcakton detyrimin e qartë të institucioneve publike për zbatimin e vendimeve gjyqësore. Këto mosveprime përbëjnë përgjegjësi ligjore dhe administrative për strukturat përkatëse, duke sjellë pasoja në të drejtat ligjore të individëve dhe rritjen e barrës financiare për institucionin.
Në përfundim, konstatimet tregojnë për mangësi serioze në përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe financiare të institucioneve publike ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë, me ndikim të drejtpërdrejtë në besueshmërinë e pasqyrave financiare, respektimin e shtetit të së drejtës, si dhe mbrojtjen e të drejtave të individëve.

ÇËSHTJE GJYQËSORE NË PROCES
✓ Çështja gjyqësore me palë paditëse (individë). dhe palë të paditura MShMS, QSUNT me objekt shpërblim dëmi jashtëkontraktor nga mosmarrja e faktorit VIII ose IX, ndër vite,

1- Çështja gjyqësore me palë paditëse **Z.L. etj.,-** në gjykim pranë Gj. A. Sh. P. Tiranë
2- Çështja gjyqësore me palë paditëse **F.D etj.,** në gjykim pranë Gj. A. Sh. P. Tiranë
3- Çështja gjyqësore me palë paditëse **M.M etj**.- në gjykim pranë Gj. A. Sh. P. Tiranë
4- Çështja gjyqësore me palë paditëse **Xh.M etj** -në gjykim pranë Gj. A. Sh. P. Tiranë
5- Çështja gjyqësore me palë paditëse **B.K etj.** - në gjykim pranë Gj. A. Sh. P. Tiranë
6- Çështja gjyqësore me palë paditëse **A.B etj.,** - në gjykim pranë Gj. A. Sh. P. Tiranë
7- Çështja gjyqësore me palë paditëse **A.K etj.,**- në gjykim pranë Gj. A. Sh. P. Tiranë
8- Çështja gjyqësore me palë paditëse **G.B etj.,** - në gjykim pranë Gj. A. Sh. P. Tiranë
9- Çështja gjyqësore me palë paditëse **E.B etj.,** - në gjykim pranë Gj. A. Sh. P. Tiranë
10- Çështja gjyqësore me palë paditëse **N.B etj.,** - në gjykim pranë Gj. A. Sh. P. Tiranë
11- Çështja gjyqësore me palë paditëse **E.L etj.,** - në gjykim pranë Gj. A. Sh. P. Tiranë
12- Çështja gjyqësore me palë paditëse **Y.Ll etj.,** - në gjykim pranë Gj. A. Sh. P. Tiranë
13- Çështja gjyqësore me palë paditëse **L.P etj**., - në gjykim pranë Gj. A. Sh. P. Tiranë

14- Çështja gjyqësore me palë paditëse **J.L etj.,** - në gjykim pranë Gj. A. Sh. P. Tiranë
15- Çështja gjyqësore me palë paditëse **Sh.D etj.**.- në gjykim pranë Gj. A. Sh. P. Tiranë
16- Çështja gjyqësore me palë paditëse **B.Xh etj.,** - në gjykim pranë Gj. A. Sh. P. Tiranë
17- Çështja gjyqësore me palë paditëse **A.B etj.,** - në gjykim pranë Gj. A. Sh. P. Tiranë
18- Çështja gjyqësore me palë paditëse **H.S etj.,** - në gjykim pranë Gj. A. Sh. P. Tiranë

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është palë e paditur ne Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë me objekt shpërblim dëmi jashtë kontraktor nga mos marrja e faktorit VIII ose IX, ndër vite. Paditësit pretendojnë se Ministria e Shëndetësisë, QSUT apo ndonjë strukturë tjetër shëndetësore **kanë dështuar të sigurojnë ose të shpërndajnë në kohë këta faktorë**, duke shkaktuar **dëme shëndetësore** dhe të parandalueshme ndaj tyre. Si rrjedhojë, ata kërkojnë nga gjykata **një shpërblim financiar për dëmin e pësuar**, bazuar në nenet përkatëse të përgjegjësisë civile në Kodin Civil Shqiptar.

Nga audtimi rezulton se paditë e përmendura **(18 raste)** për shpërblim dëmi jashtë kontraktor për mungesën e faktorit VIII ose IX,, që janë produkte mjekësore thelbësore për trajtimin e hemofilisë, **përbëjnë risk për Ministrinë e Shëndetësisë** dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), si risk financiar, ligjor dhe institucional.

Konkluzion :
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale aktualisht është **palë e paditur në 18 çështje gjyqësore** në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, me objekt **shpërblim dëmi jashtëkontraktor**, si pasojë e **mos furnizimit në kohë me faktorin VIII ose IX**, produkte mjekësore jetike për trajtimin e hemofilisë. Paditësit pretendojnë se vonesat ose mungesa e sigurimit dhe shpërndarjes së këtyre faktorëve nga Ministria e Shëndetësisë, QSUT apo struktura të tjera shëndetësore, kanë shkaktuar dëme të parandalueshme shëndetësore ndaj tyre, dhe kërkojnë kompensim financiar mbi bazën e **nenit 608 e vijues të Kodit Civil** që rregullojnë përgjegjësinë jashtëkontraktore.
Nga auditimi rezulton se këto padi përbëjnë një **risk për Ministrinë**, në aspektin **financiar** (për shkak të kostove të mundshme të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore), **ligjor** (për përgjegjësinë administrative dhe civile që mund të konstatohet nga gjykatat), si dhe **institucional**, në lidhje me besueshmërinë dhe detyrimet e shtetit për garantimin e aksesit në trajtim shëndetësor cilësor dhe në kohë.

- ✓ **Shpërblim dëmi jashtëkontraktor – Mjekim i pakujdesshëm**

Padia me objekt "Shpërblim dëmi jashtëkontraktor – Mjekim i pakujdesshëm" nënkupton që paditësi kërkon kompensim financiar për dëmin fizik, shëndetësor ose moral që pretendon të ketë pësuar si pasojë e mjekimit të pakujdesshëm ose të pasaktë nga një strukturë ose personel shëndetësor, pa ekzistuar një kontratë të drejtpërdrejtë mes palëve.
Çështje gjyqësore me palë paditëse (individë) dhe palë të paditura MSHMS**,** me objekt "Shpërblim dëmi jashtëkontraktor – Mjekim i pakujdesshëm" ne proces gjykimi janë si më poshtë:

1. Çështja gjyqësore me palë paditëse **K.R**;- pranuar pjesërisht nga Gj. A. Sh. P. Tiranë
2. Çështja gjyqësore me palë paditëse **R.Z**, në gjykim pranë Gj. A. Sh. P. Tiranë
3. Çështja gjyqësore me palë paditëse **J.Z** – Rrëzuar padia për MShMS nga Gj. A. Sh. P. Tiranë
4. Çështja gjyqësore me palë paditëse **E.P** - në gjykim pranë Gj. A. Sh. P. Tiranë
5. Çështja gjyqësore me palë paditëse **E.M** - në gjykim pranë Gj. A. Sh. P. Tiranë
6. Çështja gjyqësore me palë paditëse **L.R** - në gjykim pranë Gj. A. Sh. P. Tiranë
7. Çështja gjyqësore me palë paditëse **E.B** - në gjykim pranë Gj. A. Sh. P. Tiranë

8. Çështja gjyqësore me palë paditëse **S.B -** në gjykim pranë Gj. A. Sh. P. Tiranë
9. Çështja gjyqësore me palë paditëse **N.Z** – rrëzuar padia nga nga Gj. A. Sh. P. Lushnje
10. Çështja gjyqësore me palë paditëse **B.Q -** në gjykim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

Nga auditimi rezultoi se aktualisht janë në proces shqyrtimi gjyqësor **10 çështje** të iniciuara nga individë që kanë paditur institucionet e varësisë dhe **Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**, me objekt **"shpërblim dëmi jashtëkontraktor"**, si pasojë e **mjekimit të pakujdesshëm** në institucionet publike shëndetësore. Të gjitha këto çështje janë në trajtim pranë **Gjykatës Administrative**.

Sipas të dhënave të administruara, 7 padi janë ende në proces gjykimi, 2 janë rrëzuar nga gjykata e shkallës së parë, ndërsa 1 është pranuar pjesërisht. Pavarësisht se ndodhen në fazë gjykimi, këto çështje përbëjnë risk financiar të mundshëm për institucionin, për shkak të detyrimit të mundshëm për pagesë në rast të një vendimi gjyqësor negativ. Në këtë kuadër, mosnjohja dhe mosreflektimi i tyre në pasqyrat financiare si detyrime të mundshme, bie ndesh me parimet e kontabilitetit publik dhe kërkesat ligjore për raportimin e detyrimeve të njohura apo të mundshme. Kjo situatë vjen në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, të cilët kërkojnë që çdo detyrim i njohur apo i parashikueshëm të evidentohen në llogaritë përkatëse financiare për periudhën përkatëse.

- ✓ **Çështje gjyqësore në proces ndaj MSHMS dhe institucioneve vartëse.**

Nga auditimi rezultoi se janë në proces shqyrtimi **8 çështje gjyqësore Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë** me objekt të ndryshëm padish, ku palë paditëse janë individë apo subjekte juridike, ndërsa palë të paditura janë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ose institucione në varësi të saj.

Paditë përfshijnë: Paditë për shfuqizim vendimesh administrative **(p.sh. rimbursim i refuzuar ose masa nga FSDKSH);** Paditë për dëm moral ose financiar **(për diskriminim apo cenim të të drejtave);** Paditë për rimbursim shpenzimesh mjekësore ;Paditë për çështje pronësie/juridike **(lirim/dorëzim sendi, vendim i ATP-së), si me poshtë viojon:**

Lista e çështjeve sipas palëve paditëse:

1. **S.C** (IEVP Zaharia) **– në gjykim (e drejta** ndaj trajtimit shëndetësor ose dëm i pretenduar).
2. **D.L** – kërkesë për **rimbursim shpenzimesh** (gjykim administrativ).
3. **E.D** – **kundërshtim i vendimit të FSDKSh** për rimbursime recetash.
4. **K.N** – kërkesë për **shpërblim dëmi për diskriminim**.
5. **Shoqëria "K." shpk** – kërkesë për **lirim dhe dorëzim sendi** (gjykim civil).
6. **Familja B.** – **shfuqizim i vendimit të ATP** (gjykim civil).
7. **G.T. e të tjerë** – në gjykim për çështje administrative.
8. **E.** – në gjykim (natyra e padisë nuk specifikohet, por në juridiksion administrativ).

Nga auditimi rezulton se janë në proces gjykimi **8 çështje gjyqësore me padi** me objekt të ndryshme, ku palë paditëse janë individë apo subjekte private dhe palë të paditura Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ose institucionet në varësi të saj. Paditë përfshijnë kërkesa për rimbursim shpenzimesh, shpërblim dëmi për diskriminim apo mjekim të pakujdesshëm, shfuqizim vendimesh administrative, si dhe çështje pronësie.

Këto raste përbëjnë risk potencial ligjor dhe financiar për institucionin dhe kërkojnë jo vetëm ndjekje të vazhdueshme nga strukturat përkatëse në të gjitha shkallët e gjykimit për mbrojtjen e interesave të shtetit, por edhe vlerësim të ndikimit financiar të mundshëm.

- ✓ **Çështjeve gjyqësore me palë paditëse/shoqërinë "E." shpk.**

Aktualisht janë në proces disa çështje gjyqësore ku shoqëria **"**E." shpk figuron si palë paditëse ose palë e paditur, ndërsa palë të përfshira janë institucione të ndryshme shtetërore, përfshirë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale)**,** Shërbimin Social Shtetëror**,** Agjencinë e Zhvillimit të Territorit**,** Këshillin Kombëtar të Territorit**,** Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, dhe Këshillin e Ministrave.

Detajet e çështjeve janë si më poshtë:

- Padi për rivendosje në posedim dhe ekzekutim të vendimit për godinat (palë paditëse: "E." shpk; palë e paditur: Shërbimi Social Shtetëror; person i tretë: MShMS). Kjo padi është rrëzuar nga Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm, Shkalla e Parë Durrës.
- Padi për anulim/shfuqizim të Vendimit nr. 2, datë 28.12.2022 të Këshillit Kombëtar të Territorit. Palë paditëse: "E." shpk; palë të paditura: Agjencia e Zhvillimit të Territorit, KKT, Ministria e Financave dhe Ekonomisë; persona të tretë: MShMS dhe Shërbimi Social Shtetëror. Në gjykim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Padi për anulim/shfuqizim të VKM nr. 124 datë 01.03.2023 dhe Urdhrit të Përbashkët nr. 130 datë 06.03.2023 të MShMS dhe MFE. Palë paditëse: "E." shpk; palë të paditura: Këshilli i Ministrave, MSHMS dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Në gjykim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Padi nga MSHMS kundër shoqërisë "E." shpk për krijimin e servitutit kalimi. Në gjykim pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm të Shkallës së Parë Tiranë.

- ✓ **Çështjeve gjyqësore me palë paditëse Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**

Aktualisht janë në proces disa çështje gjyqësore ku **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** figuron si palë paditëse kundër disa shoqërive private për detyrimin e tyre për kthimin e shumave financiare, sipas gjetjeve të **Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH)**.

Detajet e çështjeve:

a. **MSHMS kundër "T." shpk, me** Objekti: Kthimi i një shume parash sipas konstatimit të KLSh. Gjykata e Shkallës së Parë në Tiranë rrëzoi padinë; çështja aktualisht është në apel.

2- **MSHMS kundër "2. K." shpk, me o**bjekt: Detyrimi për kthimin e shumës sipas konstatimit të KLSh. Çështja në proces gjykimi pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

3- **MSHMS kundër "C." shpk, me** Objekt: Detyrimi për kthimin e shumës sipas konstatimit të KLSh. Çështja në proces gjykimi pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

4- **MSHMS kundër "B." shpk, me o**bjekt: Detyrimi për kthimin e shumës sipas konstatimit të KLSh. Çështja në proces gjykimi pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Këto çështje pasqyrojnë përpjekjet ligjore të MSHMS për të siguruar kthimin e fondeve të konstatuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si të parregullta ose të pakthyeshme. Disa prej tyre janë ende në proces gjykimi, ndërsa një çështje është në fazë apelimi pas vendimit të shkallës së parë.

KONKLUZION:
Nga auditimi i kryer rezultoi se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet vartëse po përballen me një numër të konsiderueshëm çështjesh gjyqësore me natyrë të ndryshme ligjore dhe financiare. Këto procese përfshijnë paditë nga individë dhe subjekte private, si dhe paditë që lidhen me kthimin e fondeve sipas gjetjeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

2.3 Mbi prokurimet e fondeve publike.

Në zbatim të kësaj pike, grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin, si më poshtë:
- Vlerësimin e hartimit të nevojave për mallra, punë dhe shërbime nga subjekti i audituar;
- Regjistri i parashikimeve dhe realizimeve;
- Argumentimin dhe përllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, sipas nevojave konkrete për mallra dhe shërbime;
- Realizimin e procedurave të prokurimit, që nga momenti i nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, deri në lidhjen e kontratës;
- Lidhjen dhe zbatimin e kontratave, deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve;
- Dokumentacion të vënë në dispozicion nga MSHMS-ja ose institucione spitalore të varësisë.

Nga auditimi u konstatua se Regjistri i realizimeve nuk është i plotë, duke mos pasqyruar të gjithë procedurat e prokurimit të realizuara, si procedurat e prokurimit të realizuara nga organet qendrore blerëse për llogari të MSHMS-së dhe një pjesë e procedurave të prokurimit të realizuara nga vetë MSHMS-ja si organ qendror blerës. Shkaku për mospasqyrimin në Regjistrin e realizimit të procedurave të prokurimit të kryera nga MSHMS-ja si organ qendror blerës, është mungesa e përfundimit të procedurës në SPE në fazën "*Njoftim i lidhjes së kontratës*" nga institucionet spitalore të varësisë/ Autoritetet Kontraktore përfituese, duke sjellë që procedura e prokurimit të mos arkivohet e rrjedhimisht të mos pasqyrohet automatikisht në Regjistrin e realizimit.
Sa i përket Regjistrave të realizimit për vitet 2023-2024, rezulton, si më poshtë:

Viti	Lloji i Procedurës	Nr.	Fondi Limit	Vlera e Kont. (pa TVSH)	Dif.
2023	Procedurë e hapur	3	682,332,351.39	426,965,780.20	255,366,571.19
2023	Procedurë e hapur e thjeshtuar	2	9,465,413.22	4,666,880.12	4,798,533.10
2023	Procedurë e hapur ndërkombëtare	-	-	-	-
2023	Blerje e vogël + bileta	17	11,304,640.63	3,523,653	7,780,987.63
Shuma 1		**22**	**703,102,405.24**	**435,156,313.32**	**267,946,091.92**
2024	Procedurë e hapur	-	-	-	-
2024	Procedurë e hapur e thjeshtuar	-	-	-	-
2024	Procedurë e hapur ndërk.	4	13,853,203,764.6	-	n/a
2024	Blerje e vogël + bileta	23	15,285,455.6	6,934,173.2	
Shuma 2		**27**	**13,862,252,947.6**	**10,695,048.20**[14]	**n/a**
Total		**49**	**14,565,355,352.84**	**435,851,361.52**	**n/a**

Në aktivitetin e MSHMS-së, sa i përket procedurave të prokurimit publik, përfshihen 3 tipologji procedurash, përkatësisht:

1. Procedura prokurimi ku MSHMS-ja është Autoritet Kontraktor, realizon procedurën e prokurimit publik, nënshkruan kontratën dhe monitoron zbatimin e saj;
2. Procedura prokurimi të kryera nga organet qendrore blerëse (ABP/ ASHPP, AKSHI) për llogari të MSHMS-së si Autoritet Kontraktor përfitues, ku procedura e prokurimit kryhet nga OQB dhe zbatimi i kontratës ndiqet dhe likuidohet nga MSHMS-ja;
3. Procedura prokurimi të përqendruara të kryera nga MSHMS-ja si organ qendror blerës, ku Autoritete Kontraktore përfituese konsiderohen institucionet spitalore të varësisë, të cilët lidhin kontratat, monitorojnë zbatimin e tyre dhe kryejnë likuidimet përkatëse.

Nisur nga diferencat e procedurave të parashikuara (referuar Regjistrave të parashikimit) me procedurat e realizuara (referuar Regjistrave të realizimit), grupi i auditimit ka kërkuar informacion

[14] Pa përfshirë procedurat "E hapur ndërkombëtare", pasi vlerat e kontratave nuk pasqyrohen në Regjistrin e realizimeve.

të plotë lidhur me procedurat e prokurimit të MSHMS-së, duke përfshirë të trija tipologjitë e sipërpërmendura. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga MSHMS-ja lidhur me procedurat e kryera nga MSHMS "E hapur" dhe "E hapur ndërkombëtare"[15], ka rezultuar se:

	2023				2024			
	Nr.	**Fondi limit**	**Oferta**	**Diferenca**	**Nr.**	**Fondi limit**	**Oferta**	**Diferenca**
Mbi kufirin e ulët – nën kufirin e lartë	6	689,193,861	578,446,646.1	110,747,215	1	9,896,867	5,823,160	4,003,504
E hapur ndërkombëtare	1[16]	50,043,800	46,040,296	4,003,504	5	9,200,468,533.6	7,262,446,904.3	1,938,021,629.2
Totali	**7**	**739,237,661**	**624,486,942**	**114,750,719**	**6**	**9,210,365,401**	**7,268,270,064**	**1,942,025,133**
Anuluar	*4*	*1,236,019,431.9*[17]			*4*	*165,149,217*[18]		

Grupi i auditimit të KLSH-së ka audituar 7 procedura prokurimi për periudhën objekt auditimi, të përzgjedhura, si më poshtë:

Viti	nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Proc. Prok.	Vlera e kont. pa TVSH	OE fitues	Koment
2023	**1**	F.V Pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore	14,750,000	E hapur	13,249,450	T.	
	2	Ndërtim i godinës së re të laboratorëve në ISHP	384988709.39	E hapur	342,831,733.2	A. C.	
	3	Rikonstruksion i Qendrave Shëndetësore v. 2023 – 2024	282,593,642	E hapur	70,884,597	C. R.	
					57,625,120.80	I.	
					47,348,847	C .	
					40,444,769.66	2. K.	
2024	**1**	B1 – Blerje barna	2,699,242,763	Open INT	1,929,725,170	Në total 79 lot-e. Nuk janë realizuar vetëm 8 lot-e me fond 122,385,222.8 lek pa TVSH dhe 1 lot nuk ka përfunduar brenda periudhës së auditimit.	Grupi i auditimit ka përzgjedhur për auditim 14 lot-e, që përkojnë me rreth 55% të vlerës totale të kontraktuar.
	2	B2 – Blerje barna	2,446,331,243	Open INT	1,450,120,902	Në total 68 lot-e. Nuk janë realizuar vetëm 4 lot-e me fond 15,075,817 lek pa TVSH	Grupi i auditimit ka përzgjedhur për auditim 21 lot-e, që përkojnë me rreth 65 % e vlerës totale. të kontraktuar
	3	B3 – Blerje barna	3,710,275,350	Open INT	3,281,833,035	Në total 109 lot-e. Nuk janë realizuar vetëm 9 lot-e me fond 65,365,188 lek pa TVSH.	Grupi i auditimit ka përzgjedhur për auditim 15 lot-e, që përkojnë me rreth 49% të vlerës

[15] (*) pa përfshirë procedurat e ABP/ ASHPP, blerjet e vogla dhe blerjet e biletave.
[16] "Ngritja e modulit shtesë për kontrollin dhe menaxhimin e rastit në kuadër të projektit PAK nga BB" – procedurë e zhvilluar nga AKSHI
[17] Vlera sipas parashikimit në Regjistrin e parashikimeve 2023.
[18] Vlera sipas parashikimit në Regjistrin e parashikimeve 2024.

							totale të kontraktuar.
	4	Blerje pajisje të teknologjisë së lartë për spitalet	259,380,867	Open INT		E ndarë në 10 lot-e, nga të cilat për 7 lot-e është realizuar procedura e prokurimit brenda periudhës së auditimit.	Grupi i auditimit ka përzgjedhur për auditim 2 lot-e, që përkojnë me rreth 60% të vlerës totale limit të përllogaritur për 7 lot-et e realizuar brenda periudhës së auditimit

Mbi procedurën e prokurimit të përqendruar për furnizim me barna të institucioneve spitalore të varësisë

Procesi i planifikimit të barnave që do të përfshihen në procedurën e prokurimit të përqendruar është iniciuar me Urdhër të titullarit të institucionit, ku është përcaktuar grupi i punës, ndarja e detyrave dhe hapat që do të ndiqen për të konkluduar me listën përfundimtare të barnave që do të prokurohen.

MSHMS-ja nuk ka miratuar një procedurë të shkruar dhe gjurmën e auditimit, mbi procesin e planifikimit të barnave që do të përfshihen në prokurimin e përqendruar për nevoja të spitaleve publike, për të garantuar uniformitetin në kryerjen e procedurës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, afatet, duke dhënë dhe një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij, nisur nga rëndësia që mbart dhe numri i lartë i institucioneve spitalore të varësisë që përfshihen, në kundërshtim me nenin 22, pika 1, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" dhe pikën 3.3 "Aktivitetet e kontrollit" të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Në prokurimin e përqendruar të barnave spitalore përfshihen të gjithë kategoritë e spitaleve publike në Republikën e Shqipërisë, si më poshtë:

- **Spitalet Terciare** (ku përfshihen QSUNT, SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë", SUOGJ "Koço Gliozheni", SU i Traumës, QSU "Shefqet Ndroqi" i cili përfshin edhe spitalin e Kavajës);
- **Spitalet Rajonale** (QSR Berat (përfshin edhe Kuçovën), Durrës, Dibër, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Korçë, Kukës, Lezhë, Vlorë, Shkodër, Spitali Memorial Fier;
- **Spitalet bashkiake dhe ditore** (Bulqizë, Pukë, Mirditë, Malësi e Madhe; Tropojë, Has; Kurbin; Mat; Librazhd; Pogradec; Krujë; Peqin; Lushnje; Kuçovë; Mallakastër; Kolonjë; Devoll; Gramsh; Skrapar; Tepelenë; Përmet; Delvinë; Sarandë);
- **Spitalet Psikiatrike** (Vlorë, Elbasan, Shkodër).

Procedura që ndiqet nga MSHMS-ja për planifikimin e barnave që do të përfshihen në prokurimin e përqendruar për nevojat 24-mujore të spitaleve publike, iniciohet me ngritjen e grupit të punës nga titullari i institucionit, ku përcaktohen anëtarët e grupit të punës, ndër detyrat e të cilit listohen, si më poshtë:

1- *Të shqyrtojë specifikimet teknike, të dërguara nga autoritetet kontraktore*. Nëse vlerëson se specifikimet teknike nuk janë përgatitur në përputhje me LPP-në ose mund të shkaktojnë dështim të procedurës së prokurimit, kryen rishikimin dhe modifikimin e tyre dhe njofton për këtë autoritetin kontraktor, i cili duhet të konfirmojë, nëse specifikimet e rishikuara/ modifikuara përmbushin qëllimin për të cilin nevojitet objekti i prokurimit i kërkuar. Kur është e nevojshme, të bashkërendojë punën me ekspertë të fushës të institucioneve përgjegjëse, për unifikimin e specifikimeve teknike, në përputhje me standardet e përcaktuara nga legjislacioni i aplikueshëm për barnat në vendin tonë.

2- Bazuar në kërkesat e shërbimeve të institucioneve spitalore, pas rishikimit, *të përgatisë listën emërore të unifikuar të barnave për përdorim spitalor* me emërtimet, principin aktiv, formë dozën, njësinë, sistemin dhe specifikimet teknike përkatëse.
3- Bazuar në planifikimin e nevojave të depozituara sipas përcaktimeve të këtij Urdhri, *të hartojë listën emërore të unifikuar të barnave për përdorim spitalor në spitalet publike*, e cila do të prokurohet në mënyrë të përqendruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,. Kjo listë duhet të përmbajë:
a) Listën emërore me principet aktive dhe formë-dozat e barnave, me kategorizimet e mëposhtme:
- Listën emërore me principet aktive dhe formë-dozat e barnave të pajisur me Autorizim për Tregtim në vendin tonë/territorin e Republikës së Shqipërisë;
- Listën emërore me principet aktive dhe formë-dozat e barnave që nuk janë të pajisur me Autorizim për Tregtim në vendin tonë/territorin e Republikës së Shqipërisë.

b) Sasitë e parashikuara përkatëse dhe detajimin sasior për çdo spital si sasi referuese vjetore dhe 24 mujore.
c) Çmimi/njësi pa TVSH dhe vlerën e pritshme të kontratave për çdo bar të detajuar sipas institucioneve përfituese dhe në total për të gjitha institucionet spitalore;
ç) Specifikimet teknike përfshirë afatet e skadencës;
d) Afatet e parashikuara të lëvrimit;
dh) Ndarjen në lot-e.
e) Të gjitha materialet shkresore dhe elektronike të dërguara nga institucionet spitalore, si dhe ato të përdorura për llogaritjen e fondit limit.
Me ngritjen e Urdhrit nga titullari i institucionit, Drejtoria e Politikave të Shërbimit Spitalor, Sektori i Administrimit harton shkresën drejtuar spitaleve publike, me qëllim që këto të fundit të nisin procesin e planifikimit dhe ta dërgojnë atë sipas formatit në afatet kohorë të përcaktuara. Pasi të gjitha strukturat spitalore dërgojnë planifikimin paraprak, kërkesat hidhen në një databazë *excel*. Grupi i punës punon manualisht për t'i unifikuar kërkesat, rishikon çmimet për njësi sipas Regjistrit të Barnave të fundit në fuqi, rishikon formë-dozat, si dhe bën rregullimet përkatëse në rast lapsusesh. *Të gjitha këto janë procese manuale* të grupit të punës, që, përpos punës voluminoze për përpunimin e kërkesave nga institucionet spitalore të varësisë, mbartin riskun e gabimeve materiale.
Pasi vendosen çmimet për njësi për çdo bar, lista u ridërgohet spitaleve për konfirmim ose rishikim të sasive, me kushtin që të jenë të mbuluara nga ana buxhetore. Pasi spitalet konfirmojnë sasitë, grupi i punës edhe një herë rishikon listën dhe përgatit relacionin për titullarin, ku relaton secilën nga detyrat e lëna në urdhrin e ngritjes së grupit të punës për këtë qëllim. Relacioni dorëzohet në protokoll bashkë me dosjen përkatëse duke finalizuar një listë barnash për prokurim, me fond limit dhe me shpërndarje sipas kërkesave të secilit spital.
Grupi i auditimit ka kërkuar përcaktimin dhe evidentimin e *aktiviteteve të kontrollit* që aplikon MSHMS-ja (nëpërmjet Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Spitalor dhe/ ose Komisionit për planifikimin e barnave dhe/ ose njësi tjetër brenda/ në varësi të MSHMS-së), lidhur me planifikimin e kryer nga vetë spitalet, për barnat dhe sasitë përkatëse të kërkuara, për të garantuar planifikim efektiv sa i përket disponibilitetit dhe mbulimit të nevojave për barna në spitale publike. Në këtë linjë, grupi i auditimit ka kërkuar informacion dhe dokumentacion mbështetës, lidhur me të dhënat e disponuara nga DPZHS-ja (ose njësi tjetër në MSHMS), për institucionet spitalore të varësisë, si më poshtë:

a. (*i*) konsumin mesatar të barnave, (*ii*) sëmundshmërinë e mbuluar nga spitale dhe diagnozat më frekuente, (*iii*) numrin e shtrimeve vjetore dhe sipas ngarkesës sezonale dhe pritshmëritë bazuar në këtë trend;
b. nivelin e realizimit të kontratave të lidhura bazuar në MK të vitit 2022 (*në zbatim përgjatë viteve 2023-2024, që paraprijnë planifikimin për MK-të e vitit 2024*), sa i përket sasive të kërkuara në planifikim, në raport me sasitë e kërkuara për furnizim/ sasitë e përdorura/ sasitë stok, për secilin spital dhe në total.
MSHMS-ja udhëzon spitalet që planifikimi të bazohet në të dhëna lidhur me gjendjen faktike të barnave, sasitë që janë ende për t'u kontraktuar në zbatim të MK-ve në fuqi, konsumin mesatar mujor, sëmundshmërinë e mbuluar nga spitali, numrin e shtrimeve vjetore dhe sipas ngarkesës sezonale, prioritetet sipas shërbimeve dhe peshës specifike që zë secili prej tyre kundrejt totalit, barnat që përdoren më shpesh dhe kanë kosto specifike ndaj totalit, barna të kërkuara si risi apo domosdoshmëri jashtë listave të miratuara, si dhe çdo e dhënë tjetër mbi pritshmërinë dhe propozime për pasurimin, përditësimin dhe përmirësimin e listave ekzistuese, për të minimizuar nevojat për artikuj të rinj përgjatë viteve të shtrirjes së MK-ve.
Gjithashtu, nga MSHMS-ja jepen orientimet, si më poshtë:
- Për barnat të cilat kërkohen vazhdimisht por nuk realizohet procedura, spitalet udhëzohen të bashkëveprojnë me shërbimet që i kërkojnë, për të vlerësuar mundësinë e zëvendësimit me barna alternative pa prekur efektin terapeutik të pritshëm, bazuar në skemat bashkëkohore të trajtimit, në mënyrë që të mos ngurtësohen fiktivisht fonde të cilat mund të shfrytëzohen më me eficiencë për sigurimin e barnave të tjera. Pas kësaj analize, të qëndrojnë në listë për planifikim vetëm ato barna për të cilat nuk ka alternativa të vlefshme, pa prekur shërbimin.
- Spitalet udhëzohen që planifikimi i nevojave duhet të ezaurojë kërkesat dy vjeçare (24 mujore) për barna, përllogaritja e tyre duhet të jetë sa më e plotë dhe gjithëpërfshirëse, me qëllim shmangien e situatave kur dalin nevoja të reja, për të njëjtin objekt, të papërfshira në marrëveshjen kuadër.
- Spitalet udhëzohen të mbështeten në listat sipas marrëveshjeve kuadër aktuale si edhe çmimet/ njësi të këtyre MK, apo kontratave të lidhura nga vetë spitalet për procedurat e deleguara dhe të kryera nga vetë ato.
- Në rast të propozimeve për barna të reja ose për saktësimin e formë dozave, së bashku me argumentimin e detajuar nga shërbimi përkatës për domosdoshmërinë e tyre, spitalet udhëzohen t'i planifikojnë këto barna në një listë të veçantë bashkë me parashikimin sasior, specifikimet teknike dhe vlerën limit përkatëse.
- Spitalet udhëzohen të përfshijnë të gjitha strukturat që gjenerojnë të dhënat, menaxhojnë burimet financiare dhe strukturat që japin shërbimin, përmes grupeve të punës që çdo spital do të krijojë, dhe produkti final shoqëruar me relacionin argumentues të jetë i firmosur nga të gjithë anëtarët e grupeve të punës, si dhe nga titullari i autoritetit kontraktor.
Nga MSHMS-ja nuk është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion që vërteton kryerjen e verifikimeve përkatëse nëse kërkesat e spitaleve u janë përmbajtur udhëzimeve të dërguara, përfaqësojnë nevojat reale të tyre dhe janë në përputhje me aktivitetet e spitaleve.

Rishikimet e grupit të punës në kërkesat që vijnë nga spitalet për të konsoliduar listën përfundimtare të barnave konsistojnë në (i) konsultimin e listës së barnave të kërkuara me regjistrin e përditësuar të barnave, me qëllim evidentimin paraprak të statusit të tyre, (ii) verifikimin dhe saktësimin sipas rastit të specifikimeve teknike që kanë të bëjnë me principin aktiv, formë-dozën dhe njësinë.

Përllogaritja e fondit limit për secilin bar/ lot, nga Komisioni i planifikimit të barnave, *për të përcaktuar vlerën e pritshme të kontratave*, të detajuar sipas institucioneve spitalore përfituese dhe në total, realizohet, si më poshtë:

1. Për barnat e listës aktuale për përdorim spitalor të regjistruara (të autorizuara për tregtim) – Për barnat e regjistruara, të autorizuara për tregtim (sipas regjistrit të përditësuar te barnave) në vendin tonë, bazuar në çmimet CIF/EXË 2024, të miratuara nga Komisioni i Çmimit të Barnave, është përllogaritur çmimi mesatar për njësi i alternativave për çdo bar. Çmimi CIF/njësi (për barnat e importit), është konvertuar në valutën lek (ALL), sipas kursit mesatar të këmbimit, njoftuar nga Banka e Shqipërisë nëpërmjet shkresës për 6 mujorin e dytë 2023.

2. Për barnat e paregjistruara (të paautorizuara për tregtim) – Për barnat e paregjistruara (të paautorizuara për tregtim) në vendin tonë, përllogaritet çmimi mesatar/njësi, nga autorizimet e importit për barna të paautorizuara, lëshuar gjatë viteve 2021-2022-2023 duke përfshirë edhe autorizimet e importit të lëshuara për barna të paautorizuara gjatë periudhës janar-shkurt 2024.

3. Për barnat të cilat që në momentin e planifikimit nuk kanë çmim të miratuar për vitin 2024 është marrë në referencë për fondin limit çmimi më i fundit i miratuar – Mbi çmimin mesatar/njësi të barnave (të autorizuara dhe të paautorizuara) llogaritur si me sipër, janë aplikuar marzhet e tregtimit, në përputhje me përcaktimet e VKM-së nr. 143, datë 18.02.2015 "*Për përcaktimin e marzheve të tregtimit dhe fabrikimit të barnave*".

Pavarësisht rëndësisë që ky proces ka mbi garantimin e përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe detyrave funksionale të MSHMS-së në ofrimin e kujdesit shëndetësor nëpërmjet spitaleve publike, Drejtoria e Auditit të Brendshëm pranë MSHMS-së nuk rezulton të ketë planifikuar dhe/ ose kryer angazhime auditimi, për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e menaxhimit të riskut, kontrollit dhe hallkave të procesit, me qëllim që t'i ofrojë ministrit përgjegjës për shëndetësinë informacion lidhur me efikasitetin dhe përputhshmërinë e procedurës së ndjekur për planifikimin e barnave për nevoja spitalore.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, sa i përket planifikimit të barnave që do të prokurohen për llogari të spitaleve publike për mbulimin e nevojave 24-mujore (2024-2026), u konstatua se:

Planifikimi fillestar (B1 & B2)

Nëpërmjet Urdhrit nr. 716, nr. 4446 prot., datë 07.12.2023, Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS-së S. H. ka ngritur grupin e punës për rishikimin e listës së barnave për përdorim spitalor, përllogaritjen e vlerës së pritshme të kontratave dhe përcaktimin e mënyrës dhe afateve që do të ndiqen për zhvillimin e procedurave të përqendruara të prokurimit publik për barna për llogari të spitaleve publike për mbulimin e nevojave 24-mujore, nga organi qendror blerës MSHMS. Grupi i punës i përcaktuar përbëhet nga N. A. (anëtar/ ekonomist), E. B.(anëtar/ farmacist), E. T. (anëtar/ mjek). Nëpërmjet Urdhrit nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024, përbërja e grupit u ndryshua, duke zëvendësuar anëtaren E. T. me F. B. (kryetar/ mjek).

Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS-së S. H. i dërgon Sektorit të Prokurimeve shkresën nr. 748/4 prot., datë 19.04.2024 mbi prokurimin e nevojave 24-mujore për barna pas përfundimit të MK të vitit 2022, duke bashkëlidhur (i) të dhënat teknike dhe sasiore, si dhe vlerën limit të pritshme të përllogaritur për mbulimin e nevojave dhe (ii) procesverbalin e grupit të punës dhe dokumentet mbështetëse mbi procesin.

Në listat e përgatitura nga grupi i punës, bashkëlidhur këtij relacioni, rezultojnë në total 244 barna (lot-e), me vlerë limit të parashikuar **9,877,311,981 lekë pa TVSH**.

Rishikimi i planifikimit (krijimi i B3)

Nëpërmjet shkresës nr. 748/5 prot., datë 27.05.2024, Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS-së S. H. i dërgon Sektorit të Prokurimeve saktësimin e materialit të grupit të punës për prokurimin e nevojave 24-mujore për barna, ku citohet se "*grupi i punës është vënë në dijeni mbi një lapsus të bërë në pasqyrimin e sasive të planifikuara nga Spitali "Koço Gliozheni"... pasi verifikuam sasitë e planifikuara, konstatuam se në momentin e përfshirjes së planifikimit të këtij spitali në tabelën e përgjithshme, është bërë një spostim i sasive një rresht më poshtë, duke afektuar sasitë përkatëse për barnat vijuese, për të cilat bëmë saktësimet...Barnat e mëposhtme të parashikuara si risi për trajtimin e një numri pacientësh nga QSUT, si dhe barnat e tjera të kërkuara nga disa prej shërbimeve pranë QSUT dhe QSR "Shefqet Ndroqi", meqenëse vlera limit është mbi kufirin e blerjes së vogël, i shtohen listës së barnave që do të prokurohen në mënyrë të përqendruar*".
Pas reflektimit të ndryshimeve të sipërpërmendura, vlera limit e parashikuar për 24 muaj për barnat për prokurimin e përqendruar bëhet nga 9,877,311,981 lekë pa TVSH në **8,855,849,351 lekë pa TVSH**, sipas sistemeve, të radhitura sipas vlerës totale të kontraktuar (nga vlera më e lartë te vlera më e ulët), si më poshtë:

Nr.	Sistemi	Nr. i barnave (lot-eve)	Sasia (totale) e barnave e kërkuar (*bar x sasi*)	Fondi limit (lekë pa TVSH)	Vlerë e kontraktuar (lekë pa TVSH)	Lot-e të pasuksesshëm	Vlera limit e lot-eve të pasuksesshëm
1	**Gjaku dhe organet formuese të gjakut**	50	24,272,994	2,810,178,196	2,620,608,622	3	16,730,457
2	**Antineoplastike & Immunomodulatore**	49	273,817	2,210,747,057	1,617,724,365	3	107,198,440
3	**Anti-infektivë të përgjithshëm**	43	5,535,629	1,606,028,100	752,894,000	2	10,365,726
4	**Metabolizmi dhe trakti tretës**	20	6,861,181	634,810,033	391,716,510	-	
5	**Sistemi nervor**	23	3,807,367	372,977,695	328,926,258	1	2,123,395
6	**Hormone sistemike, hormonet seksuale**	8	2,071,254	259,603,656	256,241,172	2	3,006,225
7	**Anestezi reanimacion**	6	140,151	224,890,380	186,880,956	2	10,617,609
8	**Lëndë kontrasti për CT**	5	76,272	298,565,255	158,379,990	1	99,905,396
9	**Sistemi kardiovaskular**	19	3,448,814	158,188,192	143,105,165	3	6,768,543
10	**Sistemi muskulo-skeletik**	11	1,122,876	151,773,949	94,654,737	1	5,983,809
11	**Dermatologjike**	4	70,660	45,878,093	44,801,649	-	
12	**Lëndë kontrasti për MRI**	2	12,970	32,688,969	26,015,879	-	
13	**Sistemi respirator**	7	261,666	24,991,895	18,259,628	2	4,570,655
14	**Psikiatrik**	5	346,022	14,176,055	11,520,267	1	1,722,811
15	**Organet e shqisave**	1	2,925	4,431,048	4,422,600	-	
16	**Antiparazitare**	1	8,465	2,442,461	2,065,460	-	
17	**Lëndë kontrasti gastrointestinale**	1	2,650	1,948,348	1,947,750	-	
18	**Antituberkulare**	1	309	1,529,969	1,514,100	-	
TOTALI		**256**	**48,316,022**	**8,855,849,351**	**6,661,679,108**	21	**268,993,066**

Analizimi i të dhënave nga procedura e prokurimit të përqendruar për furnizim me barna të spitaleve publike

Nga analiza e të dhënave të vëna në dispozicion nga MSHMS lidhur me procedurën e prokurimit të përqendruar për furnizim me barna për nevoja të spitaleve publike, e ndarë në 256 lot-e, ka rezultuar se:
20 nga 256 lot-e nuk kanë patur ofertë/ ofertë të suksesshme, dhe 1 lot nuk është realizuar brenda periudhës së auditimit (ankesa në KPP, etj.), pra në total ka patur 235 lot-e të realizuara brenda

periudhës së auditimit. Për lot-et që nuk kanë patur ofertë/ ofertë të suksesshme, MSHMS si organ qendror blerës e delegon kryerjen e procedurës në spitalet përkatëse, të cilët më tej orientohen të vijojnë me kryerjen e procedurave të prokurimit për garantimin e disponibilitetit të këtyre barnave. Në 173 lot-e (rreth 74% të 235 lot-eve të realizuar), ka patur vetëm 1 ofertues të kualifikuar. Në 160 lot-e (rreth 68% të lot-eve të realizuar), diferenca e ofertës fituese me fondin limit ka qenë më e vogël/ e barabartë me 5%, ndër të cilët 146 lot-e (rreth 62%) përkojnë me 99-100% e fondit limit. Nga auditimi u konstatua se, diferencat më të larta me fondin limit rezultojnë në procedurat e prokurimit me konkurrencë, pra ku ka disa operatorë që disponojnë autorizim tregtimi mbi një bar me princip aktiv dhe formë-dozë të caktuar. Në këto raste, janë konstatuar diferenca me fondin limit (deri në 91% më pak se fondi limit), ku vazhdimisht operatorët ekonomikë kanë argumentuar ofertën "*anomalisht të ulët*" duke dokumentuar korrespondencën me mbajtësit e autorizimit për tregtim/ kompanitë prodhuese, të cilët kanë ofruar çmim preferencial për të siguruar ofertën më të mirë ekonomike.

Sa i përket Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë në procedurat e prokurimit për furnizim me barna, nga auditimi u konstatua se, nga 235 lot-e të suksesshme, në 34 prej tyre, fituesi i shpallur ka qenë bashkim operatorësh ekonomikë. Nga këto 34 lot-e, në 31 prej tyre, me fond limit 2,019,494,945 lekë pa TVSH, oferta e paraqitur nga BOE ka qenë 0-5% diferencë me fondin limit të përcaktuar, në vlerën totale limit të kontraktuar prej 2,001,818,398 lekë pa TVSH. Nga këto, 28 raste janë shpallur fitues me diferencë 0-1% të fondit limit, ku vetëm në 1 rast ka patur 2 ofertues pjesëmarrës dhe në 27 rastet e tjera BOE ka qenë ofertuesi i vetëm. Kjo vlerë përbën rreth 30% të vlerës totale limit të kontraktuar për 235 lot-e prej 6,661,679,106 lekë pa TVSH.

Procedurat e përqendruara të prokurimit publik për barna për llogari të spitaleve publike për mbulimin e nevojave 24-mujore

Nga auditimi bazuar në dokumentacionin e gjeneruar në SPE dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion nga MSHMS-ja u konstatua se:

I. "*B1 – Blerje barna sistemet Anestezi reanimacion, Anti tuberkulare, Antineoplastike dhe imunomodulatore, Barna antiparazitare, Barna dermatologjike, Barna hormonale sistemike, Lëndë kontrasti për CT, Lëndë kontrasti për MRI, Lëndë kontrasti gastrointestinale, Metabolizmi dhe trakti tretës, Organet e shqisave, Psikiatria, Sistemi kardiovaskular*", ndarë në 79 lot-e, me fond limit total të përllogaritur 2,699,242,763 lekë pa TVSH[19].

Në këtë procedurë prokurimi janë prokuruar barna, të ndarë sipas sistemeve, si më poshtë:

Nr.	Sistemi	Nr. i barnave (lot-eve)	Sasia (totale) e barnave e kërkuar	Fondi limit (lekë pa TVSH)	Vlerë e kontraktuar (lekë pa TVSH)	Lot-e të pasuksesshëm	Vlera limit e lot-eve të pasuksesshëm
1	Antineoplastike & immunomodulatore	44	266,993	1,984,996,661	1,415,315,185	3	107,198,440
2	Lëndë kontrasti për CT	5	76,272	298,565,255	158,379,990	1	99,905,396
3	Anestezi reanimacion	6	140,151	224,890,380	186,880,956	2	10,617,609
4	Metabolizmi dhe trakti tretës	7	1,726,532	116,798,650	108,092,062	-	
5	Lëndë kontrasti për MRI	2	12,970	32,688,969	26,015,879	-	

[19] *Fillimisht është iniciuar për 115 Lot-e, me fond limit total të përllogaritur 3,660,634,272 lekë pa TVSH, por pas anulimit të procedurës së prokurimit për 36 lot-e, praktikisht procedura B1 është zhvilluar për 79 lot-e, me fond limit total të përcaktuar 2,699,242,763 lekë pa TVSH. Lot-et e anuluara janë përfshirë në procedurën B3*.

6	Sistemi kardiovaskular	6	383,484	14,686,686	11,388,415	2	3,009,534
7	Psikiatria	4	340,522	12,453,244	11,520,267	-	
8	Hormonale sistemike, hormone seksuale	2	40,814	5,759,440	4,130,256	1	1,559,640
9	Organet e shqisave	1	2,925	4,431,048	4,422,600	-	
10	Antiparazitare	1	8,465	2,442,461	2,065,460	-	
11	Antituberkulare	1	309	1,529,969	1,514,100	-	
TOTALI		**79**	**2,999,437**	**2,699,242,763**	**1,929,725,170**	**9**	**222,290,619**

Nëpërmjet Urdhrit të Prokurimit nr. 237, datë 25.04.2024, Titullari i AK S. H. ka kërkuar kryerjen e procedurës së prokurimit me fond limit/ vlerë të përgjithshme të kontratave në total prej 3,660,634,272 lekë pa TVSH, e ndarë në 115 Lot-e, duke përcaktuar njësinë e prokurimit, të përbërë nga A. P. (*anëtar, person përgjegjës për prokurimin*), E. B. (*anëtar, specialist fushe*), E. L. (*anëtar, person përgjegjës për prokurimin*), L. A. (*anëtar, person përgjegjës për prokurimin*), E. M. (*anëtar*).

Në kriteret e veçanta të kualifikimit, Njësia e prokurimit nuk ka kërkuar që OE të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar vijimin e marrëdhënies së punës me *Drejtuesin teknik të tregtuesit farmaceutik me shumicë*, sipas përcaktimit në nenin 29 të Ligjit nr. 105/2014 "*Për barnat dhe shërbimin farmaceutik*", i ndryshuar. Ky dokumentacion është i nevojshëm, pasi drejtuesi teknik i tregtuesit farmaceutik është përgjegjës për të gjithë veprimtarinë teknike dhe profesionale që zhvillon tregtuesi me shumicë.

Titullari i AK S. H. ka miratuar Formularin nr. 1989/4 prot., datë 28.05.2024, për njoftimin e anulimit të procedurës së prokurimit për 36 Lot-e, sikurse cituar "*për gabime materiale në të dhënat e lot-eve*", në vlerë të fondit limit të përcaktuar 961,391,509 lekë pa TVSH. *Për sa më sipër, praktikisht procedura e prokurimit B1 ka vijuar e ndarë në 79 Lot-e, me fond limit total të përllogaritur prej 2,699,242,763 lekë pa TVSH*. Barnat sipas 36 lot-eve të anuluar janë përfshirë në procedurën e prokurimit B3.

Nëpërmjet Urdhrit nr. 237/1, datë 25.04.2024, Titullari i AK ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, të përbërë nga M. Sh. (kryetar), M. K. (specialist fushe), E. H., anëtarë.

Grupi i auditimit ka përzgjedhur për auditim 14 Lot-e, bazuar në çmimin më të lartë për njësi të barit dhe/ ose vlerën më të lartë të kontraktuar dhe/ ose diferencën më të madhe me fondin limit dhe/ ose indicie për problematika lidhur me disponibilitetin e barnave nga burime të hapura (media, etj.). Nga vlera totale e kontraktuar për B1 prej 1,929,725,171, vlera e kontraktuar për Lot-et e përzgjedhur për auditim është 1,051,617,900 lekë pa TVSH, ose rreth 55% e vlerës totale. Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga MSHMS-ja ka rezultuar se:

1. **Lot 6 "*Trastuzumab Biosimilar ose origjinator 150 mg Flakon*" me nr. REF-03265-05-02-2024, me fond limit 349,502,453 lekë pa TVSH, për sasinë 10,840 flakonë**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt*: Lot 6 "Trastuzumab Biosimilar ose origjinator 150 mg Flakon" me nr. REF-03265-05-02-2024*		
1. **Urdhër Prokurimi** nr. 237, datë 25.04.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 237, datë 25.04.2024 A. P. E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 237/1, datë 25.04.2024 M. Sh. (kryetar); M. K. (specialist fushe); E. H., anëtar
4. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur mbi kufirin e lartë monetar"	**Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit** Urdhër nr. 716, nr. 4446 prot., datë 07.12.2023, ndryshuar nëpërmjet Urdhrit nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024 N. A., E. B. (farmacist), E. T. (mjek). Pas ndryshimit zëvendësohet E. T.me F. B. (mjek).	

5. Fondi Limit: 349,502,453 lekë pa TVSH	**6. Oferta fituese:**" BOE "M." dhe "E.-F.", me vlerë 244,550,400 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit:** 105,052,053 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: 03.05.2024	**9. Burimi i Financimit:** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 2 OE+BOE b) Skualifikuar: - c) Kualifikuar: 2 OE
11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër Nr. 1989/53 Prot., date 30.07.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 244,550,400 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 6 është kërkuar sasia totale prej 10,840, me shpërndarje, si më poshtë:

Nr.	Spitali	Sasia
1	Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"	10,000
2	Spitali Rajonal Elbasan	600
3	Spitali Rajonal Fier	240
TOTALI		**10,840**

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	BOE "M." dhe "E.-F."	244,550,400	Kualifikuar
2	R. F.	301,601,320	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e BOE "M." dhe "E.-F.", në vlerën prej **244,550,400 lekë pa TVSH**. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH/ Prodhues	Vendi i prodhimit
6	Trastuzumab Biosimilar ose origjinator	150 mg	Flakon	10,840	22,560	244,550,400	P./ A.H./ B.C.I. Ltd./ C.H.	Belgjikë, Mb. Bashkuar, Irlandë/ Kinë, Mb. Bashkuar, Poloni, Spanjë/ Indi, Irlandë, Itali, Poloni, Gjermani/ Kore, Hungari, Turqi, Irlandë, Spanjë, Francë, Gjermani, Poloni

Sa i përket **dokumentacionit mbi autorizimin për tregtim të barnave**, BOE ka paraqitur:

Nr.	Dokumenti	Bari	Prodhuesi/ MAH
1	Konfirmim nga AKBMP nëpërmjet shkresës nr. 1832/1 prot., datë 22.05.2024, ku listohet Autorizim tregtimi nr. 449, datë 06.06.2019	"Ogivri", formë-doza "Poëder for concentrate for solution for infusion x 150mg", princip aktiv "Trastuzumab", paketimi "box x 1 vial"	"B. C. I. Ltd."
2	Konfirmim nga AKBPM nëpërmjet shkresës nr. 1813/1 prot., datë 22.05.2024, ku listohet me nr. rendor 41 Autorizim tregtimi nr. 228, datë 18.04.2024	"Herzuma", formë-doza "Poëder for concentrate for solution for infusion x 150mg", princip aktiv "Trastuzumab", paketimi "box x 1 vial"	"*C. H. H.Kft*", Hungari, duke përcaktuar prodhuesit "C. Inc. (Plant II) - Republika e Koresë; C. Inc (plant I) - Republika e Koresë; E. Ph. PLC – Hungari; G.I. - Turqi; C. H. H. kft - Hungari; M.H. Ltd. – Irlandë; H. F. s.a. – Portugali; K. Ph. S. – Spanjë; N. F. S. – Francë; N. Gbmh – Gjermani; S. M. – Poloni
3	Konfirmim nga AKBPM nëpërmjet shkresës nr. 1868/5 prot., datë 22.05.2024, ku listohet me nr. rendor 14 Autorizim tregtimi nr. 465, datë 01.11.2021	"Zercepac", formë-doza "Poëder for concentrate for solution for infusion x 150mg", princip aktiv "Trastuzumab", paketimi "box x 1 vial"	"A.H. SLU – Spanjë"
4	Autorizim për tregtim nr. 9688, nr. 1845/8 prot., datë 23.04.2020, i lëshuar nga AKBPM	"Trazimera", princip aktiv "Trastuzumab", paketimi "box x 1 vial"	"P. E., Bruksel, Belgjikë", duke përcaktuar prodhuesit "P. M. Belgium" – Belgjikë, "Ë. Ph." – Mb. e Bashkuar, "P. I.P.", Irlandë

Sa i përket **autorizimeve nga MAH/ prodhuesit**, BOE ka paraqitur:

Nr.	Dokumenti

1	Autorizim i datës 23.05.2024, nga "Pfizer Export B.V.", i vlefshëm deri në datën 31.12.2026, përfshirë artikulli me nr. rendor 30 me emër tregtar "Trazimera", princip aktiv "Trastuzumab", formë-doza "Poëder for concentrate for solution for infusion x 150mg", princip aktiv "Trastuzumab", paketimi "box x 1 vial", MAH "P. E. ., Belgjikë"
2	Autorizim i datës 22.05.2024, nga "A.H.P. sp. z.o.o", i vlefshëm për periudhën 2024-2026
3	Autorizim nga "C. H.H. Kft", i vlefshëm deri në 31.12.2026
4	Autorizim i datës 31.05.2024, nga "B. C.I. Ltd., i vlefshëm për periudhën 2024 – 2026

Nisur nga fakti se oferta e paraqitur nga BOE është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur, AK ka kërkuar argumentimin e ofertës anomalisht të ulët nëpërmjet SPE në datën 24.06.2024. OE ka paraqitur argumentimin e ofertës në datën 26.06.2024, e paprotokolluar, ku citohet se "*MAH/ kompanitë prodhuese dhe distributorët kanë ofruar tjetër çmim për njësi për pjesëmarrje në tender nga çmimi CIF i deklaruar dhe miratuar nga KÇB...*" duke garantuar se nuk cënohet cilësia e artikullit të furnizuar, si dhe duke bashkëlidhur korrespondencat me MAH "B. C.", "A. H." dhe "C. H. Kft.". Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

2. Lot 113 "*Avelumab 200mg/10ml*" me nr. REF-03508-05-02-2024, me fond limit 132,431,711 lekë pa TVSH, për sasinë 1,920 flakonë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt*: Lot 113 "Avelumab 200mg/10ml" me nr. REF-03508-05-02-2024*		
1. **Urdhër Prokurimi** nr. 237, datë 25.04.2024 4. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur mbi kufirin e lartë monetar"	**2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 237, datë 25.04.2024 A. P. E. B. (specialist fushe), E.L., L. A., E. M.. **Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit** Urdhër nr. 716, nr. 4446 prot., datë 07.12.2023, ndryshuar nëpërmjet Urdhrit nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024 N. A., E.B. (farmacist), E. T. (mjek). Pas ndryshimit zëvendësohet E. T. me F. B. (mjek).	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 237/1, datë 25.04.2024 M. Sh. (kryetar); M.K. (specialist fushe); E. H., anëtar
5. Fondi Limit: 132,431,711 lekë pa TVSH	**6. Oferta fituese:**" OE "M.", me vlerë 132,422,400 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit:** 9,311 lekë pa TVSH (0%)
8. Data e hapjes së tenderit: 03.05.2024	**9. Burimi i Financimit:** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 1 OE b) Skualifikuar: - c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër Nr. 1989/34 Prot., date 23.07.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 132,422,400 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për këtë bar është kërkuar sasia totale prej 1,920 flakonë, me destinacion Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza".
Në këtë procedurë prokurimi ka marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	**OE**	**Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)**	**Statusi**
1	"M.""	132,422,400	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "M.", në vlerën prej **132,422,400 lekë pa TVSH**. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	**Princip aktiv**	**Formë-doza**	**Njësia**	**Sasia**	**Çmim/ njësi**	**Çmim total**	**MAH/ Prodhues**	**Vendi i prodhimit**

113	Avelumab	200mg/ 10ml	Flakon	1,920	68,970	132,422,400	M. E.	Zvicër, Itali

Sa i përket dokumentacionit mbi autorizimin për tregtim të barit, OE ka paraqitur Autorizimin për tregtim nr. 10730, nr. 1695/18 prot., datë 23.06.2023, me vlefshmëri 5-vjeçare, të lëshuar nga AKBPM, për barin me emër tregtar "B.", me princip aktiv "Avelumab", formë-doza 20mg/ml (*ekuivalente me 200mg/10ml të kërkuar*), me mbajtës të autorizimit për tregtim "M. E." dhe prodhues "M. S. SA" – Zvicër, "M.S. SPA" – Itali.
Sa i përket dokumentacionit mbi autorizim nga prodhuesi, OE ka paraqitur Autorizimin e datës 14.05.2024 nga M. E. GmbH, me afat deri në 31.12.2026. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

3. Lot 7 "*Bevacizumab* 25mg/ml" me nr. REF-03267-05-02-2024, me fond limit 198,461,145 lekë pa TVSH, për sasinë 3,032 flakonë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt*: Lot 7 "Bevacizumab 25mg/ml" me nr. REF-03267-05-02-2024*		
1. **Urdhër Prokurimi** nr. 237, datë 25.04.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 237, datë 25.04.2024 A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 237/1, datë 25.04.2024 M. Sh (kryetar); M. K. (specialist fushe); E. H., anëtar
4. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur mbi kufirin e lartë monetar"	**Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit** Urdhër nr. 716, nr. 4446 prot., datë 07.12.2023, ndryshuar nëpërmjet Urdhrit nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024 N.A., E. B. (farmacist), E. T. (mjek). Pas ndryshimit zëvendësohet E. T. me F. B. (mjek).	
5. Fondi Limit: 198,461,145 lekë pa TVSH	**6. Oferta fituese:**" OE "R. F.", me vlerë 123,453,944 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit:** 75,007,201 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: 03.05.2024	**9. Burimi i Financimit:** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 2 OE b) Skualifikuar: 1 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër Nr. 1989/53 Prot., date 30.07.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 123,453,944 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 6 është kërkuar sasia totale prej 3,032 flakonë, me shpërndarje, si më poshtë:

Nr.	**Spitali**	**Sasia**
1	Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"	3,000
2	Spitali Rajonal Berat	32
TOTALI		**3,032**

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	**OE**	**Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)**	**Statusi**	**Koment**
1	R. F.	123,453,944	Kualifikuar	
2	BOE "P." dhe "M." dhe "T."	144,238,304	Skualifikuar	Oferta ekonomike ka gabim në llogaritje. Gabimi aritmetik është me një diferencë prej 15,160,000, vlerë e cila e kalon limitin prej 2%. Për rrjedhojë komisioni vendos skualifikimin e ofertës.

Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "R. F.", në vlerën prej **123,453,944 lekë pa TVSH**. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH/ Prodhues	Vendi i prodhimit
7	Bevacizumab	25mg/ml	Flakon	3,032	40,717	123,453,944	R. R. GbmH Prodhues: G. Inc. – ShBA, F. H.L.-Roche Ltd. – Zvicër, R. D. GmbH – Gjermani	ShBA, Zvicër, Gjermani

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, OE ka paraqitur Rinovimin e autorizimit për tregtim nr. 7171, nr. 8698/67 prot., datë 16.03.2021, të lëshuar nga AKBPM, për barin me emër tregtar "A.", me princip aktiv "Bevacizumab", formë-doza 25mg/ml, me mbajtës të autorizimit për tregtim "R. R. GmbH" dhe prodhues "G." – ShBA, "F. H.L.-R. Ltd." – Zvicër, "R. Di.GmbH" – Gjermani me vlefshmëri 5-vjeçare. Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizim nga prodhuesi*, OE ka paraqitur Autorizimin e datës 16.05.2024 nga F. H.-L. R.Ltd, Zvicër, të vlefshëm për periudhën 2024 – 2026. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

Nisur nga fakti se oferta e paraqitur nga OE është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur, AK ka kërkuar argumentimin e ofertës anomalisht të ulët nëpërmjet SPE. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, ka rezultuar se OE ka paraqitur argumentimin e ofertës nëpërmjet shkresës së datës 27.06.2024, e paprotokolluar në MSHMS, ku citohet se "*në uljen e çmimit ka ndikuar skonto tregtare që ka ofruar kompania furnizuese dhe kjo kosto është llogaritur saktë nga ana jonë dhe në ofertën e dhënë kemi përfshirë të gjithë elementët e kostos + marzhin e fitimit...çmimi CIF i deklaruar nga MAH nuk ka ndryshuar, por zbritja që kemi marrë nga MAH dhe e reflektuar te oferta jonë është një çmim vetëm për këtë procedurë prokurimi*" duke bashkëlidhur deklaratën e MAH ku citohet "*Ne gjithashtu konfirmojmë se çmimi i ofertuar është çmimi i pranuar nga kompania për këtë procedurë prokurimi*".

4. Lot 114 "*Polatuzumab 140mg*", me nr. REF-03510-05-02-2024, me fond limit 116,421,153 lekë pa TVSH, për sasinë 120 flakonë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt*: Lot 114 "Polatuzumab 140mg", me nr. REF-03510-05-02-2024*		
1. **Urdhër Prokurimi** nr. 237, datë 25.04.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 237, datë 25.04.2024 A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 237/1, datë 25.04.2024 M. Sh (kryetar); M. K. (specialist fushe); E. H., anëtar
4. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur mbi kufirin e lartë monetar"	**Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit** Urdhër nr. 716, nr. 4446 prot., datë 07.12.2023, ndryshuar nëpërmjet Urdhrit nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024 N.A., E. B. (farmacist), E. T. (mjek). Pas ndryshimit zëvendësohet E. T. me F. B. (mjek).	
5. Fondi Limit: 116,421,153 lekë pa TVSH	**6. Oferta fituese:**" OE "R. F.", me vlerë 116,420,760 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit:** 393 lekë pa TVSH (0%)
8. Data e hapjes së tenderit: 03.05.2024	**9. Burimi i Financimit:** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 1 OE b) Skualifikuar: - c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër Nr. 1989/34 Prot., date 23.07.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 116,420,760 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për këtë bar është kërkuar sasia totale prej 120 flakonë, me destinacion Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza".
Në këtë procedurë prokurimi ka marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	R. F.	116,420,760	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "R. F.", në vlerën prej **116,420,760 lekë pa TVSH**. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH/ Prodhues	Vendi i prodhimit
114	Polatuzumab	140mg	Flakon	120	970,173	116,420,760	R. R. GmbH, Gjermani Prodhues: L. Ltd. – Zvicër, BSP Ph. SPS – Itali	Zvicër, Itali

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, OE ka paraqitur Autorizimin për tregtim nr. 10216, nr. 6473/33 prot., datë 28.02.2022, me vlefshmëri 5-vjeçare, të lëshuar nga AKBPM, për barin me emër tregtar "P.", me princip aktiv "Polatuzumab", formë-doza 140mg, me mbajtës të autorizimit për tregtim "R. R. GmbH" dhe prodhues "L.Ltd." – Zvicër, "B. Ph. SPS" – Itali. Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizim nga prodhuesi*, OE ka paraqitur Autorizimin e datës 16.05.2024 nga F. H.-L. R. Ltd, Zvicër, të vlefshëm për periudhën 2024 – 2026. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

5. Lot 108 "*Ocrelizumab 300 mg/10 ml*", me nr. REF-03496-05-02-2024, me fond limit 99,360,641 lekë pa TVSH, për sasinë 200 fl./ amp

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Lot 108 "Ocrelizumab 300 mg/10 ml", me nr. REF-03496-05-02-2024</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
nr. 237, datë 25.04.2024</td><td rowspan="2">2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Urdhër nr. 237, datë 25.04.2024
A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..

Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit
Urdhër nr. 716, nr. 4446 prot., datë 07.12.2023, ndryshuar nëpërmjet Urdhrit nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024
N.A., E. B. (farmacist), E. T. (mjek). Pas ndryshimit zëvendësohet E. T. me F. B. (mjek).</td><td rowspan="2">3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Urdhër nr. 237/1, datë 25.04.2024
M. Sh (kryetar);
M. K. (specialist fushe);
E. H., anëtar</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit
"E hapur mbi kufirin e lartë monetar"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit:
99,360,641 lekë pa TVSH</td><td>6. Oferta fituese:" OE "R. F.", me vlerë 99,360,000 lekë pa TVSH</td><td>7. Diferenca me fondin limit:
641 lekë pa TVSH (0%)</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
03.05.2024</td><td>9. Burimi i Financimit:
Buxheti i Shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës: 1 OE
b) Skualifikuar: -
c) Kualifikuar: 1 OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime: -</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>12. Lidhja e M Kuadër
Nr. 1989/34 Prot., date 23.07.2024</td><td>13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër
99,360,000 lekë pa TVSH</td><td>14. Afati i MK në ditë
24 muaj</td></tr>
</table>

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për këtë bar është kërkuar sasia totale prej 200 fl./ amp., me destinacion Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza".
Në këtë procedurë prokurimi ka marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	R. F.	99,360,000	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "R. F.", në vlerën prej **99,360,000 lekë pa TVSH**. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH/ Prodhues	Vendi i prodhimit
108	Ocrelizumab	300mg/ 10ml	Fl/ amp	200	496,800	99,360,000	R. R. GmbH, Gjermani Prodhues: R. D. GmbH – Gjermani, F. H. L. R. – Zvicër	Zvicër, Gjermani

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, OE ka paraqitur Rinovimin e autorizimit për tregtim nr. 8382, nr. 8682/48 prot., datë 13.01.2023, me vlefshmëri 5-vjeçare, të lëshuar nga AKBPM, për barin me emër tregtar "O.", me princip aktiv "Ocrelizumab", formë-doza 300mg/ 10ml, me mbajtës të autorizimit për tregtim "R. R. GmbH" dhe prodhues R.D. GmbH – Gjermani, F. H. L. R. – Zvicër. Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizim nga prodhuesi*, OE ka paraqitur Autorizimin e datës 16.05.2024 nga F. H.-L. R. Ltd, Zvicër, të vlefshëm për periudhën 2024 – 2026. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

6. Lot 106 "*Brentuximab 50mg*", me nr. REF-03492-05-02-2024, me fond limit 90,081,620 lekë pa TVSH, për sasinë 300 fl./amp.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt*: Lot 106 "Brentuximab 50mg", me nr. REF-03492-05-02-2024*		
1. **Urdhër Prokurimi** nr. 237, datë 25.04.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 237, datë 25.04.2024 A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 237/1, datë 25.04.2024 M. Sh (kryetar); M. K. (specialist fushe); E. H., anëtar
4. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur mbi kufirin e lartë monetar"	**Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit** Urdhër nr. 716, nr. 4446 prot., datë 07.12.2023, ndryshuar nëpërmjet Urdhrit nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024 N.A., E. B. (farmacist), E. T. (mjek). Pas ndryshimit zëvendësohet E. T. me F. B. (mjek).	
5. Fondi Limit: 90,081,620 lekë pa TVSH	**6. Oferta fituese:**" OE "T.", me vlerë 90,000,000 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit:** 81,620 lekë pa TVSH (0%)
8. Data e hapjes së tenderit: 03.05.2024	**9. Burimi i Financimit:** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 1 OE b) Skualifikuar: - c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër Nr. 1989/34 Prot., date 23.07.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 90,000,000 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për këtë bar është kërkuar sasia totale prej 300 fl./ amp., me destinacion Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza".
Në këtë procedurë prokurimi ka marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	T.	90,000,000	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "T.", në vlerën prej **90,000,000 lekë pa TVSH.** Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH/ Prodhues	Vendi i prodhimit
106	Brentuximab	50mg	Fl/ amp	300	300,000	90,000,000	T. P. A/S - Danimarkë Prodhues: F. P. 1 & 2 – Francë, B. Ph.. SPA – Itali, T. A. GmbH – Austri, C.L.. Ltd. – Mb. e Bashkuar, S. Inc. – ShBA, E.L. L. Inc. – ShBA, N. L. – ShBA	Francë, Itali, Austri, Mbretëri e Bashkuar, ShBA

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, OE ka paraqitur Autorizimin për tregtim nr. 10271, nr. 7473/11 prot., datë 02.03.2022, me vlefshmëri 5-vjeçare, të lëshuar nga AKBPM, për barin me emër tregtar "A.", me princip aktiv "Brentuximab Vedotin", formë-doza 50mg, me mbajtës të autorizimit për tregtim "T. Ph. A/S" dhe prodhues F. P.1 & 2 – Francë, B.Ph.. SPA – Itali, T. A. GmbH – Austri, C. L.. Ltd. – Mb. e Bashkuar, S. Inc. – ShBA, E. L.L. Inc. – ShBA, N. L. – ShBA. Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizim nga prodhuesi*, OE ka paraqitur Autorizimin e datës 16.05.2024 nga F. H.-L. R. Ltd, Zvicër, të vlefshëm për periudhën 2024 – 2026. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

7. Lot 11 "*Paclitaxel 100mg/ 16.7ml, flakon*", nr. REF-03275-05-02-2024, me fond limit 76,792,488 lekë pa TVSH, për sasinë 17,280 flakonë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt*: Lot 106 "Brentuximab 50mg", me nr. REF-03492-05-02-2024*		
1. **Urdhër Prokurimi** nr. 237, datë 25.04.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 237, datë 25.04.2024 A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 237/1, datë 25.04.2024 M. Sh (kryetar); M. K. (specialist fushe); E. H., anëtar
4. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur mbi kufirin e lartë monetar"	**Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit** Urdhër nr. 716, nr. 4446 prot., datë 07.12.2023, ndryshuar nëpërmjet Urdhrit nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024 N.A., E. B. (farmacist), E. T. (mjek). Pas ndryshimit zëvendësohet E. T. me F. B. (mjek).	
5. Fondi Limit: 76,792,488 lekë pa TVSH	**6. Oferta fituese:**" OE "R. F.", me vlerë 15,609,542.40 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit:** 61,182,945.6 lekë pa TVSH (79%)
8. Data e hapjes së tenderit: 03.05.2024	**9. Burimi i Financimit:** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 5 OE b) Skualifikuar: 1 O c) Kualifikuar: 4 OE
11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër Nr. 1989/53 Prot., date 30.07.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 15,609,542.40 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 11 është kërkuar sasia totale prej 17,280 flakonë, me shpërndarje, si më poshtë:

Nr.	Spitali	Sasia
1	Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"	10,000
2	QSR "Shefqet Ndroqi"	1,200
3	Spitali Rajonal Berat	150
4	Spitali Rajonal Durrës	500
5	Spitali Rajonal Elbasan	600

6	Spitali Rajonal Fier	930
7	Spitali Rajonal Korçë	800
8	Spitali Rajonal Lezhë	700
9	Spitali Rajonal Shkodër	1,700
10	Spitali Rajonal Vlorë	700
TOTALI		**17,280**

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	R. F.	15,609,542.40	Kualifikuar
2	F. M. A.	15,759,360	Kualifikuar
3	I.	22,688,640	Kualifikuar
4	A. M. F	67,737,600	Kualifikuar
5	M.	Pa ofertë ekonomike	Skualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "R. F.", në vlerën prej **15,609,542.4 lekë pa TVSH**. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH/ Prodhues	Vendi i prodhimit
11	Paclitaxel	100mg/ 16.7ml	Flakon	17,280	903.33	15,609,542.4	F. K. D.GmbH Prodhues: F. K. O. Ltd., - Indi, F.K. – Gjermani, Ë. H.Kft – Hungari, Ph. Ltd. M. L. – Hungari, Ë. GmbH – Gjerman	Indi, Gjermani, Hungari

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, OE ka paraqitur Rinovimin e autorizimit për tregtim nr. 6827, nr. 1294/12 prot., datë 29.05.2020, me vlefshmëri 5-vjeçare, të lëshuar nga AKBPM, për barin me emër tregtar "P.K.", me princip aktiv "Paclitaxel", formë-doza 6mg/ ml, me mbajtës të autorizimit për tregtim "F. Ka. D. GmbH" dhe prodhues F. K. O.Ltd., - Indi, F. K. – Gjermani, Ë. H. Kft – Hungari, P. Ltd. M.L. – Hungari, Ë. GmbH – Gjermani. Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizim nga prodhuesi*, OE ka paraqitur Autorizimin e datës 23.05.2024 nga F. K. A. GmbH, Zvicër, të vlefshëm për periudhën 2024 – 2026. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

Nisur nga fakti se oferta e paraqitur nga OE është ulur nën 85% të mesatares së ofertave të vlefshme, AK ka kërkuar argumentimin e ofertës anomalisht të ulët nëpërmjet SPE. OE ka paraqitur argumentimin e ofertës në datën 27.06.2024, e paprotokolluar, ku citohet se "*Kosto e këtij produkti përbëhet nga çmimi CIF i regjistruar minus skonto tregtare që ka ofruar MAH F. K....Detaje të plota të kostos nuk mund të japim pasi janë konfidenciale*" duke bashkëlidhur Deklaratën e MAH ku citohet se "*...përmbushim të gjitha standardet e cilësisë dhe specifikimet e kërkuara pavarësisht nga çmimi i ofertuar i cili është më i ulët se çmimi i publikuar zyrtarisht*".

8. Lot 8 "Rituximab Biosimilar ose origjinator 10 mg/ml-50 ml, flakon", nr. REF-03269-05-02-2024, me fond limit 187,722,856 lekë pa TVSH, për sasinë 3,010 flakonë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt*: Lot 8 "Rituximab Biosimilar ose origjinator 10 mg/ml-50 ml, flakon", nr. REF-03269-05-02-2024*		
1. **Urdhër Prokurimi** nr. 237, datë 25.04.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 237, datë 25.04.2024 A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 237/1, datë 25.04.2024 M. Sh (kryetar); M. K. (specialist fushe); E. H., anëtar
4. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur mbi kufirin e lartë monetar"	**Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit** Urdhër nr. 716, nr. 4446 prot., datë 07.12.2023, ndryshuar nëpërmjet Urdhrit nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024	

	N.A., E. B. (farmacist), E. T. (mjek). Pas ndryshimit zëvendësohet E. T. me F. B. (mjek).	
5. Fondi Limit: 187,722,856 lekë pa TVSH	**6. Oferta fituese:**" OE "R. F.", me vlerë 52,148,250 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit:** 135,574,606 lekë pa TVSH (72%)
8. Data e hapjes së tenderit: 03.05.2024	**9. Burimi i Financimit:** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 4 OE b) Skualifikuar: - c) Kualifikuar: 4 OE
11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër Nr. 1989/53 Prot., date 30.07.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 52,148,250 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 8 është kërkuar sasia totale prej 3,010 flakonë, me shpërndarje, si më poshtë:

Nr.	Spitali	Sasia
1	Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"	3,000
2	Spitali memorial	10
TOTALI		**3,010**

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	P.	52,148,250	
2	E.-F.	103,246,010	
3	D. Ph.	116,650,443	
4	M.	187,721,660	

Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "P.", në vlerën prej **52,148,250 lekë pa TVSH.** Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH/ Prodhues	Vendi i prodhimit
8	Rituximab	10mg/ ml – 50ml	Flakon	3,010	17,325	52,148,250	MAH: P. E. . - Belgjikë Prodhues: P. M. B. N. – Belgjikë, P. I. Ph. – Irlandë, P. D. – ShBA, P. D.Ireland Ltd. – Irlandë	Belgjikë, Irlandë, ShBA

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, OE ka paraqitur Rinovimin e autorizimit për tregtim nr. 10440, nr. 3455/34 prot., datë 07.07.2022, me vlefshmëri 5-vjeçare, të lëshuar nga AKBPM, për barin me emër tregtar "R.", me princip aktiv "Rituximab", formë-doza 500mg/ 50ml, me mbajtës të autorizimit për tregtim "P. E." dhe prodhues P. M. B. NV – Belgjikë, P. I. Ph. – Irlandë, P. D.– ShBA, P. D. I. Ltd. – Irlandë. Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizim nga prodhuesi*, OE ka paraqitur Autorizimin e datës 23.05.2024 nga P. E.B.V, të vlefshëm deri në 31.12.2026. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

Nisur nga fakti se oferta e paraqitur nga OE është ulur nën 85% të mesatares së ofertave të vlefshme, AK ka kërkuar argumentimin e ofertës anomalisht të ulët nëpërmjet SPE. OE ka paraqitur argumentimin e ofertës nëpërmjet shkresës administruar në MSHMS me nr. 1989/6 prot., datë 27.06.2024, ku janë paraqitur argumentimet përkatëse, analiza e kostove, faturat furnizimi nga "P. E. B.V" Holandë, si dhe korrespondencë elektronike me përfaqësues nga "P. S. D.", Serbi. Grupi i auditimit ka kërkuar dokumentacion mbi lidhjen e "P. S. D." Serbi me kompaninë "P." dhe nga MSHMS-ja është vënë në dispozicion Letra e autorizimit nga "P. I.", ku autorizon "P. S. D."

Serbi për të mbështetur furnizimin e shoqërisë "P." për artikujt sipas listës, pjesë përbërëse e së cilës është dhe bar-i "Ruxience" me të dhënat sipas Autorizimit për tregtim.

9. Lot 109 "Daratumumab 400 mg Fl/Amp", me nr. REF-03499-05-02-2024, me fond limit 64,452,906 lekë pa TVSH, për sasinë 400 fl./ amp.

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Lot 109 "Daratumumab 400 mg Fl/Amp", me nr. REF-03499-05-02-2024</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
nr. 237, datë 25.04.2024</td><td rowspan="2">2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Urdhër nr. 237, datë 25.04.2024
A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..

Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit
Urdhër nr. 716, nr. 4446 prot., datë 07.12.2023, ndryshuar nëpërmjet Urdhrit nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024
N.A., E. B. (farmacist), E. T. (mjek). Pas ndryshimit zëvendësohet E. T. me F. B. (mjek).</td><td rowspan="2">3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Urdhër nr. 237/1, datë 25.04.2024
M. Sh (kryetar);
M. K. (specialist fushe);
E. H., anëtar</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit
"E hapur mbi kufirin e lartë monetar"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit:
64,452,906 lekë pa TVSH</td><td>6. Oferta fituese:" OE "R. F.", me vlerë 64,452,000 lekë pa TVSH</td><td>7. Diferenca me fondin limit:
906 lekë pa TVSH (0%)</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
03.05.2024</td><td>9. Burimi i Financimit:
Buxheti i Shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës: 1 OE
b) Skualifikuar: -
c) Kualifikuar: 1 OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime: -</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>12. Lidhja e M Kuadër
Nr. 1989/34 Prot., date 23.07.2024</td><td>13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër
52,148,250 lekë pa TVSH</td><td>14. Afati i MK në ditë
24 muaj</td></tr>
</table>

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për këtë bar është kërkuar sasia totale prej 400 fl./ amp., me destinacion Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza".
Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	R. F.	64,452,000	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "R. F.", në vlerën prej **52,148,250 lekë pa TVSH.** Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH/ Prodhues	Vendi i prodhimit
8	Daratumumab	400mg/ 20ml	Fl/ Amp	400	161,130	64,452,000	J.-C. – Belgjikë Prodhues: C. A. – Zvicër, V. P. F. – Gjermani, Ja. B. B.V – Hollandë	Zvicër, Gjermani, Hollandë

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, OE ka paraqitur Rinovimin e autorizimit për tregtim nr. 8810, nr. 2838/24 prot., datë 11.09.2023, me vlefshmëri 5-vjeçare, të lëshuar nga AKBPM, për barin me emër tregtar "D.", me princip aktiv "Daratumumab", formë-doza 20mg/ml, me mbajtës të autorizimit për tregtim "J.-C. I. NV" dhe prodhues C. A. – Zvicër, V. P. F.– Gjermani, J. B. B.V – Hollandë. Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizim nga prodhuesi*, OE ka paraqitur Autorizimin e datës 23.05.2024 nga J.-C. Kft. Hungari, të vlefshëm për periudhën 2024 - 2026. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

10. Lot 59 "*Iodine x 300mg/ml, 100 ml Flakon*", me nr. REF-03384-05-02-2024, me fond limit 11,096,109 lekë pa TVSH, për sasinë 3,200 flakonë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt*: Lot 59 "Iodine x 300mg/ml, 100 ml Flakon", me nr. REF-03384-05-02-2024*		
1. **Urdhër Prokurimi** nr. 237, datë 25.04.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 237, datë 25.04.2024 A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M.. **Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit** Urdhër nr. 716, nr. 4446 prot., datë 07.12.2023, ndryshuar nëpërmjet Urdhrit nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024 N.A., E. B. (farmacist), E. T. (mjek). Pas ndryshimit zëvendësohet E. T. me F. B. (mjek).	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 237/1, datë 25.04.2024 M. Sh (kryetar); M. K. (specialist fushe); E. H., anëtar
4. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur mbi kufirin e lartë monetar"		
5. Fondi Limit: 11,096,109 lekë pa TVSH	**6. Oferta fituese:**" OE "F.", me vlerë 3,785,600 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit:** 7,310,509 lekë pa TVSH (66%)
8. Data e hapjes së tenderit: 03.05.2024	**9. Burimi i Financimit:** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 2 OE b) Skualifikuar: - c) Kualifikuar: 2 OE
11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër Nr. 1989/53 Prot., date 30.07.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 3,785,600 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 59 është kërkuar sasia totale prej 3,200 flakonë, me shpërndarje, si më poshtë:

Nr.	**Spitali**	**Sasia**
1	Spitali Universitar i Traumës	20
2	Spitali Rajonal Elbasan	780
3	Spitali Rajonal Korçë	2,000
4	Spitali Rajonal Lezhë	400
TOTALI		**3,200**

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	**OE**	**Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)**	**Statusi**
1	F.	3,785,600	Kualifikuar
2	D. Ph.	5,944,640	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "F.", në vlerën prej **3,785,600 lekë pa TVSH**. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	**Princip aktiv**	**Formë-doza**	**Njësia**	**Sasia**	**Çmim/ njësi**	**Çmim total**	**MAH/ Prodhues**	**Vendi i prodhimit**
59	Iodine	300mg/ml – 100ml	Fl/ Amp	3,200	1,183	3,785,600	P.	Turqi

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, OE ka paraqitur Rinovimin e autorizimit për tregtim nr. 9384, nr. 836/140 prot., datë 26.07.2019, me vlefshmëri 5-vjeçare, të lëshuar nga AKBPM, për barin me emër tregtar "O.", me princip aktiv "Iohexol", formë-doza 300mgI/ml, me mbajtës të autorizimit për tregtim "P. I. S. A.S." dhe prodhues A. I. S. Ltd. Sti - Turqi. Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizim nga prodhuesi*, OE ka paraqitur Autorizimin e datës 01.02.2024 nga P. I. S. A.S, të vlefshëm për periudhën 2024 - 2026. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

Nisur nga fakti se oferta e paraqitur nga OE "F." është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur, AK ka paraqitur kërkesën për argumentim të ofertës anomalisht të ulët nëpërmjet SPE. Grupit të auditimit i është vënë në dispozicion shkresa e datës 27.06.2024, e paprotokolluar, ku nga OE argumentohet oferta anomalisht e ulët, duke cituar se "*kosto e marketingut janë reduktuar... duke bërë të mundur ofertimin e një çmimi të reduktuar*", duke garantuar se nuk cënohet cilësia e artikullit të furnizuar, por pa mbështetur me prova shkresore sqarimet për elementet e veçanta të ofertës, sipas përcaktimit në nenin 82, pika 4, të RPP.

11. Lot 24 "*Doxorubicin 2 mg/ml - 25 ml Flakon*", me nr. REF-03304-05-02-2024, me fond limit 10,162,974 lekë pa TVSH, për sasinë 10,217 flakonë

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Lot 24 "Doxorubicin 2 mg/ml - 25 ml Flakon", me nr. REF-03304-05-02-2024</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
nr. 237, datë 25.04.2024</td><td rowspan="2">2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Urdhër nr. 237, datë 25.04.2024
A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..

Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit
Urdhër nr. 716, nr. 4446 prot., datë 07.12.2023, ndryshuar nëpërmjet Urdhrit nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024
N.A., E. B. (farmacist), E. T. (mjek). Pas ndryshimit zëvendësohet E. T. me F. B. (mjek).</td><td rowspan="2">3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Urdhër nr. 237/1, datë 25.04.2024
M. Sh (kryetar);
M. K. (specialist fushe);
E. H., anëtar</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit
"E hapur mbi kufirin e lartë monetar"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit:
10,162,974 lekë pa TVSH</td><td>6. Oferta fituese: OE "F.", me vlerë 6,641,050 lekë pa TVSH</td><td>7. Diferenca me fondin limit:
3,521,924 lekë pa TVSH (35%)</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
03.05.2024</td><td>9. Burimi i Financimit:
Buxheti i Shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës: 2 OE
b) Skualifikuar: -
c) Kualifikuar: 2 OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime: -</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>12. Lidhja e M Kuadër
Nr. 1989/53 Prot., date 30.07.2024</td><td>13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër
6,641,050 lekë pa TVSH</td><td>14. Afati i MK në ditë
24 muaj</td></tr>
</table>

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 24 është kërkuar sasia totale prej 10,217 flakonë, me shpërndarje, si më poshtë:

Nr.	Spitali	Sasia
1	Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"	7,000
2	QSR "Shefqet Ndroqi"	150
3	Spitali Rajonal Berat	80
4	Spitali Rajonal Durrës	400
5	Spitali Rajonal Elbasan	120
6	Spitali Rajonal Fier	567
7	Spitali Rajonal Korçë	400
8	Spitali Rajonal Lezhë	200
9	Spitali Rajonal Shkodër	500
10	Spitali Rajonal Vlorë	800
TOTALI		**10,217**

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	F.	6,641,050	Kualifikuar
2	I.	9,093,130	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "F.", në vlerën prej **6,641,050 pa TVSH.** Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH/ Prodhues	Vendi i prodhimit
24	Doxorubicin	2mg/ml – 25ml	flakon	10,217	650	6,641,050	M. & prodhues "O. I. S.. A.S.", Turqi	Turqi

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, OE ka paraqitur shkresën e Drejtorit të AKBPM nr. 2064/1 prot., datë 30.05.2024, ku konfirmohet se 5 barna janë pajisur me Autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë, ndër të tjera për barin me emër tregtar "D.", me princip aktiv "Doxorubicin", formë-doza 50mg/25ml, me mbajtës të autorizimit për tregtim "O. I. S.. A.S." – Turqi, i pajisur me riautorizim tregtimi nr. 273, datë 16.05.2024 me vlefshmëri 5-vjeçare. Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizim nga prodhuesi*, OE ka paraqitur Autorizimin e datës 20.05.2024 nga O. I. S.. A.S, të vlefshëm për periudhën 2024 - 2026. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim. Nisur nga fakti se oferta e paraqitur nga OE është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur, AK ka kërkuar argumentimin e ofertës anomalisht të ulët nëpërmjet SPE. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, ka rezultuar se OE ka paraqitur argumentimin e ofertës nëpërmjet shkresës së datës 26.06.2024, e paprotokolluar në MSHMS, ku citohet se "*kompania ka marrë përsipër ofertimin e këtyre çmimeve vetëm për procdurën në fjalë, me sasitë e përcaktuara në DST... Mbajtësi i autorizimit për tregtim garanton se nuk preket cilësia e produktit...*" duke bashkëlidhur korrespondencën elektronike me MAH ku argumentohet nga MAH çmimi i ofertuar.

12. Lot 21 "*Rituximab Biosimilar ose origjinator 10 mg/ml-10 ml Flakon*" me REF-03298-05-02-2024, me fond limit 12,611,109 lekë pa TVSH, për sasinë 1,010 flakonë

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Lot 21 "Rituximab Biosimilar ose origjinator 10 mg/ml-10 ml Flakon" REF-03298-05-02-2024</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
nr. 237, datë 25.04.2024</td><td rowspan="2">2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Urdhër nr. 237, datë 25.04.2024
A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..

Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit
Urdhër nr. 716, nr. 4446 prot., datë 07.12.2023, ndryshuar nëpërmjet Urdhrit nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024
N.A., E. B. (farmacist), E. T. (mjek). Pas ndryshimit zëvendësohet E. T. me F. B. (mjek).</td><td rowspan="2">3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Urdhër nr. 237/1, datë 25.04.2024
M. Sh (kryetar);
M. K. (specialist fushe);
E. H., anëtar</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit
"E hapur mbi kufirin e lartë monetar"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit:
12,611,109 lekë pa TVSH</td><td>6. Oferta fituese: OE "P.", me vlerë 7,423,500 lekë pa TVSH</td><td>7. Diferenca me fondin limit:
5,187,609 lekë pa TVSH (41%)</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
03.05.2024</td><td>9. Burimi i Financimit:
Buxheti i Shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës: 4 OE
b) Skualifikuar: -
c) Kualifikuar: 4 OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime: -</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>12. Lidhja e M Kuadër
Nr. 1989/53 Prot., date 30.07.2024</td><td>13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër
7,423,500 lekë pa TVSH</td><td>14. Afati i MK në ditë
24 muaj</td></tr>
</table>

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 21 është kërkuar sasia totale prej 1,010 flakonë, me shpërndarje, si më poshtë:

Nr.	Spitali	Sasia

1	Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”	1,000
2	Spitali Memorial	10
TOTALI		**1,010**

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	P.	7,423,500	Kualifikuar
2	E.-F.	7,565,910	Kualifikuar
3	D. Ph.	9,534,551.50	Kualifikuar
4	M.	12,610,860	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE “P.”, në vlerën prej **7,423,500 pa TVSH.** Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH/ Prodhues	Vendi i prodhimit
21	Rituximab	10mg/ ml – 10ml	Flakon	1,010	7,350	7,423,500	MAH: P. E. M. E. - Belgjikë Prodhu. – Irlandë, P. D. – ShBA, P. D. I. Ltd. – Irlandë	Belgjikë, Irlandë, ShBA

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, OE ka paraqitur Autorizimin për tregtim nr. 10439, nr. 3455/33 prot., datë 07.07.2022, me vlefshmëri 5-vjeçare, të lëshuar nga AKBPM, për barin me emër tregtar “R.”, me princip aktiv “Rituximab”, formë-doza 100mg/ 10ml (*ekuivalente me 10mg/ml*), me mbajtës të autorizimit për tregtim “P. E. M. E.” dhe prodhues P. M. B. NV – Belgjikë, P.I. P. – Irlandë, P. D. – ShBA, P. D. I. Ltd. – Irlandë. Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizim nga prodhuesi*, OE ka paraqitur Autorizimin e datës 23.05.2024 nga P. E. B.V, të vlefshëm deri në 31.12.2026. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

Nisur nga fakti se oferta e paraqitur nga OE është ulur nën 85% të mesatares së ofertave të vlefshme, AK ka kërkuar argumentimin e ofertës anomalisht të ulët nëpërmjet SPE. OE ka paraqitur argumentimin e ofertës nëpërmjet shkresës administruar në MSHMS me nr. 1989/6 prot., datë 27.06.2024, ku janë paraqitur argumentimet përkatëse, analiza e kostove, faturat furnizimi nga “P. E. B.V” Holandë, si dhe korrespondencë elektronike me përfaqësues nga “P. S. D.”, Serbi. Grupi i auditimit ka kërkuar dokumentacion mbi lidhjen e “P. S.d.” Serbi me kompaninë “P.” dhe nga MSHMS-ja është vënë në dispozicion Letra e autorizimit nga “P. Inc”, ku autorizon “P. S.d.” Serbi për të mbështetur furnizimin e shoqërisë “P.” për artikujt sipas listës, pjesë përbërëse e së cilës është dhe bar-i “Ruxience” me të dhënat sipas Autorizimit për tregtim.

13. Lot 13 “Gemcitabine 1 gr Flakon”, me nr. REF-03280-05-02-2024, me fond limit 57,128,209 lekë pa TVSH, për sasinë 12,641 flakonë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt*: Lot 13 “Gemcitabine 1 gr Flakon”, me nr. REF-03280-05-02-2024*

1. **Urdhër Prokurimi** nr. 237, datë 25.04.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 237, datë 25.04.2024 A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 237/1, datë 25.04.2024 M. Sh (kryetar); M. K. (specialist fushe); E. H., anëtar
4. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”	**Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit** Urdhër nr. 716, nr. 4446 prot., datë 07.12.2023, ndryshuar nëpërmjet Urdhrit nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024 N.A., E. B. (farmacist), E. T. (mjek). Pas ndryshimit zëvendësohet E. T. me F. B. (mjek).	

5. Fondi Limit: 57,128,209 lekë pa TVSH	**6. Oferta fituese:** OE "A. M. F", me vlerë 56,808,654 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit:** 319,555 lekë pa TVSH (0%)
8. Data e hapjes së tenderit: 03.05.2024	**9. Burimi i Financimit:** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 4 OE b) Skualifikuar: - c) Kualifikuar: 4 OE
11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër Nr. 1989/34 Prot., date 23.07.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 56,808,654 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 13 është kërkuar sasia totale prej 12,641 flakonë, me shpërndarje, si më poshtë:

Nr.	Spitali	Sasia
1	Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"	9,300
2	QSR "Shefqet Ndroqi"	600
	Spitali Rajonal Berat	36
	Spitali Rajonal Durrës	400
	Spitali Rajonal Elbasan	125
	Spitali Rajonal Fier	480
	Spitali Rajonal Korçë	700
	Spitali Rajonal Lezhë	100
	Spitali Rajonal Shkodër	500
	Spitali Rajonal Vlorë	400
TOTALI		**12,641**

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	A. M. F	56,808,654	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "A. M. F", në vlerën prej **56,808,654 pa TVSH.** Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH/ Prodhues	Vendi i prodhimit
13	Gemcitabine	1gr	Flakon	12,641	4,494	56,808,654	V. S.A	Greqi

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, OE ka paraqitur Autorizimin për tregtim nr. 7731, nr. 7541/52 prot., datë 04.03.2022, me vlefshmëri 5-vjeçare, të lëshuar nga AKBPM, për barin me emër tregtar "G.", me princip aktiv "Gemcitabine", formë-doza 1g flakon, me mbajtës të autorizimit për tregtim "V. S.A" - Greqi dhe prodhues "V.S.A" - Greqi. Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizim nga prodhuesi*, OE ka paraqitur Autorizimin e datës 16.05.2024 nga V. S.A, të vlefshëm për periudhën 2024-2026. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

1. **Lot 104 "*Cetuximab flakon 5mg/ml Fl/Amp*", me nr. REF-03488-05-02-2024, me fond limit 38,543,097 lekë pa TVSH, për sasinë 2,200 fl./ amp.**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt*: Lot 104 "Cetuximab flakon 5mg/ml Fl/Amp", me nr. REF-03488-05-02-2024*		
1. **Urdhër Prokurimi** nr. 237, datë 25.04.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 237, datë 25.04.2024	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 237/1, datë 25.04.2024

4. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur mbi kufirin e lartë monetar"	A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M.. **Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit** Urdhër nr. 716, nr. 4446 prot., datë 07.12.2023, ndryshuar nëpërmjet Urdhrit nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024 N.A., E. B. (farmacist), E. T. (mjek). Pas ndryshimit zëvendësohet E. T. me F. B. (mjek).	M. Sh (kryetar); M. K. (specialist fushe); E. H., anëtar
5. Fondi Limit: 38,543,097 lekë pa TVSH	**6. Oferta fituese:** OE "I.", me vlerë 38,541,800 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit:** 91,297 lekë pa TVSH (0%)
8. Data e hapjes së tenderit: 03.05.2024	**9. Burimi i Financimit:** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 1 OE b) Skualifikuar: - c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër Nr. 1989/34 Prot., date 23.07.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 38,541,800 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 104 është kërkuar sasia totale prej 2,200 fl, me shpërndarje, si më poshtë:

Nr.	Spitali	Sasia
1	Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"	2,200
TOTALI		**2,200**

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	I.	38,541,800	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "I.", në vlerën prej **38,541,800 pa TVSH.** Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH/ Prodhues	Vendi i prodhimit
104	Cetuximab	5mg/ml	Flakon	2,200	17,519	38,541,800	M. E.B.V/ M. H. KGaA & B. Ingelheim Ph. GmbH & C.. K. - Holandë	Gjermani

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, OE ka paraqitur Rinovimin e Autorizimit për tregtim nr. 7474, nr. 4029/60 prot., datë 04.04.2022, me vlefshmëri 5-vjeçare, të lëshuar nga AKBPM, për barin me emër tregtar "E.", me princip "Cetuximab", formë-doza 5mg/ml, me mbajtës të autorizimit për tregtim "M. E. B.V" – Holandë, me prodhues "M. H. K." – Gjermani, "B. I. Ph." – Gjermani. Sa i përket dokumentacionit mbi autorizim nga prodhuesi, OE ka paraqitur autorizimin e datës 14.05.2024 nga M. E. GmbH, të vlefshëm për periudhën 2024-2026. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

Lidhja e marrëveshjeve kuadër

KVO ka hartuar procesverbalin përmbledhës të vlerësimit për procedurën e prokurimit B1, ku janë paraqitur ofertuesit, OE të skualifikuar dhe OE që kanë rezultuar të suksesshëm e të shpallur fitues për secilin prej lot-eve. Në zbatim të kësaj procedure prokurimi të ndarë me 79 lot-e, MSHMS ka lidhur në total 9 marrëveshje kuadër (me disa operatorë), përkatësisht:

Nr.	Nr. prot.	Datë
1	1989/34	23.07.2024
2	1989/53	30.07.2024

3	1989/74	20.08.2024
4	1989/79	21.08.2024
5	1989/101	13.09.2024
6	1989/103	13.09.2024
7	1989/106	19.09.2024
8	1989/110	25.09.2024
9	1989/137	26.12.2024

II. "*Blerje barna Anti-infektivë të përgjithshëm, Gjaku dhe organet formuese të gjakut, Sistemi muskolo-skeletik, Sistemi nervor dhe Sistemi respirator*".

Përllogaritja e fondit limit për secilin bar/ lot, nga Komisioni i planifikimit të barnave, *për të përcaktuar vlerën e pritshme të kontratave*, të detajuar sipas institucioneve spitalore përfituese dhe në total, realizohet, si më poshtë:

1. Për barnat e listës aktuale për përdorim spitalor të regjistruara (të autorizuara për tregtim) – Për barnat e regjistruara, të autorizuara për tregtim (sipas regjistrit të përditësuar te barnave) në vendin tonë, bazuar në çmimet CIF/EXË 2024, të miratuara nga Komisioni i Çmimit të Barnave, është përllogaritur çmimi mesatar për njësi i alternativave për çdo bar. Çmimi CIF/njësi (për barnat e importit), është konvertuar në valutën lek (ALL), sipas kursit mesatar të këmbimit, njoftuar nga Banka e Shqipërisë nëpërmjet shkresës për 6 mujorin e dytë 2023.

2. Për barnat e paregjistruara (të paautorizuara për tregtim) – Për barnat e paregjistruara (të paautorizuara për tregtim) në vendin tonë, përllogaritet çmimi mesatar/njësi, nga autorizimet e importit për barna të paautorizuara, lëshuar gjatë viteve 2021-2022-2023 duke përfshirë edhe autorizimet e importit të lëshuara për barna të paautorizuara gjatë periudhës janar-shkurt 2024.

3. Për barnat të cilat që në momentin e planifikimit nuk kanë çmim të miratuar për vitin 2024 është marrë në referencë për fondin limit çmimi më i fundit i miratuar – Mbi çmimin mesatar/njësi të barnave (të autorizuara dhe të paautorizuara) llogaritur si me sipër, janë aplikuar marzhet e tregtimit, në përputhje me përcaktimet e VKM-së nr. 143, datë 18.02.2015 "*Për përcaktimin e marzheve të tregtimit dhe fabrikimit të barnave*".

Nëpërmjet Urdhrit të Prokurimit nr. 275, datë 17.05.2024, Titullari i AK S. H. ka kërkuar kryerjen e procedurës së prokurimit me fond limit/vlerë të përgjithshme të kontratave në total prej 6,216,677,709 lekë pa TVSH, e ndarë në 129 Lot-e, duke përcaktuar njësinë e prokurimit, të përbërë nga A.P (*anëtar, person përgjegjës për prokurimin*), E. B. (*anëtar, specialist fushe*), E. L. (*anëtar, person përgjegjës për prokurimin*), L. A. (*anëtar, person përgjegjës për prokurimin*), E. M. (*anëtar*). Nëpërmjet Urdhrit nr. 275/1, datë 17.05.2024, Titullari i AK ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, të përbërë nga M. Sh (kryetar), M. K. (specialist fushe), E. H., anëtarë.

Me Formularin e Njoftim Anulimi me nr. 2326/3, datë 28.05.2024, për njoftimin e anulimit të procedurës së prokurimit për 61 Lot-e, sikurse cituar "për gabime materiale në të dhënat e lot-eve, në vlerë të fondit limit të përcaktuar 3,770,346,465 lekë pa TVSH. *Për sa më sipër, praktikisht procedura e prokurimit B2 ka vijuar e ndarë në 68 Lot-e, me fond limit total të përllogaritur prej 2,446,331,244 lekë pa TVSH*. Barnat sipas 61 lot-eve të anuluar janë përfshirë në procedurën e prokurimit B3.

Nga 68 lote është shpallur fillimi i procedurës, por 4 procedura me fond limit 15,075,817 lekë janë anuluar, përkatësisht: "Lot 27 Human Rabies Immunoglobulin 150 UI", Lot 31 Amoxicillin + Clavulanic Acid 1gr + 200 mg, Lot 32 Fluconazole, Lot 83 Sodium chloride + Potassium acetatë, dhe Lot 112 Valproic Acid + Sodium valproate 145 mg + 333 mg.

"*Blerje barna Anti-infektivë të përgjithshëm, Gjaku dhe organet formuese të gjakut, Sistemi muskolo-skeletik, Sistemi nervor dhe Sistemi respirator*", ndarë në 68 lot-e, me fond limit total të përllogaritur 2,446,331,243 lekë pa TVSh.

Në këtë procedurë prokurimi janë prokuruar barna, të ndarë sipas sistemeve, si më poshtë:

Nr.	Sistemi	Nr. i barnave (lot-eve)	Sasia (totale) e barnave e kërkuar	Fondi limit (lekë pa TVSh)	Vlerë e kontraktuar (lekë pa TVSh)	Lot-e të pasuksesshëm	Vlera limit e lot-eve të pasuksesshëm
1	Anti-infektivë të përgjithshëm	40	5,524,309	1,598,512,162	746,524,000	2	10,365,726
2	Gjaku dhe organet formuese të gjakut	16	2,964,151	583,390,134	521,748,004	1	2,586,696
3	Sistemi muskulo-skeletik	4	55,269	71,317,649	29,109,575	-	
4	Sistemi nervor	7	862,361	189,762,403	149,542,323	1	2,123,395
5	Sistemi respirator	1	6,950	3,348,896	3,197,000	-	
TOTALI		**68**	**9,413,040**	**2,446,331,244**	**1,450,120,902**	**4**	**15,075,817**

Në zbatim të kësaj procedure prokurimi të ndarë me 64 lot-e, MShMS ka lidhur në total 4 marrëveshje kuadër (me disa operatorë), përkatësisht:

Nr.	Nr. prot.	Datë	Lotet
1	2326/10	23.07.2024	3,5,6,16,19,20,24,25,26,29,34,36,39,48,49,63,64,74,78,79,81,82,92,106,111,113,120, 123, 124, 125, 126, 127,128,129
2	2326/19	07.08.2024	1, 22, 28, 32, 33, 35, 60, 77, 80, 93, 94, 122
3	2326/23	12.08.2024	2,4,7,8,9,10,11,13,14,15,17,18,21,23,30,87,103
4	2326/27	19.08.2024	12

Grupi i auditimit ka përzgjedhur për auditim 21 Lot-e, bazuar në çmimin më të lartë për njësi të barit dhe/ ose vlerën më të lartë të kontraktuar dhe/ ose diferencën më të madhe me fondin limit dhe/ ose indicie për mungesë barnash nga burime të hapura (media, etj.). Nga vlera totale e kontraktuar për B2 prej 2,446,331,243 lekë pa TVSh, vlera për Lot-et e përzgjedhur për auditim është 1,597,934,265 lekë pa TVSH, ose rreth 65 % e vlerës totale. Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga MSHMS-ja ka rezultuar se:

Në auditimin e kritereve të vendosura nuk janë vendosur kritere në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar.

Konkretisht:

1. Në Dokumentet Standarde të Tenderit, Kriteret e Veçanta të kualifikimit pika 2.2.2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit ka përcaktuar të pa aplikueshme kërkesën: *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare _____, të shoqëruara me Akt*

Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ... (shëno bazën ligjore), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit. (nuk është i aplikueshëm)

Në përputhje me vlerat e fondit limit dhe natyrën e prokurimit Grupi i auditimit, konstaton se në DST "Kritereve të Veçanta të Kualifikimit", "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" nga Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit duhet përcaktuar:
-Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin pasqyrat financiare vjetore, për vitet financiare 2021,2022,2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, dhe Raportet e Auditimit, kjo në përputhje e zbatim të përcaktimeve të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Standartet e Kontabilitetit ku përcaktohet: *Subjektet detyrohen të kryejnë auditim ligjor të pasqyrave financiare vjetore para publikimit të tyre nga auditues ligjore ose shoqëri audituese -në nivelin e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimit) në atë periudhë kontabël arrin ose kalon shumën prej 100 milion lekë.*
Veprim në kundërshtim me nenin 77, pika 3, e Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.
2. Në Dokumentet Standarde të Tenderit, Kriteret e veçanta pika 2.3. Aftësitë teknike dhe profesionale, Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit ka përcaktuar të pa aplikueshme kërkesën:
Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë: (nuk është i aplikueshëm)
Në përputhje me natyrën e prokurimit Grupi i auditimit, konstaton se në DST "Kritereve të Veçanta të Kualifikimit", "Aftësitë Teknike dhe Profesionale" nga Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit duhet përcaktuar:
- Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, (Drejtues Teknik) që plotëson kushtet e tregtimit të ilaçeve për njerëz në përputhje me nenin 29 të Ligjit nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik" ku përcaktohet:
Drejtuesi teknik i tregtuesit farmaceutik me shumicë
1. Drejtues teknik i tregtuesit farmaceutik me shumicë është çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë ose i huaj, që plotëson kërkesat e mëposhtme: a) zotëron diplomë universitare të Fakultetit të Farmacisë; për shtetasit e huaj nevojitet të ligjit i diplomës universitare nga ministria përgjegjëse për arsimin; b) ka një përvojë pune prej dy vjetësh në shërbimin farmaceutik; c) është anëtar i Urdhrit të Farmacistëve.
2. Drejtuesi teknik i tregtuesit farmaceutik është përgjegjës për të gjithë veprimtarinë teknike dhe profesionale që zhvillon tregtuesi me shumicë.
3. Tregtuesi me shumicë ushtron veprimtarinë vetëm në prani të drejtuesit teknik ose të farmacistit të punësuar.
Veprim në kundërshtim me nenin 77, pika 4, e Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, si dhe nenin 40, pika 5, gërma a) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar,

Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës dhe sistemit SPE, rezulton:

Procedura e prokurimit zhvilluar në datë 20.06.2024

1. **Lot 1 "*Ceftriazone*", me nr. REF-05458-05-20-2024, me fond limit 363,447,780 lekë pa TVSH, sasia totale prej 1214217 flakon/ ampulë(hollues)**

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Lot 1 "Ceftriazone", me nr. REF-05458-05-20-2024, me fond limit 363,447,780 lekë</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
nr. 275, datë 17.05.2024</td><td rowspan="2">2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Urdhër nr. 275, datë 17.05.2024
A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..

Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit
Urdhër nr. 716, nr. 4446 prot., datë 07.12.2023, ndryshuar nëpërmjet Urdhrit nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024
N.A., E. B. (farmacist), E. T. (mjek). Pas ndryshimit zëvendësohet E. T. me F. B. (mjek).</td><td rowspan="2">3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Urdhër nr. 275/1, datë 17.05.2024
M. Sh (kryetar);
M. K. (specialist fushe);
E. H., anëtar</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit
"E hapur mbi kufirin e lartë monetar"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit:
363,447,780 lekë pa TVSH</td><td>6. Oferta fituese:" OE "M.", me vlerë 56,084,683.23 lekë pa TVSH</td><td>7. Diferenca me fondin limit:
307,363,096,77 lekë pa TVSH</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
20.06.2024</td><td>9. Burimi i Financimit:
Buxheti i Shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës: 9 OE+BOE
b) Skualifikuar: -
c) Kualifikuar: 9 OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime: -</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>12. Lidhja e M Kuadër
nr. 2326/19, datë 07.08.2024</td><td>13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër
363,447,780 lekë pa TVSH</td><td>14. Afati i MK në ditë
24 muaj</td></tr>
</table>

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 1 është kërkuar sasia totale prej 1214217 flakon/ ampulë(hollues). Në këtë procedurë ka marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	M.	56,084,683.23	Kualifikuar/ fitues
2	I.	62,532,175.5	Kualifikuar
3	P.	66,781,935	Kualifikuar
4	T.	68,591,118.33	Kualifikuar
5	I.	77,709,888	Kualifikuar
6	M.	96,408,829.8	Kualifikuar
7	E.	106,851,096	Kualifikuar
8	E.	111,707,964	Kualifikuar
9	P. P	133,563,870	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "M." 56,084,683.23 lekë pa TVSH. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH	Vendi i prodhimit
1	Ceftriazone	1mg	Flakon/ Falkon +ampulë	1214217	46.19	56,084,683.23	Q. Ph.Spain	Kinë

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, OE ka paraqitur shkresën e Drejtorit të Përgjithshëm të AKBPM nr. 2534/33 prot., datë 29.06.2021, ku vërtetohen se bari me emër tregtar "C.", me përbërës aktiv "CEFTRIAXO (as CEFTRIAXO NE SODIUM)", formë-doza 1g ampulë/ampulë+pluhur, me mbajtës të autorizimit për tregtim "Q.PH. S. S.L - SPANJË", i cili disponon Riautorizimin për tregtim nga AKBPM nr. 253, datë 23.05.2021. Sa i përket

autorizimit nga prodhuesi, OE ka paraqitur autorizimin e datës 20.05.2024 nga Q. Ph. S. SL, të vlefshëm nga data 20.05.2024 deri në 31.12.2026.
Nisur nga fakti se oferta e paraqitur nga OE është më e ulët se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme, Në sistemin si dhe në dokumentacionin e dosjes nuk ka kërkesë nga AK për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, ka rezultuar se OE ka paraqitur argumentimin e ofertës nëpërmjet shkresës së datës 11.07.2024, e paprotokolluar në MSHMS, ku citohet se "*çmimi i ofertës së propozuar është i ulët në raport me fondin limit pasi MAH ka bërë ofertë të veçantë për të siguruar fitoren në lote specifikë*". Nuk ka bashkëlidhur korrespondencën me MAH ku konfirmohet se çmimi i ofertuar i referohet produktit të së njëjtës cilësie dhe standardi, por vetëm deklaratën e OE për të konfirmuar çmimin e ulët.
Veprim në kundërshtim me nenin 93 Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku përcaktohet:
1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.
dhe me nenin 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.ku përcaktohet:
Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.
Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.
Marrëveshje Kuadër me nr. 2326/19, datë 07.08.2024 përfshin edhe lotin 1 me fitues OE "M." për 56,084,683.23 lekë pa TVSH.
Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale nuk ka të dhëna mbi lidhjen e mini kontratave nga Spitalet në zbatim të marrëveshjes kuadër sipas planifikimit të kërkesave dhe realizimin e për secilin spital si dhe ecurinë e marrjes së barnave në përputhje e afatet e përcaktuara.

1. **Lot 2 "*Levofloxacine 5mg/ml-100ml flakon*", me nr. REF-05453-05-20-2024, me fond limit 156,032,071 lekë pa TVSH, sasia totale prej 150905 flakon.**

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Lot 2 "Levofloxacine 5mg/ml-100ml flakon", me nr. REF-05453-05-20-2024, me fond limit 156,032,071 lekë pa TVSH</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
nr. 275, datë 17.05.2024</td><td rowspan="2">2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Urdhër nr. 275, datë 17.05.2024
A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..

Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit
Urdhër nr. 716, nr. 4446 prot., datë 07.12.2023, ndryshuar nëpërmjet Urdhrit nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024
N.A., E. B. (farmacist), E. T. (mjek). Pas ndryshimit zëvendësohet E. T. me F. B. (mjek).</td><td rowspan="2">3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Urdhër nr. 275/1, datë 17.05.2024
M. Sh (kryetar);
M. K. (specialist fushe);
E. H., anëtar</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit
"E hapur mbi kufirin e lartë monetar"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit:
156,032,071 lekë pa TVSH</td><td>6. Oferta fituese:" OE "A. Ph" me vlerë 15,045,228.5lekë pa TVSH</td><td>7. Diferenca me fondin limit:
140,986,842.5 lekë pa TVSH</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
20.06.2024</td><td>9. Burimi i Financimit:
Buxheti i Shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës: 12 OE+BOE
b) Skualifikuar: 2
c) Kualifikuar: 10 OE</td></tr>
</table>

11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër nr. 2326/23, datë 12.08.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 156,032,071 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 2 është kërkuar sasia totale prej 150905 flakon. Në këtë procedurë ka marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	A. Ph	15,045,228.5	Kualifikohet
2	R. F.	20,689,075.5	Skualifikuar
3	I.	20,975,795	Kualifikuar
4	L.	21,277,605	Kualifikuar
5	M.	22,484,845	Kualifikuar
6	F. F	24,144,800	Kualifikuar
7	P. P	24,750,000	Kualifikuar
8	E.	25,201,135	Kualifikuar
9	M.	28,581,407	Kualifikuar
10	F. F	57,343,900	Kualifikuar
11	P.	58,852,950	Kualifikuar
12	T.	155,733,960	Skualifikohet

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "A. Ph" për 15,045,228.5 lekë pa TVSH. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH	Vendi i prodhimit
2	Levofloxacin	5mg/ml - 100ml Flakon	Flakon	150905	99.7	15,045,228.50	P.	Shqipëri

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, referuar AKBPM nr. 392, datë 13.09.2021, ku vërtetohen se bari me emër tregtar "L.", me përbërës aktiv "Levofloxacin Hemihidrate", formë-doza 5mg/ml (500mg/100ml) Solution for infusion, me mbajtës të autorizimit për tregtim "P. Shqipëri" dhe prodhues "P. Shqipëri"

Komisioni ka skualifikuar OE "R. F." me arsyetimin se deri në datën e hapjes së ofertave bari i ofertuar me emër tregtar "L.", me përbërës aktiv "Levofloxacin Hemihydrate", formë-doza 5mg/ml Solution for infusion nuk rezulton i regjistruar pasi nuk ka paraqitur autorizim për tregtim. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Listës e Barnave të regjistruara në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore rezulton i regjistruar si bar me autorizimin nr. 329, datë 20.06.2024, me mbajtës të autorizimit për tregtim "F. K. Gjermani" dhe prodhues "F. K. Poloni". Nisur nga fakti se oferta e paraqitur nga OE është më e ulët se 85 % e mesatares së ofertave të vlefshme. Në sistemin SPE si dhe në dokumentacionin e dosjes nuk ka kërkesë nga AK për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët. Me kërkesën e Grupit të Auditimit Komisioni i Vlerësimit të Ofertave paraqiti dokumentacioni e OE nëpërmjet shkresës datës 11.07.2024, mbi argumentimin e ofertës (shkresë e paprotokolluar në MSHMS), ku citohet se "*çmimi i ofertës së propozuar është i ulët në raport me fondin limit pasi MAH (P.) ka konfirmuar se çmimi nuk ndryshon nga ai i ofruar*", duke bashkëlidhur korrespondencën shkresore me MAH datë 18.06.2024 ku konfirmohet se çmimi i ofertuar i referohet produktit të së njëjtës cilësie dhe standardi, si dhe kontratën e furnizimit me afat 5 vjeçar lidhur në datë 01.10.2023. Në dokumentacionin e paraqitur nuk ka shpjegime për koston ose çmimin e ofruar.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit për plotësimin e kritereve të veçanta dhe të përgjithshme KVO nëpërmjet SPE kërkoi paraqitjen e dokumentacionit fizik për këtë lot, kjo referuar pikës 6, të nenit 26, të Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku parashikohet :

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit fizik KVO e vlerëson ofertën e OE "L." shpk të suksesshme.

Marrëveshje Kuadër me nr. 2326/10, datë 23.07.2024 përfshin edhe lotin 49 me fitues OE "L." për 83,536,100.00 lekë pa TVSH.

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale nuk ka të dhëna mbi lidhjen e mini kontratave nga Spitalet në zbatim të marrëveshjes kuadër sipas planifikimit të kërkesave dhe realizimin e për secilin spital si dhe ecurinë e marrjes së barnave në përputhje e afatet e përcaktuara.

15. Lot 48 "*Human Coagulation Factor IX*", me nr. REF-05571-05-20-2024, me fond limit 47,947,976.40 lekë pa TVSH, sasia totale prej 1454000 flakon me pluhur.

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt Lot 48 "Human Coagulation Factor IX", me nr. REF-05571-05-20-2024, me fond limit 47,947,976.40 lekë pa TVSH,</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
nr. 275, datë 17.05.2024</td><td rowspan="2">2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Urdhër nr. 275, datë 17.05.2024
A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..

Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit
Urdhër nr. 716, nr. 4446 prot., datë 07.12.2023, ndryshuar nëpërmjet Urdhrit nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024
N.A., E. B. (farmacist), E. T. (mjek). Pas ndryshimit zëvendësohet E. T. me F. B. (mjek).</td><td rowspan="2">3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Urdhër nr. 275/1, datë 17.05.2024
M. Sh (kryetar);
M. K. (specialist fushe);
E. H., anëtar</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit
"E hapur mbi kufirin e lartë monetar"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit:
47,947,976.40 lekë pa TVSH</td><td>6. Oferta fituese BOE "M." dhe "M.", për 47,909,300 lekë pa TVSH.</td><td>7. Diferenca me fondin limit:
38,676.4 lekë pa TVSH</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
20.06.2024</td><td>9. Burimi i Financimit:
Buxheti i Shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës: 1 BOE
b) Skualifikuar: -
c) Kualifikuar: 1 BOE</td></tr>
</table>

11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër nr. 2326/10, datë 23.07.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 47,947,976.40 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 48 është kërkuar sasia totale prej 1454000 flakon me pluhur. Në këtë procedurë ka marrë pjesë BOE, si më poshtë:

Nr.	BOE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	BOE: M.&M.	47,909,300.00	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e BOE "M." dhe "M.", për 47,909,300 lekë pa TVSH. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH	Vendi i prodhimit
48	Human Coagulation Factor IX	250 I.U/500 I.U/1000 IU	flakon/flakon pluhur+ampule flakon (hollues)	1454000	32.95	47,909,300	O./K.	France,Gjermani, Austri/Itali,France

Për sa më lart bari me emrat tregtar "A." dhe "O. F" me të njëjtin përbërës aktiv "Human Coagulation Factor IX" 500UI/10ml, Formë-doza: 500UI/10ml, rezultojnë mbajtësa të autorizimit për tregtim: "K." Itali dhe "Ö. Ph." Austri.

- "M." është distributor zyrtar i "K." Itali për barin "Human Coagulation Factor IX" 500UI/10ml me emrin tregtar "A.", dhe ka paraqitur Autorizim për Tregtim me nr. 46 datë 27.01.2021 lëshuar nga AKBPM.
- "M." është distributor zyrtar i "O. Ph." Austri për barin "Human Coagulation Factor IX", 500UI/10ml me emrin tregtar "O. F". Sipas shkresës nr. 2005/7, datë 29.05.2024 nga AKBPM "kthim përgjigje" ku njofton "M." se bari me emrin tregtar "O. F" dhe principin "Coagulation Factor IX", 500UI/10ml, ka Autorizim për tregtim me nr. 331 datë 12.07.2021 lëshuar AKBPM. *Në sistemin SPE nuk ka paraqitur formularin e Autorizimit për Tregtim lëshuar nga AKBPM.*

Kontrata e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë lidhur më 14.06.2024 përcakton në nenin 3 përqindjen e pjesëmarrjes në lotin 48 përkatësisht "M." 50%, "M." 50%, por pa e specifikuar ndarjen sipas njësive spitalore. Sipas aktmarrëveshjes datë 14.06.2024 rezulton të dy operatorët ekonomik kanë përqindje të barabartë në furnizimin e barit, por, në dokumentacionin e paraqitur dhe administruar në SPE nga BOE "M."&"M." nuk administrohet dokumentacion për të konfirmuar distribucionin apo përfaqësinë nga mbajtësit e autorizimit për tregtim e këtij bari në Republikën e Shqipërisë si dhe leja për të tregtuar barnat nga BOE që kanë marrë pjesë në prokurim dhe janë shpallur fitues, por vetë autorizimet si:

-Autorizim për Tregtim me nr. 46 datë 27.01.2021 nga AKBPM për barin "Human Coagulation Factor IX" 500UI/10ml me emrin tregtar "A.", me mbajtës autorizimi "K." Itali, si dhe

- Autorizim për tregtim me nr. 331 datë 12.07.2021 nga AKBPM *(Sipas shkresës nr. 2005/7, datë 29.05.2024 AKBPM "kthim përgjigje" njofton "M.")* për bari me emrin tregtar "O. F" dhe principin "Coagulation Factor IX", 500UI/10ml, me mbajtës të autorizimit "Oc. Ph." Austri.
Veprime në kundërshtim me kërkesat ligjit 105/2014 "Për barnat e Shërbimin farmaceutik" neni 32 "Importi i barnave të autorizuara" pika 1 ku përcaktohet:
1. Barnat e autorizuara në Republikën e Shqipërisë importohen nga importuesit e autorizuar nga kompanitë mbajtëse të autorizimit të tregtimit, pas pajisjes me autorizim importi të lëshuar nga Agjencia, në bazë të regjistrit të botuar të barnave.
dhe në mos përputhje me nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik"

Marrëveshje Kuadër me nr. 2326/10, datë 23.07.2024 përfshin edhe lotin 5 me fitues BOE "M.", "M.", për 47,909,300 lekë pa TVSH.
Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale nuk ka të dhëna mbi lidhjen e mini kontratave nga Spitalet në zbatim të marrëveshjes kuadër sipas planifikimit të kërkesave dhe realizimin e për secilin spital si dhe ecurinë e marrjes së barnave në përputhje e afatet e përcaktuara.

16. Lot 87 "*Zoledronic Acid*", me nr. REF-05659-05-20-2024, me fond limit 17,254,332.34 lekë pa TVSH, sasia totale prej 2580 Flakon.

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt Lot 87 "Zoledronic Acid", me nr. REF-05659-05-20-2024, me fond limit 17,254,332.34 lekë pa TVSH,</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
nr. 275, datë 17.05.2024</td><td rowspan="2">2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Urdhër nr. 275, datë 17.05.2024
A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..

Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit
Urdhër nr. 716, nr. 4446 prot., datë 07.12.2023, ndryshuar nëpërmjet Urdhrit nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024
N.A., E. B. (farmacist), E. T. (mjek). Pas ndryshimit zëvendësohet E. T. me F. B. (mjek).</td><td rowspan="2">3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Urdhër nr. 275/1, datë 17.05.2024
M. Sh (kryetar);
M. K. (specialist fushe);
E. H., anëtar</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit
"E hapur mbi kufirin e lartë monetar"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit:
17,254,332.34 lekë pa TVSH</td><td>6. Oferta fituese OE "D. Ph." për 1,497,690.00 lekë pa TVSH..</td><td>7. Diferenca me fondin limit:
38,676.4 lekë pa TVSH</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
20.06.2024</td><td>9. Burimi i Financimit:
Buxheti i Shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës: 3 OE
b) Skualifikuar: -
c) Kualifikuar: 3 OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime: -</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>12. Lidhja e M Kuadër
nr. 2326/23 datë 12.08.2024</td><td>13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër
17,254,332.34 lekë pa TVSH</td><td>14. Afati i MK në ditë
24 muaj</td></tr>
</table>

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 87 është kërkuar sasia totale prej 2580 Flakon. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	"D. Ph."	1,497,690	Kualifikuar
2	F. F	4,461,420	Kualifikuar
3	R. F.	7,105,320	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "D. Ph." për 1,497,690.00 lekë pa TVSH. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, oferta e OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH	Vendi i prodhimit
89	"Zoledronic Acid"	4 mg/5 ml	Flakon	2580	580.5	1,497,690.00	I. I./C.	Turqi/Turqi

Autorizimin për tregtim të barit, me nr. 161, datë 11.03.2020 nga AKBPM, vërteton se bari me emër tregtar "R.", me përbërës aktiv "Zoledronic Acid", formë-doza: 4mg/5ml, Flakon ka mbajtës të autorizimit për tregtim "C. I. S..." dhe prodhues "Turqi".

Oferta e paraqitur nga OE "D. Ph." prej 1,497,690 lekë e kualifikuar si e suksesshme është më e ulët se 85 % e mesatares së ofertave të vlefshme. Grupi i auditimit ka konstatuar se në SPE si dhe në dokumentacionin e administruar në dosje, nuk ka kërkesë nga AK për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët. Mbas kërkesës për sqarime nga grupi i auditimit, AK ka paraqitur dokumentacion argumentues nga OE "D. Ph." kjo me shkresën nr. 73, datë 10.07.2024 drejtuar Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (MSHMS) (shkresë e pa protokolluar në MSHMS) ku i bashkëlidhen në fotokopje "Amendament i marrëveshjes për shpërndarje të furnizimit të prodhimit" datë 14.01.2019 si dhe një informacion në formë tabelare për një sasi prej 2580 flakon për Loti 87 "Zoledronic Acid" në dozën 4mg/5ml me çmimin prej 280.5 (pa specifikuar) të propozuar nga "C.". Në dokumentacionin e paraqitur nuk ka shpjegime për koston ose çmimin e ofruar.
Veprime në kundërshtim me nenin 93 Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku përcaktohet:
1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.
dhe me pikën 4 të nenin 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet:
4. Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:
-Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Marrëveshje Kuadër me nr. 2326/23 datë 12.08.2024 përfshin edhe lotin 87 me fitues OE "D. Ph." për 1,497,690 lekë pa TVSH.
Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale nuk ka të dhëna mbi lidhjen e mini kontratave nga Spitalet në zbatim të marrëveshjes kuadër sipas planifikimit të kërkesave dhe realizimin e për secilin spital si dhe ecurinë e marrjes së barnave në përputhje e afatet e përcaktuara.

17. Lot 15 "*Cefuroxime 750 mg Flakon/ Flakon + ampule (hollues)*", me nr. REF-05489-05-20-2024, me fond limit 29,891,260.40 lekë pa TVSH, sasia totale prej 243112 Flakon/ Flakon + ampule (hollues).

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt ***Lot 15 "Cefuroxime 750 mg Flakon/ Flakon + ampule (hollues)", me nr. REF-05489-05-20-2024, me fond limit 29,891,260.40 lekë pa TVSH***		
1. **Urdhër Prokurimi** nr. 275, datë 17.05.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 275, datë 17.05.2024 A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 275/1, datë 17.05.2024 M. Sh (kryetar); M. K. (specialist fushe); E. H., anëtar
4. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur mbi kufirin e lartë monetar"	**Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit** Urdhër nr. 716, nr. 4446 prot., datë 07.12.2023, ndryshuar nëpërmjet Urdhrit nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024 N.A., E. B. (farmacist), E. T. (mjek). Pas ndryshimit zëvendësohet E. T. me F. B. (mjek).	
5. Fondi Limit: 29,891,260.40 lekë pa TVSH	**6. Oferta fituese** OE "T." për 15,471,711.32 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit:** 14,419,549.08 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: 20.06.2024	**9. Burimi i Financimit:** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 6 OE b) Skualifikuar: - c) Kualifikuar: 6 OE
11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër nr. 2326/23 datë 12.08.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 29,891,260.40 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 15 është kërkuar sasia totale prej 243112 Flakon/ Flakon + ampule (hollues). Në këtë procedurë ka marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	**OE, BOE**	**Oferta ekonomike**	**Statusi**
1	T.	15,471,711.32	Kualifikuar
2	I.	17,990,362.00	Kualifikuar
3	L.	18,962,814.00	Kualifikuar
4	F.	19,205,927.00	Kualifikuar
5	I .	19,449,040.00	Kualifikuar
6	M.&E.F.	20,032,511.20	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "T." për 15,471,711.32 lekë pa TVSH. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE oferta nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH	Vendi i prodhimit
15	**Cefuroxime 750 mg**	**750 mg**	**Flakon**	**243112**	**63.64**	**15,471,711.32**	**M.**	**Qipro**

Autorizimi për tregtim me nr. 359, datë 26.04.2019, lëshuar nga AKBPM vërteton se bari me emër tregtar "A.", me përbërës aktiv "Cefuroxime 750 mg", formë-doza: 750 mg Flakon/ Flakon + ampule (hollues), ka mbajtës të autorizimit për tregtim "M." dhe prodhues "Qipro".

Në dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi "T." është edhe shkresa nga AKBPM "kthim përgjigje" me nr. 936/3, datë 04.04.2024 ku konfirmohet se dokumentacioni i dorëzuar në AKBPM për rinovimin e autorizimit me nr. 359, datë 26.04.2019, për bar me emër tregtar "A.", me përbërës aktiv "Cefuroxime 750 mg", formë-doza: 750 mg Flakon/ Flakon + ampule (hollues) plotëson kërkesat për rinovimin e autorizimit për tregtim në Republikën e Shqipërisë. Në procesin e tenderimit nga OE "T." nuk është paraqitur Autorizim për tregtim të barnave në Republikën e Shqipërisë, çka përbën mos plotësimin e DST, pika 2.4.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim.

Oferta e paraqitur nga OE "T." prej 15,471,711.32 lekë e kualifikuar si e suksesshme është më e ulët se 85 % e mesatares së ofertave të vlefshme. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në SPE nuk ka të dokumentuar nëpërmjet SPE kërkesën për argumentim të vlerës së ofertës prej 15,471,711.32 lekë si anomalisht e ulët nga OE "T.". Mbas kërkesës për sqarime nga grupi i auditimit, AK ka paraqitur dokumentacion argumentues nga OE "T." sipas shkresës datë 11.07.2024 drejtuar Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (MSHMS) (shkresë e pa protokolluar në MSHMS). Ku citohet: *Në përgjigje të kërkesës dërguar në SPE datë 09.07.2024 lidhur me ofertën anomalisht të ulët, për sqarime është bashkëlidhur në fotokopje "pjesë të marrëveshjes për shpërndarje të furnizimit.* Në dokumentacionin e paraqitur nuk ka shpjegime për koston ose çmimin e ofruar.
Veprime në kundërshtim me nenin 93 Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku përcaktohet:
1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.
Marrëveshje Kuadër me nr. 2326/23 datë 12.08.2024 përfshin edhe lotin 15 me fitues OE "T." për 15,471,711.32 lekë pa TVSH.
Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale nuk ka të dhëna mbi lidhjen e mini kontratave nga Spitalet në zbatim të marrëveshjes kuadër sipas planifikimit të kërkesave dhe realizimin e për secilin spital si dhe ecurinë e marrjes së barnave në përputhje e afatet e përcaktuara.

18. *Lot122 "Vecuronium bromide" 10 mg Flakon*, me nr. REF-05739-05-20-2024, me fond limit 49,339,254.95 lekë pa TVSH, sasia totale prej 40814 Flakon.

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt Lot122 "Vecuronium bromide" 10 mg Flakon, me nr. REF-05739-05-20-2024, me fond limit 49,339,254.95 lekë pa TVSH,</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
nr. 275, datë 17.05.2024</td><td rowspan="2">2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Urdhër nr. 275, datë 17.05.2024
A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..

Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit
Urdhër nr. 716, nr. 4446 prot., datë 07.12.2023, ndryshuar nëpërmjet Urdhrit nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024
N.A., E. B. (farmacist), E. T. (mjek). Pas ndryshimit zëvendësohet E. T. me F. B. (mjek).</td><td rowspan="2">3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Urdhër nr. 275/1, datë 17.05.2024
M. Sh (kryetar);
M. K. (specialist fushe);
E. H., anëtar</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit
"E hapur mbi kufirin e lartë monetar"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit:
49,339,254.95 lekë pa TVSH</td><td>6. Oferta fituese OE "I." për 24,488,280 lekë pa TVSH</td><td>7. Diferenca me fondin limit:
24,850,974.95 lekë pa TVSH</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
20.06.2024</td><td>9. Burimi i Financimit:
Buxheti i Shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës: 3 OE
b) Skualifikuar: -
c) Kualifikuar: 3 OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime: -</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>12. Lidhja e M Kuadër
nr. 2326/19 datë 07.08.2024</td><td>13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër
49,339,254.95 lekë pa TVSH</td><td>14. Afati i MK në ditë
24 muaj</td></tr>
</table>

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 122 është kërkuar sasia totale prej 40814 Flakon. Në këtë procedurë ka marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	OE, BOE	Oferta ekonomike		Statusi
1	I.	24,488,280.00		Kualifikuar

2	E. – F.	44,650,516.00		Kualifikuar
3	L.	49,335,963.20		Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "I." për 24,488,280 lekë pa TVSH. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE oferta e OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH	Vendi i prodhimit
122	Vecuronium bromide	10 mg	Flakon	40814	599.99	24,488,280	V. I.	Turqi

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, me shkresë nr. 2293/1, datë 19.06.2024, nga AKBPM, në listën e barnave të pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë citohet edhe Autorizimi me nr. 89, datë 22.02.2024, i lëshuar për bar me emër tregtar "V.", me përbërës aktiv "Vecuronium bromide", formë-doza: 10 mg, Flakon me mbajtës të autorizimi për tregtim subjektin "V. I.", vendi prodhues "Turqi".

Oferta e paraqitur nga OE "I." prej 24,488,280.00 lekë e kualifikuar si e suksesshme është më e ulët se 85 % e mesatares së ofertave të vlefshme. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në SPE nuk ka të dokumentuar kërkesën për argumentim të vlerës së ofertës prej 24,488,280.00 lekë si anomalisht e ulët nga OE "I.", si dhe nuk administrohet dokumentacionin për shpjegime për koston ose çmimin e ofruar.
Veprim në kundërshtim me nenin 93 Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku përcaktohet:
1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.
dhe me pikën 4 të nenin 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet:
4. Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:
-Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.
Marrëveshje Kuadër me nr. 2326/19 datë 07.08.2024 përfshin edhe lotin 122 me fitues OE "I." për 24,488,280.00 lekë pa TVSH.
Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale nuk ka të dhëna mbi lidhjen e mini kontratave nga Spitalet në zbatim të marrëveshjes kuadër sipas planifikimit të kërkesave dhe realizimin e për secilin spital si dhe ecurinë e marrjes së barnave në përputhje e afatet e përcaktuara.

19. Lot 74 "*Recombinant human C1-inhibitor*", me nr. REF-05631-05-20-2024, me fond limit 27,976,278.96 lekë pa TVSH, sasia totale prej 300 Flakon/ Ampule.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt ***Lot 74 "Recombinant human C1-inhibitor", me nr. REF-05631-05-20-2024, me fond limit 27,976,278.96 lekë pa TVSH***		
1. **Urdhër Prokurimi** nr. 275, datë 17.05.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 275, datë 17.05.2024	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 275/1, datë 17.05.2024

4. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur mbi kufirin e lartë monetar"	A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M.. **Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit** Urdhër nr. 716, nr. 4446 prot., datë 07.12.2023, ndryshuar nëpërmjet Urdhrit nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024 N.A., E. B. (farmacist), E. T. (mjek). Pas ndryshimit zëvendësohet E. T. me F. B. (mjek).	M. Sh (kryetar); M. K. (specialist fushe); E. H., anëtar
5. Fondi Limit: 27,976,278.96 lekë pa TVSH	**6. Oferta fituese** OE "M." për 27,976,200.00 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit:** 78.96 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: 20.06.2024	**9. Burimi i Financimit:** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 1 OE b) Skualifikuar: - c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër nr. 2326/10, datë 23.07.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 27,976,278.96 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 74 është kërkuar sasia totale prej 300 Flakon/ Ampule. Në këtë procedurë ka marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	M.	27,976,200.00	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "M." për 27,976,200.00 lekë pa TVSH. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE oferta e OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH	Vendi i prodhimit
74	Recombinant human C1-inhibitor	2100 IU/25 ml	Flakon/Ampule	300	93,254	27,976,200.00	P. T.	Hollande,France

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, referuar dokumentacionit në SPE, OE "M." me deklaratën datë 20.06.2024 ka konfirmuar se bari me emrin tregtar "R." me princip aktiv "Recombinant human C1-inhibitor", formë dozë: 2100IU/5ml, ka Autorizim për tregtim nga Agjencia Europiane e Barnave (EMA) EU/1/10/641/001, datë 28.10.2010, pa afat.

- "P.T." me letër autorizimi datë 28.05.2024 ka autorizuar "Ph. Ph. D. Skopje" si distributor shpërndarje prodhimi në territorin e Shqipërisë, si dhe pjesëmarrjen në tenderim sipas REF-05631-05-20-2024.
- "Ph. Ph. D. Skopje" datë 07.06.2024, autorizon për pjesëmarrjen në tenderim sipas Lot 74, REF-05631-05-20-2024, OE "M.".

Referuar kërkesës datë 16.07.2024 të OE "M." për pajisjen me autorizim importi të barnave, si dhe shkresës së AKBPM me nr. 1932/1, datë 20.05.2024, ku përcaktohet se për principin aktiv "Recombinant human C1-inhibitor" nuk ka asnjë bar të pajisur me Autorizim Tregtimi në Republikën e Shqipërisë. OE "M." është pajisur nga Ministri i MSHMS me Autorizim Importi të Barnave nr. 62, datë 18.07.2024.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit paraqitur në SPE konstatojmë se në kundërshtim me DST dokumentacioni i paraqitur nga OE "M." është vetën në anglisht dhe nuk janë paraqitur me përkthim të noterizuar në gjuhen shqip, konkretisht: Autorizimi i "Ph. Ph.D. Skopje" datë

07.06.2024, për "M.", si dhe letër autorizimi datë 28.05.2024 ku "Ph.T." ka autorizuar "Ph.Ph.D. Skopje" si distributor shpërndarje prodhimi në territorin e Shqipërisë, edhe për pjesëmarrjen në tenderim REF-05631-05-20-2024.
Veprim në kundërshtim me DST "Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit" ku përcaktohet *Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.*
Pas shqyrtimit të dokumentacionit për plotësimin e kritereve të veçanta dhe të përgjithshme KVO nëpërmjet SPE kërkoi paraqitjen e dokumentacionit fizik për këtë lot, kjo referuar pikës 6, të nenit 26, të Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku parashikohet :
6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
Pas shqyrtimit të dokumentacionit fizik KVO e vlerëson ofertën e OE "M." shpk të suksesshme.
Marrëveshje Kuadër me nr. 2326/10, datë 23.07.2024 përfshin edhe lotin 74 me fitues OE "M." për 21,045,060 lekë pa TVSH.
Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale nuk ka të dhëna mbi lidhjen e mini kontratave nga Spitalet në zbatim të marrëveshjes kuadër sipas planifikimit të kërkesave dhe realizimin e për secilin spital si dhe ecurinë e marrjes së barnave në përputhje e afatet e përcaktuara.

20. Lot 79 "*Nadroparine calcium*", me nr. REF-05641-05-20-2024, me fond limit 94,827,928.89 lekë pa TVSH, sasia totale prej 244050 Shiringe e parapergatitur.

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt Lot 79 "Nadroparine calcium", me nr. REF-05641-05-20-2024, me fond limit 94,827,928.89 lekë pa TVSH</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
nr. 275, datë 17.05.2024</td><td rowspan="2">2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Urdhër nr. 275, datë 17.05.2024
A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..

Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit
Urdhër nr. 716, nr. 4446 prot., datë 07.12.2023, ndryshuar nëpërmjet Urdhrit nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024
N.A., E. B. (farmacist), E. T. (mjek). Pas ndryshimit zëvendësohet E. T. me F. B. (mjek).</td><td rowspan="2">3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Urdhër nr. 275/1, datë 17.05.2024
M. Sh (kryetar);
M. K. (specialist fushe);
E. H., anëtar</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit
"E hapur mbi kufirin e lartë monetar"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit:
94,827,928.89 lekë pa TVSH</td><td>6. Oferta fituese OE "I." për 94,691,400.00 lekë pa TVSH</td><td>7. Diferenca me fondin limit:
136,528.89 lekë pa TVSH</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
20.06.2024</td><td>9. Burimi i Financimit:
Buxheti i Shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës: 1 OE
b) Skualifikuar: -
c) Kualifikuar: 1 OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime: -</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>12. Lidhja e M Kuadër
nr. 2326/10, datë 23.07.2024</td><td>13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër
94,827,928.89 lekë pa TVSH</td><td>14. Afati i MK në ditë
24 muaj</td></tr>
</table>

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 79 është kërkuar sasia totale prej 244050 Shiringe e parapergatitur. Në këtë procedurë ka marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	I.	94,691,400.00	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "I." për 94,691,400.00 lekë pa TVSH. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE oferta e OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH	Vendi i prodhimit
79	Nadroparine calcium	5700 iu aXa/0.6ml	Shiringe e parapergatitur	244050	388	94,691,400.00	V.	Kroaci

Referuar dokumentacionit në SPE nga OE "I.". Autorizimin për tregtim të barit me nr. 91, datë 22.02.2024 lëshuar nga AKBPM vërteton se bari me emër tregtar "F.", me përbërës aktiv "Nadroparine calcium", formë-doza: 5700 iu Anti-Xa/0.6ml ka mbajtës të autorizimit për tregtim "V." dhe prodhues "Kroaci".

Pas shqyrtimit të dokumentacionit për plotësimin e kritereve të veçanta dhe të përgjithshme KVO nëpërmjet SPE kërkoi paraqitjen e dokumentacionit fizik për këtë lot, kjo referuar pikës 6, të nenit 26, të Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku parashikohet :

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit fizik KVO e vlerëson ofertën e OE "I." shpk të suksesshme.

Marrëveshje Kuadër me nr. 2326/10, datë 23.07.2024 përfshin edhe lotin 79 me fitues OE "I." për 94,691,400.00 lekë pa TVSH.

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale nuk ka të dhëna mbi lidhjen e mini kontratave nga Spitalet në zbatim të marrëveshjes kuadër sipas planifikimit të kërkesave dhe realizimin e për secilin spital si dhe ecurinë e marrjes së barnave në përputhje e afatet e përcaktuara.

21. Lot129 "*Human prothrombin complex as human coagulation factor (IX, II, VII, X) Protein C, Protein S*", me nr. REF-05754-05-20-2024, me fond limit 32,056,152.98 lekë pa TVSH, sasia totale prej 244050 Shiringe e parapergatitur.

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt Lot129 "Human prothrombin complex as human coagulation factor (IX, II, VII, X) Protein C, Protein S", me nr. REF-05754-05-20-2024, me fond limit 32,056,152.98 lekë pa TVSH</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
nr. 275, datë 17.05.2024</td><td rowspan="2">2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Urdhër nr. 275, datë 17.05.2024
A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..

Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit
Urdhër nr. 716, nr. 4446 prot., datë 07.12.2023, ndryshuar nëpërmjet Urdhrit nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024
N.A., E. B. (farmacist), E. T. (mjek). Pas ndryshimit zëvendësohet E. T. me F. B. (mjek).</td><td rowspan="2">3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Urdhër nr. 275/1, datë 17.05.2024
M. Sh (kryetar);
M. K. (specialist fushe);
E. H., anëtar</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit
"E hapur mbi kufirin e lartë monetar"</td></tr>
</table>

5. Fondi Limit: 32,056,152.98 lekë pa TVSH	**6. Oferta fituese** OE "M." për 32,053,875 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit:** 2,277.98 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit: 20.06.2024	**9. Burimi i Financimit:** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 1 OE b) Skualifikuar: - c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër nr. 2326/10, datë 23.07.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 32,056,152.98 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 129 është kërkuar sasia totale prej 525 Flakon. Në këtë procedurë ka marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	M.	32,053,875	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "F. M. A." për 32,053,875 lekë pa TVSH. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE oferta OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH	Vendi i prodhimit
129	Human prothrombin complex as human coagulation factor (IX, II, VII, X) Protein C, Protein S	40 ml	Flakon	525	61,055	32,053,875	O.	France,Gjermani,Austri

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, AKBPM me shkresë nr. 2005/7, datë 29.05.2024, në listën e barnave të pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë citohet edhe Autorizimi me nr. 289, datë 05.05.2022, ku përcaktohet se bari me emër tregtar "O.", me përbërës aktiv "Human prothrombin complex as human coagulation factor (IX, II, VII, X) Protein C, Protein S", formë-doza: 40 mg, Flakon ka mbajtës të autorizimi për tregtim subjektin "O.", vendi prodhues "Austri".

Nga shqyrtimi i dokumentacionit paraqitur në SPE konstatojmë se në kundërshtim me DST dokumentacioni i paraqitur nga OE "M." nuk shoqërohet me përkthim të noterizuar në gjuhen shqip, konkretisht: Autorizimi i "O." datë 06.05.2024, për "M.".

Veprim në kundërshtim me DST "Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit" ku përcaktohet *Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.*

Pas shqyrtimit të dokumentacionit për plotësimin e kritereve të veçanta dhe të përgjithshme KVO nëpërmjet SPE kërkoi paraqitjen e dokumentacionit fizik për këtë lot, kjo referuar pikës 6, të nenit 26, të Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku parashikohet :

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit fizik KVO e vlerëson ofertën e OE "M." shpk të suksesshme.

Marrëveshje Kuadër me nr. 2326/10, datë 23.07.2024 përfshin edhe lotin 129 me fitues OE "M." për 32,053,875 lekë pa TVSH.

Për sa më sipër janë paraqitur observacionet: për Projektraportin e Auditimit nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me nr. 85/2, datë 04.02.2026 ardhur në KLSH me nr. 110/27, datë 06.02.2026 nga Përfaqësuesit e MSHMS: A. A, L. A, E. L., E. B., D.K., E.H., V. H., S. K., M. K., M. Sh, për sa më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *Në lidhje me kërkesën për Kapacitetet ekonomike financiare – pika 2.2.2 e Procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimet teknike dhe kritereve për kualifikim sipas rregullave të prokurimit publik VKM 285/2021, autoriteti kontraktor mund të kërkojë pasqyrat financiare si provë për kapacitetin ekonomik dhe financiar të operatorit ekonomik. Pra, nuk kemi të bëjmë me një dispozitë me karakter detyrues, por me një dispozitë me karakter fakultativ (mundësues). Ligji nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe standardet përkatëse përcaktojnë detyrimin për auditim për subjektet që tejkalojnë një prag të caktuar qarkullimi (100 milion lekë), por ky detyrim është i natyrës rregullatore për subjektin, jo për autoritetin kontraktor, dhe nuk e shndërron vetvetiu paraqitjen e bilanceve të audituara në një kriter të detyrueshëm kualifikimi, mosparashikimi i një kërkese të tillë nuk përbën shkelje të ligjit, për sa kohë janë respektuar parimet themelore të trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, proporcionalitetit dhe konkurrencës.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se* ***argumentimi Juaj merret pjesërisht në konsideratë;*** *Nga Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit në kërkesat për kualifikim duhet përcaktuar: Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin pasqyrat financiare vjetore, për vitet financiare 2021,2022,2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, dhe Raportet e Auditimit, kjo në përputhje e zbatim të përcaktimeve të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Standartet e Kontabilitetit ku përcaktohet: Subjektet detyrohen të kryejnë auditim ligjor të pasqyrave financiare vjetore para publikimit të tyre nga audites ligjore ose shoqëri audituese -në nivelin e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimit) në atë periudhë kontabël arrin ose kalon shumën prej 100 milion lekë. Veprim në kundërshtim me nenin 77, pika 3, e Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.*

Pretendimi i subjektit: *Në lidhje me kriterin teknik për Drejtues Teknik Farmaceutik – pika 2.3 e Procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim. Në pikën 2.3.2 kapaciteti teknik i Kritereve të Veçanta të Kualifikimit të Shtojcës 7 të DST, është kërkuar: 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme per tregtim me shumice te barnave të lëshuar nga QKL ose QKB. Kërkimi i dyfishtë: i licencës së kompanisë dhe i dokumenteve personale të Drejtuesit Teknik, do të ishte i tepërt, i panevojshëm dhe në tejkalim të nevojës së verifikimit, duke rënë ndesh me frymën e ligjit për prokurimin publik.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se* ***argumentimi Juaj merret pjesërisht në konsideratë;*** *Grupi i auditimit, konstaton se në DST "Kritereve të Veçanta të Kualifikimit", "Aftësitë Teknike dhe Profesionale" nga Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit duhet përcaktuar: - Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, (Drejtues Teknik) që plotëson kushtet e tregtimit të ilaçeve për njerëz në përputhje me nenin 29 të Ligjit nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik". Veprim në kundërshtim me nenin 77, pika 4, e Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, si*

dhe nenin 40, pika 5, gërma a) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

III. "*B3 – Blerje Barna Dermatologjike, Barna hormonale sistemike, hormonet seksuale, Barna Antineoplastike dhe imunomodulatore, Lëndë Kontrasti gastrointestinale, Metabolizmi dhe trakti tretës, Sistemi kardiovaskular, Gjaku dhe organet formuese të gjakut, Sistemi muskolo-skeletik, Sistemi nervor, Sistemi respirator, Anti - Infektiv të Përgjithshëm dhe Psikiatrik*", ndarë në 109 lot-e, me fond limit total të përllogaritur 3,710,275,345 lekë pa TVSH

Në këtë procedurë prokurimi janë prokuruar barna, të ndarë sipas sistemeve, si më poshtë:

Nr.	Sistemi	Nr. i barnave (lot-eve)	Sasia (totale) e barnave e kërkuar	Fondi limit (lekë pa TVSH)	Vlerë e kontraktuar (lekë pa TVSH)	Lot-e të pasuksesshëm	Vlera limit e lot-eve të pasuksesshëm
1	Anti-infektiv të përgjithshëm	3	11,320	7,515,938	6,370,000	-	
2	Antineoplastike & immunomodulatore	5	6,824	225,750,396	202,409,180	-	
3	Dermatologjike	4	70,660	45,878,093	44,801,649	-	
4	Hormonale sistemike, hormonet seksuale	6	2,030,440	253,844,216	252,110,916	1	1,446,585
5	Gjaku dhe organet formuese të gjakut	34	21,308,843	2,226,788,068	2,098,860,618	2	14,143,761
6	Lëndë kontrasti gastrointestinale	1	2,650	1,948,348	1,947,750	-	
7	Metabolizmi dhe trakti tretës	13	5,134,649	518,011,383	283,624,447	-	
8	Psikiatrik	1	5,500	1,722,811	0	1	1,722,811
9	Sistemi kardiovaskular	13	3,065,330	143,501,505	131,716,750	1	3,759,009
10	Sistemi muskulo-skeletik	7	1,067,607	80,456,301	65,545,162	1	5,983,809
11	Sistemi nervor	16	2,945,006	183,215,292	179,383,935	-	
12	Sistemi respirator	6	254,716	21,642,999	15,062,628	2	4,570,655
TOTALI		**109**	**35,903,545**	**3,710,275,350**	**3,281,833,035**	**8**	**31,626,630**

Nëpërmjet Urdhrit të Prokurimit nr. 317, datë 10.06.2024, Titullari i AK S. H. ka kërkuar kryerjen e procedurës së prokurimit me fond limit/ vlerë të përgjithshme të kontratave në total prej 3,710,275,345 lekë pa TVSH, e ndarë në 109 Lot-e, duke përcaktuar njësinë e prokurimit, të përbërë nga A.P (*anëtar, person përgjegjës për prokurimin*), E. B. (*anëtar, specialist fushe*), E. L. (*anëtar, person përgjegjës për prokurimin*), L. A. (*anëtar, person përgjegjës për prokurimin*), E. M. (*anëtar*).

Në kriteret e veçanta të kualifikimit, Njësia e prokurimit nuk ka kërkuar që OE të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar vijimin e marrëdhënies së punës me *Drejtuesin teknik të tregtuesit farmaceutik me shumicë*, sipas përcaktimit në nenin 29 të Ligjit nr. 105/2014 "*Për barnat dhe shërbimin farmaceutik*", i ndryshuar. Ky dokumentacion është i nevojshëm, pasi drejtuesi teknik i tregtuesit farmaceutik është përgjegjës për të gjithë veprimtarinë teknike dhe profesionale që zhvillon tregtuesi me shumicë.

Nëpërmjet Urdhrit nr. 317/1, datë 10.06.2024, Titullari i AK S. H. ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, të përbërë nga M. Sh (kryetar), M. K. (specialist fushe), E. H., anëtarë.

Grupi i auditimit ka përzgjedhur për auditim 15 Lot-et, bazuar në çmimin më të lartë për njësi të barit dhe/ ose vlerën më të lartë të kontraktuar dhe/ ose diferencën më të madhe me fondin limit dhe/ ose indicie për mungesë barnash nga burime të hapura (media, etj.). Nga vlera totale e kontraktuar për B3 prej 3,281,833,034 lekë pa TVSH, vlera e kontraktuar për Lot-et e përzgjedhur për auditim është 1,584,584,186.8 lekë pa TVSH, ose rreth 49% e vlerës totale.

Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga MSHMS-ja ka rezultuar se:

1. **Lot 5 "Prednisolone 25mg/ 2ml – 2ml", me nr. REF-08672-06-10-2024, me fond limit 183,551,917 lekë pa TVSH, për sasinë 1,055,298 ampula**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt*: Lot 5 "Prednisolone 25mg/ 2ml – 2ml", me nr. REF-08672-06-10-2024*		
1. **Urdhër Prokurimi** nr. 317, datë 10.06.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 317, datë 10.06.2024 A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 317/1, datë 10.06.2024 M. Sh (kryetar); M. K. (specialist fushe); E. H., anëtar
4. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur mbi kufirin e lartë monetar"	**Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit** Urdhër nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024 N.A., E. B. (farmacist), F. B. (mjek).	
5. Fondi Limit: 183,551,917 lekë pa TVSH	**6. Oferta fituese:** "OE "A.", me vlerë 183,516,322.2 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit:** 5,594.8 lekë pa TVSH (0%)
8. Data e hapjes së tenderit: 12.06.2024	**9. Burimi i Financimit:** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 1 OE b) Skualifikuar: - c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër Nr. 2696/21 Prot., date 12.08.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 183,516,322.2 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 5 është kërkuar sasia totale prej 1,055,298 ampula. Në këtë procedurë ka marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	**OE**	**Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)**	**Statusi**
1	A.	183,516,322.2	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "A.", në vlerën prej **183,516,322.2 lekë pa TVSH**. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	**Princip aktiv**	**Formë-doza**	**Njësia**	**Sasia**	**Çmim/ njësi**	**Çmim total**	**MAH/ Prodhues**	**Vendi i prodhimit**
5	Prednisole	25mg/ 2ml – 2ml	Ampulë	1,055,298	173.9	183,516,322.2	P.	Shqipëri

Sa i përket dokumentacionit mbi autorizimin për tregtim të barit, OE ka paraqitur Rinovimin e autorizimit për tregtim nr. 6892, nr. 3146/63 prot., datë 15.01.2021, me vlefshmëri 5-vjeçare, për barin me emër tregtar "P.", me princip aktiv "prednizolon fosfati", formë-doza 25mg/ 2ml, me mbajtës të autorizimit për tregtim dhe prodhues "P." – Shqipëri. Sa i përket autorizimit nga prodhuesi, OE ka paraqitur autorizimin nr. 670 prot., datë 09.07.2024, për periudhën 2024 – 2026. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

2. **Lot 12 "*Vedolizumab 300mg*", me nr. REF-08684-06-10-2024, me fond limit 22,417,279 lekë pa TVSH, për sasinë 160 flakonë**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt*: Lot 12 "Vedolizumab 300mg", me nr. REF-08684-06-10-2024*		
1. **Urdhër Prokurimi** nr. 317, datë 10.06.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 317, datë 10.06.2024	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 317/1, datë 10.06.2024

4. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur mbi kufirin e lartë monetar"	A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M.. **Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit** Urdhër nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024 N.A., E. B. (farmacist), F. B. (mjek).	M. Sh (kryetar); M. K. (specialist fushe); E. H., anëtar
5. Fondi Limit: 22,417,279 lekë pa TVSH	**6. Oferta fituese:** "OE "T.", me vlerë 22,400,000 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit:** 17,279 lekë pa TVSH (0%)
8. Data e hapjes së tenderit: 12.06.2024	**9. Burimi i Financimit:** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 1 OE b) Skualifikuar: - c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër Nr. 2696/6 Prot., date 19.07.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 22,400,000 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 12 është kërkuar sasia totale prej 160 flakonë, e gjithë sasia për Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza".
Në këtë procedurë ka marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	T.	22,400,000	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "T.", në vlerën prej **22,400,000 lekë pa TVSH**. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH/ Prodhues	Vendi i prodhimit
12	Vedolizumab	300mg	Flakon	160	140,000	22,400,000	T. P. A/S – Danimarkë	SHBA, Itali, Japoni, Austri, Mbretëri e Bashkuar, Gjermani

Sa i përket dokumentacionit mbi autorizimin për tregtim të barit, OE ka paraqitur Autorizimin për tregtim nr. 10221, nr. 7011/16 prot., datë 02.03.2022, me vlefshmëri 5-vjeçare, për barin me emër tregtar "E.", me princip aktiv "vedolizumab", formë-doza 300mg, me mbajtës të autorizimit për tregtim "T. Ph. A/S" – Danimarkë dhe prodhues "H. Inc." – SHBA, "P. I." – Itali, "T.Ph." – Japoni, "D. N." – Itali, "T. A." – Austri, "C. L. Ltd." – Mbretëri e Bashkuar, "Ë. L." – Mbretëri e Bashkuar, "C.C." – SHBA, "Ch. R. L. G." - Gjermani. Sa i përket autorizimit nga prodhuesi, OE ka paraqitur autorizimin nr. 670 prot., datë 09.07.2024, për periudhën 2024 – 2026. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

3. Lot 13 "*Trastuzumab/ Emtasine TDM1 100mg*" me nr. REF-08688-06-10-2024, me fond limit 47,438,888 lekë pa TVSH, për sasinë 340 flakonë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt*: Lot 13 "Trastuzumab/ Emtasine TDM1 100mg" me nr. REF-08688-06-10-2024*		
1. **Urdhër Prokurimi** nr. 317, datë 10.06.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 317, datë 10.06.2024 A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 317/1, datë 10.06.2024 M. Sh (kryetar); M. K. (specialist fushe); E. H., anëtar
4. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur mbi kufirin e lartë monetar"	**Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit** Urdhër nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024 N.A., E. B. (farmacist), F. B. (mjek).	
5. Fondi Limit: 47,438,888 lekë pa TVSH	**6. Oferta fituese:** "OE "R. F.", me vlerë 47,438,160 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit:** 728 lekë pa TVSH (0%)

8. Data e hapjes së tenderit: 12.06.2024	**9. Burimi i Financimit:** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 1 OE b) Skualifikuar: - c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër Nr. 2696/6 Prot., date 19.07.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 47,438,160 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 13 është kërkuar sasia totale prej 340 flakonë, e gjithë sasia për Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza".
Në këtë procedurë ka marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	R. F.	47,438,160	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "R. F.", në vlerën prej **47,438,160 lekë pa TVSH**. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH/ Prodhues	Vendi i prodhimit
13	Trastuzumab/ Emtasine TDM1	100mg	Flakon	340	139,524	47,438,160	R. R. GmbH	SHBA, Zvicër

Sa i përket dokumentacionit mbi autorizimin për tregtim të barit, OE ka paraqitur Rinovimin e autorizimit për tregtim nr. 7240, nr. 823/25 prot., datë 30.03.2023, me vlefshmëri 5-vjeçare, për barin me emër tregtar "K.", me përbërës aktiv "Trastuzumab emtasinë", formë-doza 100mg, me mbajtës të autorizimit për tregtim "R. R. GmbH" – Gjermani dhe prodhues "P. M.S." – SHBA, "F. H.-L.R. AG" – Zvicër. Sa i përket autorizimit nga prodhuesi, OE ka paraqitur autorizimin e datës 02.07.2024 nga F.H. – L. R. Ltd., të vlefshëm për periudhën 2024 – 2026. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

4. Lot 15 "*Trastuzumab/ Emtasine TDM1 160mg*" me nr. REF-08692-06-10-2024, me fond limit 75,902,220 lekë pa TVSH, për sasinë 340 flakonë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt*: Lot 15 "Trastuzumab/ Emtasine TDM1 160mg" me nr. REF-08692-06-10-2024*		
1. **Urdhër Prokurimi** nr. 317, datë 10.06.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 317, datë 10.06.2024 A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 317/1, datë 10.06.2024 M. Sh (kryetar); M. K. (specialist fushe); E. H., anëtar
4. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur mbi kufirin e lartë monetar"	**Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit** Urdhër nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024 N.A., E. B. (farmacist), F. B. (mjek).	
5. Fondi Limit: 75,902,220 lekë pa TVSH	**6. Oferta fituese:** "OE "R. F.", me vlerë 75,901,260 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit:** 960 lekë pa TVSH (0%)
8. Data e hapjes së tenderit: 12.06.2024	**9. Burimi i Financimit:** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 1 OE b) Skualifikuar: - c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër Nr. 2696/6 Prot., date 19.07.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 75,901,260 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 15 është kërkuar sasia totale prej 340 flakonë, e gjithë sasia për Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza".
Në këtë procedurë ka marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	R. F.	75,901,260	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "R. F.", në vlerën prej **75,901,260 lekë pa TVSH**. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH/ Prodhues	Vendi i prodhimit
15	Trastuzumab/ Emtasine TDM1	160mg	Flakon	340	223,239	75,901,260	R. R. GmbH	SHBA, Zvicër

Sa i përket dokumentacionit mbi autorizimin për tregtim të barit, OE ka paraqitur Rinovimin e autorizimit për tregtim nr. 7241, nr. 823/26 prot., datë 30.03.2023, me vlefshmëri 5-vjeçare, për barin me emër tregtar "K.", me përbërës aktiv "Trastuzumab emtasinë", formë-doza 160mg, me mbajtës të autorizimit për tregtim "R. R. GmbH" – Gjermani dhe prodhues "P. M.S." – SHBA, "F. H.-L. R. AG" – Zvicër. Sa i përket autorizimit nga prodhuesi, OE ka paraqitur autorizimin e datës 02.07.2024 nga F. H. – L. R. Ltd., të vlefshëm për periudhën 2024 – 2026. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

5. Lot 17 "*Omeprazole 40mg*", me nr. REF-08696-06-10-2024, me fond limit 246,003,623 lekë pa TVSH, për sasinë 617,113 flakon/ flakon + ampulë (holluesi).

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt*: Lot 17 "Omeprazole 40mg", me nr. REF-08696-06-10-2024*		
1. **Urdhër Prokurimi** nr. 317, datë 10.06.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 317, datë 10.06.2024 A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 317/1, datë 10.06.2024 M. Sh (kryetar); M. K. (specialist fushe); E. H., anëtar
4. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur mbi kufirin e lartë monetar"	**Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit** Urdhër nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024 N.A., E. B. (farmacist), F. B. (mjek).	
5. Fondi Limit: 246,003,623 lekë pa TVSH	**6. Oferta fituese:** "OE "E.", me vlerë 41,963,684 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit:** 204,039,939 lekë pa TVSH (83%)
8. Data e hapjes së tenderit: 12.06.2024	**9. Burimi i Financimit:** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 8 OE b) Skualifikuar: - c) Kualifikuar: 8 OE
11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër Nr. 2696/31 Prot., date 26.08.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 41,963,684 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 17 është kërkuar sasia totale prej 617,113 flakon/ flakon + ampulë (holluesi).
Në këtë procedurë ka marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	E.	41,963,684	Kualifikuar/ fitues
2	M.	48,073,102.70	Kualifikuar

3	I.	73,436,447.00	Kualifikuar
4	D. Ph.	73,991,848.70	Kualifikuar
5	A. M. F	83,186,832.40	Kualifikuar
6	F.	89,481,385	Kualifikuar
7	E.-F.	106,914,827.25	Kualifikuar
8	P. Ph	141,935,990	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "E.", në vlerën prej **41,963,684 lekë pa TVSH**. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH	Vendi i prodhimit
17	Omeprazol	40mg	Flakon/ flakon + ampulë	617,113	68	41,963,684	P.I. S. - Turqi/ L. B. – I.F. - Portugali	Turqi/ Tuqi/ Portugali, Indi

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, OE ka paraqitur:

i. Autorizimi për tregtim nr. 11073, nr. 930/22 prot., datë 16.04.2024, me vlefshmëri 5-vjeçare, për barin me emër tregtar "O. B.", formë-doza 40 mg, me mbajtës të autorizimit për tregtim "L. B. – I. F." – Portugali, me prodhues "L. B. – I. F." – Portugali, "G. L. P. Ltd." – Indi.

ii. Autorizimi për tregtim nr. 10362, nr. 2477/14 prot., datë 16.05.2022, me vlefshmëri 5-vjeçare, për barin me emër tregtar "O.", formë-doza 40mg, . S. Ltd." – Turqi.

Sa i përket *autorizimit nga prodhuesi*, OE ka paraqitur:

i. Autorizimi i datës 15.05.2024, i lëshuar nga P. I. S., i vlefshëm për periudhën 2024-2026;

ii. Autorizimi i datës 06.05.2024, i lëshuar nga L. B., i vlerfshëm për periudhën 2024-2026.

Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

Nisur nga fakti se oferta e paraqitur nga OE është më e ulët se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme, AK ka kërkuar argumentimin e ofertës anomalisht të ulët nëpërmjet SPE. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, ka rezultuar se OE ka paraqitur argumentimin e ofertës nëpërmjet shkresës së datës 30.07.2024, e paprotokolluar në MSHMS, ku listohen argumentimet për ofertën anomalisht të ulët, duke bashkëlidhur korrespondencën me 2 MAH (P., L. B.) ku dakordësohet ofertimi i bar-it Omeprazole me çmim preferencial për këtë procedurë prokurimi dhe dokumentacion shoqërues mbi cilësinë e bar-it.

6. Lot 19 "*Ondansetron 8 mg/4 ml - 4 ml Flakon/ Ampule*", me nr. REF-08700-06-10-2024, me fond limit 33,738,558 lekë pa TVSH, për sasinë 85,435 fl./ amp.

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Lot 19 "Ondansetron 8 mg/4 ml - 4 ml Flakon/ Ampule", me nr. REF-08700-06-10-2024</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
nr. 317, datë 10.06.2024</td><td rowspan="2">2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Urdhër nr. 317, datë 10.06.2024
A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..

Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit
Urdhër nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024
N.A., E. B. (farmacist), F. B. (mjek).</td><td rowspan="2">3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Urdhër nr. 317/1, datë 10.06.2024
M. Sh (kryetar);
M. K. (specialist fushe);
E. H., anëtar</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit
"E hapur mbi kufirin e lartë monetar"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit:
33,738,558 lekë pa TVSH</td><td>6. Oferta fituese: "OE "M.", me vlerë 5,635,562 lekë pa TVSH</td><td>7. Diferenca me fondin limit:
28,102,996 lekë pa TVSH (83%)</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
12.06.2024</td><td>9. Burimi i Financimit:
Buxheti i Shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës: 6 OE
b) Skualifikuar: -
c) Kualifikuar: 6 OE</td></tr>
</table>

11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër Nr. 2696/31 Prot., date 26.08.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 5,635,562 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 19 është kërkuar sasia totale prej 86,435 flakon/ ampulë. Në këtë procedurë ka marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	M.	5,635,562	Kualifikuar/ fitues
2	A. M. F	6,741,930	Kualifikuar
3	A-F	10,631,505	Kualifikuar
4	I.	11,150,115	Kualifikuar
5	P.	15,990,475	Kualifikuar
6	P. Ph	18,583,525	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "M.", në vlerën prej **5,635,562 lekë pa TVSH**. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH	Vendi i prodhimit
19	Ondanestron	8mg/ 4ml – 4ml	Flakon/ ampulë	86,435	65.2	5,635,562	V.	Greqi

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, OE ka paraqitur shkresën e Drejtorit të Përgjithshëm të AKBPM nr. 1868 prot., datë 22.05.2024, ku vërtetohen se barnat sipas listës bashkëlidhur shkresës janë të pajisura me autorizim për tregtim, ku me nr. rendor 5 paraqitet bari me emër tregtar "Z.", me përbërës aktiv "Ondansetron (si Ondanestron Hidroklorid)", formë-doza 8mg/4ml – 4ml ampulë, me mbajtës të autorizimit për tregtim "V.Ph." – Greqi, i cili disponon Riautorizimin për tregtim nga AKBPM nr. 512, datë 01.12.2021 me vlefshmëri 5-vjeçare,. Sa i përket *autorizimit nga prodhuesi*, OE ka paraqitur autorizimin e datës 10.05.2024 nga V.Ph., të vlefshëm nga data 10.05.2024 deri në 31.12.2026. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

Nisur nga fakti se oferta e paraqitur nga OE është më e ulët se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme, AK ka kërkuar argumentimin e ofertës anomalisht të ulët nëpërmjet SPE. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, ka rezultuar se OE ka paraqitur argumentimin e ofertës nëpërmjet shkresës së datës 30.07.2024, e paprotokolluar në MSHMS, ku citohet se "*çmimi i ofertës së propozuar është i ulët në raport me fondin limit pasi MAH ka lëshuar autorizimin për M. për pjesëmarrje në tender me tjerër çmim nga çmimi CIF i deklaruar dhe miratuar në KÇB*", duke bashkëlidhur korrespondencën elektronike me MAH ku konfirmohet se çmimi i ofertuar i referohet produktit të së njëjtës cilësie dhe standardi.

7. **Lot 40 "*Enalapril 20 mg tabletë*", me nr. REF-08742-06-10-2024, me fond limit 1,959,068 lekë pa TVSH, për sasinë 184,770 tableta**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt*: Lot 40 "Enalapril 20 mg tabletë", me nr. REF-08742-06-10-2024*		
1. **Urdhër Prokurimi** nr. 317, datë 10.06.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 317, datë 10.06.2024 A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 317/1, datë 10.06.2024 M. Sh (kryetar); M. K. (specialist fushe); E. H., anëtar
4. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur mbi kufirin e lartë monetar"	**Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit** Urdhër nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024 N.A., E. B. (farmacist), F. B. (mjek).	
5. Fondi Limit: 1,959,068 lekë pa TVSH	**6. Oferta fituese:** OE "A. Ph", me vlerë 388,017 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit:** 1,571,051 lekë pa TVSH (80%)
8. Data e hapjes së tenderit: 12.06.2024	**9. Burimi i Financimit:** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 2 OE b) Skualifikuar: - c) Kualifikuar: 2 OE
11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër Nr. 2696/31 Prot., date 26.08.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 388,017 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 40 është kërkuar sasia totale prej 184,770 tableta. Në këtë procedurë ka marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	**OE**	**Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)**	**Statusi**
1	A-F	388,017	Kualifikuar
2	P. O	1,034,712	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "M.", në vlerën prej **388,017 lekë pa TVSH**. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	**Princip aktiv**	**Formë-doza**	**Njësia**	**Sasia**	**Çmim/ njësi**	**Çmim total**	**MAH**	**Vendi i prodhimit**
40	Enalapril	20m	Tabletë	184,770	2.1	388,017	P.	Shqipëri

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, OE ka paraqitur Rinovimin e Autorizimit për Tregtim nr. 8332, nr. 8281/16 prot., datë 22.12.2022, me vlefshmëri 5-vjeçare, për barin me emër tregtar "E.", me përbërës aktiv "Enalapril maleat", formë-doza 20mg, me mbajtës të autorizimit për tregtim dhe prodhues "P. sh.a" – Shqipëri. Sa i përket autorizimit nga prodhuesi, OE ka paraqitur autorizimin nr. 683 prot., datë 11.07.2024, të lëshuar nga kompania "P.", të vlefshëm për periudhën 2024-2026. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

Nisur nga fakti se oferta e paraqitur nga OE është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur, AK ka kërkuar argumentimin e ofertës anomalisht të ulët nëpërmjet SPE. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, ka rezultuar se OE ka paraqitur argumentimin e ofertës nëpërmjet shkresës nr. 30/1 prot., datë 28.07.2024, e paprotokolluar në MSHMS, ku citohet se "*për shkak të një marrëdhënie afatgjatë ekskluziviteti me MAH dhe fushatave që ndërmarrim për grup produkte të caktuara, përfitojmë suport ekstra nga MAH në mbulimin e shpenzimeve të shitjes dhe marketingut... kjo na krijon hapësirë të jemi më konkurrues për produktet e rrjetit spitalor...*" duke bashkëlidhur korrespondencën me MAH ku dakordësohet ofertimi i bar-it Enalapril me çmim 2.1 lekë për njësi.

8. **Lot 44 "*Human Coagulation Factor VIII ose Human Coagulation Factor VIII + Human Von Ëillenbrand Factor 250 I.U-1000 IU UI*", me nr. REF-08750-06-10-2024, me fond limit 266,548,872 lekë pa TVSH, për sasinë 8,070,000 UI**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt*: Lot 44 "Human Coagulation Factor VIII ose Human Coagulation Factor VIII + Human Von Ëillenbrand Factor 250 I.U-1000 IU UI", me nr. REF-08750-06-10-2024*		
1. **Urdhër Prokurimi** nr. 317, datë 10.06.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 317, datë 10.06.2024 A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 317/1, datë 10.06.2024 M. Sh (kryetar); M. K. (specialist fushe); E. H., anëtar
4. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur mbi kufirin e lartë monetar"	**Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit** Urdhër nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024 N.A., E. B. (farmacist), F. B. (mjek).	
5. Fondi Limit: 266,548,872 lekë pa TVSH	**6. Oferta fituese:** BOE "M." & "M." & "L." & "T.", me vlerë 266,310,000 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit:** 238,872 lekë pa TVSH (0%)
8. Data e hapjes së tenderit: 12.06.2024	**9. Burimi i Financimit:** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 1 BOE b) Skualifikuar: - c) Kualifikuar: 1 BOE
11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër Nr. 2696/21 Prot., date 12.08.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 266,310,000 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 44 është kërkuar sasia totale prej 8,070,000 UI. Në këtë procedurë ka marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	BOE "M." & "M." & "L." & "T."	266,310,000	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e BOE "M." & "M." & "L." & "T.", në vlerën prej **266,310,000 lekë pa TVSH**. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH	Vendi i prodhimit
40	Human Coagulation Factor VIII ose Human Coagulation Factor VIII + Human Von Ëillenbrand Factor	250 I.U-1000 IU	UI	8,070,000	33	266,310,000	O./ K./ T./ B.	Francë, Gjermani, Suedi, Austri/ Itali, Hungari, Belgjikë, SHBA/ Austri/ Gjermani

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, OE ka paraqitur:

i. Rinovim i autorizimit për tregtim nr. 6739, nr. 8196/71 prot., datë 05.05.2020, me vlefshmëri 5-vjeçare, për barin me emër tregtar "H.S. 500" – pluhur dhe tretësorë për injeksion, formë-doza 500 IU, me përbërës aktiv "Faktor koagulimi human VIII x 500 IU/ vial, me mbajtës të autorizimit për tregtim dhe prodhues "B. Ph. GmbH" – Gjermani.

ii. Autorizimi për tregtim nr. 6740, nr. 8196/70 prot., datë 05.05.2020, me vlefshmëri 5-vjeçare, për barin me emër tregtar "H. S. 1000", formë-doza 1000 IU, me përbërës aktiv "Faktor koagulimi human VIII x 1000 IU/ vial, me mbajtës të autorizimit për tregtim dhe prodhues "B.P. GmbH" – Gjermani.

iii. Autorizimi për tregtim nr. 6738, nr. 8196/72 prot., datë 05.05.2020, me vlefshmëri 5-vjeçare, për barin me emër tregtar "H. S. 250", formë-doza 250 IU, me përbërës aktiv "Faktor koagulimi human VIII x 250 IU/ vial, me mbajtës të autorizimit për tregtim dhe prodhues "B. Ph.GmbH" – Gjermani.

iv. Rinovim i autorizimit për tregtim nr. 7388, nr. 2463/34 prot., datë 11.06.2021, me vlefshmëri 5-vjeçare, për barin me emër tregtar "E.", formë-doza 500UI/ 10ml, me përbërës aktiv "Faktori VIII i koagulimit të plazmës humane", me mbajtës të autorizimit për tregtim "K.S.p.A" – Itali

dhe prodhues “K.” – Itali, “Ph. P.” – Itali, “H. B.” – Hungari, “P. I.B.” – Belgjikë, “G. Th.” – SHBA, “F.” – Itali, “S. L. S.” – Belgjikë, “A.” – Itali.

v. Shkresa e Drejtorit të Përgjithshëm të AKBPM-së nr. 2005/7 prot., datë 29.05.2024, listohen barnat e pajisura me autorizim për tregtim nga kompania “O.”, ku me nr. rendor 6 dhe 7 listohen barnat me emra tregtarë “Octanate 50IU/ml” dhe “Octanate 100IU/ml”, formë-dozat përkatëse 50IU/ml dhe 100IU/ml, me përbërës aktiv “Human Coagulation Factor VIII”, me mbajtës autorizimi për tregtim “O. Ph. P.” – Austri, me Autorizim tregtimi cituar përkatësisht (i) nr. 428, datë 20.07.2022 dhe (ii) nr. 428, datë 20.07.2022, me vlefshmëri 5-vjeçare.

vi. Shkresa e Drejtorit të Përgjithshëm të AKBPM-së nr. 1900/8 prot., datë 08.04.2021, ku konfirmohet Rinovimi i Autorizimit për Tregtim, bazuar në Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 186, datë 29.03.2021, për barin “Immunate” 250 dhe 500 LE “Poëder for solution for injection (250 IU + 190 IU dhe 500 IU + 375 IU), si dhe shkresa e zv. Drejtorit të Përgjithshëm të AKBPM-së nr. 4796/7 prot., datë 09.08.2022 drejtuar T. M. Austria, me objekt “Miratimi i ndryshimeve”, për barnat Immunate (i) 250/ (ii) 500 I.E.FVIII/190I.E VËF, Pluhur dhe tretës për tretësirë për injeksion x x (i) (250IU + 190IU)/ (ii) (500IU + 375IU).

Sa i përket *autorizimit nga prodhuesi*, OE ka paraqitur:

i. Autorizimi i datës 05.01.2024, i lëshuar nga “B. Ph. GmbH” për “L.”, i vlefshëm për periudhën 2024-2026, për barnat Haemoctin SDH 250/500/1000IU;

ii. Autorizimi i datës 05.06.2024, i lëshuar nga T. M. Austria” për “T.”, i vlefshëm për periudhën 2024-2026 për barnat Immunate (i) 250/ (ii) 500 I.E.FVIII/190I.E VËF, Pluhur dhe tretës për tretësirë për injeksion x x (i) (250IU + 190IU)/ (ii) (500IU + 375IU);

iii. Autorizimi i datës 20.05.2024, i lëshuar nga “K. S.p.A” për “M.”, i vlefshëm për periudhën 2024 – 2026.

iv. Autorizimi i datës 06.05.2024, i lëshuar nga “O.” për “M.”, i vlefshëm për periudhën 2024 – 2026.

Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

9. Lot 46 “*Eptacog Alfa (Activated) (1mg/ml after reconstitution) 2mg/vial (100 KIU/vial) Flakon (pluhur) + set shoqërues per pergatitje dhe aplikim*”, me nr. REF-08752-06-10-2024, me fond limit 82,538,571 lekë pa TVSH, për sasinë 700 flakonë (pluhur) + set shoqërues për përgatitje dhe aplikim

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Lot 46 “Eptacog Alfa (Activated) (1mg/ml after reconstitution) 2mg/vial (100 KIU/vial) Flakon (pluhur) + set shoqërues per pergatitje dhe aplikim”, me nr. REF-08752-06-10-2024</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
nr. 317, datë 10.06.2024</td><td rowspan="2">2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Urdhër nr. 317, datë 10.06.2024
A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..

Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit
Urdhër nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024
N.A., E. B. (farmacist), F. B. (mjek).</td><td rowspan="2">3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Urdhër nr. 317/1, datë 10.06.2024
M. Sh (kryetar);
M. K. (specialist fushe);
E. H., anëtar</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit
“E hapur mbi kufirin e lartë monetar”</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit:
82,538,571 lekë pa TVSH</td><td>6. Oferta fituese: OE “R. F.”, me vlerë 82,537,000 lekë pa TVSH</td><td>7. Diferenca me fondin limit:
1,571 lekë pa TVSH (0%)</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
12.06.2024</td><td>9. Burimi i Financimit:
Buxheti i Shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës: 1 OE
b) Skualifikuar: -
c) Kualifikuar: 1 OE</td></tr>
</table>

11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër Nr. 2696/21 Prot., date 12.08.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 82,537,000 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 46 është kërkuar sasia totale prej 700 flakonë (pluhur) + set shoqërues për përgatitje dhe aplikim. Në këtë procedurë ka marrë pjesë OE, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	R. F.	82,537,000	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "R. F.", në vlerën prej **82,537,000 lekë pa TVSH**. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH	Vendi i prodhimit
46	Eptacog Alfa (activated	1mg/ml after reconstitution, 2mg/ vial (100 KIU/vial)	Flakon	700	117,910	82,537,000	N. N. – Danimarkë	Novo Nordisk – Danimarkë; Vetter Pharma Fertigung - Gjermani

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, OE ka paraqitur Riautorizimin për tregtim nr. 8383, nr. 8682/62 prot., datë 13.01.2023, me vlefshmëri 5-vjeçare, të lëshuar nga AKBPM, për barin me emër tregtar "N.", me përbërës aktiv "Eptacog alfa (i aktivizuar) (1mg/ml pas rikonstituimit), formë-doza 2mg/ flakon (100 KIU/ flakon), me mbajtës të autorizimit për tregtim "N. N." dhe prodhues "N. N." – Danimarkë, "V. Ph. F." - Gjermani. Sa i përket *autorizimit nga prodhuesi*, OE ka paraqitur autorizimin e datës 18.06.2024 nga N. N. A/S, cituar të vlefshëm për 24 muaj. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

10. Lot 47 "*Sodium chloride 0.9% - 250 ml Flakon*", me nr. REF-08756-06-10-2024, me fond limit 130,162,057 lekë pa TVSH, për sasinë 36,527 flakonë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt*: Lot 47 "Sodium chloride 0.9% - 250 ml Flakon", me nr. REF-08756-06-10-2024*		
1. **Urdhër Prokurimi** nr. 317, datë 10.06.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 317, datë 10.06.2024 A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M.. **Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit** Urdhër nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024 N.A., E. B. (farmacist), F. B. (mjek).	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 317/1, datë 10.06.2024 M. Sh (kryetar); M. K. (specialist fushe); E. H., anëtar
4. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur mbi kufirin e lartë monetar"		
5. Fondi Limit: 130,162,057 lekë pa TVSH	**6. Oferta fituese:** BOE "I." & "A. Ph", me vlerë 130,060,153.30 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit:** 101,903.7 lekë pa TVSH (1%)
8. Data e hapjes së tenderit: 12.06.2024	**9. Burimi i Financimit:** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 1 BOE b) Skualifikuar: - c) Kualifikuar: 1 BOE
11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër Nr. 2696/21 Prot., date 12.08.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 130,060,153.30 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 47 është kërkuar sasia totale prej 1,535,539 flakonë. Në këtë procedurë ka marrë pjesë, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	BOE "I." & "A. Ph"	130,060,153.30	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "R. F.", në vlerën prej **82,537,000 lekë pa TVSH**. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH	Vendi i prodhimit
47	Eptacog Alfa (activated	1mg/ml after reconstitution, 2mg/ vial (100 KIU/vial)	Flakon	700	117,910	82,537,000	N. N. – Danimarkë	Novo Nordisk – Danimarkë; Vetter Pharma Fertigung - Gjermani

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, OE ka paraqitur Riautorizimin për tregtim nr. 8383, nr. 8682/62 prot., datë 13.01.2023, me vlefshmëri 5-vjeçare, të lëshuar nga AKBPM, për barin me emër tregtar "N.", me përbërës aktiv "Eptacog alfa (i aktivizuar) (1mg/ml pas rikonstituimit), formë-doza 2mg/ flakon (100 KIU/ flakon), me mbajtës të autorizimit për tregtim "N. N." dhe prodhues "N. N." – Danimarkë, "V.Ph. F." - Gjermani. Sa i përket *autorizimit nga prodhuesi*, OE ka paraqitur autorizimin e datës 18.06.2024 nga N. N. A/S, cituar të vlefshëm për 24 muaj. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

11. Lot 50 "*Human Albumin Serum 20% - 50 ml Flakon*", me nr. REF-08762-06-10-2024, me fond limit 118,490,525 lekë pa TVSH, për sasinë 36,527 flakonë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt*: Lot 50 "Human Albumin Serum 20% - 50 ml Flakon", me nr. REF-08762-06-10-2024*		
1. **Urdhër Prokurimi** nr. 317, datë 10.06.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 317, datë 10.06.2024 A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 317/1, datë 10.06.2024 M. Sh (kryetar); M. K. (specialist fushe); E. H., anëtar
4. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur mbi kufirin e lartë monetar"	**Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit** Urdhër nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024 N.A., E. B. (farmacist), F. B. (mjek).	
5. Fondi Limit: 118,490,525 lekë pa TVSH	**6. Oferta fituese:** BOE "L." & "M." & "M.", me vlerë 118,489,935.30 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit:** 589.7 lekë pa TVSH (0%)
8. Data e hapjes së tenderit: 12.06.2024	**9. Burimi i Financimit:** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 1 BOE b) Skualifikuar: - c) Kualifikuar: 1 BOE
11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër Nr. 2696/21 Prot., date 12.08.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 118,489,935.30 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 50 është kërkuar sasia totale prej 36,527 flakonë. Në këtë procedurë ka marrë pjesë, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	BOE "L." & "M." & "M."	118,489,935.30	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e BOE "L." & "M." & "M.", në vlerën prej **118,489,935.3 lekë pa TVSH**. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH	Vendi i prodhimit
50	Human Albumin Serum 20%	50ml	Flakon	36,527	3,243.9	118,489,935.3	O./ K./ B.	Francë, Gjermani, Suedi, Austri/ Itali, Francë, Hungari/ Gjermani

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, OE ka paraqitur:

i. Rinovim i autorizimit për tregtim nr. 8786, nr. 2578/60 prot., datë 21.08.2023, me vlefshmëri 5-vjeçare, i lëshuar nga AKBPM për barin me emër tregtar "U. A.", përbërës aktiv "Tretësirë që përmban proteina plazme 20%, nga të cilat të paktën 95% është Albumin humane", formë-doza 200g/l, me mbajtës të autorizimit për tregtim "K." – Itali dhe prodhues "K." – Itali, "Ch. R.L." – France, "E. B." – Itali, "Ph. P." – Itali, "H. B." – Hungari.

ii. Autorizimi për tregtim nr. 7387, nr. 2463/37 prot., datë 28.06.2021, me vlefshmëri 5-vjeçare, i lëshuar nga AKBPM, për barin me emër tregtar "I. V. – tretësirë për infuzion 50g/l", me përbërës aktiv "Human plasma immunoglobulin", formë-doza 50g/l, me mbajtës të autorizimit për tregtim "K." – Itali dhe prodhues "K." – Itali "H. B." – Hungari, "Ch. R. L." – Belgjikë, "F." – Itali.

iii. Rinovim i autorizimit për tregtim nr. 7909, nr. 1389/44 prot., datë 30.06.2022. me vlefshmëri 5-vjeçare, i lëshuar nga AKBPM, për barin me emër tregtar "A. 20% - tretësirë për infuzion 200g/1l", përbërës aktiv "Proteinë e plazmës humane në të cilin ka të paktën 96% albumin", formë-doza 200g/1l, me mbajtës të autorizimit për tregtim dhe prodhues "B. Ph. GmbH" – Gjermani.

iv. Shkresa e Drejtorit të Përgjithshëm të AKBPM-së nr. 2005/7 prot., datë 29.05.2024, listohen barnat e pajisura me autorizim për tregtim nga kompania "O.", ku me nr. rendor 2 listohet bari me emër tregtar "A.", përbërës aktiv "tretësirë për infuzon 20%", formë-doza 200g/l, me mbajtës të autorizimit për tregtim "O. Ph. P." – Austri, me Autorizim tregtimi cituar nr. 151, datë 04.03.2021 me vlefshmëri 5-vjeçare.

Sa i përket *autorizimit nga prodhuesi*, OE ka paraqitur:

i. Autorizimi i datës 05.01.2024, i lëshuar nga "B. Ph. GmbH" për "L.", i vlefshëm për periudhën 2024-2026;

ii. Autorizimi i datës 20.05.2024, i lëshuar nga "K. S.p.A" për "M.", i vlefshëm për periudhën 2024 – 2026.

iii. Autorizimi i datës 06.05.2024, i lëshuar nga "O." për "M.", i vlefshëm për periudhën 2024 – 2026.

Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

12. Lot 52 "*Human Coagulation Factor X 500 UI*", me nr. REF-08766-06-10-2024, me fond limit 107,825,242 lekë pa TVSH, për sasinë 185,000 UI

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt*: Lot 52 "Human Coagulation Factor X 500 UI", me nr. REF-08766-06-10-2024*

1. **Urdhër Prokurimi** nr. 317, datë 10.06.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 317, datë 10.06.2024 A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 317/1, datë 10.06.2024 M. Sh (kryetar); M. K. (specialist fushe); E. H., anëtar
4. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur mbi kufirin e lartë monetar"	**Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit** Urdhër nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024 N.A., E. B. (farmacist), F. B. (mjek).	

5. Fondi Limit: 107,825,242 lekë pa TVSH	**6. Oferta fituese:** OE "L.", me vlerë 107,823,550 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit:** 1,692 lekë pa TVSH (0%)
8. Data e hapjes së tenderit: 12.06.2024	**9. Burimi i Financimit:** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 1 OE b) Skualifikuar: - c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër Nr. 2696/21 Prot., date 12.08.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 107,823,550 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 52 është kërkuar sasia totale prej 185,000 UI. Në këtë procedurë ka marrë pjesë, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	L.	107,823,550	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "L.", në vlerën prej **107,823,550 lekë pa TVSH**. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH	Vendi i prodhimit
52	Human Coagulation Factor X	500 UI	UI	185,000	582.83	107,823,550	B. P.L.BPL – Mb. e Bashkuar	Nuk përcaktohet

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, m.q.s. bar-i nuk është i autorizuar për tregtim nga AKBPM, OE ka paraqitur deklaratën me anë të së cilës konfirmohet se bar-i që ofron disponon autorizim për tregtim nga *European Medicines Agency* (EMA), me vend të autorizimit për tregtim Mbretërinë e Bashkuar, dhe *U.S. Food & Drug Administration* (FDA), me vend të autorizimit për tregtim SHBA-në. Në deklaratë paraqiten të dhënat e përcaktuara në DST për barna të paautorizuara, *me përjashtim të numrit të autorizimit për tregtim nga EMA dhe FDA*. Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin nga prodhuesi*, OE ka paraqitur autorizimin e datës 04.07.2024 nga B. P. L. Ltd. (BPL), i vlefshëm për periudhën 2024-2026. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

13. Lot 54 "*Human Albumin Serum 20% - 100 ml, Flakon*", me nr. REF-08770-06-10-2024, me fond limit 101,419,407 lekë pa TVSH, për sasinë 15,334 flakonë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt*: Lot 54 "Human Albumin Serum 20% - 100 ml, Flakon", me nr. REF-08770-06-10-2024*		
1. **Urdhër Prokurimi** nr. 317, datë 10.06.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 317, datë 10.06.2024 A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 317/1, datë 10.06.2024 M. Sh (kryetar); M. K. (specialist fushe); E. H., anëtar
4. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur mbi kufirin e lartë monetar"	**Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit** Urdhër nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024 N.A., E. B. (farmacist), F. B. (mjek).	
5. Fondi Limit: 101,419,407 lekë pa TVSH	**6. Oferta fituese:** BOE "L." & "M." & "M.", me vlerë 101,419,076 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit:** 331 lekë pa TVSH (0%)
8. Data e hapjes së tenderit: 12.06.2024	**9. Burimi i Financimit:** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 1 BOE b) Skualifikuar: - c) Kualifikuar: 1 BOE

11. Ankimime: -		
12. Lidhja e M Kuadër Nr. 2696/21 Prot., date 12.08.2024	**13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër** 101,419,076 lekë pa TVSH	**14. Afati i MK në ditë** 24 muaj

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 54 është kërkuar sasia totale prej 15,334 flakonë. Në këtë procedurë ka marrë pjesë, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	L.	107,823,550	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e BOE "L." & "M." & "M.", në vlerën prej **101,419,076 lekë pa TVSH**. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH	Vendi i prodhimit
54	Human Albumin Serum 20%	100 ml	Flakon	15,334	6,614	101,419,076	O./ K./ B.	Francë, Gjermani, Suedi, Austri/ Itali, Francë, Hungari/ Gjermani

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, OE ka paraqitur:

i. Rinovim i autorizimit për tregtim nr. 8786, nr. 2578/60 prot., datë 21.08.2023, me vlefshmëri 5-vjeçare, i lëshuar nga AKBPM për barin me emër tregtar "U. A.", përbërës aktiv "Tretësirë që përmban proteina plazme 20%, nga të cilat të paktën 95% është Albumin humane", formë-doza 200g/l, me mbajtës të autorizimit për tregtim "K." – Itali dhe prodhues "K." – Itali, "Ch.River L." – France, "E. B." – Itali, "Ph. P." – Itali, "H. B." – Hungari.

ii. Autorizimi për tregtim nr. 7387, nr. 2463/37 prot., datë 28.06.2021, me vlefshmëri 5-vjeçare, i lëshuar nga AKBPM, për barin me emër tregtar "I. V. – tretësirë për infuzion 50g/l", me përbërës aktiv "Human plasma immunoglobulin", formë-doza 50g/l, me mbajtës të autorizimit për tregtim "K." – Itali dhe prodhues "K." – Itali "H. B." – Hungari, "Ch.R. L." – Belgjikë, "F." – Itali.

iii. Rinovim i autorizimit për tregtim nr. 7909, nr. 1389/44 prot., datë 30.06.2022, me vlefshmëri 5-vjeçare, i lëshuar nga AKBPM, për barin me emër tregtar "A. 20% - tretësirë për infuzion 200g/1l", përbërës aktiv "Proteinë e plazmës humane në të cilin ka të paktën 96% albumin", formë-doza 200g/1l, me mbajtës të autorizimit për tregtim dhe prodhues "B. Ph. GmbH" – Gjermani.

iv. Shkresa e Drejtorit të Përgjithshëm të AKBPM-së nr. 2005/7 prot., datë 29.05.2024, listohen barnat e pajisura me autorizim për tregtim nga kompania "O.", ku me nr. rendor 2 listohet bari me emër tregtar "A.", përbërës aktiv "tretësirë për infuzon 20%", formë-doza 200g/l, me mbajtës të autorizimit për tregtim "O. Ph. P." – Austri, me Autorizim tregtimi cituar nr. 151, datë 04.03.2021 me vlefshmëri 5-vjeçare.

Sa i përket *autorizimit nga prodhuesi*, OE ka paraqitur:

i. Autorizimi i datës 05.01.2024, i lëshuar nga "B. Ph. GmbH" për "L.", i vlefshëm për periudhën 2024-2026;

ii. Autorizimi i datës 20.05.2024, i lëshuar nga "K. S.p.A" për "M.", i vlefshëm për periudhën 2024 – 2026.

iii. Autorizimi i datës 06.05.2024, i lëshuar nga "O." për "M.", i vlefshëm për periudhën 2024 – 2026.

Dokumentacioni i paraqitur nga BOE është i njëjti për Lot 50 "*Human Albumin Serum 20% - 50 ml Flakon*" dhe Lot 54 "*Human Albumin Serum 20% - 100 ml Flakon*", sa i përket dokumentacionit të paraqitur mbi autorizimet për tregtim të barnave. Nga verifikimi në Regjistrin Kombëtar të

Barnave, ka rezultuar se barnat e ofertuara janë të regjistruara nëpërmjet autorizimeve të njëjtë për formë-dozat 50ml dhe 100ml flakon e kërkuara në lot-et e veçanta. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

14. Lot 60 "*Heparine sodium 25000 UI/5 ml - 5 ml Flakon/Ampule*", me nr. REF-08782-06-10-2024, me fond limit 44,879,832 lekë pa TVSH, për sasinë 86,582 fl./ amp.

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Lot 60 "Heparine sodium 25000 UI/5 ml - 5 ml Flakon/Ampule", me nr. REF-08782-06-10-2024</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
nr. 317, datë 10.06.2024</td><td rowspan="2">2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Urdhër nr. 317, datë 10.06.2024
A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..

Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit
Urdhër nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024
N.A., E. B. (farmacist), F. B. (mjek).</td><td rowspan="2">3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Urdhër nr. 317/1, datë 10.06.2024
M. Sh (kryetar);
M. K. (specialist fushe);
E. H., anëtar</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit
"E hapur mbi kufirin e lartë monetar"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit:
44,879,832 lekë pa TVSH</td><td>6. Oferta fituese: OE "D. Ph.", me vlerë 15,065,268 lekë pa TVSH</td><td>7. Diferenca me fondin limit:
29,814,564 lekë pa TVSH (66%)</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
12.06.2024</td><td>9. Burimi i Financimit:
Buxheti i Shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës: 6 OE
b) Skualifikuar: -
c) Kualifikuar: 6 OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime: -</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>12. Lidhja e M Kuadër
Nr. 2696/31 Prot., date 26.08.2024</td><td>13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër
15,065,268 lekë pa TVSH</td><td>14. Afati i MK në ditë
24 muaj</td></tr>
</table>

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 60 është kërkuar sasia totale prej 86,582 flakonë/ ampula. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	D. Ph.	15,065,268	Kualifikuar
2	E.	18,831,585	Kualifikuar
3	I.	21,558,918	Kualifikuar
4	T.	25,974,600	Kualifikuar
5	E.-F.	29,000,640.90	Kualifikuar
6	F.	31,169,520	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "D. Ph.", në vlerën prej **15,065,268 lekë pa TVSH**. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga OE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH	Vendi i prodhimit
60	Heparine Sodium	25000 UI	Flakon/ ampule	86,582	174	15,065,268	C. I. S. A.S – Turqi	Turqi

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, OE ka paraqitur Autorizimin për tregtim nr. 10846, nr. 2752/54 prot., datë 11.10.2023, me vlefshmëri 5-vjeçare, të lëshuar nga AKBPM, për barin me emër tregtar "H.", me përbërës aktiv "heparin natriumi", formë-doza 25000IU/ 5ml, me mbajtës të autorizimit për tregtim dhe prodhues "C. I. S." – Turqi. Sa i përket autorizimit nga prodhuesi, OE ka paraqitur autorizimin e datës 31.05.2024, të lëshuar nga C. I. S., të vlefshëm për periudhën 2024-2026. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

Nisur nga fakti se oferta e paraqitur nga OE është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur, AK ka kërkuar argumentimin e ofertës anomalisht të ulët nëpërmjet SPE. Nga

dokumentacioni i vënë në dispozicion, ka rezultuar se OE ka paraqitur argumentimin e ofertës nr. 231 prot., datë 01.08.2024, e paprotokolluar në MSHMS, ku citohet se "*kompania prodhuese ka arritur të ofrojë një çmim më kompetitiv për sasinë totale të furnizimit të procedurës së prokurimit... Hexarin është produkt i miratuar nga Agjencia e Barnave në vendin e referencës dhe në Shqipëri...*" duke bashkëlidhur korrespondencën elektronike me prodhuesin ku janë paraqitur çmimet e ofertuara për bar-in.

15. Lot 75 "*Sodium chloride 0.9% - 500 ml Flakon*", me nr. REF-08812-06-10-2024, me fond limit 389,833,199 lekë pa TVSH

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Lot 75 "Sodium chloride 0.9% - 500 ml Flakon", me nr. REF-08812-06-10-2024</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
nr. 317, datë 10.06.2024</td><td rowspan="2">2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Urdhër nr. 317, datë 10.06.2024
A.P E. B. (specialist fushe), E. L., L. A., E. M..

Hartuesit e listës së barnave dhe përllogaritjes së fondit limit
Urdhër nr. 71, nr. 748 prot., datë 07.02.2024
N.A., E. B. (farmacist), F. B. (mjek).</td><td rowspan="2">3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Urdhër nr. 317/1, datë 10.06.2024
M. Sh (kryetar);
M. K. (specialist fushe);
E. H., anëtar</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit
"E hapur mbi kufirin e lartë monetar"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit:
389,833,199 lekë pa TVSH</td><td>6. Oferta fituese: BOE "M." & "E.-F." & "T." & "F." & "R. F.", me vlerë 385,636,199 lekë pa TVSH</td><td>7. Diferenca me fondin limit:
4,197,000 lekë pa TVSH (1%)</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
12.06.2024</td><td>9. Burimi i Financimit:
Buxheti i Shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës: 1 BOE
b) Skualifikuar: -
c) Kualifikuar: 1 BOE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime: -</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>12. Lidhja e M Kuadër
Nr. 2696/21 Prot., date 12.08.2024</td><td>13. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër
385,636,199 lekë pa TVSH</td><td>14. Afati i MK në ditë
24 muaj</td></tr>
</table>

Referuar Aneksit të ngarkuar në SPE, për Lot 75 është kërkuar sasia totale prej 4,332,991 flakonë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike (lekë pa TVSH)	Statusi
1	BOE "M." & "E.-F." & "T." & "F." & "R. F."	385,636,199	Kualifikuar

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e BOE, në vlerën prej **385,636,199 lekë pa TVSH**. Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga BOE i shpallur fitues rezulton, si më poshtë:

Nr. Lot	Princip aktiv	Formë-doza	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Çmim total	MAH/ Origjina
75	Sodium Chloride 0.9%	500ml	Flakon	4,332,991	89	385,636,199	(i) M. S.p.A – Itali, (ii) P. – Shqipëri, (iii) D.Ph. ./ S.A.L, F L. (Greqi, Itali), (iv) F. K. – Austri (prodhues – Gjermani, Itali, Poloni), (v) H. – Serbi, (vi) V. - Greqi

Sa i përket dokumentacionit mbi *autorizimin për tregtim* të barit, OE ka paraqitur:

i. Rinovim i Autorizimit për tregtim nr. 8748, nr. 2387/70 prot., datë 27.07.2023, me vlefshmëri 5-vjeçare, i lëshuar nga AKBPM, për barin me emër tregtar "Ph. K."F." I. – tretësirë për infuzion 9mg/ml", me përbërës aktiv "klorur natriumi", formë-doza 9mg/ml, me mbajtës të autorizimit për tregtim "F. K. A.GmbH" – Austri, me prodhues "F. K." – Gjermani, Itali, Poloni.

ii. Rinovim i Autorizimit për tregtim nr. 8282, nr. 7701/35 prot., datë 22.12.2022, me vlefshmëri 5-vjeçare, i lëshuar nga AKBPM, për barin me emër tregtar "S. C. M. – tretësirë për infuzion x 0.9%", me përbërës aktiv "klorur natriumi", formë-doza 0.9%, me mbajtës të autorizimit për tregtim dhe prodhues "M. S.p.A" – Itali.

iii. Rinovim i Autorizimit për tregtim nr. 8065, nr. 3504/32 prot., datë 04.07.2022, me vlefshmëri 5-vjeçare, i lëshuar nga AKBPM, për barin me emër tregtar "Kl. N. 0.9% - tretësirë për infuzion 9g/1000ml", me përbërës aktiv "klorur natriumi", formë-doza 9g/1000ml, me mbajtës të autorizimit për tregtim dhe prodhues "P." – Shqipëri.
iv. Rinovim i Autorizimit për tregtim nr. 8302, nr. 7701/22 prot., datë 01.12.2022, me vlefshmëri 5-vjeçare, i lëshuar nga AKBPM, për barin me emër tregtar "S. Ch./ V.– tretësirë për infuzion", me përbërës aktiv "klorur natriumi", formë-doza 0.9%, me mbajtës të autorizimit për tregtim dhe prodhues "V. S.A" – Greqi.
v. Rinovim i Autorizimit për tregtim nr. 8419, nr. 9236/62 prot., datë 09.02.2023, me vlefshmëri 5-vjeçare, i lëshuar nga AKBPM, për barin me emër tregtar "N. Ch. In. – tretësirë për infuzion 0.9%", me përbërës aktiv "klorur natriumi", formë-doza 0.9%, me mbajtës të autorizimit për tregtim dhe prodhues "H." – Serbi.
vi. Shkresa e Drejtorit të AKBPM-së, ku konfirmohet lista e barnave të pajisur me Autorizim tregtimi në RSH për subjektin "E. F", ku me nr. rendor 7 dhe 30 janë barnat (i) Sodium Chloride – D. S.A Ph., Greqi, nr. 637, datë 25.11.2022 dhe (ii) Sodio Cloruro S.A.L.F – S.A.L.F L., Itali, nr. 106, datë 02.03.2023, me vlefshmëri 5-vjeçare.
Sa i përket dokumentacionit mbi autorizimin e prodhuesit, OE ka paraqitur:
i. Autorizim nga V. për F., i vlefshëm për periudhën 2024-2026;
ii. Autorizim nga H. për T., i vlefshëm për periudhën 2024-2026;
iii. Autorizim nga D. S.A për E. F, i vlefshëm për periudhën 2024-2026;
iv. Autorizim nga S.A.L.F për E. F, i vlefshëm për periudhën 2024-2026;
v. Autorizim nga M. për M., i vlefshëm për periudhën 2024-2026;
vi. Autorizim nga P. për M., i vlefshëm për periudhën 2024-2026;
vii. Autorizim nga F. K. për R. F., i vlefshëm për periudhën 2024-2026.
Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.

Lidhja e marrëveshjeve kuadër
Në zbatim të kësaj procedure prokurimi të ndarë me 109 lot-e, MSHMS ka lidhur në total 4 marrëveshje kuadër (me disa operatorë), përkatësisht:

Nr.	Nr. prot.	Datë
1	2696/6	19.07.2024
2	2696/11	31.07.2024
3	2696/21	12.08.2024
4	2696/27	15.08.2024
5	2696/31	26.08.2024
6	2696/35	28.08.2024
7	2696/45	15.10.2024

Mbi sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nëpërmjet shkresës nr. 85/2 prot., datë 04.02.2026, administruar në KLSH me nr. 110/27 prot., datë 06.02.2026, subjekti i audituar MSHMS ka paraqitur observacionet, si më poshtë:
Pretendimi i subjektit: **1.** Sa i përket mungesës së protokollimit të argumentimeve të ofertave anomalisht të ulëta, i gjithë komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit në zbatim të këtij ligji kryhen duke përdorur mjetet elektronike të komunikimit, nëpërmjet SPE-së, sistem i cili siguron jo vetëm transparencë dhe gjurmueshmëri, por edhe vlefshmëri të plotë ligjore.
2. Sa i përket Lot-it 59, OE në përgjigje të kërkesës për sqarim të ofertës anomalisht të ulët, ka paraqitur një shpjegim të plotë dhe të strukturuar, në argumentimin e të cilit përfshihet zbritja e

posaçme në çmim, eliminimi i kostove të marketingut, konfirmimi nga prodhuesi dhe deklarimi i përmbushjes së të gjitha detyrimeve ligjore dhe teknike.
3. Sa i përket Lot-it 52, OE ka paraqitur dy nga tre alternativat e mundshme kur barnat nuk janë të regjistruara për tregtim në RSH, ku theksohet se disponon autorizim për tregtim nga EMA me vend të autorizimit MB, si dhe autorizim nga FDA për tregtim në SHBA. Në DST nuk kërkohet shprehimisht paraqitja e numrit të autorizimit për tregtim dhe për rrjedhojë mungesa e këtij elementi nuk përbën mospërputhje apo shkak për skualifikim.
Qëndrimi i grupit të auditimit:
1. Grupi i auditimit ka cituar të gjithë dokumentacionin shkresor/ korrespondencën e vënë në dispozicion nga MSHMS-ja, sa i përket argumentimit të ofertave anomalisht të ulëta. Grupi i auditimit nuk e evidenton mungesën e protokollimit si shkelje thelbësore, pavarësisht se në nenin 19, pika 1, të Normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë përcaktohet se të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera evidencohen në regjistrin e korrespondencës (pra protokollohen). Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në çdo rast gjatë vlerësimit të ofertave, në rastet e ofertave anomalisht të ulëta, duhet të pasqyrojë në SPE dhe të administrojë fizikisht në dosjen përkatëse kërkesën nga AK dhe dokumentacionin e OE me shpjegime dhe argumentim për ofertën anomalisht të ulët. *Për sa më sipër, kjo pjesë e observacionit nuk merret parasysh*.
2. Grupi i auditimit ka trajtuar argumentimet e dhëna nga OE, por konstatimi konsiston në mungesën e provave dokumentare bashkëlidhur., sipas përcaktimit në nenin 82, pika 4, të RPP-së. Në raste të tjera, në argumentimin e ofertave anomalisht të ulëta, subjektet kanë bashkëlidhur korrespondenca elektronike me MAH, lidhur me çmimin e barnave, etj. *Për sa më sipër, kjo pjesë e observacionit nuk merret parasysh*.
3. Në Kriteret e veçanta të kualifikimit pjesë të DST-së, për barnat e paautorizuara për tregtim në RSH, kërkohet që OE të paraqesë deklaratën ku konfirmohet se bari që oferton plotëson të paktën 1 nga 3 alternativat e parashikuara. Në DST përcaktohet në mënyrë eksplicite se në deklaratën e nënshkruar duhet të deklarohen, ndër të tjera, **numri dhe data e lëshimit të autorizimit për tregtim** (nga institucionet e autorizuar) të barit që ofron dhe periudhën e vlefshmërisë së këtij autorizimi. Grupi i auditimit nuk shprehet nëse kjo përbën ose jo shkak për skualifikim, por si mospërputhje me specifikimet e kritereve, duhej të ishte evidentuar nga KVO-ja (që ka në përbërje edhe specialist të fushës) dhe të vlerësohej nëse kjo mangësi përbënte devijim të vogël ose shkak për skualifikim. *Për sa më sipër, kjo pjesë e observacionit nuk merret parasysh*.

Procedura me objekt *"Ndërtimi i godinës së re Laboratorëve në ISHP",* nga ku rezultojë se:

<table>
<tr><th colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndërtimi i godinës së re Laboratorëve në ISHP"</th></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi:
Nr. 351 datë 02.06.2023</td><td rowspan="2">2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Nr. 351 datë 02.06.2023
1. A.P
2. E. L.
3. D.K.</td><td rowspan="2">3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Nr. 351/1 datë 02.06.2023
1. S. K.
2. V. H.
3. E. H.</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës:
E hapur punë</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit:
384,988,709.39 lekë pa TVSh.
REF-72998-06-19-2023</td><td>6. Oferta fituese: "A. C. & K." sh.p.k, me vlerë 342,831,733.2 lekë pa TVSh.</td><td>7. Diferenca me fondin limit:
42,156,976.19 lekë pa TVSh</td></tr>
</table>

8. Data e hapjes së tenderit: 05.07.2023	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Shetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 7 OE b) Skualifikuar: 6 OE c) Kualifikuar:1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka
14. Lidhja e kontratës, datë 10.10.2023	15. Vlera limit e kontratës 384,988,709.39 lekë pa TVSH	16. Afati I kontratës 24 muaj

Fondi limit dhe Projekti:

Në auditimin e kritereve të vendosura **janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në kundërshtim me Ligjin** nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar.

Konkretisht:

Në pikën 2.3.1, në DST, është kërkuar që OE duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme a-*punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Grupi i auditimit, konstaton se vendosja e kritereve 2.3.1. nga njësia e prokurimit miratuar nga Titullari i AK, është në kundërshtim me VKM nr**.** 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 39 pika 5 ku thuhet se :

5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:
a)punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
b)punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Në **pikën 2.3.7, në DST,** *është kërkuar që OE duhet të disponojnë punonjës të specializuar/kualifikuar të punësuar në periudhën Maj 2023* dhe në listën e profesioneve nuk ka të përfshirë profesion si shofer apo manovratorë të mjeteve të veçanta për të plotësuar kërkesat e përcaktuara **në pikën 2.3.9, në DST,** *ku janë kërkuar që OE për realizimin e kontratës duhet të disponojnë mjetet e pajisjet, ndër të tjera ka kërkuar: 2 kamionë minimumi 14 ton; 2 Kamion vetëshkarkues minimumi 10 ton; 3 kamioçina me kapacitet minimum 4 ton; Ekskavator; fadromë; autobetoniere; autovinç etj*.

Kriteret e veçanta të kualifikimit të mësipërme nuk janë në përputhje me njëra tjetrën dhe janë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" neni 77 pika 4 ku përcaktohet:

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Si dhe me VKM nr**.** 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 39 pika 6 ku përcaktohet :

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:
c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës dhe sistemit SPE, rezulton:
1. BOE i shpallur fitues "A. C." dhe **"K."** sh.p.k me ofertë ekonomike 342,831,733.2 lekë pa TVSH nuk plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, konkretisht:
- Nga subjekti "K." në plotësimin e DST konkretisht në plotësimin e kritereve të veçanta sipas pikës 2.3.9, në DST, sipas Formularit të Deklarimit nr. 8 ka deklaruar në pronësi: Kamion mbi 14 ton; kamion mbi 10 ton; Fadromë. Ndërkohë në po formularin e Deklarimit nr. 8 nuk ka të deklaruar punonjës të profileve shofer dhe manovrator,
- Nga subjekti "K." në plotësimin e DST konkretisht në plotësimin e kritereve të veçanta sipas pikës 2.3.7, në DST, sipas Formularit të Deklarimit nr. 8 nuk ka të deklaruar punëtorë për procesin e suvatimit, dhe punonjës hekurkthyes. Në kontratën e bashkëpunimit të operatorëve ekonomikë datë 05.07.2023 sipas zërave të preventivit që merr përsipër për kryerjen e punimeve në pikën 9 të saj ka në pikën 5 "punime hekuri" zërat e punimeve 1.5.2. dhe 1.5.3. si edhe Pikën 1.11 "punime suvatimi dhe lyerje" zërin 1.11.6.
Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" neni 77 pika 4 ku përcaktohet:

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

2. Operatori ekonomik S. shpk me ofertë ekonomike 312,450,630 lekë (305,280,497 lekë) pa TVSH, sipas procesverbalit datë 31.07.2023 mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është shkualifikuar pasi: oferta e paraqitur nuk është në përputhje me të gjithë kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit konkretisht:
1. Operatori Ekonomik ka mangësi/mos plotësim në dokumentacionin e paraqitur
1. Operatori Ekonomik ka mangësi/mos plotësim në dokumentacionin e paraqitur
- Operatori ekonomik për pajisjet me numër rendor 7,8,9,10,11 kanë deklaruar që do të furnizohen nga subjekti "G.". Subjekti "G." autorizon subjektin "S.C. S.". Nga kontrolli në faqen e QKB rezulton që operatori G. nuk është prodhues i pajisjeve.
- Për pajisjen me numër rendor 1 është paraqitur një autorizim për I. nga A.. Ky autorizim është në gjuhën Angleze, kjo në kundërshtim me përcaktimet e DST.
- Në tabelën e deklarimit të pajisjeve, për pajisjen me numër rendor 15 nuk është specifikuar prodhuesi apo distributori i autorizuar sipas kërkesave kjo në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DT.
- Për pajisjen me numër rendor 6 është deklaruar prodhuesi H.. Për këtë është paraqitur një autorizim për S. C. S., nga B. T. i cili deklaron që është distributor i autorizuar i H., por nuk është paraqitur asnjë lidhje ndërmjet prodhuesit H. dhe B. T..
- Për pajisjen me numër rendor 13 dhe 14 është deklaruar se do të furnizohet nga M. H. Greqi. Për përmbushjen e këtij kriteri është paraqitur autorizim nga K. A. i cili deklaron që është distributor i autorizuar i prodhuesit M. H.. Autorizuesi i prodhuesit për K. A. nuk është nga M. H. por është nga A.-M. A. S.LTD.
2. Operatori ekonomik ka gabim aritmetike në llogaritjen e ofertës së paraqitur.

- Operatori Ekonomik ka aplikuar heqjen e TVSH shumës totale ku janë përfshirë e pajisjet, Oferta e Paraqitur me numra e fjalë është 305,280,497 lekë pa TVSH dhe 366,336,596 lekë me TVSH
Nga sa më sipër rezulton se skualifikimi i OE "S." nuk është i bazuar në prova e fakte të plota po për mangësi e devijime të vogla që mund të kërkohej sqarim me shkrim nga subjekti.
1.1.- Në lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga OE "S." për plotësimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për objektin e prokurimit. Komisionit i Vlerësimit të Ofertave për mangësi e konstatuara në vërtetimin e kërkesës për vërtetimin e lidhjes së prodhuesit më Distributorin nuk ka vepruar me marrjen e informacionet që merren lehtësisht me dokumente faktike me kërkesë zyrtare edhe ndaj Operatorit Ekonomik.
2.1.- Vlera e gabimit aritmetik konstatuar në ofertë është në masën 2.16 % nga oferta prej 305,280,497 lekë pa TVSH në vlerën e korrigjuar prej 312,450,630 lekë pa TVSH, nga Komisioni i Vlerësimin të Ofertave nuk ka kërkesë zyrtare për njoftimin e Operatorit Ekonomik që ka paraqitur ofertën nëse e pranon korrigjimin, për të vazhduar kualifikimin ose jo.

Veprime në kundërshtim të nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" ku përcaktohet:

.....Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thellësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

si dhe me pikën 2 të nenit 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar ku përcaktohet:

....Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.

Referuar sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kishte kualifikuar Operatorin Ekonomik "S." duke renditur në vend të parë në klasifikimin e ofertuesve si dhe duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij, mos veprim që ka sjellë ***një efekt financiar negativ në buxhetin e Shtetit për 30,381,103.2 lekë pa TVSH*** i ardhur nga diferenca e ofertës së shpallur fituese e BOE "A. C. & K." prej 342,831,733.2 lekë dhe ofertës të shkualifikuar në mënyrë të pa mbështetur në ligj të OE "S." prej 312,450,630 lekë pa TVSH.

Procedura me objekt *"Rikonstruksion i Qendrave Shëndetësore (viti 2023-2024)",* nga ku rezultojë se:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "*Ndërtimi i godinës së re Laboratorëve në ISHP***"**		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 197 datë 11.04.2023	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 197 datë 11.04.2023 1. A.P 4. L. A. 2. E. L. 5. B.M. 3. D.K.	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 197/1 datë 11.04.2023 1. M. Sh 4. E. M. 2. V. H. . J. S 3. O.A
4. Lloji i Procedurës: E hapur punë publike		
5. Fondi Limit: 282,593,642 lekë pa TVSh. REF-65894-04-13-2023 Lot.1. 51,146,570.83 lekë Lot..2 63,257,128.1 lekë Lot. 3 93,021,466.93 lekë Lot. 4 75,168,475.93 lekë	6. Oferta fituese: Lot. 1. "Z.K. & I. G." sh.p.k, me vlerë 40,444,769.66 lekë pa TVSh. Lot. 2. "C." sh.p.k, me vlerë 47,348,847.lekë pa TVSh. Lot. 3. "C. R" sh.p.k, me vlerë 70,884,597 lekë pa TVSh. Lot. 4. I. sh.p.k, me vlerë 57,625,120.8 lekë pa TVSh.	7. Diferenca me fondin limit: Lot. 1. 10,701,801.17 lekë pa TVSh Lot. 2 15,908,281.1 lekë pa TVSh Lot. 3. 22,136,869.93 lekë pa TVSh Lot. 4. 17,543,355.13 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 02.05.2023	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Shetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 33 OE

		b) Skualifikuar: 20 OE c) Kualifikuar:13 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

Fondi limit dhe Projekti:

Me urdhrin nr. 187, datë 05.04.2023 "Për ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e QSH për llogaritjen e fondit limit, ndarjen në lote, hartimi e specifikimeve teknike, si dhe përcaktimin e afateve të realizimit të punëve, për objekt prokurimi "Rikonstruksioni i qendrave Shëndetësore viti 2023-2024", përcaktohet se objekti që do të prokurohet "Rikonstruksioni i qendrave Shëndetësore viti 2023-2024" me fond të alokuar në aparatin e MSHMS në vlerën 285,325,008 lekë pa TVSH.

Grupi i punës ka referuar materialet mbështetës përcjellë me shkresat 835/3, datë 04.04.2023 dhe nr. 659/4 datë 04.04.2023 kontratat e shërbimit nr. 3943/11 datë 14.12.2022 me objekt "lot 1 "Projekt preventivat zbatimi e QSH-ve dhe AMB-ve për rajonet Shkodër dhe Vlorë" dhe nr 3943/12 datë 14.12.2022 me objekt "lot 2 "Projekt preventivat zbatimi e QSH-ve dhe AMB-ve për rajonet Tiranë dhe Elbasan".

Sa më sipër nga Grupi i punës është përcaktuar lista për 60 QSH/Ambulancave.

Në dosje nuk administrohet mënyra e përzgjedhjes së listës për 60 QSH/Ambulancave që do të bëhen rikonstruksion. Veprim në kundërshtim me ligjin 162/2020 "Për prokurimin publik" neni 21 ku përcaktohet:

1.Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës dhe sistemit SPE, rezulton:

Loti 1.

Kriteret e vlerësimit:

Me urdhrin e prokurimit nr. 197, datë 11.04.2023 nxjerrë nga Titullari i AK, është përcaktuar fondi limit 282,593,642 lekë pa TVSh., për llojin e procedurës "*Procedurë e Hapur, Punë*". Për Lotin e 1 është përcaktuar fondi limit 51,146,570.83 lekë pa TVSh dhe me urdhrin nr. 197/1, datë 11.04.2023 është përcaktuar KVO dhe data e hapjes së tenderit 02.05.2023.

Nga Njësia e Prokurimit, referuar urdhrit të prokurimit nr. 197, datë 11.04.2023, është mbajtur PV nr. 1592/3 datë 13.04.2023, për hartimin e dokumenteve të tenderit, kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike dhe Dokumentet e Tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

- Në pikën 2.3.1. në DT, kërkohet "*a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur për* ***lotin 1,*** *dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit* ***për lotin 1*** *që prokurohet.....*".

Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, neni 39, "*Kërkesa*

të veçanta për kontratat për punë publike", pika 5.
- Në pikën 2.3.5., në DT, krahas të tjerave, kërkohet që OE të disponojë edhe staf mbështetës përgjegjës kantieri Inxhinier Ndërtimi për Qarkun Tiranë dhe Inxhinier Ndërtimi për Qarkun Durrës, kërkesë e pa argumentuar pasi njëkohësisht në Pikën 2.3.4. Operatorit Ekonomik duhet të deklarojë drejtues teknik për këtë vepër të punësuar: Inxhinier Ndërtimi; Inxhinier Mekanik/Hidroteknik dhe Inxhinier Elektrik.
Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 2 "*Qëllimi*", pikat c) dhe d), neni 77 "*Kërkesat për kualifikim*", si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, neni 39 "*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*", pika 6.
Vlerësimi i ofertave:
- Në Raportin përmbledhës nr. 1597/15, datë 23.06.2023, nga KVO, për Personin e Autorizuar të Autoritetit Kontraktor, si dhe formulari i Njoftimit të Fituesit (pas mbarimit të afatit të ankimimit) datë 26.06.2023 mbi kualifikimin e OE Ofertues konkretisht:

Operatori Ekonomik		Vlera e Ofertuar pa TVSH
BOE	"I. G." & "Z .K"	40,444,769 lekë,
OE	"C. R."	42,258,960 lekë,
BOE	"G." & "E. K."	43,613,810 lekë,
OE	"D."	44,326,727.25 lekë
OE	"E."	43,868,953 lekë,
OE	"N."	45,444,735 lekë,
OE	"M."	45,703,207 lekë,
BOE	"G." & "N."	46,726,979.2 lekë,
BOE	"I." & "I."	48,604,148.5 lekë,
OE	"S."	48,667,341 lekë,
OE	"F. C."	----------

Nga kontrolli i dokumentacionit u konstatua se BOE "I. G." & "Z K." shpallur fitues sipas kriterit me ofertën ekonomike më të ulët, plotëson kriteret e vendosura në DT, kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare si dhe kapacitetet teknike. Sipas shkresës nr. 1592/25, datë 11.07.2023 "Formular i njoftimit të kontratës së nënshkruar është njoftuar Agjencia e Prokurimit Publik, për fituesin e Lotit 1 lidhja e kontratës me Bashkimin e Operatorëve Ekonomik "I. G." & "Z K." në vlerë 40,444,769 lekë,

Loti 2.
Kriteret e vlerësimit:
Me urdhrin e prokurimit nr. 197, datë 11.04.2023 nxjerrë nga Titullari i AK, është përcaktuar fondi limit 282,593,642 lekë pa TVSh., për llojin e procedurës "*Procedurë e Hapur, Punë*". Për Lotin e 2 është përcaktuar fondi limit 63,257,128.1 lekë pa TVSh dhe me urdhrin nr. 197/1, datë 11.04.2023, data e hapjes së tenderit 02.05.2023.
Nga Njësia e Prokurimit, referuar urdhrit të prokurimit nr. 197, datë 11.04.2023, është mbajtur PV nr. 1592/3 datë 13.04.2023, për hartimin e dokumenteve të tenderit, kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike dhe Dokumentet e Tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.
- Në pikën 2.3.1. në DT, kërkohet "*a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur për* ***lotin 2,*** *dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku*

*vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit **për lotin 2** që prokurohet.....*".

Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, neni 39, "*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*", pika 5.

- **Në pikën 2.3.5.,** në DT, krahas të tjerave, kërkohet që OE të disponojë edhe staf mbështetës përgjegjës kantieri Inxhinier Ndërtimi për Qarkun Elbasan dhe Inxhinier Ndërtimi për Qarkun Korçë, Qarkun Berat dhe Inxhinier Ndërtimi, kërkesë e pa argumentuar pasi njëkohësisht në **Pikën 2.3.4.** Operatorit Ekonomik duhet të deklarojë drejtues teknik për këtë vepër të punësuar : Inxhinier Ndërtimi; Inxhinier Mekanik/Hidroteknik dhe Inxhinier Elektrik.

Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 2 "*Qëllimi*", pikat c) dhe d), neni 77 "*Kërkesat për kualifikim*", dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, neni 39 "*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*", pika 6.

Vlerësimi i ofertave:

- Në Raportin përmbledhës nr. 1597/15, datë 23.06.2023, nga KVO, për Personin e Autorizuar të Autoritetit Kontraktor, si dhe formulari i Njoftimit të Fituesit (pas mbarimit të afatit të ankimimit) datë 26.006.2023 mbi kualifikimin e OE Ofertues nga kontrolli i dokumentacionit u konstatua:

Operatori Ekonomik		Vlera e Ofertuar	
BOE	"I. G." & "Z K" & "V G"	45,706,208	lekë,
OE	"C."	47,821,371	lekë,
OE	"B"	49,821,370	lekë,
BOE	"F" & "B" & "K"	50,868,220	lekë,
OE	"Z"	58,192,874.35	lekë,
OE	"F C"		

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka përcaktuar fitues të Lotit 2, OE "C." me ofertën ekonomike për 47,348,847 lekë pa TVSH,

Nga auditimi i dokumentacionit paraqitur në sistemin e SPE nga Operatorët Ekonomikë u konstatua se:

1. BOE "I.", **"Z.K." dhe "V. G."** sh.p.k me ofertë ekonomike 45,706,208 lekë pa TVSH, sipas vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në Raportin përmbledhës datë 23.06.2023 "Ky BOE është fitues potencial në lotin 2 dhe sipas sqarimeve të NJ.P. nuk plotëson kategorinë e licencave, nr. e punonjësve dhe mjetet, kontratat e ngjashme, xhiro... etj sipas shumatores së lotëve për të cilat konkurron. Për sa më sipër nuk kualifikohet, pasi ka konkurruar edhe për Lotin 4.

2. OE "C." me ofertë ekonomike 47,348,847 lekë pa TVSH, sipas vlerësimit të KVO plotëson Kriteret e Veçanta dhe Kriteret e Përgjithshme të Prokurimit të Kualifikimit.

Njoftimin paraprak të fituesit për Lot 2 i publikuar në SPE në datë 15.06.2023

Nga Komisioni i Verifikimit të Ofertave në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga OE "C." nuk është marrë në konsideratë edhe paraqitja për prokurim i OE në Lotin e 4 dhe sipas dokumentacionit të paraqitur nuk plotëson, nr. e punonjësve dhe mjetet, kontratat e ngjashme, xhiro... etj sipas shumatores së lotëve për të cilat konkurron.

Për sa më lart Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vepruar me dy standarde pasi në rastin e OE "C." me të njëjtat kategorinë e licencave; nr. e punonjësve dhe mjetet, kontratat e ngjashme; xhiro etj. të ofertuar në lotët 2 e 4 dhe është shpallur fitues në lotin 2, njëkohësisht BOE "I.", "Z.K." dhe "V. G." ka ofertuar në lotët 2 dhe 4, por është shkualifikuar për mos plotësim DT sipas kërkesës të DT kur oferton për 2 apo më shumë lote.

Veprime në kundërshtim me nenin 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" ku përcaktohet:

Qëllim i këtij ligji është:..... *d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.*

Referuar sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kishte kualifikuar BOE "I.", "Z.K." dhe "V. G." duke renditur në vend të parë në klasifikimin e ofertuesve si dhe duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij, mos veprim që ka sjellë ***një efekt financiar negativ në buxhetin e Shtetit për 1,642,639 lekë pa TVSH*** i ardhur nga diferenca e ofertës së shpallur fituese e **"C."** në vlerë 47,348,847 lekë pa TVSH dhe ofertës të shkualifikuar në mënyrë të pa mbështetur në ligj të BOE "I.", "Z.K." dhe "V. G." prej 45,706,208 lekë pa TVSH.

Loti 3.

Kriteret e vlerësimit:

Me urdhrin e prokurimit nr. 197, datë 11.04.2023 nxjerrë nga Titullari i AK, është përcaktuar fondi limit 282,593,642 lekë pa TVSh., për llojin e procedurës "*Procedurë e Hapur, Punë*". Për Lotin e 2 është përcaktuar fondi limit 63,257,128.1 lekë pa TVSh dhe me urdhrin nr. 197/1, datë 11.04.2023, data e hapjes së tenderit 02.05.2023.

Nga Njësia e Prokurimit, referuar urdhrit të prokurimit nr. 197, datë 11.04.2023, është mbajtur PV nr. 1592/3 datë 13.04.2023, për hartimin e dokumenteve të tenderit, kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike dhe Dokumentet e Tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

- **Në pikën 2.3.1.** në DT, kërkohet "*a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur për* ***lotin 3,*** *dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit* ***për lotin 3*** *që prokurohet.....*".

Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, neni 39, "*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*", pika 5.

- **Në pikën 2.3.5.,** në DT, krahas të tjerave, kërkohet që OE të disponojë edhe staf mbështetës përgjegjës kantieri Inxhinier Ndërtimi për Qarkun Shkodër dhe Inxhinier Ndërtimi për Qarkun Lezhë, kërkesë e pa argumentuar pasi njëkohësisht në **Pikën 2.3.4.** Operatorit Ekonomik duhet të deklarojë drejtues teknik për këtë vepër të punësuar : Inxhinier Ndërtimi; Inxhinier Mekanik/Hidroteknik dhe Inxhinier Elektrik.

Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 2 "*Qëllimi*", pikat c) dhe d), neni 77 "*Kërkesat për kualifikim*", dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, neni 39 "*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*", pika 6.

Vlerësimi i ofertave:

- Në Raportin përmbledhës nr. 1597/15, datë 23.06.2023, nga KVO, për Personin e Autorizuar të Autoritetit Kontraktor, si dhe formulari i Njoftimit të Fituesit (pas mbarimit të afatit të ankimimit) datë 26.06.2023 mbi kualifikimin e OE Ofertues nga kontrolli i dokumentacionit u konstatua:

Operatori Ekonomik	Vlera e Ofertuar pa TVSH
BOE "K. C." & "D."	69,716,476.13 lekë,
OE "C. R."	70,884,597 lekë,

OE "2." 74,184,508 lekë,
OE "N." 82,987,535 lekë,
OE "S." 85,171,171.15 lekë,
OE "F.C." ----------

Në shqyrtimin e ofertave të paraqitura nga Komisioni i Vlerësimit të ofertave u konstatua se BOE "K. C." & "D." më ofertën ekonomike 69,716,476.13 lekë pa TVSH rezultoi se çmimi/njësi për një zë punimi ishte i pa plotësuar, nga kërkesa për sqarimi në datë 25.05.2023, BOE kthen përgjigje duke sqaruar komisionin (referuar sistemit SPE). Nga kontrolli i ofertës rezultoi me gabime aritmetike dhe sipas KVO ishte 67,129,377.8 lekë pa TVSH (oferta e Operatorit ishte paraqitur për 69,716,476.13 lekë pa TVSH). Mbas kërkesës dhe sqarimit së KVO në datë 31.05.2023 për pranimin e korrigjimit nga BOE. Në datë 02.06.2023 BOE nuk pranoi të bëje korrigjimin e vlerës së ofertuar(referuar SPE). Bazuar në nenin 82 të VKM 285/2021 oferta refuzohet për arsye se nuk pranon korrigjimin.

Sipas shkresës nr. 1592/25, datë 11.07.2023 "Formular i njoftimit të kontratës së nënshkruar është njoftuar Agjencia e Prokurimit Publik, për fituesin e Lotit 3 lidhja e kontratës me Operatorin Ekonomik "C. R" në vlerë 70,884,597 lekë

Loti 4.

Kriteret e vlerësimit:

Me urdhrin e prokurimit nr. 197, datë 11.04.2023 nxjerrë nga Titullari i AK, është përcaktuar fondi limit 282,593,642 lekë pa TVSh., për llojin e procedurës "*Procedurë e Hapur, Punë*". Për Lotin e 2 është përcaktuar fondi limit 63,257,128.1 lekë pa TVSh dhe me urdhrin nr. 197/1, datë 11.04.2023, data e hapjes së tenderit 02.05.2023.

Nga Njësia e Prokurimit, referuar urdhrit të prokurimit nr. 197, datë 11.04.2023, është mbajtur PV nr. 1592/3 datë 13.04.2023, për hartimin e dokumenteve të tenderit, kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike dhe Dokumentet e Tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

- Në pikën 2.3.1. në DT, kërkohet "*a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur për* ***lotin 4,*** *dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit* ***për lotin 4*** *që prokurohet.....*".

Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, neni 39, "*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*", pika 5.

- **Në pikën 2.3.5.,** në DT, krahas të tjerave, kërkohet që OE të disponojë edhe staf mbështetës përgjegjës kantieri Inxhinier Ndërtimi për Qarkun Vlorë dhe Inxhinier Ndërtimi për Qarkun Gjirokastër, kërkesë e pa argumentuar pasi njëkohësisht në **Pikën 2.3.4.** Operatorit Ekonomik duhet të deklarojë drejtues teknik për këtë vepër të punësuar : Inxhinier Ndërtimi; Inxhinier Mekanik/Hidroteknik dhe Inxhinier Elektrik.

Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 2 "*Qëllimi*", pikat c) dhe d), neni 77 "*Kërkesat për kualifikim*", dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, neni 39 "*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*", pika 6.

Vlerësimi i ofertave:

- Në Raportin përmbledhës nr. 1597/15, datë 23.06.2023, nga KVO, për Personin e Autorizuar të Autoritetit Kontraktor, si dhe formulari i Njoftimit të Fituesit (pas mbarimit të afatit të ankimimit) datë 26.006.2023 mbi kualifikimin e OE Ofertues nga kontrolli i dokumentacionit u konstatua:

Operatori Ekonomik		Vlera e Ofertuar pa TVSH
OE	"C."	51,004,668 lekë,
BOE	"I." & "Z.K." & "V.G."	53,888,348 lekë,
BOE	"M." & "I."	59,028,125 lekë,
BOE	"F." & "B." & "C.u"	59,144,436 lekë,
OE	I. *(oferta e korrigjuar 57, 625,120.8 lekë pa TVSH)*	59,983,491 lekë,
BOE	"R." & "T.-D" & "A. C."	61,855,779 lekë,
BOE	"C." & "K. G. K."	64,814,815 lekë,
OE	"A.K."	67,571,967 lekë,
BOE	"G." & "N."	68,641,847.83 lekë,
OE	"F.C."	----------

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka përcaktuar fitues të Lotit 4, OE I. sh.p.k me ofertë ekonomike 59,983,491 lekë pa TVSH *(oferta e korrigjuar 57, 625,120.8 lekë pa TVSH),*

Nga auditimi i dokumentacionit paraqitur në sistemin e SPE nga Operatorët Ekonomikë u konstatua se:

1. OE "C." me ofertë ekonomike 51,004,668 lekë pa TVSH, sipas vlerësimit të KVO nuk kualifikohet pasi ka një diferencë në sasinë e ofruar për një zë punimesh nga kërkesa sipas preventivit *(për Qendrën Shëndetësore Erind Gjirokastër në preventivin e paraqitur nga ky OE në zërin 14 An (instalime Hidrosanitare dhe Mekanike) ofruar 250 copë fasheta x 268 lekë/copa nga kërkesa e preventivit për 4 copë fasheta x 268 lekë/copa me një diferencë 65,928 lekë më shumë në një ofertë totale prej 51,004,668 lekë).*

2. BOE "I.", **"Z.K." dhe "V. G."** sh.p.k me ofertë ekonomike 53,888,348 lekë pa TVSH, sipas vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në Raportin përmbledhës datë 23.06.2023 "Ky OE nuk plotëson kategorinë e licencave, nr. e punonjësve, mjetet, kontratat e ngjashme, xhiro... etj sipas shumatores së lotëve për të cilat konkurron. Për sa më sipër nuk kualifikohet.

3**. OE I.** sh.p.k me ofertë ekonomike 59,983,491 lekë pa TVSH, sipas vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në Raportin përmbledhës datë 23.06.2023, KVO i ka dërguar OE mesazh për pranimin e korrigjimit të ofertës nga 59,983,491 lekë pa TVSH në vlerën e korrigjuar për 57, 625,120.8 lekë pa TVSH. Në sistemin SPE datë 02.06.2023 OE ka pranuar korrigjimin e propozuar. OE I. është shpallur fitues me Njoftimin paraprak të fituesit për Lot 4 i publikuar në SPE në datë 12.06.2023

1. Për sa më lart Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vepruar me dy standarde pasi në rastin e OE "C." me të njëjtat kategorinë e licencave; nr. e punonjësve dhe mjetet, kontratat e ngjashme; xhiro etj. ka ofertuar në lotët 2 e 4 dhe është shpallur fitues në lotin 2, njëkohësisht BOE "I.", "Z.K." dhe "V. G." ka ofertuar në lotët 2 dhe 4, por është shkualifikuar në të dy rastet për mos plotësim DT sipas kërkesës të DT kur oferton për 2 apo më shumë lote.

Veprime në kundërshtim me nenin 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" ku përcaktohet:

Qëllim i këtij ligji është:..... *d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.*

Referuar sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kishte kualifikuar BOE "I.", "Z.K." dhe "V. G." duke renditur në vend të parë në klasifikimin e ofertuesve si dhe duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij, mos veprim që ka sjellë ***një efekt financiar negativ në buxhetin e Shtetit për 3,736,772 lekë pa TVSH*** i ardhur nga diferenca e ofertës së shpallur fituese e I. në vlerë 57, 625,120.8 lekë pa TVSH dhe ofertës të shkualifikuar në mënyrë të pa mbështetur në ligj të BOE "I.", "Z.K." dhe "V. G." prej 53,888,348 lekë pa TVSH.

2. OE "C." me ofertë ekonomike 51,004,668 lekë pa TVSH, sipas vlerësimit të KVO nuk kualifikohet pasi ka një diferencë në sasinë e ofruar për një zë punimesh nga kërkesa sipas preventivit *(për Qendrën Shëndetësore Erind Gjirokastër në preventivin e paraqitur nga ky OE në zërin 14 An (instalime Hidrosanitare dhe Mekanike) ofruar 250 copë fasheta x 268 lekë/copa nga kërkesa e preventivit për 4 copë fasheta x 268 lekë/copa me një diferencë 65,928 lekë më shumë kur oferta ofertë totale është për 51,004,668 lekë, me një gabim prej 0.13 %).*
Komisioni i Vlerësimin të Ofertave nuk ka kërkesë zyrtare për njoftimin e Operatorit Ekonomik që ka paraqitur ofertën nëse e pranon korrigjimin.
Veprime në kundërshtim të nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" ku përcaktohet:

.....Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thellësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

si dhe me pikën 2 të nenit 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar ku përcaktohet:

....Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.

Referuar sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kishte kualifikuar OE "C." duke renditur në vend të parë në klasifikimin e ofertuesve si dhe duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij, mos veprim që ka sjellë ***një efekt financiar negativ në buxhetin e Shtetit për 6,620,452.8 lekë pa TVSH*** i ardhur nga diferenca e ofertës së shpallur fituese e I. në vlerë 57, 625,120.8 lekë pa TVSH dhe ofertës të shkualifikuar në mënyrë të pa mbështetur në ligj të OE "C." prej 51,004,668 lekë pa TVSH.

Për sa më sipër janë paraqitur observacionet: për Projektraportin e Auditimit nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me nr. 85/2, datë 04.02.2026 ardhur në KLSH me nr. 110/27, datë 06.02.2026 nga Përfaqësuesit e MSHMS: A. A, L. A, E. L., E. B., D.K., E.H., V. H., S. K., M. K., M. Sh, për sa më poshtë:
Pretendimi i subjektit: *Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet..." Ky përcaktim nuk përmban ndalim për operatorin ekonomik, por vendos një kufi maksimal për kërkesat që mund të vendosë autoriteti kontraktor. Me fjalë të tjera: autoriteti kontraktor nuk lejohet të kërkojë përvojë mbi 50% të vlerës së kontratës për një objekt të vetëm; por është plotësisht e lejuar që të kërkojë përvojë deri në këtë kufi (pra nga 0% +50%), përfshirë edhe pikërisht 50%, siç është bërë në këtë rast.*
Qëndrimi i grupit të auditimit: *Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi* ***se argumentimi Juaj nuk merret në konsideratë,*** *pasi në nenin 39, pika 5 e RPP është përcaktuar se: "autoriteti/enti*

kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet..

Pretendimi i subjektit: *Kriteret në pikën 2.3.7 të DST së për objektin: "Ndërtimi i godinës së re të laboratorëve në ISHP", dhe pikën 2.3.5 për objektin: "Rikonstruksion i qendrave shëndetësore (viti 2023-2024)". Nuk janë në kundërshtim me Ligjin 162/2020 dhe VKM nr. 285/2021, por janë në proporcion me objektet e kontratave të sipërpërmendura dhe janë jo vetëm në zbatim të RPP, por dhe të akteve ligjore e nënligjore të fushës së ndërtimit si, Ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", UKM nr.2 date 13.05.2005 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit, etj*

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Në lidhje me sa më sipër, shprehemi* ***se argumentimi Juaj nuk merret në konsideratë.*** *Në pikën 2.3.7, në DT, është kërkuar që OE duhet të disponojnë punonjës të specializuar kualifikuar të punësuar në periudhën Maj 2023 dhe në listën e profesioneve nuk ka të përfshirë profesion shofer apo manovratorë të mjeteve të veçanta për të plotësuar kërkesat e përcaktuara në pikën 2.3.9, të DT.*

Në pikën 2.3.5 në DT, krahas të tjerave kërkohet që OE duhet të disponojë edhe stafin mbështetës -pergjegjes kantieri Inxhinier ndërtimi për qarkun Vlorë, dhe një inxhinier ndërtimi për qarkun Gjirokastër, kërkesë e paargumentuar pasi njëkohësisht në pikën 2.3.4 OE duhet të deklarojë drejtues teknik për këtë vepër të punësuar: Inxh ndërtimi, inxh mekanik/hidroteknik dhe inxh elektrik.

Pretendimi i subjektit: *Subjekti "K." në Formularin e Deklarimit nr. 8 ka deklaruar në pronësi mjete të rënda (kamion mbi 14 ton, kamion mbi 10 ton dhe fadromë), por nuk ka deklaruar punonjës të profileve shofer apo manovrator, sqarojmë sa vijon: Në dokumentet standarde të tenderit, konkretisht në pikën 2.3.9, është përcaktuar qartë detyrimi për të disponuar mjetet dhe pajisjet e nevojshme për kryerjen e punimeve, por nuk është përcaktuar asnjë kërkesë që këto mjete të shoqërohen me deklarimin e personelit të posaçëm (shoferë ose manovratorë) për secilin mjet, dhe as që këta punonjës duhet të jenë pjesë e listë-pagesës së të njëjtit operator ekonomik që i zotëron mjetet. Çdo kërkesë shtesë për deklarim të personelit shofer/manovrator për mjetet e rënda, përbën vendosje të një kriteri të ri kualifikimi,*

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se* ***argumentimi Juaj nuk merret në konsideratë;*** *Nga subjekti "K." në plotësimin e DST konkretisht në plotësimin e kritereve të veçanta sipas pikës 2.3.9, në DST, sipas Formularit të Deklarimit nr. 8 ka deklaruar në pronësi: Kamion mbi 14 ton; kamion mbi 10 ton; Fadromë. Ndërkohë në po formularin e Deklarimit nr. 8 nuk ka të deklaruar punonjës të profileve shofer dhe manovrator,*

Pretendimi i subjektit: *Në lidhje me konstatimin e KLSH-së se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) ka pranuar ofertën ndonëse, sipas tyre, anëtari "K." i bashkimit duhet të kishte punonjës suvatues dhe hekurkthyes, sqarojmë sa vijon:VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" KREU XI, kushte të përgjithshme për zbatim, Neni 88 Bashkimi i operatorëve ekonomikë pika 3:Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

Oferta është paraqitur nga një BOE ku sipas marrëveshjes së bashkëpunimit datë 05.07.2023 operatorët ekonomikë kanë ndarë përqindjen e punimeve përkatësisht Agri Construction me 89.95% ndërsa OE K. me 10.05% të punimeve.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se* ***argumentimi Juaj nuk merret në konsideratë;*** *Nga subjekti "K." në plotësimin e DST konkretisht në plotesimin e kritereve të vecanta sipas pikes 2.3.7, ne DST, sipas Formularit të Deklarimit nr. 8 nuk ka të deklaruar punetorë për procesin e suvatimit, dhe punonjës hekurkthyes. Në kontraten e bashkëpunimit të operatorëve ekonomike datë 05.07.2023 sipas zërave të preventivit që merr përsipër për kryerjen e punimeve në pikën 9 të saj ka ne pikën 5 "punime hekuri" zërat e punimeve 1.5.2. dhe l.5.3. si edhe Piken 1.11 "punime suvatimi dhe lyerje" zerin 1.11.6.*
Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" neni 77 pika 4
Pretendimi i subjektit: *Sa i përket pajisjeve të tjera të ofruara, nga verifikimi i kryer nga KVO është konstatuar se, për disa prej tyre, mungon dokumentacioni që provon lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit. Ky element është thelbësor në procesin e vlerësimit, pasi në mungesë të këtij dokumentacioni nuk garantohet që pajisjet e ofertuara janë të autorizuara nga prodhuesi origjinal, duke rrezikuar cilësinë, standardet dhe garancitë e kontraktuara. Është e rëndësishme të theksohet se, sipas kuadrit ligjor dhe nënligjor për prokurimin publik, çdo dokument që lidhet me cilësinë e pajisjeve, origjinën e tyre dhe të drejtën për t'i ofruar ato në tender duhet të jetë pjesë e dokumentacionit të ofertës që në momentin e dorëzimit.*
Qëndrimi i grupit të auditimit: *Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se* ***argumentimi Juaj merret pjesërisht në konsideratë;*** *Në lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga OE "S." për plotësimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për objektin e prokurimit. Komisionit i Vlerësimit të Ofertave për mangësi e konstatuara në vërtetimin e kërkesës për vërtetimin e lidhjes së prodhuesit më Distributorin nuk ka vepruar me marrjen e informacionet që merren lehtësisht me dokumente faktike me kërkesë zyrtare edhe ndaj Operatorit Ekonomik.*
Pretendimi i subjektit: *Në këtë rast, gabimi aritmetik prej 2.16% e tejkalon kufirin ligjor prej 2%, dhe si pasojë, oferta hyn automatikisht në kushtet e refuzimit. Ligji nuk parashikon që në këtë rast të kërkohet pranim ose mospranim nga operatori mospranim ekonomik për korrigjimin, pasi tejkalimi i pragut prej 2% sjell detyrimisht skualifikimin e ofertës, pa pasur nevojë për ndonjë procedurë të mëtejshme administrative.Praktika e njoftimit dhe pranimit të korrigjimit është e zbatueshme vetëm për rastet kur korrigjimi i gabimit aritmetik është brenda kufirit prej 2%.*
Qëndrimi i grupit të auditimit: *Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se* ***argumentimi Juaj merret pjesërisht në konsideratë;*** *Vlera e gabimit aritmetik konstatuar në ofertë është në masën 2.16 % nga oferta prej 305,280,497 lekë pa TVSH në vlerën e korrigjuar prej 312,450,630 lekë pa TVSH, nga Komisioni i Vlerësimin të Ofertave nuk ka kërkesë zyrtare për njoftimin e Operatorit Ekonomik që ka paraqitur ofertën nëse e pranon korrigjimin, për të vazhduar kualifikimin ose jo, kjo edhe nga diferenca në vlerë e ofertës.*

Për sa më sipër janë paraqitur observacionet: për Projektraportin e Auditimit nga Ministria e Shëndetësisë e Mirëqenies Sociale me nr. 85/2, datë 02.02.2026 ardhur në KLSH me nr. 110/26, datë 05.02.2026 nga Përfaqësuesit e MSHMS: M. Sh, O. A., E. M., V. H., J. S për sa më poshtë:
Pretendimi i subjektit: *Në rastin e Lotit 4 në tenderin "Rikonstruksioni i qendrave shëndetësore", sipas Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nuk qëndron efekt financiar negativ në buxhetin e Shtetit, pasi: Ndryshimi i sasisë në formularin e ofertës nuk mund të quhet gabim i vogë aritmetik, për arsye se ligji i prokurimit shprehet qartë se në cilat raste quhet gabim aritmetik. Lejimi i korrigjimit në këtë rast do të nënkuptonte që një operator që ndryshon një zë teknik mund të ftohet për sqarim apo korrigjim kështu do të cenonte barazinë në konkurrim.*
Qëndrimi i grupit të auditimit: *OE "C." me ofertë ekonomike 51,004,668 lekë pa TVSH, sipas vlerësimit të KVO nuk kualifikohet pasi ka një diferencë në sasinë e ofruar për një zë punimesh*

nga kërkesa sipas preventivit (për Qendrën Shëndetësore Erind Gjirokastër në preventivin e paraqitur nga ky OE në zërin 14 An (instalime Hidrosanitare dhe Mekanike) ofruar 250 copë fasheta x 268 lekë/copa nga kërkesa e preventivit për 4 copë fasheta x 268 lekë/copa me një diferencë 65,928 lekë më shumë kur oferta ofertë totale është për 51,004,668 lekë, me një gabim prej 0.13 %). Komisioni i Vlerësimin të Ofertave nuk ka kërkesë zyrtare për njoftimin e Operatorit Ekonomik që ka paraqitur ofertën nëse e pranon korrigjimin. Veprime në kundërshtim të nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020.

Publikimi i procedurave të prokurimit

Sipas përcaktimit në nenin 56 të LPP-së, për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, njoftimet publikohen edhe në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian (EUOJ), me përjashtim të njoftimit të fituesit dhe njoftimit të procedurës së anuluar. Në njoftimet që publikohen, sipas këtij ligji, duhet të përfshihen të gjitha informacionet që u lejojnë operatorëve ekonomikë të vendosin nëse do të marrin pjesë apo jo në procedurat e prokurimit. Nga auditimi u konstatua se, pavarësisht se procedurat e prokurimit B1, B2 dhe B3 për furnizimin me barna të spitaleve publike, janë *mbi kufirin e lartë monetar*, këto procedura janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, për të krijuar kushtet dhe për të mundësuar pjesëmarrjen në procedurë tenderimi të operatorëve ekonomikë ndërkombëtarë, me qëllim rritjen e konkurrencës. Në nenin 24, pika 3, të RPP-së, përcaktohet se "*publikimi edhe në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, sipas përcaktimit të nenit 56 të LPP-së, bëhet kur ky detyrim vjen nga angazhimi i shtetit shqiptar në raport me strukturat e Bashkimit Evropian*".

Nga ana e MSHMS-së është vënë në dispozicion korrespondenca elektronike me APP-në, nëpërmjet e-mail të datës 13.06.2025, dërguar nga adresa info@app.gov.al, me subjekt "*Re: Kërkesë për asistencë*", ku APP, në përmbushje të detyrave të përcaktuara në nenin 23, pika ç, të LPP-së, ka dhënë këshilla dhe asistencë, me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik. Në këtë e-mail janë interpretuar neni 56, pika 2, e LPP dhe neni 24, pika 3, e RPP, duke cituar se "*detyrimet për publikimin e njoftimeve për procedurat e prokurimit edhe në Gazetën Zyrtare të BE-së* ***zbatohen kur shteti shqiptar të angazhohet në strukturat e Bashkimit Evropian***".

Për gjithë sa më sipër, pavarësisht se janë aplikuar të gjitha detyrimet e tjera që burojnë nga dispozitat ligjore për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar (si p.sh., publikimi i dokumenteve të tenderit në gjuhën angleze, afatet e përcaktuara për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, etj.), por pa publikuar njoftimin në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, asnjë operator ekonomik ndërkombëtar nuk ka marrë pjesë në asnjë prej lot-eve të publikuar.

Mbi sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nëpërmjet shkresës nr. 85/2 prot., datë 04.02.2026, administruar në KLSH me nr. 110/27 prot., datë 06.02.2026, subjekti i audituar MSHMS ka paraqitur observacionet, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Neni 56, pika 2, i Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar" gjen interpretim dhe zbatim të mëtejshëm në aktin nënligjor, përkatësisht neni 24, pika 3, i VKM-së nr. 285/2021, ku citohet se publikimi në GZBE bëhet kur ky detyrim vjen nga angazhimi i shtetit shqiptar në raport me strukturat e BE-së, pra detyrimi është i lidhur ngushtë me angazhimet ndërkombëtare të shtetit shqiptar, përkatësisht në kuadër të marrëdhënieve me BE-në. Në mungesë të një detyrimiformal ndërkombëtar, ky publikim nuk është i detyrueshëm. Për më tepër, edhe ju keni cituar interpretimin zyrtar të legjislacionit të prokurimit publik në fuqi, i dhënë nga organi përgjegjës për dhënien e këshillave dhe asistencës në fushën e prokurimit publik.

Theksojmë se konstatimi nga KLSH mbi mosrespektimin e detyrimit për publikim në GZBE nuk mund të konsiderohet shkelje, për sa kohë MSHMS ka ndjekur saktësisht udhëzimet dhe interpretimet e APP-së.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Në këtë pjesë të materialit është trajtuar gjithë sa ju parashtroni në observacion. Kjo nuk është konsideruar shkelje për sa kohë grupit të auditimit i është vënë në dispozicion komunikimi zyrtar me APP-në, i cituar në material. Gjithë sa më sipër, nuk e ndryshon faktin se, pavarësisht se janë aplikuar të gjitha detyrimet e tjera që burojnë nga dispozitat përkatëse për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, por pa publikuar njoftimin në GZBE, asnjë operator ekonomik ndërkombëtar nuk ka marrë pjesë në asnjë prej 256 lot-eve të prokuruara nga MSHMS.
Për sa më sipër, observacioni nuk merret parasysh.

Mbi mbikqyrjen nga MSHMS të institucioneve spitalore të varësisë, në lidhje me zbatimin e kontratave të furnizimit me barna

Furnizimi me barna për spitalet publike është thelbësor për ofrimin e shërbimit spitalor në Republikën e Shqipërisë. Për të garantuar sa më sipër, MSHMS kryen procedurën e prokurimit të përqendruar për furnizim me barna për përdorim spitalor, për 44 institucione spitalore, përfshirë spitale terciare, spitale rajonale, spitale bashkiake/ ditore dhe spitale psikiatrike. Sipas përkufizimeve përkatëse në legjislacionin e prokurimit publik, MSHMS operon si organ qendror blerës, duke lidhur Marrëveshjet Kuadër me afat 24 muaj me një operator ekonomik për secilin lot (bar), ndërkohë që autoritete kontraktore konsiderohen vetë spitalet publike, të cilat bazuar në kërkesat e paraqitura gjatë fazës së planifikimit, lidhin kontratat bazuar në Marrëveshjet kuadër.
Sipas përcaktimeve në DST, disa prej detyrimeve kryesore për palën furnizuese (OE) konsistojnë në realizimin e furnizimit (i) sipas të dhënave në DST lidhur me datën e prodhimit dhe datën e skadencës, (ii) sipas ofertës fituese (bar-i sipas të cilit është shpallur fitues, kompania dhe vendi i origjinës), si dhe (iii) lëvrimin brenda afateve të përcaktuara në kontrata. Sipas legjislacionit të prokurimit publik, monitorimi i zbatimit të kontratave është përgjegjësi e autoriteteve kontraktore, në këtë rast vetë institucionet spitalore.
Pavarësisht se sipas legjislacionit të prokurimit publik, monitorimi i zbatimit të këtyre kontratave është përgjegjësi e vetë autoriteteve kontraktore, MSHMS, si institucioni përgjegjës për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe për bashkërendimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve brenda dhe jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor, të cilët kontribuojnë dhe synojnë të garantojnë të drejtën kushtetuese të përcaktuar në nenin 55 të Kushtetutës, sipas përcaktimit në pikën 2 të VKM-së nr. 609, datë 20.10.2021, duhet të mbikqyrë në mënyrë efektive dhe të përshtatshme zbatimin e këtyre kontratave, për të garantuar se institucionet spitalore publike furnizohen në kohë dhe në cilësi me barnat e kërkuar.
Nga auditimi u konstatua se MSHMS-ja nuk ka përcaktuar një person/ strukturë brenda MSHMS-së, si pikë kontakti për të gjithë institucionet spitalore të varësisë, nëpërmjet së cilës MSHMS të vihet në dijeni për çdo problematikë të shfaqur, lidhur me ecurinë e kontratave të furnizimit me barna, që mund të ndikojnë në disponibilitetin e barnave në spitalet publike.
Neni 23, pika 1, i Ligjit nr. 90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*" përcakton se institucionet e varësisë mbikqyren, ndër të tjera, për realizimin e objektivave të miratuar politikë dhe të menaxhimit, për ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e veprimeve të tyre administrative, ekzekutimin e buxhetit, menaxhimin financiar, etj.
Lidhur me mbikqyrjen e veprimtarisë së institucioneve spitalore të varësisë, mbi zbatimin e kontratave të furnizimit me barna, nga MSHMS-ja bëhet me dije se, zbatim të rekomandimeve të

lëna në Raportin Përfundimtar të Auditimit të përputhshmërisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2023, përkatësisht rekomandimeve nr. 25.1 dhe 26.1, spitaleve u është kërkuar të raportojnë mbi zbatimin e marrëveshjeve kuadër të vitit 2022, me qëllim (i) sigurimin e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale nga të gjithë palët e përfshira, (ii) vlerësimin e progresit të arritur dhe identifikimin e çdo devijimi nga planet e parashikuara, (iii) verifikimin e shpenzimeve dhe alokimit të burimeve financiare sipas kushteve të marrëveshjeve dhe (iv) sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies.

Nëpërmjet shkresës nr. 3098 prot., datë 10.07.2024, Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS-së S. H. u është drejtuar Drejtorive të Spitaleve, duke kërkuar (i) një përmbledhje të raporteve të monitorimit të zbatimit të MK-ve dhe mbarëvajtjes së minikontratave bazuar në to, duke konstatuar mangësitë/ problematikat eventuale, si dhe (ii) informacion mbi rastet kur është mbajtur sigurimi i kontratës dhe procedurat që keni ndjekur për mospërmbushje të kushteve. Në shkresë citohet se ky informacion është kërkuar "*në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së të vitit 2023, me qëllim (i) sigurimin e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale nga të gjitha palët e përfshira, (ii) vlerësimin e progresit të arritur dhe identifikimin e çdo devijimi nga planet e parashikuara, (iii) verifikimin e shpenzimeve dhe alokimit të burimeve financiare sipas kushteve të marrëveshjeve dhe (iv) sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies*".

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga MSHMS-ja, konstatohet se:

1. Pavarësisht se vlera totale e fondit limit të përllogaritur për QSUNT dhe SUSN (*të cilët janë 2 spitalet publike ku është parashikuar vlera limit e pritshme më e madhe në raport me spitalet e tjera publike*) është në total 5,138,547,966 lekë pa TVSH (*ku për QSUNT është 4,563,062,775 lekë pa TVSH dhe për SUSN është 575,485,191 lekë pa TVSH*), që përkon me rreth 55% të fondit total të përllogaritur për furnizimin me barna të të gjithë spitaleve publike në Republikën e Shqipërisë prej 9,359,128,794 lekë pa TVSH, as QSUNT dhe as SUSN nuk rezulton të kenë kthyer përgjigje mbi sa kërkuar informacion lidhur me realizimin e kontratave dhe problematikat e hasura. Nga MSHMS-ja, si institucion epror, nuk është marrë asnjë masë vijuese për sigurimin e të dhënave të nevojshme për të identifikuar problematikat e hasura të zbatimin e kontratave me objekt furnizimin me barna në QSUNT dhe SUSN.

2. Përgjigje mbi kërkesën për informacion të MSHMS-së nuk rezulton të kenë kthyer as 8 spitale/ AK përfituese të tjera, përfshirë Spitalin Rajonal Fier dhe Shkodër, si dhe spitale të tjera më të vogla, me vlerë totale të fondit limit të përllogaritur prej 826,191,034 lekë pa TVSH, që përkon me 9% të vlerës totale të përllogaritur për furnizimin me barna të të gjithë spitaleve publike në RSH.

3. Në 4 nga përgjigjet e kthyera nga spitalet publike janë raportuar problematika lidhur me zbatimin e kontratave, si më poshtë:

- Nëpërmjet shkresës administruar në MSHMS me nr. 3098/1 prot., datë 15.07.2024, Drejtori i Përgjithshëm i *Spitalit Universitar të Traumës* ka përcjellë relacionin nr. 2583/2 prot., datë 12.07.2024 të hartuar nga grupi i punës për monitorimin dhe zbatimin e MK pranë SUT, ku citohet se "*Përgjatë zbatimit të minikontratave është mbajtur penalitet për çdo vonesë në furnizimin me barna. Rezulton se në 8 raste janë mbajtur penalitete pasi furnizimi është kryer me vonesë*".
- Nëpërmjet shkresës administruar në MSHMS me nr. 3098/3 prot., datë 15.07.2024, Drejtori i Përgjithshëm i *Qendrës Spitalore Rajonale Berat* ka bërë me dije se "*Në lidhje me problematikat, institucioni ynë ka aplikuar penalitet vetëm për kontratën nr. 3251 prot., datë 20.07.2024 me afat 4 mujor me objekt: B2 Lot 90 – Sodium Chloride, lidhur me BOE "T." & "F." & "E. F" & "R. F.". OE "F. F" kaloi afatin për pjesën përkatëse të mallit. Bazuar në 2 faturat e fiskalizimit të*

ngarkuara nga OE rezultoi që një faturë malli është dorëzuar dy ditë jashtë afatit dhe fatura tjetër 6 ditë jashtë afatit".

- Nëpërmjet shkresës administruar në MSHMS me nr. 3098/25 prot., datë 18.07.2024, zv. Drejtori Ekonomik dhe Administrativ i *Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë"* ka bërë me dije se "*ju informojmë se për kontratat e mëposhtme lëvrimi i mallit në institucion është bërë me vonesë: (i) nr. 340/4 prot., datë 30.05.2022, lidhur me OE "D. Ph.", (ii) nr. 51/7 prot., datë 20.02.2023, lidhur me OE "M.", (iii) nr. 117/7 prot., datë 16.02.2023, lidhur me OE "C. Ph.", (iv) nr. 56/7 prot., datë 28.02.2023, lidhur me OE "P. Ph.", (v) nr. 453/7 prot., datë 25.06.2024, lidhur me OE "P. P.". Për kontratat e listuara, institucioni ka mbajtur penalitete konform kontratës dhe në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik... Është konfiskuar sigurimi i kontratës dhe institucioni i është drejtuar për të kaluar vlerën e sigurimit nga ana e shoqërisë së sigurimit... Problematika të konstatuara shfaqen te rastet e BOE-ve, sepse ka vonesa në sjelljen e kontratave dhe zbatimi krijon konfuzion, pasi secili përfaqësues sjell sasinë e ndarë. Në shumë raste gjykohet e arsyeshme që vonesa të tilla shkaktojnë humbje kohe*".

- Nëpërmjet shkresës administruar në MSHMS me nr. 3098/30 prot., datë 19.07.2024, Drejtori i *Spitalit Rajonal Durrës* bën me dije se "*problematika që kemi hasur dhe aktualisht vijon të jetë problem është për medikamentin antitumoral Paclitaxel 100mg/16.7ml, aktualisht kemi gjendje 8 flakon, ndërkohë që është çuar kërkesë për t'u lidhur kontrata nr. 878 prot., datë 11.06.2024, por ende nuk është sjellë kontrata nga OE. Kemi mungesë të medikamentit Irinotecan 20mg/5ml, pasi është ezauruar e gjithë sasia e MK. Për medikamentin Carboplatin 150mg/15ml i cili është mungesë, pacientëve u është alternuar medikamenti Cisplatin sipas rekomandimit të mjekut*".

Për gjithë sa më sipër, procedura e ndjekur nga MSHMS-ja për mbikqyrjen e veprimtarisë së institucioneve spitalore të varësisë lidhur me zbatimin e kontratave për furnizim me barna rezulton të jetë joefektive, kjo pasi:

1. 10 nga 44 spitale/ AK përfituese nuk rezulton të kenë raportuar (*përfshirë këtu QSUNT dhe SUSN që janë 2 nga spitalet kryesore në vend*) që përbëjnë rreth 64% të vlerës totale të fondit limit të përllogaritur për furnizim me barna në Republikën e Shqipërisë, duke mos marrë reagim (*feedback*) lidhur me ecurinë dhe problematikat e hasura në zbatimin e këtyre kontratave;

2. Në 4 raste ku janë raportuar problematika për zbatimin e kontratave, MSHMS-ja nuk rezulton të ketë ndërmarrë asnjë hap të mëtejshëm lidhur me verifikimin e shkaqeve që kanë sjellë këto vonesa dhe/ ose parregullsi në zbatimin e kontratave, apo të ketë kërkuar informacion plotësues nëse këto problematika janë referuar ose jo në APP, madje në rastin e SUT-së, nuk ka kërkuar as informacion të mëtejshëm se në cilat lot-e janë hasur problematikat dhe cilët OE i kanë shkaktuar. Pavarësisht rëndësisë thelbësore që ky proces ka mbi garantimin e përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe detyrave funksionale të MSHMS-së në ofrimin e kujdesit shëndetësor nëpërmjet spitaleve publike, Drejtoria e Auditit të Brendshëm pranë MSHMS-së nuk rezulton të ketë planifikuar dhe/ ose kryer angazhime auditimi, për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e menaxhimit të riskut, kontrollit dhe hallkave të procesit, me qëllim që t'i ofrojë ministrit përgjegjës për shëndetësinë informacion lidhur me efikasitetin dhe përputhshmërinë e veprimtarisë së institucioneve spitalore të varësisë në zbatimin e kontratave për furnizim me barna.

3. Të tjera lidhur me udhëzimin e autoriteteve kontraktore të varësisë, për monitorimin e zbatimit të kontratave

Neni 67, pika 3, i RPP-së, përcakton se në rastin kur ministritë mund të përdorin blerjen e përqendruar, ato nxjerrin udhëzimet e duhura për autoritetet kontraktore të varësisë. Nga auditimi

nuk rezulton që MSHMS të ketë nxjerrë udhëzime për AK të varësisë, lidhur me zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të kontratave të lidhura për furnizimin me barna.
Sipas përcaktimit në nenin 124, pika 2 dhe 3, të LPP-së, si dhe në Udhëzimin e APP-së nr. 8, datë 01.09.2021, *plani i zbatimit të kontratës* përfshin çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës dhe ka si qëllim sigurimin e zbatimit të kontratës në përputhje me kushtet e saj dhe kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit, si dhe administrimin e gjithë dokumentacionit që dëshmon se kontrata është përmbushur me sukses dhe është monitoruar gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj.
Me ndryshimet e RPP-së nëpërmjet VKM-së nr. 498, datë 01.08.2024, *detyrimi* për monitorimin e kontratës sipas një plani zbatimi të kontratës u përcaktua për kontratat që kanë kohëzgjatje *jo më pak se 6 muaj*, pavarësisht se *nuk ndalon* aplikimin e planit të zbatimit të kontratave edhe për kontratat me afate më të shkurtra. MSHMS-ja orienton autoritetet kontraktore të lidhin minikontrata bazuar në nevojat e tyre, në zbatim të marrëveshjeve kuadër, pa përcaktuar kohëzgjatjen e këtyre minikontratave. Në Shtojcën 6 të DST orientohen afatet e lëvrimit, që kanë një shpërndarje orientuese në fasha 4-mujore, me përjashtim të QSUT-së, për të cilën citohet se "*do të lidhë kontratat në bazë të nevojave të saj*".
Sa më sipër, nisur nga kompleksiteti dhe domosdoshmëria e kryerjes së verifikimeve të nevojshme për artikujt e furnizuar (specifikat lidhur me datën e prodhimit, datën e skadencës, mbajtësin e autorizimit për tregtim, vendin e origjinës së barnave, afatet e lëvrimit, etj.) lidhja e kontratave nga ana e AK-ve, pa një udhëzim të qartë nga MSHMS mbi nevojën e hartimit të planit zbatimit të kontratës dhe mbi zbatimin e detyrimeve të tjera që rrjedhin nga neni 107 i RPP-së, *edhe në rastet e lidhjes së kontratave nën kohëzgjatjen e përcaktuar*, riskon aplikimin e monitorimit të duhur dhe të përshtatshëm të zbatimit të kontratave nga ana e autoriteteve kontraktore të varësisë. Kjo mungesë mund të shkaktojë mangësi në ndjekjen e zbatimit të kontratës, që nga ana e tyre mund të sjellin mospërputhje me kushtet e saj, me dokumentet e tenderit, me ofertat fituese dhe legjislacionin në fuqi.

4. Mbi zbatimin e kontratave për furnizim me barna të institucioneve spitalore të varësisë së MSHMS-së, në zbatim të MK-ve të vitit 2024

Në mungesë të udhëzimeve nga MSHMS-ja për AK institucionet spitalore të varësisë, lidhur me zbatimin e kontratave të furnizimit me barna, sipas përcaktimit në nenin 67, pika 3, të RPP-së, grupi i auditimit ka evidentuar riskun e ndryshimit në qasje të institucioneve spitalore të varësisë në kuadër të lidhjes së minikontratave për furnizim me barna dhe monitorimit të tyre në cilësinë e AK-ve, për plotësimin e kushteve të përcaktuara në DST, marrëveshje kuadër, kontrata, si dhe në ofertat e pranuara nga operatorët ekonomikë respektivë.
Nisur nga sa më sipër, grupi i auditimit ka kërkuar vënien në dispozicion të praktikave të ndjekura nga 3 institucione spitalore të varësisë (përkatësisht Shërbimi Spitalor Kukës, Qendra Spitalore Rajonale Berat dhe Shërbimi Spitalor Përmet), që nga lidhja e minikontratave (në zbatim të MK-ve të vitit 2024) dhe deri te marrja në dorëzim. Qëllimi i administrimit të këtij dokumentacioni nga grupi i auditimit ishte krahasimi i procedurave të ndjekura nga 3 institucione spitalore varësie të ndryshme, në mungesë të udhëzimeve unifikuese nga MSHMS-ja. Nga ana e institucioneve spitalore të varësisë janë vënë në dispozicion praktikat, si më poshtë:

Për Shërbimin Spitalor Kukës

Nëpërmjet Urdhrit të Drejtorit të SHS Kukës nr. 06/1, datë 03.01.2024, është ngritur Komisioni i pritjes së mallit në magazinat e spitalit, për pritjen e mallit në farmaci (barna dhe materiale

mjekimi). Nëpërmjet Urdhrit të Drejtorit të SHS Kukës nr. 19, datë 05.01.2024, janë caktuar personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratave për furnizim me barna.
Nga ana e SHS Kukës janë vënë në dispozicion praktikat e furnizimit me barna, bazuar në kontratat e lidhura në zbatim të MK-ve të vitit 2024, si më poshtë:

Nr.	Kontrata (nr. datë)	OE	Bar-i	Vlera totale (pa TVSH)	Afati i kontratës
1	Nr. 75, datë 29.08.2024	M.	1.Glyceryl trinitrate 2.Metamizole sodium	144,780	4 muaj
2	Nr. 88, datë 07.10.2024	I.	Diclofenac sodium	41,600	4 muaj
3	Nr. 97, datë 18.11.2024	E.	Enoxaparine sodium	243,000	4 muaj
4	Nr. 105, datë 03.12.2024	A. Ph	1.Silver Sulphadiazine 2. Hyoscine butylbromide	64,620	4 muaj

Nga auditimi u konstatua se kontratat e lidhura *nuk janë në përputhje me Shtojcën 14 dhe 15 të DST-së*, ku është përcaktuar formati tip i kushteve të përgjithshme dhe kushteve të veçanta të kontratës, për furnizim me barna. Në të 4 kontratat e lidhura, në pikën 2.2 përcaktohet se "*Kontraktuesi është i detyruar të fillojë lëvrimin menjëherë me nënshkrimin e kontratës*". Pavarësisht sa më sipër, AK SHS Kukës nuk ka parashikuar grafikun e lëvrimit për barnat, në mospërputhje me nenin 40 të RPP-së, duke mbajtur në konsideratë vetëm afatin 4-mujor të kontratës. Në mungesë të përcaktimit të grafikut të lëvrimit, pavarësisht se kërkohet që lëvrimi të fillojë menjëherë me nënshkrimin e kontratës, në një rast ku OE e kryen furnizimin ditën e fundit të përfundimit të afatit 4-mujor të zbatimit të kontratës, pavarësisht mungesave që mund të jenë krijuar, do të ishte e pamundur të kryhej rast pas rasti përllogaritja dhe aplikimi i penaliteteve sipas përcaktimit në kontratë, si masa shtrënguese për të shtyrë operatorin të kryejë furnizimet pa krijuar mungesa të barnave.
Në pikën 2.1 të kontratave, AK SHS Kukës përcakton se "*Kjo kontratë ka afat 4-mujor* ***dhe do të pasohet nga 1 kontratë tjetër me të njëjtin afat****, deri në përfundim të MK prej 24 muajsh*". Kjo dispozitë është në kundërshtim me vetë frymën e MK, ku sasitë për AK janë orientuese dhe furnizohen në bazë të nevojës, ndaj është e panevojshme që AK t'i shtojë vetes detyrimin për lidhjen e një kontrate tjetër, në një kohë që OE është i detyruar të përgjigjet pas ftesës për ofertë në momentin që kërkohet nga AK, angazhim ky i marrë nga OE me lidhjen e MK ndërmjet MSHMS-së dhe OE.
Në PV e marrjes në dorëzim, të hartuara nga Komisioni i posaçëm i ngritur me Urdhrin e Drejtorit të SHS Kukës, konstatohet se Komisioni përcakton vetëm disa të dhëna të nevojshme për barnat e marra në dorëzim, si emërtimi i barit (ku plotësohet emërtimi dhe formë-doza e bar-it), njësia, sasia, seria (lot) dhe skadenca. Në këto PV nuk përcaktohen të dhënat, si më poshtë:
1. Firma prodhuese (MAH) dhe vendi i origjinës – Këto të dhëna janë të rëndësishme, për të dokumentuar verifikimin e kryer nga AK, nëse barnat e furnizuara janë në përputhje me ofertën e pranuar, sa i përket MAH dhe vendit të origjinës.
2. Data e prodhimit – Kjo e dhënë është e rëndësishme në rastet kur afati i skadencës është më i vogël se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit, për të dokumentuar verifikimin e kryer nga AK, nëse barnat e furnizuara janë në përputhje me kushtet e DST dhe të kontratës, ku përcaktohet se për barna me afat skadence më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit, data e skadencës duhet të jetë jo më pak se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

Për Qendrën Spitalore Rajonale Berat
Nëpërmjet Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të QSR Berat nr. 7, datë 06.01.2025, është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim për barna. Nga ana e QSR Berat janë vënë në dispozicion praktikat e furnizimit me barna, bazuar në kontratat e lidhura në zbatim të MK-ve të vitit 2024, si më poshtë:

Nr.	Kontrata (nr. datë)	OE	Bar-i	Vlera totale (pa TVSH)	Afati i kontratës
1	1930 prot., 08.04.2025	BOE "M.", "E.", "T.", "F.", "R. F."	Sodium chloride	2,781,250	Nuk përcaktohet
2	1805 prot., 01.04.2025	OE "M."	1.Ceftriaxone 2. Ceftazidime	115,235	6 muaj
3	2007 prot., 10.04.2025	OE "M."	1.Adrenaline 2. Promethazine	18,780	4 muaj
4	1747 prot., 27.03.2025	BOE "I.", "E.", "T."	Dexamethasone	416,080	4 muaj

Nga auditimi u konstatua se kontratat e lidhura *nuk janë në përputhje me Shtojcën 14 dhe 15 të DST-së,* ku është përcaktuar formati tip i kushteve të përgjithshme dhe kushteve të veçanta të kontratës, për furnizim me barna. Në asnjë nga kontratat, AK QSR Berat nuk ka parashikuar grafikun e lëvrimit për barnat, në mospërputhje me nenin 40 të RPP-së. Në kontratën nr. 1930 prot., datë 08.04.2025, AK nuk ka përcaktuar as afat lëvrimi dhe as datën e përfundimit të kontratës, ndërkohë që në nenin 16.4 ka përcaktuar se "*Afati i lëvrimit të mallit objekt i kësaj kontrate do të shtyhet aq kohë sa zgjasin forcat madhore. Secila nga palët ka të drejtë të heqë dorë nga ekzekutimi i mëtejshëm i kësaj kontrate në rastin kur forcat madhore zgjasin më shumë se 100 ditë*". Mungesa e parashikimit të grafikut të lëvrimit, përcaktimit të afateve të lëvrimit dhe/ ose të afatit të përfundimit të kontratës, si dhe përcaktimi në pikën 16.4 të kontratës, heq çdo mekanizëm shtrëngues për OE për realizimin me sukses dhe në kohë të përshtatshme të furnizimit, duke pamundësuar gjithashtu kryerjen e përllogaritjes së penaliteteve të mundshme në rast vonesash, që do të ndikonin në disponibilitetin e bar-it. Në pikën 2.2 të secilës prej 3 kontratave të tjera, përcaktohet se "*Kontraktuesi është i detyruar të fillojë lëvrimin e mallit menjëherë me nënshkrimin e kontratës dhe sipas nevojave të AK-së*". Pavarësisht sa më sipër, AK QSR Berat nuk ka parashikuar grafikun e lëvrimit për barnat, në mospërputhje me nenin 40 të RPP-së, duke mbajtur në konsideratë vetëm afatin 4-mujor ose 6-mujor të kontratës. Në mungesë të përcaktimit të grafikut të lëvrimit, pavarësisht se kërkohet që lëvrimi të fillojë menjëherë me nënshkrimin e kontratës, në një rast ku OE e kryen furnizimin ditën e fundit të përfundimit të afatit 4-mujor të zbatimit të kontratës, pavarësisht mungesave që mund të jenë krijuar, do të ishte e pamundur të kryhej përllogaritja dhe aplikimi i penaliteteve sipas përcaktimit në kontratë, si masa shtrënguese për të shtyrë operatorin të kryejë furnizimet pa krijuar mungesa të barnave.

Në PV e marrjes në dorëzim, të hartuara nga Komisioni i posaçëm, konstatohet se Komisioni përcakton përgjithësisht të dhënat e nevojshme për barnat e marra në dorëzim, si emërtimi i barit, formë-doza, njësia, sasia, seria (lot), skadenca, firma prodhuese dhe vendi i prodhimit. Në këto PV nuk përcaktohet data e prodhimit të bar-it, e cila është e rëndësishme në rastet kur afati i skadencës është më i vogël se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit, për të dokumentuar verifikimin e kryer nga AK, nëse barnat e furnizuara janë në përputhje me kushtet e DST dhe të kontratës, ku përcaktohet se për barna me afat skadence më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit, data e skadencës duhet të jetë jo më pak se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

Në zbatim të kontratës nr. 1930 prot., datë 08.04.2025, Komisioni i marrjes në dorëzim pasqyron se është furnizuar me bar-in klorur natriumi, seria 51SA, me datë skadence 30.11.2027, me çmim për njësi 89 lekë, nga kompania prodhuese Hemofarma, me vend origjine Serbi. Furnizimi për këtë lot është marrë përsipër nga BOE, për 7 barna të ndryshme me të njëjtin princip aktiv dhe formë-dozë, nga 7 MAH të ndryshëm, me çmim/ njësi 89 lekë të ofertuar dhe pranuar, dhe AK QSR Berat është faturuar për dorëzimin pjesor nëpërmjet faturës elektronike nr. 4282/2025, datë 15.04.2025, për sasinë 4,400 njësi, me çmim 89 lekë/ njësi, në vlerë totale 391,600 lekë.

Sipas përcaktimit në nenin 37 të Ligjit nr. 105/2014 "*Për barnat dhe shërbimin farmaceutik*", ***çmimi i barnave në treg është i kontrolluar dhe bazohet mbi çmimet CIF të importit***, të deklaruara nga kompanitë mbajtëse të autorizimit të tregtimit dhe mbi bazën e çmimeve të prodhimit për barnat e prodhuara në vend. ***Kontrolli i çmimit të barnave në treg realizohet përmes***

marzheve të fabrikimit e të tregtimit, që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, përkatësisht nëpërmjet VKM-së nr. 53, datë 05.02.2014 "*Për përcaktimin e marzheve të fabrikimit dhe tregtimit të barnave*".

Nga verifikimi në listën e publikuar të çmimeve CIF për vitin 2025[20] dhe të listës së çmimeve CIF për vitin 2024 të vënë në dispozicion nga MSHMS-ja, bar-i i furnizuar "*Natrii Chloridi Infundibile*", me princip aktiv Sodium Chloride 0.9% - 500ml, me prodhues H. A.D. V., Serbi, ka çmim CIF 0.62 EUR (të pandryshuar në të dyja vitet). Pika 2 e VKM-së nr. 53, datë 05.02.2014 "*Për përcaktimin e marzheve të fabrikimit dhe tregtimit të barnave*" përcakton se ***çmimi maksimal i tregtimit me shumicë të barnave*** *nga importuesit dhe shpërndarësit farmacutikë caktohet duke shtuar deri në 11% mbi çmimin CIF të importit të bar-it*, e konvertuar në lekë sipas kursit mesatar të njoftuar nga BSH, për çdo 6-mujor. Për sa më sipër, për këtë bar, çmimi maksimal i tregtimit me shumicë është (0.62 x 111% =) 0.6882 EUR/ njësi. Grupi i auditimit nuk ka pasur në dispozicion kursin mesatar të dërguar zyrtarisht nga BSH, por nga publikimet në faqen zyrtare të BSH-së[21], rezulton se mesatarja e kursit të këmbimit për 6-mujorin e dytë të vitit 2024 (01.07.2024 – 31.12.2024) është 99.1819 lekë/ 1 EUR, pra konvertimi për çmimin maksimal të lejuar për tregtimin me shumicë të këtij bar-i do të arrinte vlerën e (0.6882 x 99.1819 =) 68.25 lekë/ njësi, dhe jo 89 lekë/ njësi, sa është faturuar, duke tregtuar bar-in mbi çmimin maksimal të lejuar për tregtim me shumicë.

E njëjta situatë për këtë kontratë furnizimi paraqitet edhe për 5 nga 6 barnat e tjera (7 në total për këtë Lot), sa i përket furnizimit me Lot 75 "Sodium Chloride", ku çmimi/ njësi i pranuar për BOE është më i lartë se çmimi maksimal i lejuar për tregtimin me shumicë për një pjesë të këtyre barnave, si më poshtë:

1. Bar-i me emër tregtar "S. Ch./ V.", me princip aktiv Sodium Chloride – 0.9% - 500ml, me MAH V.S.A, Greqi, e ka çmimin CIF (në databazën e çmimeve CIF për vitin 2024) 0.66 EUR. Duke shtuar marzhin e fitimit sipas përcaktimit në VKM (0.66 x 111% =) 0.736 EUR, si dhe duke konvertuar nëpërmjet mesatares së kursit të këmbimit përkatës (0.739 EUR x 99.1819 lekë/ 1 EUR =), çmimi maksimal i lejuar për tregtimin me shumicë të këtij bar-i është 72.66 lekë, pra më i ulët se çmimi prej 89 lekë/njësi. *Në databazën e çmimeve CIF të përditësuar në 12.05.2025, ky bar ka çmimin CIF 0.9 EUR/ njësi*[22].

2. Bar-i me emër tregtar "Ph. K. "F." I.", me princip aktiv Sodium Chloride – 0.9% - 500ml, me MAH F. K. A. GmbH, me vend prodhimi Gjermani, Itali, Poloni, e ka çmimin CIF (në databazën e çmimeve CIF për vitin 2024) 0.72 EUR (*i pandryshuar edhe në databazën e përditësuar në 12.05.2025*[23]). Duke shtuar marzhin e fitimit sipas përcaktimit në VKM (0.72 x 111% =) 0.7992 EUR, si dhe duke konvertuar nëpërmjet mesatares së kursit të këmbimit përkatës (0.7992 EUR x 99.1819 lekë/ 1 EUR=), çmimi maksimal i lejuar për tregtimin me shumicë të këtij bar-i është 79.266 lekë, pra më i ulët se çmimi prej 89 lekë/ njësi.

3. Bar-i me emër tregtar "S. Ch.", me princip aktiv Sodium Chloride – 0.9% - 500ml, me MAH D. S.A. Ph. I., me vend prodhimi Greqi, e ka çmimin CIF (në databazën e çmimeve CIF për vitin 2024) 0.7 EUR (*i pandryshuar edhe në databazën e përditësuar në 12.05.2025*[24]). Duke shtuar marzhin e fitimit sipas përcaktimit në VKM (0.7x111%=) 0.777 EUR, si dhe duke konvertuar nëpërmjet mesatares së kursit të këmbimit përkatës (0.7992 EUR x 99.1819 lekë/ 1 EUR =), çmimi

[20] https://akbpm.gov.al/ëp-content/uploads/2025/05/cmimet-cif-25.pdf nr. rendor 2212
[21] https://ëëë.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/
[22] https://akbpm.gov.al/ëp-content/uploads/2025/05/cmimet-cif-25.pdf nr. rendor 2094
[23] https://akbpm.gov.al/ëp-content/uploads/2025/05/cmimet-cif-25.pdf nr. rendor 3990
[24] https://akbpm.gov.al/ëp-content/uploads/2025/05/cmimet-cif-25.pdf nr. rendor 3851

maksimal i lejuar për tregtimin me shumicë të këtij bar-i është 77.064 lekë, pra më i ulët se çmimi prej 89 lekë/ njësi.

4. Bar-i me emër tregtar "S. C. S.. me princip aktiv Sodium Chloride – 0.9% - 500ml, me MAH S.A.L.F L. F., me vend prodhimi Itali, e ka çmimin CIF (në databazën e çmimeve CIF për vitin 2024) 0.75 EUR. Duke shtuar marzhin e fitimit sipas përcaktimit në VKM (0.75 x 111%=) 0.835 EUR, si dhe duke konvertuar nëpërmjet mesatares së kursit të këmbimit përkatës (0.835 EUR x 99.1819 lekë/ 1 EUR =), çmimi maksimal i lejuar për tregtimin me shumicë të këtij bar-i është 82.568 lekë, pra më i ulët se çmimi prej 89 lekë/ njësi. *Në databazën e çmimeve CIF të përditësuar në 12.05.2025, ky bar ka çmimin CIF 1.304504505 EUR/ njësi*[25].

5. Bar-i me emër tregtar "S. C. M.", me princip aktiv Sodium Chloride – 0.9% - 500ml, me MAH M. S.P.A, me vend prodhimi Itali, e ka çmimin CIF (në databazën e çmimeve CIF për vitin 2024) 0.8 EUR (*i pandryshuar edhe në databazën e përditësuar në 12.05.2025*[26]). Duke shtuar marzhin e fitimit sipas përcaktimit në VKM (0.8 x 111% =) 0.888 EUR, si dhe duke konvertuar nëpërmjet mesatares së kursit të këmbimit përkatës (0.888 EUR x 99.1819 lekë/ 1 EUR=), çmimi maksimal i lejuar për tregtimin me shumicë të këtij bar-i është 88.07 lekë, pra më i ulët se çmimi prej 89 lekë/ njësi.

Bazuar në Marrëveshjen Kuadër nr. 2696/21 prot., datë 12.08.2024, sikurse trajtuar edhe në drejtimin përkatës për auditimin e procedurave të prokurimit, për Lot-in 75 "Sodium Chloride", sasia totale e bar-it të planifikuar/ të kërkuar për furnizimin 24-mujor të të gjithë institucioneve spitalore të varësisë të përfshirë në planifikim është 4,332,991 njësi, me çmim/ njësi 89 lekë (i njëjtë për secilin prej 7 barnave të ofertuar për këtë Lot nga BOE), në vlerën totale limit të përllogaritur prej 385,636,199 lekë. Nga auditimi u konstatua se në DST, në Marrëveshjet Kuadër të lidhura, në kontratat tip pjesë të DST-së, si dhe në minikontratat e vëna në dispozicion nga institucionet spitalore të varësisë, *nuk ka asnjë dispozitë ku pasqyrohet detyrimi i Autoriteteve Kontraktore të varësisë (institucioneve spitalore të varësisë, si njësi shpenzuese) për të verifikuar në çdo rast vlerën e faturuar sipas përcaktimit në MK dhe minikontrata, në raport me çmimin maksimal të lejuar për tregtimin me shumicë të barnave specifike,* në kuadër të kontrollit të çmimit të barnave, sipas përcaktimit në nenin 37 të Ligjit nr. 105/2014, i ndryshuar, si dhe pikën 2 të VKM-së nr. 53, datë 05.02.2014.

Nisur nga fakti që çmimet CIF rishikohen çdo vit, ndërkohë që procedurat e prokurimit për furnizim me barna janë 2-vjeçare, ekziston gjithashtu risku që një bar i caktuar, përgjatë zbatimit të kontratës të pësojë ulje të çmimit CIF, e rrjedhimisht ulje të çmimit maksimal të lejuar për tregtim me shumicë, ndryshim i cili duhet të reflektohet në zbatimin e kontratave, për të qenë në përputhje me pikën 2 të VKM-së nr. 53, datë 05.02.2014, duke mos lejuar tregtimin e barnave mbi çmimin maksimal të lejuar. Sa i përket një situate të anasjelltë, kur çmimi CIF mund të pësojë rritje në vitin pasardhës, kjo situatë është e rregulluar që në fazën e procedurës së prokurimit, ku OE duhet të paraqesë autorizimin e prodhuesit, që garanton vijimin e furnizimit përgjatë shtrirjes së MK-së.

Marrëveshja kuadër për Lot-in 75 "Sodium Chloride" ka një afat 24-mujor, me një vlerë të përgjithshme limit të përllogaritur prej rreth 385,639 mijë lekë, mbi bazën e së cilës parashikohet lidhja e kontratave nga 43 institucione spitalore të varësisë, sipas sasive përkatëse. Grupi i auditimit nuk disponon të dhëna mbi numrin dhe ecurinë e kontratave të lidhura nga këto institucione në zbatim të marrëveshjes kuadër dhe, nga sa rezulton, as MSHMS, si organ qendror blerës, nuk disponon informacion të plotë mbi ecurinë e zbatimit të tyre. Situata është evidentuar

[25] https://akbpm.gov.al/ëp-content/uploads/2025/05/cmimet-cif-25.pdf nr. rendor 3880
[26] https://akbpm.gov.al/ëp-content/uploads/2025/05/cmimet-cif-25.pdf nr. rendor 2069

konkretisht vetëm në një praktikë marrjeje në dorëzim në QSR Berat, ku, bashkëlidhur dokumentacionit, rezultonte edhe fatura e lëshuar nga një prej operatorëve ekonomikë pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë (BOE). Nga verifikimi i kësaj praktike u konstatua se për një bar specifik ishte ofertuar dhe faturuar çmimi fiks prej 89 lekësh, ndonëse ky çmim rezultonte mbi çmimin maksimal të lejuar për atë produkt. Më tej, nga analiza e të njëjtit lot u evidentua se 6 nga 7 barnat e përfshira rezultonin mbi çmimet maksimale të lejuara.
Grupi i auditimit nuk ka administruar urdhër-shpenzime nga QSR Berat apo nga institucionet e tjera spitalore të varësisë, të cilat funksionojnë si njësi shpenzuese më vete dhe aktiviteti ekonomik i tyre nuk ishte objekt auditimi, për të verifikuar nëse pagesat janë kryer realisht me këto çmime. Po ashtu, mungesa e të dhënave mbi aktivitetin financiar të 43 institucioneve spitalore nuk lejon arritjen e një konkluzioni të plotë nëse kemi të bëjmë me shpenzime joefektive apo menaxhim joefektiv të fondeve publike, si dhe, nëse po, pamundëson përcaktimin e vlerës së mundshme të këtij efekti.
Në mungesë të përcaktimeve në DST, në MK dhe në formatin tip të kontratës të miratuar, si dhe në mungesë të udhëzimeve përkatëse për zbatimin e kontratave nga MSHMS-ja, grupi i auditimit vlerëson riskun e përhapjes së këtij fenomeni, në kundërshtim me nenin 37 të Ligjit nr. 105/2014 dhe pikën 2 të VKM-së nr. 53, datë 05.02.2014, qoftë në rastet e furnizimeve nga BOE, ku barna të caktuara mund të kenë çmim maksimal të lejuar për tregtim më të ulët se çmimi/ njësi i ofertuar, pranuar dhe dakordësuar në MK, qoftë në barna që mund të pësojnë ndryshime duke ardhur në ulje të çmimit CIF përgjatë zbatimit të kontratës.

Në mungesë të përcaktimeve në DST, në MK dhe në formatin tip të kontratës të miratuar, si dhe në mungesë të udhëzimeve përkatëse për zbatimin e kontratave nga MSHMS-ja, grupi i auditimit vlerëson riskun e përhapjes së këtij fenomeni, në kundërshtim me nenin 37 të Ligjit nr. 105/2014 dhe pikën 2 të VKM-së nr. 53, datë 05.02.2014, qoftë në rastet e furnizimeve nga BOE, ku barna të caktuara mund të kenë çmim maksimal të lejuar për tregtim më të ulët se çmimi/ njësi i ofertuar, pranuar dhe dakordësuar në MK, qoftë në barna që mund të pësojnë ndryshime duke ardhur në ulje të çmimit CIF përgjatë zbatimit të kontratës.

Për Shërbimin Spitalor Përmet
Nëpërmjet Urdhrit të Drejtorit të SHS Përmet nr. 10, datë 06.01.2025, është ngritur komisioni i verifikimit dhe marrjes në dorëzim të medikamenteve. Nga ana e SHS Përmet janë vënë në dispozicion praktikat e furnizimit me barna, bazuar në kontratat e lidhura në zbatim të MK-ve të vitit 2024, si më poshtë:

Nr.	Kontrata (nr. datë)	OE	Bar-i	Vlera totale (pa TVSH)	Afati i kontratës
1	67/6 prot., 18.04.2025	M.	Ceftriaxone	23,095	4 muaj
2	122/2 prot., 06.05.2025	F. N.	Viper venom antiserum	54,380	4 muaj
3	243/8 prot., 27.09.2024	M.	Human tetanus immunoglobin	403,250	Nuk përcaktohet
4	243/9 prot., 10.10.2024	A.	1.Prednisolone 2. Ascorbic acid vitamine C	542,750	Nuk përcaktohet

Nga auditimi u konstatua se kontratat e lidhura *nuk janë në përputhje me Shtojcën 14 dhe 15 të DST-së,* ku është përcaktuar formati tip i kushteve të përgjithshme dhe kushteve të veçanta të kontratës, për furnizim me barna. Në nenin 3, pika 1, të kontratës nr. 67/6 prot., datë 18.04.2025, përcaktohet se afati i lëvrimi të mallit do të jetë 4 muaj, që fillon në datën e lidhjes së kontratës, dhe 15% e sasisë së barit duhet të lëvrohet brenda 20 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës. Për pjesën e mbetur të sasisë, AK SHS Përmet nuk ka parashikuar grafikun e lëvrimit për barnat, në mospërputhje me nenin 40 të RPP-së, duke mbajtur në konsideratë vetëm afatin 4-mujor të lëvrimit të mallit. Në nenin 3, pika 1, të kontratës nr. 122/2 prot., datë 06.05.2025, është përcaktuar

se afati i lëvrimit do të jetë 4 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, sërish pa hartuar grafik lëvrimi. Sa i përket kontratave nr. 243/8 prot., datë 27.09.2024 dhe nr. 243/9 prot., datë 10.10.2024, pavarësisht se është cituar se 15% e sasisë së barit duhet të lëvrohet brenda 20 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës, AK SHS Përmet nuk ka përcaktuar as afatin e lëvrimit të mallit (sa i takon pjesës së mbetur) dhe as afatin e mbarimit të kontratës. Në kushte të tilla, do të ishte objektivisht i pamundur aplikimi i dispozitës kontraktore ku përcaktohen penalitetet për vonesa në lëvrimin e pjesës së mbetur (85% e sasisë) së barnave, për sa kohë nuk ka të përcaktuar as grafik lëvrimi dhe as afat përfundimi kontrate.
Në PV e marrjes në dorëzim, të hartuara nga Komisioni i posaçëm i ngritur me Urdhrin e Drejtorit të SHS Përmet, konstatohet se Komisioni përcakton përgjithësisht të dhënat e nevojshme për barnat e marra në dorëzim, si emërtimi i barit, formë-doza, njësia, sasia, seria (lot), skadenca, firma prodhuese dhe vendi i prodhimit. Në këto PV nuk përcaktohet data e prodhimit të bar-it, e cila është e rëndësishme në rastet kur afati i skadencës është më i vogël se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit, për të dokumentuar verifikimin e kryer nga AK, nëse barnat e furnizuara janë në përputhje me kushtet e DST dhe të kontratës, ku përcaktohet se për barna me afat skadence më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit, data e skadencës duhet të jetë jo më pak se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

Mbi sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nëpërmjet shkresës nr. 85/2 prot., datë 04.02.2026, administruar në KLSH me nr. 110/27 prot., datë 06.02.2026, subjekti i audituar MSHMS ka paraqitur observacionet, si më poshtë:
Pretendimi i subjektit: **1.** Në procedurat e prokurimit publik për barna, çmimi i ofertuar nga OE nuk përfaqëson thjesht çmimin e njësisë së barit në tregun e hapur, por përfshin një sërë elementësh shtesë që lidhen ngushtësisht me përmbushjen e kontratës, si magazinimi, transporti dhe shpërndarja, menaxhimi i stokut, përgjegjësia për skadencat (kthimi dhe asgjësimi i barnave të papërdorura ose të dëmtuara), vendosja e sistemeve të ndjekjes së gjurmueshmërisë (track & trace) dhe raportimi elektronik i shpërndarjes. Çmimi i tenderit duhet të kuptohet në funksion të parimit të kostos totale të zotërimit, që përfshin kostot e blerjes, ruajtjes, shpërndarjes dhe mbikqyrjes, si dhe çdo detyrim tjetër kontraktual që lidhet me qarkullimin, gjurmueshmërinë dhe asgjësimin e barit.
2. Parimi i pandryshueshmërisë së çmimit të ofertës – Në pikën 7 të nenit 24 të RPP-së parashikohet se ofertat ekonomike të dhëna nga ofertuesi duhet të jenë të fiksuara përgjatë ekzekutimit të kontratës dhe nuk duhet t'i nënshtrohen asnjë ndryshimi. Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës ndonjë ligj apo akt nënligjor në RSH hyn në fuqi dhe ndryshon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, këto do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës. Oferta e paraqitur me çmim të ndryshueshëm do të refuzohet nga AK-ja si e papranueshme. Nga interpretimi literal i kësaj pike arrihet në përfundimin logjik se çmimi i ofertës duhet të mbetet i pandryshuar nga dita e dorëzimit të ofertës deri në fund të MK dhe nuk lejohet asnjë lloj modifikimi (as për rritje, as për ulje) për sa kohë nuk ka bazë ligjore (specifikisht ligj ose akt nënligjor).
3. Miratimi i çmimeve të barnave nga KÇB nuk përbën ndryshim ligjor të natyrës që lejon ndryshim çmimi në kontratë. Vendimet e KÇB janë akte administrative individuale, të cilat miratojnë ose rishikojnë çmimin tavan me shumicë ose pakicë të një produkti konkret, vlejnë për të gjithë tregun farmaceutik, nuk janë ligje apo akte nënligjore me karakter normativ. Ndryshimi i çmimit të miratuar nga KÇB nuk ndikon detyrimisht në kostot reale të përmbushjes së kontratës,

pasi çmimi i ofruar nga OE në një procedurë prokurimi është i pavarur nga çmimi tavan i barnave me shumicë/ pakicë të miratuar nga KÇB dhe OE në momentin e ofertimit është i detyruar të parashikojë çdo ndryshim të mundshëm të tregut dhe të ofrojë një çmim fiks dhe të garantuar për kohëzgjatjen e kontratës. Në pikën 1 të nenit 65 të RPP-së përcaktohet se OE-të janë të detyruar të zbatojnë kontratën sipas cilësisë dhe çmimit të ofertuar, në kohën e kërkuar prej AK-ve. Ky formulim vendos një detyrim të qartë dhe të pacënueshëm për OE që të respektojë cilësinë, çmimin dhe afatet e vendosura. Neni 65, pika 1 ndalon çdo klauzolë që do të lejonte OE të ndryshonte çmimin e ofertuar gjatë periudhës së kontratës.

4. Neni 36 i Ligjit "Për barnat" parashikon që barnat nuk mund të shiten me çmim më të lartë se çmimi CIF i miratuar. Ky nen zbatohet për tregun e lirë (shumicë/ pakicë), jo për marrëdhëniet kontraktore të prokurimit publik, të cilat zhvillohen sipas LPP. Në interpretimin e normave ligjore, duhet respektuar hierarkia dhe autonomia e legjislacionit të posaçëm LPP, që rregullon marrëdhëniet kontraktore shtet – operator ekonomik, ndaj çdo ndërhyrje nga norma të tjera duhet të jetë shprehimisht e autorizuar nga ky ligj ose nga ligji tjetër sektorial nëpërmjet normës deleguese.

5. Mungesa e kompetencës së Drejtorisë së Prokurimeve për monitorim të çmimeve ose marrëveshjes kuadër – Monitorimi i çmimeve në treg, përfshirë çmimet CIF të miratuara, është funksion i organeve përkatëse të kontrollit dhe inspektimit farmaceutik, si MSHMS dhe institucionet e varësisë (AKBPM). Po ashtu, monitorimi i zbatimit të MK-ve, përfshirë respektimin e çmimeve gjatë ekzekutimit, është kompetencë e strukturave të kontrollit të brendshëm të ministrisë apo njësive zbatuese, jo e Drejtorisë së Prokurimeve.

6. Për analogji, edhe pse është e ndaluar me ligj tregtimi i barnave të skaduara, kjo nuk përkthehet në kërkesë për të paraqitur analiza laboratorike në fazën e ofertimit, pasi kontrolli përkatës realizohet në fazën e zbatimit të kontratës. E njëjta logjikë vlen edhe për çmimet e miratuara në treg, respektimi i tyre është detyrim për OE pas lidhjes së kontratës, jo kriter kufizues gjatë fazës së tenderimit.

7. Ky kriter është zbatuar në mënyrë të vazhdueshme nga MSHMS në procedura të mëparshme. APP-ja nuk e ka kundërshtuar këtë kriter në procedurat e mbikëqyrura apo të miratuara më parë, si dhe grupet e mëparshme të auditimit të KLSH-së nuk kanë ngritur vërejtje për këtë kriter në raste të ngjashme. Kjo tregon se praktika e vendosjes së këtij kriteri është e qëndrueshme dhe e njohur, dhe nuk përbën risi apo shmangie nga rregullat e prokurimit publik.

8. Ligji nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" përbën ligj të posaçëm (lex specialis) që rregullon në mënyrë shteruese procedurat e prokurimit publik. Në zbatim të parimit lex specialis derogat legi generali, gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, autoriteti kontraktor dhe Njësia e Prokurimit janë të detyruara të zbatojnë ekskluzivisht LPP-në dhe aktet nënligjore të tij. Njësia e Prokurimit nuk ka kompetencë ligjore për të bërë interpretime juridike mbi raportin e prevalencës ndërmjet LPP-së dhe ligjeve të tjera sektoriale, përfshirë legjislacionin farmaceutik. Njësia e Prokurimit është strukturë administrative dhe zbatuese, jo organ interpretues i ligjit. Ajo nuk ka kompetencë të vlerësojë se cili ligj prevalon apo të inkorporojë norma të ligjeve të tjera jashtë LPP-së në DST. Çdo interpretim mbi ndërveprimin e LPP-së me ligjin e barnave, si dhe çdo vendosje rregullash shtesë për çmimin CIF, tejkalon kompetencat e Njësisë së Prokurimit dhe do të përbënte shkelje të parimit të ligjshmërisë. Njësia e Prokurimit zbaton vetëm rregullat procedurale të parashikuara në LPP dhe VKM Nr. 285/2021, pa diskrecion për të shtuar kushte apo norma ligjore të tjera. Detyrimi për respektimin e çmimit CIF buron drejtpërdrejt nga ligji. Respektimi i çmimit CIF është detyrim ligjor që zbatohet ex lege për të gjithë operatorët ekonomikë. Ky detyrim nuk krijohet dhe as nuk kushtëzohet nga përfshirja e tij në DST. Mungesa

e citimit të një ligji të posaçëm në dokumentacionin e prokurimit nuk përbën shkelje dhe nuk cenon zbatueshmërinë e tij. DST nuk ka funksion të riprodhojë legjislacionin sektorial. Dokumentet e tenderit kanë për objekt rregullimin e procedurës së garës dhe kushteve kontraktore, jo pasqyrimin e plotë të gjithë legjislacionit në fuqi. Respektimi i ligjeve sektoriale mbetet detyrim i pavarur i operatorëve ekonomikë. Njësia e Prokurimit nuk ka kompetencë ligjore për të verifikuar ose kontrolluar çmimet CIF te barnave. Ky funksion i përket strukturave kompetente dhe realizohet gjatë fazës së zbatimit të kontratës, jo gjatë prokurimit. Edhe sikur ligji i barnave të ishte cituar shprehimisht në DST, kjo nuk do të ndryshonte detyrimet ligjore të operatorëve ekonomikë dhe as mekanizmat e kontrollit, të cilët janë të pavarur nga dokumentacioni i prokurimit.
9. Në rast se nga KLSH konstatohet nevoja për harmonizim më të detajuar ndërmjet procedurave të prokurimit publik dhe legjislacionit farmaceutik, kjo kompetencë i përket:
- Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS);
- Agjencisë së Prokurimit Publik (APP).
Këto institucione, në bashkëpunim, mund të nxjerrin akte administrative rregulluese, udhëzime ose modele standarde DST, përfshirë kontratash, të cilat do të ishin detyruese për autoritetet kontraktore për çështjen konkrete. Deri në nxjerrjen e akteve të tilla, Njësia e Prokurimit nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për mungesë rregullimi që nuk varet nga kompetenca e saj.

Qëndrimi i grupit të auditimit:
1. Fillimisht, pavarësisht se në observacion MSHMS-ja citon se "çmimi i ofertuar për barnat në një tender publik nuk është dhe nuk duhet të krahasohet me çmimin e zakonshëm të tregut të lirë, pasi përfshin një sërë detyrimesh të natyrës logjistike, teknike dhe operacionale", MSHMS-ja përllogarit fondin limit për secilin bar *bazuar vetëm në shumatoren e çmimit CIF të përcaktuar dhe marzhit të fitimit 11%, të konvertuar në valutë vendase sipas kursit të Bankës së Shqipërisë*, duke marrë të mirëqenë që barnat nuk mund të tregtohen me shumicë mbi çmimin maksimal të lejuar për tregtim, pra pa përfshirë përbërësit e tjerë të çmimit që citon lidhur me çështjet logjistike. Sa i përket kthimit dhe asgjësimit të barnave të papërdorura ose të dëmtuara, kjo nuk përcaktohet as në DST, as në MK, as në formatet tip të kontratave dhe as në kontratat që janë vënë në dispozicion grupit të auditimit nga 3 institucionet spitalore të varësisë. Sa i përket sistemit të ndjekjes së gjurmueshmërisë track & trace, ky nuk është një sistem i aplikuar në qarkullimin e barnave në shërbimin shëndetësor publik, rrjedhimisht nuk bën sens të përllogaritet në kosto.
2 – 4. Sipas përcaktimeve në nenet 659 dhe 660 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike, ndërkohë që palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, **brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi**. Çmimi maksimal i lejuar për tregtimin me shumicë të barnave është një kufizim që ligjvënësi ka çmuar të nevojshëm të përcaktojë, me qëllim kontrollin e çmimit të barnave në treg. **Në asnjë pikë të Ligjit nr. 105/2014 "*Për barnat dhe shërbimin farmaceutik*" nuk përjashtohet tregtimi me shumicë në sektorin publik, përkundrazi, që në nenin 1 të këtij ligji përcaktohet në mënyrë eksplicite se ky ligj përcakton rregullat për prodhimin, vendosjen në treg, importin, eksportin, tregtimin, farmakovigjilencën, publicitetin, kontrollin e cilësisë dhe inspektimin e veprimtarive që lidhen me barnat për përdorim njerëzor në RSH, me qëllim garantimin e shëndetit publik. Në nenin 2, pika 2, përcaktohen përjashtimet e zbatimit të këtij Ligji, ku në asnjë rast nuk përmenden kontratat e tregtimit me shumicë të përftuara nga procedurat e prokurimit publik**. Dispozitat që MSHMS-ja i referohet, janë dispozita që mbrojnë palën publike nga rritjet e çmimeve të kontraktuara nga ana e OE-ve. Në këtë rast, KLSH evidenton detyrimin për t'iu

përmbajtur detyrimeve të një akti ligjor në fushëveprimin e MSHMS-së, sikurse është Ligji "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", **ku ligjvënësi qartësisht ka ngritur një sistem për kontrollin e çmimit të barnave**.

5 – 6. Konstatimi i grupit të auditimit të KLSH-së nuk lidhet me rolin e Drejtorisë së Prokurimeve, por me rolin e MSHMS-në në këtë proces. Sa i përket procedurës së prokurimit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, sipas parashikimeve ligjore, ka kualifikuar ofertën duke çmuar se dokumentacioni është i rregullt dhe oferta ekonomike është më e ulët se fondi limit. Problematika e ngritur nga KLSH-ja nuk lidhet me procedurën e prokurimit në vetvete, por me risqet në zbatimin e saj, kjo pasi çmimi i fiksuar është më i lartë se çmimi maksimal i lejuar për tregtim me shumicë për disa nga barnat në këtë procedurë. KLSH në asnjë rast nuk shprehet se KVO duhej të kishte skualifikuar OE. Konstatimi i grupit të auditimit konsiston në faktin që, për të garantuar zbatimin e plotë të kuadrit ligjor relevant gjatë zbatimit të kontratave, në DST, MK, si dhe në udhëzimet përkatëse drejtuar institucioneve spitalore të varësisë, duhej të ishte parashikuar qartësisht se, pavarësisht çmimit të dakordësuar, barnat kanë një çmim maksimal të lejuar për tregtim me shumicë, i cili është detyrim ligjor i sanksionuar në Ligjin "Për barnat", ku një institucion varësie i MSHMS-së (AKBPM) ka përgjegjësinë të kryejë inspektime dhe të marrë masat përkatëse. Sa i përket monitorimit të zbatimit të kontratave të lidhura bazuar në MK, grupi i auditimit i referohet mbikqyrjes nga MSHMS-ja të aktivitetit të institucioneve spitalore të varësisë lidhur me zbatimin e kontratave, dhe jo monitorimit të kontratave, që sikurse cilësuar është përgjegjësi e vetë AK-ve përfituese (institucioneve spitalore të varësisë). Sikurse cituar edhe nga ju në observacion, bazuar edhe në Ligjin "*Për administratën shtetërore*", mbikqyrja e aktivitetit të institucioneve spitalore të varësisë është përgjegjësi e MSHMS-së, ku mund të përfshihet edhe struktura e auditit të brendshëm, për angazhimin e auditimeve me këtë fokus.

7. Ligji "*Për barnat dhe shërbimet farmaceutike*" bën pjesë në fushëveprimin e MSHMS-së, sikundër detyrimi për kontrollin e çmimit maksimal të lejuar për tregtimin e barnave buron nga përcaktimet në këtë ligj, dhe jo nga detyrimet e përcaktuara në Ligjin "Për prokurimet publike", për të cilat APP-ja angazhohet vazhdimisht në konsulencë, udhëzime dhe rekomandime. Angazhimi i juristëve dhe specialistëve të fushës në njësinë e prokurimit nga ana e MSHMS-së dhe/ ose strukturat e tjera të MSHMS-së duhet të ishin të mjaftueshme për njohjen e plotë të kuadrit ligjor që rregullon tregtimin e barnave në RSH dhe garantimin e respektimit të të gjitha detyrimeve që rrjedhin prej tij.

8. Ligji nr. 162/2020 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij rregullojnë procedurën e prokurimit publik, por jo regjimin material të objektit të kontratës. Nga ana tjetër, Ligji nr. 105/2014 rregullon vendosjen në treg dhe tregtimin e barnave, përfshirë kufizimin e çmimit maksimal të tregtimit me shumicë. Në asnjë rast nuk është kërkuar nga njësia e prokurimit të bëjë interpretim të prevalencës ndërmjet ligjit, por respektimi i kuadrit ligjor në fuqi në tërësinë e tij. Sikurse citoni dhe ju, kufizimi i çmimit maksimal të tregtimit me shumicë të barnave zbatohet drejtpërdrejt nga ligji, pikërisht për këtë arsye dokumentet e tenderit dhe marrëveshjet kuadër të lidhura nuk mund të krijojnë një situatë që bie ndesh me këtë kufizim, pa asnjë përcaktim ku të përmendet çmimi maksimal i lejuar për tregtimin me shumicë të barnave. Kontrata publike parimisht nuk duhet të legjitimojë çmime që tejkalojnë një kufi të përcaktuar nga ligji sektorial. Zbatimi ex lege nuk e përjashton nevojën që autoriteti kontraktor të parandalojë riskun e mospërputhjeve në fazën e zbatimit të kontratës. Grupi i auditimit nuk ka kërkuar riprodhimin e plotë të legjislacionit sektorial, por kur ekziston një kufizim material që ndikon drejtpërdrejt në çmimin e objektit të kontratës, mosparashikimi i tij në dokumentacion krijon risk në zbatim.

9. Një nga qëllimet kryesore të ligjit "Për prokurimin publik" është të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike, nga ana tjetër, Ligji nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik" përcakton MSHMS-në dhe institucionet e varësisë (AKBPM) si përgjegjëse për të garantuar zbatimin e dispozitave të këtij ligji, ku ndër të tjera përcaktohet kontrolli për çmimin e tregtimit të barnave duke mos lejuar tregtimin e tyre me shumicë mbi një çmim maksimal. **Në aspektin sistemik, nuk është e logjikshme që vetë MSHMS-ja të ketë për detyrë të mbikqyrë zbatimin e një detyrimi ligjor që ndalon tregtimin me shumicë të barnave mbi një çmim maksimal të lejuar për të gjithë subjektet tregtare në Republikën e Shqipërisë, dhe nga ana tjetër të lejojë dhe të vijojë të argumentojë që vetë ai si blerës publik të kontraktojë mbi atë kufi, pa asnjë përcaktim për të orientuar as për operatorin ekonomik dhe as për institucionet spitalore të varësisë që do të zbatojnë kontratën**. Në observacionin tuaj citohet "*kjo kompetencë i përket MSHMS-së...*", ndërkohë që edhe konstatimi dhe rekomandimi përkatës i adresohet pikërisht MSHMS-së. Njësia e prokurimit ka për detyrë të përcaktojë çdo informacion specifik të nevojshëm për objektin e prokurimit, sikurse është edhe kufiri maksimal i lejuar për tregtimin me shumicë të barnave, për objektin në fjalë.
Për sa më sipër, observacioni nuk merret parasysh.

Procedurat e prokurimit për blerjen e pajisjeve mjekësore
Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga MSHMS-ja ka rezultuar se:

I. Procedura e prokurimit "*E hapur*" me objekt "*F.V. pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore*", me afat 35 ditë nga nënshkrimi i kontratës, nr. REF-64820-04-04-2023, me fond limit 14,750,000 lekë pa TVSH

<table>
<tr><td colspan="3">Procedura e prokurimit "F.V. pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore"</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 179 prot., 29.03.2023</td><td rowspan="2">3. Përllogaritja e fondit limit dhe specif. Teknike
Urdhër nr. 155 prot., datë 16.03.2023
- F. S.
- E. R
- R. .M

Njësia e Prokurimit
Urdhër nr. 179 prot., 29.03.2023
- A. A
- E. L.
- L. .P</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
Urdhër nr. 179/1., 29.03.2023, i ndryshuar me nr. 179/2, 13.04.2023
- K. Z.
- D. N.
- A. Q.</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit
"E hapur"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSH)

14,750,000 lekë</td><td>6. Oferta fituese (pa TVSH)

13,249,450 lekë</td><td>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)

1,500,550 lekë (10%)</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit
06.04.2023</td><td>9. Burimi i financimit
Buxheti i Shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender: 4 OE
b) Skualifikuar: 2 OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime
AK: -
KPP: -</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>12. Lidhja e kontratës (MK)
Nr. 1441/9 prot., 20.07.2023</td><td>13. Vlera e kontratës
15,899,340 lekë me TVSH</td><td>14. Afati i kontratës në ditë
35 ditë</td></tr>
</table>

Nëpërmjet Urdhrit nr. 155, datë 16.03.2023, Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS J. D. ka ngritur grupin e punës për përcaktimin e specifikimeve teknike, sasive, afatet e lëvrimit, si dhe shpërndarjen për objektin "F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore", të përbërë nga F. S., E. R (specialist fushe), R. M.. Ky komision ka dërguar

relacionin nr. 1291/1 prot., datë 21.03.2023, ku është kryer përllogaritja e fondit limit bazuar në çmimet e kontratave të mëparshme, përkatësisht kontrata e realizuar në vitin paraardhës (2022) me të njëjtin objekt, në vlerën prej 2,950,000 lekë pa TVSH/njësi, për 5 njësi, në vlerë totale prej 14,750,000 lekë pa TVSH. Në këtë relacion janë përcaktuar gjithashtu (i) specifikimet teknike të pajisjeve dhe stacionit kompjuterik pjesë të pajisjes, si dhe (ii) shpërndarja e pajisjeve, përkatësisht për Spitalet Rajonale Berat, Dibër, Elbasan, Gjirokastër dhe Kukës. Anëtarët e komisionit nuk rezulton të kenë nënshkruar Deklaratat e konfliktit të interesit, në mospërputhje me nenin 73, pika 4 të RPP.

Nëpërmjet Urdhrit të Prokurimit nr. 179, datë 29.03.2023, Titullari i AK J.D. ka kërkuar kryerjen e procedurës së prokurimit me objekt "*F.V. pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore*", me fond limit 14,750,000 lekë pa TVSH, duke përcaktuar Njësinë e Prokurimit, të përbërë nga A. A, E. L., L. P. (specialist fushe). Njësia e prokurimit ka hartuar Procesverbalin nr. 1441/2 prot., datë 05.04.2023 për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e prokurimit. Njësia e prokurimit ka ngarkuar në SPE DST dhe Procesverbalin e argumentimit të kritereve për pajisjet DEXA në datën 05.04.2023, ka publikuar procedurën e prokurimit në datën 06.04.2023 dhe ka përcaktuar afatin e fundit për pranimin e ofertave datën 24.04.2023.
Njësia e prokurimit ka kërkuar që operatorët ekonomikë të paraqesin Autorizimin për tregtim të pajisjeve mjekësore, të lëshuar nga MSHMS, sipas përcaktimit në nenin 21 të Ligjit nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore", i ndryshuar. Ky dokument autorizon ndër të tjera subjektet të tregtojnë me pakicë pajisje mjekësore në Republikën e Shqipërisë.
Për të orientuar AK përfituese lidhur mbi zbatimin e kontratës, njësia e prokurimit duhet të kishte përfshirë në DST detyrimin që OE gjatë furnizimit të shoqërojë pajisjen me certifikatën përkatëse të regjistrimit të pajisjes (ose dokumentacion tjetër që vërteton se pajisja është e regjistruar, konfirmim nga AKBPM, etj.), për të garantuar zbatimin e përcaktimit në nenin 13 të Ligjit nr. 89/2014 "*Për pajisjet mjekësore*".
Nëpërmjet Urdhrit nr. 179/1, datë 29.03.2023 (*i korrigjuar nëpërmjet Urdhrit nr. 179/2, datë 13.04.2023*), Titullari i AK ka ngritur KVO, të përbërë nga K. Z., D. N. (specialist fushe), A. Q.. Në dosjen e prokurimit administrohen Formularët e Deklarimit të Konfliktit të Interesit (*sipas shtojcave nr. 1, bazuar në nenin 73 të RPP, dhe nr. 2, bazuar në nenin 80, pika 2, të RPP*)
Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 OE, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta (lekë pa TVSH)		Koment
1	T.	13,239,450	Kualifikuar	
2	S. M.	14,575,000	Kualifikuar	
3	A.	14,750,000	Skualifikuar	OE ka mungesë në dokumentacionin e paraqitur përkatësisht sigurimin e ofertës dhe autorizimin e prodhuesit, duke mos plotësuar kriteret e kualifikimit sipas DST.
4	O. D.T.	Pa ofertë ekonomike	Skualifikuar	OE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues për përmbushjen e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit sipas DST, si dhe as ofertën ekonomike.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka dokumentuar në procesverbal të posaçëm procesin e hapjes së ofertave, shqyrtimit dhe vlerësimit të tyre, si dhe të administrimit dhe vlerësimit të dokumentacionit fizik të paraqitur nga OE, në mospërputhje me nenin 2, pika 2, gërma *ë* dhe *j* të RPP.
Titullari i AK J.D. ka nënshkruar Formularin e njoftimit të fituesit (paraprak) nr. 1441/6 prot., datë 19.05.2023, duke informuar OE "T." Shpk se oferta e paraqitur është identifikuar si fitues (paraprak) dhe duke njoftuar për afatet e ankimit. Në dosjen e procedurës së prokurimit

administrohet dokumentacioni fizik i paraqitur nga OE, i cili nuk rezulton të ketë praktikë hyrëse në MSHMS dhe të jetë evidencuar me numër protokolli.
Në formularin e ofertës ekonomike, si dhe dokumentacionin shoqërues të ofertës (katalogë, certifikata, etj.), OE ka ofertuar për të furnizuar me pajisjen e matjes së densitometrisë kockore DEXA me origjinë nga Koreja e Jugut, nga kompania prodhuese "O. Co. Ltd.". Për të plotësuar kriterin lidhur me certifikatën CE të pajisjes, OE "T." ka paraqitur kopje të noterizuar të certifikatës "EC Certificate", nr. 286016-2019-CE-KOR-NA-PS Rev 2.0, që certifikon O. Co Ltd. për dizenjimin, zhvillimin dhe prodhimin e produktit "*X-ray Bone Densitometer and Ultrasound Bone Densitometer*" dhe prodhimin e produktit "*Ultrasound fracture therapeutic radiator*". Kjo certifikatë mban datën 04.11.2020 dhe citohet "*e vlefshme deri më 17.11.2023*". Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim.
Titullari i AK M.K. ka miratuar Raportin përmbledhës të procedurës së prokurimit nr. 1441/7 prot., datë 19.06.2023, si dhe Formularin e njoftimit të fituesit (në përfundim të afateve të ankimimit) nr. 1441/8 prot., datë 19.06.2023.
Ndërmjet AK dhe OE "T." Shpk është lidhur kontrata e furnizimit nr. 1441/9 prot., datë 20.07.2023, në vlerë totale 13,249,45 lekë pa TVSH dhe 15,899,340 lekë me TVSH, me afat lëvrimi 35 ditë nga nënshkrimi i kontratës. Vendi i dorëzimit të pajisjeve është përcaktuar, si më poshtë:

Nr.	Artikulli	Sasia (copë)	Vendi i dorëzimit
1	Pajisje për matjen e densitometrisë kockore - DEXA	1	Spitali Rajonal Berat
2	Pajisje për matjen e densitometrisë kockore - DEXA	1	Spitali Rajonal Dibër
3	Pajisje për matjen e densitometrisë kockore - DEXA	1	Spitali Rajonal Elbasan
4	Pajisje për matjen e densitometrisë kockore - DEXA	1	Spitali Rajonal Gjirokastër
5	Pajisje për matjen e densitometrisë kockore - DEXA	1	Spitali Rajonal Kukës

Në nenin 10 të Kushteve të veçanta të kontratës përcaktohet se, në momentin e dorëzimit të pajisjeve, OE duhet ta shoqërojë mallin me dokumentacionin përkatës që vërteton plotësimin e standardeve dhe specifikimeve teknike të kërkuara, por nuk kërkohet të paraqitet certifikata e regjistrimit të pajisjes, e lëshuar nga AKBPM.
Nëpërmjet Urdhrit nr. 1441/10 prot., datë 25.07.2023, Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS M.K. ka ngritur Komisionin për mbikqyrjen e kontratës së furnizimit, të përbërë nga L.P., R.M., S.L. , duke kërkuar ndjekjen e ecurisë së zbatimit të kontratës. Nëpërmjet shkresës nr. 1441/12 prot., datë 25.07.2023, Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS ka dërguar për zbatim kontratën me objekt "*F.V pajisje për matjen e densiotemtrisë kockore për strukturat shëndetësore*", drejtuar Spitaleve Rajonale Berat, Dibër, Elbasan, Gjirokastër, Kukës.

Për Spitalin Rajonal Berat - Nëpërmjet shkresës nr. 3817 prot., datë 22.08.2023, administruar në MSHMS me nr. 1441/15 prot., datë 04.09.2023, Zv. Drejtori i Shërbimeve Administrative të Spitalit Rajonal Berat K.P, në mungesë dhe me urdhër të Drejtorit të SR Berat A.K., ka dërguar dokumentacionin mbi kontratën e furnizimit, si më poshtë:

Nr.	Dokumenti	Nënshkruar për SR Berat nga:
1	Procesverbal i dorëzimit të pajisjes DEXA (SN: PM2300050) i datës 18.08.2023	K. H., F. V., B. Sh., B.T., E. X.
2	Procesverbal instalimi i datës 18.08.2023	K. H., F. V., B. Sh., B. T., E. Xh.
3	Format trajnimi i datës 18.08.2023	Punonjësit e trajnuar: E. Ç., M. M., B. T.
4	Fletë garancie 2-vjeçare	K. H., F. V., B. Sh., B. T., E. Xh.
5	Fletë-hyrje nr. 8, datë 18.08.2023	F. V.

Për Spitalin Rajonal Dibër - Nëpërmjet shkresës nr. 717/4 prot., datë 22.08.2023, administruar në MSHMS me nr. 1441/16 prot., datë 04.09.2023, Drejtori i Spitalit Rajonal Dibër ka dërguar dokumentacionin mbi kontratën e furnizimit, si më poshtë:

Nr.	Dokumenti	Nënshkruar për SR Dibër nga:
1	Procesverbal i dorëzimit të pajisjes DEXA (SN: PM2300049) i datës 18.08.2023	I. Sh., E. Sh., Je. D., J. V.
2	Procesverbal instalimi i datës 18.08.2023	I. Sh., E. Sh., J. D., J. V.
3	Format trajnimi i datës 18.08.2023	I. Sh., Punonjësit e trajnuar: H. L. E.Sh., J. V.
4	Fletë garancie 2-vjeçare	H. L. E. Sh., J. V., J. D.
5	Fletë-hyrje nr. 40, datë 18.08.2023	J. D., I. S.

Në Fletë-hyrjen nr. 40, datë 18.08.2023 janë përcaktuar të gjithë artikujt e marrë në dorëzim, përfshirë aksesorët e pajisjes, si PC ThinkVision & monitor LCD + tastierë + mouse, printer, tavolinë pune për PC, kabëll komunikimi LAN, kabëll ushqimi, manual përdorimi servisi dhe fantoma për inspektim ditor.

Për Spitalin Rajonal Elbasan - Nëpërmjet shkresës nr. 1442 prot., datë 25.08.2023, administruar në MSHMS me nr. 1441/18 prot., datë 04.09.2023, Drejtori i Spitalit Rajonal Elbasan ka dërguar dokumentacionin mbi kontratën e furnizimit, si më poshtë:

Nr.	Dokumenti	Nënshkruar për SR Elbasan nga:
1	Procesverbal i dorëzimit të pajisjes DEXA (SN: PM2300048) i datës 18.08.2023	D.M, Xh. K., I. I.
2	Procesverbal instalimi i datës 18.08.2023	D.M, Xh. K., I. I.
3	Format trajnimi i datës 18.08.2023	Punonjësit e trajnuar: D.M, A. B.
4	Fletë garancie 2-vjeçare	
5	Fletë-hyrje nr. 8, datë 18.08.2023	I. I.

Për Spitalin Rajonal Gjirokastër - Nëpërmjet shkresës nr. 581/2 prot., datë 21.08.2023, administruar në MSHMS me nr. 1441/14 prot., datë 04.09.2023, Drejtori i Spitalit Rajonal Gjirokastër ka dërguar dokumentacionin mbi kontratën e furnizimit, si më poshtë:

Nr.	Dokumenti	Nënshkruar për SR Gjirokastër nga:
1	Urdhër i Drejtorit të S.R.Gj. nr. 03, datë 04.01.2023 "Për krijimin e Komisionit për marrjen në dorëzim të pajisjeve"	S.F. Përbërja e Komisionit: M. G., R. K., S. Ç., M. Ç., V. T.
2	Procesverbal i dorëzimit të pajisjes DEXA (SN: PM2300051) i datës 18.08.2023	R. K.
3	Procesverbal instalimi i datës 18.08.2023	M. G., R. K., Sh. Ç., M. Ç., V. T.
4	Format trajnimi i datës 18.08.2023	Punonjësit e trajnuar: J. B., F. I., V. K.
5	Fletë garancie 2-vjeçare	
6	Fletë-hyrje nr. 157, datë 18.08.2023	R. K.

Për Spitalin Rajonal Kukës - Nëpërmjet shkresës nr. 1587 prot., datë 30.08.2023, administruar në MSHMS me nr. 1441/17 prot., datë 04.09.2023, Drejtori i Spitalit Rajonal Kukës ka dërguar dokumentacionin mbi kontratën e furnizimit, si më poshtë:

Nr.	Dokumenti	Nënshkruar për SR Kukës nga:
1	Procesverbal i dorëzimit të pajisjes DEXA (SN: PM2300046) i datës 18.08.2023	A. C., R. T., N. K.
2	Procesverbal instalimi i datës 18.08.2023	A. C., R. T., N. K.

3	Format trajnimi i datës 18.08.2023	Punonjësit e trajnuar: D. B., Y. K.
4	Fletë garancie 2-vjeçare	
5	Fletë-hyrje nr. 16, datë 18.08.2023	N. K.

Për sa më sipër, pavarësisht se pajisja DEXA shoqërohej me aksesorë të tjerë, si PC + monitor LCD, printer me ngjyra, tavolinë pune për PC, kabëll komunikimi LAN, kabëll ushqimi, manual përdorimi dhe servisi, fantoma për inspektim ditor, *vetëm Spitali Rajonal Dibër i ka pasqyruar të gjithë artikujt në fletë-hyrjen përkatëse në magazinë*, ndërkohë që 4 Spitalet e tjerë rajonalë kanë përcaktuar në fletë-hyrje vetëm pajisjen DEXA dhe jo artikujt e tjerë të marrë në dorëzim.
OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 641, datë 21.09.2023**, në vlerën prej **15,899,340 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 88906/2023, datë 17.08.2023.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës nëpërmjet verifikimit në terren nga grupi i auditimit, në tre nga pesë institucionet spitalore të varësisë të furnizuar me pajisjet DEXA, përkatësisht në Spitalin Rajonal Elbasan, Shërbimin Spitalor Kukës dhe Polikliniken Berat, ka rezultuar se:
1. Pavarësisht se pajisja DEXA ishte marrë fillimisht për Spitalin Rajonal Berat, ajo ishte transferuar pranë Poliklinikës Berat, veprim ky i pasqyruar në fletë-daljen përkatëse.
2. *Spitali Rajonal Elbasan* dhe *Shërbimi Spitalor Kukës* nuk kishin administruar dokumentacionin përkatës që vërteton plotësimin e standardeve dhe specifikimeve teknike të kërkuara, por vetëm manualet e përdorimit dhe servisit, në mospërputhje me përcaktimin në nenin 10 të kontratave respektive të lidhura.
3. *Spitali Rajonal Berat* vuri në dispozicion të grupit të auditimit fotokopje të certifikatës "EC Certificate", nr. 286016-2019-CE-KOR-NA-PS Rev 5.0, që certifikon O. Co Ltd. për dizenjimin, prodhimin dhe inspektimin/ testimin e produktit final për pajisjen "*X-ray Bone Densitometer and Ultrasound Bone Densitometer*". Kjo certifikatë mban datën 28.09.2020 dhe citohet "*e vlefshme deri më 17.11.2022*" dhe është e ndryshme nga certifikata e ngarkuar në SPE bashkëlidhur ofertës ekonomike të paraqitur nga OE, sa i përket nr. të referencës dhe datave përkatëse të lëshimit dhe vlefshmërisë.
4. Në asnjë rast, institucionet spitalore të varësisë nuk kishin administruar certifikatën e regjistrimit të pajisjes, sipas përcaktimit në nenin 13, pika 4, të Ligjit nr. 89/2014 "*Për pajisjet mjekësore*", i ndryshuar, të lëshuar nga AKBPM, për pajisjen DEXA. Nga verifikimi në listën e publikuar në faqen zyrtare të AKBPM[27], rezulton se kjo pajisje është e regjistruar, me nr. 10903, me datë aplikimi 27.12.2021.
5. Nga etiketat e verifikuara rezulton se pajisja është e markës P., me prodhues "O. Co Ltd.", sipas ofertës së pranuar, si dhe pjesët e tjera përbërëse të pajisjes, si (i) "*Patient table*" (shtrati për pacientin) dhe (ii) "*Phantom*" (fantoma), janë të së njëjtës marke dhe firme prodhuese. Sa i përket pjesës përbërëse "*X-ray generator*", që është pjesë përbërëse e pajisjes Primus, të modeluar dhe zhvilluar nga O. Co Ltd., rezulton se (i) "*X-ray high voltage generator*", me model HTB-1003, ka prodhues "P. Co. Ltd.", dhe (ii) "*X-ray tube*", me model OPX/105, ka prodhues "C.".

II. Procedura e prokurimit e hapur ndërkombëtare me objekt "*Blerje pajisje të teknologjisë së lartë për spitalet*", ndarë në 10 lot-e - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot) ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj, me fond limit/ vlera e pritshme e kontratave në total prej 259,380,166 lekë pa TVSH

[27] https://akbpm.gov.al/

Nëpërmjet Urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS-së S. H. nr. 290, datë 24.05.2024, është ngritur grupi i punës për përllogaritjen e vlerës së parashikuar të prokurimit, përcaktimin e specifikimeve teknike, sasive, afatet e lëvrimit, si dhe shpërndarjen për zhvillimin e procedurave të përqendruara të prokurimit publik për pajisje mjekësore të teknologjisë së lartë për llogari të spitaleve publike, të përbërë nga O.A(kryetar, jurist), R.M. (anëtare, ing. Ekonomike), E. K. (anëtare, ing. Biomedikale, ekspert fushe). Ky grup pune është ndryshuar nëpërmjet Urdhrit nr. 290/1, datë 25.06.2024, duke zëvendësuar anëtarin E. K. me R. H. (anëtar, ekspert fushe).
Nëpërmjet PV nr. 2, të datës 03.06.2024, i paprotokolluar, grupi i punës ka dokumentuar shqyrtimin e nevojave të mbledhura nga spitalet, si dhe inventarin e pajisjeve mjekësore, të përcjellë nga Sektori i Pajisjeve në MSHMS, duke cituar se ky dokumentacion do të shërbejë për përzgjedhjen me efektivitet dhe eficiencë të shpërndarjes së pajisjeve mjekësore sipas nevojave reale dhe kapaciteteve. Nëpërmjet PV nr. 3, të datës 04.06.2024, grupi i punës ka dokumentuar hartimin e specifikimeve teknike për 23 pajisje, për të cilat sikurse cituar është bazuar në "*research online, procedura të ngjashme në institucionet shëndetësore publike, WorldWide, etj., si dhe modele "online" duke iu referuar karakteristikave të përbashkëta*". Nëpërmjet PV nr. 4, të datës 11.06.2024, dhe PV nr. 5, të datës 13.06.2024, grupi i punës ka dokumentuar ftesat për ofertë për studimin e tregut drejtuar 19 operatorëve ekonomikë, si dhe shtyrjen e afatit për paraqitjen e ofertave. Nëpërmjet PV nr. 6, PV nr. 7 dhe PV nr. 8, të datës 24.05.2024, grupi i punës ka dokumentuar administrimin e ofertave të para, si dhe disa propozime për ndryshim të specifikimeve teknike të paraqitura nga operatorët ekonomikë, duke cituar se "*u pa që operatorët kishin propozuar ndryshime në disa specifikime teknike... specialisti i fushës vijoi me shqyrtimin e rekomandimeve të lëna*". Nëpërmjet Urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS-së nr. 290/1 prot., datë 25.06.2024, anëtari/ specialist fushe E. K. zëvendësohet me R. H. (anëtar, ekspert fushe). Nëpërmjet PV nr. 9, të datës 26.06.2024, grupi i punës ka dokumentuar marrjen në dorëzim nga anëtari i ri specialist fushe të specifikimeve teknike dhe të ndryshimeve të propozuara nga operatorët. Nëpërmjet PV nr. 10-17, të datave 08-16.07.2024 është dokumentuar marrja në dorëzim e ofertave për studim tregu si dhe hapat e ndjekura nga grupi i punës për konsolidimin e listës së lot-eve që do të prokurohen, bazuar në korrespondencat me spitalet. Nëpërmjet PV nr. 14, të datës 11.07.2024, grupi i punës ka dokumentuar rishikimin e specifikimeve teknike, duke bashkëlidhur e-mail të specialistit të fushës R. H., ku citohet "*bashkëngjitur draft specifikimet teknike ku janë pasqyruar edhe sugjerimet/ kërkesat e operatorëve teknikë*". As në këtë dokument, specifikimet teknike nuk janë argumentuar teknikisht.
Në dosjen e prokurimit administrohen Formularët e Deklarimit të Konfliktit të Interesit (*sipas shtojcave nr. 1, bazuar në nenin 73 të RPP, dhe nr. 2, bazuar në nenin 80, pika 2, të RPP*) të nënshkruar nga anëtarët O. A., R.M., por jo nga anëtarët E. K., R. H., të përcaktuar si specialistë fushe.
Grupi i punës ka hartuar relacionin nr. 2452/2 prot., datë 17.07.2024, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS-së S. H., ku citohet se:

1. Për të shmangur dublikimin, grupi i punës ka përjashtuar nga lista e pajisjeve mjekësore pajisjet që financohet nga PBA e vitit 2024-2026 për 3 spitale, pajisjet që financohen nga projekte të huaja të Bankës Botërore, pajisjet që financohen na institucionet e tjera;
2. Grupi i punës përjashtoi nga përzgjedhja 8 pajisje që nuk plotësojnë kriteret për studimin e tregut.

Në vijim, është konkluduar lista me 10 lot-e, duke përcaktuar fondin limit për secilin prej tyre, në total 259,380,166 lekë pa TVSH, si më poshtë:

Nr. Lot	Pajisja	Sasia	Destinacioni	Fondi limit
1	Aparat Anestezie	4	Spitali Dibër, Spitali Lushnje, Spitali Tepelenë, Spitali Pukë	12,266,120
2	Respirator	1	Spitali Tropojë	2,093,520
3	Grafi-skopi stacionar digjital	2	Spitali Korçë, Spitali Elbasan	32,018,133
4	Echo 3D/4D me aplikim te pergjithshem + sonde lineare + sonde kardiake + sonde konvekse + sonde gjinekologjike	9	Spitali Kukës, SUOGJ Koco Gliozheni, Spitali Delvinë, Spitali Përmet, Spitali Gramsh, Spitali Devoll, Spitali Kuçovë, Spitali Has, Spitali Skrapar	37,356,570
5	Sistem komplet fibrobronkoskop	2	Spitali Gjirokastër, Shefqet Ndroqi	13,266,667
6	Grafi portabel digjitale	1	Spitali Mirditë	7,870,950
7	Sistem komplet Laparaskopi	1	Spitali Vlorë	12,006,800
8	Sistem komplet artroskopie	1	Spitali Memorial Fier	9,896,867
9	Mamografi Digjitale	1	Mbretëresha Geraldinë	15,191,873
10	CT Scan 64 slice	2	Spitali Shkodër, Spitali Sarandë	117,412,667
TOTALI				**259,380,166**

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Sektori i Prokurimeve pranë MSHMS-së ka rezultuar se procedura e prokurimit ka përfunduar dhe është lidhur MK *brenda periudhës së auditimit* vetëm për lot-et nr. 1-7. Lot-i nr. 8 është anuluar dhe përsëritur si procedurë më vete, ndërsa lot-et nr. 9-10 nuk kanë përfunduar/ nuk është lidhur MK deri në datën 31.12.2024 (brenda periudhës së auditimit). Për sa më sipër, grupi i auditimit ka përzgjedhur për auditim lot-in nr. 3, me fond limit 32,018,133 lekë pa TVSH dhe lot-in nr. 4, me fond limit 37,356,570 lekë pa TVSH, që përkojnë me rreth 60% të vlerës totale limit të përllogaritur prej 116,878,760 lekë pa TVSH për 7 lot-et e realizuar brenda periudhës së auditimit.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe dokumentacioni i ngarkuar në SPE, ka rezultuar se:

Lot 3 "*Grafi-skopi stacionar digjital*", me nr. REF-15526-08-06-2024, me fond limit/ vlera e pritshme e kontratave 32,018,133 lekë pa TVSH

Procedura e prokurimit "F.V. pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore"		
1. **Urdhër Prokurimi** Nr. 413, datë 31.07.2024	3. **Përllogaritja e fondit limit dhe specif. Teknike** Urdhër nr. 290, datë 24.05.2024, i ndryshuar - O. A. - R.M. - E. K. - R. H. (pas ndryshimit 25.06.2024) **Njësia e Prokurimit** Urdhër nr. 413, datë 31.07.2024 - A. A - E. L. - L.P. - L. A. - O. A.	4. **Komisioni i Vlerësimit të Ofertave** Urdhër nr. 413/1, datë 31.07.2024 - B. H. - E. K. - E. H. - A. P. - N. K.
2. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur ndërkombëtare"		
5. **Fondi Limit (pa TVSH)** 32,018,133 lekë	6. **Oferta fituese (pa TVSH)** 22,980,000 lekë	7. **Diferenca me fondin limit (pa TVSH)** 9,038,133 lekë (28%)
8. **Data e hapjes së tenderit** 06.08.2023	9. **Burimi i financimit** Buxheti i Shtetit 2024 - 2026	10. **Operatorët Ekonomike** a) Pjesëmarrës në tender: 8 OE b) Skualifikuar: 5 OE
11. **Ankimime** AK: Po (DST) KPP: Po (DST)		
12. **Lidhja e MK** Nr. 3384/79 prot., datë 12.12.2024	13. **Vlera limit e MK** 32,018,133 lekë pa TVSH	14. **Afati i MK në ditë** 36 muaj

Titullari i AK S. H. ka miratuar Urdhrin e Prokurimit nr. 413, datë 31.07.2024, duke cituar se "*përllogaritja e vlerës së parashikuar, përcaktimi i specifikimeve teknike, sasive, afatet e lëvrimit si dhe shpërndarja, etj., janë mbledhur, përpunuar dhe hartuar nga Grupi i punës ad hoc i emëruar me Urdhrin nr. 290, datë 24.05.2024, i ndryshuar*", duke caktuar Njësinë e prokurimit, të përbërë nga A.P (anëtar, person përgjegjës për prokurimin), L.P. (anëtar, specialist fushe), E. L. (anëtar, person përgjegjës për prokurimin), L. A. (anëtar, person përgjegjës për prokurimin), O.A(anëtar). Nëpërmjet Urdhrit nr. 413/1, datë 31.07.2024, Titullari i AK ka ngritur KVO, të përbërë nga B. H. (kryetar), E. K. (anëtar, specialist fushe), E. H. (anëtar, specialist fushe), A. P., N. K. (anëtarë).
Njësia e prokurimit ka hartuar DST dhe procesverbalin e datës 06.08.2024 për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim (i paprotokolluar). Në asnjë rast, as nga grupi i punës i ngritur nëpërmjet Urdhrit nr. 290, datë 24.05.2024, i ndryshuar, dhe as nga njësia e prokurimit, nuk rezulton të jenë argumentuar teknikisht specifikimet teknike të pajisjeve (pra pse këto specifikime teknike janë të nevojshme për të garantuar cilësinë e kërkuar), në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të RPP-së.
Njësia e prokurimit ka kërkuar që operatorët ekonomikë të paraqesin Autorizimin për tregtim të pajisjeve mjekësore, të lëshuar nga MSHMS, sipas përcaktimit në nenin 21 të Ligjit nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore", i ndryshuar. Ky dokument autorizon ndër të tjera subjektet të tregtojnë me pakicë pajisje mjekësore në Republikën e Shqipërisë.
Për të orientuar AK përfituese lidhur mbi zbatimin e kontratës, njësia e prokurimit duhet të kishte përfshirë në DST detyrimin që OE gjatë furnizimit të shoqërojë pajisjen me certifikatën përkatëse të regjistrimit të pajisjes (ose dokumentacion tjetër që vërteton se pajisja është e regjistruar, konfirmim nga AKBPM, etj.), për të garantuar zbatimin e përcaktimit në nenin 13 të Ligjit nr. 89/2014 "*Për pajisjet mjekësore*".
Autoriteti Kontraktor ka publikuar procedurën e prokurimit në SPE në datën 07.08.2024, duke përcaktuar afatin e fundit për pranimin e ofertave datën 14.10.2024. Specifikimet teknike të hartuara nga specialistët e fushës pjesë të grupit të punës, të dokumentuara nëpërmjet PV nr. 3, datë 04.06.2024 dhe nr. 14, datë 11.07.2024, kanë pësuar disa ndryshime sa i përket pajisjeve të lot-it 3, të paargumentuara teknikisht, ndër të tjera si më poshtë:

Nr.	**Specifikimi teknik në PV nr. 3, datë 04.06.2024 (hartuar nga E. Kilja)**	**Specifikimi teknik në PV nr. 14, datë 04.06.2024 (hartuar nga R. Haxhiraj)**	**Specifikimi teknik i publikuar në SPE**
Mbi gjeneratorin e rrezeve X			
1	Të suportojë intervalet në lidhje me radiografinë nga të paktën 40-150 kV, **1-800 mA** dhe 0,001-5 sekonda ose më mirë për secilin rang aplikues	Të suportojë intervalet në lidhje me radiografinë nga të paktën 40-150 kV, **10-800 mA** dhe 0,001-5 sekonda ose më mirë për secilin rang aplikues	Të suportojë intervalet në lidhje me radiografinë nga të paktën 40-150 kV, **10-800 mA** dhe 0,001-5 sekonda ose më mirë për secilin rang aplikues
2	Të suportojë intervalet në lidhje me fluoroskopinë në të paktën 40-125 kV dhe **0,5 – 25 mA** ose më mirë për secilin rang aplikues	Të suportojë intervalet në lidhje me fluoroskopinë në të paktën 40-125 kV dhe **0,5 – 10 mA** ose më mirë për secilin rang aplikues	Të suportojë intervalet në lidhje me fluoroskopinë në të paktën 40-125 kV dhe **0,5 – 10 mA** ose më mirë për secilin rang aplikues
Mbi tubin e rrezeve X			
3	Kapaciteti maksimal i ekspozimit në kV të jetë afërsisht 100kV	Kapaciteti maksimal i ekspozimit në kV të jetë afërsisht 500kV	Kapaciteti maksimal i ekspozimit në kV të jetë afërsisht 500kV
Mbi tavolinën e radiografisë			
4	Të mundësojë lëvizje vertikale prej +90 gradë si dhe lëvizje trendelenburg me 20 gradë	Të mundësojë lëvizje vertikale prej +90 gradë si dhe lëvizje trendelenburg me 15 gradë	Të mundësojë lëvizje vertikale prej +90 gradë si dhe lëvizje trendelenburg me 15 gradë

Lidhur me dokumentat e tenderit OE "H. & L." ka paraqitur Formularin e ankesës pranë AK dhe KPP të datës 15.08.2024.

Nëpërmjet Urdhrit nr. 439, datë 16.08.2024, Titullari i AK ka pezulluar vazhdimin e procedurës për lot-in 3 dhe ka ngritur KSHA, të përbërë nga M.K. (kryetar), E. K. (specialist fushe), E. H. (specialist fushe), A. P., N. K..
Nëpërmjet shkresës nr. 3384/5 prot., datë 22.08.2024, KSHA i paraqet Titullarit të AK vendimin lidhur me ankesën e OE "H. & L.", ku janë marrë pranuar 3 nga 4 pretendimet e paraqitura lidhur me specifikimet teknike të pajisjes. Nëpërmjet shkresës nr. 3384/6 prot., datë 22.08.2024, Titullari i AK ka dërguar vendimin e KSHA drejt KPP-së.
Nëpërmjet shkresës administruar në MSHMS me nr. 3384/29 prot., datë 13.09.2024, KPP ka përcjellë vendimin nr. 1233/2024, nr. 2301/9 prot., datë 10.09.2024, ku është vendosur pranimi pjesërisht i ankesës së OE, dhe është kërkuar nga AK të bëjë modifikimet dhe sqarimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e KPP-së.
Nëpërmjet shkresës nr. 3384/32 prot., datë 24.09.2024 është kryer njoftimi për ndryshimin e dokumentave të tenderit, duke rishikuar afatin e fundit për pranimin e ofertave datën 14.10.2024, publikuar në SPE në datën 24.09.2024, ku konstatohet ndryshimet, si më poshtë:

Nr.	Ishte	Bëhet
Mbi tubin e rrezeve X		
1	Kapaciteti maksimal i ekspozimit në kV të jetë afërsisht 500kV	Kapaciteti maksimal i ekspozimit në kV të jetë maksimumi jo më pak se 100 KV
2	Kapaciteti i nxehtësisë në lidhje me anodën duhet të përballojë të paktën vlerën: 500 kHU	Kapaciteti i nxehtësisë në lidhje me anodën duhet të përballojë të paktën vlerën: 140 kHU ose më mirë
Mbi detektorin digjital		
3	Madhësia e pixelit duhet të jetë afërsisht 140µm ose më mirë	Madhësia e pixelit duhet të jetë afërsisht 200µm ose më mirë
Mbi printerin		
4	Formatet e disponueshme të printimit të jenë 35x43cm; 26x36cm dhe 20x25cm	Formatet e disponueshme të printimit të jenë nga 20x25cm deri në 35x43cm

Nëpërmjet shkresës nr. 3384/34 prot., datë 25.09.2024, Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS-së L. S. ka vënë në dijeni KPP-në lidhur me zbatimin e vendimeve përkatëse, ndër të tjerë për lot-in 3.
KVO ka dokumentuar hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, nëpërmjet PV të datës 07.11.2024, i paprotokolluar, ku konstatohet se:

Nr.	OE	Vlera e ofertuar (lekë pa TVSH)	Statusi	Arsyeja
1	B. Ph.	Pa ofertë ekonomike	Skualifikuar	OE nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.
2	H. & L.	Pa ofertë ekonomike	Skualifikuar	OE nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.
3	M.	Pa ofertë ekonomike	Skualifikuar	OE nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.
4	M.	22,980,000	Kualifikuar/ fitues	
5	I.	24,000,000	Skualifikuar	O Sigurimi i ofertës është me datë 06.09.2024, nuk plotëson 180 ditëshin sipas DST-së. O Katalogu i pamarkuar. O Të mundësohet ekspozimi manual me të paktën 2/3 faktorë (kV, mAs dhe Sek).- Nuk është i përcaktuar në katalog O Të mundësohet ekspozimi automatik me të paktën 1/2 faktorë (kV dhe mAs).- Nuk është i përcaktuar në katalog O Nuk ka paraqitur katalog për UPS dhe printerin. O Faturat e ngjashme janë për materiale mjekësore dhe jo për pajisje mjekësore.
6	B.G.	24,580,000	Skualifikuar	O ISO 9001-2015 në sistemin online nuk është e vlefshme për distributorin Albaphoto O Nuk ka mbrojtje nga Collision dhe mbrojtja nga mbinxehja e paspecifikuar O Kolimatori LED i paspecifikuar O Dedektori 30fps i pa specifikuar O Paneli kontrollit me ram 8GB O Gjeneratori i rrezeve x janë faktorët 2/3 dhe ½ që nuk janë përcaktuar në katalog
7	B.	30,900,000	Kualifikuar	
8	M.	31,380,000	Kualifikuar	

Nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE, nuk janë konstatuar parregullsi lidhur me plotësimin e kritereve për kualifikim. Nisur nga fakti se oferta e paraqitur nga OE është ulur nën 85% të

mesatares së ofertave të vlefshme, AK ka kërkuar argumentimin e ofertës anomalisht të ulët nëpërmjet SPE. OE ka paraqitur argumentimin e ofertës nëpërmjet shkresës nr. 289 prot., datë 01.11.2024, e paprotokolluar në MSHMS, ku janë detajuar zërat përbërës të ofertës, duke bashkëlidhur dokumentacion mbi çmimet e prodhuesit për pajisjen dhe kostot e transportit.
KVO ka vlerësuar si të suksesshme ofertën e OE "M." në vlerën prej **22,980,000 lekë pa TVSH**. Titullari i AK ka miratuar Raportin përmbledhës të procedurës së prokurimit, protokolluar me nr. 3384/71 prot., datë 27.11.2024.
Nëpërmjet Urdhrit nr. 557, datë 31.10.2024, Titullari i AK ka krijuar Komisionin për dhënien e kontratave për lot-et e procedurës, të përbërë nga H. T. (jurist), E. H. (inxhinier), E. M. (ekonomist), duke përcaktuar detyrat e komisionit, si dhënien dhe hartimin e minikontratave, hartimin e njoftimit të kontratave të lidhura, dërgimin pranë personave përgjegjës për prokurimin të formularit të njoftimit të nënshkrimit të kontratave. Nëpërmjet Urdhrit nr. 580, datë 11.11.2024, Titullari i AK ka krijuar Komisionin për ndjekjen e zbatimit të kontratave, të përbërë nga E. L. (kryetar), N. K., B. M. (anëtarë).
Ndërmjet AK dhe OE "M." është lidhur marrëveshja kuadër nr. 3384/79 prot., datë 12.12.2024, me afat 36 muaj, me fond limit/ vlerë të pritshme të kontratave 32,018,133 lekë pa TVSH, ku përcaktohet se kontraktori duhet të furnizojë mallrat sipas MK, formularit të deklarimit të ofertës së paraqitur nga ofertuesi, specifikimet teknike, lista e çmimeve të artikujve.
Në ofertën fituese, OE ka ofertuar me çmim/ njësi 11,499,000 lekë pa TVSH dhe çmim total 22,998,000 lekë pa TVSH për sasinë prej 2 pajisjesh të kërkuar në lot-in 3. Marrëveshja kuadër është lidhur në vlerën e përllogaritur të fondit limit për lot-in përkatës prej 32,018,133 lekë pa TVSH. Pavarësisht se sasitë në marrëveshje kuadër janë sasi orientuese dhe AK mund të blejë më pak ose më shumë se sasitë e parashikuara (brenda vlerës së përllogaritur të marrëveshjes kuadër), **MSHMS të mbajë në vëmendje se ka detyrimin të mirëplanifikojë nevojat që me fillimin e procedurës dhe kontratat që jepen brenda marrëveshjes kuadër të lidhen në bazë të nevojave faktike, që duhet të jenë të dokumentuara**, për të garantuar përdorimin me eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.

Lot 4 "Echo 3D/4D me aplikim te përgjithshëm + sonde lineare + sonde kardiake + sonde konvekse + sonde gjinekologjike", me fond limit 37,356,570 lekë pa TVSH

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt*: "Echo 3D/4D me aplikim te pergjithshem + sonde lineare + sonde kardiake + sonde konvekse + sonde gjinekologjike"* REF-15528-08-06-2024		
1. **Urdhër Prokurimi** Nr. 413, datë 31.07.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 413, datë 31.07.2024 A. A E. L. L. A. O. A. R H (anëtar në datë 12.12.2024) L.P. (largohet datë 12.12.2024)	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 413/1, datë 31.07.2024 B H A P E. H. E K N K
4. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur ndërkombëtare"		
5. Fondi Limit: 37,356,570 lekë pa TVSH.	**6. Oferta fituese:** "OE M.", me vlerë 15,840,000 lekë pa TVSh. Marrëveshje Kuadër nr. 3384/92, datë 23.12.2024, me afat 36 muaj	**7. Diferenca me fondin limit:** 21,516,570 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 24.10.2024	**9. Burimi i Financimit:** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 11 OE+BOE b) Skualifikuar: 7 OE c) Kualifikuar: 4 OE

11. Ankimime 2 për DST date 15.08.2024, në KPP dhe AK nga OE "M." dhe "H.&L."	12. Përgjigje ankesës nga AK: datë 22.08.2024	13. Përgjigje dhe dërgim Vendimi i KPP datë 13.09.2024
14. Lidhja e M Kuadër Nr. 3384/92 prot., datë 23.12.2024,	15. Vlera limit e Marrëveshjes Kuadër 37,356,570 lekë pa TVSH	16. Afati i MK në ditë 36 muaj

Zhvillimi i procedurës

Nëpërmjet Urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS-së nr. 290, datë 24.05.2024, është ngritur grupi i punës për përllogaritjen e vlerës së parashikuar të prokurimit, përcaktimin e specifikimeve teknike, sasive, afatet e lëvrimit, si dhe shpërndarjen për zhvillimin e procedurave të përqendruara të prokurimit publik për pajisje mjekësore të teknologjisë së lartë për llogari të spitaleve publike, të përbërë nga:

O.A(kryetar, jurist),

R.M. (anëtare, ing. Ekonomike),

E. K. (anëtare, ing. Biomedikale, ekspert fushe).

Ky grup pune është ndryshuar nëpërmjet Urdhrit nr. 290/1, datë 25.06.2024, duke zëvendësuar anëtarin E. K. me R. H. (anëtar, ekspert fushe).

Në dosjen e prokurimit administrohen Formularët e Deklarimit të Konfliktit të Interesit të nënshkruar nga anëtarët O. A., R.M., por jo nga anëtarët E. K., R. H., të përcaktuar si specialistë fushe.

Veprim në kundërshtim me nenin 19 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 dhe nenet 13 e 73 të RPP.

Me Proces Verbalit nr. 2, të datës 03.06.2024, i paprotokolluar, grupi i punës ka dokumentuar shqyrtimin e nevojave të mbledhura nga spitalet, si dhe inventarin e pajisjeve mjekësore, të përcjellë nga Sektori i Pajisjeve në MSHMS, duke cituar se ky dokumentacion do të shërbejë për përzgjedhjen me efektivitet dhe eficiencë të shpërndarjes së pajisjeve mjekësore sipas nevojave reale dhe kapaciteteve.

Grupi i Punës me Proces Verbalin nr. 3, të datës 04.06.2024, ka dokumentuar hartimin e specifikimeve teknike për 23 pajisje, për të cilat sikurse cituar është bazuar në "*research online, procedura të ngjashme në institucionet shëndetësore publike, ËorldËide, etj., si dhe modele "online" duke iu referuar karakteristikave të përbashkëta*". Nëpërmjet PV nr. 4, të datës 11.06.2024, dhe PV nr. 5, të datës 13.06.2024, grupi i punës ka dokumentuar ftesat për ofertë për studimin e tregut drejtuar 19 operatorëve ekonomikë, si dhe shtyrjen e afatit për paraqitjen e ofertave.

Me Proces Verbalin nr. 8, të datës 24.05.2024, grupi i punës ka dokumentuar administrimin e 4 ofertave të para, si dhe disa propozime për ndryshim të specifikimeve teknike të paraqitura nga operatorët ekonomikë, duke cituar se: "*u pa që operatorët kishin propozuar ndryshime në disa specifikime teknike... specialisti i fushës vijoi me shqyrtimin e rekomandimeve të lëna*".

Me Verbalin nr. 13, të datës 10.07.2024 Grupi i Punës ka dokumentuar administrimin e 7 ofertave, si dhe disa propozime për ndryshim të specifikimeve teknike të paraqitura nga operatorët ekonomikë, duke cituar se: *merren në konsideratë 5 oferta ekonomike dhe nuk merren në konsideratë 2 oferta ekonomike pasi, 1 nuk ishte në përputhje me specifikimet teknike dhe 1 nuk verifikohet ne QKB.*

Proces Verbalin nr. 14, të datës 11.07.2024 grupi i punës ka dokumentuar hartimin e specifikimeve teknike për 22 pajisje.

Specifikimet teknike të hartuara nga specialistët e fushës pjesë të grupit të punës, të dokumentuara nëpërmjet PV nr. 3, datë 04.06.2024 dhe nr. 14, datë 11.07.2024, kanë pësuar disa ndryshime sa i përket pajisjeve të lot-it 4, si më poshtë:

Nr.	Specifikimi teknik në PV nr. 3, datë 04.06.2024 (hartuar nga E. K.)	Specifikimi teknik në PV nr. 14, datë 11.07.2024 (hartuar nga R. H.)	Specifikimi teknik i publikuar në SPE Proces Verbali datë 06.08.2024
	Të ketë të paktën 6.000.000 kanale procesimi	---------	----------
	Të ketë thellësi imazhi në varësi të sondave dhe preseteve përafërsisht në intervalin nga 2cm deri në 50 cm	Të ketë thellësi imazhi në varësi të sondave dhe preseteve përafërsisht në intervalin nga 1.5 cm ± 0.5 deri në 40 cm± 0.5	Të ketë thellësi imazhi në varësi të sondave dhe preseteve përafërsisht në intervalin nga 1.5 cm ± 0.5 deri në 40 cm± 0.5
	Të mundësojë një "Frame Rate" në jo më pak se 2000 fps(Hz) për një rezultate imazh sa më cilësor	Të mundësojë një "Frame Rate" në jo më pak se 1400 fps(Hz) për një rezultate imazh sa më cilësor	Të mundësojë një "Frame Rate" në jo më pak se 1400 fps(Hz) për një rezultate imazh sa më cilësor
	Të ketë kapacitet SSD me kapacitet 500GB	Të ketë kapacitet memorje brenshme/jashtme jo më pak se 1TB ku të paktën 128 GB të jetë SSD ose më e mirë	Të ketë kapacitet memorje brenshme/jashtme jo më pak se 1TB ku të paktën 128 GB të jetë SSD ose më e mirë
	Të ketë RAM të paktën 16GB DDR4	----------	----------
	Të jetë i pajisur me dale HDMI dhe Porta USB (3.0)	Të jetë i pajisur me dale HDMI dhe Porta USB	Të jetë i pajisur me dale HDMI dhe Porta USB
	Të ketë teknologji të avancuar për depërtim dhe rezolucion maksimal. Fushë pamja të mundësohet në afersisht në 60^0	Të ketë teknologji të avancuar për depërtim dhe rezolucion maksimal. Fushë pamja të mundësohet në afersisht në $70^0 \pm 10$	Të ketë teknologji të avancuar për depërtim dhe rezolucion maksimal. Fushë pamja të mundësohet në afersisht në $70^0 \pm 10$

Ndryshimet e mësipërme janë të paargumentuara teknikisht, veprim jo në përputhje e zbatim të pikës 2 të nenit 78, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" të RPP, ku përcaktohet:

..... Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Nuk ka një analizë të detajuar mbi efektet e ndryshimeve të specifikimeve teknike në kërkesat për funksionet e aparaturave dhe ndikimi në cmim/cilësi e specifikimeve teknike të tyre.

Me njoftimin për ndryshimin e dokumenteve të tenderit nr. 3384/32 datë 24.09.2024 Titullari i Autoritetit Kontraktor ka përcaktuar edhe afatin e fundit të pranimit të ofertave nga 06.09.2024 në 14.10.2024.
Me shkresën Nr. 3384/43 Prot., datë 11.10.2024, AK ka publikuar në SPE Njoftimin për ndryshimin e dokumenteve të tenderit (lotet 1, 4),

Nr	Ishte	Bëhet
2.1	"Të ketë të integruar ekran me prekje (touch screen) me madhësi ekrani jo më pak se 13" dhe me rezolucion HD ose më mirë".	"Të ketë të integruar ekran me prekje (touch screen) me madhësi ekrani jo më pak se 12" dhe me rezolucion HD ose më mirë".
2.2	"Të jetë e pajisur me opsionet për theksimin e ngjyrave".	"Të jetë e pajisur me kontrast për theksimin e ngjyrave".
2.3.	"Të ketë thellësi imazhi në varësi të sondave dhe preseteve përafërsisht në intervalin nga 1.5± 0.5cm deri në 40±0.5cm ose më mirë".	"Të ketë thellësi imazhi në varësi të sondave dhe preseteve përafërsisht në intervalin nga 1.5 ± 0.5cm deri në 35 ± 5cm ose më mirë".
2.4.	"Të ketë opsionet si Auto EF (ejection fraction), 'Strain', Analize të Karotides për "intima-media thickness, matje automatike të IMT, skanim panoramik etj"".	"Të ketë opsionet si Auto EF (ejection fraction), 'Strain', Analize të Karotides për "intima-media thickness, matje

		automatike, ose gjysmë automatike të IMT, skanim panoramik etj””.
2.5.	“Të mundësojë matje automatike për çdo hap të matjeve ekokardiografike si septumit interventrikular, Diametri LV, Diametri i murit posterior, Diametri LA, Diametër Aorte, Volum LA dhe LV, në planet 2 Chamber sikurse dhe në planet 4 Chamber. Matje automatike në M Mode të Aortes, LA, LV, Spetumit, Muritposterior, Matje Automatike në doppler të Vmax dhe Velocity për valvolatmitrale, aortës, pulmonare etj””.	“Të mundësojë matje automatike, ose gjysmë automatike për çdo hap të matjeve ekokardiografike si septumit interventrikular, Diametri LV, Diametri i murit posterior, Diametri LA, Diametër Aorte, Volum LA dhe LV, në planet 2 Chamber sikurse dhe në planet 4 Chamber. Matje automatike ose gjysmë automatike në M Mode të Aortes, LA, LV, Spetumit, Muritposterior, Matje Automatike ose gjysmë automatike në doppler të Vmax dhe Velocity për valvolatmitrale, aortës, pulmonare etj””.

Në vijim të kërkesa për sqarim të paraqitura në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE). Autoritetit Kontraktor ka përcaktuar edhe afatin e fundit të pranimit të ofertave nga 14.10.2024 në 24.10.2024.

Vlerësimi i ofertave

Me Urdhër nr. 413/1, datë 31.07.2024 është ngritur Komisioni për vlerësimin e ofertave i përbërë nga B. H., A. P., E. H., E. K. dhe N. K..

Në datën 24.10.2024 është bërë hapja e ofertave për Lotet 1,4 dhe 9. Në datë 12.11.2024, KVO verifikoi dhe vlerësoi dokumentacionin e paraqitur nga Ofertuesit dhe me procesverbal datë 20.11.2024. Shqyrtimin nga KVO dhe vlerësimi i ofertave, paraqitet si më poshtë:

Nr.	OE	Vlera e ofertuar (lekë pa TVSH)	Statusi	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit
1	M.	15,840,000	Kualifikuar/ fitues	
2	BOE G.	18,900,000	Skualifikuar	Mungon autorizimi për tregtim pajisjesh mjekësore Shtojca 8 është e pa plotë Mungon vërtetim Xhiros nga OE G. Nuk specifikohet që printeri është i integruar Frame Rate është 6667 fps pa specifikuar a është në gjithë modelet e imazhit Ska matje automatike për gjithë strukturat kardiake sipas DT Nuk është specifikuar fushëpamja për imazh panoramik Nuk është specifikuar nëse ka media instalimi të pa varura Të ketë të përfshirë opsioni Softëare për të zbuluar anatominë e dobët të rrjedhjes së gjakut
3	M.	20,700,000	Kualifikuar	
4	P.	20,970,000	Kualifikuar	
5	O.E.S.	22,860,000	Skualifikuar	Printimi është periferik Frekuenca e aparatit te mundësohet afërsisht ne intervalin nga 1 deri me 15 MHz. Pa specifikuar Sonda konvekse thuhet me shume ose baras 30cm fazqe 16 Te mundësoje te paktën një “ frame rate” ne jo me pak se 1,400 fps (Hz) për një rezultat dhe imazh sa me cilesor Faqe 11, 16.56 fps ne 4D. Pa percaktuar Ofertuar faqe 160 është me sistem operimi ëindoës 7 Te shoqërohet me te gjithë programet e nevojshme mbi aplikimet mjekësore sipas kërkesave te operatorit. --Pa përcaktuar Programet / aplikacionet si dhe sistemi operativ duhet te dorëzohet me versionin e tyre te instalimit ne USB apo media ekuivalente. Pa përcaktuar
6	B.	25,227,000	SKualifikuar	‘XC70 Nuk specifikohet printeri terminal i inkorporuar Nuk specifikohen pikat fokale Nuk specifikohen të dhënat për memorien Nuk ka të dhëna për baterinë Nuk specifikohet mbajtësi i xhelit Nuk jepen te dhëna për penetrimin dhe rezolucionin Sistemi ka 2800 fps por pa specifikuar ne cilat kushte i ka Fushëpamja e pa specifikuar Sonda SC1-7H është ne rangun 1.0 - 7.0 MHz Sonda L3-8H ka fushëpamje 38.4 mm Sonda L3-8H operon ne rangun 3.0 - 8.0 MHz XC60 Frame rate për te gjitha mënyrat nuk specifikohet psh 2D arrin 2800 HZ por nuk specifikohet nëse arrihet ne te gjitha modalitetet

				Manuali thotë qe mund te te mbaje bateri 22 ore ne sleep mode por pa specifikuar ne kushte pune Kapacitetet post processing përmenden por te pa specifikuara me detaje Ka mundësi gjenerimi raportesh por nuk percakton kostumizimin e raporteve Katalogu thotë qe është ne ëindoës 10 por pa specifikuar full apo embedded Për sondën konvekse nuk jepen te dhëna për fushëpamjen Katalogu nuk jep te dhëna për fushëpamjen e sondës lineare, sondës kardiake dhe sondës gjinekologjike
7	M.	26,100,000	Skualifikuar	TDI – Tissue doppler imaging, etj ne gjinekologji dhe obstetrike nuk cilësohet nëse e ka funksionalitetin 4D Printeri nuk thuhet qe është i integruar por vetëm qe është supported Nuk jepet rangu i frekuencave v etem thuhet qe mund te ndryshohet kollaj Specifikuar vetëm për 2D Është ofertuar ne total 500GB SSD Nuk thuhet qe mund te printoje por vetëm qe mund te ruaj te dhëna ne cd, dvd dhe memorie te jashtme Te mund te lidhet ne rrjetin spitalor nuk është përcaktuar ne katalog
8	H. & L.	26,757,000	kualifikuar	
9	I.	28,017,000	Skualifikuar	Sigurimi i ofertës date 06.09.2024 Faturat janë për barna dhe materiale mjekësore por jo për pajisje mjekësore Katalogu i pa markuar Nuk ka te dhëna për UPS Ka vetëm një monitor Nuk ka te dhëna për printerin Nuk ka te dhëna për sondat Shume specifikime nuk janë ne katalog
10	B.E.	29,867,472	Skualifikuar	Oferta ekonomike nuk ka te përcaktuar çmimet për sondat siç është përcaktuar ne DT Te mundësoje opsionet e kombinuara si duplex dhe triplex (color-floë) ne kohe reale. Vetëm me PË me puls jo te vijueshëm Te shoqërohet me printer monokrom termik te integruar. OE ka paraqitur printer periferik dhe jo te integruar. Frekuenca e aparatit te mundësohet afërsisht ne intervalin nga 1 deri me 15 MHz. Ne katalog janë disa sonda, sonda e specifikuar L20-5S nuk e kapin brezin 1 dhe 2 por fillojne nga 3 MHZ e lart Te jete e pajisur me opsionet per ekzaminimin Elastografik per gjirin, tiroiden, etj. E ka si opsion STE por pa specifikuar për gjirin dhe teroiden Te ketë te përshirë opsionin e 'softëare' për te zbuluar anatominë e ngadalte dhe te dobët te rrjedhës se gjakut ne inde (vizualizimi i rrjedhës me shpejtësi te ulet ne mikrovaskulaturen e strukturave) e selektuar HR floë e cila është High resolution floë por qe nuk specifikon gjë për anatomine. Te shoqërohet me sonde lineare 2D L14-3Ës
11	B.Ph.	Pa ofertë ekonomike	Skualifikuar	OE nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

Me nr. 3384/76, datë 11.12.2024 në Raportin Përmbledhës, Komisioni i Verifikimit të Ofertave klasifikon si të suksesshme ofertën ekonomike të OE "M." prej 15,840,000 lekë.

- Nisur nga fakti se oferta e paraqitur nga OE është më e ulët se 85 % e mesatares së ofertave të vlefshme. Në sistemin si dhe në dokumentacionin e dosjes nuk ka kërkesë nga AK për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, ka rezultuar se OE ka paraqitur argumentimin e ofertës nëpërmjet shkresës së datës 14.11.2024, e paprotokolluar në MSHMS, ku citohet se "*në përgjigje të kërkesës tuaj në lidhje me ofertën anomalisht të ulët dërguar në SPE datë 12.11.2024 ju lutemi gjeni argumentimin e më poshtëm.....*", duke bashkëlidhur Dokumente të prodhuesit "G. H.C.", CV e stafit teknik, Certifikata EN ISO 14001:2015, EN ISO 45001:2018, PAS 99-2012, Faturat nr. 103/2024, datë 30.01.2024, nr.741/2023, datë 20.06.2023.

Në SPE, si dhe në dokumentacionin e dosjes nuk ka kërkesë nga AK për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

Veprim në kundërshtim me nenin 93 Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku përcaktohet:

1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

dhe me nenin 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. ku përcaktohet:

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.
Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

- OE i shpallur fitues "M." me ofertë prej 15,840,000 lekë, nuk ka plotësuar kriteret e Veçanta për kualifikim pasi në "Pika 2.4.1. -8" Të DST është kërkuar ***"Operatori duhet të paraqesë "Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore", të lëshuar nga MSHMS sipas Ligjit 89/2014 "Për pajisjet mjekësore".*** Në dokumentacionin e paraqitur nga OE i shpallur fitues "M." konstatohet se:
- Autorizimi për tregtim me nr. 3/13, datë 05.12.2023 është më afat deri 31.12.2024, kur kontrata është lidhur Ndërmjet Autoritetit Kontratktor dhe OE "M." marrëveshja kuadër nr. 3384/92 prot., datë 23.12.2024, dhe MiniKontartë nr. 1, datë 24.01.2025. Jashtë afatit të Autorizimit.

Zbatimi i Kontratës:
Me Urdhrin nr. 580, datë 11.11.2024, Titullari i Autoritetit Kontraktor ka krijuar Komisionin për dhënien e kontratave për lot-et e procedurës, të përbërë nga H. T. (jurist), E. H. (inxhinier), E. M. (ekonomist), duke përcaktuar detyrat e komisionit, si dhënien dhe hartimin e minikontratave, hartimin e njoftimit të kontratave të lidhura, dërgimin pranë personave përgjegjës për prokurimin të formularit të njoftimit të nënshkrimit të kontratave.
Me Urdhrit nr. 580, datë 11.11.2024, Titullari i AK ka krijuar Komisionin për ndjekjen e zbatimit të kontratave, të përbërë nga E. L. (kryetar), N. K., B. M. (anëtarë).
Ndërmjet Autoritetit Kontratktor dhe OE "M." është lidhur marrëveshja kuadër nr. 3384/92 prot., datë 23.12.2024, "Blerje pajisje të teknologjisë së lartë për spitalet", ndarë në 10 lot-e - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot) ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj, me fond limit/ vlera e pritshme e kontratave në total prej 259,380,166 lekë pa TVSH. – *Lot 4 "Echo 3D/4D me aplikim te përgjithshëm + sonde lineare + sonde kardiake + sonde konvekse + sonde gjinekologjike", me fond limit 37,356,570 lekë pa TVSH, fondi limit në Euro 372,857 Euro pa TVSH.*
MiniKontartë nr. 1, datë 24.01.2025 "Blerje pajisjesh të teknologjisë së lartë": Lot 4 "Echo 3D/4D me aplikim te përgjithshëm + sonde lineare + sonde kardiake + sonde konvekse + sonde gjinekologjike" Midis Autoritetit Kontraktor "Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale" dhe OE "M." me objekt: "Blerje pajisjesh të teknologjisë së lartë": Lot 4 "Echo 3D/4D me aplikim te përgjithshëm + sonde lineare + sonde kardiake + sonde konvekse + sonde gjinekologjike" dhe vlerë minikontrate 15,840,000 lekë pa TVSH dhe 19,008,000 lekë me TVSH
Komisioni i ngritur me Urdhrin nr. 580, datë 11.11.2024, "Për ndjekjen e zbatimit të kontratave" sipas Proces Verbalit datë 23.05.2025 mbas verifikimit fizik për mallrat e marra në dorëzim nga Spitalet konfirmon se janë dorëzuar pajisjet sipas MiniKontartë nr. 1, datë 24.01.2025 dhe janë bërë hyrje respektivisht në 9 Spitale: SUOGJ Koco Glozheni, Qendra Spitalore Rajonale Berat (Njësia Kuçovë), Shërbimet Spitalore Delvinë, Përmet, Gramsh, Skrapar, Kukës Has, Devoll.

Nga verifikimi fizik në Spitalet Kukës, Përmet dhe Qendra Spitalore Rajonale Berat (Njësia Kuçovë), u konstatua:

Spitali Kukës

Drejtori i Shërbimit Spitalor Kukës ka nxjerrë urdhrin nr. 36, datë 13.03.2025 për marrje në dorëzim të *"Echo 3D/4D me aplikim te përgjithshëm + sonde lineare + sonde kardiake + sonde konvekse + sonde gjinekologjike".* Komisioni i marrjes në dorëzim i përbërje nga A. C, A. Sh dhe N. K. ka mbajtur Procesverbal në datë 19.03.2025 ku cilësohet se Aparati Echo është konform specifikimeve teknike dhe kontratës.

Nga verifikimi fizik i pajisjes u konstatua:

Spitali Përmet

Drejtori i Shërbimit Spitalor Përmet ka nxjerrë urdhrin nr. 18, datë 05.01.2025 për marrje në dorëzim të *"Echo 3D/4D me aplikim te përgjithshëm + sonde lineare + sonde kardiake + sonde konvekse + sonde gjinekologjike".* Komisioni i marrjes në dorëzim i përbërje nga E. R., P.T. dhe M. J. ka mbajtur Procesverbal në datë 17.03.2025 ku cilësohet se Aparati Echo është konform specifikimeve teknike dhe kontratës.

Qendra Spitalore Rajonale Berat (Njësia Kuçovë),

Drejtori i Qendrës Spitalore Berat ka nxjerrë urdhrin nr. 151, datë 18.03.2025 për marrje në dorëzim të *"Echo 3D/4D me aplikim te përgjithshëm + sonde lineare + sonde kardiake + sonde konvekse + sonde gjinekologjike".* Komisioni i marrjes në dorëzim i përbërje nga K. H., F. V. dhe G. Ll. ka mbajtur Procesverbal në datë 18.03.2025 ku cilësohet se Aparati Echo është konform specifikimeve teknike dhe kontratës.

Nga verifikimi fizik i pajisjes në të tre Qendrat Spitalore u konstatua:

- Ka një mos përputhje me sondat e dorëzuara me ato që ka në funksion pajisja referuar manualit teknik pasi: Pajisja sipas karakteristikave teknike është e vlefshme për sondat lexuese 4C-RS; L6-12-RS; 12L-RS;.E8Cs-RS.(Referuar Manualit teknik të dorëzuar me ofertën në pikën 10.37 General System parameters).

Të dorëzuara nga OE janë fizikisht sondat; E8Cs-RS (sondë gjinekologjike); L6-12-RS (Sondë lineare); 3Sc-RS (Sondë kardiake); 4C-RS (sondë konvekse).

- Nuk ka një përshkrim për disponimin të memories brendshme/jashtme me kapacitet 1 TB, ku 128 GB duhet të jenë në formatin SSD, sipas kërkesave në specifikimet teknike.

Nga Komisionin për ndjekjen e zbatimit të kontratave, të përbërë nga E. L., N. K., dhe B.M. nuk ka dokumentacion për këto mos përputhje të konstatuara.

Procedura e prokurimit me objekt 'Blerje aparat ekografie'

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt*: "Blerje aparat Ekografie"* REF-26564-10-28-2024		
1. **Urdhër Prokurimi** Nr. 41, datë 10.10.2024	**2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** Urdhër nr. 387, datë 04.07.2024 P. M. S. M K. P.	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 547, datë 18.10.2024 A. Sh. A. A. E. D.
4. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "E hapur Thjeshtuar"		
5. Fondi Limit: 2,444,444 lekë pa TVSH.	**6. Oferta fituese:** "M. SHPK", me vlerë 2,100,000 lekë pa TVSh.	**7. Diferenca me fondin limit:** 344,444 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 26.11.2024	**9. Burimi i Financimit:** Të Ardhurat Dytësore	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Pjesëmarrës: 4 OE+BOE b) Skualifikuar: 3 OE+BOE c) Kualifikuar: 1 OE

11. Ankimime 2 për DST date 05.11.2024, në KPP dhe AK nga OE "B.E." dhe "H.&L."	12. Përgjigje ankesës nga AK: datë 11.11.2024	13. Përgjigje dhe dërgim Vendimi i KPP datë 14.11.2024

Zhvillimi i procedurës

- Nëpërmjet Urdhrit të Drejtorit K. Sh. nr. 374, datë 20.06.2024, është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën me objekt "Blerje aparat Ekografie" i përbërë na K. N. (Mjek Radiolog), K. Xh. (Teknik Imaxherie) dhe E. K. (specialist i fushës Inxhinier). Grupi i Punës me Procesverbalin datë 26.09.2024 ka përcaktuar specifikimet teknike të detajuara.
- Nëpërmjet Urdhrit të Drejtorit K. Sh. nr. 415, datë 15.07.2024, është ngritur grupi i punës për llogaritjen e vlerës së parashikuar të prokurimit, i përbërë nga M. J. Kryetar (Ekonomist) E. C. (Kryinfermiere) dhe F. Th. (mjeke OBST). Grupi i punës me Procesverbalin datë 07.10.2024 mbështetur në tre oferta ka përcaktuar fondin limit "Për blerje aparat ekografie" për shumën 2,444,444 lekë pa TVSH dhe 2.933,333 lekë me TVSH.

Referuar çmimeve të tregut sipas ofertave të mara te operatoret

Ofertuesit	Pa tysh	Tvsh	Me TVSH
M.SHPK	2,400,000	480.000	2,880,000
A.	2,333,334	466,666	2,800,000
M.SHPK	2,600,000	520,000	3,120,000
Mesatarja	2,444,444	488,889	2,933,333

Me njoftimin e shkurtuar të kontratës nr. 560, datë 28.10.2024 Qendra Socio-Shendetesore Nr.7 është përcaktuar:

- Lloji i procedurës së prokurimit: *E hapur e Thjeshtuar*
- Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: "Blerje aparat EKOGRAFIE me dy sonda"
- Fondi limit: 2,444,444 (dy milion e katërqind e dyzet e katër mije e katërqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH
- Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 1 (Një) Muaj
- Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 11.11.2024 ora. 10.00

Me Urdhër nr. 48, datë 05.11.2024 Titullari i Autoritetit Kontraktor ka pezulluar procedurën e prokurimit për arsye të një ankese. Ankesë e shqyrtuar sipas urdhrit nr. 49, datë 06.11.2024 dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor pas shqyrtimit të ankesës me Vendimin nr.595, datë 11.11.2024 ka bërë modifikimin e DST "specifikime teknike" dhe ka njoftuar (publikuar) me shkresën nr. 614, datë 19.112024. Në lidhje me këtë ankesë ka edhe Vendim të KPP me nr. 1610/2024 datë 14.11.2024.

Vlerësimi i ofertave

Me Urdhër nr. 547, datë 18.10.2024 është ngritur Komisioni për vlerësimin e ofertave i përbërë nga A. Sh., A. A. dhe E. D..

Në datën 26.11.2024 është bërë hapja e ofertave dhe me procesverbal datë 02.12.2024 ka shqyrtuar dhe vlerësuar ofertat e paraqitura si më poshtë:

Nr.	OE	Vlera e ofertuar (lekë pa TVSH)	Statusi	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit
1	M.	2,100,000	Kualifikuar	
2	H. & L.	1,873,380	S'kualifikuar	OE "H. & L." Shpk **nuk plotëson** kriteret e veçanta te kualifikimit Kapaciteti teknik, pika 2.3.10 per specifikimet teknike ne katalogët e paraqitur si me poshtë: Aplikimet qe duhet te ofroje sistemi: Abdominal, Obstetrik, Gjinekologjik, Kardiak, Urologji. Vaskular, pjese me Madhesi te vogel, Pediatri, Mjekesi emergjence.

				Minimumi i modalitetit te skanimit: B, M, THI, PD, PËD, Color Doppler, CË, B Trapezoid, Anatomik M. Sistemi duhet te kete nje kufi dinamik (dynamic range) minimalisht 10-350dB per te arritur te kape dhe analizoje reflektimet e dobeta. Monitori per interpretim te ECHO-s duhet te jete me ngjyra dhe minimalisht 23". Duhet te plotesoje konditat e rezolucionit te larte, qe duhet te jete mbi ose 1920x1080 pixel, standarti HD. Paneli i kontrollit duhet te jete minimalisht 13" dhe komandim me prekje (touch screen) dhe te kete te pakten 2 porta USB. Paisja duhet te kete nje bateri te perfshire per te mundesuar punen ne mungese te energjise elektrike. Echo duhet te punoje minimalisht th ne menyre te vazhduar skanimin ne menyre autonome pa energjie elektrike. Doppler spectral: Frekuenca e perseritjes minimalisht 15 kHz ne PË (pulse doppler) dhe ne regjimin e CË (continues ëave) jo me e vogesl se 50kHz. Sonda konvekse me frekuence pune mbi 2,5 MHz deri ne 6.0 MHz. Fusha e skanimit mbi 70° Pajisja duhet te disponoje hard disk per hapesire ruajtese minimalisht 500 GB dhe minimalisht memorje 30,000 imazhe. Pajisja duhet te suportoje formate per imazhe te tipit JPG, TIFF, ndersa per cine formate te tipit AVI per te mundesuar egzaminime offline.
3	B.E.	1,890,000	S'kualifikuar	OF "B. E." Shpk **nuk plotëson** kriteret e veçanta te kualifikimit Kapaciteti teknik, pika 2.3.10 per specifikimet teknike ne katalogët e paraqitur si me poshtë: - Minimumi i modalitetit te skanimit: B, M, THI, PD, PËD, Color Doppler, CË, B Trapezoid, Anatomik M. - Sistemi duhet te kete nje kufi dinamik (dynamic range) minimalisht 10-350dB per te arritur te kape dhe analizoje reflektimet e dobeta. - Paneli i kontrollit duhet te jete minimalisht 13" dhe komandim me prekje (touch screen) dhe te kete te pakten 2 porta USB. - Doppler spectral: Frekuenca e perseritjes minimalisht 15 kIlz ne PË (pilse doppler) dhe ne regjimin e CË (continues ëave) jo me e vogesl se 50kHz. - Paisja duhet te mundesoje fluks me rezolucion te larte hapsinor per profilizim te sakte te eneve te gjakut. e punimit te sondave duhet te suportoje nga min. 1.5 - 12 MHz. Sonda konvekse me frekuence pune mbi 2,5 MHz deri ne 6.0 MHz. Fusha e skanimit mbi 70°. Frekuenca - Sonda Lineare ne frekunce pune mbi 4 MIlz deri ne 12 MHz. Fusha e pamjes minimalisht 35mm.
4	BOE "G." "A. T."	1,340,000	S'kualifikuar	BOE "G." Shpk & A. T." PF, **nuk ploteson** kriteret e veçanta te kualifikimit si me poshte: BOE "G." Shpk & A. T." PF nuk kane paraqitur oferten ekonomike ne përputhje me LPP 162 dhe VKM 285 pasi rezulton anomalisht e ulet. 1 B.OE nuk ka paraqitur katalogun e perkthyer ne gjuhen shqipe dhe specifikimet teknike nuk perputhen me kërkesat e AK. B.OE nuk plotëson kriteret e veçanta te kualifikimit per pikat 2.3.4; 2.3.5; 3.3.6; 2.3.7. pasi dokumentacioni duhet te paraqitet nga ana e te dy OE si pjese e kontratës se bashkëpunimit mes tyre.

- Autoriteti Kontraktor në datë 05.12.2024 ka shpallur fitues OE "M." me ofertën ekonomike në shumën 2,100,000 lekë pa TVSH, duke s'kualifikuar OE "H.& L.", "B. E." dhe BOE "G."&"A. T.", njëkohësisht datë 06.12.2024 ka publikuar Formularin e njoftimit të fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.
- OE "B. E." ka publikuar në sistemin SPE ankesën datë 11.12.2024 ku parashtron se s'kualifikimi është i pa bazuar dhe AK nuk ka kërkuar sqarime për plotësimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenin 92, pika 1 të ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik". Publikuar në Regjistrin e ankesave APP në datë 12.12.2024 sipas shkresës të KPP me nr. 3609/2, datë 12.12.2024.
- Autoriteti Kontraktor me Vendimin për ankesën nr. A/2024/4876, datë 11.12.2024 me nr. 671, datë 23.12.2024 ka kthyer përgjigje OE "B. E.", për pranimin e pjesshëm të ankesës. Vendimi i marrë shoqërohet me relacion nga Komisioni i Shqyrtimit të ankesës i ngritur me Urdhrin e AK nr. 53, datë 13.12.2024 me përbërje të I. A., E. M. dhe K. P., si dhe me komentet e mjekut Radiolog dr. K. N. datë 18.12.2024.
- Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr. 106/2025 prot, datë 22.01.205 drejtuar OE "B. E." si dhe Qendra Shëndetësore nr. 7 Tiranë është shprehur:

Me shkresën nr. 25 prot., datë 20.01.2025, protokolluar me tonën nr. 3609/9 prot., datë 21.01.2025, autoriteti kontraktor Qendra Shëndetësore Nr.7 Tiranë, lidhur me zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 51/2025, datë 13.01.2025, duke e rivlerësuar ofertën e operatorin ekonomik "B. E. Sh.PK në procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur e Thjeshtuar", me Nr. REF26564-10-28-2024, me objekt "Blerje aparat Ekografie me dy sonda", me fond limit 2,444,444.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 26.11.2024 nga autoriteti kontraktor Qendra Shëndetësore Nr.7 Tiranë.
Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike shtojcës së publikuar në SPE, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor ka rivlerësuar procedurën e prokurimit në përputhje të plotë me përcaktimet e vendimit Nr. 51/2025, datë 13.01.2025.
Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "Për miratimin e rregullave "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,
Vendos
1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit "Procedurë e Hapur e Thjeshtuar", me Nr. REF26564-10-28-2024, me objekt "Blerje aparat Ekografie me dy sonda", me fond limit 2,444,444.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 26.11.2024 nga autoriteti kontraktor Qendra Shëndetësore Nr.7 Tiranë.
Zbatimi i Kontratës:
Me Urdhrin nr. 8, datë 01.02.2025, Titullari i Autoritetit Kontraktor ka urdhëruar administrimin e dokumentacionit dhe lidhjen e kontratës për furnizimin me aparat Ekografie.
Nëpërmjet OE "M." dhe Qendrës Socio-Shëndetësore nr. 7 është lidhur Kontratë për furnizim me mallra nr. 71, datë 07.02.2025 "Për blerje aparat ekografie me dy sonda", nga OE "M." me çmimin e ofertuar prej 2,100,000 lekë pa TVSH.
Me Urdhrin nr. 12, datë 04.03.2025 AK ka krijuar Komisionin për marrjen në dorëzim të Aparaturës së Ekografisë, të përbërë nga F. Th. (Mjek obstetër-Gjinekolog), Z. C. (Mjek Radiolog), E. K. (Inxhinier Bio-mjekësor), M. A. (Infermiere) dhe N. K. (Mjeke), duke përcaktuar detyrat e komisionit.
Me proces verbal datë 05.03.2025 nga Komisioni i ngritur me Urdhrin nr. 12, datë 04.03.2025 është dokumentuar marja në dorëzim dhe administrimin i mallit.
Konkluzion:
- Në lidhje me pretendimin se Qendra Socio-Shëndetësore nr. 7 ka një Aparaturë për kryerjen e ekzaminimeve ekografike. Ndërkohë që e ka një të tillë, por me qëllim blerjen e një aparati tjetër e ka nxjerrë jashtë përdorimit me defekt teknik u konstatua se:
Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore (QKTBM) Sektori i Riparim Mirëmbajtjes me nr. 43 Prot datë 12.04.2024 Lënda: "Relacion për pajisjet mjekësore" i kthen përgjigje Qendrës Socio-Shëndetësore nr. 7 se në vijim të kërkesës nr. prot. 244, datë 08.04.2024, administruar ne QKTBM me nr.prot.43, datë 11.04.2024, ku kërkohet asistencë në lidhje me riparimin e moduleve periferike sonda mbi njësinë imazherike eko ju informojmë si vijon:

Sonda abdominale si dhe ajo e indeve të buta të njësisë imazherike EKO me nr. inv: 25349, prodh: GE, mod: Logiq C-5 nuk funksionojnë. Simptomat fillestare paraqesin mungesë 'output-i si dhe dëmtime fizike të pariparueshme. Rezultatet ekzaminuese evidentojnë dëmtime fizike në lidhje me kabullin dhe konektorët përkatës për secilën sondë si pasojë e aplikimit masiv ndër vite. Komponenti sondë është një modul tepër sensitiv në kompozim në njësitë imazherike eko. Dëmtime të atilla nuk mund të riparohen, Njësia imazherike EKO aktuale nuk pranon komponentë alternative duke dështuar ndjeshëm në fazat testuese. Nuk disponojmë pjesë këmbimi (sonda) për të vijuar më tej me fazat e ndërhyrjes.

- Në lidhje me pretendimin se të gjitha aparaturat mjekësore me vlera të mëdha janë kompetencë zëvendësimi apo prokurimi nga Ministria dhe jo Qendra Shëndetësore. Me presione e kërcënime detyrojnë stafin për firmosjen e dokumenteve të blerjes u konstatua se:

- Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale me nr. 2600/3, datë 10.06.2024 Lënda: "Miratim shpenzimesh nga të ardhurat dytësore" bazuar edhe në kërkesën e Qendrës Socio-Shëndetësore Nr.7, Tiranë me nr. 327 prot., datë 20.05.2024, përcjellë nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Drejtoria Rajonale Tiranë, me shkresën nr. 1497/3, datë 28.05.2024, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Drejtoria Qendrore Tiranë, me shkresën nr. 2047/1 prot., datë 03.06.2024, protokolluar në MSHMS me nr. 2600, datë 05.06.2024, referuar analizës së çmimeve dërguar nga institucioni Qendra Socio-Shëndetësore nr. 7, miratojmë përdorimin e fondit të planifikuar nga të ardhurat dytësore të vitit 2024, si më poshtë: 1. Artikulli 231 (investime), a. Ekografi me sondë konvekse 2D, sondë lineare 2D dhe video printer copë 1 (një) deri në 2,933,333 lekë me TVSH.

Realizimi i procedurës është përgjegjësi e vetë institucionit dhe duhet të jetë konform legjislacionit në fuqi.

- ✓ **Mbi lidhjen dhe zbatimin e kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave/punëve dhe shërbimeve.**

Në zbatim të pikës 4 të Programit të Auditimit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, mbi lidhjen dhe zbatimin e kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave/punëve dhe shërbimeve, sipas kontratave të lidhura me Operatorët ekonomik fitues, u krye auditimi i zbatimit të punimeve në objektet:

1. Ndërtimi i godinës së re të laboratorëve në ISHP.

A. Të dhëna mbi objektin

<table>
<tr><td colspan="6">Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Ndërtimi i godinës së re të laboratorëve në ISHP".</td></tr>
<tr><td colspan="2">14.Lidhja e kontratës
Nr. 1013 prot., datë 10.10.2023</td><td colspan="2">15.Vlera e kontratës (me TVSH)
403,151,919 lekë
BOE fitues "A. C." SHPK & "K." SHPK</td><td colspan="2">16.Likuiduar</td></tr>
<tr><td colspan="2">17- Situacioni Përfundimtar</td><td colspan="2">18.Afati i kontratës në ditë
Parashikuar 480 ditë, Zbatuar në proces
Fillimi punimeve: 25.03.2024
Përfundimi punimeve :</td><td colspan="2">19. Zgjatja e kontratës</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve
OE "A." SHPK</td><td>Licenca Nr. MK. 1865/13</td><td>Kontrata me nr. 825/5 prot., datë 30.10.2023</td><td>Likuiduar</td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve</td><td>Licenca Nr:</td><td></td><td></td><td colspan="2"></td></tr>
</table>

22.Akt Kolaudimi	23.Certifikata e përfundimit të punimeve	

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 1013 prot., datë 10.10.2023, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Instituti i Shëndetit Publik, të përfaqësuar nga Drejtori znj.E. T. dhe Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "A. C." SHPK & "K." SHPK, me përfaqësues ligjor respektiv z.P. P. dhe z.S. K..

Vlera e kontratës me objekt "Ndërtimi i godinës së re të laboratorëve në ISHP" është 342,831,733 lekë pa TVSH / 403,151,919 lekë me TVSH.

Afati i zbatimit të kësaj kontrate është 16 muaj, nga fillimi i punimeve.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr.825/5 prot., datë 30.10.2023, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi OE "A." SHPK, vlera e kontratës është 3,319,500 lekë pa TVSH / 3,983,400 lekë me TVSH, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1865/13.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt është dhënë leja e ndërtimit me nr. 646/4, datë 29.02.2024, sipas Vendimit nr. 11 datë 25.04.2023 të KKT.
- Projekt Preventivi është hartuar nga shoqëria projektuese "A.-A." SHPK & "A." SHPK.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 25.03.2024, duhet të përfundojnë në datën 24.07.2025.

Mbikëqyrësi i punimeve me shkresat nr. 64 prot., datë 03.04.2024, nr.290 prot., datë 03.04.2024, nr.339 prot., datë 11.12.2024, nr.405 prot., datë 16.06.2025 si dhe duke marrë në konsideratë kërkesave të AK me shkresën nr.262 prot., datë 20.02.2025, janë evidentuar të gjitha mangësitë dhe përmirësimet e projekteve të cilat janë evidentuar në rishikim dhe disa do evidentohen në rishikimin përfundimtar.

Konstatim: Në librezën e masave nr.11 janë evidentuar se në punimet e suvatimeve për fasadën e ventiluar, janë certifikuar si nën zëra në libreza masash në kategorinë 1.13.4, respektivisht nën zërat si më poshtë:

- an. Veshje fasade me lesh guri 5cm , 125 kg/m3, λ=0,035 Ë/m*K, sasia 1,061.42 m2;
- nr. anal. 2.346 Suva fasade me teranove çimento te bardhe h > 8m, sasia 1,601.51 m2;
- nr. anal. 2.328/1 Patinim muri me stuko, sasia 1,601.51 m2;
- nr. anal. 2.308/a Suvatim me grafiato h > 4 m, sasia 1,452.11 m2.

Punimet e sipërcituara janë realizuar dhe certifikuar në libreza masash por nuk ishin miratuar ende nga AK, pasi preventivi i rishikuar nr.2 ende nuk është miratuar, në kundërshtim me pikën 7.1, Kreu I, të Udhëzimit nr.2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", ku cilësohet: "…Sipërmarrësi është i detyruar të zbatojë çdo ndryshim të urdhëruar me shkrim nga investitori ose persona të autorizuar prej tij, që nuk ndryshon, në thelb, kushtet kryesore të projektit, të kontratës dhe nuk rrit vleftën e saj...", dhe në kundërshtim me pikën 2.1, Kreu II, të Udhëzimit nr.2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", ku cilësohet:. "...2.1 Drejtori i punimeve njofton menjëherë mbikëqyrësin e punimeve për pasaktësitë, mospërputhjet, mungesat e të dhënave në vizatimet, përshkrimet e specifikimet teknike, paraqet propozimet e veta dhe pret udhëzimet e tij...".

Konstatim: Nga auditimi në terren u konstatua se ulluqet e shkarkimit vertikal ishin realizuar me ulluqe PVC dhe jo bakri siç është në preventiv.

Nga grupi i auditimit nuk u verifikuan specifikimet e ashensorit pasi duke qenë se objekti është në ndërtim rezultuan të mbyllura.
- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacioni nr.11,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.
Nga auditimi i situacionit nr.11, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 2,093,076 lekë pa TVSH.

Tabela nr. 1

Nr		**Zëri i punimeve**	**Njësia**	**Çmimi i ofertës**	**Situacioni nr.11**	**Libri i masave**	**Fakti**	**Diferenca në +**	
								Vol.	Vlera
	1.14	Punime dyer dritare							
1.14.3	2.273/1	Shtrese pllaka mermeri t = 25 mm,b=55cm për parmak dritare	m2	6,000	33	33.66	24.26	8.74	52,400
	4.2	Instalimet e kanalizimeve							
4.2.2	2.15	Gërmim e mbushje dheu me krah për kanale i Kategorisë III, për hapjen e kanalit për tubin e kanalizimeve me thellësi h=3.0 m, b=0.6 m	m³	700	2,891.90	2,891.90	2,891.90	2,891.90	2,024,330
	3.98/a	Gërmim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në mjet	m³	285.16			2,891.90	-2,891.90	-824,654.2
	2.10.11	Ndriçimi i Jashtëm							

2.10.11.1	An	Shtylla elektrike e vetme konike prej metali të galvanizuar me lartësi h = 6m, diametër D = 193mm / d = 60mm, trashësia e shtyllës ëalPl është s = 4mm.	copë	15,000	14	14	0	14	210,000
2.10.11.2	An	Shtylla elektrike e dyfishtë konike prej metali të galvanizuar me lartësi h = 6m, diametër D = 193mm / d = 60mm, trashësia e shtyllës ëalPl është s = 4mm.	copë	15,000	2	2	0	2	30,000
2.10.11.3	An	Mbulesa e terminalit lidhës të shtyllës prej materiali alumini, e cila duhet të ketë shkallë mbrojtjeje IP54	copë	15,000	16	16	0	16	240,000
2.10.11.4	An.	Termina lidhëse kabllore me izolim të dyfishtë me shkallë hapjeje të perimetrit të mbrojtjes IP43 dhe shkallë të mbrojtjes së përçuesve IP23	copë	15,000	16	16	0	16	240,000
2.10.11.6	An.	Kabllo energjie Kabell NYY -J 4X4mm²,	m	350	260	260	0	260	91,000

2.10.11.7	An.	Kabllo energjie Kabell NYY -J 4X1.5mm²,	m	200	150	150	0	150	30,000
		Total							**2,093,076**

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

1. Zëri 1.14.3. Shtrese pllaka mermeri t = 25 mm,b=55cm për parmak dritare. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin nr.11 sasia e këtij zëri pune është 33 m2 dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 33.66 m2. Nga auditimi në terren rezultoi se davancialet e dritareve dhe në pjesët që i përkisnin vetratave rezultoi se gjerësia e tyre ishte 15 cm dhe jo 22 cm sa është llogaritur në libreza masash, nga rillogaritja e këtij zëri pune rezulton se sasia 24.26 m2. Për këtë arsye, sipërfaqja e këtij zëri pune është 8.74 m2 më pak se sipërfaqja e situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
2. Zëri 4.2.2. Gërmim e mbushje dheu me krah për kanale i Kategorisë III, për hapjen e kanalit për tubin e kanalizimeve me thellësi h=3.0 m, b=0.6 m. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 2,891.90 m3. Referuar dokumentacionit fotografik pjesë e dosjes së zbatimit dhe referuar lartësisë së madhe të kanalit ky gërmim është realizuar me eskavator me zingjir. Ky zë pune duhet të llogaritet me An. 3.98/a Gërmim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk. në mjet me çmim 285.16 lekë/m3. Për këtë arsye, çmimi i këtij zëri pune është 414.84 lekë/m3 më pak se çmimi i ofertuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
3. Zërat e Ndriçimit të jashtëm. Në preventivin e rishikuar, situacionin nr.11 dhe librezat e masave rezultojnë të jenë situacionuar punimet e ndriçimit të jashtëm, i cili përfshin shtyllat e ndriçimit, mbulesa e terminalit lidhës të shtyllës, termina lidhëse kabllore, kabllo energjie dhe tub PVC. Por nga auditimi në terren rezultoi se ishte vendosur vetëm tuba PVC dhe nuk ishin vendosur shtyllat bashkë me elementët e saj dhe kabujt. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se i janë likuiduar tepër në vlerën 2,093,076 lekë pa TVSH sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

2. Loti 1 Rikonstruksioni i disa QSH-ve në qarqet Tiranë dhe Durrës.

Për zbatimin e punimeve e nën objektit:
1- Rikonstruksioni i QSH Paskuqan 2, Kamëz.
B. Të dhëna mbi objektin

Zbatimi i Punimeve të objektit "Rikonstruksioni i QSH Paskuqan 2"		
14.Lidhja e kontratës Nr.1592/19 prot., datë 11.07.2023	15.Vlera e kontratës (me TVSH) 48,533,724 lekë BOE fitues "Z." SHPK & "I. G." SHPK Për objektin QSH Paskuqan 2: 6,452,000 lekë	16.Likuiduar deri datë 19.07.2024 USH. Nr.348&349 për pagesën e situacioneve me vlerë 10,287,293 dhe 8,,233,726 lekë.
17- Situacioni Përfundimtar Vlera me TVSH 6,950,490 lekë Vlera pa TVSH 5,891,742 lekë	18.Afati i kontratës në ditë Parashikuar 172 ditë, Zbatuar 164 ditë. Fillimi punimeve: 11.09.2023 Përfundimi punimeve : 22.02.2024	19. Zgjatja e kontratës Amendamenti nr.1, shkresa nr.1066 prot., datë 26.02.2024.

			Amendamenti nr.2, shkresa nr.520/7 prot., datë 29.03.2024.	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "N. S." SHPK	Licenca Nr: MK.1846/7	Kontrata me nr.2615/11 prot., datë 28.08.2023		
21. Kolaudatori i punimeve OE "R." SHPK	Licenca Nr: MK.1506/11	Kontrata me nr. 934/22 prot., datë 02.05.2024		
22.Akt Kolaudimi Datë 21.06.2024	23.Certifikata e përfundimit të punimeve datë 21.06.2024			

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr.1592/19 prot., datë 11.07.2022, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të përfaqësuar nga titullari znj.M.K. dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik "Z." SHPK & "I. G" SHPK, me përfaqësues ligjor z. Z. Z.

Vlera e kontratës me objekt "Loti 1 Rikonstruksioni i disa QSH-ve në qarqet Tiranë dhe Durrës" është 40,444,770 lekë pa TVSH / 48,533,724 lekë me TVSH.

Objekti QSH Paskuqan 2, vlera e kontratës 5,376,667 lekë pa TVSH / 6,452,000 lekë me TVSH, punimet do kryhen nga OE "Z." SHPK.

Afati i zbatimit të kësaj kontrate është 172 ditë nga fillimi i punimeve (për objektin e parë).

Amendamenti nr.1, shkresa nr.1066 prot., datë 26.02.2024, për zgjatjen e afatit të kontratës me nr.1592/19 prot., datë 11.07.2024, lidhur midis MSHMS, të përfaqësuar nga Titullari znj.S. H. Bashkimit të Operatorëve Ekonomik "Z." SHPK & "I. G" SHPK, për objektin qendra shëndetësore Ambulanca Kurcaj në Krujë, afati i zbatimit të punimeve zgjatet me 20 ditë, pasi për objektin Ambulanca Kurcaj gjatë realizimit të punimeve kishte rrëshqitje dheu dhe u realizuan punime përforcimi shtesë.

Amendamenti nr.2, shkresa nr.520/7 prot., datë 29.03.2024, për zgjatjen e afatit të kontratës me nr.1592/19 prot., datë 11.07.2024, lidhur midis MSHMS, të përfaqësuar nga Titullari znj.S. H. Bashkimit të Operatorëve Ekonomik "Z." SHPK & "I. G." SHPK, për objektin Qendra Shëndetësorë nr.8, pika 1 Tiranë, afati i zbatimit të punimeve zgjatet me 44 ditë, pasi për objektin Qendra Shëndetësorë nr.8, pika 1 ka patur vonesa në fillimin e punimeve për arsye se QSH ishte e zënë nga pronarët e truallit

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr.2615/11 prot., datë 28.08.2023, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi OE "N. S.", SHPK vlera e kontratës është 525,375 lekë pa TVSH / 630,450 lekë me TVSH.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr.934/22 prot., datë 02.05.2024, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi OE "R." SHPK, vlera e kontratës është 26,422.2 lekë pa TVSH / 31,706.64 lekë me TVSH, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1506/11.

Proces verbal kolaudimi është mbajtur më datë 21.06.2024, midis përfaqësuesve të Kontraktorit të punimeve, Mbikëqyrësit të punimeve dhe kolaudatorit të punimeve.

Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit me datë 21.06.2024, e nënshkruar nga përfaqësuesit e sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, përfaqësues të Investitorit nga komisioni i marrjes në dorëzim të Investimit i përbërë nga z. D. Z., znj.A. B., dhe znj.L. C.

Projektpreventivi

- Njësia administrative Paskuqan me shkresën nr.2061/2 prot., datë 24.07.2023, ka sjellë përgjigje OE që punimet kryhen pa leje ndërtimi dhe deklaratë paraprake, sipas VKM nr. 457 datë 29.06.2022, pasi janë riparime të brendshme dhe të jashtme.
- Projekt Preventivi është hartuar nga shoqëria projektuese "T." SHPK, Janar 2023.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 11.09.2023, duhet të përfundonin në datën 10.03.2024 dhe kanë përfunduar me datë 22.02.2024, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentet e kontratës.

Me shkresën nr.14 prot., datë 29.01.2024, mbikëqyrësi i punimeve ka kërkuar miratimin e ndryshimeve të volumeve, pas rishikimit të projektit.

Me proces verbalin mbi përdorimin e fondit rezervë mbajtur me 28.09.2024, miratohet ndryshimet në volume të cilat do mbulohen nga fondi rezervë me vlerë punimesh që shtohen 1,721,958 lekë pa TVSH për total kontratën, dhe për objektin QSH Paskuqan 2 shtohet shuma 350,416 lekë pa TVSH, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, Mbikëqyrësi i punimeve dhe Sipërmarrësi i punimeve.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 162,600 lekë pa TVSH.

Tabela nr. 2

Nr		**Zëri i punimeve**	**Njësia**	**Çmimi i ofertës**	**Situacioni përfundimtar**	**Libri i masave**	**Fakti**	**Diferenca në +**	
								Vol.	Vlera
		Punime suvatimi, veshje bojatisje							
6	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle h-8m	m²	600	271	271	0	271	162,600
		Total							162,600

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

1. Zëri. Suva e zakonshme fasade mur tulle h-8m. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 271 m2.

Referuar preventivit të punimeve zëri 8 ne punime suvatimi, dhe auditimit në terren fasada e jashtme është realizuar me veshje me polisterol dhe suva grafiato (sistem kapot).

Nr.			PUNTORI			TRANSPORT			MAKINERI			MATERIAL				Shp	Fitim	
	EMERTIMI	Njesia	op	çmimi	Vlefta	T*km	çmimi	Vlefta	o.p	çmimi	Vlefta	Sasia	çmimi	Vlefta	Shuma	pl		TOTALI
Kodi																8%	10%	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19
2.358/b	Veshje fasade me polisterol jeshil t=5cm + rrjete + suva.	m2																
	Sp + p	op	5.80	185.00	1,073.00													
	Sigurime shoqerore 16.7%	leke	1,073.00	0.17	179.19													
	Transport	T*km				0.95	21.00	19.95										
	Elektro argano	op							0.35	45.00	15.75							
	Trapano	op							0.18	95.00	17.10							
	Polisterol kompakt jeshil 5cm	m2										0.05	9,050.00	452.50				
	Kolle per ngjitje	kg										4.00	25.00	100.00				
	Upa betoni plastike	cope										9.00	22.00	198.00				
	Rrjete plastike	m2										1.10	80.00	88.00				
	Grafiato per suva	kg										5.00	25.00	125.00				
	Skele inventar	m2										1.25	130.00	162.50				
	Shuma :				1,252.19			19.95			32.85			1,126.00	2,430.99	194.48	243.10	2,868.57

Referuar An.2.358/b sipas VKM nr. 629, datë 15.7.2015, "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", i ndryshuar, suvaja kryhet me grafiato e gatshme për suva, për rrjedhojë suvatimi është realizuar me grafiato gjatë ndërtimit të sistemit kapot dhe nuk ka nevojë për suvatim shtesë. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se i janë likuiduar tepër në vlerën 162,600 lekë pa TVSH sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

3. Loti 2 Rikonstruksioni i disa QSH-ve në Qarqet Berat, Korçë dhe Elbasan.
Për zbatimin e punimeve e nën objekteve:
1- Rikonstruksioni i QSH Maliq;
2- Rikonstruksioni i QSH Roshnik.
C. Të dhëna mbi objektin

Zbatimi i Punimeve të objektit "Rikonstruksioni i QSH Maliq".				
14.Lidhja e kontratës Nr. 1592/20 prot., datë 11.07.2024	15.Vlera e kontratës (me TVSH) 56,818,616 lekë OE fitues "C." SHPK Nënobjekti-1: 10,502,245 lekë;		16.Likuiduar deri datë 10.12.2024 USH. Nr.708 për pagesën e situacionit përfundimtar me vlerë 9,624,024 lekë.	
17- Situacioni Përfundimtar Nën objekti: Vlera me TVSH 13,601,030 lekë Vlera pa TVSH 11,409,942 lekë	18.Afati i kontratës në ditë Parashikuar 180 ditë, Zbatuar 201 ditë Fillimi punimeve: 01.11.2023 Përfundimi punimeve :20.05.2024		19. Zgjatja e kontratës	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "P. C." SHPK	Licenca Nr. MK.	Kontrata me nr. 3108/17 prot., datë 18.10.2023		
21. Kolaudatori i punimeve OE "R." SHPK	Licenca Nr: MK.....	Kontrata me nr. 934/21 prot., datë 02.05.2024		
22.Akt Kolaudimi 02.07.2024	23.Certifikata e përfundimit të punimeve 03.07.2024			

D. Të dhëna mbi objektin

Zbatimi i Punimeve të objektit "Rikonstruksioni i QSH Roshnik".		
14.Lidhja e kontratës Nr. 1592/20 prot., datë 11.07.2024	15.Vlera e kontratës (me TVSH) 56,818,616 lekë OE fitues "C." SHPK Nënobjekti-2: 6,736,001 lekë;	16.Likuiduar deri datë 10.12.2024 USH. Nr.708 për pagesën e situacionit përfundimtar me vlerë 9,624,024 lekë.
17- Situacioni Përfundimtar Nën objekti: Vlera me TVSH 5,618,615 lekë Vlera pa TVSH 4,742,846 lekë	18.Afati i kontratës në ditë Parashikuar 180 ditë, Zbatuar 180 ditë Fillimi punimeve: 01.11.2023 Përfundimi punimeve :29.04.2024	19. Zgjatja e kontratës

20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "P. C." SHPK	Licenca Nr. MK.	Kontrata me nr. 3108/17 prot., datë 18.10.2023		
21. Kolaudatori i punimeve OE "R. " SHPK	Licenca Nr: MK.....	Kontrata me nr. 934/21 prot., datë 02.05.2024		
22.Akt Kolaudimi 02.07.2024	23.Certifikata e përfundimit të punimeve 03.07.2024			

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 1592/20 prot., datë 11.07.2023, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të përfaqësuar nga Titullari znj.M.K. dhe Operatorit Ekonomik "C." SHPK, me përfaqësues ligjor z.H. L..
Vlera e kontratës me objekt "Loti 2 Rikonstruksioni i disa QSH-ve në Qarqet Berat, Korçë dhe Elbasan" është 56,818,616 lekë pa TVSH / 47,348,847 lekë me TVSH.
Afati i zbatimit të kësaj kontrate është 180 ditë, nga fillimi i punimeve.
Me shkresën nr.50 prot., datë 08.04.2024 dhe nr.63 prot., datë 12.04.2024, Mbikëqyrësi i punimeve ka kërkuar zgjatjen e afatit të punimeve por nuk janë marrë në konsideratë nga AK.
Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr.3108/17 prot., datë 18.10.2023, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi OE "P. C." SHPK, vlera e kontratës është 614,313 lekë pa TVSH / 737,176 lekë me TVSH, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0899/19.
Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr.934/21 prot., datë 02.05.2024, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi OE "R." SHPK, vlera e kontratës është 20,164 lekë pa TVSH / 24,197 lekë me TVSH, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1506/11.
Proces verbal kolaudimi është mbajtur më datë 02.07.2024, midis përfaqësuesve të Kontraktorit të punimeve, Mbikëqyrësit të punimeve dhe kolaudatorit të punimeve.
"Rikonstruksioni i QSH Maliq".
Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit me datë 03.07.2024, e nënshkruar nga përfaqësuesit e sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, përfaqësues të Investitorit nga komisioni i marrjes në dorëzim të Investimit i përbërë nga znj. E. D., z.A. G. dhe znj.I. P.
"Rikonstruksioni i QSH Roshnik".
Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit me datë 03.07.2024, e nënshkruar nga përfaqësuesit e sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, përfaqësues të Investitorit nga komisioni i marrjes në dorëzim të Investimit i përbërë nga z.A. H., znj.L. C. dhe znj.D. C.
Projektpreventivi
- Në dosjen e zbatimit nuk administrohet autorizim për kryerjen e punimeve.
- Projekt Preventivi është hartuar nga shoqëria projektuese "T." SHPK.
Zbatimi i punimeve
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se për objektin Rikonstruksioni i QSH Maliq punimet kanë nisur me datë 15.12.2023 dhe kanë përfunduar me datë 20.05.2024,
jashtë afatit të kontratës, për të cilin është mbajtur penalitet 60,018 lekë.
Për nën objektin "Rikonstruksioni i QSH Roshnik" punimet kanë nisur me datë 15.11.2023 dhe kanë përfunduar me datë 29.04.2024 ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

Me shkresën nr.33 Prot., datë 27.02.2024, mbikëqyrësi i punimeve ka kërkuar rishikimin e projekt-preventivit dhe miratim ndryshimesh nga projekt preventivi dhe përdorimin e fondit rezervë. Preventivi i rishikuar, ka punime që shtohen dhe punime që zbriten por pa rritur vlerën e kontratës.
- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.
Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 525,600 lekë pa TVSH.
"Rikonstruksioni i QSH Maliq".
Tabela nr. 3

Nr		**Zëri i punimeve**	**Njësia**	**Çmimi i ofertës**	**Situacioni përfundimtar**	**Libri i masave**	**Fakti**	**Diferenca në +**	
								Vol.	Vlera
	5	Punime suvatimi, veshje bojatisje							
9	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle h-8m	m²	800	383	383	0	383	306,400
		Total							306,400

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:
1. Zëri Suva e zakonshme fasade mur tulle h-8m. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 383 m2.
Referuar preventivit të punimeve zëri 8 ne punime suvatimi, dhe auditimit në terren fasada e jashtme është realizuar me veshje me polisterol dhe suva grafiato (sistem kapot).
Referuar An.2.358/c sipas VKM nr. 629, datë 15.7.2015, "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", i ndryshuar, suvaja kryhet me grafiato e gatshme për suva, për rrjedhojë suvatimi është realizuar me grafiato gjatë ndërtimit të sistemit kapot dhe nuk ka nevojë për suvatim shtesë. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

"Rikonstruksioni i QSH Roshnik".
Tabela nr. 4

Nr		Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
								Vol.	Vlera
	4	Punime suvatimi, veshje bojatisje							
11	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle h-8m	m²	800	233	233	0	233	186,400
	E-6	Sistemi i data dhe telefonisë							

1	An.	F.V. Priza interneti, tip RJ-45 FTP-Cat.6	copë	400	7	7	0	7	2,800
2	An.	F.V. Priza telefonie, tip RJ-11 FTP-Cat.6	copë	400	7	7	0	7	2,800
3	An.	F.V. Kuti, suporte, kapak, 3 module	copë	100	7	7	0	7	700
4	An.	F.V. Kabllo rrjeti, tip F/FTP-Cat.6, 350Mhz deri në 400Mhz, LSZH rezistent ndaj zjarrit	ml	120	200	200	0	200	24,000
5	480/3	F.V. Tub plastmasi Ø22-26mm	Ml	25	100	100	0	100	2,500
		Total							219,200

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

1. Zëri Suva e zakonshme fasade mur tulle h-8m. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 233m2.

Referuar preventivit të punimeve zëri 10 ne punime suvatimi, dhe auditimit në terren fasada e jashtme është realizuar me veshje me polisterol dhe suva grafiato (sistem kapot).

Referuar An.2.358/c sipas VKM nr. 629, datë 15.7.2015, "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", i ndryshuar, suvaja kryhet me grafiato e gatshme për suva, për rrjedhojë suvatimi është realizuar me grafiato gjatë ndërtimit të sistemit kapot dhe nuk ka nevojë për suvatim shtesë. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

2. Zërat e kapitullit E-6 Sistemi i data dhe telefonisë. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave rezultojnë të jenë situacionuar sistemi i data dhe telefonisë i cili përfshin priza, kuti, kabllo dhe tub plastmasi. Por nga auditimi në terren rezultoi se ky sistem është realizuar me ëifi. Për pasojë, zërat e këtij kapitulli janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se i janë likuiduar tepër në vlerën 525,600 lekë pa TVSH sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

4. Loti 3 Rikonstruksioni i disa QSH-ve në qarqet Shkodër, Kukës, Lezhë dhe Dibër.

Për zbatimin e punimeve e nën objektit:

1- Rikonstruksioni i QSH Velipojë.

E. Të dhëna mbi objektin

Zbatimi i Punimeve të objektit "Rikonstruksioni i QSH Velipojë"		
14.Lidhja e kontratës Nr.1592/21 prot., datë 11.07.2023	15.Vlera e kontratës (me TVSH) 85,061,516 lekë OE fitues "C." SHPK Për objektin QSH Velipojë: 17,032,473 lekë	16.Likuiduar deri datë 18.12.2024 USH. Nr.764 për pagesën e pjesës së mbetur të situacionit me vlerë 529,055 lekë.
17- Situacioni Përfundimtar	18.Afati i kontratës në ditë	19. Zgjatja e kontratës

Vlera me TVSH 16,204,808 lekë Vlera pa TVSH 13,953,556 lekë	Parashikuar 195 ditë, Zbatuar 193 ditë. Fillimi punimeve: 12.01.2024 Përfundimi punimeve : 24.07.2024			
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "M." SHPK	Licenca Nr: MK.....	Kontrata me nr.3108/32 prot., datë 15.12.2023		
21. Kolaudatori i punimeve OE "2. S" SHPK	Licenca Nr: MK.....	Kontrata me nr. 934/19 prot., datë 24.04.2024		
22.Akt Kolaudimi Datë 06.09.2024	23.Certifikata e përfundimit të punimeve datë 09.10.2024			

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr.1592/21 prot., datë 11.07.2022, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të përfaqësuar nga titullari zj.M.K. dhe Operatorit Ekonomik "C." SHPK, me përfaqësues ligjor z.A K.

Vlera e kontratës me objekt "Loti 3 Rikonstruksioni i disa QSH-ve në qarqet Shkodër, Kukës, Lezhë dhe Dibër" është 70,884,597 lekë pa TVSH / 85,061,516 lekë me TVSH.

Objekti QSH Velipoje, vlera e kontratës 14,466,702 lekë pa TVSH / 17,032,473 lekë me TVSH.

Afati i zbatimit të kësaj kontrate është 195 ditë nga fillimi i punimeve (për objektin e parë).

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr.3108/32 prot., datë 15.12.2023, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi OE "M." SHPK vlera e kontratës është 822,005 lekë pa TVSH / 986,406 lekë me TVSH.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr.934/19 prot., datë 24.04.2024, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi OE "2.S. Studio" SHPK, vlera e kontratës është 20,979 lekë pa TVSH / 25,175 lekë me TVSH, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. .....

Proces verbal kolaudimi është mbajtur më datë 06.09.2024, midis përfaqësuesve të Kontraktorit të punimeve, Mbikëqyrësit të punimeve dhe kolaudatorit të punimeve.

Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit me datë 09.10.2024, e nënshkruar nga përfaqësuesit e sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, përfaqësues të Investitorit nga komisioni i marrjes në dorëzim të Investimit i përbërë nga z. Sh. G., z.B. N., dhe znj.V. L.

Projektpreventivi

- Bashkia Shkodër me shkresën nr.1286/1 prot., datë 18.08.2023, ka sjellë përgjigje NJVKSH Shkodër që punimet kryhen pa leje ndërtimi dhe deklaratë paraprake, sipas nenit 6 të VKM nr. 408 datë 13.05.2015, pasi janë riparime të brendshme dhe të jashtme.
- Projekt Preventivi është hartuar nga shoqëria projektuese "I." SHPK, 2022.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 23.01.2024 dhe kanë përfunduar me datë 24.07.2024, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentet e kontratës.

Me shkresën nr.60 prot., datë 02.05.2024, mbikëqyrësi i punimeve ka kërkuar miratimin e ndryshimeve të volumeve, pas rishikimit të projektit.

Me proces verbalin e punimeve që shtohen dhe hiqen mbajtur me 02.05.2024, miratohet ndryshimet në volume të cilat do mbulohen nga fondi rezervë me vlerë punimesh që shtohen 3,058,769 lekë pa TVSH për total kontratën, dhe për objektin QSH Velipojë zbritet shuma 94,588 lekë pa TVSH, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, Mbikëqyrësi i punimeve dhe Sipërmarrësi i punimeve.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 486,085 lekë pa TVSH.

Tabela nr. 5

Nr		**Zëri i punimeve**	**Njësia**	**Çmimi i ofertës**	**Situacioni përfundimtar**	**Libri i masave**	**Fakti**	**Diferenca në +**	
								Vol.	Vlera
	V	Punime suvatimi, veshje e bojatisje							
4	2.358/b	Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5cm + rrjetë+ suva	m²	2,227	305	305	305		
		Diferenca polisterol i zakonshëm – polisterol jeshil	m²	212			305	305	64,660
		Pajisjet							
		Rrjeti kompjuterik & CCTV							
1.1	An.	F. Kamera IP Dome 5 MP, Lente fikse 2.8mm, IR (30m) IP 66	copë	10,100	3	3	3		
		Diferenca çmimi kamera sipas preventivit të rishikuar – kamera sipas preventivit fitues	copë	3,725			3	3	11,175
2.1	An.	F. Kamera IP Bullet 5 MP, Lente fikse 2.8mm, IR (30m) IP 66	copë	13,000	8	8	8		
		Diferenca çmimi kamera sipas preventivit të rishikuar – kamera sipas preventivit fitues	copë	6,250			8	8	50,000
6.1	An.	F. Monitor LED, 22”, Full HD, HDMI/VGA	copë	25,000	1	1	1		
		Diferenca çmimi monitor sipas preventivit të rishikuar – monitor	copë	24,250			1	1	24,250

		sipas preventivit fitues							
		Pajisjet hidrosanitare dhe mekanike							
13	Ofertë	Furnizim kondicionerë 12 BTU	copë	112,500	16	16	16		
		Diferenca kondicioner oferte – kondicioner dhe kompresor sipas preventivit fitues	copë	21,000			16	16	336,000
		Total							486,085

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

1. Zëri Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5cm+rrjetë+suva. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 305 m2. Nga auditimi në terren rezultoi se ky zë pune është realizuar me polisterol të bardhë dhe jo jeshil, referuar Manualit të çmimeve nr.2, zëri 2.358/b Polisterol kompakt jeshil 5cm është 452.5 lekë/m2, ndërsa zëri 2.358/b Polisterol i zakonshëm 5cm është 180 lekë/m2. Pra diferenca është 272.5 lekë/m2, duke marrë në konsideratë që çmimi i ofertuar është aplikuar një zbritje rreth 22%, diferenca e përfituar padrejtësisht nga kontraktori sipas rillogaritjes së këtij zëri pune rezulton 212 lekë/m2. Për pasojë, çmim 212 lekë/m2 i këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
2. Zëri F. Kamera IP Dome 5 MP, Lente fikse 2.8mm, IR (30m) IP 66. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 3 copë. Për këtë zë është rishikuar çmimi në preventivin e rishikuar dhe është caktuar çmimi i ri 10,100 lekë/copë, por referuar specifikimeve të zërin dhe në analizën respektive shoqëruese në dokumentacionit e preventivit të ndryshuar, nuk ndryshon asnjë specifikë e kamerave ose nuk ka analizuar pse ka ardhur ky ndryshim. Çmimi referuar zërit në preventivin fitues është 6,375 lekë. Pra diferenca është 3,725 lekë/copë, nuk është e justifikuar duke rritur kështu vlerën e kontratës. Për pasojë, çmim 3,725 lekë/copë i këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
3. Zëri F. Kamera IP Bullet 5 MP, Lente fikse 2.8mm, IR (30m) IP 66. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 8 copë. Për këtë zë është rishikuar çmimi në preventivin e rishikuar dhe është caktuar çmimi i ri 13,000 lekë/copë, por referuar specifikimeve të zërin dhe në analizën respektive shoqëruese në dokumentacionit e preventivit të ndryshuar, nuk ndryshon asnjë specifikë e kamerave ose nuk ka analizuar pse ka ardhur ky ndryshim. Çmimi referuar zërit në preventivin fitues është 6,750 lekë. Pra diferenca është 6,250 lekë/copë, nuk është e justifikuar duke rritur kështu vlerën e kontratës. Për pasojë, çmim 6,250 lekë/copë i këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
4. Zëri F. Monitor LED, 22", Full HD, HDMI/VGA. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 1 copë. Për këtë zë është rishikuar çmimi në preventivin e rishikuar dhe është caktuar çmimi i ri 25,000 lekë/copë, por referuar specifikimeve të zërin dhe në analizën respektive shoqëruese në dokumentacionit e preventivit të ndryshuar, nuk ndryshon asnjë specifikë e monitorit ose nuk ka analizuar pse ka ardhur ky ndryshim. Çmimi referuar zërit në preventivin fitues është 750 lekë. Pra diferenca është 24,250 lekë/copë, nuk është e justifikuar duke rritur kështu vlerën e kontratës. Për pasojë, çmim 24,250 lekë/copë i këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
5. Zëri F. Furnizim kondicionerë 12 BTU. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 16 copë. Për këtë zë është rishikuar duke

vendosur zë të ri në preventivin e rishikuar dhe është caktuar çmimi i ri 112,500 lekë/copë, por nuk ka analizuar pse ka ardhur ky ndryshim. Çmimi referuar zërit në preventivin fitues ku përfshin kondicioner multisplit dhe kompresor respektiv (marrë çmimet më të larta) është 91,500 lekë. Pra diferenca është 21,000 lekë/copë, nuk është e justifikuar duke rritur kështu vlerën e kontratës. Për pasojë, çmim 21,000 lekë/copë i këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se i janë likuiduar tepër në vlerën 486,085 lekë pa TVSH sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

5. Loti 4 Rikonstruksioni i disa QSH-ve në Qarqet Gjirokastër, Vlorë dhe Fier.
Për zbatimin e punimeve e nën objekteve:
1- Rikonstruksioni i Ambulancës Lagjja "28 Nëntori";
2- Rikonstruksioni i QSH Fshati Armen;
3-Rikonstruksioni i Ambulancës Fshat Këlcyrë (Përmet).

F. Të dhëna mbi objektin

Zbatimi i Punimeve të objektit "Rikonstruksioni i Ambulancës Lagjja "28 Nëntori"".				
14.Lidhja e kontratës Nr. 1592/22 prot., datë 11.07.2024	15.Vlera e kontratës (me TVSH) 69,150,145 lekë OE fitues I. SHPK Nënobjekti-1: 7,778,090 lekë;		16.Likuiduar deri datë 18.12.2024 USH. Nr.763 për pagesën e pjesës së mbetur të situacionit me vlerë 1,011,031 lekë.	
17- Situacioni Përfundimtar Nën objekti: Vlera me TVSH 8,157,182 lekë Vlera pa TVSH 7,129,369 lekë	18.Afati i kontratës në ditë Parashikuar 185 ditë, Zbatuar 94 ditë Fillimi punimeve: 13.02.2024 Përfundimi punimeve :18.05.2024		19. Zgjatja e kontratës Amendim Kontrate nr. 975/6 prot., datë 14.06.2024, vetëm për nën objektin QSH Këlcyrë.	
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE "H.- C." SHPK & "P. C." SHPK	Licenca Nr. MK.	Kontrata me nr. 3108/31 prot., datë 15.12.2023		
21. Kolaudatori i punimeve BOE "I." SHPK & "M." SHPK	Licenca Nr: MK..... MK.....	Kontrata me nr. 934/20 prot., datë 02.05.2024		
22.Akt Kolaudimi 04.11.2024	23.Certifikata e përfundimit të punimeve 2024			

G. Të dhëna mbi objektin

Zbatimi i Punimeve të objektit "Rikonstruksioni i QSH Fshati Armen".		
14.Lidhja e kontratës Nr. 1592/22 prot., datë 11.07.2024	15.Vlera e kontratës (me TVSH) 69,150,145 lekë OE fitues I. SHPK Nën objekti: 5,255,966 lekë	16.Likuiduar deri datë 18.12.2024 USH. Nr.763 për pagesën e pjesës së mbetur të situacionit me vlerë 1,011,031 lekë.
17- Situacioni Përfundimtar Nën objekti: Vlera me TVSH 5,175,093 lekë Vlera pa TVSH 4,497,492 lekë	18.Afati i kontratës në ditë Parashikuar 185 ditë, Zbatuar 87 ditë Fillimi punimeve: 13.02.2024 Përfundimi punimeve :11.05.2024	19. Zgjatja e kontratës Amendim Kontrate nr. 975/6 prot., datë 14.06.2024, vetëm për nën objektin QSH Këlcyrë.

20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE "H.- C." SHPK & "P. C." SHPK	Licenca Nr. MK. 3730/4	Kontrata me nr. 3108/31 prot., datë 15.12.2023		
21. Kolaudatori i punimeve BOE "I.-" SHPK & "M." SHPK	Licenca Nr: MK..... MK.....	Kontrata me nr. 934/20 prot., datë 02.05.2024		
22.Akt Kolaudimi 04.11.2024	23.Certifikata e përfundimit të punimeve 2024			

H. Të dhëna mbi objektin

Zbatimi i Punimeve të objektit "Rikonstruksioni i Ambulancës Fshat Këlcyrë (Përmet)".				
14.Lidhja e kontratës Nr. 1592/22 prot., datë 11.07.2024	15.Vlera e kontratës (me TVSH) 69,150,145 lekë OE fitues I. SHPK Nën objekti: 4,876,223 lekë		16.Likuiduar deri datë 18.12.2024 USH. Nr.763 për pagesën e pjesës së mbetur të situacionit me vlerë 1,011,031 lekë.	
17- Situacioni Përfundimtar Nën objekti: Vlera me TVSH 4,072,681 lekë Vlera pa TVSH 3,533,311 lekë	18.Afati i kontratës në ditë Parashikuar 185 ditë, Zbatuar 82 ditë Fillimi punimeve: 05.06.2024 Përfundimi punimeve :17.08.2024		19. Zgjatja e kontratës Amendim Kontrate nr. 975/6 prot., datë 14.06.2024, vetëm për nën objektin QSH Këlcyrë.	
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE "H.- C." SHPK & "P. C." SHPK	Licenca Nr. MK. 3730/4	Kontrata me nr. 3108/31 prot., datë 15.12.2023		
21. Kolaudatori i punimeve BOE "I." SHPK & "M." SHPK	Licenca Nr: MK..... MK.....	Kontrata me nr. 934/20 prot., datë 02.05.2024		
22.Akt Kolaudimi 04.11.2024	23.Certifikata e përfundimit të punimeve 2024			

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 1592/22 prot., datë 11.07.2023, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të përfaqësuar nga Titullari znj.M.K. dhe Operatorit Ekonomik I. SHPK, me përfaqësues ligjor z.F. C.

Vlera e kontratës me objekt "Loti 4 Rikonstruksioni i disa QSH-ve në Qarqet Gjirokastër, Vlorë dhe Fier" është 57,625,120 lekë pa TVSH / 69,150,145 lekë me TVSH.

Afati i zbatimit të kësaj kontrate është 185 ditë.

Amendim nr.1 Kontrate me nr.975/6 prot., datë 14.06.2024, shtyrje afati punimesh me 2 muaj vetëm për nën objektin QSH fshati Këlcyrë, për arsye të vonesës së fillimit të punimeve për shkak të problematikave të pronësisë që kishte kjo QSH

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr.3108/31 prot., datë 15.12.2023, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi BOE "H.- C." SHPK & "P. C." SHPK, vlera e kontratës është 780,935 lekë pa TVSH / 937,122 lekë me TVSH, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3730/4.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr.934/20 prot., datë 02.05.2024, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi BOE "I." SHPK & "M." SHPK, vlera e kontratës është 20,248 lekë pa TVSH / 24,298 lekë me TVSH, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3331/5 dhe MK.3119/8.

Proces verbal kolaudimi është mbajtur më datë 04.11.2024, midis përfaqësuesve të Kontraktorit të punimeve, Mbikëqyrësit të punimeve dhe kolaudatorit të punimeve.

“Rikonstruksioni i Ambulancës Lagjja “28 Nëntori””.
Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit me datë 2024, e nënshkruar nga përfaqësuesit e sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, përfaqësues të Investitorit nga komisioni i marrjes në dorëzim të Investimit i përbërë nga znj. I. K., znj.A. Z., dhe z.K. L.
“Rikonstruksioni i QSH Fshati Armen”.
Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit me datë 2024, e nënshkruar nga përfaqësuesit e sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, përfaqësues të Investitorit nga komisioni i marrjes në dorëzim të Investimit i përbërë nga znj. I.K., znj.A. Z., dhe z.K. Gj.
“Rikonstruksioni i Ambulancës Fshat Këlcyrë (Përmet)”.
Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit me datë 2024, e nënshkruar nga përfaqësuesit e sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, përfaqësues të Investitorit nga komisioni i marrjes në dorëzim të Investimit i përbërë nga znj. E. I., z.H. C.o dhe z.B. D.
Projektpreventivi
- Projekt Preventivi është hartuar nga shoqëria projektuese “I.” & Universiteti Politeknik i Tiranës.
- Për objektin “Rikonstruksioni i Ambulancës Lagjia “28 Nëntori””, Bashkia Vlorë me shkresën nr.8798/1 prot., datë 28.07.2023, shprehet se sipas VKM nr.457 datë 29.06.2022, këto punime kryhen pa leje ndërtimore ose deklaratë paraprake punimesh.
- Për objekt “Rikonstruksioni i QSH Fshati Armen”, Bashkia Selenicë me shkresën nr.1580/2 prot., datë 30.08.2023, shprehet se sipas VKM nr.457 datë 29.06.2022, këto punime kryhen pa leje ndërtimore ose deklaratë paraprake punimesh.
- Për objekt “Rikonstruksioni i Ambulancës Fshat Këlcyrë (Përmet) Bashkia Këlcyrë me shkresën nr.1092 prot., datë 29.05.2024, shprehet se sipas VKM nr.457 datë 29.06.2022, këto punime kryhen pa leje ndërtimore ose deklaratë paraprake punimesh.
Zbatimi i punimeve
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se për nën objektin “Rikonstruksioni i Ambulancës Lagjja “28 Nëntori”, punimet kanë nisur me datë 13.02.2024 dhe kanë përfunduar me datë 18.05.2024.
Për nën objektin “Rikonstruksioni i QSH Fshati Armen” punimet kanë nisur me datë 13.02.2024 dhe kanë përfunduar me datë 11.05.2024 ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentet e kontratës.
Për nën objektin “Rikonstruksioni i Ambulancës Fshat Këlcyrë (Përmet)” punimet kanë nisur me datë 05.06.2024 dhe kanë përfunduar me datë 17.08.2024 ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentet e kontratës.
Me shkresën pa nr. Prot., dhe pa datë, mbikëqyrësi i punimeve ka kërkuar rishikimin e projekt-preventivit dhe miratim ndryshimesh nga projekt preventivi bazë sipas azhornimit teknik. Preventivi i rishikuar, ka punime që shtohen dhe punime që zbriten por pa rritur vlerën e kontratës.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

Nga auditimi i situacioneve përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 715,465 lekë pa TVSH.
"Rikonstruksioni i Ambulancës Lagjja "28 Nëntori"".
Tabela nr. 6

Nr		**Zëri i punimeve**	**Njësia**	**Çmimi i ofertës**	**Situacioni përfundimtar**	**Libri i masave**	**Fakti**	**Diferenca në +**	
								Vol.	Vlera
	V	Punime suvatimi, veshje e bojatisje							
4	2.358/b	Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5cm + rrjetë+ suva	m²	1,650	193.84	193.84	193.84		
		Diferenca polisterol i zakonshëm – polisterol jeshil	m²	164			193.84	193.84	31,790
	3	Sistemi HVAC (Ngrohje-ftohje)							
		Rakorderi bakri diametra të ndryshëm							
1	An.	F.V Tubacione bakri me armaflex të termoizoluara paraprakisht, veshje antikondense, përmase të përshtatshme për freon R410A Ø 6.35 mm	ml	540	90	90	0	90	48,600
2	An.	F.V Tubacione bakri me armaflex të termoizoluara paraprakisht, veshje antikondense, përmase të përshtatshme për freon R410A Ø 9.5 mm	ml	620	90	90	0	90	55,800
3	An.	F.V Aksesore për montimin e tubave të bakrit, fasheta, vida, dado, nastro alumini etj.	komplet	8,300	1	1	0	1	8,300

4	An.	F.V Tubacione kondensati PPR DN 25 mm	ml	290	35	35	0	35	10,150
5	An.	F.V Aksesore për montimin e tubave të kondensatit, fasheta, vida, dado, nastro alumin etj.	komplet	7,900	1	1	0	1	7,900
6	An.	F.V Kabëll multipolar bakri me izolim PVC, djegie pa flakë dhe emetim gazi 6.0/1kv, FG 160R16 Tipi S = 5X1.5 mm (për komunikimin e pajisjeve të kondicionimit).	ml	180	90	90	0	90	16,200
	D	Instalimet elektrike, internet dhe telefoni							
4.10	An.25	V. Central GSM me mundësi minimumi 4 Inpute, dhe mundësi thirrje mbi 5numra	copë	10,000	1	1	0	1	10,000
6.2	An.34	V. Kamera IP Dome 5MP, Lente fikse 2,8mm, IR(30m) IP66	copë	2,500	3	3	0	3	7,500
6.3	An.35	V. Kamera IP Bullet 5MP, Lente fikse 2,8mm, IR(30m) IP66	copë	2,500	5	5	4	1	2,500
	E	Pajisjet							
3.9	An.25.1	F. Central GSM me mundësi minimumi 4 Inpute, dhe mundësi thirrje mbi 5numra	copë	45,800	1	1	0	1	48,800
5.1	An.34.1	F. Kamera IP Bullet 5MP, Lente fikse	copë	6,000	3	3	0	3	18,000

		2,8mm, IR(30m) IP66							
5.2	An.35.1	F. Kamera IP Bullet 5MP, Lente fikse 2,8mm, IR(30m) IP66	copë	6,580	5	5	4	1	6,580
		Total							272,120

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:
"Rikonstruksioni i Ambulancës Lagjja "28 Nëntori"".
1. Zëri Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5cm+rrjetë+suva. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 193.84 m2. Nga auditimi në terren rezultoi se ky zë pune është realizuar me polisterol të bardhë dhe jo jeshil, referuar Manualit të çmimeve nr.2, zëri 2.358/b Polisterol kompakt jeshil 5cm është 452.5 lekë/m2, ndërsa zëri 2.358/b Polisterol i zakonshëm 5cm është 180 lekë/m2. Pra diferenca është 272.5 lekë/m2, duke marrë në konsiderate që çmimi i ofertuar është aplikuar një zbritje rreth 40%, diferenca e përfituar padrejtësisht nga kontraktori sipas rillogaritjes së këtij zëri pune rezulton 164 lekë/m2. Për pasojë, çmim 164 lekë/m2 i këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
2. Zërat e kapitullit 3 Sistemi HVAC (Ngrohje-ftohje). Rakorderi bakri diametra të ndryshëm. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave rezultojnë të jenë situacionuar sistemi i ngrohje ftohjes i cili përfshin tubacionet e bakrit, aksesorët, tubacionet e kondesatit PPR dhe kabëll. Por nga auditimi në terren rezultoi se ky sistem është realizuar me kondicionerë. Për pasojë, zërat e këtij kapitulli janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
3. Zëri Central GSM me mundësi minimumi 4 Inpute, dhe mundësi thirrje mbi 5numra. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 1 copë. Nga auditimi në terren rezultoi se ky zë pune nuk ishte realizuar. Për këtë arsye, sasia e këtij zëri pune është 0 copë, 1 copë më pak se sasia e situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi për furnizim dhe vendosje është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
4. Zëri Kamera IP Dome 5MP, Lente fikse 2,8mm, IR(30m) IP66. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 3 copë. Nga auditimi në terren rezultoi se ky zë pune nuk ishte realizuar. Për këtë arsye, sasia e këtij zëri pune është 0 copë, 3 copë më pak se sasia e situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
5. Zëri Kamera IP Bullet 5MP, Lente fikse 2,8mm, IR(30m) IP66. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 5 copë. Nga auditimi në terren rezultoi se ky zë pune ishte vendosur 4 copë. Për këtë arsye, sasia e këtij zëri pune është 4 copë, 1 copë më pak se sasia e situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

"Rikonstruksioni i QSH Fshati Armen".
Tabela nr. 7

Nr		**Zëri i punimeve**	**Njësia**	**Çmimi i ofertës**	**Situacioni përfundimtar**	**Libri i masave**	**Fakti**	**Diferenca në +**	
								Vol.	Vlera
	V	Punime suvatimi, veshje e bojatisje							

4	2.358/b	Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5cm + rrjetë+ suva	m²	1,650	138.76	138.76	138.76		
		Diferenca polisterol i zakonshëm – polisterol jeshil	m²	164			138.76	138.76	22,757
	3	Sistemi HVAC (Ngrohje-ftohje)							
		Rakorderi bakri diametra të ndryshëm							
1	An.	F.V Tubacione bakri me armaflex të termoizoluara paraprakisht, veshje antikondense, përmase të përshtatshme për freon R410A Ø 6.35 mm	ml	540	70	70	0	70	37,800
2	An.	F.V Tubacione bakri me armaflex të termoizoluara paraprakisht, veshje antikondense, përmase të përshtatshme për freon R410A Ø 9.5 mm	ml	620	70	70	0	70	43,400
3	An.	F.V Aksesore për montimin e tubave të bakrit, fasheta, vida, dado, nastro alumini etj.	komplet	8,300	1	1	0	1	8,300
4	An.	F.V Tubacione kondensati PPR DN 25 mm	ml	290	35	35	0	35	10,150
5	An.	F.V Aksesore për montimin e tubave të kondensatit, fasheta, vida, dado, nastro alumin etj.	komplet	7,900	1	1	0	1	7,900
6	An.	F.V Kabëll multipolar	ml	180	70	70	0	70	12,600

		bakri me izolim PVC, djegie pa flakë dhe emetim gazi 6.0/1kv, FG 160R16 Tipi S = 5X1.5 mm (për komunikimin e pajisjeve të kondicionimit).							
	D	Instalimet elektrike, internet dhe telefoni							
4.10	An.25	V. Central GSM me mundësi minimumi 4 Inpute, dhe mundësi thirrje mbi 5numra	copë	10,000	1	1	0	1	10,000
6.3	An.35	V. Kamera IP Bullet 5MP, Lente fikse 2,8mm, IR(30m) IP66	copë	2,500	5	5	4	1	2,500
	E	Pajisjet							
3.9	An.25.1	F. Central GSM me mundësi minimumi 4 Inpute, dhe mundësi thirrje mbi 5numra	copë	45,800	1	1	0	1	48,800
5.2	An.35.1	F. Kamera IP Bullet 5MP, Lente fikse 2,8mm, IR(30m) IP66	copë	6,580	5	5	4	1	6,580
		Total							210,787

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:
"Rikonstruksioni i QSH Fshati Armen".
1. Zëri Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5cm+rrjetë+suva. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 138.76 m2. Nga auditimi në terren rezultoi se ky zë pune është realizuar me polisterol të bardhë dhe jo jeshil, referuar Manualit të çmimeve nr.2, zëri 2.358/b Polisterol kompakt jeshil 5cm është 452.5 lekë/m2, ndërsa zëri 2.358/b Polisterol i zakonshëm 5cm është 180 lekë/m2. Pra diferenca është 272.5 lekë/m2, duke marrë në konsiderate që çmimi i ofertuar është aplikuar një zbritje rreth 40%, diferenca e përfituar padrejtësisht nga kontraktori sipas rillogaritjes së këtij zëri pune rezulton 164 lekë/m2. Për pasojë, çmim 164 lekë/m2 i këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
2. Zërat e kapitullit 3 Sistemi HVAC (Ngrohje-ftohje). Rakorderi bakri diametra të ndryshëm. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave rezultojnë të jenë

situacionuar sistemi i ngrohje ftohjes i cili përfshin tubacionet e bakrit, aksesorët, tubacionet e kondesatit PPR dhe kabëll. Por nga auditimi në terren rezultoi se ky sistem është realizuar me kondicionerë. Për pasojë, zërat e këtij kapitulli janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
3. Zëri Central GSM me mundësi minimumi 4 Inpute, dhe mundësi thirrje mbi 5numra. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 1 copë. Nga auditimi në terren rezultoi se ky zë pune nuk ishte realizuar. Për këtë arsye, sasia e këtij zëri pune është 0 copë, 1 copë më pak se sasia e situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi për furnizim dhe vendosje është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
4. Zëri Kamera IP Bullet 5MP, Lente fikse 2,8mm, IR(30m) IP66. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 5 copë. Nga auditimi në terren rezultoi se ky zë pune ishte vendosur 4 copë. Për këtë arsye, sasia e këtij zëri pune është 4 copë, 1 copë më pak se sasia e situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

"Rikonstruksioni i Ambulancës Fshat Këlcyrë (Përmet)".
Tabela nr. 8

Nr		**Zëri i punimeve**	**Njësia**	**Çmimi i ofertës**	**Situacioni përfundimtar**	**Libri i masave**	**Fakti**	**Diferenca në +**	
								Vol.	Vlera
	III	Punime Tarrace							
1	2.206	Kasetë shkarkimi me llamarinë xingat	copë	1,950	2	2	0	2	3,900
2	2.209	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë Ø100mm	ml	1,150	8	8	0	8	9,200
	V	Punime suvatimi, veshje e bojatisje							
4	2.358/b	Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5cm + rrjetë+ suva	m²	1,650	146.94	146.94	146.94		
		Diferenca polisterol i zakonshëm – polisterol jeshil	m²	164			146.94	146.94	24,098
	B	Punime sistemimi / Punime kullimi të ujërave sipërfaqësore							
1	3.25/a	Gërmim me krah seksioni i detyruar b<1m, h=1.5m, tokë e zak.	m³	620	8.4	8.4	0	8.4	5,208
2	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m³	480	8.4	8.4	0	8.4	4,032
3	An.23	Puseta b/a shiu 40x60cm,	cope	9,500	2	2	0	2	19,000

		h=100 cm me kapak gize							
4	An.55	F.V. tub drenazhi Ø150mm	Ml	650	28	28	0	28	18,200
	3	Sistemi HVAC (Ngrohje-ftohje)							
		Rakorderi bakri diametra të ndryshëm							
1	An.	F.V Tubacione bakri me armaflex të termoizoluara paraprakisht, veshje antikondense, përmase të përshtatshme për freon R410A Ø 6.35 mm	ml	540	20	20	0	20	10,800
2	An.	F.V Tubacione bakri me armaflex të termoizoluara paraprakisht, veshje antikondense, përmase të përshtatshme për freon R410A Ø 9.5 mm	Ml	620	20	20	0	20	12,400
3	An.	F.V Aksesore për montimin e tubave të bakrit, fasheta, vida, dado, nastro alumini etj.	komplet	8,300	1	1	0	1	8,300
4	An.	F.V Tubacione kondensati PPR DN 25 mm	Ml	290	3	3	0	3	870
5	An.	F.V Aksesore për montimin e tubave të kondensatit, fasheta, vida, dado, nastro alumin etj.	komplet	7,900	1	1	0	1	7,900
6	An.	F.V Kabëll multipolar bakri me izolim PVC, djegie pa flakë	Ml	180	20	20	0	20	3,600

		dhe emetim gazi 6.0/1kv, FG 160R16 Tipi S = 5X1.5 mm (për komunikimin e pajisjeve të kondicionimit).							
	D	Instalimet elektrike, internet dhe telefoni							
4.10	An.25	V. Central GSM me mundësi minimumi 4 Inpute, dhe mundësi thirrje mbi 5numra	copë	10,000	1	1	0	1	10,000
	E	Pajisjet							
3.9	An.25.1	F. Central GSM me mundësi minimumi 4 Inpute, dhe mundësi thirrje mbi 5numra	copë	45,800	1	1	0	1	48,800
II.3	2.505	F. Bide komplet importi	copë	8,750	1	1	0	1	8,750
II.7	An.	F. Enë zgjerimi me diafragmë për rrjetin e furnizimit me ujë të ftohtë Volumi 24 lit. Diam 350mm, lart. 395 mm, Pmax 8 bar Lidhja Ø11/4''	copë	37,500	1	1	0	1	37,500
		Total							232,558

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:
"Rikonstruksioni i Ambulancës Fshat Këlcyrë (Përmet)".
1. Zëri Kasetë shkarkimi me llamarinë xingat. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 2 copë. Nga auditimi në terren rezultoi se ky zë pune nuk ishte realizuar. Për këtë arsye, sasia e këtij zëri pune është 0 copë, 2 copë më pak se sasia e situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
2. Zëri Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë Ø100mm. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në gjatësinë 8 m. Nga auditimi në terren rezultoi se ky zë pune nuk ishte realizuar. Për këtë arsye, sasia e këtij zëri pune është 0 m, 8 m më pak se sasia e situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

3. Zëri Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5cm+rrjetë+suva. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 146.94 m2. Nga auditimi në terren rezultoi se ky zë pune është realizuar me polisterol të bardhë dhe jo jeshil, referuar Manualit të çmimeve nr.2, zëri 2.358/b Polisterol kompakt jeshil 5cm është 452.5 lekë/m2, ndërsa zëri 2.358/b Polisterol i zakonshëm 5cm është 180 lekë/m2. Pra diferenca është 272.5 lekë/m2, duke marrë në konsiderate që çmimi i ofertuar është aplikuar një zbritje rreth 40%, diferenca e përfituar padrejtësisht nga kontraktori sipas rillogaritjes së këtij zëri pune rezulton 164 lekë/m2. Për pasojë, çmim 164 lekë/m2 i këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
4. Zërat e kapitullit B Punime sistemimi / Punime kullimi të ujërave sipërfaqësore. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave rezultojnë të jenë situacionuar punime sistemimi i cili përfshin gërmim dhe transport dheu për tubacionet, pusetat dhe tubat e drenazhit. Por nga auditimi në terren rezultoi se ky sistem nuk është realizuar pasi nuk u gjenden pusetat. Për pasojë, zërat e këtij kapitulli janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
5. Zërat e kapitullit 3 Sistemi HVAC (Ngrohje-ftohje). Rakorderi bakri diametra të ndryshëm. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave rezultojnë të jenë situacionuar sistemi i ngrohje ftohjes i cili përfshin tubacionet e bakrit, aksesorët, tubacionet e kondesatit PPR dhe kabëll. Por nga auditimi në terren rezultoi se ky sistem është realizuar me kondicionerë. Për pasojë, zërat e këtij kapitulli janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
6. Zëri Central GSM me mundësi minimumi 4 Inpute, dhe mundësi thirrje mbi 5numra. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 1 copë. Nga auditimi në terren rezultoi se ky zë pune nuk ishte realizuar. Për këtë arsye, sasia e këtij zëri pune është 0 copë, 1 copë më pak se sasia e situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi për furnizim dhe vendosje është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
7. Zëri Bide komplet importi. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 1 copë. Nga auditimi në terren rezultoi se ky zë pune nuk ishte realizuar. Për këtë arsye, sasia e këtij zëri pune është 0 copë, 1 copë më pak se sasia e situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
8. Zëri Enë zgjerimi me diafragmë për rrjetin e furnizimit me ujë të ftohtë Volumi 24 lit. Diam 350mm, lart. 395 mm, Pmax 8 bar Lidhja Ø11/4’’. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 1 copë. Nga auditimi në terren rezultoi se ky zë pune nuk ishte realizuar. Për këtë arsye, sasia e këtij zëri pune është 0 copë, 1 copë më pak se sasia e situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se i janë likuiduar tepër në vlerën 715,465 lekë pa TVSH sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

6. Loti 1 Rikonstruksion i disa QSH-ve në rajonet Tirana dhe Shkodër (13 Objekte).
Për zbatimin e punimeve e nën objektit:
1- Rikonstruksioni i QSH Bicaj, Kukës.
I. Të dhëna mbi objektin

Zbatimi i Punimeve të objektit “Rikonstruksioni i QSH Bicaj, Kukës”

14.Lidhja e kontratës Nr.1487/12 prot., datë 28.07.2022	15.Vlera e kontratës (me TVSH) 67,002,102 lekë OE fitues "C." SHPK Për objektin QSH Bicaj: 5,183,596 lekë		16.Likuiduar	
17- Situacioni Përfundimtar Vlera me TVSH 5,135,215 lekë Vlera pa TVSH 4,320,150 lekë	18.Afati i kontratës në ditë Parashikuar 260 ditë, Zbatuar 318 ditë. Zgjatur 60 ditë, Fillimi punimeve: 03.08.2022 Përfundimi punimeve : 16.06.2023		19. Zgjatja e kontratës Amendim Kontrate nr.1, nr. 1379/5 prot., datë 18.04.2023.	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "D." SHPK	Licenca Nr: MK.....	Kontrata me nr.2501/10 prot., datë 01.08.2022		
21. Kolaudatori i punimeve OE "L." SHPK	Licenca Nr: MK.....	Kontrata me nr. 284/14 prot., datë 17.08.2023		
22.Akt Kolaudimi Datë 01.11.2023	23.Certifikata e përfundimit të punimeve datë 01.11.2023			

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr.1487/12 prot., datë 28.07.2022, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të përfaqësuar nga titullari zj.J.D. dhe Operatorit Ekonomik "C." SHPK, me përfaqësues ligjor z. A. K.

Vlera e kontratës me objekt "Loti 1 Rikonstruksion i disa QSH-ve në rajonet Tirana dhe Shkodër (13 Objekte)" është 55,835,085 lekë pa TVSH / 67,002,102 lekë me TVSH.

Afati i zbatimit të kësaj kontrate është 8.5 muaj nga fillimi i punimeve (për objektin e parë).

Amendim nr.1 Kontrate me nr.1379/5 prot., datë 18.04.2023, shtyrje afati punimesh me 2 muaj, nga data 17.04.2023 deri datë 17.06.2023, për arsye të vështirësisë së hasur nga kushtet atmosferike, dhe QSH nr.2 Durrës për arsye të moslirimit të QSH nga stafi mjekësor

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr.2501/10 prot., datë 01.08.2022, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi OE "D." SHPK vlera e kontratës është 620,904 lekë pa TVSH / 745,084 lekë me TVSH.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr.284/14 prot., datë 17.08.2023, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi OE "L." SHPK, vlera e kontratës është 40,000 lekë pa TVSH / 48,000 lekë me TVSH, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0985/7.

Proces verbal kolaudimi është mbajtur më datë 01.11.2023, midis përfaqësuesve të Kontraktorit të punimeve, Mbikëqyrësit të punimeve dhe kolaudatorit të punimeve.

Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit me datë 01.11.2023, e nënshkruar nga përfaqësuesit e sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, përfaqësues të Investitorit nga komisioni i marrjes në dorëzim të Investimit i përbërë nga z.P. Z., z.Xh. R. dhe z.A. O.

Projektpreventivi

- Në dosjen e zbatimit nuk administrohet autorizim për kryerjen e punimeve.
- Projekt Preventivi është hartuar nga shoqëria projektuese "T." SHPK.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 03.08.2022 dhe kanë përfunduar me datë 16.06.2023, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendimin e kontratës.

Me shkresën nr.extra prot., datë 27.02.2023 mbikëqyrësi i punimeve ka kërkuar miratimin e ndryshimeve të volumeve, pas rishikimit të projektit.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 148,402 lekë pa TVSH.

Tabela nr. 9

Nr		**Zëri i punimeve**	**Njësia**	**Çmimi i ofertës**	**Situacioni përfundimtar**	**Libri i masave**	**Fakti**	**Diferenca në +**	
								Vol.	Vlera
	3	Punime jashtë ndërtesës							
5	2.262/1	Shtresë betoni C7/10	m3	6,086	4.5	4.5	0	4.5	27,387
	I	Punime hidrosanitare							
1	An.proj.	Heqje e pajisjeve dhe rrjeteve hidrosanitare + largimi i mbeturinave + shkarkimet	d/pune	3,000	2	2	0	2	6,000
8	An.proj.	FV Tub plastmasi PE-HD Ø50 (me gomina)	Ml	795	20	20	0	20	15,900
9	2.52	FV Tub plastmasi Ø110 (me gomina)	Ml	907	10	10	0	10	9,070
12	2.501	FV ËC allafrenga importi	copë	13,255	1	1	0	1	13,255
13	An.proj.	Evidentim pastrim riparime dhe plotësime në pusetën e shkarkimit ekzistuese	copë	4,000	1	1	0	1	4,000
	4	Punime çatie (shtesa)							
8	An.	Ndërtim oxhaqesh me tulla komplet punimet dhe aksesorët	copë	30,000	2	2	0	2	60,000
	B	Punime hidrosanitare (shtesa)							
5	An-19	Puseta shkarkimi b/a	copë	10,271	1	1	0	1	10,271

		80x80, h-100cm							
	I	Punime elektrike (shtesa)							
11	An.	Puseta për elektroda 0.5x0.5x0.5	copë	2,519	1	1	0	1	2,519
		Total							148,402

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:
1. Zëri Shtresë betoni C7/10. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 4.5 m3. Referuar An.3.62 sipas VKM nr. 629, datë 15.7.2015, "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", i ndryshuar, në zërin e trotuarit përfshihet dhe shtresa e betonit nën pllaka, për rrjedhojë ky zë i betonit rezulton që është marrë dy herë në situacion/preventiv. Për këtë arsye, sasia e këtij zëri pune është 0 m2 ose 4.5 m2 më pak se sasia e situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
2. Zërat për punimet hidrosanitare të ËC dhe shkarkimet (heqjet e pajisjeve, tubat e plastmasit dhe ËC allafrenga). Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave rezultojnë të jenë situacionuar punimet hidrosanitare të shkarkimit të ujërave të zeza të godinës, i cili përfshin heqjen e pajisjeve, tubacionet e plastmasit dhe ËC allafrenga. Por nga auditimi në terren rezultoi se në ËC ishte vendosur ËC allaturka, e cila sjell që ka ardhur nga mos ndërtimi i sistemit të shkarkimit të ujërave të zeza të godinës. Për pasojë, zërat e këtij sistemi të shkarkimit të ujërave të zeza të godinës janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
3. Zëri Evidentim pastrim riparime dhe plotësime në pusetën e shkarkimit ekzistuese. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 1 copë. Nga auditimi në terren nuk u evidentua ndonjë pusetë shkarkimi ekzistuese por vetëm një gropë septike. Për këtë arsye, sasia e këtij zëri pune nuk është realizuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
4. Zëri Ndërtim oxhaqesh me tulla komplet punimet dhe aksesorët. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 5 copë. Nga auditimi në terren dhe sipas projektit shtesa e godinës përfshin vetëm ndërtimin e dy dhomave për mjekun, ndërsa në situacionin për shtesën janë situacionuar ndërtimi i 5 oxhaqeve, por për shtesën duhet të jenë ndërtuar jo më shumë se 3 oxhaqe. Për këtë arsye, sasia e këtij zëri pune është 3 copë, 2 copë më pak se sasia e situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
5. Zëri Puseta shkarkimi b/a 80x80, h-100cm. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 1 copë. Nga auditimi në terren nuk u evidentua ndonjë pusetë shkarkimi. Për këtë arsye, sasia e këtij zëri pune nuk është realizuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve
6. Zëri Puseta për elektroda 0.5x0.5x0.5. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 1 copë. Nga auditimi në terren nuk u evidentua ndonjë pusetë për elektrodat. Për këtë arsye, sasia e këtij zëri pune nuk është realizuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se i janë likuiduar tepër në vlerën 148,402 lekë pa TVSH sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

7. Loti 2 Rikonstruksion i disa QSH-ve në rajonet Elbasan dhe Vlorë (12 Objekte).
Për zbatimin e punimeve e nën objektit:
1- Rikonstruksioni i Ambulancës Lagjja Brigada e 17 Sulmuese.
J. Të dhëna mbi objektin

<table>
<tr><th colspan="5">Zbatimi i Punimeve të objektit “Rikonstruksioni i Ambulancës Lagjja Brigada 17 Sulmuese, Elbasan”</th></tr>
<tr><td>14.Lidhja e kontratës
Nr.1487/19 prot., datë
14.07.2022</td><td colspan="2">15.Vlera e kontratës (me TVSH)
38,317,984 lekë
BOE fitues “I. G” SHPK & “Z.” SHPK & “V. G” SHPK
Për objektin Ambulanca Lagjja Brigada 17 Sulmuese: 3,560,899 lekë</td><td colspan="2">16.Likuiduar</td></tr>
<tr><td>17- Situacioni Përfundimtar
Vlera me TVSH 3,559,026 lekë
Vlera pa TVSH 2,979,139 lekë</td><td colspan="2">18.Afati i kontratës në ditë
Parashikuar 138 ditë, Zbatuar 138 ditë.
Fillimi punimeve: 23.08.2022
Përfundimi punimeve : 09.01.2023</td><td colspan="2">19. Zgjatja e kontratës</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve
OE “T.” SHPK</td><td>Licenca Nr:
MK.....</td><td>Kontrata me nr.2501/7 prot., datë 19.07.2022</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve
OE “A. Projektim Mbikëqyrje”</td><td>Licenca Nr:
MK.....</td><td>Kontrata me nr. 284/4 prot., datë 22.02.2023</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>22.Akt Kolaudimi
Datë 11.04.2023</td><td colspan="2">23.Certifikata e përfundimit të punimeve datë 12.04.2023</td><td colspan="2"></td></tr>
</table>

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr.1487/19 prot., datë 14.07.2022, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të përfaqësuar nga titullari zj.J.D. dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “I. G” SHPK & “Z.” SHPK & “V. G.” SHPK, me përfaqësues ligjor respektiv z. E. Z., z.Z. Z. dhe z.M. H.
Vlera e kontratës me objekt “Loti 2 Rikonstruksion i disa QSH-ve në rajonet Elbasan dhe Vlorë, (12 objekte)” është 31,931,654 lekë pa TVSH / 38,317,984 lekë me TVSH.
Afati i zbatimit të kësaj kontrate është 4.6 muaj nga fillimi i punimeve (për objektin e parë).
Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr.2501/7 prot., datë 19.07.2022, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi OE “T.”, SHPK vlera e kontratës është 462,306 lekë pa TVSH / 554,767 lekë me TVSH.
Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr.284/4 prot., datë 22.02.2023, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi OE “A. P. M.” SHPK, vlera e kontratës është 35,000 lekë pa TVSH / 42,000 lekë me TVSH, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3433/1.
Proces verbal kolaudimi është mbajtur më datë 11.04.2023, midis përfaqësuesve të Kontraktorit të punimeve, Mbikëqyrësit të punimeve dhe kolaudatorit të punimeve.
Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit me datë 12.04.2023, e nënshkruar nga përfaqësuesit e sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, përfaqësues të Investitorit nga komisioni i marrjes në dorëzim të Investimit i përbërë nga znj.E. Sh., z.Th. B., znj.M. E., z.A. M.dhe znj.D. Gj., dhe Titullari i AK.
Projektpreventivi
- Në dosjen e zbatimit nuk administrohet leja e ndërtimit / autorizim për kryerjen e punimeve, por ka vetëm një kërkesë drejtuar njësisë administrative nr.2 Elbasan, dhe jo Bashkisë Elbasan.
- Projekt Preventivi është hartuar nga shoqëria projektuese “D. P.” SHPK.
Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 23.08.2022 dhe kanë përfunduar me datë 09.01.2023, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.
Me shkresën nr.778 prot., datë 02.12.2022 mbikëqyrësi i punimeve ka kërkuar miratimin e ndryshimeve të volumeve, pas rishikimit të projektit.
- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.
Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 161,052 lekë pa TVSH.
Tabela nr. 1

Nr		**Zëri i punimeve**	**Njësia**	**Çmimi i ofertës**	**Situacioni përfundimtar**	**Libri i masave**	**Fakti**	**Diferenca në +**	
								Vol.	Vlera
	IV	Punime tarrace							
7	2.206	Kasetë shkarkimi me llamarinë xingat	copë	1,000	4	4	0	4	4,000
8	2.209	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë xingat Ø 100	ml	500	12	12	12		
		Diferenca e çmimit ulluk llamarinë xingat – ulluk shkarkimi vertikal me PVC	ml	149			12	12	1,788
	IX	Punime të sistemimit të jashtëm							
1	3.62	Trotuar, 6 cm beton me pllaka	m2	1,200	118	118	85	33	39,600
2	3.617/1	FV Bordura betoni 15x30 cm	m	800	85	85	50	35	28,000
5	2.412	Parapet shkalle e pandus me hekur Ø e korimano	ton	207,612	0.35	0.35	0	0.35	72,664
	II	Montim Pajisje hidrosanitare							
2	An-16	V. Bolier 12 litër ujë të	copë	500	2	2	0	2	1,000

		ngrohtë sanitar							
	II	Furnizim Pajisje hidrosanitare							
2	An-16	F. Bolier 12 litër ujë të ngrohtë sanitar	copë	7,000	2	2	0	2	14,000
		Total							161,052

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

1. Zëri Kasetë shkarkimi me llamarinë xingat. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 4 copë. Nga auditimi në terren rezultoi se ky zë pune nuk ishte realizuar. Për këtë arsye, sasia e këtij zëri pune është 0 copë, 4 copë më pak se sasia e situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
2. Zëri Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë xingat Ø 100. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 12 ml. Referuar auditimit në terren ulluqet vertikal ishin realizuar PVC. Referuar An.2.209/a sipas VKM nr. 629, datë 15.7.2015, "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", i ndryshuar, Ulluk shkarkimi vertikal me PVC Ø 120 çmimi është 351 lekë/ml, pra diferenca është 149 lekë/ml. Për pasojë, çmim 149 lekë/m i këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
3. Zëri Trotuar, 6 cm beton me pllaka. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 118 m2. Nga auditimi në terren dhe rillogaritja e sasive sipas verifikimit në terren rezultoi se ky zë pune ishte realizuar për një sipërfaqe 85 m2. Për këtë arsye, sasia e këtij zëri pune është 85 m2, 33 m2 më pak se sasia e situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
4. Zëri FV Bordura betoni 15x30 cm. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 85 m. Nga auditimi në terren dhe rillogaritja e sasive sipas verifikimit në terren rezultoi se ky zë pune ishte realizuar për një gjatësi 50 m. Për këtë arsye, sasia e këtij zëri pune është 50 m, 35 m më pak se sasia e situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
5. Zëri Parapet shkalle e pandus me hekur Ø e korimano. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 0.35 ton. Nga auditimi në terren rezultoi se ky zë pune nuk ishte realizuar. Për këtë arsye, sasia e këtij zëri pune është 0 ton, 0.35 ton më pak se sasia e situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
6. Zëri Bolier 12 litër ujë të ngrohtë sanitar. Në preventivin e rishikuar, situacionin përfundimtar dhe librezat e masave ky zë pune figuron në sasinë 2 copë. Nga auditimi në terren rezultoi se ky zë pune nuk ishte realizuar. Për këtë arsye, sasia e këtij zëri pune është 0 copë, 2 copë më pak se sasia e situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi për furnizim dhe vendosje është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se i janë likuiduar tepër në vlerën 161,052 lekë pa TVSH sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

✓ AUDITIMI I PROCEDURAVE TË PROKURIMIT ME VLERË TË VOGËL.

Auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, të kryera nga MSHMS, në cilësinë e AK u ushtrua bazuar në aktet ligjore/ nënligjore të prokurimit publik, si dhe në aktet ligjore/ nënligjore që kanë lidhje me objektet e prokurimit.

Në zbatim të kësaj pike, grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin, si më poshtë:

- Vlerësimin e hartimit të nevojave për mallra, punë dhe shërbime nga subjekti i audituar;
- Argumentimin dhe përllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, sipas nevojave konkrete për mallra dhe shërbime;
- Realizimin e procedurave të prokurimit, që nga momenti i nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, deri në lidhjen e kontratës;
- Lidhjen dhe zbatimin e kontratave, deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve.

Autoriteti Kontraktor ka krijuar në SPE regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimin e APP-së, brenda afateve ligjore, të përcaktuar në nenin 4 "*Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik*" të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e APP https://ëëë.app.gov.al.

Për periudhën objekt auditimi, MSHMS, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor (AK) ka kryer prokurime me procedurë:

- **"*Blerje me vlerë të vogël*" për vitin 2023**, ka parashikuar në vlerën prej 9,070,069 lekë pa TVSH, ku "*Sistem dinamik blerje të biletave të transportit ajror ndërkombëtar*" zë vlerën 4,402,256 lekë, ose rreth 49% të totalit;
- "***Blerje me vlerë të vogël*" për vitin 2024**, në vlerën prej 10,695,048 lekë pa TVSH, ku "*Sistem dinamik blerje të biletave të transportit ajror ndërkombëtar*" zë vlerën 4,402,256 lekë, ose rreth 41% të totalit.

Grupi i auditimit ka përzgjedhur për të audituar procedurat blerje e vogël për blerje mallra/ shërbime, si më poshtë:

Periudha	Numri i procedurave të realizuara	Procedurat e zgjedhura	Vlera e kontratës pa TVSH
2023	44	13	9,070,069
2024	46	11	10,695,048
Totali	**90**	**24**	**19,765,117**

Për vitin 2023 dhe 2024, grupi i auditimit ka përzgjedhur për të audituar procedurat, të pasqyruara në Aneksin 2.3 "*Procedurat për blerje mallra/shërbime të përzgjedhur për të audituar"* bashkëngjitur.

✓ **<u>Auditimi i procedurave të prokurimit "Blerje e biletave të transportit ajror ndërkombëtar"</u>**

Bazuar në Udhëzimi APP nr. 3, datë 18.06.2021 "*Mbi Përdorimin e Sistemit Dinamik për Blerjen e Biletave të Transportit Ajror Ndërkombëtar dhe Zhvillimin me Mjete Elektronike*", i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor, në fillim të vitit buxhetor, me Urdhëri NA nr. 07, datë 09.01.2024 "*Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe komisionit të sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar për vitin 2024*", i ndryshuar, ka ngritur Komisionin e Sistemit Dinamik për blerjen e biletave të përbërë nga 3 anëtarë.

Për periudhën objekt auditimi, MSHMS, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor ka kryer prokurime "Blerje e biletave të transportit ajror ndërkombëtar":

- **për vitin 2023**, në *Sistemin dinamik blerje të biletave të transportit ajror ndërkombëtar*" zë ka parashikuar fond limit në 7,200,000 lekë dhe ka prokuruar vlerën 4,402,273 lekë, ose rreth 66% të totalit;
- **për vitin 2024**, në s*istem dinamik blerje të biletave të transportit ajror ndërkombëtar*" ka parashikuar fonde 3,000,000 lekë dhe prokuruar blerje biletash në vlerën 2,447,550 lekë, ose rreth 82% të fondit te parashikuar.

Referuar pikës 4 të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 18.06.2021, Pas nxjerrjes së autorizimit për pjesëmarrje titullari/ ministri, titullari i AK/ personi i autorizuar prej tij, ka nxjerrë Urdhrat e Prokurimit përkatës.

Komisioni, në zbatim të pikës 5-6 të Udhëzimit, ka realizuar procedurën e prokurimit nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik (SPE).

Nga auditimi i blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar u konstatua se:

Blerja e biletave të transportit ajror ndërkombëtar është realizuar afër datës së udhëtimit, megjithëse ftesa për pjesëmarrje nga organizatorët e takimit/ aktivitetit është dërguar disa javë në parë kryerjes së procedurave të prokurimit dhe blerjes së biletave.

Një faktor jo pozitiv është miratimi me vonesë të autorizimeve për shërbime jashtë vendit, mbi pjesëmarrjen e përfaqësuesve të MSHMS në këto aktivitete. Blerja e biletave shumë afër datës së nisjes rrit kostot financiare, pasi është fakt i njohur se biletat e avionit janë shumë më të shtrenjta kur prokurohen afër datës së udhëtimit. Njëkohësisht blerja e biletave në afatet e fundit rrezikon disponueshmërinë e biletave për shkak të mungesës së vendeve të lira në oraret dhe itineraret e kërkuara. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me nenin 8, pika 1, nenin 9, pika 1 dhe nenin 12, pika 3, germa a, të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm", i ndryshuar.

Në urdhër-shpenzimet e blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar të përzgjedhura për t'u audituar nga ana e Grupit të Auditimit, si dhe në disa urdhër-shpenzime të shërbimeve-dieta jashtë vendit të punonjësve, të likuiduara nëpërmjet arkës, u konstatua *mungesa e ftesës së vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve*., dokumentacioni që vërteton qëllimi dhe objekti i shërbimit si dhe jep informacion mbi pjesën e shpenzimeve që do të mbulojë organizatori dhe pjesa që do të mbulojë buxheti i shtetit, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr.22 të MFE datë 10.07.2013 " Mbi zbatimin e VKM nr. 870, date 14.12.2011"*Për trajtimin financiar te punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit"*, pika 4 dhe me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, nenin 4, pika 26 të ku citohet se "*Dokument financiar është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative"*, nenin 2, pika 16 "Gjurma e auditimit, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre…", si dhe pikën 35, germa b "Dokumente vërtetues", të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*".

❖ **Prokurim me nr. 2879 prot, ref-11801-07-02-2024 "F-V pajisje mobilimi për aparatin e MSHMS"**

Ne regjistrin e **parashikimeve** të prokurimeve publike për vitin 2024 është parashikuar kryerja e procedurës së prokurimit, blerje e vogël, me objekt "**F-V pajisje mobilimi për aparatin e MSHMS**" me fond limit 1,000,000 lekë (pa TVSH).

Regjistri i realizimit të prokurimeve për vitin 2024 për prokurimit, blerje e vogël, me objekt "F-V pajisje mobilimi për aparatin e MSHMS" rezulton i realizuar me fond limit 993,318 lekë (pa TVSH).

✓ Regjistri realizimit "F-V pajisje mobilimi për aparatin e MSHMS"2024

Numri references	OE	Objekti_i_prokurimit	Lloji procedurës	Tipi kontratës	Fondi limit
REF-11801-07-02-2024	R.-A.sh.p.k	F.V pajisje mobilimi për aparatin e MSHMS	Small Value	Supplies	993,318
REF-17151-08-27-2024	R.-A. sh.p.k	F.V pajisje mobilimi për aparatin e MSHMS	Small Value	Supplies	100,000
REF-12169-07-04-2024		F.V pajisje për arkiv protokollin e aparatit të MSHMS	Small Value	Supplies	724,616

1. Në procedurën e prokurimit me objekt "**Furnizim pajisjesh mobilimi për aparatin e MSHMS",** me referencë **REF-11801-07-02-2024,** e zhvilluar me procedurën e blerjes së vogël**,** operatori ekonomik fitues është **R.-A. sh.p.k**, me **NIPT J……M.** Fondi limit i kësaj procedure ishte 993,318 lekë (pa TVSH)**,** ndërsa vlera fituese **e** kontratës është 899,999 lekë (pa TVSH)**.**

Komisioni prokurimi: A. N.; E. M.; N.K..

Komisioni marrjes së dorëzim: E. K., E. B., A. H. ngritur me Urdhër Ministri nr. 170, datë 29.03.2024

Nga auditimi rezultoi se:

- Në procedurën e prokurimit me referencë REF-11801-07-02-2024, **mungesa e deklaratës së garancisë së mallit** nga operatori ekonomik (OE) përbën një shkelje të qartë të kërkesave të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit, konkretisht në ftesën për ofertë nr. 2879/3, datë 28.06.2024. Kjo deklaratë është e domosdoshme për të mbuluar çdo anomali apo defekt të mallrave për një periudhë jo më pak se një vit, gjatë së cilës ofertuesi duhet të sigurojë riparim dhe mirëmbajtje të tyre.
- Procesverbali i datës 17.07.2024 për marrjen në dorëzim të mallrave të furnizuara (karrige, poltron, tavolinë mesi) **nuk përmban informacion lidhur me përputhshmërinë teknike të artikujve të dorëzuar** me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e prokurimit. Në përmbajtjen e tij nuk janë evidentuar karakteristikat teknike të secilit artikull, si dhe nuk është bërë konfirmimi formal nga anëtarët e komisionit të pranimit mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të kontratës, ashtu siç janë përcaktuar në dokumentacionin e tenderit/ofertës fituese. Ky veprim **është në kundërshtim** me nenin **78 të Ligjit nr. 162/2020**" Për prokurimin publik", i cili përcakton se autoriteti kontraktor është i detyruar të verifikojë dhe të dokumentojë zbatimin e kontratës sipas kushteve të përcaktuara në të. Gjithashtu, praktika bie në kundërshtim me nenin **56 të VKM nr. 285,** datë 19.05.2021, që rregullon zhvillimin e procedurave me vlerë të vogël dhe kërkon që në të gjitha rastet të respektohet parimi i dokumentimit të qartë dhe të verifikueshëm të përmbushjes së objektit të kontratës

❖ **Prokurim "Shërbim përkthimi"**

Ne regjistrin e **parashikimeve** të prokurimeve publike **për vitin 2024** është parashikuar kryerja e procedurës së prokurimit, blerje e vogël, me objekt "**Shërbimit të përkthimit**" me fond limit **391,000 lekë** (pa TVSH), i ndryshuar (shtuar) ne regjistrin e parashikimeve me shkrese nr. 1225/3 prot, datë 25.03.2024 ne shumen 200,000 lekë.

Regjistri i **realizimit** të prokurimeve për vitin 2024 për prokurimit, blerje e vogël, me objekt "Shërbimit të përkthimit" rezulton i realizuar me fond limit 124,550 lekë (pa TVSH).

Regjistri realizimit "Shërbim perkthimi"2024

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Lloji i Procedures se Prokurimit	Vlera e kontratës	Nr. referencës ne SPE
24	Shërbime përkthimi i ndryshuar	191,000	Small Value	95,550	REF-32434-12-10-2024
25	Shërbime te përkthimit	200,000	Small Value	3,000	REF-04502-05-13-2024
				800	REF-22957-10-07-2024
				25,200	REF-15136-08-01-2024

Nga auditimi rezulton se:

- Ne procedurën e prokurimit me REF-22957-10-07-2024 ne dosjen e prokurimit ne proces verbalin i marrjes ne dorëzim date 11.10.2024, mungon referenca ne Urdhëri per ngritjen e Komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimit të kryer, mungon flete hyrje dhe fatura tatimore e shërbimit te përfunduar.
- Ne procedurën e prokurimit me REF-32434-12-10-2024 ne dosjen e prokurimit mungon proces verbali i marrjes ne dorëzim date 23.12.2024,
- Ne procedurën e prokurimit me REF-15136-08-01-2024 ne dosjen e prokurimit mungon proces verbali i marrjes ne dorëzim date 23.12.2024, veprime në kundërshtim me **VKM nr. 285, datë 19.5.2021**, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, **Neni 79**, pika 1 dhe 2: Kërkon ngritjen e një komisioni të posaçëm për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve/punëve të kryera, dhe urdhri i ngritjes së tij duhet të jetë i dokumentuar zyrtarisht neni 39, pika 4 të l**igjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik"**, i cili përcakton detyrimin për institucionin kontraktor që të ndjekë procedura të dokumentuara gjatë zbatimit të kontratës.
- **Komisioni i blerjeve te vogla** ka kryer **jashtë sistemit elektronik** procedura prokurimi *që gjatë vitit kalendarik kanë një vlerë mbi 100 000 (njëqind mijë) lekë* per blerjen në disa raste të sherbimeve të perkthimit si më poshtë vijon:
    - o për blerje e vogël procedurën e përkthimit ne **vlerën 29,960 lekë** (pa tvsh) të iniciuar me kërkesë nr.499, datë 24.01.2024 per shërbimin e "Përkthim i Marrëveshjes së Posaçme (MEA- Managed Entry Agreements", vlerësuar nga Komisioni si procedurë qe nuk duhet të realizohet me sistem elektronik ne SPE, referuar në Kreun IV, neni 11, pika 3 VKM nr. 285, dt 19.05.2021, duke konsideruar se vlera e përllogaritur , brenda një vitit kalendarik , nuk është me e madhe së 100,000 lekë;
    - o per blerje e vogël procedurën e përkthimit ne **vlerën 31,040 lekë** (pa tvsh) me iniciuar me kërkesë nr.499, datë 24.01.2024 per procedurën "Përkthim i Marrëveshjes së Posaçme (MEA- Managed Entry Agreements", vlerësuar nga Komisioni si procedurë qe nuk duhet të realizohet me sistem elektronik ne SPE, referuar në Kreun IV, neni 11,

pika 3 VKM nr. 285, dt 19.05.2021, duke konsideruar se vlera e përllogaritur , brenda një vitit kalendarik , nuk është me e madhe së 100,000 lekë.;

- o për blerje e vogël shërbimi përkthimit, likuiduar me Urdhër Shpenzim nr. 272, datë 04.06.2024 ne shumën **23,036 lekë**; likuiduar me Urdhër Shpenzim nr. 298, datë 19.06.2024 ne shumën 198,400 lekë, **vlerësuar nga Komisioni si procedurë qe nuk duhet të realizohet me sistem elektronik ne SPE,** referuar në Kreun IV, neni 11, pika 3 VKM nr. 285, dt 19.05.2021, duke konsideruar se vlera e përllogaritur, brenda një vitit kalendarik , nuk është me e madhe së 100,000 lekë.
- o Për prokurimin e shërbimit të përkthimit gjatë vitit kalendarik, është likuiduar fatura tatimore e shitjes nr. 2/2024, dt 05.02.2024 **në shumën 198,400** lekë, bazuar në Kontrate Shërbim Përkthimi nr. 217, dt 16.01.2023, Memo datë 06.02.2024, konceptuar nga E. A. Përgjegjës Sektorit Financës.Nga shqyrtimi i kësaj praktike, rezulton se shërbimi i përkthimit është porositur dhe likuiduar **pa ndjekur procedurën e prokurimit publik** dhe pa përdorimin e Sistemit Elektronik të Prokurimit, në kundërshtim me përcaktimin në pikën 2, të nenit 41, të LPP-së dhe me nenin 56 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i cili përcakton se Autoriteti/enti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë/mallra/shërbime, kur vlera e përllogaritur është ndërmjet kufijve nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë në vit.
- o Nga auditimi i kryer për vitin 2024, rezulton se, për shërbimin e përkthimit gjatë vitit kalendarik, është likuiduar **fatura tatimore e shitjes nr. 10/2023, datë 19.06.2023**, në shumën **23,036 lekë**. Fatura është bazuar në procesverbalin e datës 18.06.2023**,** me marrës në dorëzim znj. A. Nj., Drejtore në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator. Praktika është shoqëruar me dokumentin shoqërues Memo, datë 31.05.2024**,** dhe është hedhur në sistemin e Thesarit **me** urdhër shpenzimi nr. 488/2023**,** miratuar nga NA dhe NZ. Kalimi i fondit në bankë nuk është realizuar**,** për shkak të një problemi teknik në sistem, dhe si rrjedhojë veprimi nuk është finalizuar.

KONKLUZION:
Nga auditimit rezulton se nga shqyrtimi i procedurave të ndjekura **për prokurimin e shërbimit të përkthimit** gjatë vitit kalendarik, rezulton se megjithëse vlera totale e likuiduar për këtë kategori me urdhër shpenzim rezulton **407,486 lekë**, pasyruar në Aneksin 2.5 "*Procedurat e prokurimit publik "Shërbimi Përkthimit" 2024*"
Nga shqyrtimi i prokurimeve te shpenzimeve të përkthimit, rezultoi se ne 5 (pesë) transaksione në vlerën **163,690 lekë**, shërbimi i përkthimit është porositur dhe likuiduar **pa ndjekur procedurën e prokurimit publik** dhe pa përdorimin e Sistemit Elektronik të Prokurimit, në kundërshtim me përcaktimin në pikën 2, të nenit 41, të LPP-së dhe me nenin 20 pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i cili përcakton se "*Autoritetet kontraktore janë të detyruara të përdorin sistemin e prokurimit elektronik për të gjitha procedurat e prokurimit publik, përfshirë procedurat me vlerë të vogël, që kanë një vlerë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë, pa TVSH.*

❖ **Prokurim me nr. 2641 prot, ref-12169-07-24-2024 "F-V rafte për arkiv-protokollin e MSHMS**

Me shkrese nr. 2641 Prot, date 06.06.2024 nga Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme ka paraqitur kërkesa për kryerjen e procedurës se prokurimit blerje e vogël me objekt "*blerje paisje per arkiv*

protokollin e MSHMS", me fond limit 1,000,000 lekë (pa TVSH), parashikuar në regjistrin PP per vitin 2024, per kryerjen e shërbimit sipas kërkesës se Sektroit Arkiv protokoll .
Komisioni prokurimit: Urdhër nr. 7, datë 09.01.2024, i ndryshuar me urdhër nr. 07/1, datë 07.02.2024, me 07/2 datë 28.02.2024, Urdhër nr. 07/3, datë 24.06.2024 përbër nga: z. N.K. (Kryetar); z. A. N. (Anëtar) dhe E. M. (Anëtar).
Komisioni marrjes së dorëzim: Urdhër nr. 170, datë 29.03.2024 i përbërë: E. K., E. B., A. H.
Komisioni i Blerjeve të vogla ka bërë vlerësimin OE duke kualifikuar 4 OE dhe skualifikuar 6 OK per te cilët në SPE ka evidentuar arsyet e skulaifikimit.
Per OE të kualifikuar është vlerësuar si më poshtë vijon:
Pas vlerësimit të OE nëpërmjet SPE OE i klasifikuar i pari, u njoftua operatori "B. K." me oferte 449,000 lekë, i cili në datë 08.07.2024 dërgon mesazh në sistem per tërheqje nga procedura. Komisioni kalon te operatori i rrodhes, përkatësisht të OE "P. A." me ofertë 599,430 lekë, duke dorëzuar në MSHMS Formularin e ofertës dhe dokumentacionin me përkatës me protokoll nr. 2641/5, date 09.07.2024. Por ky operator nuk ka paraqitur Certifikatë ISO 9001:2015 për sistemin e menaxhimit te cilësisë, arsye per te cilën me proces verbal dt 10.07.2024. Ne vijim kalohet te operatori i radhës përkatësisht të "**F." me vlerë 650,000 lekë** (pa tvsh). Operatori me shkrese nr. 2641/6 prot, dt 10.07.2024 ka dorëzuar në MSHMS dokumentacionin me kriteret e vendosura në ftesën per ofertë.
Ne date 12.07.2024 paraqitet **ankim nga BOE "B. B."** me shkrese nr. 2641/7 prot, dt 12.07.2024 me arsyetimin se BOE ishte skualifikuar gabim. Ankesa **u shqyrtua dhe u pranua** nga AK dhe me shkresë date 16.07.2024. **BOE u njoftua si fitues për të dorëzuar** pranë AK dokumentacionin e kërkuar në ftesën për ofertë. Me date 17.07.2024 BOE ka dorëzuar dokumentacionin në protokoll. Komisioni i Blerjeve të vogla me proces verbal dt 22.07.2024 skualifikohen me arsyetimin se pjesa e shërbimit, punës ose furnizimin që do të kryeje secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve si dhe nuk ka paraqitur vërtetim për konfirmimin e shlyerjes se detyrimeve tatimore dhe pagesës se kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
Ne këto kushte me proces verbal (përfundimtar) datë 22.07.2024 Komisioni i Blerjeve me vlerë të vogël, **konfirmoi si fitues OE "F." me NIPT K……..B, me vlerë fituese 650,000 lekë (pa tvsh)**
Me proces verbal date 05.08.2024 Komisioni i marrjes në dorëzim morri në dorëzim, raftet metalike për arkiv protokollin e MSHMS.
Me dokument Memo date 19.08.2024, praktika është dërguar per pagesë në Sektorin e Financës, me fature tatimore nr. 467/2024, dt 05.08.2024 dhe Flete Hyrje në magazine nr. 15, datë 05.08.2024
Nga auditimi rezulton se:
MSHMS në cilësie e AK ne ftesën për ofertë nr. 2641/3 prot, datë 04.07.2024 në dokumentet e tenderit ka kërkuar (pika 8) ka kërkuar se ofertuesi duhet të këtë të punësuar, **minimumi 4 (katër) punonjës të cilët duhet të figurojnë në listë pagesat e shoqërisë për periudhën e fundit të deklaruar**.
Sipas Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", autoritetet kontraktore kanë të drejtë të përcaktojnë kritere përzgjedhjeje që lidhen me kapacitetin ekonomik, financiar dhe teknik të operatorëve ekonomikë. Në gjykimin e grupit të auditimit, kërkesa për një numër minimal të punësuarish nuk **është e justifikuar** nga specifikat e kontratës dhe nevojat për kapacitete të caktuara për realizimin e saj, **diskriminon** operatorët ekonomikë më të vegjël ose të rinj në treg, **nuk gjen** mbështetje me arsyetim të qartë për nevojën e saj.

Ne dokumentet e prokurimit, fituesi ka paraqitur **Certifikatë ISO 9001:2015**. **Sipas** Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" **dhe** akteve nënligjore përkatëse **(si** VKM nr. 285, datë 19.5.2021**. Certifikata e cilësisë në një procedurë prokurimi publik nuk rezulton të jetë lëshuar nga një organ certifikimi i akredituar përkatësisht Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA)** ose nga një trup i akredituar ndërkombëtarisht, pjesë e EA, IAF apo ILAC, veprim në kundërshtim ligjit nr. 162/2000 dhe nenin 44 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 sipas të cilës: "*Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*"

❖ **Mobilimi dhe plotësimi me pajisje i QSH-ve dhe ambulancave të rikonstruktuara**

Nga verifikimi i kryer në terren u konstatua se:

✓ Sa i përket *treguesve sasiorë* të artikujve të furnizuar:

1. **Qendra Shëndetësore nr. 2 Vlorë (ose Amb. "28 nëntori"**) ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mobiljeve të furnizuara nëpërmjet fletë-hyrjes nr. 3, datë 27.11.2024, në vlerën totale prej **2,545,923 lekë**.

Si fillim, mungesa e aktiviteteve të kontrollit nga ana e MSHMS-së, në lidhje me verifikimin e nevojave reale për furnizim nga kjo QSH, ka sjellë që të pranohet, miratohet, e më tej prokurohet kërkesa me sasi të pajustifikuar të artikujve në raport me madhësinë e kësaj qendre shëndetësore. Sipërfaqja totale e kësaj QSH-je, bashkë me ambientet e jashtme, është rreth 160m^2 (bazuar në planimetrinë përkatëse) ku përfshihen gjithsej 8 dhoma mjeku/ mjekimi. Pavarësisht kësaj, është miratuar pranuar pa asnjë verifikim kërkesa për furnizim për artikujt, si 40 copë karrige për mjekun, 25 copë karrige për pacientin, 30 copë tavolina pune për mjekun, 16 copë shtrat vizite dhe shkallë ndihmëse, 20 copë dollapë mjeku, 42 copë rafte për dokumentacion, 18 sete me nga 3 karrige për pritje në holl, etj. Nga verifikimi në terren u konstatua se objekti i QSH nr. 2 Vlorë ka gjithsej 18.35m^2 dritare (duke përfshirë dhe dritaret e tualeteve, ku nuk vendosen perde me mekanizëm), ndërkohë që është furnizuar me 116m^2 perde me mekanizëm. Nga Zyra e Financës pranë QSH-së nr. 2 Vlorë u vu në dispozicion Urdhri nr. 658, datë 27.12.2024 (1 muaj pas dokumentit të fletë-hyrjes në QSH), nëpërmjet të cilit Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS-së ka urdhëruar kalimin kapital të artikujve (sikurse cituar "*bazuar në kërkesën e OSHKSH Vlorë nr. 2824/1 prot., datë 18.12.2024*"), nga QSH nr. 2 Vlorë në Qendrën Shëndetësore Bubullimë, Lushnje. Artikujt e marrë në dorëzim dhe artikujt e përfshirë në kalimin kapital rezultojnë, si më poshtë:

Nr.	**Artikulli**	**Sasia e artikullit sipas Fletë-hyrjes nr. 3, datë 27.11.2024**	**Sasia e artikullit e përfshirë në kalimin kapital me Urdhrin nr. 658, datë 27.12.2024**	**Diferenca**
1	Karrige për stafin mjekësor	40	30	10
2	Karrige për pacientin	25	-	25
3	Tavolinë pune për mjekun	30	15	15
4	Shtrat vizite	16	7	9
5	Shkallë ndihmëse	16	7	9

6	Stativ serumi	4	3	1
7	Dollap mjeku	20	8	12
8	Raft për dokumenta	42	11	31
9	Karrige holli me 3 poste	18	6	12
10	Perde me mekanizëm	116 m^2	51.74m^2	64.26m^2
11	Recepsion me 1 post	2	1	1
12	Raft për ilaçe dhe pajisje	4	2	2
Vlera totale (në lekë)		**2,545,923**	**1,071,701.6**	**1,474,221.4**

Nga verifikimi fizik i diferencës së mbetur pas kalimit kapital janë konstatuar diferenca, p.sh në ambientet e QSH nr. 2 Vlorë nuk gjendeshin 10 karrige për stafin mjekësor, por vetëm 8 të tilla; nuk gjendeshin 12 karrige holli me 3 poste, por vetëm 5 të tilla; kishte diferenca në artikujt tavolina pune për mjekun, shtrate vizitash & shkallëve ndihmëse, dollap mjeku, rafte për dokumenta. Nga përgjegjësi i zyrës së financës u konfirmua verbalisht se një pjesë e pajisjeve/ mobiljeve u ishin transferuar ambulancave të tjera që kanë patur nevojë, por pa vënë në dispozicion dokumentacion të natyrës vërtetuese, si fletë-dalje magazine dhe/ ose procesverbale përkatëse. Për sa më sipër, ishte e pamundur të verifikohej prezenca fizike e të gjithë mobiljeve të marra në dorëzim.
Në vijim, pas përfundimit të verifikimit në terren, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në MSHMS u vu në dispozicion dokumentacioni i përcjellë nga QSH nr. 2 Vlorë, si fletë-daljet nga magazina dhe plani i shpërndarjes nr. 185 prot., datë 19.12.2024, ku është miratuar shpërndarja e artikujve (të cilat nuk u konstatuan fizikisht gjatë verifikimit në terren) nga QSH nr. 2 Vlorë, Amb. "28 nëntori", drejt 3 ambulancave të tjera, Amb. "Osman Haxhiu", "Rajoni 5" dhe "11 janari", në vlerën totale prej 373,234.2 lekë.
Nga auditimi u konstatua se rreth 55% e vlerës totale të artikujve të kërkuar për QSH-në nr. 2 Vlorë është planifikuar gabimisht dhe kërkesa nuk paraqiste nevojat reale të QSH-së, duke rezultuar (i) në kalimin kapital të artikujve në masën rreth 40% të vlerës totale në QSH-në Bubullimë, Lushnje, e cila nuk ishte planifikuar fillimisht, dhe (ii) në lëvizjet e artikujve në masën rreth 15% të vlerës totale në ambulanca të tjera, lëvizje për të cilat, MSHMS-ja nuk ishte vënë në dijeni.
2. **Qendra Shëndetësore "Armen"** (Vlorë) ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mobiljeve të furnizuara nëpërmjet fletë-hyrjes nr. 9, datë 02.12.2024, në vlerën totale prej **589,244.23 lekë**. Përgjithësisht, mobiljet e furnizuara ishin vënë në punë brenda ambienteve të QSH-së, me përjashtim të 2 artikujve tavolina pune, të cilat sikurse konfirmuar verbalisht nga përgjegjësi i zyrës së financës në QSH, ishin transferuar pranë QSH/Amb. Karbunarë, Vlorë, por pa paraqitur dokumentacion të natyrës vërtetuese, si fletë-dalje dhe/ ose procesverbal. Gjithashtu, 1 shtrat vizite & shkallët ndihmëse administroheshin në një ambient të përshtatur si magazinë dhe nuk ishin vënë në punë, pasi ambientet e dhomave të mjekëve ishin të plotësuar.
Në vijim, pas përfundimit të verifikimit në terren, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në MSHMS u vu në dispozicion dokumentacioni i përcjellë nga QSH Armen, si fletë-daljet nga magazina dhe plani i shpërndarjes nr. 120 prot., datë 03.12.2024, nëpërmjet të cilit 2 artikujt tavolinë pune kalojnë për plotësim nevojash nga QSH Armen drejt Ambulancës Karbunarë, Vlorë.

3. **Qendra Shëndetësore Maliq** ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mobiljeve të furnizuara

nëpërmjet fletë-hyrjes nr. 14, datë 11.11.2024, në vlerën totale prej **1,584,829.2 lekë**. Përgjithësisht, mobiljet e furnizuara ishin vënë në punë brenda ambienteve të QSH-së, me përjashtim të 1 tavoline pune për mjekun, e cila ishte transferuar në Ambulancën e Kolanecit, sikurse konfirmuar verbalisht nga personi që administron magazinën pranë QSH Maliq, por pa paraqitur dokumentacion të natyrës vërtetuese, si fletë-dalje dhe/ ose procesverbal. Sa i përket artikullit "*Raft për ilaçe dhe pajisje*", për të cilin është konfirmuar marrja në dorëzim në sasinë prej 21 copë, nga verifikimi në terren u konstatua se ishin marrë në dorëzim gjithsej 19 copë nga ky artikull, por janë dorëzuar shtesë 5 rafte/ komodina të vogla në përmasat 45*45*h65, të cilat nuk figuronin në fletë-hyrje. Sa i përket artikullit "*recepsion me 3 poste, me dy nivele*", me përmasa 390*60*h75, për të cilin është konfirmuar marrja në dorëzim e 2 copëve, nga verifikimi në terren u konstatua se ishin marrë në dorëzim 6 recepsione me 1 post, me përmasa 130*70*h75 secili. Sa i përket artikullit "perde me mekanizëm", QSH Maliq është furnizuar në sasinë 72m^2. Nga verifikimi në terren u konstatua se në QSH Maliq kishte gjithsej 31 dritare, me sipërfaqe totale të të gjithë dritareve (përfshirë edhe dritaret e tualeteve që nuk pajisen me perde me mekanizëm) 51.17m^2. Pavarësisht sa më sipër, 3 nga dritaret kryesore në katin e dytë të objektit nuk janë pajisur me perde, me pretendimin se "*sasia e perdeve nuk ka qenë e mjaftueshme për t'i pajisur të gjitha dritaret*", duke vijuar të përdorin për këto dritare perde të vjetra pa mekanizëm që dispononin përpara marrjes në dorëzim të artikujve të furnizuar.

4. **Qendra Shëndetësore Velipojë** (Shkodër) ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mobiljeve të furnizuara nëpërmjet fletë-hyrjes nr. 9, datë 21.11.2024, në vlerën totale prej **984,083.2 lekë**. Mobiljet e furnizuara ishin vendosur në ambientet e QSH-së, sipas sasive përkatëse. Nga verifikimi në terren u konstatua se 2 artikujt "*karrige për mjek*" ishin dëmtuar dhe një artikull "shkallë ndihmëse për shtratin e vizitës" ishte thyer, duke dalë jashtë funksionit.

Foto nr. 1-2: Pajisjet e dëmtuara në QSH Velipojë

Burimi: Grupi i auditimit

5. **Qendra Shëndetësore Paskuqan 2** (Tiranë) ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mobiljeve të furnizuara nëpërmjet fletë-hyrjes nr. 12, datë 20.08.2024, në vlerën totale prej **850,319.4 lekë**. Mobiljet e furnizuara ishin vendosur në ambientet e QSH-së, sipas sasive përkatëse dhe nuk u konstatuan problematika apo dëmtime të tyre.

6. **Qendra Shëndetësore Bicaj** (Kukës) ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mobiljeve të furnizuara nëpërmjet fletë-hyrjes përkatëse, në vlerën totale prej 470,734.5 lekë. Nga verifikimi në terren u konstatua se një pjesë e mobiljeve ishin transferuar në ambulanca të tjera (Amb. Bushat & Amb. Osmanaj, Kukës), pa vënë në dispozicion të grupit të auditimit dokumentacionin vërtetues (si procesverbale, fletë-dalje nga magazina). Artikujt e transferuar në ambulancat e tjera konsistonin në 2 rafte për dokumentacion, 3 tavolina pune për mjekun, 3 karrige për pritje holli (treshe), 1 stativ, 1 dollap mjeku, 1 shtrat vizite dhe 1 shkallë krevati, në vlerën totale prej

146,650.2 lekë, ose rreth 31% të vlerës totale të artikujve të furnizuar.

7. **Qendra Shëndetësore Fshat Këlcyrë** ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mobiljeve të furnizuara nëpërmjet fletë-hyrjes nr. 82, datë 15.04.2025, në vlerën totale prej **505,483.728 lekë**. Nga verifikimi në terren u konstatua se e gjithë sasia e furnizuar ishte brenda ambienteve të kësaj QSH-je, por sasitë e furnizuara ishin konsiderueshëm në tejkalim të nevojës reale, duke rezultuar që një pjesë e madhe e mobiljeve të ishin grumbulluar në një ambient të përshtatur si magazinë, të pavëna në punë në funksion të mobilimit të QSH-së.

Foto nr. 3: Ambienti i përshtatur si magazinë pranë QSH Fshat Këlcyrë



Burimi: Grupi i auditimit

8. **Qendra Shëndetësore Roshnik** (Berat) ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mobiljeve të furnizuara nëpërmjet fletë-hyrjes nr. 4, datë 16.09.2024, në vlerën totale prej **376,381.2 lekë**. Nga verifikimi në terren u konstatua se e gjithë sasia e furnizuar ishte vendosur brenda ambienteve të kësaj QSH-je.

- Sa i përket *treguesve cilësorë* të artikujve të furnizuar:

Fillimisht, përfaqësuesit e QSH-ve nuk konfirmojnë të kenë administruar paraprakisht Shtojcën 5 "*Formulari i specifikimeve teknike*", përpara marrjes në dorëzim të artikujve të furnizuar, për të mundësuar krahasimin e artikujve të furnizuar me specifikimet teknike të miratuara nga MSHMS-ja.

Për artikullin "*Tavolinë pune për mjekun/ infermierin*" është përcaktuar "*me 4 këmbë material inoksi, këmbët mat tub oval...*". Nga verifikimi në terren, u konstatua se vetëm në QSH Paskuqan dhe QSH Roshnik këmbët e tavolinave ishin me material inoksi, por sërish jo me tub oval, ndërsa në QSH-të e tjera këmbët e tavolinave ishin me material dërrasë, jo në përputhje me specifikimet teknike, pasi nuk kanë këmbë me material inoksi, mat tub oval, problematika këto të paevidentuara nga komisioni i marrjes në dorëzim, në kundërshtim me nenin 107 të RPP-së dhe specifikimet teknike të përcaktuara në DST.

Foto nr. 4-5: Tavolinat e punës të marra në dorëzim (dy llojet)



Burimi: Grupi i auditimit

Për artikullin "*Shtrat vizitash*" është përcaktuar "*...i pajisur në fund të shtratit me mbajtësen e letrës rulo universal*". Nga verifikimi në terren u konstatua se shtratet e vizitave nuk ishin të pajisura me mbajtëset e letrës rulo universal, problematika këto të paevidentuara nga komisioni i marrjes në dorëzim, në kundërshtim me nenin 107 të RPP-së dhe specifikimet teknike të përcaktuara në DST.

Foto nr. 6-7: Shtratet e vizitave të marra në dorëzim (dy llojet)



Burimi: Grupi i auditimit

Për artikullin "*Dollap mjeku për dhomë konsulte*" është përcaktuar "*...me kapak gjatësor të kornizuar me elementë metalikë me kënde të rrumbullakosura*". Nga verifikimi në terren u konstatua se kapakët e dollapit nuk ishin të kornizuara me elementë metalikë me kënde të rrumbullakosura, problematika këto të paevidentuara nga komisioni i marrjes në dorëzim, në kundërshtim me nenin 107 të RPP-së dhe specifikimet teknike të përcaktuara në DST. Gjithashtu, në QSH Fshat Këlcyrë, artikulli i furnizuar si dollap mjeku, nuk kishte ndarjen e përcaktuar për të varur rroba, por vetëm rafte për dokumentacion.

Foto nr. 8-9: Artikulli "dollap mjeku" i furnizuar në QSH Fshat Këlcyrë dhe në QSH-të e tjera

Burimi: Grupi i auditimit

Për artikullin "*Karrige për pritje holli e thjeshtë*" është përcaktuar "*Set karrige vizitorësh, të përbëra nga 3 karrige të lidhura bashkë, ku ndenjëset janë të veshura me material kundra zjarrit, antibakterial, të padepërtueshëm nga uji dhe shpinorja është e përbërë nga material i fortë (laminant)*". Nga verifikimi në terren u konstatua se artikulli i furnizuar në QSH Maliq, QSH Paskuqan 2 dhe QSH Roshnik janë të ndryshme nga QSH-të e tjera, duke konsistuar në 3 karrige (të njëjta me karriget për pacient), por të salduara me njëra-tjetrën, ndërkohë që në QSH-të e tjera ulëset ishin metalike. Ndenjëset nuk janë të veshura me material kundra zjarrit, të padepërtueshëm nga uji dhe shpinorja nuk përbëhet nga material i fortë, problematika këto të paevidentuara nga komisioni i marrjes në dorëzim, në kundërshtim me nenin 107 të RPP-së dhe specifikimet teknike të përcaktuara në DST.

Foto nr. 10-11: Artikulli "karrige për pritje holli e thjeshtë" (dy llojet)




Burimi: Grupi i auditimit

Mbi sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nëpërmjet shkresës nr. 85/3 prot., datë 05.02.2026, administruar në KLSH me nr. 110/30 prot., datë 09.02.2026, anëtarët e Komisionit të Dhënies së Minikontratave kanë paraqitur observacionin, si më poshtë:
Pretendimi i subjektit: 1. Planifikimi i nevojave për zhvillimin e procedurës me objekt "Blerje orendi dhe pajisje mobilimi" për QSH/Amb të rikonstruktuara, është kryer nga grupi i punës i ngritur me urdhër titullari me nr. 309/1 datë 13 0620023 me objekt "Hartimi i specifikimeve teknike, përllogaritjen e fondit limit, për procedurën e prokurimit me objekt "FV pajisje mjekësore

dhe mobilimi" për QSH të rikonstruktuara", dokumentacion i cili është dërguar për prokurim në ASHPP. Si rrjedhojë, komisioni vendosi marrjen në konsideratë të sasive të konfirmuara nga secili OSHKSH, gjithmonë në përputhje me fondin limit të parashikuar për këtë Marrëveshje Kuadër, dhe brenda kompetencave të Komisionit të Dhënies së Minikontratave për MK, të përcaktuara qartësisht në urdhrin nr. 08 date 09 (011 2024 dhe nr. 08/2 datë 19.06.2024 (i ndryshuar).
2. Komisioni i marrjes në dorëzim në zbatim të urdhrit nr. 08 datë 09.01.2024 dhe nr. 08/2 datë 19.06.2024 (i ndryshuar), është përgjegjës për dhënien e minikontratave të MK si raportimi në OQB për lidhjet e minikontratave. Për këtë arsye janë ngritur komisionet e marrjes në dorëzim.
3. Komisioni i Dhënies së Minikontratave në zbatim të urdhrit nuk është përgjegjës për planifikimin, zbatimin dhe lëvizjen e aktiveve. Në zbatim të urdhrit nr. 08 datë 09.01.2024 dhe nr. 08/2 datë 19.06.2024 (i ndryshuar), Komisioni është përgjegjës për lidhjen e Minikontratave dhe si vijon:
a. Dërgimin e njoftimit të kontratës/ave të lidhura pranë organit qendror blerës sipas mënyrës dhe afateve të përcaktuara në RRPP, udhëzimin e APP dhe Organin Qendror Blerës.
b. Dërgimi pranë personave përgjegjës për prokurimin, me qëllim përcjelljen pranë APP të planeve të zbatimit të kontratës/ave sipas parashikimit të nenit 125 të LPP, si dhe raportimet për ecurinë e zbatimit të kontratës në rastet kur kërkohet, dhe raportimi përfundimtar të ekzekutimit të kontratës.
c. Hartimin e vërtetimeve për zbatimin e kontratave, objekt i këtij urdhri me kërkesën e të interesuarve.
4. MSHMS si institucion, në përputhje me funksionin dhe kompetencat që i janë ngarkuar ka vepruar konform hierarkisë. Është vlerësuar që verifikimi paraprak të bëhej nga OSHKSH-të përkatëse të cilët kanë në varësi hierarkik të drejtpërdrejtë me QSH/Amb, për të cilën u është përcjellë dokumentacioni për ndjekjen përkatëse. Megjithatë, kemi mbajtur qëndrim institucional duke bashkëpunuar me strukturat përkatëse dhe duke ndjekur procedurat sipas praktikës së vendosur. Gjithashtu, sqarojmë se në çdo rast që përmendet MSHMS, konsiderohet edhe për institucionet e varësisë së saj. Ky veprim është në përputhje me strukturën hierarkike dhe mënyrën e funksionimit të sistemit shëndetësor, me qëllim garantimin e një procesi të mbikëqyrur institucionalisht. Ky proces është ndjekur nga OSHKSH përkatëse në bashkëpunim me QSH/Amb, si struktura në varësi të drejtpërdrejtë nga OSHKSH-të Rajonale.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit është shprehur se parregullsitë e konstatuara, në planifikim, zbatim dhe lëvizjen e aktiveve, vijnë nga mungesa e aktiviteteve të përshtatshme të kontrollit nga MSHMS-ja, dhe jo vetëm nga Komisioni i Dhënies së Minikontratave, që ka patur për detyrë ndjekjen e zbatimit të kësaj kontrate. Në kontratën e lidhur ndërmjet MSHMS dhe OE është përcaktuar në mënyrë nominale se përfaqësuesit e MSHMS-së do të kryejnë verifikim paraprak të pajisjeve të mobilimit, sikurse janë përcaktuar edhe detyrat përkatëse për institucionet e varësisë së MSHMS-së. Punonjësit e MSHMS-së të ngarkuar me detyrat përkatëse, duhet të zbatonin me përpikmëri dispozitat e kontratës, ndër të tjera ku kërkohet kryerja e verifikimit paraprak nga përfaqësues të MSHMS-së, dhe jo *të vlerësonin* shmangien nga ky detyrim, duke riskuar realizimin e kontratës në përputhje me specifikimet teknike. Për më tepër, neni 124, pika 1, i LPP-së, ngarkon MSHMS-në, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, me detyrimin për ndjekjen e zbatimit të kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit. *Për sa më sipër, kjo pjesë e observacionit nuk merret parasysh*.

2.4 Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe

auditit të brendshëm.

*Baza ligjore mbi të cilën mbështetet auditimi***:**

- "Manuali i Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik", miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar;
- Ndryshimet në Manualin e Auditimit të Brendshëm, të miratuara me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë;
- Ligji nr. 114/2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar (ndryshuar me Ligjin nr. 12, datë 02.02.2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 114, datë 22.10.2015, 'Për auditimin e brendshëm në sektorin publik'");
- Vendimi nr. 160, datë 02.03.2016, "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike";
- VKM nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të AB në sektorin publik";
- Vendimi nr. 353, datë 11.05.2016, "Për një ndryshim në Vendimin nr. 83, datë 03.02.2016, të Këshillit të Ministrave, 'Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik'";
- LIGJ Nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore".
- Ligji Nr.9154, datë 6.11.2003 për Arkivat (Ndryshuar me Ligjin nr. 27/2024, datë 4.4.2024).
- Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Dokumentacioni i shqyrtuar:

- Urdhri i Kryeministrit nr. 121, datë 28.10.2021, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale";
- Urdhri i Kryeministrit nr. 14, datë 25.01.2024, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale";
- Urdhri i Kryeministrit nr. 205, datë 23.10.2024, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale";
- Kodi i Etikës, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 86, datë 10.12.2015 (shkresë nr. 17059 prot).
- Karta e Auditimit, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 202, datë 27.02.2018 (shkresë nr. 1585 prot).
- Plani Strategjik dhe Vjetor për vitet 2023–2025, miratuar me nr. 3656/1 prot, datë 19.10.2022.
- Raporti përmbledhës për periudhën janar–dhjetor 2023, me nr. 782/2 prot, datë 13.02.2024;
- Raporti vjetor i auditimit për rekomandimet e vitit 2023, miratuar me nr.1569, datë 29.03.2024.
- Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë "Për angazhim auditimi" me nr. 742, datë 18.12.2023 (shkresë nr. 4631 prot, datë 18.12.2023).
- Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë "Për angazhim auditimi" me nr. 293, datë 16.05.2023 (shkresë nr. 2013 prot, datë 16.05.2023).
- Plani Strategjik dhe Vjetor për vitet 2024–2026, miratuar me nr. 3414/1 prot, datë 12.10.2023.
- Raporti përmbledhës për periudhën janar–dhjetor 2024, miratuar me nr. 293/1 prot, datë 14.02.2025.

- Raporti vjetor i auditimit për rekomandimet e vitit 2024, miratuar me nr. 1669, datë 10.04.2025.
- Një ndryshim në planin vjetor 2024 nr. 1101, datë 26.02.2024: Shtohet auditimi pranë "Spitalit Universitar Obstetrik-Gjinekologjik Koço Gliozheni, Tiranë".
- Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë "Për angazhim auditimi" me nr. 244, datë 30.04.2024 (shkresë nr. 2045 prot, daë 30.04.2024);
- Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë "Për angazhim auditimi" me nr. 454, datë 26.08.2024 (shkresë nr. 3615 prot, datë 26.08.2024);
- Kërkesë për miratim të rishikimit të Planit Vjetor 2024, me nr. 4823 prot, datë 26.11.2024.

Dosjet e raporteve të auditimit të brendshëm:
- Drejtoria e Shërbimit Spitalor Pogradec (Periudha: 01 Shtator 2018 deri më 31 Gusht 2023);
- Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore Tiranë (Periudha: 01 Janar 2022 deri më 30 Qershor 2023);

Brendshme (për vitin 2024):
- Spitali Universitar i Traumës, Tiranë (Periudha: 03.05.2024 – 10.05.2024);
- Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Periudha: 01 Janar 2023 deri më 31 Dhjetor 2023).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

1.Organizimi i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm viti 2023.

Mbi zbatimin e Kreut IV "Organizimi i Auditimit të Brendshëm" të ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, u konstatua:

Drejtoria e Auditimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është ngritur dhe funksionon në përputhje me ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, si dhe me VKM-në nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të AB në sektorin publik", i ndryshuar.

Organizimi i drejtorisë është në nivel drejtorie që nga viti 2004 dhe ndodhet në varësi të drejtpërdrejtë nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duke përmbushur detyrimin ligjor për pavarësi, të parashikuar nga Standardi Atributiv nr. 1100 i Institutit Ndërkombëtar të Auditorëve të Brendshëm, si dhe në zbatim të ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 10, pika 2. Ndërkohë, varësia organizative është nga Sekretari i Përgjithshëm.

Struktura e drejtorisë është e miratuar me 5 punonjës për vitet 2023:
- Drejtor Drejtorie (1)
- Specialistë (4)

Për vitin 2023, konstatohet se struktura e DAB rezulton me 5 punonjës: 1 Drejtor dhe 4 Specialistë.

Nga auditimi i dokumenteve, bazuar edhe në regjistrin e trajnimeve për vitin 2023, konstatohet se audituesit pjesë e strukturës së DAB, përveç kushteve të përgjithshme të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për punonjësit që punësohen në njësinë e auditimit të brendshëm, i plotësojnë edhe të gjitha kushtet e posaçme të parashikuara në nenin 11, nenin 19 dhe nenin 20 të ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

Struktura e Auditit të Brendshëm për viti 2023.

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Arsimi	Niveli i Diplomës	Vite pune gjithsej	Vitet e punës në DAB	Certifikimi (viti)	Orët e trajnimit
1	S. D.	Drejtor i Auditit të Brënshëm	Fakulteti i Ekonomisë "Ekonimist"	Ms.Shkencor	38	20	2009	40
2	J. Q.	Specjalist Auditi	Fakulteti i Ekonomisë "Administrim Biznesi" 2Fakulteti i Drejtësisë	Ms.Shkencor	16	15	2012	40
3	M. K.	SpecjalisteAuditi	Fakulteti I Ekonomisë "Administrim Biznesi"	Ms.Shkencor	28	25	2008	40
4	S. R.	SpecjalisteAuditi	F Ekonomisë "Ad.Biznesi" F.Juridik "Drejtësi"	Ms.Shkencor	21	17	2010	40
5	Z. K.	Specialist Auditi	F Ekonomisë "Agrobiznes"	Ms.Shkencor	34	14	2012	40

Burimi: Të dhënat nga MSHMS, përpunim nga grupi i KLSH-së.

1.Konkluzion:

Mbi mosfunksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2023.

Gjatë auditimit të veprimtarisë në Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), është konstatuar se Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk ka funksionuar gjatë vitit 2023. Ky komitet është krijuar me urdhër të ministrit në vitin 2018, por mandati i anëtarëve të tij ka përfunduar në fund të vitit 2020. "Pas kësaj date, nuk janë emëruar anëtarë të rinj nga titullari i ministrisë dhe, për rrjedhojë, aktiviteti i komitetit është pezulluar."

- *Ligjit nr. 114/2015,* "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, neni 12 "Përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike", pika b): *krijimi i Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike përkatëse, sipas kritereve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave,* siç parashikohet në shkronjën **"***b" të nenit 23* të këtij ligji;
- *Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 160, datë 02.03.2016,* "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike", Kreu I, Kreu II dhe Kreu III.

2.Mbi përgjigjësite e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm.

Mbi zbatimin e përcaktimeve të nenit 14 dhe nenit 16, Kreu V "Të drejtat dhe përgjegjësitë e audituesve të brendshëm" të ligjit nr. 114/2015, i ndryshuar, si dhe të Manualit të Auditit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik, i ndryshuar", u konstatua:

Karta e Auditit.

Nga auditimi konstatohet se Drejtoria e Auditit të Brendshëm (DAB) ka hartuar "Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik", e cila është miratuar me Urdhrin nr. 202, datë 27.02.2018, të Ministrit të Shëndetësisë, në zbatim të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 14, germa "b", si dhe të Urdhrit nr. 100, datë 25.10.2016, të Ministrit të Financave "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik".

Nga auditimi i dokumenteve u konstatua se Karta e Auditimit të Brendshëm përmban strukturën dhe formatin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, kapitulli II, Formati Standard 1 "Modeli i Kartës së Auditimit të Brendshëm".

Planifikimi dhe zbatimi i planit strategjik dhe planit vjetor 2023.

Nga auditimi konstatohet se DAB ka hartuar dhe miratuar Planin Strategjik 2023–2025 me Urdhrin nr. 3656/1, datë 19.10.2022, "Për miratimin e Planit Strategjik 2023–2025 dhe Planit Vjetor 2023 të Drejtorisë së Auditimit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale", në përmbushje të detyrimit ligjor të përcaktuar në ligjin nr. 114/2015, neni 14, germa "c", si edhe në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, pika 3.3 "Afati i përgatitjes dhe miratimit të planit strategjik dhe planit vjetor".

Nga auditimi i dokumenteve konstatohet se Plani Strategjik dhe Plani Vjetor kanë të bashkëngjitura të gjitha pasqyrat e përcaktuara në Manualin e AB-së, kapitulli III. Konstatohet se hartimi i Planit Strategjik nga DAB përmban të gjithë elementët dhe është në përputhje me formatin dhe strukturën e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Formati Standard nr. 5 "Hartimi i Planit Strategjik dhe Vjetor të NJAB".

Për hartimin e planit strategjik, fillimisht DAB ka identifikuar subjektet me risk për t'u planifikuar dhe subjektet për të cilat auditimi është i detyrueshëm brenda një frekuence jo më të madhe se 5 vjet. Për planifikimin strategjik 2023–2025, DAB ka identifikuar subjektet që janë prekur nga ndryshimet në organizimin e sistemit shëndetësor dhe mbrojtjes sociale, ndryshimet e fundit në aktet ligjore lidhur me krijimin e institucioneve të reja ose organizimin e shërbimeve, si dhe në mënyrën e organizimit të shërbimit të auditimit të brendshëm, kryesisht në institucionet spitalore.

Për planin strategjik dhe vjetor 2023–2025 janë identifikuar gjithsej 29 subjekte për t'u audituar, nga 30 të identifikuara në vitin 2022. Ky ndryshim i numrit të subjekteve i referohet VKM-së nr. 637, datë 27.10.2021, "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror", nga bashkimi i dy institucioneve:

- Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore, dhe
- Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim.

Pas identifikimit të subjekteve, DAB ka përcaktuar fushat/sistemet prioritare për hartimin e planit strategjik, në respektim të Manualit të AB-së, kapitulli III "Planifikimi i veprimtarive të auditimit të brendshëm". Për këtë qëllim, është përcaktuar universi i auditimit, i përbërë nga sistemet dhe mënyra e funksionimit, strukturimit apo kombinimit të tyre.

DAB, bazuar në këto fusha dhe sisteme të identifikuara, ka përcaktuar nevojat për auditim për periudhën trevjeçare, duke konsideruar burimet e auditimit dhe vlerësimet si:

- Objektivat e auditimit;
- Përfshirja e të gjitha subjekteve në planin (1+2), me fokus në përzgjedhjen e llojit të auditimit dhe fushave me ndikim në arritjen e objektivave të sistemit shëndetësor dhe të mbrojtjes sociale;
- Programimi dhe kryerja e auditimeve sipas planit, duke ruajtur frekuencën e auditimit, vlerësimin e riskut dhe nivelin e materialitetit;
- Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm në aspektin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit, si për sistemet financiare, ashtu edhe për ato jofinanciare;
- Roli i rëndësishëm në dhënien e rekomandimeve për përmirësim dhe ndjekjen e zbatimit të tyre;

- Minimimi i kostos së auditimit përmes menaxhimit efektiv të kohës, pa cenuar cilësinë.

Konstatohet se DAB ka identifikuar dhe vlerësuar risqet për subjektet e përfshira në planin strategjik 2023–2025, në përputhje me Manualin e AB-së, kapitulli III, faza 2 "Identifikimi i risqeve". Ky proces është realizuar përmes një analize gjithëpërfshirëse të riskut dhe vlerësimit të proceseve. DAB ka identifikuar burimet kryesore të vlerësimit të riskut:

- Programimi dhe zbatimi i buxhetit;
- Menaxhimi i burimeve njerëzore;
- Procedurat e prokurimeve;
- Pagesat financiare;
- Kontabiliteti dhe raportimi financiar;
- Shërbimi stomatologjik;
- Inspektimi.

Bazuar në këtë analizë, është kryer kategorizimi i subjekteve sipas riskut në tre nivele: i lartë, i mesëm dhe i ulët. DAB ka përcaktuar subjektet që do të auditohen në secilin vit të periudhës strategjike, duke marrë në konsideratë edhe risqet me status "pas kontrolleve", të deklaruara nga vetë subjektet. Sipas regjistrit përkatës, DAB ka identifikuar një subjekt me risk të lartë: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në planifikimin strategjik 2023–2025, DAB ka përfshirë të gjitha subjektet për t'u mbuluar me auditim brenda kuadrit kohor 5-vjeçar (1+2+2), pavarësisht se kur auditohet secili prej tyre.

Gjithashtu, DAB ka identifikuar kufizimet e mundshme që mund të pengojnë arritjen e objektivave, si edhe ka përcaktuar prioritetet për tri vitet e ardhshme në funksion të përmirësimit të punës, në përputhje me Manualin e AB-së, kapitulli III, formati nr. 5 "Struktura e Planit Strategjik".

2.Konkluzion:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me raportin vjetor të veprimtarisë për vitin 2023 të Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NjAB), rezulton se ky raport është dërguar në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm (Ministria e Financave) me shkresën nr. 782/1 prot., datë 13.02.2024, pa u miratuar paraprakisht nga titullari i institucionit (Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale).

- Manualit për Auditimin e Brendshëm, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, Kapitulli IV, pika 4.3, ku përcaktohet se: *"Njësia e auditimit të brendshëm përgatit raportin vjetor të veprimtarisë dhe, pasi merr opinionin e Komitetit të Auditimit, ia dërgon për miratim titullarit të njësisë publike. Një kopje e këtij raporti i dërgohet në rrugë zyrtare dhe në format elektronik brenda datës 15 Shkurt të çdo viti strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave."*

Konstatohet se hartimi i planit vjetor nga DAB është në përputhje me formatin dhe strukturën e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Formati Standard nr. 5 "Hartimi i Planit Strategjik dhe Vjetor të NJAB"

Procesi i hartimit të Planit Vjetor të Auditimit i është nënshtruar një analize të thellë të risqeve nga ana e DAB, që karakterizojnë projektet e investimeve të realizuara në vitet e fundit, duke pasur parasysh periudhën e pambuluar me auditim. Faktorët e riskut të identifikuar janë vlerësuar sipas rëndësisë së tyre, sikurse jepen në tabelën më poshtë. Këta faktorë janë:

- Mosplotësimi i objektivave lidhur me çështjet që mbulojnë politikat për burimet njerëzore;
- Projektim i buxhetit jo mbi bazën e prioriteteve;
- Administrimi dhe menaxhimi i aktiveve jo mbi bazë risku;
- Mosplotësimi i objektivave për projektet e investimeve;
- Mosplotësimi i objektivave për shpenzimet operative (mallra dhe shërbime të tjera);
- Mosplotësimi i objektivave për krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore;
- Mosplotësimi i objektivave për standardet profesionale në shërbimin dentar;
- Shmangie e inspektimeve në subjektet private me risk të lartë në fazën e programimit, si dhe të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit nga masat administrative.

Për vitin 2023 janë planifikuar të kryhen 11 misione auditimi nga 29 subjekte, ose 37.93% e totalit të universit të auditimit, me një mesatare prej një auditimi në muaj. Në tabelën e mëposhtme jepen misionet e auditimit sipas llojit të angazhimit.

Tabela: Misionet e auditimit sipas llojit të angazhimit.

Lloji i angazhimit	Nr.	Pesha
Auditime të kombinuara	9	82%
Auditime të përputhshmërisë	1	9%
Auditime të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve	1	9%
Totali	11	100%

Burimi: MSHMS, përpunim nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Mbi realizimin e planit vjetor 2023.

Për vitin 2023, DAB ka planifikuar në planin vjetor të kryejë 11 misione auditimi. Nga auditimi i dokumenteve mbi realizimin e planit vjetor konstatohet se nga DAB janë realizuar në total 10 misione auditimi, konkretisht:

- *10 misione të realizuara,* të cilat janë të planifikuara në planin vjetor 2023, ose 90.91% e 11 të planifikuarave në total. Një auditim i programuar në MSHMS për fondet e Bashkimit Europian nuk është realizuar, pasi sistemi shëndetësor nuk ka përfituar fonde IPA.

Në planin vjetor 2023 ka pasur ndryshime. Me kërkesë të Ministrit janë shtuar edhe 2 misione auditimi shtesë ndaj planit fillestar vjetor:

- **Nr. 2013 Prot., Tiranë, më 16.05.2023. Urdhër Nr. 293, datë 16.05.2023.**

  Auditim i realizuar në 10 QSH-të e qytetit të Tiranës, me objekt *"Funksionimi i QSH-ve sipas akteve ligjore në fuqi"*.

  Ky ndryshim nuk është dërguar në Ministrinë e Financave, duke mos u reflektuar në planin vjetor të konsoliduar të auditimit të brendshëm në shkallë vendi.
- **Nr. 4631 Prot., Tiranë, më 18.12.2023. Urdhër Nr. 742, datë 18.12.2023.**

  Auditim i realizuar në NJVKSH Tepelenë, me objekt *"Veprimtaria e institucionit në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe objektivat e vendosura nga MSHMS"*.

  Edhe ky ndryshim nuk është dërguar në Ministrinë e Financave, duke mos u reflektuar në planin vjetor të konsoliduar të auditimit të brendshëm në shkallë vendi.

Në përfundim, për vitin 2023 janë planifikuar 11 misione auditimi, janë shtuar 2 misione shtesë (në total 13), prej të cilave janë realizuar 12, ose 92.31%.

3.Konkluzion:

Gjatë vitit 2023 janë realizuar dy angazhime shtesë auditimi jashtë planit vjetor të miratuar:

- Urdhri nr. 293, datë 16.05.2023 (auditimi në 10 QSH të Tiranës),
- Urdhri nr. 742, datë 18.12.2023 (auditimi në NJVKSH Tepelenë).

Këto ndryshime nuk janë komunikuar me strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, duke mos u reflektuar në planin vjetor të konsoliduar në shkallë vendi.

- *Manuali i Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar:*
  Kapitulli III, pika 3.5 – Rishikimi i planeve strategjikë dhe vjetor të auditimit të brendshëm.
  Të gjithë planet vjetorë dhe strategjikë të rishikuar të auditimit të brendshëm duhet t'i dërgohen strukturës përgjegjëse të harmonizimit për AB-në, së bashku me shpjegimet e ndryshimeve të bëra.

Gjetjet dhe Rekomandimet

Nga misionet e auditimit janë konstatuar 253 gjetje sipas fushave të përmbledhura në tabelën e mëposhtme.

Tabela: Gjetjet sipas fushës.

Gjetjet sipas fushave	Nr.	Pesha
Sistemi i prokurimeve, blerjeve & investimeve	20	8%
Sistemi i pagesave, shpërblime, trajtime, komisione.	26	10,2%
Sistemi i tatimeve,taksave,doganave.	1	0,4%
Të tjera.	206	81,4%
Totali	**253**	**100%**

Burimi: MSHMS, përpunim nga grupi audites KLSH-së.

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se numrin më të madh të gjetjeve janë në fushën e Sistemeve të tjera.

Gjetjet me efekt financiar për vitin 2023 nga NJAB:

Për 2023 janë në shumën *1,104 mijë lekë,* nga të cilat:

- *ISHSH Rajonal Tiranë* – vlera e dëmit gjithsej *1,018 mijë lekë*
- *AKBPM Tiranë* – vlera e dëmit gjithsej *74 mijë lekë*
- *ISHSH Rajonal Kukës* – vlera e dëmit gjithsej *12 mijë lekë*

Nga analiza e të dhënave rezulton se subjektet me më shumë gjetje/problematika sipas sistemeve paraqiten si më poshtë:

- *Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, Tiranë – 22 gjetje*
- *Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Rajonal, Tiranë – 16 gjetje*
- *Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Rajonal, Kukës – 20 gjetje*
- *Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor – 24 gjetje*
- *Qendrat Shëndetësore në Rrethin e Tiranës – 113 gjetje*

Nga analiza e të dhënave rezulton se DAB gjatë vitit 2023 ka dhënë gjithsej *231 rekomandime* në *12 auditime.*

Gjithashtu, nga vlerësimi i nivelit të riskut për këto 231 rekomandime, rezulton se janë dhënë:

- *89 rekomandime* të vlerësuara me *rëndësi/risk të lartë*
- *140 rekomandime* të vlerësuara me *rëndësi/risk të mesëm*

- *1 rekomandim* i vlerësuar me *rëndësi/risk të ulët*

Tabela: Rekomandimet sipas natyrës.

Rekomandimi	Nr.	Pesha %	I pranuar	I zbatuar	Në proces	I pazbatuar	Rekomandime të pa pranuara
Rekomandime të përmirësimin e sistemeve	77	33.4%	77	47	24	6	0
Rekomandime per permiresimin e kuadrit ligjor	0	0%	0	0	0	0	0
Rekomandime të karakterit organizativ	20	8.7%	20	8	11	1	0
Rekomandime per arketime	9	3.8%	9	2	6	0	1
Rekomandime te tjera	125	54.11%	125	67	41	13	4
Totali	**231**	**100%**	**231**	**124**	**82**	**20**	**5**

Burimi: MSHMS, përpunim nga grupi audituesi i KLSH-së.

4.Zbatimi i procedurave dhe evadimi i materialeve të auditimit, ruajtja dhe arkivimi i tyre.

Nga grupi i auditimit, për të verifikuar evidentimin e punës audituese dhe plotësinë e dosjeve të auditit për misionet e realizuara gjatë vitit 2023, u përzgjodhën dy dosje, përkatësisht:

- Dosja e auditimit në subjektin "Drejtoria e Shërbimit Spitalor Pogradec"
- Dosja e auditimit në subjektin "Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, Tiranë"

Nga auditimi i dosjeve të përzgjedhura u konstatua se grupet e punës kanë krijuar dosje të veçanta për secilin prej angazhimeve, dosje të cilat janë të inventarizuara. Këto dosje përmbajnë të gjithë paketën e dokumenteve për çdo fazë të procesit të auditimit, në zbatim të Manualit të AB, kapitulli IV "Kryerja e auditimit të brendshëm, ndjekja e procedurave dhe raportimi e komunikimi i auditimit", Formati Standart.
Për çdo fazë është respektuar lista e dokumenteve që duhet të përmbajë dosja dhe konstatohet se auditimet janë kryer në respektim të afateve të planifikuara në planin vjetor 2023.

Përsa i përket dokumentit "Rishikimi i Cilësisë së Punës", konstatohet se për dosjet e përzgjedhura, dokumenti është administruar në secilën prej tyre, referuar Kapitullit VII "Sigurimi i cilësisë së punës së auditimit të brendshëm", pika 4.1.10, hapi 9 "Rishikimi i punës së auditimit" në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, i ndryshuar. Në dosje gjenden pyetësorët e plotësuar nga grupet e auditimit.
Nga auditimi i dosjeve për testim, konstatohet se grupi i auditimit, pas marrjes së planit të veprimit nga subjekti i audituar, ka formuluar *Memo* (përmbledhje e shkurtër e raportit përfundimtar) dhe ia ka paraqitur titullarit të institucionit, në varësi të të cilit është subjekti i audituar, në respektim të Ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 12/1, pika 3, dhe Manualit të AB, Kapitulli IV.
Referuar kërkesave të parashikuara në "Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", një kopje e dokumenteve të dosjeve të auditimit (shkresa dhe/ose dokumente që lidhen me to) duhet të protokollohen dhe të dorëzohen në arkivën e institucionit. Nga auditimi u konstatua se dosjet e angazhimeve për vitin 2023 janë protokolluar dhe arkivuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit për vitin 2024, konstatohet se:

1.Organizimi i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm viti 2024.
Mbi zbatimin e Kreut IV "Organizimi i Auditimit të Brendshëm" të Ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, u konstatua:
Drejtoria e Auditimit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është ngritur dhe funksionon sipas Ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, dhe VKM-së nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të AB në sektorin publik", i ndryshuar. Organizimi i drejtorisë është në nivel drejtorie që nga viti 2004 dhe është në varësi të drejtpërdrejtë nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë të parashikuar nga Standardi Atributiv nr. 1100 i Institutit Ndërkombëtar të Auditorëve të Brendshëm dhe në zbatim të Ligjit nr. 114/2015, neni 10, pika 2. Ndërkohë, varësia organizative është nga Sekretari i Përgjithshëm.
Struktura e drejtorisë është e miratuar me 5 punonjës për vitet 2023–2024:

- Drejtor Drejtorie (1)
- Specialistë (4)

Në tetor 2024, me Urdhrin e Kryeministrit nr. 205, datë 23.10.2024 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së MSHMS-së", struktura bëhet (1+5):

- Drejtor Drejtorie (1)
- Specialistë (5)

Për vitin 2024 konstatohet se struktura e DAB rezulton të jetë ndryshuar nga (1+4) në (1+5).

1. **Konkluzion:**
Mosrealizimi i trajnimit të detyrueshëm profesional për vitin 2024 nga ish-drejtuesi i DAB.
Nga auditimi i dokumentacionit të trajnimeve për vitin 2024 dhe regjistrit përkatës të audituesve të DAB, rezulton se audituesit në detyrë plotësojnë si kriteret e përgjithshme, ashtu edhe ato të posaçme të përcaktuara në nenet 11, 19 dhe 20 të Ligjit nr. 114/2015.
Megjithatë, për një rast të veçantë – ish-drejtuesi i DAB, z. S. D., i cili ka dalë në pension më datë 31.07.2024 – rezulton se nuk ka realizuar orët e trajnimit të detyrueshme për vitin 2024, deri në datën e largimit nga detyra.
Ligji nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar:

- *Neni 15, pika d)*: "Të ndjekin, në mënyrë periodike, trajnimin e vazhdueshëm profesional, sipas kërkesave të nenit 20 të këtij ligji."
- *Neni 20, pika 2*: "Audituesit e brendshëm janë të detyruar të ndjekin, çdo vit, jo më pak se 40 orë trajnime profesionale të miratuara ose të njohura nga Ministria e Financave."

Përmbledhje e situatës së personelit në NjAB gjatë vitit 2024.
Gjatë vitit 2024, struktura dhe përbërja e Njësisë së Auditimit të Brendshëm ka pësuar ndryshime të rëndësishme në aspektin organizativ dhe të burimeve njerëzore:

- Nga 1 janari deri më 31 korrik 2024, struktura ka qenë në përputhje me Urdhrin nr. 14, datë 25.01.2024, me 5 punonjës (1 drejtor dhe 4 specialistë). Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur pozicione vakante.
- Më 31.07.2024, z. S. D. është larguar për shkak të daljes në pension pleqërie.
- Nga 01.08.2024 deri më 27.09.2024, z. J. Q. ka qenë drejtor i komanduar.
- Më 25.09.2024, ka paraqitur kërkesë për dorëheqje për arsye personale (nr. prot. 4003, datë 25.09.2024).

- Është larguar nga shërbimi civil më 27.09.2024 (nr. prot. 4003/1, datë 27.09.2024).
- Nga 28.09.2024 deri më 03.11.2024, Drejtoria ka funksionuar pa drejtues të komanduar apo të emëruar për 37 ditë kalendarike.
- Më 04.11.2024, z. J. Q. është rikthyer në detyrë si Drejtor, me vendim të DAP (shkresa nr. 5960, datë 04.11.2024), dhe vazhdon në këtë funksion.
- Me Urdhrin e Kryeministrit nr. 205, datë 23.10.2024, është miratuar një strukturë e re, duke shtuar një pozicion specialisti. Struktura e re përbëhet nga 1 drejtor dhe 5 specialistë (totali 6 punonjës).

Periudhat e vakancave:

- Nga 01.08.2024 deri më 17.11.2024, njësia ka funksionuar me 4 punonjës, rezulton:
- 1 pozicion vakant për 58 ditë (nga 01.08.2024 deri më 27.09.2024 pas largimit të S.D.),
- 2 pozicione vakante për 25 ditë (nga 23.10.2024 kur miratohet struktura e re deri më 17.11.2024, për shkak të shtimit të një pozicioni të ri + mungesës së mbetur),
- Nga 18.11.2024, z. F. G. është emëruar specialist me vendim të DAP (dt. 18.11.2024), duke reduktuar vakancën në vetëm një pozicion të paplotësuar për periudhën 18.11.2024 – 31.12.2024.

Periudha me 3 punonjës:

- Nga 28.09.2024 deri më 03.11.2024:
- Pas dorëheqjes së Drejtorit (J. Q),
- Njësia ka pasur 3 punonjës në total (pa drejtues, dhe me një pozicion vakant specialisti),
- Kjo përbën një periudhë **37 ditore** me **mungesë drejtuesi dhe staf të reduktuar në 3 punonjës**.

2. Konkluzion:

Mungesa e drejtuesit të NjAB-së për një periudhë 37-ditore.

Gjatë auditimit u konstatua se Njësia e Auditimit të Brendshëm ka funksionuar për një periudhë 37-ditore (nga data 28.09.2024 deri më 03.11.2024) pa një drejtues të komanduar apo të emëruar, pas dorëheqjes së drejtorit të komanduar dhe përpara rikthimit të tij në detyrë.

Ligji Nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

- Neni 12, pika 2. Sektori drejtohet nga shefi i sektorit, i cili i raporton drejtpërdrejt drejtorit të drejtorisë, pjesë e së cilës është sektori. Shefi i sektorit, në rast mungese apo paaftësie afatshkurtër, zëvendësohet, për shkak të ligjit, nga nëpunësi civil i nivelit më të lartë të të njëjtit sektor. Në rast se ka më shumë se një nëpunës civil të të njëjtit nivel, ai zëvendësohet nga nëpunësi civil i nivelit më të lartë që ka vjetërsi më të madhe në shërbimin civil.
- Neni 13, pika 3. Drejtori është përgjegjës për përcaktimin e objektivave të drejtorisë, nëse ato nuk përcaktohen nga një nivel më i lartë hierarkik, për planifikimin e veprimtarisë së drejtorisë dhe realizimin e detyrave të saj, duke dhënë orientime dhe udhëzime, si dhe duke monitoruar veprimtarinë e njësive administrative dhe personelit brenda drejtorisë.
- 4. Pika 2 e nenit 12 të këtij ligji zbatohet, me ndryshimet përkatëse, për zëvendësimin e drejtorit.

Tabela: Përmbledhëse e situatës së personelit në njësinë e AB – viti 2024.

Periudha	Struktura e Miratuar	Baza Ligjore e Strukturës	Punonjës Faktikë	Vakanca	Shënime
01.01.2024 – 31.07.2024	1 Drejtor + 4 Specialistë (totali: 5)	Urdhri nr. 14, datë 25.01.2024	5	0	Strukturë e plotë dhe funksionale. Asnjë pozicion vakant.

01.08.2024 – 22.10.2024	1 Drejtor + 4 Specialistë (totali: 5)	Urdhri nr. 14, datë 25.01.2024	4	1 pozicion vakant për 58 ditë	Z. S. D. del në pension më 31.07.2024. Z. J. Q.komandohet si drejtor. Mungon një specialist.
28.09.2024 – 03.11.2024	Referuar strukturës në fuqi gjatë periudhës	-	3	Drejtues mungon, 1 specialist mungon	Pas dorëheqjes së z. J.Q.. Njësia funksionon për 37 ditë me 3 punonjës dhe pa drejtues të komanduar.
23.10.2024 – 17.11.2024	1 Drejtor + 5 Specialistë (totali: 6)	Urdhri nr. 205, datë 23.10.2024	4	2 pozicione vakante për 25 ditë	Struktura e re miratohet më 23.10.2024. Njësia funksionon me 4 punonjës. Vakanca për specialistin ekzistues + pozicioni i ri shtuar në strukturë.
18.11.2024 – 31.12.2024	1 Drejtor + 5 Specialistë (totali: 6)	Urdhri nr. 205, datë 23.10.2024	5	1 pozicion vakant	Z. F. G. emërohet si specialist më 18.11.2024. Një pozicion specialisti mbetet i paplotësuar deri në fund të vitit.

Burimi: të dhënat nga MSHMS, përpunim nga grupi i KLSH-së.

3. Konkluzion:

Mbi mosfunksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2024.

Gjatë auditimit të veprimtarisë në Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), është konstatuar se Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk ka funksionuar gjatë vitit 2024. Ky komitet është krijuar me urdhër të ministrit në vitin 2018, por mandati i anëtarëve të tij ka përfunduar në fund të vitit 2020. "Pas kësaj date, nuk janë emëruar anëtarë të rinj nga titullari i ministrisë dhe, për rrjedhojë, aktiviteti i komitetit është pezulluar."

- *Ligjit nr. 114/2015,* "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, neni 12 "Përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike", pika b): *krijimi i Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike përkatëse, sipas kritereve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave,* siç parashikohet në shkronjën **"***b" të nenit 23* të këtij ligji;
- *Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 160, datë 02.03.2016,* "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike", Kreu I, Kreu II dhe Kreu III.

2.Mbi përgjigjësite e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm.

Mbi zbatimin e përcaktimeve të nenit 14 dhe nenit 16, Kreu V "Të drejtat dhe përgjegjësitë e audituesve të brendshëm" të ligjit nr. 114/2015, i ndryshuar, si dhe të Manualit të Auditit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik, i ndryshuar", u konstatua:

Karta e Auditit.

Nga auditimi konstatohet se Drejtoria e Auditimit të Brendshëm (DAB) ka hartuar "Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik", e cila është miratuar me Urdhrin nr. 202, datë 27.02.2018, të Ministrit të Shëndetësisë, në zbatim të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 14, germa "b", dhe të Urdhrit nr. 100, datë 25.10.2016, të Ministrit të Financave, "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik".
Nga auditimi i dokumenteve u konstatua se Karta e Auditimit të Brendshëm përmban strukturën dhe formatin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, kapitulli II, Formati Standart 1, "Modeli i Kartës së Auditimit të Brendshëm".

3.Planifikimi dhe zbatimi i planit strategjik dhe planit vjetor 2024.
Nga auditimi konstatohet se DAB ka hartuar dhe miratuar planin strategjik 2024-2026 me Urdhrin nr. 3414/1, datë 12.10.2023, "Për miratimin e planit strategjik 2024-2026 dhe planit vjetor 2024 të Drejtorisë së Auditimit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale", në përmbushje të detyrimit ligjor të përcaktuar në Ligjin nr. 114/2015, neni 14/c, si edhe në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, pika 3.3 "Afati i përgatitjes dhe miratimit të planit strategjik dhe planit vjetor".
Nga auditimi i dokumenteve konstatohet se plani strategjik dhe plani vjetor i kanë bashkëngjitur të gjitha pasqyrat e përcaktuara në Manualin e AB, kapitulli III. Konstatohet se hartimi i planit strategjik nga DAB përmban të gjithë elementët dhe është në përputhje me formatin dhe strukturën e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Formati Standart nr. 5, "Hartimi i Planit Strategjik dhe Vjetor të NJAB".

Për hartimin e planit strategjik, fillimisht DAB ka identifikuar subjektet me risk për t'u planifikuar dhe subjektet për të cilat është detyrim auditimi i tyre me frekuencë jo më shumë se 5 vjet. DAB, për planifikimin strategjik 2024-2026, ka identifikuar subjektet që janë prekur nga ndryshime në mënyrën e organizimit të sistemit shëndetësor dhe mbrojtjes sociale, ndryshimet e fundit në aktet ligjore përsa i përket krijimit të institucioneve të reja ose organizimit të shërbimeve, si dhe në organizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm në institucionet shëndetësore, kryesisht në shërbimet spitalore. Për planin strategjik dhe vjetor 2024-2026 janë identifikuar gjithsej 29 subjekte.
Pas identifikimit të subjekteve, DAB ka identifikuar fushat/sistemet prioritare për hartimin e planit strategjik, në respektim të Manualit të AB, kapitulli III, "Planifikimi i veprimtarive të auditimit të brendshëm". Për identifikimin e fushave, DAB ka përcaktuar universin e auditimit, i cili përbëhet nga sistemet dhe mënyra e funksionimit të tyre, mënyra e strukturimit apo edhe të kombinuar. Bazuar në fushat dhe sistemet e identifikuara, DAB ka përcaktuar nevojat për auditim për periudhën 3-vjeçare, duke konsideruar burimet e auditimit dhe vlerësimet e mëposhtme, si:

- Objektivat e auditimit;
- Mbulimi me auditim i subjekteve me frekuencë të ulët auditimi (një herë në 4 deri 5 vite), në planin e vitit 2024, me objektiv rritjen (shpeshtimin) e frekuencës së auditimeve deri në 3 herë në 3 vite;
- Ndjekja me prioritet e detyrimeve të prapambetura financiare, duke vënë theksin tek forcimi i disiplinës financiare nëpërmjet kontrolleve financiare dhe rritjen e eficencës së shpenzimeve për të parandaluar rritjen e detyrimeve në të ardhmen. Kjo fushë mbetet prioritet me mbulimin me auditim për 3 vitet e planit strategjik;

- Monitorimi çdo vit i zbatimit të rekomandimeve, për të përcaktuar nëse gjetjet e auditimit janë adresuar në mënyrën e duhur, si dhe nëse janë zbatuar sipas afateve dhe kritereve të kërkuara. Auditimi për këtë pikë është projektuar për të tre vitet e planit strategjik.

Konstatohet se DAB ka identifikuar dhe vlerësuar risqet për subjektet që do të përfshihen në planin strategjik 2024-2026, në përputhje me Manualin e AB, kapitulli III, faza 2, "Identifikimi i risqeve". Ky proces është bërë bazuar në një analizë gjithëpërfshirëse të riskut dhe proceseve të vlerësimit. Nga kjo analizë, DAB ka identifikuar burimet e vlerësimit të riskut për hartimin e planit strategjik, të cilat janë:

- Programimi dhe zbatimi i buxhetit;
- Menaxhimi i burimeve njerëzore;
- Procedurat e prokurimeve;
- Pagesat financiare;
- Kontabiliteti dhe raportimi financiar;
- Shërbimi stomatologjik;
- Inspektimi.

Bazuar në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve është bërë kategorizimi i zonave/subjekteve me risk në tre nivele: i lartë, i mesëm dhe i ulët. DAB ka caktuar subjektet e synuara për t'u audituar në secilin vit strategjik. DAB ka marrë në konsideratë risqet me status "risqe pas kontrolleve", të identifikuara nga vetë subjektet si risqe me probabilitet të lartë/impakt të lartë. Sipas këtij regjistri, DAB ka identifikuar një subjekt si risk me probabilitet të lartë që i përket drejtorisë, si më poshtë:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në planifikimin strategjik 2024-2026, DAB ka përfshirë të gjitha subjektet për t'u mbuluar me auditim në kuadrin kohor 5-vjeçar (1+2+2), pavarësisht periudhës së kur auditohet.

Konstatohet se DAB në hartimin e planit strategjik ka identifikuar edhe kufizimet e mundshme që mund të pengojnë arritjen e objektivave, si edhe prioritetet për tri vitet e ardhshme në funksion të përmirësimit të punës, në zbatim të Manualit AB, kapitulli III, Formati 5, "Struktura e Planit Strategjik".

Nga auditimi konstatohet se DAB ka përgatitur dhe dërguar raportin vjetor të veprimtarisë për vitin 2024 pranë strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, në zbatim të Ligjit nr. 114/2015, neni 14, pika "ç", si edhe të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik. Konstatohet se hartimi i planit vjetor nga DAB përmban të gjithë elementët dhe është në përputhje me formatin dhe strukturën e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Formati Standart nr. 5, "Hartimi i Planit Strategjik dhe Vjetor të NJAB".

Procesi i hartimit të Planit vjetor të auditimit i është nënshtruar një analize të thellë të risqeve nga ana e DAB, të cilat karakterizojnë projektet e investimeve të realizuara në vitet e fundit, duke pasur parasysh periudhën e pabuluar me auditim. Faktorët e riskut të identifikuar janë vlerësuar sipas rëndësisë së tyre, sikurse jepen në tabelën më poshtë, dhe janë:

- Mos përmbushje e objektivave lidhur me çështjet që mbulojnë politikat për burimet njerëzore;
- Projektim i buxhetit jo mbi bazën e prioriteteve;
- Administrimi dhe menaxhimi i aktiveve jo mbi bazë risku;
- Mospërmbushje e objektivave për projektet e investimeve;
- Mospërmbushje e objektivave për shpenzimet operative (mallra e shërbime të tjera);
- Mospërmbushja e objektivave për krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore;

- Shmangie e inspektimeve në subjektet private me risk të lartë në fazën e programimit, si dhe të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit nga masat administrative.

Për vitin 2024 janë planifikuar të kryhen 12 misione auditimi nga 29 subjekte, ose 41.37% e totalit të universit të auditimit. Mesatarisht, 1 auditim në muaj. Në tabelën më poshtë jepen misionet e auditimit sipas llojit të angazhimit.

Tabela: Misionet e auditimit sipas llojit të angazhimit.

Lloji i angazhimit	Nr.	Pesha
Auditime të kombinuara	10	83.34%
Auditime të përputhshmërisë	1	8.33%
Auditime të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve	1	8.33%
Totali	12	100%

Burimi: MSHMS, perpunim nga grupi i auditimit të KLSH-së.

4.Konkluzion:

Gjatë vitit 2024, është realizuar një angazhim shtesë auditimi jashtë planit vjetor të miratuar: Urdhri i Ministrit në MSHMS nr. 244, datë 30.04.2024; Nr. 2045 prot., Tiranë, më 30.04.2024. Shtohet auditimi pranë "Spitalit Universitar të Traumës, Tiranë". Ky ndryshim nuk është komunikuar në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm pranë "Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë", duke mos u reflektuar në planin vjetor të konsoliduar në shkallë vendi.

- *Manuali i Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar: Kapitulli III, pika 3.5 – Rishikimi i planeve strategjikë dhe vjetor të auditimit të brendshëm.* Të gjithë planet vjetorë dhe strategjikë të rishikuar të auditimit të brendshëm duhet t'i dërgohen strukturës përgjegjëse të harmonizimit për AB-në, së bashku me shpjegimet e ndryshimeve të bëra.

4.Ndryshimet në Planin Vjetor të Auditimit për vitin 2024.

Për vitin 2024, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm (DAB) kishte planifikuar të realizonte 12 misione auditimi, të miratuara në planin vjetor përkatës. Gjatë vitit, me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, janë bërë disa ndërhyrje në planin fillestar, duke shtuar tre auditime shtesë si më poshtë:

• Një ndryshim në planin vjetor 2024 nr. 1101, datë 26.02.2024: Shtohet auditimi pranë "Spitalit Universitar Obstetrik-Gjinekologjik Koço Gliozheni, Tiranë". Ky ndryshim është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 1101/1, datë 26.02.2024.

• Urdhri i Ministrit në MSHMS nr. 244, datë 30.04.2024: Nr. 2045 prot., Tiranë, më 30.04.2024. Shtohet auditimi pranë "Spitalit Universitar të Traumës, Tiranë". Ky ndryshim nuk është dërguar në Ministrinë e Financave, duke mos u reflektuar në planin vjetor të konsoliduar të auditimit të brendshëm në shkallë vendi.

• Urdhri i Ministrit në MSHMS nr. 454, datë 26.08.2024: Nr. 3615 prot., Tiranë, më 26.08.2024. Shtohet auditimi me objekt "Verifikimi i elementëve të pagës për punonjësit e shërbimit të urgjencës paraspitalorë". Ky ndryshim është përcjellë pranë Ministrisë së Financave me shkresën nr. 4823, datë 26.11.2024.

5.Ndryshimi i Planit Vjetor 2024.

Në shkresën nr. 4823, datë 26.11.2024, DAB paraqet një kërkesë për rishikimin e planit vjetor, me arsyetimin se për shkak të kufizimeve në burime njerëzore dhe kohës së mbetur deri në fund të vitit, ishte i pamundur realizimi i plotë i planit. Në këtë kërkesë është paraqitur: heqja nga plani e 4 subjekteve nga 8 që nuk u audituan deri në atë moment:

1. Spitali Psikiatrik Vlorë
2. Qendra Kombëtare e Inxhinierisë Biomjekësore, Tiranë
3. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (Qendror), Tiranë
4. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Rajonal, Elbasan

Shtimi i një auditimi të ri në 40 subjekte, me objekt "Verifikimi i elementëve të pagës për punonjësit e shërbimit të urgjencës paraspitalorë".

5. Konkluzion:

Pasaktësia e konstatuar në shkresën nr. 4823, datë 26.11.2024, dërguar Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm (DHAB):

Në këtë shkresë zyrtare, e cila përcjell përditësimet e Planit të angazhimeve të auditimit të brendshëm për vitin 2024, nuk është përfshirë auditimi i realizuar pranë "Spitalit Universitar të Traumës, Tiranë", i miratuar me Urdhrin nr. 244, datë 30.04.2024. Auditimi është zhvilluar në praktikë gjatë datave 03.05.2024 deri më 10.05.2024, por ky angazhim nuk figuron në shkresën përcjellëse dhe nuk është pasqyruar në Pasqyrën 3 të dokumentit "Plani i angazhimeve të NJAB për vitin 2024 (i ndryshuar)", ku janë raportuar gjithsej 10 auditime. Mos-përfshirja e këtij angazhimi ka sjellë mungesë qartësie dhe pasaktësi në raportimin e ndryshimeve të planit, duke e bërë të pamundur për Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm (DHAB) të ketë një pasqyrë të saktë dhe të përditësuar të situatës së auditimeve në atë fazë.

- *Ligji nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar Neni 14, pika c):*

  "Hartimi dhe zbatimi i planit strategjik dhe vjetor për veprimtarinë e auditimit të brendshëm dhe dërgimi për informacion në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, pas miratimit nga titullari i njësisë publike."

- *Manuali i Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar Kapitulli III, pika 3.5:*

  "Të gjithë planet vjetorë dhe strategjikë të rishikuar të auditimit të brendshëm duhet t'i dërgohen strukturës përgjegjëse të harmonizimit për auditimin e brendshëm, së bashku me shpjegimet e ndryshimeve të bëra."

Auditime të hequra	4
Auditime që duhej të ishin faktikisht në fund	11

Burimi: MSHMS, perpunim nga grupi i auditimit të KLSH-së.

6. Konkluzion:

Gjatë shqyrtimit të tabelës "Realizimi i planit të angazhimeve për vitin 2024" në kuadër të raportit përmbledhës nr. 293/2 prot., datë 14.02.2025, u konstatua një *pasaktësi në pasqyrimin tabelar të numrit të angazhimeve të auditimit.* Konkretisht, në tabelë është përfshirë auditimi i zhvilluar pranë "Spitalit Universitar të Traumës, Tiranë", i miratuar me *Urdhrin nr. 244, datë 30.04.2024,* i cili është *jashtë planit fillestar të miratuar dhe nuk është formalizuar si shtesë zyrtare* në planin e

dërguar në Ministrinë e Financave. Njëkohësisht, auditimi i planifikuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Fondet IPA), *nuk është realizuar***,** por *nuk është hequr nga tabela.* Për rrjedhojë, ndonëse janë *8 auditime të përfunduara dhe 2 në proces***,** *totali në tabelë është mbajtur në 10,* duke mos reflektuar në mënyrë të saktë faktin që në total janë trajtuar *11 angazhime,* sipas urdhrave zyrtarë deri në datën 31.12.2024.

7. Konkluzion:

"Gjatë analizës së pasqyrës së realizimit të planit të angazhimeve të auditimit për vitin 2024, u konstatua një pasaktësi në lidhje me numrin e auditimeve shtesë të miratuara nga titullari. Në tabelë është paraqitur gabimisht numri zero (0) auditime shtesë, ndërkohë që, sipas dokumentacionit zyrtar, janë miratuar tre (3) auditime shtesë, të cilat janë si më poshtë:

• Një ndryshim në planin vjetor 2024 nr. 1101, datë 26.02.2024, auditimi pranë "Spitalit Universitar Obstetrik-Gjinekologjik Koço Gliozheni, Tiranë".

• Urdhri i Ministrit të MSHMS nr. 244, datë 30.04.2024, nr. prot. 2045 – auditimi pranë "Spitalit Universitar të Traumës", Tiranë.

• Urdhri i Ministrit të MSHMS nr. 454, datë 26.08.2024, nr. prot. 3615 – auditimi me objekt "Verifikimi i elementëve të pagës për punonjësit e shërbimit të urgjencës paraspitalore".

Gjetjet dhe Rekomandimet

Nga misionet e auditimit janë konstatuar 143 gjetje sipas fushave të përmbledhura në tabelën e mëposhtme.

Tabela: Gjetjet sipas fushës.

Gjetjet sipas fushave	**Nr.**	**Pesha**
Sistemi i prokurimeve, blerjeve & investimeve	27	21%
Sistemi i pagesave, shpërblime, trajtime, komisione.	25	17%
Sistemet e administrimit pronës pasurise	17	11%
Të tjera.	74	51%
Totali	**143**	**100%**

Burimi:MSHMS, përpunim nga grupi i auditimit KLSH-së.

8. Konkluzion:

Pasaktësi në pasqyrimin e gjetjeve në raportin përmbledhës të auditimit për vitin 2024.

Gjatë shqyrtimit të "Raportit Përmbledhës për periudhën janar–dhjetor 2024" me nr. 293/2, datë 14.02.2025, hartuar nga Njësia e Auditimit të Brendshëm në MSHMS, u konstatua një pasaktësi në pasqyrën nr. 4 "Përmbledhëse e parregullsive të identifikuara sipas sistemeve për vitin 2024". Në këtë pasqyrë është deklaruar se numri total i parregullsive të evidentuara është 143. Megjithatë, nga verifikimi i detajuar i raportit rezulton se në këtë tabelë nuk janë përfshirë saktësisht 5 parregullsi të raportuara në pikën nr. 7, që i përkasin Spitalit Universitar të Traumës, të paraqitura në faqen 10 të raportit.

Kjo mospërputhje ka çuar në:

• Gabim në totalin e pasqyrës nr. 4, i cili duhej të ishte 148 dhe jo 143;

• Gabim në gjetjet kryesore sipas sistemeve, të raportuara në vazhdimësi të raportit, të cilat janë llogaritur mbi një total të pasaktë, në faqen 1 dhe faqen 8 të raportit.

Gjetjet me efekt financiar për vitin 2024 nga NJAB:
Për vitin 2024, shuma është 18 mijë lekë, nga të cilat:

- Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tepelenë, vlera e dëmit gjithsej 4 mijë lekë.
- Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Rajonal Shkodër, vlera e dëmit gjithsej 14 mijë lekë.

Nga analiza e të dhënave rezulton se subjektet me më shumë gjetje/problematika sipas sistemeve janë:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (19 gjetje)
- Klinika Stomatologjike Universitare Tiranë (31 gjetje)
- Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koço Gliozheni", Tiranë (29 gjetje)
- Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë (21 gjetje)
- Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Rajonal Shkodër (18 gjetje)

Rekomandimet e dhëna nga DAB gjatë vitit 2024:

- Numri total i rekomandimeve: 154
- Sipas nivelit të riskut:
  - Rekomandime me rëndësi/risk të lartë: 86
  - Rekomandime me rëndësi/risk të mesëm: 68
  - Rekomandime me rëndësi/risk të ulët: 0

Tabela: Rekomandimet sipas natyrës.

Rekomandimi	Nr.	Pesha %	I pranuar	I zbatuar	Në proces	I pazbatuar	Rekomandime të pa pranuara
Rekomandime të përmirësimin e sistemeve	50	32.5%	50	19	21	4	6
Rekomandime per permiresimin e kuadrit ligjor	4	2.5%	4	1	3	0	0
Rekomandime të karakterit organizativ	8	5.3%	8	5	3	0	0
Rekomandime per arketime	5	3.2%	5	4	0	1	0
Rekomandime te tjera	87	56.5%	87	47	27	12	1
Totali	**154**	**100%**	**154**	**76**	**54**	**17**	**7**

Burimi: MSHMS, përpunim nga grupi audituesi i KLSH-s.

Zbatimi i procedurave dhe evadimi i materialeve të auditimit, ruajtja dhe arkivimi i tyre.
Nga grupi i auditimit, për të verifikuar evidentimin e punës audituese dhe plotësinë e dosjeve të auditimit për misionet e realizuara gjatë vitit 2024, u përzgjodhën dy dosje, përkatësisht:

- Dosja e auditimit në subjektin "Spitali Universitar i Traumës, Tiranë";
- Dosja e auditimit në subjektin "Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale".

9. Konkluzion:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes së përzgjedhur, "Spitali Universitar i Traumës, Tiranë", rezulton se mungojnë: "Autorizimi", "Njoftimi për fillimin e angazhimit të auditimit" dhe "Vlerësimi i riskut". Konstatohet se auditimi është kryer në respektim të afateve të planifikuara në planin vjetor 2024. Kjo dosje nuk përmban të gjithë paketën e dokumenteve për çdo fazë të procesit të auditimit, në zbatim të Manualit të Auditimit të Brendshëm (AB), Kapitulli IV "Kryerja e auditimit të brendshëm, ndjekja e procedurave, raportimi dhe komunikimi i auditimit" – Formati Standard.

Nga auditimi i dosjes së përzgjedhur, "Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale", u konstatua se grupi i punës ka krijuar një dosje të veçantë për angazhimin, e cila është e inventarizuar. Kjo dosje përmban të gjithë paketën e dokumenteve për çdo fazë të procesit të auditimit, në zbatim të Manualit të Auditimit të Brendshëm (AB), Kapitulli IV "Kryerja e auditimit të brendshëm, ndjekja e procedurave, raportimi dhe komunikimi i auditimit", Formati Standard. Konstatohet se auditimi është kryer në respektim të afateve të planifikuara në planin vjetor 2024.

Përsa i përket dokumentit "Rishikimi i Cilësisë së Punës", konstatohet se për dosjet e përzgjedhura ky dokument është administruar në secilën prej tyre, referuar Kapitullit VII "Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm", Pika 4.1.10, Hapi 9 "Rishikimi i punës së Auditimit" në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, i ndryshuar. Në dosje gjenden pyetësorët e dhënë nga grupet e auditimeve.
Nga auditimi i dosjeve për testim, konstatohet se grupi i auditimit, pas marrjes së plan-veprimit nga subjekti i audituar, ka formuluar memo (përmbledhje e shkurtër e raportit përfundimtar) dhe ia ka paraqitur titullarit të institucionit në varësi të të cilit është subjekti i audituar, në respektim të Ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 12/1, pika 3, dhe Manualit të AB, Kapitulli IV.
Referuar kërkesave të parashikuara në "Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", një kopje e dokumenteve të dosjeve të auditimeve (shkresa dhe/ose dokumente që lidhen me to) duhet të protokollohet dhe të dorëzohet në arkivin e institucionit. Nga auditimi u konstatua se dosjet e angazhimeve për vitin 2024 janë protokolluar dhe arkivuar.

3. Për sa konstatohet në situatën e mësipërme, mbajnë përgjegjësi:
Z. S. D., ish-Drejtor i Auditit të Brendshëm – ka ndërprerë marrëdhëniet financiare me institucionin më datë 31.07.2024, për shkak të daljes në pension pleqërie.
Z. J. Q., Drejtor i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm:
– në detyrën e Drejtorit të komanduar gjatë periudhës 01.08.2024 – 27.09.2024, me urdhër të DAP; në detyrën e Drejtorit të emëruar zyrtarisht nga data 04.11.2024 e në vazhdim.

2.5 Të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.

Mbi vendimmarrjen lidhur me menaxhimin e flukseve të pacientëve që kërkojnë shërbim spitalor
Bazuar në Ligjin nr. 55/2022 "Për shërbimin spitalor në RSH" dhe Ligjin nr. 147/2014 "Për shërbimin e urgjencës mjekësore" MSHMS është e ngarkuar me hartimin dhe zbatimin e kornizës ligjore dhe rregullatore për funksionimin e shërbimit spitalor publik.
Neni 5 i Ligjit nr. 55/2022 përcakton rëndësinë e rolit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si autoriteti kryesor përgjegjës për formësimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit spitalor në vend. Ministria ka kompetencë për të hartuar politikat dhe planin strategjik në fushën e kujdesit shëndetësor spitalor, për të përgatitur dhe propozuar bazën ligjore të nevojshme, dhe për të paraqitur modelin e financimit për spitalet publike pranë Këshillit të Ministrave. Ajo përcakton kriteret për hapjen dhe mbylljen e spitaleve dhe shërbimeve spitalore, organizon dhe monitoron aktivitetin e spitaleve publike , përfshirë auditimin sistematik, dhe inspekton institucionet publike dhe private në përputhje me legjislacionin shëndetësor. Ministria përcakton gjithashtu llojet e

shërbimeve që ofrohen prej spitaleve publike në bazë të nevojave të popullatës, investon në mënyrë të vazhdueshme në infrastrukturën spitalore dhe garanton vendosjen e standardeve cilësore për akreditimin e institucioneve dhe shërbimeve spitalore.
Neni 15 i ligjit nr. 55/2022 përcakton mekanizmat e referimit në shërbimin spitalor, duke vendosur sistemin e referimit si rrugën institucionale që garanton kalimin e pacientit nga kujdesi parësor ku kryhet diagnostikimi dhe trajtimi fillestar, drejt institucionit spitalor, në rastet kur sëmundjet janë më komplekse ose kanë nevojë për trajtime të specializuara, barna, pajisje dhe hapësira të posaçme. Sipas këtij neni spitalet janë të detyruara të bashkëpunojnë me institucionet e kujdesit parësor dhe të ofrojnë mbështetje profesionale gjatë ofrimit të shërbimit. Konsultat e specializuara dhe shtrimi brenda ditës duhet të ofrohen në ambientet hospitalore, ndërsa aktivitetet jashtë infrastrukturës mjekësore mund të kryhen përmes njësi organizative të integruara. Rastet spitalore mund të trajtohen si urgjenca mjekësore ose përmes referimit të strukturuar nga nivelet më të ulëta drejt atyre më të specializuara. Ministri përcakton mënyrën e funksionimit të këtij mekanizmi referimi përmes urdhrit dhe përdorimit të sistemeve dixhitale shëndetësore.

Sa më sipër në zbatim të kuadrit ligjor dhe rregullator, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka lëshuar një numër të konsiderueshëm urdhrash drejt zbatimit të përgjegjësive të saj kryesore.
Konkretisht në vitin 2023 janë lëshuar **774 urdhra** nga Ministri, Zv/Ministri dhe Sekretari i Përgjithshëm, ndërsa gjatë vitit 2024 janë nxjerrë **663 urdhra**. Këto dokumente operacionale përfshijnë udhëzime për hartimin e politikave shëndetësore, mbikëqyrjen e veprimtarive spitalore, funksionimin e urgjencave dhe zbatimin e standardeve ligjore të sistemit shëndetësor.
Ndër urdhërat e lëshuar grupi i auditimit përzgjodhi **për auditim Urdhërin nr. 295, datë 17.05.2023** *"Mbi organizmin e shërbimit të urgjencave të kirurgjisë së përgjithshme, në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", në Spitalin Universitar të Traumës dhe në Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi"".*
Urdhëri është bazuar në shkresën nr. 53/12, datë 25.10.2023, protokolluar në MSHMS me nr. 2037/1, datë 26.10.2023 të dërguar nga Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi" (SUSN). Në shkresë përcaktohet se në zbatim të Urdhërit të Ministrit nr. 295, datë 17.05.2023, SUSN është institucioni që bën pritjen e urgjencave të kirurgjisë së përgjithshme nga të gjitha rrethet e vendit. Nëpërmjet shkresës i bëhet me dije Ministrisë se referuar statistikave të saj numri i ndërhyrjeve kirurgjikale në të tre klinikat e kirurgjisë në këtë spital, për vitin 2023 është rritur me 17.3% (bashkëlidhur tabela statistikore).Për sa më sipër, nga SUSN **kërkohen udhëzime se si duhet të vazhdohet me tej** për mos ndërprerje të ndërhyrjeve kirurgjikale dhe një shërbim sa më cilësor ndaj pacientëve që trajtohen në këtë spital.
Në zbatim të shkresës me Memo nr. 2037, datë 17.05.2023 drejtuar Ministres, lidhur me projekt urdhërin "*Për organizmin e shërbimit të urgjencave të kirurgjisë së përgjithshme, në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza*", në Spitalin Universitar të Traumës dhe në Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi"", në kuadër të mirë organizmit për shërbimin e urgjencave kirurgjikale dhe shpërndarjen e punës, për eficencë më të madhe në marrjen e shërbimit ndaj qytetarëve, **propozohet rishpërndarje e shërbimit të urgjencave kirurgjikale në të tre spitalet universitare sipas një grafiku javor**.

Në mbështetje te kërkesë propozimit Zëvendës Ministri znj. E. R., **me Urdhër nr. 295, datë 17.05.2023** ka urdhëruar organizmin e shërbimit të urgjencës kirurgjikale sipas përcaktimeve si vijon:

a) Spitali Universitar i Traumës të presë urgjencat kirurgjikale në dy ditë në javës, përkatësisht **ditët e hëna dhe të marta të çdo jave**;
b) Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi" të presë urgjencat kirurgjikale në dy ditë të javës përkatësisht, **ditët e mërkura dhe të enjte të çdo jave**;
c) Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" të presë urgjencat kirurgjikale në tre ditë të javës, përkatësisht **ditët e premte, e shtunë dhe të diel** të çdo jave.
d) Etj

Ngarkohet për zbatimin të këtij urdhëri:
1- **QSUNT; SUT, SUSN**, të marrim masa për mirë organizmin e burimeve njerëzore në sallat kirurgjikale dhe krijimin e ekipeve që do të presin rastet urgjente, sipas përcaktimeve të këtij urdhëri
2- **Qendra Kombëtare e Urgjencave Mjekësore të Kujdesit Shëndetësor**, për referimin e urgjencave kirurgjikale të kirurgjisë së përgjithshme, sipas parashikimeve të këtij urdhëri.
3- **Operatori Qendror i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor** të marrë masat për të informuar spitalet publike, për referimin e urgjencave kirurgjikale, të kirurgjisë së përgjithshme sipas përcaktimeve të këtij urdhëri.

Nga auditimi rezultoi se:
Urdhëri nr. 295, datë 17.05.2023 ka përcaktuar grafikun javor të pritjes së rasteve kirurgjikale emergjente mes tre spitaleve universitare të Tiranës (QSUT, Trauma dhe "Shefqet Ndroqi"). Ky urdhër ka trajtuar rastet e urgjencës të përcaktuara sipas kritereve të ligjin Nr. 147/2014 "Për shërbimin e urgjencës mjekësore".
Pas verifikimit të bërë në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, **nuk është gjetur ndonjë dokument publik që trajton shprehimisht mundësinë apo procedurën** e pranimit të pacientit drejtpërdrejt në spital për urgjencë kirurgjikale, për marrjen dijeni për Urdhërin nr. 295, datë 17.05.2023, i cili organizon grafikun e paraqitjes së rasteve urgjente mes spitaleve universitare.
Por në përditshmërinë e rasteve të urgjencës mjekësore shumë pacientë mbërrijnë vetë në dyert e saj duke menduar se kanë nevojë për ndërhyrje emergjente kirugjikale.
Marre shkas nga trajtimi ne media i shërbimit te urgjencës spitalore[28], nisur nga organizimi i shërbimit të urgjencës sipas këtij urdhëri, nuk rezulton i vlerësuar apo adresuar rasti kur një qytetar paraqitet **drejtpërdrejt në urgjencë, duke mos i dhënë përgjigje shteruese** pyetjeve:
- A ka rregulla të përcaktuara dhe të publikuara nga spitali për dhënien e ndihmës së parë mjekësore kur i sëmuri shkon në urgjencën spitalore që nuk ka ditën e grafikut të urgjencës?
-A ka rregulla të përcaktuara se si duhet te transportohet i sëmuri drejt spitalit qe ka ditën e pritjes së urgjencave apo kjo lëvizje e detyruar orientohet të kryhet nga shoqëruesit e të sëmurit?
-etj..
Mungesa e informacionit zyrtar nga MSHMS rrit rrezikun për keqinformim dhe moszbatim procedural pasi pacientët ose qytetarët që nuk kanë informacion për orarin e saktë dhe procedurat e grafikut të pritjes në urgjencë, mund të mos ndjekin rrugën e drejtë për trajtim profesional, duke rritur rrezikun për vonesa dhe keqtrajtime në dëm të shëndetit personal. Mungesa e informacionit të publikuar **cënon cilësinë e shërbimit të urgjencës spitalore**, pasi në mungesë të protokolleve të publikuara, është e vështirë të garantohet që praktikat e stafit mjekësor dhe rasti urgjent i

[28] https://top-channel.tv/2024/02/24/urgjenca-pjeserisht-ne-pune-nis-rikthimi-i-sherbimeve-pas-zjarrit-rastet-shume-urgjente-dhe-nderhyrjet-abdominale/?utm_source=chatgpt.com

paraqitjes së pacientit janë të përputhshme me legjislacionin dhe standardet profesionale.

Konkluzion:
Mungesa e informacionit publik për procedurat e urgjencës kirurgjikale: Urdhëri nr. 295, datë 17.05.2023 përcakton grafikun javor të pritjes së rasteve kirurgjikale emergjente mes tre spitaleve universitare të Tiranës dhe trajton rastet e urgjencës sipas ligjit nr. 147/2014. Megjithatë, nga verifikimi në faqen zyrtare të MSHMS nuk është gjetur ndonjë dokument publik që shpjegon mënyrën e pranimit të pacientëve që paraqiten drejtpërdrejt në urgjencë, duke mos i dhënë dijeni për grafikun e përcaktuar.
Rreziku nga mungesa e informacionit: Në praktikën e përditshme, shumë pacientë mbërrijnë vetë në urgjencë duke kërkuar ndërhyrje kirurgjikale, por nuk ka udhëzime të publikuara që tregojnë procedurën e marrjes së ndihmës së parë, transportin drejt spitalit të parashikuar në grafikun e urgjencës ose mënyrën se si duhet të veprojnë qytetarët. Mungesa e këtij informacioni rrit rrezikun për keqinformim dhe moszbatim procedural, duke mundësuar vonesa dhe keqtrajtime që mund të cenojnë shëndetin e pacientëve.
Cenimi i cilësisë së shërbimit: Mungesa e protokolleve të publikuara dhe e udhëzimeve të qarta pengon garantimin e praktikave të përputhshme me legjislacionin dhe standardet profesionale. Kjo cenon cilësinë e shërbimit të urgjencës spitalore dhe rrit rrezikun që rastet urgjente të trajtohen në mënyrë jo të standardizuar nga stafi mjekësor.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është paraqitur observacion: *Me shkresën nr. 85/6, date 06,02,2026, protokolluar në KLSH me nr. 110/31 prot, datë 09,02,2025* ***nga znj. A. D.*** *specialiste në Drejtorinë e Politikave të Shërbimit Spitalor/ Sektori i Politikave dhe Shërbimit Spitalor dhe* ***znj. A. P. specialiste,*** *Drejtoria e programit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator/ Sektori i hartimit, harmonizimit dhe Monitorimit të Akteve Rregullatorë.*

- *Në pretendimet e ngritura në shkresën e sipër cituar, arsyetohet se:*

Bazuar në Rregulloren e MSHMS, miratuar me Urdhrin nr. 124/1 prot, datë 07.03.2022, protokolluar me nr. 939/1, datë 07.03.2022 "Për organizimin dhe funksionimin e MSHMS", në nenin 41 pika 8 parashikohet se:
"8. Të gjitha drejtoritë e Ministrisë, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm ose Drejtorit të Kabinetit, vënë në dispozicion të drejtorisë përkatëse të gjithë informacionin mbi aktivitetin e tyre, sipas kësaj rregulloreje, është objekt informimi për publikun"
Në zbatim të kësaj dispozite Urdhri nr. 295, datë 17.05.2023, protokolluar me nr. 2037, datë 17.05.2023 është përcjellë nëpërmjet memos me nr. 2037, datë 17.05.2023, sipas hierarkisë institucionale, deri te Sekretari i Përgjithshëm, për të cilin është marrë nënshkrimi dhe miratimi përkatës.
Gjithashtu në zbatim të kësaj rregulloreje janë përcaktuar edhe detyrat e përgjegjësitë e sektorit përkatës ku bëjnë pjesë dy specialistet që kanë paraqitur observacion. Nga sa më sipër sipas observacionit, konkludohet se në asnjë akt normativ apo dokument zyrtar nuk është parashikuar si detyrë dhe përgjegjësi e znj. A.D dhe znj. A.P publikimi i këtij urdhëri në faqen zyrtarë të MSHMS..
<u>Qëndrimi i grupit të auditimit</u>
Grupi i auditimit lexoi me vëmendje gjithë parashtrimet, dhe arsyeton si me poshtë:
Neni 41 pika 8 e Urdhrit nr. 124/1 prot, datë 07.03.2022, protokolluar me nr. 939/1, datë 07.03.2022 "Për organizimin dhe funksionimin e MSHMS", përcakton se të gjitha drejtoritë e Ministrisë, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm ose Drejtorit të Kabinetit, vënë në dispozicion të

drejtorisë përkatëse të gjithë informacionin mbi aktivitetin e tyre, i cili sipas kësaj rregulloreje, ***është objekt informimi për publikun****"*

Në observacionin e paraqitur sqarohet se në zbatim të Urdhri nr. 295, datë 17.05.2023 "Për organizimin e shërbimit të urgjencave të kirurgjisë së përgjithshme, në Qendrën Spitalore "Nënë Tereza", në Spitalin Universitar të Traumës dhe në Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi"" protokolluar me nr. 2037, datë 17.05.2023, është përcjellë nëpërmjet memos me nr. 2037, datë 17.05.2023, sipas hierarkisë institucionale, deri te Sekretari i Përgjithshëm, për të cilin është marrë nënshkrimi dhe miratimi përkatës.

Meqenëse Urdhri nr. 295, datë 17.05.2023 prek njëkohësisht shërbimin e urgjencës spitalore dhe aksesin e qytetarëve në spitale, sipas përcaktimeve të *Nenit 41 pika 8 e Urdhrit nr. 124/1 prot, datë 07.03.2022,* Ministria **duhet të kishte bërë njoftim** në faqen zyrtare të ministrisë për informimin e publikut *për organizimin e shërbimit të urgjencave të kirurgjisë së përgjithshme në 3 Qendra Spitalore.*

Mungesa e publikimit ne faqen zyrtare të Ministrisë, apo në urgjencat spitalore, përbën mos informim të qytetarëve për të drejtat e tyre në paraqitjen në urgjencë, duke cënuar cilësinë e shërbimit të urgjencës spitalore, arsye për të cilën rasti do të trajtohet në Raport Përfundimtar Auditimi.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:
-znj. A. D., Drejtor i Politikave dhe Zhvillimit të Shërbimit Spitalor, në cilesinë e propozuesit sipas Memo nr. 2037, datë 17.05.2023;
-znj. A. P., Drejtor i Programit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në cilesinë e propozuesit sipas Memo nr. 2037, datë 17.05.2023.

Verifikim Ankese

Nga verifikim mbi zgjidhjen e ankesës disponuar me nr. 1291, datë 28.10.2024 të KLSH, e cila denoncon "Kryerjen e procedurave fiktive për blerje aparaturash mjekësore me vlera të mëdha" e cila në mënyre të përmbledhur ka këtë përmbajtje:
-Drejtoresha në Qendrën Shëndetësore n. 7 Laprakë, dhe si titullarë e autoritetit kontraktor po detyron pjesë të stafit (mjekë, infermierë, sanitarë) që të firmosin një procedurë fiktive për blerjen e një aparati mjekësor me një fond limit 24 milion lekë Aparaturë për kryerjen e ekzaminimeve ekografike. Ndërkohë Qendra Shëndetësore e ka një të tillë, por me qëllim blerjen e një aparati tjetër e ka nxjerrë jashtë përdorimit me defekt teknik. Të gjitha aparaturat mjekësore me vlera të mëdha janë kompetencë zëvendësimi apo prokurimi nga Ministria dhe jo Qendra Shëndetësore. Me presione e kërcënime detyrojnë stafin për firmosjen e dokumenteve të blerjes.
Në lidhje me ankesën për Kryerjen e procedurave fiktive për blerje aparaturash mjekësore me vlera të mëdha **nga auditimi i dokumentacionit** në Qendrën Shëndetësore nr. 7 dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale **u konstatua se:**

I. ***Procedurat e përcaktimit dhe aprovimit të fondit***

- Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore, Sektori i Riparim Mirëmbajtjes me nr. 43 Prot datë 12.04.2024 Lënda: "Relacion për pajisjet mjekësore" i kthen përgjigje Qendrës Socio-Shëndetësore nr. 7 se në vijim të kërkesës nr. prot. 244, datë 08.04.2024, administruar ne QKTB me nr.prot.43, datë 11.04.2024, ku kërkohet asistencë në lidhje me riparimin e moduleve periferike sonda mbi njësinë imazherike eko ju informojmë si vijon:

Sonda abdominale si dhe ajo e indeve të buta të njësisë imazherike EKO me nr. inv: 25349, prodh: GE, mod: Logiq C-5 nuk funksionojnë. Simptomat fillestare paraqesin mungesë 'output-i si dhe

dëmtime fizike të pariparueshme. Rezultatet ekzaminuese evidentojnë dëmtime fizike në lidhje me kabullin dhe konektorët përkatës për secilën sondë si pasojë e aplikimit masiv ndër vite. Komponenti sondë është një modul tepër sensitiv në kompozim në njësitë imazherike eko. Dëmtime të atilla nuk mund të riparohen, Njësia imazherike EKO aktuale nuk pranon komponentë alternative duke dështuar ndjeshëm në fazat testuese. Nuk disponojmë pjesë këmbimi (sonda) për të vijuar më tej me fazat e ndërhyrjes.

- Në datë 26.04.2024 nga subjekti i mirëmbajtjes M. sh.p.k. nisur e-mail në vijim te kërkesës ka përgjigje - *Pajisja ekografike model LOGIQ CS nga prodhuesi General Electric nuk prodhohet më dhe nuk furnizohen më pjese këmbimi për shkak te vjetërsisë me shume se 10-vjeçare. Për këtë arsye, na vjen keq t'ju informojmë qe nuk mund t'ju furnizojmë me sondat e kërkuara për ekografin LOGIQ CS.*
- Në datë 10.05.2024 mjeku imazherist i Qendrës Shëndetësore nr. 7 ka bërë kërkesë për furnizim me "Aparat Grafie" kërkesë e bazuar në raportet e lëna nga inxhinierët e G. E. dhe Inxhinierët e Bio-mjekësores.
- Grupi i punës i përbërë nga A. Sh., P. M. dhe F. B. në zbatim të ligjit 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik"dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ka përcaktuar vlerën limit për blerje të aparatit të Eko-Grafisë në shumën 2,933,333. Lekë.
- Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale me nr. 2600/3, datë 10.06.2024 Lënda: "Miratim shpenzimesh nga të ardhurat dytësore" bazuar edhe në kërkesën e Qendrës Socio-Shëndetësore Nr.7, Tiranë me nr. 327 prot., datë 20.05.2024, përcjellë nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Drejtoria Rajonale Tiranë, me shkresën nr. 1497/3, datë 28.05.2024, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Drejtoria Qendrore Tiranë, me shkresën nr. 2047/1 prot., datë 03.06.2024, protokolluar në MSHMS me nr. 2600, datë 05.06.2024, referuar analizës së çmimeve dërguar nga institucioni Qendra Socio-Shëndetësore nr. 7, miratojmë përdorimin e fondit të planifikuar nga të ardhurat dytësore të vitit 2024, si më poshtë:

1. Artikulli 231 (investime)

a. Ekografi me sondë konvekse 2D, sondë lineare 2D dhe video printer copë 1 (një) deri në 2,933,333 lekë me TVSH.

Realizimi i procedurës është përgjegjësi e vetë institucionit dhe duhet të jetë konform legjislacionit në fuqi. Për sa më sipër është vepruar në zbatim të Udhëzimit nr. 10 datë 09.04.2019, të FSDKSH "Për përdorimin e të ardhurave që realizojnë qendrat shëndetësore të kujdesit parësor nga veprimtaria e tyre", pika 4, germa c, ku përcaktohet:

Udhëzimit nr. 10, datë 09.04.2019 i F**ondit të sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor,** "Për përdorimin e të ardhurave që realizojnë qendrat shëndetësore të kujdesit parësor nga veprimtaria e tyre"

2. Të ardhurat e realizuara nga qendrat shëndetësore nga shërbimet e ofruara personave t pasiguruar dhe për shërbimet jashtë paketës së shërbimeve të kujdesit shëndetëso parësor arkëtohen në llogarinë e vetë qendrës shëndetësore.

3. Përdorimi i këtyre të ardhurave bëhet si më poshtë:

a. Paga dhe përfitime të punonjësve, 20% e shumës totale,

b. Investime, 40% e shumës totale.

c. Mallra e shërbime, 40% e shumës totale.

4. Detajimi dhe përdorimi i të ardhurave propozohet nga drejtori i qendrës shëndetësor dhe miratohet në parim nga operatori rajonal i shërbimeve të kujdesit shëndetëso nëse:

a. Kërkesa për përdorim të të ardhurave dytësore shërben për plotësim nevojave të qendrës për ofrim të paketës së shërbimeve shëndetësore kujdesit parësor.

b. Investimet nga të ardhurat, kërkojnë më pas blerje të mallrave e shërbimeve cilat përballohen nga niveli i të ardhurave të tjera të qendrës dhe nuk kërkojnë shtesë e buxhetit të miratuar nga Fondi.
c. Operatori ka marrë miratimin nga Ministria e Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale në raste të kërkesave për blerje të pajisjeve mjekësore.
5. Drejtori i qendrës shëndetësore, në raste të veçanta, për plotësim të kushteve, si pikës 4, kërkon miratimin në parim nga operatori rajonal, të ndryshimit të destinacionit të përdorimit të të ardhurave të tjera.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i respektimit të procedurave standarde për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe udhëzimeve plotësuese përkatëse për vitet 2023–2024, rezultoi se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka respektuar afatet dhe kërkesat procedurale të përcaktuara në kuadrin rregullator në fuqi.
Për vitin 2023, dokumenti i PBA 2023–2025 për fazën strategjike (Faza I) është dërguar me shkresën nr. 1350/1 prot., datë 03.05.2022 dhe është protokolluar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) me nr. 5771/60, datë 26.05.2022, në tejkalim të afatit të përcaktuar në "*Udhëzimin plotësues nr. 9, datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023–2025"*", si dhe në kundërshtim me kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2022. Në të njëjtën mënyrë, për vitin 2024, dokumenti i PBA 2024–2026 për fazën strategjike është dërguar me shkresën nr. 1674/1 prot., datë 05.06.2023, në tejkalim të afatit të përcaktuar në pikën 9/a të "*Udhëzimit plotësues nr. 5, datë 28.02.2023 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024–2026"*".
Gjithashtu, rezultoi se institucioni ka paraqitur kërkesa buxhetore shtesë në fund të fazës teknike (Faza II) për të dy vitet objekt auditimi, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3 të "*Udhëzimit plotësues nr. 22, datë 08.07.2022 "Për përgatitjen e PBA 2023–2025"*" për vitin 2023 dhe të "*Udhëzimit plotësues nr. 22, datë 22.07.2023 "Për përgatitjen e PBA 2024–2026"*" për vitin 2024, si dhe me paragrafin III të kapitullit 3 të "*Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm"*". Po ashtu, nuk disponohet dokumentacion që të provojë zhvillimin e konsultimeve me shoqërinë civile gjatë fazës strategjike, në kundërshtim me pikën 8/c të "*Udhëzimit plotësues vjetor për përgatitjen e PBA-së*". Këto mangësi lidhen me mosrespektimin e afateve nga strukturat përgjegjëse, mungesën e monitorimit efektiv të procesit dhe koordinimin e pamjaftueshëm ndërmjet njësive, si dhe me moszbatimin e plotë të kërkesave procedurale për dokumentim dhe konsultim. Si pasojë, janë cenuar parimet e planifikimit buxhetor të qëndrueshëm dhe transparent, është dobësuar cilësia e procesit të hartimit të PBA-së dhe është kufizuar mundësia për një vendimmarrje të informuar dhe gjithëpërfshirëse në menaxhimin e fondeve publike.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1. faqet nr.14-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
1.1 Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të kërkojë nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar forcimin e procesit të konsolidimit të PBA-së, duke siguruar ndjekjen e afateve, verifikimin paraprak dhe realizmin e kërkesave buxhetore të paraqitura nga drejtoritë dhe institucionet e varësisë përpara fazës teknike, si dhe sigurimin e organizimit, zhvillimit dhe dokumentimit të rregullt të takimeve konsultative me njësitë e varësisë dhe

shoqërinë civile, me qëllim përmirësimin e koordinimit dhe rritjen e transparencës në procesin e planifikimit buxhetor.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve kapitale me financim nga buxheti i shtetit (kapitulli 01) për vitin 2023 dhe 2024, rezultoi se projekte janë çelur pa kaluar procedurat e ciklit të miratimit të Programit Buxhetor Afatmesëm, si dhe janë konstatuar produkte të realizuara në tejkalim të planit operativ.

Për vitin 2023, nga krahasimi i projekteve të investimeve sipas planit të miratuar në projektbuxhet me projektet e çelura në vijim të miratimit të ligjit vjetor të buxhetit rezultoi se 2 projekte, konkretisht "Taksë infrastrukturë për godinën e re te ISHP" dhe "TVSH sipas marrëveshjes për BE (EU4HEALTH)", janë çelur në shumën 53,200 mijë lekë, por nuk kanë qenë pjesë e Listës së Investimeve të miratuar me projektligj, pra nuk kanë kaluar procedurat e përgatitjes së kërkesave buxhetore. Gjithashtu, 19 projekte janë çelur më pak se shuma e planifikuar, konkretisht në shumën 411,510 lekë, ndërsa 5 projekte janë çelur me shumë se shuma e planifikuar në listën e investimeve, konkretisht në shumën 35,982 lekë.

Gjithashtu, nga krahasimi i projekteve të investimeve të realizuara për vitin 2023 me ato të planifikuara në Fazën e III-të të PBA 2023–2025 rezultoi se 47 projekte investimi, të paplanifikuara në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2023–2025, janë realizuar pa kaluar procedurat e ciklit të miratimit të PBA-së, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 9, germa "a" dhe pikës 10 të *"VKM nr. 887, datë 27.12.2022 'Për menaxhimin e investimeve publike'"*, si dhe me pikat 22/a dhe 25/b të *"Udhëzimit plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 'Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023'"*. Shuma totale e realizimit të këtyre projekteve, sipas tabelës së realizimeve, paraqitet në vlerën 270,108,184 lekë.

Gjithashtu, 8 projekte investimi janë realizuar në vlerë më të lartë se ajo e planifikuar në PBA, duke sjellë një tejkalim në shumën 163,337,805 lekë, ndërsa 31 projekte investimi janë realizuar në vlerë më të ulët se ajo e planifikuar në PBA 2023–2025, ku diferenca e parealizuar paraqitet në shumën 348,489,766 lekë. Projekti me kod 18BB209, me objekt "Kosto Lokale Godina A1, dy katet + Kati 0, QSUT – Faza 2", megjithëse i realizuar, nuk ka pasur të parashikuar Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) në planifikimin buxhetor. Për tre programet 07220 "Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor", 07330 "Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor" dhe 07450 "Shërbime të Shëndetit Publik", rezultojnë gjithsej 16 projekte investimi të planifikuara, të cilat nuk janë realizuar.

Për vitin 2024, nga krahasimi i investimeve të çelura në fillim të vitit me Ligjin e Buxhetit me realizimin në fund të vitit 2024 rezultuan 26 projekte të çelura në fillim të vitit me Ligjin e Buxhetit, por nuk janë realizuar, me një vlerë të planifikuar prej 967,099,858 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e pikës 9, germa "a" dhe pikës 10 të *"VKM nr. 887, datë 27.12.2022 'Për menaxhimin e investimeve publike'"*, si dhe me pikat 22/a dhe 25/b të *"Udhëzimit plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 'Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023'"* dhe aktet përkatëse për vitin 2024.

Këto mangësi lidhen me verifikimin e pamjaftueshëm të përfshirjes së projekteve në PBA dhe në listën e investimeve nga strukturat përgjegjëse, si dhe me ndjekjen joefektive të përputhshmërisë së tyre me planifikimin e miratuar. Si pasojë, janë çelur dhe realizuar projekte të paplanifikuara, janë tejkaluar fondet për projekte të veçanta dhe nuk janë realizuar projektet e planifikuara, duke cenuar disiplinën dhe besueshmërinë e planifikimit buxhetor.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1. faqet nr.14-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të marrë masa për përfshirjen e plotë të projekteve në planifikimin buxhetor, duke shmangur realizimin e projekteve pa plan buxhetor me qëllim të rritjes së transparencës, monitorimit, efektivitetit dhe për të mundësuar një analizë reale të realizimit të shpenzimeve buxhetore.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i shpenzimeve kapitale me financim të huaj për vitet 2023–2024 rezultoi se një pjesë e projekteve janë realizuar në tejkalim të planit buxhetor të miratuar ose pa pasur plan buxheti, si dhe nuk janë ndërmarrë masa për sistemimin e këtyre devijimeve nëpërmjet rialokimeve gjatë vitit apo procesit të rishikimit të buxhetit.

Për vitin 2023, rezultoi se 10 projekte janë realizuar mbi planin në shumën 178,899,700 lekë, ndërsa 7 projekte janë realizuar nën plan. Për vitin 2024, nga 7 produkte të realizuara, 5 rezultojnë të planifikuara, ku diferenca nga krahasimi fakt-plan paraqitet në shumën 103,537 mijë lekë mbi realizim.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e pikës 27 të "*Udhëzimit plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023"*" dhe pikës 28 të "*Udhëzimit plotësues nr. 1, datë 24.01.2024 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024"*", pasi realizimi i projekteve është kryer jashtë planifikimit të miratuar dhe pa u reflektuar nëpërmjet mekanizmave të rishikimit buxhetor.

Kjo situatë lidhet me mungesën e ndjekjes dhe monitorimit të vazhdueshëm të realizimit të projekteve nga strukturat përgjegjëse, si dhe me mosndërmarrjen në kohë të masave për rialokimin e fondeve në përputhje me ecurinë faktike të tyre, duke sjellë si pasojë tejkalime të planit për disa projekte dhe nënrealizim për të tjera, çka ndikon negativisht në saktësinë e planifikimit dhe në përdorimin eficient të fondeve me financim të huaj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1. faqet nr.14-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të marrë masa për përfshirjen e të gjitha projekteve me financim të huaj në planin fillestar dhe atë të rishikuar të buxhetit, me qëllim evitimin e realizimit të projekteve pa plan buxhetor ose në tejkalim të tij apo të sigurojë marrjen masave përmes rialokimeve me qëllim rritjen e transparencës dhe monitorimin e efektivitetit të shpenzimeve kapitale me financim të huaj.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i detajimit dhe realizimit të investimeve kapitale rezultoi se janë detajuar dhe financuar projekte të investimit publik, të cilat nuk kanë qenë pjesë e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe nuk kanë qenë të përfshira në listën e investimeve publike të paraqitur me projektbuxhetin e vitit. Veprimi për detajimin dhe financimin brenda vitit buxhetor të projekteve të investimit publik, të cilat nuk kanë qenë pjesë e PBA-së dhe e listës së investimeve të miratuar, është në kundërshtim me pikën 64 të *"Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 'Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit'"*. Gjithashtu, financimi i projekteve të investimit publik me financim të brendshëm nuk është orientuar plotësisht për kontrata në vazhdim, në kundërshtim me pikën 23 të *"Udhëzimit standard të zbatimit të buxhetit nr. 9, datë 20.03.2018"*, i ndryshuar dhe udhëzimet plotësuese përkatëse.

Nga kryqëzimi i të dhënave të fondeve në dispozicion të projekteve të investimit me financim të brendshëm me të dhënat e fondit limit të procedurave të prokurimit, sipas të dhënave të Open Procurement, rezultoi se janë iniciuar procedura prokurimi për vlera më të larta se fondet në dispozicion sipas shpërndarjes 3-vjeçare të buxhetit të miratuar, në kundërshtim me nenin 50 të *Ligjit nr. 9936, datë 26.08.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar. Për vitin 2023, nga auditimi me zgjedhje i projekteve të investimeve

rezultuan tre projekte (22AC623 "Rikonstruksioni i Poliklinikës së Spitalit Rajonal Durrës", 22AC613 "Rikonstruksion i Poliklinikës së Specialiteteve Shkodër" dhe 22AC625 "Rikonstruksioni i Shtëpizave të Mbështetura në Spitalin Psikiatrik Vlorë"), të përfshira në fazën e III-të të PBA 2023–2025, me një vlerë totale prej 156,121,669 lekësh, të cilat u çelën gjatë vitit me periudhë kontrate më pak se një vit, ndërkohë që në momentin e lidhjes së kontratës fondet në dispozicion rezultuan më të ulëta se vlera e kontratës, duke sjellë marrje angazhimesh pa fonde të mjaftueshme buxhetore. Për vitin 2024, projekti 22AC640 "Ndërhyrje në godinën e A2 në QSUT për kthimin në gjendje pune të shërbimeve shëndetësore" u çel në muajin mars 2024 në vlerën 28,000 mijë lekë, pa qenë pjesë e PBA-së, ndërsa kontrata u lidh në datën 12.04.2024 me vlerë 30,716 mijë lekë me TVSH dhe gjatë vitit nuk rezultuan pagesa për këtë projekt. Gjithashtu, për projektin 18BB043 "Rikonstruksion i godinës qendrore të spitalit Gjirokastër", i planifikuar në PBA 2024–2026, në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe lidhjes së kontratës fondet në dispozicion rezultuan rreth 20% e vlerës së nevojshme, ndërsa pas lidhjes së kontratës fondet u reduktuan në vlerën 70,638 mijë lekë.
Këto mangësi lidhen me verifikimin e pamjaftueshëm të përfshirjes së projekteve në PBA dhe në listën e investimeve nga strukturat përgjegjëse, si dhe me ndjekjen joefektive të përputhshmërisë së tyre me planifikimin e miratuar, duke sjellë si pasojë marrjen e angazhimeve buxhetore pa fonde të mjaftueshme dhe financimin e projekteve jashtë planifikimit, duke cenuar disiplinën fiskale dhe besueshmërinë e procesit buxhetor.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1. faqet nr.14-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
4.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, të marrë masa për të garantuar angazhimet buxhetore afatshkurtra me fonde buxhetore, me qëllim shmangien e detyrimeve të prapambetura, duke siguruar që çdo projekt të jetë i përfshirë paraprakisht në PBA dhe në listën investimeve vjetore përpara çeljes së tij, të mos iniciohen procedura prokurimi pa fonde të garantuara sipas shpërndarjes shumëvjeçare, si dhe të respektohen prioritetet e kontratave në vazhdim, për të shmangur marrjen e angazhimeve pa mbulim financiar dhe për të siguruar një menaxhim të qëndrueshëm të investimeve publike.

Në vijimësi

5. **Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i raportit të monitorimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2024 rezultoi se në treguesit e monitorimit dhe anekset shoqëruese mungojnë të dhënat në lidhje me dy programe, 07330 "*Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor*" dhe 10430 "*Përkujdesja Sociale*", por në relacionin shoqërues paraqitet shënimi se realizimi faktik i këtyre programeve paraqet diferenca sipas sistemeve AFMIS dhe SIFQ, pra Raporti i Monitorimit i MSHMS dhe tabelat e anekseve zyrtare të publikuara, për vitin 2024 nuk janë të plota dhe nuk përfshijnë të gjithë programet buxhetore të Anekset përkatëse, veprim në kundërshtim me nenin 65, të Ligjit nr. 65, datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Si rezultat, Raporti i Monitorimit për vitin 2024 nuk ofron një paraqitje të saktë dhe gjithëpërfshirëse të ekzekutimit buxhetor, duke dobësuar mekanizmat e llogaridhënies dhe kontrollit të brendshëm të ministrisë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1. faqet nr.14-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
5.1 Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, të marrë masa për të siguruar që raportet e monitorimit të jenë të plota dhe të përfshijnë të gjitha programet buxhetore, të dhënat e relacionit shoqërues të mbështeten me anekset përkatëse, si dhe të dhënat ndërmjet sistemeve AFMIS e SIFQ të rakordohen në kohë, në mënyrë që të garantohet transparenca dhe besueshmëria e raportimit.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i faturave të likuiduara nga MSHMS për vitet 2023 dhe 2024 rezultoi se janë kryer likuidime në tejkalim të afatit ligjor 30 ditor. Konkretisht, nga kryerja e testimeve mbi urdhër shpenzimet, u konstatua se janë kryer likuidime në tejkalim të afatit ligjor 30 ditor 56 transaksione në vlerë 38,960,913 lekë (aneksi bashkëlidhur) për vitin 2023, 54 transaksione në vlerë 83,626,788 lekë (aneksi bashkëlidhur) për vitin 2024. Këto veprime janë në kundërshtim me neni 52 të Ligjit Nr.9936, datë 26.6.2008 **"***Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH*", i ndryshuar, dhe neni 7 pika iv) të Ligjit nr.48/2014 "*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*", të cilët parashikojnë kryerjen e pagesave brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të faturës.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 , faqe 56-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
6.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në MSHMS duhet të vendosë procedura monitorimi dhe kontrolli për kryerjen e likuidimeve brenda afateve ligjore, duke siguruar që të gjitha faturat e operatorëve ekonomikë të likuidohen brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se referuar të dhënave të përfshira në pasqyrat financiare të vitit 2024, llogaria 468 **"**Debitorë të ndryshëm" rezultoi me një vlerë prej 26,256,378 lekë, e cila përfaqëson detyrime të prapambetura të hershme ndaj subjekteve kontraktore që kanë kryer punime në funksion të MSHMS, për të cilat Ministria nuk ka ndermarrë asnjë veprim për likujdim. Kjo vlerë përbën një angazhim financiar të mbartur nga vitet e mëparshme, i cili është trajtuar edhe nga auditimet e mëparshme të KLSH-së. Nga auditimi rezultoi se në dokumentacionin shoqërues të pasqyrave financiare 2024 nuk është reflektuar asnjë informacion lidhur me masat konkrete të ndërmarra për arkëtimin apo zgjidhjen e këtij detyrimi, duke treguar një mungesë transparence dhe ndjekjeje efektive të çështjes.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 , faqe 56-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
7.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në MSHMS, të sigurojë transparencë dhe ndjekje efektive të detyrimit prej 26,256,378 lekësh në llogarinë 468, duke dokumentuar masat e ndërmarra, duke përcaktuar afate të qarta për zgjidhjen e tij dhe duke raportuar periodikisht progresin në dokumentacionin shoqërues të pasqyrave financiare të institucionit.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për rimbursimin e TVSH-së për ndërtimet e reja dhe furnizimin e tyre me pajisje mjekësore në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 5241, datë 25.11.2013, të lidhur ndërmjet Donatorit "Gj. K." e Emirateve të Bashkuara Arabe dhe Ministrisë u evidentuan mangësi në zbatimin dhe monitorimin e kësaj marrëveshjeje, pasi Ministria nuk ka ngritur një strukturë apo grup monitorimi për ndjekjen e projektit, si dhe nuk ka planifikuar në mënyrë të plotë fondet për rimbursimin e TVSH-së në kuadër të planit të investimeve, duke paraqitur kërkesë për çelje fondesh vetëm në muajin prill 2024, pas kërkesës së donatorit për rimbursim.
Ministria deri më datën 31.12.2024, nuk ka kryer rimbursimin e TVSH-së në vlerën totale prej 208,000 lekë ndaj donatorit, lidhur me ndërtimin dhe pajisjen e Qendrave Shëndetësore Ambulanca Tip A2, të realizuara në fshatin Vanaj dhe në fshatin Peshtan, Fier. Nga auditimi u

konstatua gjithashtu mungesë monitorimi për sa i përket kontrollit të cilësisë së punimeve, respektimit të afateve të realizimit dhe pajisjes së objekteve me aparatura mjekësore. Po ashtu, aktet e dhurimit nuk rezultojnë të jenë nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e përfituesit të donacionit, duke penguar përfundimin e procedurës për kalimin formal të pronësisë nga donatori te përfituesi. Nga verifikimi i dokumentacionit financiar rezultoi gjithashtu mungesa e raporteve periodike të progresit nga Këshilli Drejtues i Projektit për verifikimin e shpenzimeve faktike dhe aprovimin e TVSH-së së rimbursuar.

Nga auditimi u konstatua se në kuadër të zbatimit të projektit "Shëndet për të Gjithë" (Health for All Project/HAP), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim me qëllim përmirësimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka miratuar dhe likuiduar pjesërisht shumën e kërkuar për Fazën e Tretë në vlerën 9,670,233 lekë. Kjo pagesë është kryer me tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh, në kundërshtim me afatet e përcaktuara në pikën 184 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 ***"Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit"***, si dhe në paragrafin 63, pika 2 të Udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015 për TVSH-në.

Nga auditimi rezultoi se kërkesa për rimbursimin e TVSH-së në vlerën 12,580,297 lekë, e paraqitur në kuadër të projektit "Shëndeti për të Gjithë – HAP", financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, nuk është miratuar nga MSHMS, si detyrim për rimbursim, dhe nuk rezultoi e pasqyruar në pasqyrat financiare të institucionit. Gjithashtu, u konstatua mungesa e një strukture monitoruese të projektit brenda MSHMS, si dhe mungesa e dokumentacionit mbështetës për ndjekjen dhe verifikimin e shpenzimeve, duke krijuar paqartësi në administrimin dhe monitorimin e procesit të rimbursimit të TVSH-së në kuadër të marrëveshjes përkatëse.

Nga auditimi u konstatua se në kuadër të zbatimit të projektit **"**S. Ch.", me NIPT J.....D, në zbatim të projektit të SDC "Shkolla për Shëndetin". MSHMS ka kryer rimbursimin e TVSH-së për projektin "Shkolla për Shëndetin" në shumën 4,997,962 lekë, kundrejt kërkesës për rimbursim prej 5,898,932 lekë duke mos rimbursuar shumën prej 900,970 lekësh. Pagesa për rimbursimin e TVSH-së është realizuar me tejkalim të afatit ligjor 30-ditor, duke shkelur dispozitat e Udhëzimit të MFE nr. 09/2018 dhe Udhëzimit nr. 6/2015 për TVSH-në. Në MSHMS nuk është ngritur një grup i posaçëm monitorimi për ndjekjen e zbatimit të projektit dhe nuk janë hartuar apo miratuar raportet gjashtëmujore dhe vjetore të progresit, në kundërshtim me nenin 6.6, germa "b" të Marrëveshjes, duke krijuar mangësi në mekanizmat e kontrollit dhe mbikëqyrjes së projektit. Në pasqyrat financiare të vitit 2024 nuk janë pasqyruar detyrimet e prapambetura për rimbursimin e TVSH-së në vlerën 900,970 lekë, ndonëse ato burojnë nga kontrata zyrtare nr. 81068419 dhe janë të mbështetura në marrëveshjen ndërkombëtare me Konfederatën Zvicerane, duke cenuar transparencën dhe saktësinë e pasqyrimit të detyrimeve buxhetore dhe duke rrezikuar respektimin e angazhimeve ndërkombëtare të shtetit shqiptar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 , faqe 56-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në MSHMS**,** të krijojë një grup monitorimi për zbatimin e projektit dhe të sigurojë hartimin dhe dorëzimin e raporteve gjashtë-mujore dhe vjetore për Këshillin Drejtues të Projektit, për të verifikuar shpenzimet faktike dhe miratimin e TVSH-së së rimbursuar, të sigurojë regjistrimin dhe pasqyrimin e saktë të gjithë detyrimeve financiare të projektit, përfshirë TVSH-në e rimbursuar, në pasqyrat financiare për të garantuar përputhshmërinë me standardet kontabël dhe ligjore si dhe të forcojë menaxhimin dhe koordinimin për donacionet duke siguruar kontrollin dhe monitorimin e cilësisë dhe afateve të projekteve, dokumentimin dhe regjistrimin e aktit të dhurimit të pasurive të dhuruara, sipas dispozitave ligjore dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit.

Sektori i Financës në MSHMS të regjistrojë dhe pasqyrojë të gjitha detyrimet e prapambetura të projektit në pasqyrat financiare, duke siguruar transparencën dhe saktësinë e raportimit buxhetor dhe respektimin e angazhimeve ndërkombëtare të shtetit shqiptar.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se MSHMS nuk ka nxjerrë udhëzime për AK të varësisë, lidhur me monitorimin e zbatimit të kontratave për furnizimin me barna, në mospërputhje me nenin 67, pika 3, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Në këtë kuadër, nga shqyrtimi i praktikave të ndjekura nga disa institucione spitalore të varësisë (SHS Kukës, QSR Berat dhe SHS Përmet), për periudhën nga lidhja e minikontratave në zbatim të marrëveshjeve kuadër të vitit 2024, deri në marrjen në dorëzim të furnizimeve, u evidentuan mangësi në dokumentimin dhe administrimin e kontratave dhe të procedurave të pranimit të barnave.

Sa i përket kontratave të lidhura, u konstatua se asnjë prej tyre nuk ishte në përputhje me formatet standarde të përcaktuara në Shtojcat 14 dhe 15 të Dokumenteve Standarde të Tenderit për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës. Gjithashtu, në kontratat e lidhura nuk rezultoi të jetë hartuar grafik lëvrimi për realizimin e furnizimeve, ndërsa në një nga kontratat e lidhura nga QSR Berat nuk është përcaktuar as afati i lëvrimit dhe as data e përfundimit të kontratës, duke dobësuar mekanizmat e kontrollit për zbatimin e kontratës dhe mundësinë e aplikimit të penaliteteve në rast vonesash. Sa i përket marrjes në dorëzim të barnave, tre institucionet spitalore të varësisë aplikojnë formate të ndryshme të procesverbaleve të marrjes në dorëzim, ku u konstatua se SHS Kukës nuk dokumenton verifikimin e të dhënave lidhur me firmën prodhuese dhe vendin origjinës së barnave të furnizuara, ndërkohë që asnjë nga 3 institucionet spitalore të varësisë nuk dokumentojnë verifikimin e datave të prodhimit të barnave të furnizuara, në kundërshtim me Kreun III, pika 4b, të Rekomandimit të APP-së nr. 5529/1 prot., datë 18.07.2023 "Mbi problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të zbatimit të kontratave të furnizimit të mallrave, të nënshkruara në bazë të marrëveshjeve kuadër".

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 , faqe 90-269 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

<u>9.1. Rekomandimi</u>: Titullari i MSHMS-së të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një procedure të shkruar, që të shërbejë si udhëzim për institucionet spitalore të varësisë, lidhur me ndjekjen e zbatimit të kontratave nëpërmjet planit të zbatimit të kontratave, ku, pa u kufizuar, të përcaktohet:

- Unifikimi i kontratave të lidhura nga autoritetet kontraktore të varësisë, në zbatim të marrëveshjeve kuadër për furnizim me barna, sidomos sa i përket dispozitave lidhur me afatet e lëvrimit të barnave dhe hartimit të grafikut të lëvrimit;
- Unifikimi i të dhënave të paraqitura në dokumentacionin e mbajtur për marrjen në dorëzim të barnave, duke hartuar një format tip procesverbali, ku të mundësohet evidentimi i çdo verifikimi të kryer nga njësitë e marrjes në dorëzim në institucionet spitalore të varësisë, për të garantuar përputhshmërinë e barnave me specifikimet teknike, kontratën dhe ofertën e pranuar;
- Formati dhe periodiciteti i raportimit periodik pranë MSHMS-së, lidhur me nivelin e zbatueshmërisë së kontratave, si dhe me çdo problematikë të hasur për furnizim me barna;
- Aktivitete kontrolli nga MSHMS, në cilësinë e institucionit epror, për të garantuar realizimin e objektivave politikë dhe të menaxhimit, si dhe ligjshmërinë/ përshtatshmërinë e veprimeve administrative, ekzekutimin e buxhetit dhe menaxhimin financiar, nga institucionet e varësisë të MSHMS-së, lidhur me zbatimin e kontratave të furnizimit me barna.

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik ka rezultuar se:
a. Në të trija procedurat e prokurimit të përqendruar për furnizim me barna (B1, B2, B3, ndarë gjithsej në 256 lot-e, me fond limit total prej 8,855,849,351 lekë pa TVSH), për të garantuar kontrollin e çmimit të barnave dhe marzhet, sipas përcaktimit në nenin 37 të Ligjit nr. 105/2014 "*Për barnat dhe shërbimin farmaceutik*", njësia e prokurimit nuk ka përcaktuar në DST dhe marrëveshjet kuadër të lidhura, se, në fazën e zbatimit të kontratave, pavarësisht çmimit të ofertuar dhe të pranuar gjatë procedurës së prokurimit, asnjë bar nuk lejohet të tregtohet me shumicë mbi çmimin maksimal të lejuar;
b. Në procedurat e prokurimit me objekt (i) "*Blerje pajisje të teknologjisë së lartë për spitalet*", ndarë në 10 lot-e, me fond limit 259,380,166 lekë pa TVSH dhe (ii) "*F.V. pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore*", me fond limit 14,750,000 lekë pa TVSH, njësia e prokurimit nuk ka parashikuar në DST dhe MK/ kontrata, detyrimin e OE të shpallur fitues, që në momentin e lëvrimit të pajisjeve, t'i shoqërojë këto të fundit me certifikatën e regjistrimit të pajisjes në Regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore që mbahet nga Agjencia e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, në momentin e hyrjes së pajisjes në tregun Shqiptar, sipas përcaktimit në nenin 13 të Ligjit nr. 89/2014 "*Për pajisjet mjekësore*", i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 , faqe 90-269 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
10.1. Rekomandimi: Njësitë e prokurimit në MSHMS, të marrin masa për përfshirjen në dokumentet e tenderit dhe marrëveshjet kuadër/ kontratat e lidhura, të gjitha informacionet e nevojshme dhe detyrimet ligjore që burojnë nga fusha specifike e objektit të prokuruar, që mbartin riskun e parregullsive thelbësore përgjatë zbatimit të kontratave, për të garantuar zbatimin e të gjithë kuadrit ligjor në fuqi të lidhur me objektin e prokurimit.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në procedurën e prokurimit me objekt "*Blerje pajisje të teknologjisë së lartë për spitalet*", ndarë në 10 lot-e, me fond limit 259,380,166 lekë pa TVSH, nuk rezultoi që specifikimet teknike të hartuara nga specialisti i fushës të jenë të argumentuara teknikisht, në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar. Mungesa e argumentimit në nivel teknik të specifikimeve teknike riskon përfshirjen e specifikimeve teknike që nuk janë të domosdoshme për të siguruar realizimin e procedurës së prokurimit sipas cilësisë së kërkuar, duke ndikuar drejtpërdrejt në kufizimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë në tregun e pajisjeve mjekësore.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 , faqe 90-269 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
11.1. Rekomandimi: Titullari i MSHMS-së të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për kryerjen e verifikimeve të nevojshme lidhur me shkaqet, pasojat dhe përgjegjësitë, sa i përket mosargumentimit të specifikimeve teknike në procedurën e prokurimit me objekt "Blerje pajisje të teknologjisë së lartë për spitalet".

Menjëherë

11.2. Rekomandimi: MSHMS të marrë masa për dokumentimin e argumentimit të specifikimeve teknike në mënyrë të tillë që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mosdiskriminim dhe konkurrencë, njëherazi duke garantuar përdorimin e fondeve publike me ekonomicitet dhe eficiencë.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave të lidhura në zbatim të Marrëveshjes Kuadër me objekt "*Blerje orendi dhe pajisje mobilimi*" për Qendrat Shëndetësore të rikonstruktuara, me fond limit 35,203,770 lekë pa TVSH, përkatësisht minikontratat (i) nr. 2019/23 prot., datë 08.10.2024, me vlerë 5,992,659.015 lekë pa TVSH; (ii) nr. 2019/11 prot., datë 07.08.2024, me vlerë 7,100,146 lekë pa TVSH; (iii) nr. 2019/28 prot., datë 21.11.2024, me vlerë 5,504,355 lekë pa TVSH; dhe (iv) nr. 2019/18 prot., datë 02.09.2024, me vlerë 5,508,005 lekë pa TVSH, u konstatua si në vijim:

- Për përcaktimin e sasive që do të prokurohen, MSHMS ka mbajtur korrespondencë me Drejtoritë Rajonale të OSHKSH-ve, të cilat kanë përcjellë sasitë e artikujve për furnizimin e QSH-ve të rikonstruktuara. Sasitë e kërkuara nga DR OSHKSH-të janë marrë të mirëqena dhe nuk është kryer asnjë verifikim nga ana e MSHMS-së.

Nga auditimi u konstatua se, për përcaktimin e sasive që do të prokurohen, MSHMS ka zhvilluar korrespondencë me Drejtoritë Rajonale të OSHKSH-ve, të cilat kanë përcjellë kërkesat për sasitë e artikujve për furnizimin e qendrave shëndetësore të rikonstruktuara, ndërkohë që këto kërkesa janë përdorur si bazë për planifikimin e prokurimit pa u kryer verifikime apo analiza nga ana e MSHMS mbi përputhshmërinë e tyre me nevojat reale të furnizimit, duke krijuar risk për planifikim jo të saktë të sasive, në kundërshtim me nenin 1, pika 1 dhe 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Nga auditimi u konstatua se, pavarësisht përcaktimit në minikontrata për kryerjen e kontrollit paraprak nga MSHMS mbi furnizimin me orendi dhe pajisje mobilimi, nuk rezultoitë jetë kryer verifikim paraprak nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim, ndërkohë që marrja në dorëzim e pajisjeve është realizuar nga grupe pune në Drejtoritë Rajonale të OSHKSH-ve, pa disponuar paraprakisht dokumentacionin mbi specifikimet teknike për verifikimin e përputhshmërisë së artikujve dhe pa pasqyruar në procesverbalet përkatëse elementët cilësorë dhe verifikimet e kryera, duke evidentuar mungesë të ushtrimit të kontrollit nga ana e MSHMS, si në fazën e planifikimit të sasive sipas nevojave reale ashtu edhe në fazën e marrjes në dorëzim të furnizimeve, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, lidhur me përgjegjësitë e autoritetit kontraktor për planifikimin dhe zbatimin e kontratave në prokurimet publike..

Nga verifikimi në terren në 8 qendra shëndetësore të rikonstruktuara, me vlerë totale të artikujve të furnizuar prej 7,906,998 lekë me TVSH, u evidentuan mospërputhje ndërmjet sasive të artikujve të kërkuar dhe furnizuar me nevojat reale të këtyre njësive, duke rezultuar në raste ku sasia e mobiljeve të furnizuara tejkalon kapacitetin funksional dhe fizik të qendrave shëndetësore. Si pasojë, një pjesë e artikujve të furnizuar për përdorim në këto njësi (p.sh. deri në 55% të vlerës totale të artikujve për QSH nr. 2 Vlorë dhe 31% të vlerës për QSH Bicaj), janë transferuar në qendra shëndetësore apo ambulanca të tjera që nuk kanë qenë pjesë e planifikimit fillestar, ose në magazinimin e pajisjeve të papërdorura. Gjithashtu, nga verifikimi në terren janë konstatuar mospërputhje sa i përket specifikimeve teknike të artikujve të marrë në dorëzim. Në rastet kur është konstatuar se artikujt (mobiljet) e furnizuara janë transferuar nga qendrat shëndetësore për të cilat ishin planifikuar fillimisht drejt njësive të tjera shëndetësore, nuk është vënë në dispozicion në të gjitha rastet dokumentacioni përkatës justifikues (si procesverbale, fletë-dalje nga magazina, etj.), sipas përcaktimeve në UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Në dy raste, përkatësisht në QSH nr. 2 Vlorë dhe QSH Armen, ky dokumentacion është vënë në dispozicion elektronikisht vetëm pasi strukturat e MSHMS-së janë vënë në dijeni për mangësitë e konstatuara gjatë verifikimit në terren.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 , faqe 90-269 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

12.1. Rekomandimi: Titullari i MSHMS-së të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për analizimin e shkaqeve dhe përgjegjësive brenda MSHMS-së dhe institucioneve të varësisë DR OSHKSH, NJVKSH, që kanë sjellë parregullsitë në planifikimin e sasive dhe pranimin e objekteve/ pajisjeve jo në përputhje me specifikimet teknike.

Menjëherë

12.2. Rekomandimi: Titullari i MSHMS-së të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me qëllim evidentimin e prezencës fizike të aktiveve nëpër QSH, për të garantuar se pajisjet janë në ambientet e QSH-ve/ Amb.-ve për të cilat janë prokuruar ose janë lëvizur me dokumentacion të rregullt. Në rast se evidentohen pajisje që janë prokuruar mbi sasitë e nevojshme (si në rastin e QSH Fshat-Këlcyrë), nëpërmjet dokumentacionit të nevojshëm autorizues dhe vërtetues, të kryhet rishpërndarja nëpër QSH/ Amb. ku mund të jenë efektive..

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 2 (dy) procedurave të prokurimit në kategorinë/zërin "Punë publike", "Ndërtimi i godinës së re Laboratorëve në ISHP" dhe "Rikonstruksion i Qendrave Shëndetësore" me fond limit prej 667,582,351.39 lekë nga 6 procedura të kryera me fond limit 678,061,821.61 lekë, u konstatuan mangësi sa i takon hartimit të kritereve të kualifikimit dhe konkretisht:

- aplikimi në mënyrë të gabuar i masës së vlerës për paraqitjen e punëve të ngjashme, në të gjitha rastet,
- mos argumentimi apo analizimi i nevojës për numrin e punonjësve, apo numrin e makinerive të kërkuar,
- aplikimi i kriterit të njëjta dhe të përsëritura për disponim staf mbështetës përgjegjës kantieri Inxhinier, kërkesë e pa argumentuar pasi njëkohësisht është kërkuar që Operatorit Ekonomik duhet të deklarojë drejtues teknik të punësuar: Inxhinier Ndërtimi; Inxhinier Mekanik/Hidroteknik dhe Inxhinier Elektrik.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 2 dhe 77 të Ligjit 162/2020 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar, me nenin 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 , faqe 90-269 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandimi: Njësia e prokurimit në MShMS të marrë masa që, gjatë përcaktimit të kritereve të kualifikimit, kërkesat të argumentohen jo vetëm në funksion të objektit të prokurimit, por edhe sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve përkatëse të ekspertëve të fushës, rast pas rasti, me qëllim që të mos kufizohet pjesëmarrja e operatorëve ekonomik.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi fizik i pajisjeve të furnizuara në Spitalin Kukës, Spitalin Përmet dhe në Qendrën Spitalore Rajonale Berat (Njësia Kuçovë), në kuadër të auditimit të zbatimit të Mini Kontratës nr. 1, datë 24.01.2025, me objekt "Blerje pajisjesh të teknologjisë së lartë", Lot 4 "Echo 3D/4D me aplikim të përgjithshëm + sondë lineare + sondë kardiake + sondë konvekse + sondë gjinekologjike", të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor "Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale" dhe OE "M.", me vlerë kontraktuale 15,840,000 lekë pa TVSH, u konstatuan mospërputhje ndërmjet karakteristikave teknike të përcaktuara në dokumentacionin e ofertës dhe pajisjeve të dorëzuara. Konkretisht, u evidentuan mospërputhje ndërmjet sondave të deklaruara sipas manualit teknik të pajisjes dhe sondave të dorëzuara fizikisht,

referuar parametrave të sistemit të përcaktuar në manualin teknik të dorëzuar me ofertën. Gjithashtu, nuk rezulton të jetë dokumentuar disponimi i memories së brendshme/jashtme me kapacitet 1 TB, ku 128 GB duhet të jenë në formatin SSD, sipas kërkesave të specifikimeve teknike. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 124 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe nenin 107 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 , faqe 90-269 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të marrë masa për ngritjen e një komisioni verifikimi, në përbërje të të cilit të përfshihet edhe një specialist i fushës së inxhinierisë biomedikale, me qëllim kryerjen e verifikimit fizik të pajisjeve "Echo 3D/4D me aplikim të përgjithshëm" të furnizuara në 9 qendrat spitalore në zbatim të Mini Kontratës nr. 1, datë 24.01.2025 "Blerje pajisjesh të teknologjisë së lartë", lidhur me funksionalitetin e aparaturave, disponimin e memories së brendshme/jashtme sipas kapacitetit të kërkuar, si dhe përputhshmërinë e sondave të dorëzuara me karakteristikat teknike të pajisjeve.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje i procedurave të prokurimit të fondeve për barna, në 21 lote, nga 21 lote te audituara, me fond limit 1,726,769,083 lekë pa TVSH, kundrejt totalit prej 68 lote me fond limit total të përllogaritur 2,446,331,243 lekë pa TVSh u konstatuan mangësi sa i takon hartimit të kritereve të kualifikimit konkretisht:

- Në DST nuk është aplikuar kriteri kualifikues për Operatorët ekonomik pjesëmarrës, që për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, (Drejtues Teknik) që plotëson kushtet e tregtimit të ilaçeve për njerëz sipas përcaktimeve të nenin 29 të Ligjit nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik";
- Në DST "Kritereve të Veçanta të Kualifikimit", "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" nga njësia e prokurimit në DST nuk është kërkuar që Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin pasqyrat financiare vjetore, për vitet financiare 2021,2022 dhe 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, dhe Raportet e Auditimit, kjo në përputhje me vlerat e fondit limit dhe natyrën e prokurimit në zbatim të përcaktimeve të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Standardet e Kontabilitetit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 77 të Ligjit 162/2020 "*Për prokurimin publik*", si dhe nenet 40 dhe 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 , faqe 90-269 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Njësia e prokurimit, gjatë përcaktimit të kritereve të kualifikimit, të marrë masa që të aplikojë kërkesa kualifikuese në funksion me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe në përputhje me legjislacionin e fushave specifike që lidhen me prokurimin e fondeve.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje i procedurave të prokurimin të fondeve për barna në vitin 2024 u konstatua se:

- ***Në 7 raste*** me vlerë totale 802,112,538 lekë oferta e paraqitur nga OE është më e ulët se 85 % e mesatares së ofertave të vlefshme përkatësisht; Lot 1 "Ceftriazone", me fond limit 363,447,780 lekë pa TVSH fitues OE "M."; Lot 2 "Levofloxacine 5mg/ml-100ml flakon", me fond limit 156,032,071 lekë pa TVSH fitues OE "A. Ph"; Lot 4 "Metronidazole", me fond limit 128,834,817.76 lekë pa TVSH fitues OE "A. Ph"; Lot 12 "Ciprofloxacine", me fond limit

57,313,022 lekë pa TVSH fitues OE "A." ; Lot 87 "Zoledronic Acid", me fond limit 17,254,332.34 lekë pa TVSH, fitues OE "D. Ph."; Lot 15 "Cefuroxime 750 mg Flakon/ Flakon + ampule (hollues)", me fond limit 29,891,260.40 lekë pa TVSH fitues OE "T."; Lot122 "Vecuronium bromide" 10 mg Flakon, me fond limit 49,339,254.95 lekë pa TVSH fitues OE "I.". Në sistemin SPE si dhe në dokumentacionin e dosjes nuk ka kërkesë nga Autoriteti Kontraktor për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët. Dokumentacion të paraqitur nga Operatorët Ekonomikë janë të pa protokolluar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe nuk disponohet dokumentacion për shpjegimet e kostos ose për çmimin e ofruar.

- Në 1 rast oferta e paraqitur nga OE e kualifikuar si e suksesshme është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në SPE nuk ka të dokumentuar nëpërmjet SPE kërkesën për argumentim të vlerës së ofertës prej 40,868,100 lekë si anomalisht e ulët nga OE "P.", si dhe nuk ka dokumentacion për shpjegime dhe argumentim për ofertën anaomalisht të ulët.

Veprim në kundërshtim me nenin 93 Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe me nenin 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 , faqe 90-269 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1. Rekomandimi: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në çdo rast gjatë vlerësimit të ofertave nga operatorëve ekonomik, të marrë masa që në rastet e ofertave anomalish të ulëta të pasqyrojë në sistemin e prokurimit elektronik si dhe të administrojë në dokumentacionin e dosjes kërkesën nga Autoriteti Konraktor ndaj Operatorëve Ekonomikë për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, si dhe dokumentacionin e Operatorit Ekonomik për shpjegime dhe argumentim për ofertën anomalisht të ulët.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje i procedurave të prokurimit të fondeve për barna në vitin 2024 u konstatua se:

- Në 1 rast autorizimi për tregtim është lëshuar nga AKBPM me nr. 359, datë 26.04.2019 me afat 5 vjeçar, ndërkohë që procedura e prokurimit është hapur më 20.06.2024, pra ky autorizim në momentin e hapjes së procedurës ka qenë jashtë afatit të vlefshmërisë. Pavarësisht se në dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi është shkresa nga AKBPM "kthim përgjigje" me nr. 936/3, datë 04.04.2024 ku konfirmohet se dokumentacioni i dorëzuar për rinovimin e autorizimit plotëson kërkesat për rinovimin, nga OE "T." nuk është paraqitur Autorizimi i rinovuar çka përbën mos plotësimin e DST, pika 2.4.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim.
- Në 3 raste në vlerë totale prej 126,932,889.8 lekë në sistemin SPE nuk ka paraqitur formularin e Autorizimit për Tregtim lëshuar nga AKBPM, kjo në Lot 6 "Cefepime", me fond limit 49,093,653 lekë pa TVSH; Lot 48 "Human Coagulation Factor IX", me fond limit 47,947,976.40 lekë pa TVSH, Lot 15 "Cefuroxime 750 mg Flakon/ Flakon + ampule (hollues)", me fond limit 29,891,260.40 lekë pa TVSH, duke krijuar risk për zbatimin e kontratës së lidhur, për shkak të mosdeklarimit të stokut në momentin e lidhjes së kontratës.

Veprim në kundërshtim me nenin 11 të Ligjit nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 , faqe 90-269 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe e Mirëqenies Sociale, Drejtoria e politikave të shërbimit spitalor të marrë masa për verifikimin rast pas rasti të zbatimit të kontratave në ato raste kur autorizimi për tregtim i barit, i lëshuar nga AKBPM dhe i paraqitur nga operatorët ekonomikë, rezulton me afat vlefshmërie të tejkaluar gjatë periudhës së furnizimit sipas marrëveshjeve kuadër

për vitet 2024–2026. Gjithashtu, në vijimësi të procedurave të prokurimit, të sigurojë që lidhja e marrëveshjeve kuadër të kryhet vetëm pas paraqitjes së autorizimit të vlefshëm për tregtim të barit, si dhe të parashikojë në dokumentacionin kontraktual klauzola që garantojnë përputhjen e afatit të vlefshmërisë së autorizimit me periudhën e zbatimit të marrëveshjes kuadër.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se gjatë vitit kalendarik, 4 raste të kontraktimeve për shërbimin e përkthimit në vlerën 163,690 lekë janë realizuar jashtë sistemit të prokurimit elektronik, pavarësisht se vlera totale e likuiduar për këtë kategori ishte 407,486 lekë. Ky veprim përbën shmangien në përdorimin e detyrueshëm të sistemit elektronik të prokurimit, duke shkelur nenin 20, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, i cili kërkon përdorimin e sistemit elektronik për të gjitha procedurat e prokurimit publik me vlera nga 100,000 deri në 1,000,000 lekë pa TVSH.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 , faqe 90-269 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
18.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, nëpërmjet njësive përkatëse të prokurimit, të marrë masa të sigurojë që të gjitha kontraktimet për shërbime, përfshirë ato me vlerë të vogël, të kryhen përmes sistemit të prokurimit elektronik duke shmangur fragmentimin e vlerës dhe respektuar detyrimin ligjor për transparencë dhe përdorim të detyrueshëm të procedurave elektronike të prokurimit.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit teknik administruar në dosjen e zbatimit të objektit "Ndërtimi i godinës së re të laboratorëve në ISHP", me ndërtues BOE "A. C. & K." sh.p.k, sipas kontratës nr. 1013 prot., datë 10.10.2023 me vlerë 403,151,919 lekë me TVSH, u konstatua se në librezën e masave nr.11 (sipas situacionit të fundit të certifikuar), në punimet e suvatimeve për fasadën e ventiluar, janë evidentuar se janë certifikuar si nënzëra në libreza masash në kategorinë 1.13.4, respektivisht nënzërat si më poshtë:
- an. Veshje fasade me lesh guri 5cm , 125 kg/m3, λ=0,035 Ë/m*K, sasia 1,061.42 m2;
- nr. anal. 2.346 Suva fasade me teranove çimento te bardhe h > 8m, sasia 1,601.51 m2;
- nr. anal. 2.328/1 Patinim muri me stuko, sasia 1,601.51 m2;
- nr. anal. 2.308/a Suvatim me grafiato h > 4 m, sasia 1,452.11 m2.

Punimet e sipërcituara janë realizuar dhe certifikuar në libreza masash, por nuk ishin miratuar ende nga AK. Gjithashtu dhe ulluqet e shkarkimit vertikal janë realizuar me ulluqe PVC dhe jo bakri, pa marrë miratimin zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, në kundërshtim me Udhëzimin nr.2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 , faqe 90-269 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
19.1 Rekomandimi: Mbikëqyrësi i punimeve dhe grupet e ndjekjes dhe të zbatimit të kontratave të marrin masat që çdo ndryshim në projekt dhe preventiv të miratohet paraprakisht nga strukturat përgjegjëse dhe më pas të realizohet certifikimi i këtyre punimeve në libreza masash, proces ky i cili duhet të dokumentohet dhe administrohet në dosjen teknike të zbatimit, me qëllim verifikimin dhe reflektimin e sasive dhe cilësinë e materialeve e të produkteve të përdorura sipas miratimeve respektive.

Në vijimësi
19.2. Rekomandimi: Titullari i MShMS të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për verifikimin e zërave të mësipërm të certifikuar dhe të dokumentohet në dosjen teknike nëpërmjet

një relacioni nëse këto zëra janë kryer në përputhje me projektin dhe nëse duhet të miratohen nga AK.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm janë konstatuar mangësitë si vijon:
- Komiteti i Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) gjatë viteve 2023 dhe 2024 nuk ka funksionuar. Ky komitet është krijuar me urdhër të ministrit në vitin 2018, por mandati i anëtarëve të tij ka përfunduar në fund të vitit 2020 dhe nuk është ngritur më.
- NJAB në MSHMS ka realizuar auditime shtesë të cilat nuk janë përcjellë drejt Drejtorisë së Harmonizimit në ish-Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë duke mos u reflektuar në planin vjetor të konsoliduar në shkallë vendi.
- Njësia e Auditimit të Brendshëm ka funksionuar për një periudhë 37-ditore (nga data 28.09.2024 deri më 03.11.2024) pa një drejtues të komanduar apo të emëruar, pas dorëheqjes së drejtorit të komanduar dhe përpara rikthimit të tij në detyrë.
- Raporti vjetor i veprimtarisë për vitin 2023 të Njësisë së Auditimit të Brendshëm është dërguar në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm (Ministria e Financave) me shkresën nr. 782/1 prot., datë 13.02.2024, pa u miratuar paraprakisht nga titullari i institucionit.
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, VKM nr. 160, datë 02.03.2016, "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike" dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 , faqe 269-297 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
20.1 Rekomandimi: Ministri i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të marrë masa për emërimin e anëtarëve të rinj të Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe të sigurojë funksionimin aktiv të tij, si dhe të marrë masa për respektimin e formave të raportimit apo transparencës në dokumentimin e veprimtarisë së NjAB dhe konkretisht sa i takon Raporteve Vjetore, apo dërgimit të plotë të tyre pranë Drejtorisë së Harmonizimit në Ministrinë e Financave.

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Urdhëri nr. 295, datë 17.05.2023 përcakton grafikun javor të pritjes së rasteve kirurgjikale emergjente mes tre spitaleve universitare të Tiranës për të trajtuar rastet e urgjencës sipas Ligjit nr. 147/2014. Nga verifikimi në faqen zyrtare të MSHMS ose burime të tjera informacioni, nuk është gjetur informacion mbi informimin publik për grafikun e pranimit të pacientëve në urgjencë spitalor.
Mungesa e protokolleve të publikuara dhe e udhëzimeve të qarta pengon garantimin e praktikave të përputhshme me legjislacionin dhe standardet profesionale.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 , faqe faqe 297-303 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
21.1 Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të marrë masa në bashkëpunim me Drejtoritë përkatëse në Ministri dhe titullarët e Spitaleve të publikojë udhëzime dhe protokolle të qarta për pranimin e pacientëve në urgjencën spitalore, nëpërmjet informimit publik mbi grafikun e pritjes së emergjencave sipas spitaleve, për të orientuar drejt dhe në kohë pacientët që paraqiten drejtpërdrejt në urgjencë.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë" nenet 98-102, Titullari i Njësisë Publike në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, **me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën 5,018,888 lekë** sipas gjetjeve dhe rekomandimeve të trajtuara më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 1013 prot., datë 10.10.2023, të lidhur ndërmjet Institutit të Shëndetit Publik të realizuar nga BOE "A. C." SHPK & "K." SHPK dhe mbikëqyrur nga "A." SHPK, me objekt *"Ndërtimi i godinës së re të laboratorëve në ISHP"* me vlerë totale 403,151,919 lekë me TVSH, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit teknik të zbatimit, situacionit nr. 11, librezave të masave dhe verifikimit në terren, në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe ato të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në realitet, me pasojë dëm ekonomik vlerën **2,511,691 lekë me TVSH**, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes si dhe me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 , faqe 86-231 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Instituti i Shëndetit Publik të marrë të gjitha masat e nevojshme ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës prej 2,511,691 lekë me TVSH nga BOE "A. C." SHPK & "K." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 1013 prot., datë 10.10.2023, me objekt *Ndërtimi i godinës së re të laboratorëve në ISHP.*

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 1592/19 prot., datë 11.07.2023, të lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe BOE "Z.K." SHPK & "I. G." SHPK dhe mbikëqyrës "N. S." SHPK, me objekt "*Rikonstruksioni i disa QSH-ve në qarqet Tiranë dhe Durrës*", me vlerë totale 48,533,724 lekë me TVSH, për nënobjektin *"Rikonstruksioni i QSH Paskuqan 2, Kamëz*", me vlerë 6,452,000 lekë me TVSH, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit teknik të zbatimit, situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe ato të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në realitet, me pasojë dëm ekonomik vlerën **1195,120 lekë me TVSH**, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes me nr. 1592/19 prot., datë 11.07.2023 dhe me parashikimet e bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 , faqe 86-231 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të marrë të gjitha masat e nevojshme ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës prej 195,120 lekë me TVSH nga BOE "Z.K." SHPK & "I. G." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 1592/19 prot., datë 11.07.2023, me objekt *Loti 1 Rikonstruksioni i disa QSH-ve në qarqet Tiranë dhe Durrës, nënobjekti Rikonstruksioni i QSH Paskuqan 2, Kamëz.*

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 1592/20 prot., datë 11.07.2023, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe OE "C." SHPK dhe mbikëqyrës "P. C." SHPK, me objekt *Loti 2 Rikonstruksioni i disa QSH-ve në Qarqet Berat, Korçë dhe Elbasan,* me vlerë totale 56,818,616 lekë me TVSH, *për nënobjektet Rikonstruksioni i QSH Maliq dhe Rikonstruksioni i QSH Roshnik* me vlerë totale 403,151,919 lekë me TVSH, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit teknik të zbatimit, situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe verifikimit në terren, në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe ato të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në realitet, me pasojë dëm ekonomik vlerën **630,720 lekë me TVSH**, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes si dhe me parashikimet e bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 , faqe 86-231 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të marrë të gjitha masat e nevojshme ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës prej 630,720 lekë me TVSH nga OE "C." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 1592/20 prot., datë 11.07.2023, me objekt *Loti 2 Rikonstruksioni i disa QSH-ve në Qarqet Berat, Korçë dhe Elbasan, për nënobjektet Rikonstruksioni i QSH Maliq dhe Rikonstruksioni i QSH Roshnik.*

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 1592/21 prot., datë 11.07.2023, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe "C." SHPK dhe mbikëqyrës "M." SHPK, me objekt *Loti 3 Rikonstruksioni i disa QSH-ve në qarqet Shkodër, Kukës, Lezhë dhe Dibër,* me vlerë totale 85,061,516 lekë me TVSH, *për nënobjektin Rikonstruksioni i QSH Velipojë* me vlerë 17,032,473 lekë me TVSH, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit teknik të zbatimit, situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe verifikimit në terren, në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe ato të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në realitet, me pasojë dëm ekonomik vlerën **499,017 lekë me TVSH**, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes si dhe me parashikimet e bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 86-231 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të marrë të gjitha masat e nevojshme ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës prej 499,017 lekë me TVSH nga OE "C." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 1592/21 prot., datë 11.07.2023, me objekt *Loti 3 Rikonstruksioni i disa QSH-ve në qarqet Shkodër, Kukës, Lezhë dhe Dibër, për nënobjektin Rikonstruksioni i QSH Velipojë*.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 1592/22 prot., datë 11.07.2023, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe OE I. SHPK me objekt *Loti 4 Rikonstruksioni i disa QSH-ve në Qarqet Gjirokastër, Vlorë dhe Fier,* me vlerë totale 85,061,516 lekë me TVSH, *për nënobjektet Rikonstruksioni i Ambulancës Lagjja "28 Nëntori", Rikonstruksioni i QSH Fshati Armen dhe Rikonstruksioni i Ambulancës Fshat Këlcyrë (Përmet)* me vlerë 17,032,473 lekë me TVSH, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit teknik të zbatimit,

situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe verifikimit në terren, në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe ato të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në realitet, me pasojë dëm ekonomik vlerën **813,796 lekë me TVSH**, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes si dhe me parashikimet e bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 , faqe 86-231 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1.Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të marrë të gjitha masat e nevojshme ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës prej 813,796 lekë me TVSH nga OE I. SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 1592/22 prot., datë 11.07.2023, me objekt *Loti 4 Rikonstruksioni i disa QSH-ve në Qarqet Gjirokastër, Vlorë dhe Fier, për nënobjektet Rikonstruksioni i Ambulancës Lagjja "28 Nëntori", Rikonstruksioni i QSH Fshati Armen dhe Rikonstruksioni i Ambulancës Fshat Këlcyrë (Përmet).*

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 1487/12 prot., datë 28.07.2022, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe OE "C." SHPK dhe mbikëqyrës "D." SHPK, me objekt *Loti 1 Rikonstruksion i disa QSH-ve në rajonet Tirana dhe Shkodër (13 Objekte)* me vlerë totale 67,002,102 lekë me TVSH, *për nënobjektin Rikonstruksioni i QSH Bicaj, Kukës* me vlerë 5,183,596 lekë me TVSH, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit teknik të zbatimit, situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe verifikimit në terren, në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe ato të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në realitet, me pasojë dëm ekonomik vlerën **178,082 lekë me TVSH**, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes si dhe me parashikimet e bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 , faqe 86-231 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1.Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të marrë të gjitha masat e nevojshme ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës prej 178,082 lekë me TVSH nga OE "C." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 1487/12 prot., datë 28.07.2022, me objekt *Loti 1 Rikonstruksion i disa QSH-ve në rajonet Tirana dhe Shkodër (13 Objekte), nënobjektin Rikonstruksioni i QSH Bicaj, Kukës*.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 1487/19 prot., datë 14.07.2022, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe BOE "I. G" SHPK & "Z." SHPK & "V.G." SHPK dhe mbikëqyrës "T." SHPK, me objekt *Loti 2 Rikonstruksion i disa QSH-ve në rajonet Elbasan dhe Vlorë (12 Objekte),* me vlerë totale 38,317,984 lekë me TVSH, *për nënobjektin Rikonstruksioni i Ambulancës Lagjja Brigada e 17 Sulmuese* me vlerë 5,183,596 lekë me TVSH, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit teknik të zbatimit, situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe verifikimit në terren, në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe ato të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në realitet, me pasojë dëm ekonomik vlerën **190,462 lekë me TVSH**, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes si dhe me parashikimet e bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 , faqe 86-231 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1.Rekomandimi: Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 190,462 lekë me TVSH nga BOE "I. G." SHPK & "Z." SHPK & "V. G." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 1487/19 prot., datë 14.07.2022, me objekt *Loti 2 Rikonstruksion i disa QSH-ve në rajonet Elbasan dhe Vlorë (12 Objekte), për nënobjektin Rikonstruksioni i Ambulancës Lagjja Brigada e 17 Sulmuese*.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit rezultoi se në një rast është aplikuar standard i dyfishtë në vlerësimin e ofertave. Konkretisht, një operator ekonomik është skualifikuar për mangësi në vetëdeklarime, ndërkohë që operatorë të tjerë, me mangësi të ngjashme në të njëjtin element, janë kualifikuar dhe shpallur fitues, konkretisht: në procedurën e prokurimit "Rikonstruksion i Qendrave Shëndetësore (viti 2023–2024)", Loti 4, me vlerë të prokuruar 75,168,475.93 lekë, është shpallur fitues operatori ekonomik I. sh.p.k., me ofertë në vlerën 57,625,120.8 lekë pa TVSH. Nga verifikimi rezultoi se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), në rastin e korrigjimit të gabimeve të vogla në ofertë, nuk ka ndjekur procedurën e parashikuar ligjërisht, pasi nuk ka paraqitur kërkesë zyrtare për njoftimin e operatorit ekonomik përkatës, me qëllim konfirmimin e pranimit të korrigjimit. Mos veprimi ka sjellë një efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit në vlerën 6,620,452.8 lekë pa TVSH. Veprime në kundërshtim me nenet 2 dhe 92 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, si dhe me pikën 2 të nenit 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 86-231 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale të marrë masa ngrejë një grupi pune për verifikimin e pasaktësive, dhe identifikimin e shkaqeve dhe përgjegjësive qe kane shkaktuar parregullsitë e konstatuara me efekt financiar negativ në buxhetin e Shtetit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të marrë masa për garantimin e përdorimit me efektivitet të fondeve në dispozicion, duke vlerësuar me kujdes dhe paanshmëri mangësitë që çojnë në skualifikimin e operatorëve ekonomik, sidomos në rastet kur kjo vendimmarrje shoqërohet me pasoja financiare.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për vitet 2023-2024 nga MSHMS janë ekzekutuar gjithsej 36 urdhër shpenzime për vendime gjyqësore, në vlerën totale prej 42,945,244 lekë, të cilat të analizuara sipas llojit dhe vlerës paraqiten si më poshtë:

Gjatë vitit 2023 janë ekzekutuar pjesërisht vendime gjyqësore të formës së prerë për 11 urdhra shpenzimesh, me një shumë të likuiduar prej 9,739,882 lekë.

Gjatë vitit 2024 janë ekzekutuar vendime gjyqësore të formës së prerë (pjesërisht) për 25 urdhra shpenzimesh, me një shumë të likuiduar prej 33,205,362 lekë.

Pagesat e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, paguhen në total pa diferencuar shumën e shpenzimeve përmbarimore. Vendimet gjyqësore nuk janë ekzekutuar vullnetarisht, pas marrjes së njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por është zbatuar nëpërmjet urdhrave të ekzekutimit të lëshuara nga përmbarues privatë, veprime në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, nenin 130, nenin 451/a dhe nenin 510/a. Shpenzimet

për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore ekzekutohen çdo vit për secilin gjyqfitues të pa rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës.
Moszbatimi i vendimeve gjyqësore për kthimin në detyrë të nëpunësve civilë përbën shkelje të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" dhe nenit 117 të Kodit të Procedurave Administrative, duke krijuar përgjegjësi ligjore dhe administrative për strukturat përkatëse dhe duke sjellë pasoja në të drejtat ligjore të individëve, si dhe rritjen e barrës financiare për institucionin.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 , faqe 56-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1 Rekomandimi: MSHMS duhet të vendosë një mekanizëm të qartë për zbatimin e menjëhershëm të të gjitha vendimeve gjyqësore të formës së prerë/
MSHMS të marrë masa për analizimin e përgjegjësive dhe përmirësimin e administrimit dhe menaxhimit me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike për shpenzimet mbi vendimet gjyqësore për ish-punonjësit në vlerën totale prej 42,945,244lekë**,** me qëllim parandalimin dhe eliminimin e efekteve negative të konstatuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. PËR AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në zbatim të programit të auditimit nr. 110/1 prot., datë 21.01.2025, i ndryshuar, me objekt "*Auditim i përputhshmërisë*", për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri në datën 31.12.2024, u konstatua se:
-Ndërmjet ASHPP, në cilësinë e organit qendror blerës dhe OE "R.-A." është lidhur Marrëveshja Kuadër nr. 75/11 prot., datë 24.04.2024, me objekt "*Blerje orendi dhe pajisje mobilimi për Qendrat Shëndetësore të rikonstruktuara*", me fond limit 35,203,770 lekë pa TVSH, dërguar për zbatim në MSHMS.
-Nëpërmjet shkresës së APP-së nr. 750/15 prot., datë 25.07.2024 "*Të dhëna mbi Vendimin nr. 73, datë 25.07.2024*", APP ka vendosur të përjashtojë OE "R.-A." nga e drejta për të fituar kontrata publike për 12 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
Në zbatim të marrëveshjes kuadër nr. 75/11 prot., datë 24.04.2024, ndërmjet AK "MSHMS" dhe OE është lidhur kontrata e furnizimit nr. 2019/11 prot., datë 07.08.2024, në vlerën prej 7,100,146.01 lekë pa TVSH dhe 8,520,175 lekë me TVSH, në një kohë kur ka qenë në fuqi Vendimi i APP-së nr. 73, datë 25.07.2024, për përjashtimin e këtij operatori nga e drejta për të përfituar kontrata publike.
Vendimi për përjashtimin e OE ka mbetur në fuqi deri në shkresën e APP-së nr. 5973/3 prot., datë 30.08.2024, pas Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka vendosur ndër të tjera pranimin e kërkesës së shoqërisë për marrjen e masës së sigurimit të padisë dhe pezullimin e aktit administrativ Vendimit të APP-së nr. 73/2024, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.
Nga auditimi u konstatua se Vendimi i APP-së për përjashtimin e operatorit ekonomik nga e drejta për të përfituar kontrata publike nuk përcakton në mënyrë të qartë nëse ky përjashtim shtrihet edhe mbi kontratat apo minikontratat që lidhen në zbatim të marrëveshjeve kuadër në fuqi apo vetëm mbi procedurat e reja të prokurimit. Në këto kushte krijohet paqartësi në zbatimin e legjislacionit të prokurimit publik, veçanërisht në rastet kur lidhen kontrata ose minikontrata në zbatim të një marrëveshjeje kuadër gjatë periudhës kur operatori ekonomik është subjekt i një vendimi për përjashtim nga kontratat publike, duke marrë në konsideratë edhe implikimet financiare, kohore

dhe administrative, si dhe risqet ligjore që mund të lindin nga ndërprerja e marrëveshjeve kuadër apo nga nevoja për nisjen e procedurave të reja të prokurimit për garantimin e furnizimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 , faqe 59-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Agjencia e Prokurimit Publik, bazuar në nenin 23 dhe nenin 132 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe në nenin 15, shkronjat c dhe ç të Ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", të vlerësojë dhe të përcaktojë nëse vendimet për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga e drejta për të përfituar kontrata publike shtrihen edhe mbi kontratat apo minikontratat e lidhura në zbatim të marrëveshjeve kuadër në fuqi, si dhe të orientojë autoritetet kontraktore mbi veprimet që duhet të ndërmarrin për garantimin e furnizimit, shërbimeve apo punëve objekt të këtyre marrëveshjeve..

1.2 Rekomandimi: Agjencia e Prokurimit Publik të shqyrtojë ligjshmërinë e lidhjes së kontratës nr. 2019/11 prot., datë 07.08.2024, ndërmjet AK "MSHMS" dhe OE "R.-A.", në kushtet kur për OE ka qenë në fuqi një Vendim i APP-së për përjashtimin nga e drejta për të fituar kontrata publike.

Menjëherë

E. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit në marrëdhënie pune:

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja, mbështetur në nenin 15 *"Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së"*, shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, nenin 58 të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil"*, **i rekomandojmë Titullarit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale**, ngrejë Komisionin Disiplinor pranë institucionit, dhe bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për adresuar më poshtë, duke siguruar marrjen e masave disiplinore ***"Vërejtje deri në mos ngritje në detyrë":***

1. E. M., me detyrë specialiste në Sektorin e Buxhetit lidhur me mangësitë e konstatuara në realizimin e procedurave të prokurimit, në cilësinë e anëtarit të komisionit për vlerësimin e ofertave;
2. O. A., me detyrë Përgjegjës i Sektorit për Këshillimin Ligjor, lidhur me mangësitë e konstatuara në realizimin e procedurave të prokurimit, në cilësinë e anëtarit të komisionit për vlerësimin e ofertave;
3. R. H., lidhur me mangësitë e konstatuara në realizimin e procedurave të prokurimit, në cilësinë e në cilësinë e specialistit të fushës për hartimin e specifikimeve teknike. Kjo masë duhet ti adresohet Titullarit të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", duke qenë se specialisti është pjesë e strukturës së këtij institucioni.
4. V. H., me detyrë specialiste në Sektorin e Investimeve, lidhur me mangësitë e konstatuara në realizimin e procedurave të prokurimit, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave;
5. J. S., me detyrë specialiste në Sektorin e programeve të shëndetit publik, promocionit dhe parandalimit, lidhur me mangësitë e konstatuara në realizimin e procedurave të prokurimit, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave;

6. N. K., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme, Çështjeve Juridike dhe Emergjencave, lidhur me mangësitë e konstatuara në realizimin e procedurave të prokurimit, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit për zbatimin e kontratës;
7. R. M., me detyrë specialiste në Sektorin e Investimeve në cilësinë e anëtarit të komisionit për zbatimin e kontratës
8. E. K., me detyrë specialiste për emergjencat, në cilësinë e anëtarit të komisionit për zbatimin e kontratës dhe marrjes në dorëzim të aktiveve.

Për punonjësit e larguar:
Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë, nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre:

1. S. K.
2. M. Sh

E1. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRTËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL.
Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:
1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", të ndryshuar.
2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të Ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", të ndryshuar.

F. MASA ADMINISTRATIVE
Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit përcaktuar në nenet 7/1 dhe 12, Kreu III, dhe nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar dhe UKM nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikeqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, të ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2014 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Per Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit", i rekomandojmë Titullarit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, t'i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Tiranë, sipas kontratave respektive, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të nxjerrë vendime për marrjen e masave dhe sanksioneve administrative për operatorët ekonomik në rolin e mbikqyrësve, si vijon:

1. Subjekti “A.” SHPK, për kontratën me nr. 1013 prot., datë 10.10.2023 me objekt *“Ndërtimi i godinës së re të laboratorëve në ISHP”*.
2. Subjekti “N. S.” SHPK, për kontratën nr. 1592/19 prot., datë 11.07.2023 me objekt *“Rikonstruksioni i QSH Paskuqan 2, Kamëz*”.
3. Subjekti “P. C.” SHPK, për kontratën me nr. nr. 1592/20 prot., datë 11.07.2023, me objekt *“Rikonstruksioni i QSH Maliq dhe Rikonstruksioni i QSH Roshnik”*.
4. Subjekti “M.” SHPK, për kontratën me nr. 1592/21 prot., datë 11.07.2023 me objekt *“Rikonstruksioni i QSH Velipojë”*.
5. Subjekti BOE “H.C.” SHPK & “P. C.” SHPK, për kontratën me nr. 1592/22 prot., datë 11.07.2023, me objekt *Rikonstruksioni i Ambulancës Lagjja “28 Nëntori”, Rikonstruksioni i QSH Fshati Armen dhe Rikonstruksioni i Ambulancës Fshat Këlcyrë (Përmet).*
6. Subjekti “D.” SHPK, për kontratën me nr. 1487/12 prot., datë 28.07.2022 me objekt *Rikonstruksioni i QSH Bicaj, Kukës.*
7. Subjekti “T.” SHPK, për kontratën me nr. nr. 1487/19 prot., datë 14.07.2022 me objekt *Rikonstruksioni i Ambulancës Lagjja Brigada e 17 Sulmuese.*

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT